



**Republika e Shqipërisë  
Universiteti i Tiranës  
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë  
Departamenti i Gjuhës shqipe**



**Tezë në kërkim të gradës shkencore  
“DOKTOR”**

**Fusha : Gjuhësi  
Specialiteti: Leksikologji**

**LEKSIKU APELATIV E ONOMASTIK NË MAKRO E  
MIKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES E  
DYGJUHËSH TË SHQIPES**

**Doktorant  
Isuf BAZAJ**

**Udhëheqës shkencor  
Prof. dr. Çlirim BIDOLLARI**

**Tiranë, 2014**



**Republika e Shqipërisë  
Universiteti i Tiranës  
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë  
Departamenti i Gjuhës shqipe**



**LESIKU APELATIV E ONOMASTIK NË MAKRO E  
MIKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES E  
DYGJUHËSH TË SHQIPES**

**Doktorant**

**Ma. Isuf BAZAJ**

**Udhëheqës shkencor**

**Prof. dr. Çlirim BIDOLLARI**

**Tiranë, 2014**

# DISERTACION

**Përgatitur nga: Isuf BAZAJ**  
**Për marrjen e gradës shkencore “Doktor”**  
**Fusha: Gjuhësi**  
**Specialiteti: Leksikologji.**

## **LEKSIKU APELATIV E ONOMASTIK NË MAKRO E MIKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES E DYGJUHËSH TË SHQIPES**

**Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Çlirim BIDOLLARI**

**Mbrohet më, 10.06.2014 para jurisë :**

- |                         |                            |                       |
|-------------------------|----------------------------|-----------------------|
| <b>1. Prof. dr.</b>     | <b>Valter Memisha.....</b> | <b>Kryetar</b>        |
| <b>2. Prof. dr.</b>     | <b>Enver Hysa.....</b>     | <b>Anëtar oponent</b> |
| <b>3. Prof. as. dr.</b> | <b>Idriz Metani.....</b>   | <b>Anëtar oponent</b> |
| <b>4. Doc. dr.</b>      | <b>Ardian Dako.....</b>    | <b>Anëtar</b>         |
| <b>5. Prof. dr.</b>     | <b>Dhimitri Bello.....</b> | <b>Anëtar</b>         |

## PASQYRA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	4
<b>KREU I</b> Kronologjia e botimeve leksikografike të shqipes.....	11
1.1 Çështje të përgjithshme.....	11
1.2 Etapat e zhvillimit të leksikografisë shqipe.....	13
1.3 Fjalorë dygjuhësh.....	18
1.4 Fjalorë dialektorë e krahinorë.....	20
1.5 Fjalorë specialë .....	23
1.6 Fjalorë terminologjikë.....	24
<b>KREU II</b> Krahasimi i ndryshimit të makrostrukturës në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe .....	26
2.1 Çështje të përgjithshme.....	26
2.2 Pasqyrimi i leksikut të gjuhës shqipe në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues .....	31
2.2.1 Leksiku në shkronjën A si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	34
2.2.2 Leksiku në shkronjën B si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	37
2.2.3 Leksiku në shkronjën C si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	40
2.2.4 Leksiku në shkronjën Ç si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH .....	42
2.2.5 Leksiku në shkronjën DH si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	44
2.2.6 Leksiku në shkronjën F si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	46
2.2.7 Leksiku në shkronjën H si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	48
2.2.8 Leksiku në shkronjën K si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	50
2.2.9 Leksiku në shkronjën LL si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	52
2.2.10 Leksiku në shkronjën O si pjesë e makrostrukturës në FSHGJSH.....	53
<b>KREU III</b> Prirjet e zhvillimit të leksikut të gjuhës shqipe të pasqyruara në fjalorët shpjegues të saj.....	55
3.1 Zhvillimi i kuptimit të fjalëve.....	55
3.2 Ndikimi i fjalëformimit në shtimin e numrit të fjalëve në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të GJSH.....	72
3.2.1 Çështje të përgjithshme.....	72
3.2.2 Ndikimi i ndajshmesimit në shtimin e numrit të fjalëve në makrostrukturën e	

fjalorëve shpjegues të GJSH.....	74
3.2.3 Ndikimi i përbërjes e përngjitjes në shtimin e numrit të fjalëve në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues GJSH.....	80
3.3 Ndikimi i leksikut dialektor në shtimin e numrit të fjalëve në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues GJSH.....	82
3.4 Grupet tematike me burim popullor të pasqyruara FSHGJSH.....	87
3.5 Kategoritë leksiko-gramatikore me zhvillim më të madh.....	95
<b>KREU IV Rreth karakteristikave stilistike të fjalëve në FSHGJSH.....</b>	<b>104</b>
4.1 Çështje të përgjithshme.....	104
4.2 Fjalët stilistikisht asnjëse në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe.....	110
4.3 Pasqyrimi i fjalorit terminologjik në makrostrukturën e FSHGJSH.....	116
4.4 Shtresa e fjalëve me funksione stilistike - ligjëimore në FSHGJSH.....	124
4.5 Shtresa e fjalëve me kufizim në rrafshin territorial të pasqyruara në makrostrukturën e FSHGJSH.....	127
4.6 Karakteristikat stilistike të fjalëve në boshtin kohor, pjesë e makrostrukturës së FSHGJSH.....	130
4.7 Shtresa e fjalëve me ngjyime emocionale - vlerësuese në makrostrukturën e FSHGJSH.....	133
4.8 Fjalët me shënime të tjera jogramatikore në makrostrukturën e FSHGJSH.....	135
<b>KREU V. Mikrostruktura në FSHGJSH.....</b>	<b>139</b>
5.1 Çështje të përgjithshme.....	139
5.2 Drejtshkrimi i njësive leksikore.....	141
5.3 Norma e shqiptimit të njësive leksikore dhe theksi.....	145
5.4 Pasqyrimi i veçorive gramatikore të fjalëve në FSHGJSH.....	146
5.5 Struktura kuptimore dhe shpjegimet e kuptimit të fjalëve.....	148
5.6 Veçori të paraqitjes së thënieve ilustruese në FSHGJSH.....	158
5.7 Veçoritë e përdorimit të shembujve në FSHGJSH.....	162
5.8 Fjalë që duhet të pasqyrohen në makrostrukturën e FSHGJSH.....	167
<b>KREU VI. Onomastika një shkencë e re gjuhësore.....</b>	<b>171</b>
6.1 Fillimet e studimeve onomastike për gjuhën shqipe.....	171
6.2 Stabilizimi i termave në onomastikë.....	181
6.3 Standardizimi i elementeve onomastike.....	188

<b>KREU VII.</b> Pasqyrimi i fjalësit onomastik në FSHGJSH.....	192
7.1 Etnonimet si kategori e ndërmjetme midis emrit të përveçëm dhe apelativit.....	192
7.2 Vendi i etnonimeve në FSHGJSH .....	197
7.2.1 Fjalësi onomastik në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954.....	202
7.2.2 Fjalësi onomastik në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980.....	204
7.2.3 Fjalësi onomastik në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006.....	205
7.2.4 Fjalësi onomastik në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984.....	208
<b>KREU VIII.</b> Antroponimet dhe patronimet me frekuencë më të lartë përdorimi në fjalësin onomastik shqip.....	211
8.1 Antroponimet me frekuencë më të lartë përdorimi.....	211
8.1.1 Emrat vetjakë të ardhur nga leksiku i përgjithshëm.....	211
8.1.2 Emrat e përveçëm me burim vendës.....	215
8.1.3 Emrat vetjakë me burim të huaj.....	222
8.2. Patronimet me frekuencë më të lartë përdorimi.....	225
<b>KREU IX.</b> Vendi i fjalësit onomastik në disa fjalorë dygjuhësh.....	238
9.1 Çështje të përgjithshme.....	238
9.2 Fjalësi onomastik në fjalorin dygjuhësh të Hetzerit.....	239
9.3 Krahasimi i fjalësit onomastik të fjalorit të Hetzerit me “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984.....	243
9.4 Fjalësi onomastik në fjalorin gjermanisht - shqip të A.Dhrimos.....	246
<b>KREU X.</b> Informacionet jashtë nomenklaturës në FSHGJSH.....	248
<b>PËRFUNDIME</b> .....	256
<b>ABSTRAKTI</b> .....	266
<b>FJALORË TË SHFRYTËZUAR</b> .....	269
<b>BIBLIOGRAFI DHE LITERATURË E KONSULTUAR</b> .....	270

## HYRJE

Gjuha si mjete më i nderlikuar dhe më i rëndësishëm e i mrekullueshëm që ka në dorë njeriu për të komunikuar, është jo vetëm një pasqyrë e historisë dhe e jetës së tij, por edhe një forcë e gjallë që e ndihmon atë të zhvillohet e të ecë përpara. Në themel të saj qëndron fjala në të cilën përqëndrohen në një tërësi tingulli, kuptimet, trajtat dhe marrëdhëniet e ndryshme që ajo ka, e kaluara e sotmja dhe prirjet e zhvillimit në të ardhmen. Kjo është arsyeja që i jep rëndësi të dorës së parë studimit të pasurisë leksikore e frazeologjike të gjuhës, rrugëve e mjeteve kryesore që shërbejnë për zgjerimin e mëtejshëm të kësaj pasurie. Por që një gjuhë të njihet në gjithë gjerësinë e saj dhe fjalët të gdhenden fort në kujtesën historike të kombit e të mos treten, duhet të shkruhen në libra të veçantë, sipas kriterëve të caktuar.

Më mirë se cilado vepër a botim me karakter popullarizues apo shkencor, me fjalët e mbarë gjuhës apo të një dialekti a të folmeje, me termat e një fushe të caktuar të shkencës, teknikës etj., këtë e bëjnë fjalorët, të cilët pavarësisht nga sasia e lëndës leksikore, frazeologjike dhe semantike që sjellin, kanë vlera të mëdha në rrafshin regjistruar.

Fjalori është një objekt kulture që paraqet leksikun e një apo disa gjuhëve në trajtë alfabetike duke na dhënë për fjalët një informacion për kuptimin e tyre dhe të njësive frazeologjike, veçoritë gramatikore, fushat e përdorimit për disa njësi, theksin e drejtshkrimin e fjalëve, informacione që jepen në makrostrukturën e mikrostrukturën, sidomos të fjalorëve shpjegues. Pra fjalori është një vepër që fikson, që regjistron një gjendje të dhënë të leksikut të gjuhës. Leksiku i një gjuhe nuk është një grumbull fjalësh, por një sistem njësisht, që klasifikohen sipas kriterëve nga nisemi.

Ky punim doktoral është një përpjekje për të evidentuar, shtruar e zgjidhur një sërë problemesh të praktikës leksikografike të gjuhës shqipe, që kanë të bëjnë me aparatën plotësues të Fjalorit të madh shpjegues të gjuhës shqipe, por edhe të fjalorëve të tjerë, si fjalorët dygjuhësh. Problematika e fjalorëve shpjegues është e larmishme, por e renditur në çështje do të merrte këtë pamje:

- A janë zgjedhur mirë e drejt fjalët që janë futur në makrostrukturën e fjalorit?
- Deri në ç' masë është futur në makrostrukturën e fjalorit shpjegues leksiku special që përfshin terminologjinë dhe fjalët profesionale?
- Ç' peshë zënë fjalët e huaja në makrostrukturën e fjalorit dhe a janë të vlefshme për t'u përfshirë të gjitha aty?
- Ç' vend zë fjalësi onomastik në fjalësinë e fjalorit dhe a duhet pasqyruar ai në nomenklaturë e tij apo jashtë nomenklaturës?

Përgjigjet që do të marrin këto pyetje, apo dhe të tjera, do të përcaktojnë edhe mënyrën e zgjidhjes për një fjalor normativ, pra zgjedhjen e fjalëve që do të përbëjnë makrostrukturën e tij, që përbën detyrën themelore të hartuesit të një fjalori shpjegues.

Gjuha shqipe tashmë është formuar si gjuhë kombëtare e njësuar ose si standard i përgjithshëm me norma të ngulitura në të gjitha nënsistemet e saj. Ajo ka arritur në këtë shkallë nëpër një rrugë të gjatë e të vështirë, duke i bërë ballë ndikimit të huaj asimilues, duke kapërcyer ndarjen dialektore dhe duke zhvilluar trajtat e saj të përbashkëta. Gjuha standarde nuk është e ngrirë, ajo zhvillohet gjithnjë së brendshmi, me mundësitë e saj të zhvillimit, si dhe nëpërmjet veprimit të përbashkët të të dy dialekteve mbi të. Gjuha jonë ka zgjeruar shumë edhe funksionet shoqërore duke u shtrirë në të gjitha fushat e jetës.

Shqipja standarde ka fituar tipare të dallueshme edhe në fushën e leksikut, të frazeologjisë e formimit të fjalëve. Veçori e leksikut të gjuhës standarde shqipe është se të dy dialektet marrin pjesë njësoj si në bërthamën e leksikut të gjuhës standarde, ashtu edhe në pasurimin e tij të mëtejshëm. Ndaj pasuria leksikore dhe frazeologjike është pasuri e përbashkët kulturore kombëtare, pavarësisht nga burimi i saj.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i leksikut të shqipes standarde është prirja për pastrimin nga fjalët e huaja të panevojshme. Çështja e pastirimit të leksikut të gjuhës letrare nga lënda e huaj, si dhe e pasurimit të tij me mjetet e vetë shqipes, është bërë tani një çështje jo vetëm e gjuhëtarëve, por edhe e shtrësve të tjera të shoqërisë, sidomos njerëzve të arsimit, kulturës, shkrimtarëve, përkthyesve, publicistëve e specialistëve të fushave të ndryshme.

Leksiku i gjuhës shqipe shquhet për begatinë e mjeteve të shprehjes dhe mjeteve emocionuese, që i japin ligjërimin shkathtësi e forcë të veçantë dhe zhvillojnë më tej sistemin e stileve funksionale. Shprehje e kësaj begatie janë letërsia artistike, publicistika e folur dhe e shkruar, ligjërimi bisedor në situata të ndryshme etj.

Mbështetur në këtë pasuri leksikore të pasqyruar në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, qëllimi i punimit tonë është të trajtohen këto dy çështje:

1. Të evidentojë zhvillimin e fjalësit të përgjithshëm të gjuhës shqipe, në mënyrë vertikale (numër fjalësh) e horizontale (numër kuptimesh), duke filluar me fjalorin e parë shpjegues të gjuhës shqipe, “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, e deri te fjalori i fundit shpjegues “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, si pjesë të makrostrukturës, si dhe të të japë një pamje të mikrostrukturës së këtyre fjalorëve.
2. Të monitorojë gjendjen e fjalësit onomastik në fjalorët ekzistues shpjegues të gjuhës shqipe dhe në disa fjalorë dygjuhësh, konstatimi i problemeve, krahasimi me fjalorë të ngjashëm të gjuhëve të tjera dhe dalja me zgjidhje sa më të



pranueshme e të qëndrueshme për t'u stabilizuar pasqyrimi i këtij leksiku edhe në fjalorët shpjegues, jo vetëm në ata onomastikë.

Për të arritur këto qëllime janë shfrytëzuar këta fjalorë njëgjuhësh e dygjuhësh:

- “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954.
- “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980.
- “Fjalori i shqipes së sotme” 1984.
- “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006.
- “Fjalori gjermanisht - shqip e shqip - gjermanisht” i A.Hetzerit, 1991.
- “Fjalori gjermanisht - shqip” i Ali Dhrimos, 2002.
- Bleta shqiptare, Thimi Mitko (botim i vitit 1981).
- “Vëzhgime për emrat familjarë të shqiptarëve”, Jusuf Shpuza, 1998.
- “Antroponimia e shqiptarëve të kosovës”, Rexhep Doçi, 1990.

Gjithashtu janë shfrytëzuar shumë botime me elemente onomastike të trevave të ndryshme të banuara nga shqiptarët në Kosovë, Maqedoni e Mali i Zi. Për realizimin e punimit është shfrytëzuar një literaturë e gjerë shkencore ku trajtohen problemet e fjalësit apelativ e onomastik për fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe e fjalorët dygjuhësh, apo shumëgjuhësh.

Metodologjia e punës.

Metodat e përdorura në punën tonë kërkimor janë ato të vëzhgimit, analizës së tekstit e induksionit. Pasi kemi grumbulluar materialin leksikor sipas kërkesave paraprake, kemi bërë klasifikimin e tij sipas kriterëve të përcaktuara që më parë në platformën e temës. Kjo është bërë për çdo fjalor shpjegues të gjuhës shqipe dhe për fjalorët dygjuhësh të marrë në analizë. Më pas kemi evidentuar gjërate përbashkëta dhe ndryshimet midis tyre, sidomos në numrin e fjalëve e kuptimeve në fjalësin e fjalorëve shpjegues, si pjesë e makrostrukturës, por edhe ndryshimet në mënyrën e paraqitjes, informacionit që japin për njësitë leksikore, si pjesë e mikrostrukturës. Dallime vihen re në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe dhe në ata dygjuhësh edhe nivelin dhe mënyrën e pasqyrit të fjalësit onomastik. Materiali për gjithë çështjet e fjalësit apelativ është vjelë në mënyrë shteruese në shkronjat A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, 1954, 1980 dhe 2006. Për fjalësin onomastik vjelja e materialit është bërë në fjalësin e gjithë makrostrukturës së fjalorit dhe në të gjithë fjalorët që kemi marrë në analizë. Për materialin e vjelë kemi hartuar tabela për çdo çështje të trajtuar.

Në kapitullin e parë flitet për rëndësinë dhe objektin e leksikografisë, si një nga fushat e gjuhësisë, që është hartimi i fjalorëve të tipave të ndryshëm, si dhe për etapat e zhvillimit të leksikografisë shqipe. “Lëksikografia shqipe, -thotë J.Thomai,- është fusha më e hershme dhe më e pasur në gjuhësinë tonë dhe mund të themi madje, që vetë

historia e gjuhës shqipe nis me një vepër leksikografike, me një fjalor. Po të lëmë mënjanë “fjalorthët” e Arnold von Harfit (1497) dhe Pjetër Mazrekut (1633), lista me dhjetëra fjalë shqipe, - guri i parë në rrugën e gjatë të leksikografisë shqipe mbetet fjalori “latinisht-shqip” (1635) i Frang Bardhit, vepër leksikografike e mirëfilltë pavarësisht nga numri i fjalëve shqipe”<sup>1</sup> Në rubrika të veçanta jepen botimet me fjalorë të llojeve të ndryshme si, fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, fjalorë dygjuhësh, fjalorë dialektorë e krahinorë, fjalorë specialë dhe fjalorë terminologjikë.

Në kapitullin e dytë analizojmë pasqyrimin e fjalësit të gjuhës shqipe në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të saj, 1954, 1980 dhe 2006. Ndërsa fjalësi i shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O, analizohet në gjithë problematikën, në numrin e fjalëve të përbashkëta në të tre fjalorët e ndryshimet midis tyre, fjalët që gjenden në fjalësin e këtyre shkronjave, por edhe për ato që nuk gjenden aty. Ndryshimet jepen jo vetëm në numër fjalësh, por jepen shembuj të shumtë për konkretizim si dhe zhvillimi i strukturës kuptimore të shumë njësive leksikore. Informacioni jepet i pasqyruar në tabela.

Në kapitullin e tretë flitet për prirjet e zhvillimit të leksikut të gjuhës shqipe, pasqyruar në fjalorët shpjegues, për ndikimin e ndajshitesimit, përbërjes e përngjitjes në shtimin e numrit të fjalëve në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues dhe rolin e leksikut dialektor në këtë pasurim. Aty flitet për grupet me burim popullor të pasqyruara në këta fjalorë dhe kategoritë leksiko-gramatikore me zhvillim më të madh. Për këto informacione jepen tabela krahasuese.

Në kapitullin e katërt flitet për karakteristikat stilistike të fjalëve në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Bëhet krahasimi i fjalësit të cilësuar stilistikisht dhe atij të pacilësuar për fjalësin e gjithë shkronjave të mësipërme, në të tre fjalorët shpjegues të marrë në analizë. Një vend të veçantë zë pasqyrimi i fjalorit terminologjik në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe si dhe shtresa e fjalëve me funksione stilistikore ligjërimore, fjalëve me kufizim në rrafshin territorial, karakteristikat stilistike të fjalëve në boshtin kohor, shtresa e fjalëve me ngjyrimë emocionale-vlerësuese si dhe fjalët me shënime të tjera jogramatikore. Gjithë ky informacion jepet me tabela.

Në kapitullin e pestë flitet për mikrostrukturën në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, si drejtshkrimi i njësive leksikore, normat e shqiptimit të tyre, pasqyrimi i veçorive gramatikore të fjalëve, struktura kuptimore dhe shpjegimet e kuptimit të fjalëve, veçoritë e paraqitjes së thënieve ilustruese, veçoritë e përdorimit të shembujve, si dhe për një kategori fjalësh që mendojmë se duhet të zënë vend në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës sonë.

---

<sup>1</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.317

Në kapitullin e gjashtë, të dhëna dhe në tabelë, pasqyrohet informacioni jashtë nomenklaturës në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe 1954, 1980, 1984 dhe 2006. Aty evidentohen ndryshimet që vihen në re në të gjithë fjalorët shpjegues, si dhe natyra e ndryshimeve.

Në kapitullin e shtatë flitet për fillimet e studimeve onomastike për gjuhën shqipe, stabilizimin e termave në onomastikë, standartizimin e elementeve onomastike dhe etnonimet si kategori e ndërmjetme midis emrit të përveçëm dhe apelativit.

Në kapitullin e tetë flitet për vendin e etnonimeve në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Në pasqyra të veçanta jepet fjalësi onomastik në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1980, në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984 dhe “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006. Një vend të veçantë zë pasqyrimi i fjalësit onomastik në disa fjalorë dygjuhësh. Gjithë informacioni për këtë kapitull jepet me pasqyra, ku evidentohet fjalësi onomastik në fjalësin e çdo shkronjë dhe për gjithë fjalorin.

Në kapitullin e nëntë jepet një informacion për antroponimet, apo emrat vetjakë të njerëzve, patronimet, apo emrat familjarë përkatës të tyre, që kanë frekuencë relativisht më të lartë përdorimi në shqipëri, material i vjelë nga vepra të ndryshme me lëndë onomastike në gjuhën shqipe. Antroponimet janë ndarë në dy grupe të mëdha: emra vetjakë me burim vendës dhe emra vetjakë me burim të huaj, kryesisht me burim fetar. Fjalët e grupit të parë janë ndarë në emra shqiptarë ku dallohen emra historikë, emra me origjinë nga bota bimore e fauna, emra nga fjalësi apelativ si dhe emra me lëndë shqiptare, pasi përveç lëndës shqiptare kanë edhe ndikim të jashtëm të kohës., ambientit apo kontaktit me kultura të tjera. Fjalët e grupit të dytë janë ndarë në emra vetjakë myslymanë, gjermanikë e anglo-saksonë dhe emra me origjinë greke.

Gjithashtu në këtë kapitull janë sjellë njëqind patronimet me frekuencë më të lartë përdorimi, të cilët janë ndarë në disa tipa sipas prejardhjes së tyre në: emra familjesh të prejardhura nga emra të parë (emra personi), emra familjesh të ardhur nga toponimet, dhe emra familjesh të ardhur nga emërtime profesionesh, funksionesh a ofiqesh.

Në kapitullin e dhjetë jepen përfundimet për punën e kryer dhe sugjerimet për përmirësimin e punës në pasqyrimin e fjalësit apelativ e onomastik në fjalorët shpjegues e dygjuhësh. Në kushtet e sotme kjo bëhet më urgjente, kur shqipja standarde, si faza më e lartë e zhvillimit të gjuhës, po përjeton zhvillim të shumanshëm, të hovshëm si dhe përballje me sfidat e reja të hapjes me botën, sepse, gjuha e njësuar si një madhësi kulturore që u formua në një etapë të caktuar të zhvillimit politik e shoqëror të kombit shqiptar, po u shërben kërkesave në rritje të bashkësisë së shqiptarëve, duke u bërë shprehëse e njësisë kombëtare, treguese e identitetit, gjallërisë së kombit tonë, baza mbi të cilën ngrihet dhe përcillet kultura dhe përvoja e tij.

Gjuha shqipe e njësuar ka nevojë të plotësojë sistemin e vet leksiko-semantik e leksiko-stilistik me njësi të reja, prandaj ajo i është drejtuar ngaherë gjithë hapësirës gjuhësore shqipe, jo vetëm dialekteve që përfshihen në truallin e sotëm, por edhe nëndialekteve jashtë këtij trualli, te arbëreshët e italisë e Greqisë, te shqiptarët e Maqedonisë, Malit të Zi dhe në shtetin e Kosovës, kudo ku flitet shqip. Ajo vazhdon të thithë vlera, pavarësisht se nga cilat troje vijnë ato, duke iu përgjigjur menjëherë nevojave të praktikës edhe nëpërmjet fjalëve të reja, ndaj ato duhen përfshirë me guxim në fondin e fjalëve të shqipes standarde e të gjejnë pasqyrim në fjalorët shpjegues të saj. Për leksikografia shqipe, mund të themi se, është në një rrugë që po njeh ngjitje. Ajo tani është në gjendje të shtrojë dhe të zgjidhë detyra më të vështira për të pasqyruar mirë zhvillimin e leksikut si sistem, gjë që do të ndodh me hartimin e Fjalorit të Madh të gjuhës shqipe.

Kur të kalohet në fjalor të tipit të madh, problemet do të jenë më të thjeshta nga pikëpamja e zgjedhjes së fjalësit, duke mbajtur gjithmonë parasysh që një fond i mirë leksikor tashmë është grumbulluar e sistemuar, lëvizjet vertikale e horizontale të shtresave të leksikut të shqipes janë stabilizuar, prurjet e reja nuk janë më në gjendjen e flukseve, por kanë zënë vend. Çështja e përzgjedhjes së fjalëve vështirësohet kur shtrohet në trajtë pyetjeje: ç' do të lëmë jashtë glosarit?, sesa në trajtën e pyetjes tjetër: ç' do të përfshijmë në glosar?

Marrëdhënia e drejtë dhe e bazuar shkencërisht midis përfshirjes dhe përjashtimit të kategorive e grupeve të caktuara të fjalëve mund të sjellë prishje të baraspeshës midis tipeve të fjalëve barbarizma e fjalë shqipe, neologjizma e historizma, fjalë në përdorim të gjerë e krahinorizma, terminologjizma e letrarizma, fjalë neutrale e me ngjyrim emocional në pikëpamje të stilit etj.

Fjalori normativ, me glosarin e vet, duhet të pasqyrojë prirjet e leksikut të shqipes dhe të provojë me objektivitetin e hartimit të tij se leksiku i shqipes është në lëvizje të pandërprerë, e cila shpie në krijimin e disa gjendjeve të tilla, që japin arsye për identifikimin e këtyre shtresave të leksikut. Fjalorët shpjegues të shqipes, të hartuar deri më sot, nuk na japin dorë për të bërë një pohim objektiv për këtë zhvillim, sepse koha e hartimit të tyre ka qenë e shkurtër.

Me përvojën e derisotme të arritjeve, me kapërcimin e pengesave të natyrave të ndryshme, në kushtet e lirisë akademike të punës me projekte e të pikëpamjeve të hapura e të pakushtëzuara politikisht e ideologjikisht, puna për hartimin e fjalorëve duhet të synojë standardet më të larta të veprave të ngjashme që hartohen sot në vendet demokratike.

Me të gjitha këto të dhëna, si edhe me aparat plotësues me informacion enciklopedik për gjuhën e kulturën e shqiptarëve në trajtë shtojcash (emërtime gjeografike,

kontinentesh, pjesësh të tyre, gadishujsh e ishujsh të mëdhenj, oqeanësh, malesh, detesh, lumenjsh, liqenesh, si dhe emra fshatrash të Shqipërisë e të trojeve jashtë saj të banuara me shqiptarë, emra vetjakë të krishterë e myslimanë në trajtat e tyre të plota dhe patronime shqiptarësh të tre besimeve fetare, fjalori i madh shpjegues i gjuhës shqipe do të jetë jo vetëm një fjalor gjuhësor thjesht shpjegues, por edhe një objekt kulture me dobi të madhe për të gjithë përdoruesit e tij.

Ky punim, veç të tjerash, ka dhe karakter kritik në analizën e vlerësimin që i bën prodhimin leksikografik të deritashëm, ndaj dhe fillon me marrjen në analizë të disa veprave, në të cilat, me një vështrim kritik, janë evidentuar problemet e janë vlerësuar zgjidhjet që janë dhënë në një kontekst të caktuar historik, por dhe në një gjendje të caktuar të zhvillimit të vetë gjuhës.

Gjej rastin të shpreh mirënjohje dhe falënderim të veçantë për udhëheqësin shkencor **prof. dr. Çlirim Bidollari**, që me udhëzimet profesionale, me konsultimet e vazhdueshme, të pakursyera e dashamirëse, për kurajon që më dha, duke ndihmuar për realizimin me sukses të plotë të kësaj teme disertacioni.

Falënderoj gjithashtu **stafin akademik të Departamentit të Gjuhës shqipe**, të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, të UT, që më krijuan mundësinë e ndjekjes së këtij programi studimesh me miratimin e temës doktrale dhe për ndihmën e herëpashershme që kanë dhënë gjatë këtyre viteve. Një falënderim i veçantë për Drejtorin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, **prof.dr. Valter Memisha**, për mundësitë e krijuara, nëpërmjet shkollës doktrale, të paraqesim e diskutojmë punimet tona në konferencat shkencore të organizuara aty, duke plotësuar në kohë edhe kushtet për mbrojtjen e disertacionit. Gjithashtu falënderoj **prof. dr. Thanas Feka** për këshillat e orientimet e pakursyera në disa çështje të trajtuara në këtë tezë.

## KREU I

### KRONOLOGJIA E BOTIMEVE LEKSIKOGRAFIKE TË SHQIPES

#### 1.1 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Popujt në rrugën e zhvillimit të tyre historik kanë krijuar thesare të paçmuara materiale e shpirtërore. Fjala shqipe është krijesë e pavdekshme e popullit tonë, është vetë jeta e historia e tij. Ajo vjen nga thellësitë e shekujve me përpjekjet për mbijetesë dhe me qëndrueshmërinë e vet ka regjistruar vlera të shuanshme që i shfaq, si asnjëherë, në ditët e sotme, kur zhvillimi i gjuhës njeh ritme të papara më parë. Kjo pasuri e madhe është bërë objekt studimi i gjuhësisë në të gjitha fushat e saj.

Që një gjuhë të njihet në gjithë gjerësinë e saj dhe fjalët të gdhenden fort në kujtesën historike të kombit e të mos tretien, ato duhet të shkruhen, duke i renditur në libra të veçantë, sipas kriterëve të caktuar. Më mirë se cilado vepër apo botim, me karakter popullarizues apo shkencor, me fjalët e mbarë gjuhës apo të një dialekti a të folmeje, me termat e një fushe të caktuar të shkencës, teknikës etj., këtë e bëjnë fjalorët, të cilët pavarësisht nga sasia dhe cilësia e lëndës leksikore, frazeologjike dhe semantike që sjellin, kanë vlera të veçanta në rrafshin regjistruar. Si të tillë fjalorët, të të gjitha llojeve, janë ndër librat e parë dhe një nga shtyllat e gjuhës që mbajnë gjallë memorjen e një kombi dhe vendi ku mund të ndjekësh studime të fushave të ndryshme.

Leksikografia, si një nga fushat e gjuhësisë, ka si objekt të vet hartimin e fjalorëve të tipave të ndryshëm. Si çdo shkencë në përgjithësi, e gjuhësore në veçanti, ajo ka teorinë e saj, mbi bazën e së cilës përcakton tipat e fjalorëve, kriteret e zgjidhjet leksikografike që zbatohen, strukturën kuptimore për çdo fjalë, shkallën e zbërthimit kuptimor, pasqyrimin e vlerave kuptimore, shprehëse e stilistike të fjalëve etj.

“Leksikografia shqipe, - thotë akademiku J.Thomai, - është fusha më e hershme dhe më e pasur në gjuhësinë tonë dhe mund të themi madje, që vetë historia e gjuhësisë shqipe nis me një vepër leksikografike, me një fjalor, “Fjalori latinisht - shqip” (Dictionarium latino-epiroticum, 1635) i Frang Bardhit, vepër leksikografike e mirëfilltë, pavarësisht nga numri i fjalëve shqipe (rreth 2500 fjalë shqipe përkrah 5000 fjalëve latine)<sup>2</sup>

Ky fjalor, me vlera praktike të papërsëritshme, përbën një dëshmi të rëndësishme gjuhësore të asaj kohe si dhe të periudhës para saj, pasi kishte një fjalës të trashëguar nga

---

<sup>2</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.317

gjuha e popullit, apo veprat shqip të autorëve të vjetër (duhet të pohojmë se lënda gjuhësore e shqipes lidhej drejtpërdrejt me të folmet geqe).

Leksikografia shqipe, me një jetë të gjatë e trashëgimi të pasur, me gjithë vlerësimet që janë bërë për këtë trashëgimi, përsëri nuk mund të pretendojmë se ka dhënë pamjen e plotë të saj. Është i vërtetë pohimi se teoria leksikografike ndërtohet me studime të veçanta, por ajo shfrytëzon edhe studimet në fusha të tjera të gjuhësisë, si në fushën e historisë së gjuhës, të gramatikës, dialektologjisë, etnolinguistikës, sociolinguistikës. Por veçanërisht shfrytëzon studimet në fushën e leksikologjisë, semantikës e stilistikës.

Dihet që fjalorët në përgjithësi janë pasqyrë e fjalëve, frazeologjisë dhe kuptimeve të tyre leksikore. Kështu në fjalorët e tipeve të ndryshëm të gjuhës shqipe gjen pasqyrim, jo në mënyrë shteruese, pasuria leksikore e saj. Por si në çdo fjalor, për më tepër fjalorët shpjegues të gjuhës, në një farë mënyre, ka në shumë elementë të tij edhe pasqyrën fonetike të shqipes, ka edhe elemente gramatikore themelore, si edhe elemente të sintagmatikës e leksematikës më të përgjithshme. Fjalorët janë pasqyrë semantike në vështrim më të gjerë se leksiku, po ashtu ata janë pasqyrë stilistike përgjithësisht e kulturës së gjuhës. Ajo mund të jetë edhe pasqyrë etimologjike, historiko-gjuhësore, etnokulturore etj. Kjo ndodh se vetë njësia themelore e leksikut, fjala, është njësi gjuhësore shumëvlerëshe.

Në historinë e leksikografisë shqipe është për t'u evidentuar fakti se të dhënat për aspekte të ndryshme të fjalëve dhe për gjithë përbërësit e fjalorëve, kanë ardhur duke u pasuruar e duke u plotësuar krahas thellimit të njohjes shkencore të leksikut, zhvillimit të vetë gjuhës shqipe, gjallërimit të të gjitha vlerave të mjeteve leksikore e frazeologjike në veprimtarinë gjuhësore të shkruar e të folur dhe rritjes së pandërprerë të këtyre vlerave në përdorimin e pasurisë leksikore të gjuhës.

Zhvillimi i leksikografisë shqipe deri në ditët e sotme ka si një arritje të madhe pasurimin e vazhdueshëm e sistematik të spektrit tipologjik nëpërmjet hartimit të fjalorëve të tipave të ndryshëm, filologjikë, fjalorë shpjegues kombëtarë, fjalorë krahinorë, fjalorë dygjuhësh e shumëgjuhësh, terminologjikë, frazeologjikë, historikë, etimologjikë, sinonimikë e antonimikë, drejtshkrimorë, onomastikë, të vegjël, të mesëm, e të mëdhenj.

Leksikografisë së sotme shqipe i mungon një fjalor i tipit të madh apo dhe një fjalor "Thesarus" që do të pasqyronte sa më gjerë pasurinë e madhe leksikore, frazeologjike e semantike të gjuhës shqipe dhe do të ishte një lloj "kartoteke" për fjalorë të tipave të tjerë. Franc Jozef Hausman e përkufizon fjalorin si "një përmbledhje të njësisve leksikore, të cilat japin informacione të caktuara për përdorues të caktuar dhe që paraqiten përmes një mediumi të caktuar, duke u radhitur në mënyrë të tillë që për secilin informues, të jetë

e mundshme një qasje praktike dhe e shpejtë”.<sup>3</sup> Zhvillimet demokratike të 20-vjeçarit të fundit, krahas ndryshimeve në shumë fusha, sollën edhe një “bum” leksikor në gjuhën shqipe nëpërmjet huazimit, pasuri leksikore që duhet të gjejë pasqyrimin në fjalorë, krahas përpjekjes së vazhdueshme e sistematike të gjetjes së mundësisë për zëvendësimin e tyre me fjalë të burimit të shqipes, por pa kaluar në purizëm. Ndaj kjo shtron edhe detyrën e kalkimit nga gjuhët e huaja, pa folur dhe për hyrjen më në thellësi të trajtimit të leksikut të gjuhës duke hartuar fjalorë shkencërisht e praktikisht të dobishëm si fjalorë të frekuencës së fjalëve, fjalorë shpjegues profesionalë, fjalorë paradigmaticë, gjë që kërkon dhe thellimin e njohurive leksikografike për të arritur në përcaktimin e kritereve rreptësisht shkencore, mbi bazën e të cilave do të hartohen këta fjalorë.

## **1.2 ETAPAT E ZHVILLIMIT TË LEKSIKOGRAFISË SHQIPE**

Studiuesit e shumtë në vështrim të përgjithshëm të historisë së leksikografisë shqiptare, duke zbatuar kritere shkencore në studimin e pasurisë leksikore, kanë arritur në një mendim të përbashkët duke evidentuar dy periudha të mëdha në zhvillimin e saj:

1. Periudha e parë fillon me “Fjalorin latinisht shqip” të Frang Bardhit (1635) e vjen deri në fundin e gjysmës së parë të shekullit të 20-të.
2. Periudha e dytë nis me fillimin e gjysmës së dytë të shekullit të 20-të e deri në ditët tona.

Pavarësisht nga kjo ndarje, ato janë pjesë të një të tërë, por edhe me dallime të rëndësishme si në fushën e teorisë, ashtu edhe të praktikës leksikografike shqipe.

### **❖ Periudha e parë e zhvillimit të leksikografisë shqipe.**

Në periudhën e parë të zhvillimit të leksikografisë janë botuar shumë fjalorë për gjuhën shqipe, madje edhe dygjuhësh si:

1. “Fjalori latinisht - shqip” i Frang Bardhit (1635).
2. “Fjalori i gjuhës shqipe” i Kostandin Kristoforidhit, (Athinë, 1904).
3. “Fjalori i ri i shqipes” i shoqërisë Bashkimi, botuar në Shkodër në vitin 1908, që është fjalor dygjuhësh shqip - italisht, me rreth 11.000 fjalë.

---

<sup>3</sup> Memisha, V. Rreth një fjalori shkurtesash në gjuhën shqipe, në “Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë”, Ohër, 2007, f.292.



4. “Fjalorth i ri” i Nikollë Gazullit (1941), me rreth 5000 fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipërisë.
5. “Fjalorth i ri” i Pano Tasos (1941), me rreth 2000 fjalë kryesisht të krahinës së Përmetit.
6. “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe” i Gustav Mayerit si dhe disa fjalorë të tjerë krahinorë, ndonjëherë dhe si shtojcë të përmbledhjes folklorike, një pjesë e të cilëve kanë mbetur dorëshkrime.

Historia e botimeve me lëndë leksikore e frazeologjike nga të folmet e krahinave të ndryshme të Shqipërisë është e lidhur ngushtë dhe me vetë zhvillimin e dialektologjisë. Studimet në fushën e dialektologjisë, në këndvështrimin diakronik të gjuhëve, jo vetëm për gjuhësinë shqiptare, por edhe atë botërore, lidhen me lindjen në shekullin e 19-të të gjuhësisë historiko-krahasuese. Ndërsa “shkolla gjuhësore me këndvështrim gjeolinguistik, neolinguistika apo gjuhësia hapësinore, i studion dukuritë gjuhësore si fenomene të të folurit, të lidhura ngushtë me përhapjen e tyre në hapësirë, përmes marrëdhënieve të vazhdueshme ndërmjet njerëzve. Duke i kërkuar shkaqet e ndryshimeve në gjuhë jashtë realitetit gjuhësor, neolinguistët përcaktuan se faktori jashtëgjuhësor ishte ndër më kryesorët që shkaktonte “inovacione” në gjuhë”.<sup>4</sup> Prandaj neolinguistika e orientoi drejt zhvillimeve të reja gjuhësinë krahasimtare indoevropiane, duke iu shmangur “ligjeve” të ngurta të drejtimeve të mëparshme gjuhësore dhe shtroi për zgjidhje çështje të tilla, si territori fillestar i shtrirjes së vatrave gjuhësore, shkaqet dhe veçoritë e përhapjes së tyre, përcaktimi i kronologjisë së përhapjes së dukurive gjuhësore.

Por në këtë periudhë studimet për të folmet e shqipes nuk ishin të organizuara, të planifikuara, të koordinuara dhe sistematike, pasi ato bëheshin nga “dijetarë të veçuar, të cilët për qëllime të ndryshme dhe herë-herë të diktuar nga rasti, botuan materiale dialektore, vërejtje e shënime mbi të folme të shqipes dhe aty-këtu edhe disa studime të mirëfillta dialektologjike për një numër të vogël të folmesh”<sup>5</sup> Kjo, padyshim, është trashëgimi e pasur e me vlera të mëdha që leksikografia jonë e sotme jo vetëm që nuk e ka nënvleftësuar, por e ka shfrytëzuar në të gjitha drejtimet, gjë që e gjen shprehjen praktike në hartimin e fjalorëve të mëvonshëm, të cilët i përkasin etapës tjetër të zhvillimit të leksikografisë shqiptare. Kjo pjesë e trashëgimisë leksikografike ka vlerë të pamohueshme pasi:

- Në fjalorët e hartuar në këtë periudhë u përfshi një pasuri e madhe leksikore e frazeologjike, një pjesë e së cilave ishte mbledhur nga goja e popullit duke i

<sup>4</sup> Koperaj, E. “Metodat linguistike dhe të gjeografisë gjuhësore në veprën e prof. E.Çabejt”, në Studime Albanologjike, gjuhë 1, Tiranë, 2008, f.166.

<sup>5</sup> Koperaj, E. “Metodat linguistike dhe të gjeografisë gjuhësore në veprën e prof. E.Çabejt”, në Studime Albanologjike, gjuhë 1, Tiranë, 2008, f.166.

shpëtuar kështu pluhurit të harresës si dhe duke shërbyer si burim për fjalorët e mëpastajmë.

- Fjalorët e botuar në këtë periudhë kanë plotësuar, secili në kohën e vet, nevojat e praktikës, të shkollës e kulturës, sidomos për mësimin e shqipes nga të huajt e anasjelltas.
- Drejtimet e leksikografisë shqipe në këtë periudhë përcaktoheshin nga rrethanat historiko-shoqërore e kulturore të kohës dhe shkalla e zhvillimit të shkencës gjuhësore në përgjithësi, ndaj dhe në këtë periudhë janë përpunuar disa tipa fjalorësh”<sup>6</sup>

Leksikografia shqipe nuk u formua dot në këtë periudhë, megjithë vlerën e madhe të kësaj trashëgimie. Një gjë e tillë ka ndodhur për faktin e karakterit të kufizuar të punës leksikografike dhe varfërisë së mendimit teorik leksikografik, pasi trajtimi shkencor i problemeve leksikografike mbeti shumë mbrapa, leksikografia nuk mund të orientohet dot drejt normës gjuhësore kombëtare, pasi nuk ishte formuar ende standardi i gjuhës shqipe, si dhe fjalorët nuk u mbështetën në parimet leksikografike bashkëkohore, të përpunuara e të njësuara.

Gjatë Rilindjes Kombëtare mbledhja e materialeve leksikore u frymëzua nga ideali kombëtar. Ndër gjuhëtarët rilindës u shqua Kostandin Kristoforidhi, i cili në vitin 1904 botoi në Athinë “Fjalori i gjuhës shqipe” (Leksikon tis allvaniqis gllosis). Ky ishte fjalori më i mirë i kësaj periudhe dhe konsiderohet si hapi i parë për hartimin e një fjalori shpjegues të gjuhës shqipe, sepse pasurinë leksikore e frazeologjike të mbledhur nga goja e popullit e përfshiu në fjalor jo si pasuri dialektore, por si pasuri të përbashkët të shqipes. Ky fjalor mishëron idenë e Rilindjes sonë mbi gjuhën e kulturën kombëtare. Sami Frashëri e kishte formuluar qartë mendimin se fjalët e të gjitha dialekteve e të folmeve duhen vlerësuar si pasuri e përbashkët e shqipes: “...ca nga frazat e fjalët e gjuhës, - i shkruan ai De Radës, - janë humburë, më ca anë të Shqipërisë e të kolonivet e janë ruajtur në ca anë të tjera; ...me të përmbledhurë të gjithë të këtyre fjalëve e fraseve bashkë, edhe gjuha shqipe do të bëhet e begatë e e gjerë, e do të shpëtojë nga të pasurit nevojë me fjalë të huaja, edhe gjithë dialektatë do të gjendenë të gjitha të bashkuara e të përzjera”<sup>7</sup>

“Fjalori i gjuhës shqipe” i Kristoforidhit është në përgjithësi dygjuhësh, shqip-greqisht, por autori synonte të hartonte fjalorin e shqipes për shqiptarët, prandaj dhe titullin e vuri “Fjalori i gjuhës shqipe”, kurse si mjet shpjegues përdori greqishten. Kristoforidhi është i pari që ndërmori hartimin e një fjalori të gjuhës shqipe pa ia ngushtuar bazën në një dialekt a të folme, siç kishin vepruar hartuesit e fjalorëve të mëparshëm. Ky fjalor ka një

<sup>6</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.317.

<sup>7</sup> Frashëri, S. Letër J.De Radës, Stamboll, 20.2.1881, cituar sipas Dh.Shuteriqit, “Mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe”, BSHSH, 1952, IV, f.54.

vlerë të posaçme dokumentare, sepse u shërbeu më pas hartuesve të fjalorëve si dhe studiuesve krahasimtarë. Vepra e tij, që kaloi dorë më dorë e u botua në Athinë pas vdekjes së autorit, përfundoi në rreth 12.000 fjalë. Disa fjalë që mblodhi nga goja e popullit, K.Kristoforidhi i shoqëroi me shënimin për vendin ku i mblodhi. Gjithashtu në fjalor janë dhënë edhe burimet etimologjike të disa fjalëve. Ky fjalor, pasi u ripunua dhe u fut në alfabet shqip nga Aleksandër Xhuvani, u ribotua në vitin 1961 me titullin “Fjalor shqip - greqisht”.

Bashkë me përpjekjet për formimin e një gjuhë letrare të përbashkët, kërkesë kjo e rilindësve që u shtrua me forcë pas Kongresit të Manastirit, kur u zgjidh përfundimisht problemi i alfabetit të shqipes, duke vendosur në themelet e tij alfabetin latin, i cili shënoi kulmin e aksionit të Rilindjes, u shtuan edhe botimet në fushën e leksikografisë.

Pas shpalljes së Pavarësisë u bë një hap tjetër për njësimin e gjuhës letrare shqipe me Komisinë Letrare të Shkodrës, në vitin 1916. Këtu, një komision gjuhëtarësh e shkrimtarësh, i krijuar për të ndihmuar në formimin e një gjuhe letrare të përbashkët përmes afrimit të dy varianteve letrare në përdorim, vlerësoi variantin letrar të elbasnishtes dhe gegërishtes dhe përcaktoi disa rregulla për drejtshkrimin e saj.<sup>8</sup> Duke u zgjidhur problemi i alfabetit, po përvijohet norma drejtshkrimore, e cila përfundimisht u zgjidhnë Kongresin e Drejtshkrimit, 1972.

Në vitet 30-të të shekullit të kaluar po bëhej gjithnjë e më i domosdoshëm hartimi i një fjalori kombëtar shpjegues të shqipes, mungesa e të cilit ishte bërë shqetësim i përgjithshëm. Në këtë kohë kemi dy ngjarje të rëndësishme në fushën e leksikografisë sonë. Në faqet e botimeve “Visare të kombit” (1941), botohen dy fjalorë dialektorë, “Fjalori i ri” i Pano Tasos dhe “Fjalori i ri” i Nikollë Gazullit, që shënuan dhe lindjen e leksikografisë njëgjuhëshe dialektore, duke i hapur rrugë leksikografisë njëgjuhëshe kombëtare dhe fjalorëve shpjegues kombëtarë të gjuhës shqipe.

#### ❖ **Periudha e dytë e zhvillimit të leksikografisë shqipe.**

Leksikografisë shqipe iu shtruan detyra të ngutshme pas 1944-ës, kohë kur fillon një periudhë tjetër në zhvillimin e saj si degë e shkencës gjuhësore. Ajo duhej t’u përgjigjej kërkesave të reja e të shumta që shtruan të gjitha fushat e jetës për një fjalor shpjegues të shqipes. Ndaj në këtë periudhë të zhvillimit të saj, leksikografia shqipe u përvijua si shkencë me objektin e metodat e studimit, u bënë përpjekje për të përvetësuar metodologjinë shkencore të kohës, e cila solli ndryshime të thella në karakterin e punës leksikografike.

---

<sup>8</sup> Osmani, T. Komisia Letrare Shqipe në Shkodër, (1916-1918), Shkodër, 2004.

Shenjat e një zhvillimi të tillë duken qartë në makrostrukturën dhe mikrostrukturën e fjalorëve, duke u arritur në këtë mënyrë nivele cilësore më të larta jo vetëm në fjalorët shpjegues kombëtarë normativë, por dhe në fjalorët dygjuhësh. Te të dy tipat e fjalorëve, por sidomos në ata shpjegues, është zgjeruar hapësira e shtresave leksikore me përdorim më të ngushtë, si e krahinorizmave, e terminologjisë, e neologjizmave leksikore e semantike.

Në vitin 1954 botohet “Fjalori i gjuhës shqipe”, i hatruar nga Kostaq Cipo, kryetar, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Anton Krajni, Osman Myderrizi, botim i Institutit të Shkencave, i pari fjalor shpjegues i mirëfilltë i shqipes dhe arritja më e madhe deri në atë kohë e leksikografisë shqipe. Ai është i tipit të vogël, sepse pasqyron shtresën aktive të leksikut të shqipes dhe një pjesë të kufizuar të shtresës pasive, që është krejt e domosdoshme për të kuptuar gjuhën e sotme shqipe. Fjalori ka rreth 25 000 fjalë, me shpjegime dhe përshkohet në përgjithësi nga një teori shkencore e shëndoshë, jep një pasqyrë të drejtë të leksikut e të frazeologjisë shqipe dhe me fondin e tij ia kalon çdo fjalori të botuar më parë. Megjithëse fjalori u hartua i mbështetur në toskërishte, ai përfshiu fjalë nga të gjitha anët e Shqipërisë, fjalët e shprehjet më të përdorëshme, të përbashkëta për të gjithë folësit e shqipes duke e zgjeruar fondin e vet me fjalë e shprehje nga të dy dialektet, për të treguar kështu edhe forcën e madhe të gjuhës sonë.

“Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, është një fjalor i shqipes i tipit shpjegues. Në shumë drejtime ky fjalor ka edhe prirje normative ose i ndihmoi mjaft ngulitjes së normës gjuhësore, si në zgjedhjen e fjalëve e të frazeologjisë, në zbërthimin kuptimor, në shpjegimet, në disa vlerësime stilistike dhe në një shkallë më të madhe në trajtat gramatikore e në theksin e fjalëve. Tipi i fjalorit dhe koha në të cilin u botua i sollën disa kufizime vëllimit të tij. Ky fjalor, nga krahinorizmat mori ato fjalë që kishin një përhapje më të gjerë, se dhe ato që ishin të vlefshme për leksikun e përgjithshëm. Fjalët ndërkombëtare, si fjalët e huaja në përgjithësi, përfshirë këtu fjalët me burim nga turqishtja që dalin në letërsinë e shkruar, në folklor ose përdoren dendur në të folur, gjetën pasqyrim në fjalor. Gjithashtu fjalori ka merita për zbërthimin kuptimor dhe për shpjegimin e kuptimeve sipas tipit të tij.

Në këtë periudhë të leksikografisë, sidomos me ngritjen e Kartotekës së leksikut të shqipes, me 1955, vjelja e fjalëve dhe e shprehjeve nga gurra popullore u organizua mbi baza shkencore. Qindra bashkëpunëtor të jashtëm, mësues, studentë e dashamirë të gjuhës sonë amtare kanë dhënë kontributin e tyre në arkivin e madh kombëtar të gjuhës shqipe, në Kartotekën e leksikut të shqipes. Edhe sot, gjurmimi e zbulimi i vlerave të gjuhës së popullit është një nga drejtimet e gjuhësisë shqiptare.

Leksikografia, si një nga fushat e gjuhësisë, ka si objekt të vet hartimin e fjalorëve të tipave të ndryshëm. Si çdo shkencë në përgjithësi, e gjuhësore në veçanti, ajo ka teorinë e saj, mbi bazën e së cilës përcaktohen tipat e fjalorëve, kriteret e zgjidhjet leksikografike

që zbatohen, ndërtimi i strukturës kuptimore për çdo fjalë, shkalla e zberthimit kuptimor, pasqyrimi i vlerave kuptimore, shprehëse e stilistike të fjalëve.

Një element tjetër që vihet re në fjalorët e periudhës së dytë, është dhe zgjerimi i makrostrukturave në fjalorë. Strukturat kuptimore të fjalëve, falë plotësimit me elemente të panjohura e të patrajtuara leksikografikisht të përmbajtjes dhe zberthimeve më të imta të kësaj përmbajtjeje, sipas metodave bashkëkohore të strukturimit semantik, zbulojnë përbërësit kuptimorë dhe ndërtojnë strukturat kuptimore simetrike në përputhje me tipin e fjalorit apo tipologjinë semantike. Mjafton të krahasosh disa struktura kuptimore të disa fjalëve nga “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe e vë re këtë zhvillim. Zgjerimi i fjalësit dhe strukturave kuptimore është shoqëruar dhe me synimin për të pasqyruar në fjalor sa më shumë vlera të tjera të fjalëve, edhe ato të “mbishtresuara”.

Në punimin tonëjemi ndalur për analizë, kryesisht në zhvillimin e leksikografisë njëgjuhëshe, pra të fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, pasi lënda që ata sjellin është më afër temës që po trajtojmë. Krahas këmbënguljes për të pasqyruar fjalën shqipe në gjithë gjerësinë e saj, të lashtë e të rrallë, në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, u është hapur më shumë vend neologjizmave e termave të përgjithshëm, madje edhe fjalëve të huaja aktive në shqipen e sotme. Këtë e vërtetojnë në mënyrë të veçantë edhe fjalorët e vëllimshëm e cilësorë të shqipes me gjuhë të tilla si anglishtja, italishtja, gjermanishtja, fjalë që kanë dalë dhjetëvjeçarët e fundit. Ndaj dhe ky tip fjalorësh është bërë, në përmasa më të vogla, objekt i studimit tonë, sidomos në këndvështrimin e pasqyrimin të fjalësit onomastik.

### 1.3 FJALORË DYGJUHËSH

Periudha e dytë e leksikografisë shqiptare pati si një zhvillim të saj zgjerimin e “hartës gjeografike” që nga SHBA, Gjermania, Holanda, Rusia, Japonia, Suedia, Italia, Finlanda, Bullgaria, Greqia, Serbia e vende të tjera. Kjo tregon se leksikografia shqipe është zhvilluar jovetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij, prej shqiptarëve dhe të huajve.

Shqipja, nëpërmjet fjalorëve dygjuhësh, ka hyrë në lidhje leksikografike thuajse me të gjitha gjuhët indoevropiane, përfshirë latinishten, por edhe me disa gjuhë joindoevropiane si hungarishtja, finlandishtja, turqishtja, arabishtja. Më poshtë po rendisim disa nga fjalorët dygjuhësh botuar te ne:

1. “Fjalori rusisht - shqip” 1954, botim i Institutit të Shkencave.
2. “Fjalori frëngjisht - shqip” 1966 me rreth 20.000 fjalë.
3. “Fjalori latinisht - shqip” 1966, hartuar nga Henrik Lacaj e Filip Fishta.
4. “Fjalori shqip - frëngjisht” 1977, me rreth 25.000 fjalë.

5. “Fjalori gjermanisht - shqip”1978, me 25.000 fjalë, hartuar nga Zef Simoni.
6. “Fjalori latinisht - shqip” 1986, hartuar nga Kosta Qiriazati.
7. “Fjalori shqip - frëngjisht”1988, me rreth 35.000 fjalë, hartuar nga Vedat Kokona.
8. “Fjalori italisht - shqip” 1996, hartuar nga F.Leka-R.Konçi.
9. “Fjalori frazeologjik anglisht-shqip” 1999, hartuar nga Ramazan Hysa.
10. “Fjalori shqip-anglisht i Oksfordit”, 2000, me rreth 70.000 fjalë, hartuar nga Leonard Njumarku.
11. “Fjalori frëngjisht-shqip”, 2001, me rreth 35.000 fjalë, hartuar nga Vedat Kokona.
12. “Fjalori italisht-shqip” 2002, me rreth 40.000 fjalë, hartuar nga F.Leka dhe Z.Simoni
13. “Fjalori shqip-italisht” 2003, me rreth 40.000 fjalë, hartuar nga F.Leka dhe Z.Simoni

Synimi i parë i hartimit të fjalorëve të të gjitha llojeve ka qenë ai praktik, ndërsa synimi i dytë i tyre ka qenë ai shkencor i mirëfilltë në dy aspekte:

1. Pasqyrimi shkencor i sistemit leksikor, frazeologjik e semantik i shqipes, siç janë fjalorët shpjegues kombëtarë, periudha e rëndësishme e të cilëve në historinë e leksikografisë shqipe nis me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, e vazhdon me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, “Fjalorin e shqipes së sotme” 2002 dhe së fundi me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006.
2. Studimi i paradigmave të veçanta leksikore, siç janë fjalorët historikë ose etimologjikë, fjalorët sinonimikë, antonimikë etj.

Veç fjalorëve shpjegues e atyre dygjuhësh, leksikografia shqiptare e zgjeroi këndvështrimin e leksikut edhe nëpërmjet hartimit të fjalorëve të veçantë e specialë, kryesisht shpjegues kombëtarë e normativë, si fjalorët frazeologjikë, antonimikë, terminologjikë, krahinorë etj. Më poshtë do të përmendim disa nga tipat më të spikatur të këtyre fjalorëve dhe jo të gjithë, pasi ata janë shumë, siç pohon J.Thomai; “Leksikografia që në shekullin e XVII me “Fjalorin latinisht - shqip” të Frang Bardhit e deri më sot na ka sjellë mbi 500 fjalorë të shqipes a me shqipen, njëgjuhësh, dygjuhësh ose shumë gjuhësh, të cilët në pjesën shqipe regjistruan shumë fjalë e shprehje me vlerë, që i shpëtuan kështu humbjes”.<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë 2006, f.12.

#### 1.4 FJALORË DIALEKTORË E KRAHINORË

“Gjuha kombëtare shqipe përbëhet nga varianti letrar dhe variantet dialektore. Këto variante dallohen midis tyre nga natyra e strukturës. Gjuha letrare është njësishteshe, kurse gjuha dialektore është shumësishteshe”.<sup>10</sup> Në shqipen kemi në përdorim shumë fjalorë dialektorë. Këta nuk do të jenë objekt i studimit tonë, por duke ngjallur interes për pasurinë leksikore e frazeologjike, që gjallon në të folme e dialekte dhe e domosdoshme për zgjerimin e fjalësit në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, më poshtë po japim në mënyrë të përmbledhur disa nga arritjet leksikografike në këtë fushë.

Arritje me vlerë në letërsinë shqiptare kanë qenë botimet leksikografike me lëndë leksikore e frazeologjike nga të folmet e krahinave të ndryshme të vendit a trevave jashtë kufijve shtetërorë, të cilat, nën një emërtim të përgjithshëm, janë konsideruar si fjalorë krahinorë. Këta fjalorë edhe pse me baza të ngushta janë konsideruar si pasuri e çmuar, pasi ata sjellin shumë lëndë leksikore, frazeologjike e semantike të shqipes, që i shërben si praktikës gjuhësore ashtu edhe zgjerimit të bazës dialektore të standardit në leksik dhe më tej pasurimit të fjalorëve të ndryshëm.

Në gjuhësinë shqiptare inteëresimi për mbledhjen dhe sistemimin e leksikut të shqipes është i hershëm. Ai fillon me Frang Bardhin, me fjalorin e tij latinisht-shqip, dhe me autorë të tjerë të veriut, të cilët përpiqeshin, siç thoshte Bogdani: “për të nxjerrë në dritë fjalë plaka e të harrueme, që gjuha jonë të mos bdarret e bastardhohet”.<sup>11</sup>

Kjo punë vazhdoi nga shekulli në shekull, por më intensive ajo që në periudhën e Rilindjes Kombëtare, ku u koordinua lufta për pavarësinë kombëtare me luftën për ruajtjen e gjuhës shqipe e të pastërtisë së saj. Duke qenë patriotë, me dashurinë për atdheun e tyre të robëruar, ata ngritën lart vlerat e gjuhës sonë. “Gjuha jonë sa e mirë”, - shkruante Naimi; “Pa gjuhë shqipe, s’ka komb shqiptar”, - ngrinte zërin ideologu i Rilindjes, Sami Frashëri.

Mbledhja dhe studimi i leksikut dialektor e krahinor ka qenë pjesë e veprimtarisë së shumë patriotëve shqiptarë, si K. Kristoforidhi, A. Xhuvani, P. Tase, N. Gazulli, etj. dhe objekt i studimeve të shumta dialektologjike që janë bërë për dialektet e shqipes.

Ky interesim për pasurinë leksikore dhe frazeologjike që gjallon në të folme e dialekte, është realizuar në tri lloje punimesh: në studime të mirëfillta dialektore për të folme të veçanta, të cilat autorët i pajisin në fund me nga një fjalorth, ku pasqyrojnë fjalë dhe shprehje dialektore; nëpërmjet fjalorëve të ndryshëm shpjegues, ku leksiku krahinor është pasqyruar me shënimin krahinorizëm; si dhe nëpërmjet fjalorëve dialektorë, si vepra të veçanta leksikografike. “Në periudhën kohore prej 60 vjetëshjanë botuar mbi

<sup>10</sup> Gjinari, J. Dialektologjia, Tiranë, 1975, f.5.

<sup>11</sup> “Fjalorth i ri” i Nikollë Gazullit, në Visaret e Kombit, vëll.XI, Tiranë, 1941.

katërmbëdhjetë fjalorë dialektorë e fjalorthë krahinorë” -thotë prof. dr.Th. Feka.<sup>12</sup> Por pas këtij konstatimi, më mbrapa u botuan dhe fjalorë të tjerë dialektorë.

Nga fjalorët dialektorë e krahinorë po përmendim këto botime:

1. “Fjalorth i ri” i Nikollë Gazullit, në Visaret e Kombit, vëll. XI, Tiranë, 1939.
2. “Fjalorth i ri” i Pano Tases, në Visaret e Kombit, Vëll. XII, Tiranë, 1941.
3. “Fjalorth i fjalëve të rralla” i Abdullah Zyberit, Prishtinë, 1979.
4. “Fjalorth fjalësh e shprehjesh popullore” i Sulejman Drinit, Ibrahim Goçit, Mehmet Halimit, Skënder Gashit, Prishtinë, 1982.
5. “Fjalë popullore nga Myzeqeja”, i Jani Nushit, Tiranë, 1991.
6. “Shprehje popullore nga krahina e Korçës”, i Niko Mustakës, Tiranë, 1989.
7. “Fjalor i të folmeve të Malit të Zi”, i Mehmet Ahmetaj, Prishtinë, 1996.
8. “Fjalor i shqipes truallsoretë Maqedonisë”, i Qemal Muratit, Tetovë, 1998.
9. “Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë” i Qemal Muratit, Shkup, 2003.
10. “Fjalor me shprehje e fjalë të rralla” i Petrit Zenelit, Tiranë, 2000.
11. “Visaret gjuhësore - kulturore nga malësia e Gjakovës”, në dy vëllime i Abdyl Sulës, , I,II, Tiranë, 2000.
12. “Faqe nga visari leksikor i Mirditës” i Preng Cub Lleshit, Mirditë, 2002.
13. “Fjalor i shqipes së Plavës e Gucisë” i Pavli Haxhillazit e Sulejman B.Ahmetit, Tiranë, 2004.
14. “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe” i At Benedikt Demës, 2005.
15. “Fjalor i gjuhës shqipe”, Mehmet Elezi, Tiranë, 2006

Përveç këtyre fjalorëve që po i quajmë fjalorë krahinorë a dialektorë, pasi elementi kryesor që i bashkon është lënda leksiko-semantike dhe frazeologjike popullore e gjuhës së folur, ka edhe disa fjalorë me lëndë leksikore të burimit krahinor, por të specializuar për fusha të caktuara, si “Fitonimia e Kosovës” i Shefki Sejdiut (Prishtinë, 1979), “Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi” i Abdullah Zyberit (Prishtinë, 1996) dhe “Emërtime për kafshë e shpendë në Labëri” i Valter Memishës (Gjirokastër, 2001). Elementi më kryesor që i bashkon të gjithë këta fjalorë, është lënda leksiko-semantike dhe frazeologjike popullore e gjuhës së folur ndaj sipas këtij tipari

---

<sup>12</sup> Th. Feka, Rreth fjalorëve dialektorë të shqipes, në “Leksikografia shqipe- trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.204.



J.Thomai vëren se “asnjë nga këta fjalorë nuk është dialektor e krahinor i mirëfilltë, por në një vështrim më të gjerë mund të cilësohen si të tillë, pasi pjesa më e madhe e fjalëve, shprehjeve dhe e kuptimeve, janë provë e këtyre të folmeve të ndryshme. Fjalorët e këtij tipi paraqiten në leksikografi edhe si fjalorë krahinorë”.<sup>13</sup> Gjurmimi i fjalëve e shprehjeve popullore në gjysmën e dytë të shekullit XX përfshiu të gjitha trojet shqiptare dhe në ditët e sotme po merr përmasa gjithnjë e më të gjera. Kjo shihet në fjalorët dialektorë të botuar deri më sot dhe ata që presin dritën e botimit, të cilët po shtohen dita-ditës, duke synuar një pasqyrim dhe një njohje më të plotë të kësaj pasurie të çmueshme, që fshihet në gjirin e popullit dhe që rrezikon të zhduket, po nuk u tregua interes, sidomos tani në kohën e hapjes me botën e depërimitin e shumë fjalëve të huaja në leksikon e gjuhës sonë. Ky interesim shihet tashmë, jo vetëm brenda kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë, të asaj që quhet Shqipëri, por edhe jashtë këtyre kufijve, në trojet shqiptare në Mal të zi, në Kosovë, në Maqedoni, në Çamëri, në diasporën arbëreshe, si dhe në ishujt gjuhësorë ku shqipja përdoret si gjuhë amtare. Për këtë A.Kostallari shprehet: “Kjo lëndë e mbledhur në gjirin e popullit dhe ajo që do mblidhet, ka ushqyer e do të ushqejë jo vetëm fjalorët e shqipes (shpjegues, terminologjikë) të hartuar deri tani dhe atyre që do të hartohen në të ardhmen, por edhe studimet gjuhësore shqiptare”.<sup>14</sup>

Në fazën e sotme të zhvillimit të gjuhës standarde shqipe, pasurimi i saj me leksikon dialektor e krahinor luan një rol të rëndësishëm. Fjalët e shprehjet e ligjëritit popullor përbëjnë një nga burimet e rëndësishme për pasurimin e leksikut të gjuhës së sotme standarde shqipe. të shpejtosh në mbledhjen e kësaj pasurie do të thotë ta shpëtosh atë nga humbja, sepse dialektet tona, me lëvizjet e shumta brendapërbrenda dhe hapjen e madhe, kanë zënë të tretën e bashkë me to edhe pasuria leksikore e frazeologjike e krijuar në shekuj e mijëvjeçarë. Me të drejtë shqetësohen dialektologët kur thonë se: “Dialektet tona po vdesin. U është sulur atyre shkolla, televizioni, radioja, filmi, gazetatat, librat. Dialektet tona po bjerrin bashkë me opingat, jelekët e qëndisur, kremtet vjetore, bukën e misrit, votrën e zjarrit dhe më shumë elemente të tjera “primitive”. Nuk është humbje ajo që bjerret “pasuria e pashtershme e të folmeve tona popullore”, por humbje është në qoftë se kjo pasuri bjerret e paregjistruar, sepse dialektet janë dokumente. Ato janë madje përmbledhja më e pasur me të dhëna për jetën e kaluar të popullit. Ajo që në matematikë nuk zbulohet sot, do të zbulohet nesër, por në dialektologji jo”.<sup>15</sup>

Në kushtet e sotme kjo detyrë bëhet më emergjente dhe më e domosdoshme, sepse brezi i vjetër po ndahet nga jeta dhe bashkë me të rrezikon të zhduket gjithë pasuria leksiko-semantike dhe frazeologjike që ruhet në kujtesën e tij. Një pjesë e kësaj pasurie

---

<sup>13</sup> Thomai, J. Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme, Tiranë, 2001, f.221.

<sup>14</sup> Kostallari, A. Vëzhgime mbi disa grupe fjalësh popullore të trojeve verilindore të shqipes, në “Studime mbi leksikon...”, III, Tiranë, 1989, f.77.

<sup>15</sup> Murati, Q. Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë, Shkup, 2003, f.9.

po kufizohet edhe si rezultat i veprimit të gjuhës letrare mbi dialektet. Kjo ndodh për faktin se, siç pohonte gjuhëtari i shquar francez A.Mielllet: “Gjuha nuk mund të trajtohet si produkt industrial, megjithatë, të folmet lokale vdesin ashtu siç zhduken artizanët e vegjël përpara industrialistëve të mëdhenj”.<sup>16</sup>

Është kjo arsyeja që Jani Thomai e konsideron “gjurmimin, mbledhjen e studimin e fjalës shqipe si një detyrë jo vetëm shkencore, por edhe atdhetare”.<sup>17</sup> Në këtë këndvështrim, prurjet e fjalorëve krahinorë janë përherë një lëndë potenciale edhe për fjalorët shpjegues të shqipes e aq më tepër për fjalorin e madh që pritet të hartohet, duke përfshirë në fondin e tyre shumë njësi të kësaj natyre. Shumë gjuhë tashmë e kanë përfunduar procesin e hartimit të fjalorëve të tillë, p.sh. anglishtja ka një fjalor të tipit të madh me 20 vëllime, botuar në vitin 1989, i quajtur ndryshe “Fjalori i Oksfordit”. Po kështu në rrusishte ka shumë fjalorë shpjegues të gjuhës së sotme ruse, për përdorim masiv apo të ngushtë, në një vëllim, në katër vëllime, madje në 17 vëllime. Por edhe gjuhët me një numër të vogël folësish tash e kanë kapërcyer zbrazëtinë e fjalorëve të mëdhenj. Po përmendim këtu fjalorin e gjuhës sllovene në pesë vëllime që përmban mbi 110.000 fjalë etj.

Ky qëndrim përbën një nga pjesët më të qenësishme në parimet e kriteret e zgjedhjes së fjalësisit që është formuluar në mënyrë të tillë: “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe duhet t’i shohë të gjitha fjalët e fondit leksikor të shqipes, pavarësisht nga burimi i tyre, si pasuri të përbashkët kulturore të popullit shqiptar...” 1). (A.Kostallari, Mbi disa veçori strukturore funksionale të gjuhës letrare të kohës sonë, në “studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972, f.39).

## 1.5 FJALORË SPECIALË

Leksikografia shqipe është pasuruar dhe me fjalorë specialë etimologjikë. Në këtë rubrikë po përmendim disa prej këtyre lloj fjalorësh. Renditjen nuk po e bëjmë sipas kronologjisë së botimit, por në fillim po japim fjalorët eshqipes. Leksikografia shqipe është pasuruar me këta fjalorë specialë terminologjikë:

1. “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe” 1999, nga J. Thomai, me rreth 12.000 njësi..
2. “Fjalori i antonimeve në gjuhën shqipe” 1999, nga M.Samara, me rreth 2000 çifte antonimesh.
3. “Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe” 2002, hartuar nga A.Dhrimo, E.Tupja, E.Ymeri, me rreth 30.000 zëra.

---

<sup>16</sup> Referuar: S.Mansaku, Rreth zhvillimeve të strukturës sintaksore të shqipes së sotme standarde, në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë, Ohër, 2007, f.77.

<sup>17</sup> Thomai, J. Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme, Tiranë, 2001, f.238.

4. “Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe” 2004, hartuar nga J.Thomai, M.Samara, Th.Feka, H.Shehu, me rreth 29.000 zëra.
5. “Fjalor frazeologjik italisht - shqip” 1997, hartuar nga N.Balla, E. Ymeri.
6. “Fjalor frazeologjik anglisht - shqip” 1998, hartuar nga I.Stefanllari.
7. “Fjalor frazeologjik frëngjisht - shqip” 1998, hartuar nga E.Shijaku.
8. “Fjalor frazeologjik ballkanik” 1999, me rreth 5000 njësi frazeologjike në pesë gjuhë: shqip - bullgarisht - greqisht - rumanisht - serbokroatisht, hartuar nga J.Thomai (shqip), Xh.Lloshi (serbokroatisht), R.Ristova (bullgarisht), K.Qiriazati (greqisht) e A.Melonashi (rumanisht).

Në kërkimet etimologjike përmendim këto punime:

- a. “Studime etimologjike në fushë të shqipes” të prof. Eqrem Çabej. Këto studime me lëndën që japin dhe kriteret që zbatojnë, përbëjnë për shqipen më shumë se një fjalor etimologjik dhe pa frikë mund ta quanim “Fjalor etimologjik” dhe “Fjalor historik” i gjuhës shqipe.
- b. “Leksiku historik i gjuhës shqipe” (I-III, 1996 - 2000), me lëndë leksikore nga veprat e autorëve të vjetër, hartuar nga K.Ashta.
- c. “Elemente leksikore të gjuhës shqipe në gjuhët sllave ballkanike” 2001, hartuar nga S.Hoxha, etj.

## 1.6 FJALORË TERMINOLOGJIKË

Në gjuhën shqipe janë hartuar rreth 50 fjalorë terminologjike me rreth 60.000 njësi nga disiplina të fushave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, si: fjalorë nga fusha e fizikës (fjalori i optikës, i elektromagnetizmit, i akustikës, i termodinamikës, i energjisë atomike etj.); fjalorë të disiplinave nga fusha e ekonomisë (fjalor i financë-kontabilitetit, i statistikës, i tregtisë së jashtme e të brendshme, i ekonomi- transportit, i bankës etj.); të disiplinave të fushës së mjekësisë (fjalor i anatomisë, i histologjisë, i gjinekologji - obstetrikës, i stomatologjisë, i fiziologjisë etj.) dhe fjalorë të disiplinave të shumë fushave të tjera.

Me gjithë këto arritje në fushën e leksikografisë shqiptare, ne mund të themi me plot gojën se kemi krijuar një përvojë tonën në këtë fushë, përvojë e formuar me hartimin e shumë fjalorëve të tipave të ndryshëm, me trajtime shkencore, fjalorë dygjuhësh, shumëgjuhësh e shpjegues kombëtarë e krahinorë, të mbështetur në parime e kritere të leksikografisë së përgjithshme, në arritjet e gjuhësisë shqiptare në të gjitha fushat e saj dhe në përvojën më të mirë të leksikografisë së huaj.

Veçanërisht në kohën e sotme është e dukshme asimetria lidhur me zhvillimet historiko-shoqërore. Nga fusha të ndryshme të jetës, si biznesi, informatika, ekonomia e tregut, sistemi i riorganizimit shtetëror e drejtësisë, rrjeti i gjerë i medias së shkruar e elektronike, kanë hyrë fjalë të shumta duke pasuruar leksikun e shqipes. Por përveç kësaj, kanë ndodhur dhe fenomene të tjera si “vjetërimi” i fjalëve e shprehjeve që lidheshin me sistemin shoqëror që lamë pas, me organizimin shtetëror të kohës dhe me ekonominë e mbyllur si dhe janë kthyer në përdorim të gjerë e aktiv fjalë të lëna mënjanë në mënyrë të dhunshme, si ato të leksikut fetar, i cili tani nuk mund të quhet më i vjetëruar.

Gjithë arritjet dhe problematika në fushën e leksikografisë u trajtuan në Konferencën shkencore “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, organizuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë, në dhjetor 2004. Problematika që u trajtua në këtë Konferencë që e pasur dhe detyrat që u shtruan të shumta e të mëdha.

Në referimin e tij, homonim me titullin e konferencës, akademiku J.Thomai, pasi evidentoi disa nga arritjet në fushën e leksikografisë, shtroi dhe disa kërkesa parësore për të ardhmen në këtë fushë:

- Regjistrimi elektronik i fondeve leksikore e ngritja e një kartoteke elektronike.
- Hartimi i një fjalori të madh disavëllimësh të gjuhës shqipe.
- Hartimi i fjalorëve të autorëve e i fjalorëve krahinorë në një shkallë më të gjerë.
- Ndërmarrja e studimeve në fushë të teorisë së leksikografisë.
- Hartimi i historisë së leksikografisë shqipe që të përshkruajë e të vlerësojë trashëgiminë dhe të përgjithësojë përvojën në këtë fushë.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup> Thomai, J. “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.21-23.

## KREU II

### KRAHASIMI I NDRYSHIMIT TË MAKROSTRUKTURËS SË FJALORËVE SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE

#### 2.1 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Shkenca e leksikografisë ka evidentuar faktin se pasuria dhe larmia e leksikut të një gjuhe është shprehja e drejtpërdrejtë e pasurimit dhe e zhvillimit të asaj gjuhe. Në këtë aspekt, njohja, mbledhja dhe botimi i leksikut në fjalorë shpjegues është detyrë parësore e gjuhëtarëve leksikografë. Nga vështrimi i çështjes në aspektin e peshës specifike që ka leksiku i gjuhës në shkencën gjuhësore, del edhe rëndësia e madhe që kanë fjalorët ku psqyrohet ky leksik në zhvillimin e tij dhe veçanërisht fjalorët shpjegues, e brenda tyre ata normativë, siç është “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe fjalorët e tjerë shpjegues të gjuhës shqipe që vijnë pas tij 1984, 2002, 2006. Leksiku i gjuhës shqipe, sipas akademikut J.Thomai, “nuk është një grumbull i thjeshtë fjalësh, por një system njësisish, që klasifikohen sipas parimeve të ndryshme”.<sup>19</sup>

Botimi i leksikut të gjuhës shqipe në një fjalor të mirëfilltë shpjegues, për fat të keq, është realizuar shumë vonë, në vitin 1954 me veprën e parë më të madhe në fushën e fjalorëve shpjegues kombëtarë me “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), hartuar nga Kostaq Cipo (kryetar), Eqrem Çabej, Mahir Domi, Anton Krajni, Osman Myderrizi, botim i Institutit të Shkencave.

Pavarësisht lëndës së shumtë leksikografike edhe në formën e fjalorëve, fakti që para “Fjalorit të gjuhës shqipe” (1954), nuk ishte botuar asnjë fjalor tjetër me shpjegime, e vështirësonte mjaft punën për një fjalor të tillë. Duke kapërcyer një sërë vështirësish, autorët e Fjalorit jo vetëm kanë shfrytëzuar gjerësisht e kryesisht lëndën e fjalorëve të mëparshëm, duke bërë një kodifikim kritik të lëndës leksikore e frazeologjike të tyre, por aty kanë pasqyruar edhe lëndë të re, pasi dihet se leksiku i një gjuhe pasurohet me disa rrugë: me krijimin e fjalëve të reja, me kuptime të reja dhe me huazime nga gjuhë të ndryshme.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954), bëhen përpjekjet e para për të zgjidhur edhe çështje të stilistikës në leksikografinë shqipe. Ai shënoi shkallën më të lartë të kësaj leksikografie deri në këtë kohë dhe hapi një etapë të re në këtë fushë të gjuhësisë,

---

<sup>19</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.252.

etapën e fjalorëve shpjegues kombëtarë e normativë. Vetë tipi i fjalorit, kushtet në të cilat u hartua, i sollën kufizime vëllimit të tij, duke pasqyruar rreth 25000 fjalë, kur gjuha shqipe ishte shumë e pasur.

Komentet e ndryshme që janë bërë për Fjalorin e 1954-ës, kanë evidentuar faktin se si nga vëllimi, ashtu dhe cilësia e lëndës leksikore të gjuhës shqipe, ky fjalor qëndron më lart se çdo fjalor tjetër i botuar para tij qoftë në Shqipëri, qoftë jashtë saj. Ai përfshin një numër të madh fjalësh dhe tregon forcën e madhe me të cilën gjuha jonë i ka qendruar asimilimit nga gjuhët e tjera, mundësitë e pashtershme të saj për t'u pasuruar e zhvilluar. Për këtë A. Xhuvani është shprehur: “Si dihet, më 1954 u botua nga Instituti i Shkencave “Fjalori i gjuhës shqipe”, i pari fjalor krejt shqip, me përkufizimet e me kuptimet e çdo fjale dhe me shembulla e fraza për ilustrimin e fjalës.”<sup>20</sup>

Për hartimin e “Fjalorit të gjuhës shqipe” (1954), autorët, megjithëse kanë vendosur në bazë të tij toskërishten, kanë përfshirë në fjalësin e tij fjalë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, pasi e kanë konsideruar këtë fond fjalësh si një pasuri të përbashkët të gjuhës sonë. Në këtë mënyrë “Fjalori” është një provë e gjallë që dëshmon ndryshimin e vogël që ekziston midis dy dialekteve të gjuhës shqipe. Vlera e këtij Fjalori, midis të tjerave, qëndron në faktin se ai shërben si një informues për kuptimin dhe përdorimin e shumë fjalëve të rralla ose të varianteve dialektore.

Koha në të cilën u botua “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), ishte një kohë kur nuk kishte rregulla të plota normative për gjuhën shqipe, ndaj ai do të reflektonte të meta në pasqyrimin e leksikut të gjuhës sonë si në sasi dhe cilësi, duke pasur parasysh variantet fonetike të pasqyruara aty, apo dhe fjalët e huaja, sidomos turqizmat, të panevojshme, pasi një pjesë e madhe e tyre kishin dhe korespondueset në gjuhën shqipe, gjë që shprehet edhe në parathënien e fjalorit, ku thuhet se: “Për të tilla fjalë lexuesi dërgohet te fjala shqipe përkatëse me shënimin sh. (shih) ose shënohen pranë tyre sinonimet shqipe”.<sup>21</sup>

Në atë kohë, mungesa e Kartotekës së gjuhës shqipe, sigurisht që do të reflektonte të meta në hartimin e tij, ndaj ai nxori detyra të rëndësishme para gjuhësisë shqiptare, për të ecur më tej, për të hartuar një fjalor të ri shpjegues sa më normativ, me një fjalës më të gjerë e më të sistemuar, me një frazeologji të pasur e me kërkesa të larta shkencore. Realizimi i një detyre të tillë kërkontë në radhë të parë mbështetjen në një lëndë të gjerë e të re leksikore dhe jo vetëm në fjalorët e mëparshëm, si dhe zgjidhjen shkencore të një

---

<sup>20</sup> Xhuvani, A. Çështja e “Fjalorit të gjuhës shqipe”, në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f.115.

<sup>21</sup> “Fjalori i gjuhës shqipe”, Tiranë, 1954, f.IV.

sërë problemesh teorike gjuhësore që delnin para, duke pasur parasysh veçoritë e gjuhës shqipe në fazën e zhvillimit e konsolidimit të saj.

Kjo detyrë e shtruar para gjuhëtarëve tanë u realizua me sukses në kohën e mëpasme dhe gjeti pasqyrimin, afërsisht dy dekada e gjysmë më vonë, në vitin 1980, me botimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980), (dhe në fjalorët e tjerë shpjegues që do botoheshin më pas), (me rreth 41000 fjalë, rreth 7000 mijë njësi frazeologjike dhe mbi 180000 kuptime) vepër kolektive e një grupi leksikografësh të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, një vepër cilësore jo vetëm në aspektin e rregullave të normës gjuhësore, por edhe në zgjedhjen e shpjegimit të fjalëve në makrostrukturë, në përcaktimin e kuptimeve kryesore e dytësore e shpjegimit të tyre si pjesë e mikrostrukturës, me qëllim që ai të ishte sa më afër lexuesve e t’u shërbente atyre për të kuptuar përdorimin real të fjalëve, përcaktimin drejt të sferave të përdorimit të tyre si dhe dhënien e informacioneve të domosdoshme gramatikore për njësitë leksikore.

“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), është i pari fjalor shpjegues kombëtar i tipit të mesëm dhe mund të quhet dhe reflektim i leksikografëve ndaj kërkesës së ngutshme të kulturës kombëtare, të shkollës, jetës e praktikës së kohës, si plotësim i njërës prej ëndrrave të lëvrujesve të gjuhës amtare, që kanë pritur të shohin në një vepër të tillë thesarin kryesor të pasurisë leksikore, frazeologjike e kuptimore të gjuhës shqipe. Ky Fjalor, për nga lënda leksikografike, frazeologjike e kuptimore që përmban, nga karakteri sistemor e normativ dhe nga niveli shkencor i zgjidhjeve leksikografike, përbën një nga arritjet më madhore të gjuhësisë shqiptare dhe shënon një hap cilësor në zhvillimin e leksikografisë sonë të re.

Rrethanat e favorshme në të cilat u hartua e botua ky fjalor, në krahasim me “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954), me një Kartotekë të pasur të gjuhës shqipe e me nivel të lartë të shkencës gjuhësore, bënë që autorët e Fjalorit (1980), të zgjedhin pjesën më të mirë të leksikut të shqipes duke u dhënë vendin e merituar fjalëve e shprehjeve të bukura popullore të panjohura ose pak të njohura. Në këtë fjalor u dhanë në gjerësi strukturat kuptimore të fjalëve, duke u hapur rrugë leksikut e frazeologjisë vetjake të shqipes, me qëllim që ai t’i shërbente sa më mirë masës së gjerë të lexuesve për të njohur e kuptuar përdorimin real të fjalëve, në përcaktimin drejt të kufijve e sferave të përdorimit drejt të tyre, si edhe në njohjen e variantit letrar të fjalëve, në bazë të normës gramatikore që u vendos në Kongresin e Drejtshkrimit, nëntor 1972, dhe gjeti pasqyrim të plotë në makro e mikrostrukturën e këtij fjalori shpjegues.

“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), krijoi një mbështetje të shëndoshë e hapi një rrugë më të gjerë edhe për hartimin e fjalorëve të tjerë shpjegues, si, “Fjalori i shqipes së sotme” (1984), me rreth 34000 fjalë, hartuar nga grup autorësh, i cili u

ripunua e ribotua në vitin 2002. Ky fjalor përmban në trajtë të ngjeshur vlerat kryesore të “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980), por me trajtim leksikografik më sintetik e më përgjithësues ai nuk është thjesht një shkurtime mekanik i tij, por si nga përbërja e fjalëve e ndërtimi i fjalësit, ashtu edhe nga shpjegimi i tyre, nga përbërja e frazeologjisë dhe e thënieve e nga mënyra si jepen ato, ai është një vepër e re leksikografike me një rreze më të gjerë veprimi pasi kemi informacion gramatikor të zgjeruar e informacion onomastik të pasqyruar në shtojcë, ndryshe nga fjalorët paraardhës e pasardhës, duke u shërbyer kështu shtresave më të gjera shoqërore. Fjalori ka një vëllim më të vogël e përdorim më praktik, pasi në të strukturat kuptimore jepen më të përmbledhura, si dhe përkufizimet e kuptimeve më të shkurtra.

Me ripunimin që iu bë në vitin 2002, “Fjalori i shqipes së sotme” (1984), solli lëndë të re leksikore, frazeologjike e kuptimore, duke rritur kështu peshën specifike të fjalës shqipe, duke ndrequr, në krahasim me fjalorin e mëparshëm, edhe disa përkufizime në cilësimin stilistik të fjalëve, në përsosjen e normës leksikore, duke iu përgjigjur kështu zhvillimit të gjuhës sonë në periudhën që nga fillimet e viteve 90-të, pra në rrethanat e zhvillimeve të vrullshme shoqërore, hapjen me botën e jashtme, kohë që pati ndikimin e saj edhe në gjuhë, veçanërisht reflektim të dukshëm në leksik.

Fjalori që reflektoi më shumë këto ndryshime të leksikut të gjuhës shqipe në periudhën 20 vjeçare të zhvillimeve demokratike të ne, që “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006), (edhe këto ndryshime në aspektin e pasurimit nuk i pasqyroi të gjitha), me rreth 48000 fjalë, hartuar nga grup autorësh, J.Thomai, M.Samara, P.Haxhillazi, H.Shehu, Th.Feka, V.Memisha, A.Goga. Ky fjalor shpjegues, si një vepër e re leksikografike, ruan në shkallën më të lartë vlerat kryesore të fjalorëve të mëparshëm shpjegues të shqipes dhe synon t’i rritë dukshëm këto vlera si me fjalë e me kuptime, si elementetë makrostrukturës, ashtu edhe ndërtimin e çdo zëri leksikografik si pjesë e mikrostrukturës së tij. Megjithëse ka një numër më të madh fjalësh sesa fjalorët e mëparshëm shpjegues, vëllimi i tij fizik është zvogëluar nëpërmjet trajtimeve leksikografike të një fjalori të vogël, si: sinteza më të mëdha kuptimore që ngjeshin strukturat kuptimore të fjalëve, gërshetimi i tipit leksemor me atë çerdhor në fjalë me prejardhje të drejtëpërdrejtë fjalëformuese.

Ajo që përcakton profilin e një fjalori, nuk është thjesht numri i fjalëve, por detyra më e rëndësishme e tij është zgjedhja e fjalëve, ndërtimi i makrostrukturës, pasi kjo do të pasqyrojë gjendjen reale të gjuhës, mjetet leksikore më aktive, mjetet e saj shprehëse, gjë që sjell si domosdoshmëri paisjen me një sistem njohurish teorike. Sigurisht që “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, nuk e pati një mundësi të tillë, ndaj reflekton të meta, në raport me fjalorët e tjerë shpjegues të gjuhës shqipe.



Leksiku i gjuhës sonë, ashtu si i çdo gjuhe, mund të studiohet nga prerje të ndryshme dhe mund të ndahet në grupe paradigmatiche të ndryshme. Ai mund të studiohet :

1. Sipas burimit të fjalëve, që nënkupton dy grupe paradigmatiche të mëdha njësisish; grupi i njësisive leksikore që lidhen me leksikun amtar (autokton) dhe grupi i njësisive leksikore të huazuara
2. Sipas dendurisë së përdorimit, që nënkupton larmi kriteresh dhe për pasojë edhe larmi grupimesh, si grupi paradigmatic i leksikut aktiv dhe grupi paradigmatic i leksikut pasiv.
3. Sipas sferës së përdorimit. Sipas këtij këndvështrimi leksiku mund të ndahet: a). Leksik i përgjithshëm, që përmban fjalët e zakonshme të gjuhës së përditshme, fjalë që përdoren në të gjitha fushat e jetës shoqërore.  
b). Leksiku special, që përfshin fjalët profesionale dhe terminologjike. Në fushat e ndryshme të veprimtarisë njerëzore, sipas mjeshtrëve ndeshim shtresa fjalësh që njihen e përdoren vetëm nga grupe të caktuara njerëzish, nga punonjës e specialistë që merren me një punë të caktuar.

Duke e vështruar fjalësin e tre fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006), konstatojmë në radhë të parë ndryshim të fjalësit në aspektin vertikal, në numër njësisish leksikore, në makrostrukturën e tyre, me respektivisht 25000 fjalë Fjalori i 1954-ës, rreth 41000 fjalë Fjalori i 1980-ës dhe rreth 48000 fjalë Fjalori i 2006-ës. Konstatimi i një fakti të tillë të çon në pohimin e parë se leksiku i gjuhës shqipe është pasqyruar më mirë në fjalorët shpjegues e është pasuruar. Siç e kemi theksuar edhe më lart, ky pasurim është bërë në disa rrugë, me krijimin e fjalëve të reja, me zhvillimin e kuptimeve të fjalëve ekzistuese dhe me huazime nga gjuhë të ndryshme, sidomos dy dekadat e fundit, pas 1990-ës e deri sa kanë gjetur pasqyrim pjesërisht në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006.

## 2.2 PASQYRIMI I LEKSIKUT TË GJUHËS SHQIPE NË MAKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES

Aspektet e ndryshme të ndërtimit të një fjalori gjuhësor si, parimet për hartimin e tij, kriteret përzgjedhëse të fjalëve, drejtshkrimi, drejtshqiptimi, kategoria gramatikore e njësive leksikore, shpjegimi, shembujt, shtresimi i leksikut etj., grupohen në termat e makrostrukturës e mikrostrukturës të fjalorëve shpjegues, të cilat shtrojnë probleme të ndryshme për t'u zgjidhur ku, nga mënyra e zgjidhjes së tyre, bëhet edhe dallimi midis fjalorëve apo edhe cilësia e tyre.

Çdo fjalor shpjegues gjithëlëndën leksikore e organizon në dy njësi që quhen makrostrukturë dhe mikrostrukturë. “Makrostruktura –shkruan J.R.Deboue- quhet tërësia e njësive leksikografike të renditura që i nënshtrohen gjithmonë një leximi vertikal të pjesshëm për gjetjen e objektit të mesazhit”.<sup>22</sup> Pra makrostruktura është ndërtimi i fjalorit në tërësi: fjalësi (d.m.th. lista e fjalëve a e njësive frazeologjike që janë zgjedhur për t'u përfshirë në fjalor dhe që renditen sipas një kriteri), struktura kuptimore e fjalëve a njësive frazeologjike me trajtat plotësuese, me shënimet gramatikore, stilistike e për fushën e përdorimit, me shpjegimet e kuptimeve, me thëniet e me shembujt. Të gjitha këto elemente të makrostrukturës përcaktohen nga tipi i fjalorit dhe synojnë të japin çdo njësi leksikore, frazeologjike e semantike sa më të plotë e sa më të qartë për përdoruesit e fjalorit. Kështu makrostruktura është “ndërtesa” në tërësi e fjalorit, që ka ndarjet e pjesët e veçanta.

Pjesën kryesore të makrostrukturës në fjalorët shpjegues e përbën leksiku aktiv i gjuhës shqipe. Kësaj pjese i shtohen edhe disa grupe të tjera fjalësh që janë të domosdoshme për përdoruesit e fjalorit si, fjalët e vjetruara dhe historizmat, sepse ato janë të vlefshme për të kuptuar dhe shpjeguar letërsinë e etapave të mëparshme historike si të Rilindjes apo edhe vetë historinë.

Fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, sidomos nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) e deri te “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006), kanë qenë të hapur ndaj fjalëve të reja. Për këtë fenomen në parathënieën e Fjalorit shpjegues të 1980-ës thuhet se një nga detyrat e tij është të hedhë në përdorim fjalë e shprehje pak të njohura, sidomos të gurrës popullore, që deri më sot nuk janë pasqyruar në fjalorë e në botime të tjera, por që i kanë të gjitha vlerat e mundësitë për të qenë pjesë e pandarë e fondit leksikor e frazeologjik të gjuhës sonë letrare kombëtare. Me të drejtë ky Fjalor fjalët e reja nuk i quan neologjizma, sepse, sipas disa gjuhëtarëve, pas pasqyrimin në fjalor neologjizmat pushojnë së qeni të tilla.

---

<sup>22</sup> .Debove, J.R Etude linguistique et semiotique des dictionnaires français contemporains, La Haye, 1971,f.2.

Siç theksuam edhe më lart, fjalori ka pjesë të tij të rëndësishme edhe mikrostrukturën që, sipas J.R. Debove, quhet “tërësia e informacioneve të renditura të çdo artikulli që zbatojnë një program informacioni të qëndrueshëm për të gjithë artikujt dhe që lexohen horizontalisht pas njësisë leksikografike”.<sup>23</sup> Pra mikrostruktura e fjalorit është ndërtimi i çdo njësie leksikografike veças, d.m.th. paragrafi për një fjalë a për një njësi frazeologjike. Edhe mikrostruktura varet nga tipi e synimi kryesor i fjalorit. Kështu në një fjalor të madh, që ka shumë fjalë, ka edhe një zbërthim më të imët të përmbajtjes leksikore për çdo fjalë, shpjegime më të gjera për çdo kuptim, më shumë shënime plotësuese, më shumë thënie e shembuj.

Fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe dallojnë nga njëri-tjetri veçanërisht në makrostrukturën e tyre. Por ndryshime të vogla kanë edhe në mikrostrukturë, sidomos “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006) në krahasim me të gjithë fjalorët paraardhës shpjegues të gjuhës sonë, pasi ai shënoi nivelin më të lartë të pasqyrimin të njësive leksikore duke përfshirë shumë fjalë, shprehje e kuptime që përdoren sot në gjuhën shqipe, por nuk gjenden në fjalorët e mëparshëm shpjegues të saj. Kjo lëndë e re pasuruese që është nxjerrë nga vjelja leksikore e veprave të letërsisë artistike e shkencore, nga shtypi i përditshëm e periodik, nga fjalorët e tipave të ndryshëm etj., e ka përditësuar në mënyrë të kënaqshme fjalorin. Ky fjalor ka një mënyrë të veçantë pasqyrimi në krahasim me fjalorët e tjerë shpjegues, ka pasqyrimin me çerdhe fjalësh. Si fjalë themelore në krye të çerdes ai ka 43000 njësi, ndërsa si fjalë që përdoret i fjalorit i ndërton vetë sipas shkurtësive (*edhe si em.; edhe si em.m, edhe si em.f.; edhe si f.; edhe si mb., nd. etj.*). Fjalori përmban 48000 fjalë, përveç shumë njësive frazeologjike dhe thënieve. Ky fjalor përfshin shtresën kryesore, më aktive të leksikut të gjuhës shqipe (kryesisht nga leksiku i shqipes standarde) dhe një pjesë të kufizuar, krejt të domosdoshme, të shtresës pasive. Ky parim në fjalor është ndjekur edhe për regjistrimin e kuptimeve, për frazeologjinë dhe për vlerat mbishtresore të fjalëve.

Më poshtë ne do të paraqesim ndryshimin në makrostrukturë të tre fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006), duke evidentuar ndryshimet më të spikatura të fjalësit të tyre, në numër, në zhvillimin e kuptimeve, shtimin e bjerrjen e numrit të fjalëve, në mënyrë shteruese për fjalësin e shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O. Në një tabelë të veçantë ne do të japim numrin e njësive leksikore për çdo shkronjë të tre fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, por në analizë të detajuar do të marrim fjalësin e shkronjave të mësipërme.

---

<sup>23</sup> Debove, J.R. Etude linguistique et semiologique des dictionnaires français contemporains, La Haye, 1971, f.21.

**PASQYRA E ZHVILLIMIT TË FJALËSIT APELATIV NË MAKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE.**

<b>Nr.</b>	<b>SHKRONJA</b>	<b>FJALORI 1954</b>	<b>FJALORI 1980</b>	<b>FJALORI 2006</b>
1.	A	884 fjalë	1851 fjalë	1911 fjalë
2.	B	1245 “	2839 “	2868 “
3.	C	282 “	667 “	892 “
4.	Ç	480 “	793 “	1066 “
5.	D	1088 “	1969 “	2226 “
6.	DH	145 “	238 “	247 “
7.	E	321 “	534 “	757 “
8.	Ë	18 “	582 “	78 “
9.	F	865 “	1472 “	1870 “
10.	G	719 “	1442 “	1496 “
11.	GJ	384 “	756 “	792 “
12.	H	653 “	968 “	1135 “
13.	I	290 “	421 “	657 “
14.	J	151 “	278 “	367 “
15.	K	2531 “	3393 “	3623 “
16.	L	1045 “	1637 “	1930 “
17.	LL	141 “	217 “	345 “
18.	M	1692 “	2482 “	2723 “
19.	N	963 “	1478 “	1652 “
20.	NJ	128 “	332 “	446 “
21.	O	207 “	282 “	432 “
22.	P	2993 “	4793 “	5112 “
23.	Q	478 “	712 “	982 “
24.	R	541 “	865 “	918 “
25.	RR	468 “	752 “	1017 “
26.	S	1206 “	1640 “	1945 “
27.	SH	1502 “	2632 “	3267 “
28.	T	1198 “	1563 “	1942 “
29.	TH	244 “	372 “	461 “
30.	U	277 “	417 “	488 “
31.	V	1015 “	1575 “	1836 “
32.	X	46 “	57 “	71 “
33.	XH	100 “	153 “	179 “
34.	Y	19 “	59 “	67 “
35.	Z	559 “	765 “	1194 “
36.	ZH	157 “	421 “	668 “

### 2.2.1 MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS A NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Në makrostrukturën e shkronjës A në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954) janë përfshirë 884 njësi leksikore, një pjesë e të cilave janë variante fonetike dialektore nga krahina të ndryshme të vendit. Nga leksiku i kësaj shkronje 70 fjalë kanë dy variante dialektore dhe 16 fjalë me 3-4 variante të tilla, si fjalët e mëposhtme: *i afër-i afërm, agrep-akrep-hagrep, agjërim-agjënim, ahur-haur-ahër, ahmarrje-hakmarrje, e ama- e ëma, ambël-ëmbël, ambëltore-ëmbëltore, andej-andejza, prandaj-prandej, andë-andje-ëndje, androroj-arnoj, anmik-armik, ap-jap etj.*

Paraqitja si glosë më vete e varianteve fonetike dialektore shton artificialisht numrin e fjalëve në fjalor dhe nuk ruan normativitetin dhe as parimin e mbështetjes të toskërishtja për fjalë të tilla. Nga këto fjalë vetëm njëri prej varianteve duhet të vendoset në fjalor, pasi të tjerët janë të panevojshëm, sepse në mes tyre nuk ka ndryshim kuptimi, por vetëm ndryshim minimal shqiptimi, pasi ato janë vetëm variante fonetike-dialektore të së njëjtës fjalë.

Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980), në këtë shkronjë gjenden 1851 njësi leksikore, kurse në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (2006), gjenden 1911 njësi. Në një vështrim të parëshohim se leksiku i të tre fjalorëve ndryshon në këtë shkronjë. Kështu në krahasim me “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954), në Fjalorin e vitit 1980 ka 967 njësi leksikore më shumë, dhe të Fjalori i 2006-ës, 1027 njësi leksikore më shumë. Kjo diferencë rritet më shumë dhe shkon në 1021 fjalë të fjalori i dytë shpjegues (1980) po të marrim parasysh faktin se të “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954) gjenden 54 fjalë që nuk i ka fjalori i vitit 1980, si: *abdes, abnegacion, abrogim, abrogoj, absorboj, adezion, adjektiv (mbiemër), adha (lidhëza pra), aerolit, agushi, akllai, akllaci, akropol, alijar, alkaik, allonari, amashirë, ambulant, amnuer, anapest, anasan, anacak, anestetik, antivenerian, antropogjeografi, aorist (e kryera e thjeshtë), apansëz, apepleksi, aposteriori, apriori, aproksimativ, arabaske, arak, araknide, ardhishtë, arenc, argëlidh, arnicë, argimandrit, arqipel, arshin, arrishte, arrjet, as, asjatër, atakoj, atej, atkos, aton, autenticitet, autosugjestion, avdos, avre.*

Fjalët e shtuara në fjalorin e vitit 1980 nuk janë të gjitha neologjizma, d.m.th. të krijuara pas botimit të “Fjalorit të gjuhës shqipe” (1954), por shumica e tyre janë fjalë që nuk kanë gjetur vend pasqyrimi në këtë fjalor, për arsye nga më të ndryshmet, ashtu sikurse ka dhe fjalë të reja, të krijuara më vonë, duke treguar qartë zhvillimin e gjuhës në rrethanat e reja historiko-shoqërore, në përputhje me zhvillimin ekonomik, shoqëror e kulturor të popullit tonë.

Nga kjo pasuri leksikore shtesë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980), fjalë që nuk gjenden në Fjalorin e 1954-ës, po japim fjalët e mëposhtme: *abanoz, abort, abortar, abresh, absidë, abstraksionist, abstraksionizëm, abstraktësi, abstraktoj, abuzues, acetilinë, acetone, acidoj, acidim, acik, adalet, adaxhio, adekuat, aderim, adertar, adjuntaturë, administrues, admirues, i admirueshëm, i adaptueshëm, adhurues, i adhurueshëm, aerodinamik, aeroplanmbajtës, afarist, afatgjatë, afatshkurtër, afcë, afendiko, afetar, afetari, afërmendsh, afërmendësi, afërndenjëse, afshohet, afshia, afshon, aftësoj, aftësim, agallëk, agar, agëshok, aginar, aglomerat, aglomerim, aglomeroj, agraro-industrial, agreement, aggressor, agjitativ, agjikator, agjitprop, ahengxhi, ahishtor, ajërftohës, ajërmatës, ajrolundrues, ajroset, ajth, arktik, acrobat, aksiomatik, aktbesim, aktdalje, aktdelegim, aktdetyrim, aktdënim.*

Ndryshim në makrostrukturë, në krahasim me dy fjalorët e mëparshëm, paraqet edhe “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006), te i cili, ashtu si te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), e ndryshe nga “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), “...korpusi i përgjithshëm nuk përfshin variantet fonetike e gramatikore, krahinorizmat e ngushtë, termat tepër speciale, fjalët me strukturë të lehtë fjalëformuese (si disa fjalë të prejardhura a të përbëra që formohen lehtë nga çdo shqipfolës ose që nuk kanë përdorim të gjerë, formime tipologjike me parashtesa të specializuara si *mos-, pa-, për-, ri-,* etj.), huazimet tashmë të mënjanuara nga përdorimi a të rejtat që nuk janë ngulitur ende në shqip ose u takojnë sferave të ngushta të përdorimit”.<sup>24</sup>

Kriteret që cituam më sipër, kanë çuar në ndryshimin e fjalëve në këtë shkronjë të “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006). Aty gjenden gjithsej 1911 njësi leksikore, pra 1027 njësi më shumë se te Fjalori i 1954-ës, dhe 60 njësi më shumë se te Fjalori i vitit 1980. Por në të gjithë fjalorët shpjegues mungojnë fjalë të njëri-tjetrit, ashtu sikurse ka fjalë që gjenden vetëm te njëri fjalor. Këto ndryshime më të mëdha janë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954), por këtij konstatimi nuk i shpëtojnë as fjalorët e tjerë shpjegues.

Kështu nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), mungojnë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (2006), fjalë të tilla si: *abak, adaxhio, aferim, afratë, afrikate, agallari, agërshak, akçi, akël, aj, ajërnxjerrës, ajërshpërndarës, agor, akraba, aktdelegim, aktpërfaqësim, akullor, alem, allaxha, allçak, amel, amerikanizohem, anteri, antiklerikal, antipunëtor, ap, araba, arabaxhi, arallëk, argano, argati, arka, arkapi, arkëz, armac, arzushall, atëri, avër, axhele etj.*

---

<sup>24</sup> Fjalor i gjuhës shqipe, 2006, (grup autorësh), Tiranë, f.8-9.

Ashtu si në fjalorët e mëparshëm shpjegues, edhe te ky fjalor ka shumë fjalë që nuk janë përfshirë në makrostrukturën e tij. Por ky fenomen nuk përbën ndonjë varfërim të gjuhës shqipe, nëse në vend të tyre, vihen fjalë të tjera shqipe me një fuqi shprehëse më të madhe e përgjithësuese, që s'kanë variante sinonime, ndonëse edhe pse mund të jenë me burim krahinor apo neologjizma, e eliminojnë tiparin kufizues po t'i nënshtrohen normës gjuhësore dhe e pasurojnë fuqinë shprehëse të saj. Një proces i tillë zëvendësimi është pasurim i leksikut të gjuhës me elementin vendës duke iu përgjigjur kështu kërkesës për kombëtarizimin e normativizimin e këtij leksiku.

Fjalë të reja që nuk gjenden në fjalorët e mëparshëm shpjegues të gjuhës shqipe, por janë në Fjalorin e vitit 2006, mund të përmendim nga fjalësi i shkronjës **A**: *abdes, abdeshan, abonoh, anohem, abonues, abrogoj, abrogim, absorboj, absorbues, absorbim, adrenalinë, adeso, adresohem, adresim, aerobi, afatmesëm, afekt, afektiv, afganistanas, aforfe, agrumishtë, agëtim, aids, ajkos, akcizë, aksidentoj, aksidentim, (i e) aksidentuar, aktorial, aktoresk, aktpagesë, aktroj, aktrim, aktualisht, akuadrom, akullsirë, alarmant, aleluje, alergolog, alergologji, alkalin, alogjen, aliristik, aludoj, aludim, amatoresk, ambiental, aroralitet, analizues, anaprapthi, anashkaloj, antemoj, anatemim, anatemë, aneksues, anërrugë, anëtarësoj, anëtarësohem, (i, e) anëtarësuar, anglofon, animizoj, animizim, (i, e) animizuar, anipse, anonimat, anonimizoj, anonimizim, anoreksi, antigaz, antikontrabandë, antikrim, antivlerë, arëtar, arvanit, arvanitas, asajane, asociues, asteroid, astomatik, ashëron, autostradë, aviobambë etj.*

## 2.2.2 MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS B NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Ndryshim të numrit të njërive leksikore në të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe vërehen dhe në fjalësin e shkronjës **B**. Në “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), janë pasqyruar 1254 njësi leksikore, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) janë pasqyruar 2839 njësi leksikore dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (2006) 2868 njësi leksikore. Diferenca e numrit të përgjithshëm të fjalëve me fjalët e përbashkëta midis këtyre fjalorëve në shkronjën B është më e madhe po të marrim parasysh faktin se ka fjalë që janë në një fjalor e nuk janë në tjetrin. Ky fenomen vërehet te të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, nga i pari (1954) deri te i fundit fjalor shpjegues, “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006).

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954), edhe në fjalësin e kësaj shkronje zënë vend një numër i madh variantesh fonetike-dialektore, rreth 160 të tilla, të cilat mund të lireshin jashtë fjalorit, pasi nuk emërtojnë diçka të re e nuk i shtojnë gjë gjuhës shqipe, veçse përsërisin të njëjtat fjalë, por me ndonjë ndryshim fonetik dialektor, si: *boboreshë-boboricë-buburrecë, bagëti-bakëti, badër-bathër-badhër, baj-bëj, barkac-bargac, balkue-balkon, ballomatar-ballomaxhi, ballomë-mballomë, ballungë-bullungë, bartje-mbartje, barsë-mbarsë etj.*

Në këtë shkronjë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980), jepen 2839 fjalë, ndërsa në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (2006), jepen 2868 fjalë. Pra siç shihet ndryshimi është i madh me Fjalorin e 1954-ës, respektivisht 1594 fjalë më shumë në Fjalorin e 1980-ës dhe 1623 fjalë më shumë në Fjalorin e 2006-ës. Edhe midis tyre ka ndryshim në numër të përgjithshëm fjalësh pa marrë parasysh se ç’fjalë nuk kanë nga njëri tjetri. “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006), ka edhe 29 fjalë më shumë, ndryshim që nuk ka ndonjë peshë të madhe duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të fjalëve të pasqyruara në këtë shkronjë në të dy fjalorët. Po të shtojmë edhe variantet fonetike të fjalëve të pasqyruara te “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), diferenca rritet edhe më shumë duke shkuar në 1754 fjalë me Fjalorin e 1980-ës dhe 1783 me atë të 2006-ës.

Një pjesë e fjalëve që nuk gjenden te “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954) dhe janë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980), janë: *babaxhan, babzot, babëzisht, babunë, babush, bacarak, bajrakas, bajraktarizëm, bajramcurras, bakllama, baktermbartës, baktermbartës, baktermytës, balash, balestër, balëdrenjë, balëmushkë, baloshanë, balsamues, balsam, balsohem, balsoj, ballovec, balthukë, balush, ballas, ballargjendë, ballëbardhë, ballëçelik, ballëçelur, ballëlartë, ballinë, ballkanas, ballkanolog, ballkanologji, ballkë, ballkat, bamboo, bama, bantitizëm, banketë, banjëzot, banjëzohet, baraslargësi, baraspeshë, baraspeshim, barazh, barbac, barbari, barbarozë, bardhëllëmë, bardhëllor, bardhësi, bardhësirë, bardhje, barik, barimëz, barisferë,*



*barishtak, barium, barkace, bar-kafe, barrikadë, basen, baskë, barometrik, barominë, baron, baroneshë, batisje, batiskaf, batërdi, batërdisem, baticor, batis, belor, belar, begatoj, begatohem, beharisht, beharoj, besëmirë, besëkeq, besëplotë, besim, betonues, besimplotë, besdisem, besdisje, (i, e) bezdisshëm, bëltacë, bëltojë, bërbëlit, bërcel, bësh tajë, bifkë, biguti, bikarbonat, bimisht, bimsë (qilar), bisedor, bisedues, bishtërra, bishtës, bishtëgërshërë, bjeshkor, bjezgë, blistër, blogurë, blojtës, blokëra, balcam, boksit, bolivian, bonifikues, bonz, braktis, braktisje, boshje, botëkuptimor, boshtivan, branoj, branim, breshkaqen, briartë, bridredhur, brizanë, brizë, brizoj, brumosem, brumosje, bucem, buđko, budist, buding, bufal, bufar, bukovicë, bujë, bujanë, bujqësor-industrial, bulon, bulb, bukhëm, bukthi, bulbor, buzëbardhë, buzëplasje, bushel, bylyk, bylykbash, bymej, bymim, bymehet, byreckë, bytynte etj.*

Nga ballafaqimi i fjalësit të fjalorëve vëmë re se ka fjalë që nuk gjenden te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), por gjenden te “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, fjalë që nuk hyjnë në variantet fonetike dialektore, si: *ballgame, bastues, balmuq, bashtë, batori, balzot, befët, belinë, berqi, bërbani, bidat, bikonkav, bikonveks, bilonjë, bahcallëk, bokëlinë, bok, bombastic, borazanë, bors, botme, boticë, Brahman, broskë, brenci, brerore, breskë, brije, brigim, brigoj, brilem, broшти, brutalitet, brutalisht, buburis, bukator, bukolik, bukli, buklorë, buklëz, bukoliket, burdullak, burumli, burdhë, burrot, busolë, bushicë, butri, buxhel.*

Siç u shprehëm më sipër, te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, gjenden në fjalësin e kësaj shkronje 2868 fjalë, ose 29 fjalë më shumë se te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe 1623 fjalë më shumë se Fjalori i 1954-ës. Diferenca e fjalëve të pasqyruara në të tre fjalorët rritet, pasi në Fjalorin shpjegues të vitit 2006, kemi fjalë të reja që nuk ndodhen në fjalorët e mëparshëm shpjegues të gjuhës shqipe, ashtu sikurse kemi fjalë që ndodhen te fjalorët e mëparshëm, por nuk ndodhen në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, si: *babaraq, babazi, bagëlosh, bagmi, backallos, backallom, bagolinë, bajagi, bajalldi, bajameshitës, bajramcurras, bajum, bakërim, bakllama, bakthi, balenagjuajtës, bakal, baledrenjë, ballëçelik, baltos, balashan, ballanxhë, ballcak, ballëbardhë, ballëflori, ballëgreq, ballëpruar, ballënxirë, ballukemadh, ballukemënjatë, ballukezi, bandazh, bankëprovë, baraban, barabitem, barash, barazh (pritë), barbagam, barburig, bardhosh, bedilemë, bef, begalem, (i, e) begenisshëm, bejc (be i vogël), belaxhi, bellitë, belicë, belshak, bemal, benzinatë, beratçe, berbecul, berdankë, bimor, binamadh, binek, binjor, bojëhurmë, bojëmish, bojëshkurtër, bolloverbët, boriz, borgull, boritë, borrohit, bostancë, bosti, boshas, boshatis, boshatisje, boshtivan, bravapunues, brumës, byreksheqer, bytymtë, byrynxyk etj.*

Fjalë që kanë zënë vend në makrostrukturën e “Fjalorit të gjuhës shqipe” 2006, por nuk janë në fjalorët e mëparshëm shpjegues të gjuhës shqipe janë: *babiloni(rrëmuje e*

*madhe), babilonas, babëzitje, bacan, bagëtisht, bajalet, bajgan, bajgosje, bakërrohem, bakteriologjik, (i, e) balancuar, balsamosje, (i, e) ballë, ballëkeq, ballëroj, ballërohem, (i, e) ballëruar, ballavec, ballërinë, ballavesh, ballëdjersitur, ballëzëmtë, ballok, ballosh, bankomat, barazditë, (i, e) baraspeshuiar, barasvlerësoj, barasvlerësim, barashtroj, barashtrim, bardhem, bardhje, (i, e) bardhur, behje, (i, e) betuar, belbje, belbëri, belbëzim, belgjerë, belngushtë, benediktin, bimon, bimohet, (i, e) bimuar, binjakëzgj, (i, e) binjakëzgj, biokimik/e, biond/e, bohemë, bojëfjnjë, bombastic, bordurë, borëton, borëtimë, borishtë, bos, boshkë, boshnjak, boshtar, boshtak, braktis, bravo, (i, e) brazdazgj, bre, bredhje, bregogjë, (i, e) bregëzgj, brushtullimë, brutalitet, bubac, bubajkë, (i, e) brymëzgj.*

Kriteret e ndryshme në vlerësimin e fjalëve që do të përfshihen në fjalorët e ndryshëm shpjegues, krahas fjalëve të reja, kanë rritur deri diku, në mënyrë subjektive diferencën e fjalëve për çdo shkronjë me numrin e fjalëve të përbashkëta, në shkronjat që kemi marrë në shqyrtim, konkluzion që me përafërsi mund të nxirret për fjalësin e gjithë makrostrukturës në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe.

### 2.2.3. MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS C NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Një situatë e ngjashme me fjalësin e pasqyruar në shkronjat e mësipërme, vihet re dhe në fjalësin e shkronjës C. Megjithëse pesha specifike e fjalësit të kësaj shkronje, në raport me fjalësin e përgjithshëm të çdo fjalori shpjegues, është e vogël, përsëri diferencat janë të mëdha nga njëri fjalor shpjegues në tjetrin.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, në shkronjën C janë pasqyruar 282 njësi leksikore, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, 667 njësi dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, janë pasqyruar 892 njësi leksikore. Në një vështrim të parë shohim ndryshimin numerik në rritje nga njëri fjalor paraardhës në atë pasardhës shpjegues. Diferenca me Fjalorin shpjegues të 1954-ës rritet më shumë po të marrim parasysh faktin se në këtë fjalor, si në fjalësin e çdo shkronje edhe këtu, janë pasqyruar variantet fonetiko-dialektore të disa fjalëve si: *caponjë-capore, celfë-cefël, ca-cazë, carrok-carrue-carroi, cergar-cergatar, cironkë-cirua, cys-cyth, cikrron-cirkon*.

Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, kemi 667 fjalë, ose 385 fjalë më shumë, pra që nuk gjenden në makrostrukturën e Fjalorit të 1954-ës, si: *cabik, cacë, cacër, caherë, cajakë, cakërr, cakonjë, cakërroj, cakërrim, cakkërri, cakërrsor, cacos, cakthi, cakule, cakulthi, camuze, cangëloj, cangër, cangohet, cap, capërluar, capim, capinë, capoj, carangth, carist, cecë, cecull, cecë, cecull, cedër, cedrishte, ceflisht, cekapreka, cekash, cekë, cejlonez, cektësirë, cengë, cenak, cenosur, censor, censuruar, cent, centigradë, centrifugë, centrim, centrist, (i) cenueshëm, ceparak, celebral, cezarian, cesium, cifloj, ciflosje, cicërues, cicmic, cifund, cifundoj, cigon, cigarepërdredhës, ciklonar, cikërr, ciklik, cikon, cikut, cilësimë, cilësues, cilindrik, cilivile, cimar, cimartë, cimbidhem, cingal, cingaris, cingarisur, cingëlor, cingthi, cingush, cinkë, cinxami, circuit, cirrozë, cokaqe, cokatje, copamadh, copatar, copërinë, copëtohem, crogem, cubak, cuba, cuboj, cullan, cullnisht, cungajë, cumrak, cundër, curle, curufujkë, currak, curran, curril, currubab, cytanik, (i, e) cytuar, cylaq etj.*

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, në fjalësin e kësaj shkronje kemi një rritje me 225 fjale në krahasim me Fjalorin shpjegues të vitit 1980 dhe 610 fjalë më shumë se Fjalori i 1954-ës. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i prurjeve të shumta në leksikon e shqipes pas vitit 1990, si edhe statusit gjithëkombëtar të disa fjalëve dialektore, si: *cac, cacas, cacti, cacitem, cacitje, caf, cakatan, cakcak, cakël, caklartë, cacosje, (i, e) cacosur, callangur, capok, camë, camruk, camrukem, camrukje, (i, e) camrukur, cangëlon, cangull, capon, capëlloj, capëllim, caradung, caruk, caulë, cecat, ceflisje, ceflim, (i, e) cefluar, cekatore, (i, e) cekuar, (i, e) celebruar, celinë, celular, cemerlik, (i, e) cenueshëm, cenueshmëri, cepastar, ceplë, cepore, cergosje, cermëz (raki e fortë),*

*cërcall, cërrfas, cërrlakthi, cfag, cfëng, cfëngie, cfingj, cicar, cicërifkë, cikalos, cikalosem, cikalosje, (i, e) cikalosur, cikomë, cikatje, cikëllim, cikoj, cikim, cikues, cilësorisht, cimbje, cimocë, cinabel, cinakuq, cingalor, cingërimë, cinur, cipëkuq (ëmbëlsirë si qumështor), cpërimë, cipëzezë, cipricullak, cipricullakoj, ciptas, cipërak, cirilëng, cirkakeq, cirkalarmë, cirkalor, cirkani, cinis, cinisje, citem, citje, cizoj, cizim, ckurrë, coffe, cofëtan, cokem, cokje, cokatan, ckëlloj, cokëlimë, cakure, capëlore, cputh, (i, e) cubët, cucat, cucatje, cuktojë, culakajë, culakitem, culakitje, culloj, cungim, cuminar, cytës etj.*

Por edhe në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, ka fjalë që nuk gjenden në Fjalorin shpjegues të 2006-ës, si: *calinë, carinë, cazë, cekth, cernik, cezarian, i cercertë, cërkakeq, cërkalor, cerkanë, cërkat, cërkazi, cifundoj, cikem, cikëton, ciklostil, cikmë, cimak, cimbos, cinkograf, cinkografi, cipëthatë, citologjik, (i, e) cituar, cullufetumbë*. Siç vihet re në Fjalorin e 2006-ës mungojnë disa fjalë që nuk ka arsye të mos ishin si: *(i, e) cituar, cikmë, cezarian*, që janë shumë të njohura e përdoren pothuajse nga të gjithë njerëzit. Pradiferenca e njësive leksikore në fjalësin e pasqyruar në këtë shkronjë, midis fjalorëve shpjegues është shumë e madhe, duke pasur parasysh dhe peshën e vogël specifike që zë fjalësi i kësaj shkronje në makrostrukturën e çdo fjalori shpjegues.

#### 2.2.4. MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS Ç NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Edhe për fjalësin e kësaj shkronje, midis tre fjalorëve shpjegues, vërehen ndryshime në fjalë e kuptime. Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, shkronja Ç përfshin 480 fjalë, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, 793 fjalë dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, pasqyrohen 1066 fjalë. Në fjalësin e kësaj shkronje, veç varianteve fonetike-dialektore, ashtu si në fjalësin e shkronjave të tjera të këtij fjalori, kemi dhe një specifike tjetër, një pjesë e fjalëve që normalisht duhet të përfshieshin në fjalësin e shkronjave të tjera janë përfshirë këtu. Në këtë rast bëhet fjalë për njësi leksikore qëduhet të merrnin parashtesat *sh-*, *zh-*, *xh-*, *s-*, dhe *ç-*. Pra këtu janë shënuar fjalë me luhatje tingëllore dhe, në vend që të shkruhen me parashtesa të tjera janë shkruar me parashtesën *ç-*, ndaj janë përfshirë si fjalë të kësaj shkronje, si: *çbëj*, *çdredh*, *çduk*, *çdukje*, *çfajësim*, *çfajësohem*, *çfaq*, *çfaqje*, *çfaros*, *çfarosje*, *çfryj*, *çfrytëzim*, *çkalit*, *çkallmoj*, *çkarkim*, *çkatërraq*, *çkatërrim*, *çkatërrimtar/e*, *çkatërroj*, *çkëlqej*, *çkëlqim*, *çkoq*, *çkoqit*, *çkrij*, *çkrimb*, *çkul*, *çpalos*, *çpall*, *çpallje*, *çpenkoj*, *çpërblim*, *çpërbljes*, *çpërblimtar*, *çpifje*, *çpifarak*, *çpifës*, *çpikje*, *çplaj*, *çpronësoj*, *çpyllëzim*, *çpyllëzohet*, *çqetësim*, *çthurçvat*, *çvendos*, *çvidhos*, *çvleftësoj* etj.

Pra siç shihet këto fjalë nuk e kanë vendin në fjalësin e kësaj shkronje, por meqë ende në gjuhën tonë nuk ishin stabilizuar rregullat drejtshkrimore, ato u përfshinë në këtë shkronjë mbi bazën e shqiptimit në krahina të ndryshme. Një gjë e tillë është korrigjuar në gjithë fjalorët e mëvonshëm shpjegues, pasi miratimi i rregullave drejtshkrimore eliminoi përfundimisht shmangie të tilla dialektore.

Duke përfshirë edhe këto fjalë, ndryshim i fjalëve me fjalorët e tjerë është i tillë: Në Fjalorin e 1980-ës janë pasqyruar edhe 313 fjalë më shumë, si: *çaçkë*, *çadrandreqës*, *çafër*, *çafëri*, *çafkëbardhë*, *çahem*, *çajor*, *çajtor/e*, *çak*, *çakaçuk*, *çakaçukthi*, *çakëllosem*, *çakalloz*, *çakçirë*, *çakëllimë*, *çakërdis*, *çakërdisem*, *çakërdimë*, *çakërdohet*, *(i, e)* *çakorduar*, *çatdhesoj*, *çatdhesim*, *(i, e)* *çatdhesuar*, *çatiprishur*, *çatis*, *çdofarë*, *çdoditshëm*, *çdofarshëm*, *çdoherë*, *çdolloj*, *çdollojshëm*, *çedukoj*, *çedukim*, *çeltas*, *çeltazi*, *çeltirë*, *çelur*, *çerek*, *çerekfinale*, *çerekkilësh*, *çereklitërsh*, *çereksh*, *çerekshe*, *çerekshekullor*, *çmat*, *çmatem*, *çaterializohet* *çmos*, *çnjerëzim*, *çnjerëzisht*, *çnjerëzohet*, *çunëri* *çupit*, *çupitje* etj.

Po kështu edhe Fjalori i 2006-ës ka 586 fjalë më shumë se Fjalori i 1954-ës dhe 273 fjalë më shumë se “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, që nuk gjenden te ky i fundit si: *çabullë*, *çafkëtoje*, *çakëlan*, *çakërdisje*, *çakje*, *çaklamin*, *çakramane*, *çakrraç*, *çakrraman*, *çalët*, *çalok*, *çallapatisem*, *çallapatisje*, *(i, e)* *çallapatisur*, *çallashnik*, *çallëstar*, *çamëroj*, *çamërohet*, *çamërim*, *(i, e)* *çamëruar*, *çapërçik*, *çapërçikem*,

*çapërçikje, (i e) çapërçikur, çaravesh, çaraveshem, çaraveshje, (i, e) çaraveshur, çaraveshan, çarmatim, (i, e) çarmatuar, çdomuajshëm, çdonjëri, çdota, çdovitshëm, çehreëmbël, çejnë, çejz, çejzoi, çejzim, çejztar, çičibuç, çičbanoz, çideologjizoj, çideologjizim, (i, e) çideologjizuar, çmallje, çmallohem, çmallim, çmatje, çmpirje, (i, e) çmpirë, çuçu, çuçukam, çuçukat, çuçurjar, çukaç, çukajë etj.*

Edhe në fjalësin e kësaj shkronje në të gjithë fjalorët shpjegues ka zhvillime të strukturës kuptimore në fjalë të ndryshme. Më e qartë është kjo në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980.

## 2.2.5 MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS DH NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Megjithëse hyn te shkronjat me numër të vogël njësisht leksikore të pasqyruara në të, përsëri numri i fjalëve ndryshon nga njëri fjalor shpjegues në tjetrin. Në këtë shkronjë në Fjalorin e 1954-ës, janë pasqyruar 145 fjalë, duke përfshirë edhe variantet fonetike-dialektore të panevojshme, pasi nuk shprehin sasgjë të re, veçse rrisin në mënyrë fiktive numrin e fjalëve, si: *dhallnik-dhalltues, dhenar-dhënar, dhandërr-dhëndërr, dhandërri-dhëndërri, dhandërroj-dhëndërroj etj.*

Në fjalorët e mëpasshëm shpjegues kemi rritje të numrit të fjalëve e të zhvillimit të kuptimeve në këtë shkronjë, duke e bërë kështu më shprehës leksikun e gjuhës shqipe. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 janë pasqyruar 238 fjalë, ndërsa në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006 janë 247 fjalë. Të dy fjalorët kanë fjalë të reja në krahasim me paraardhësin, por edhe më njëri-tjetrin kanë ndryshime, pasi ka fjalë që janë te njëri, por nuk janë te fjalori tjetër shpjegues, duke e bërë kështu pak të vështirë pasqyrimin vetëm në nivel rritës të njësisht leksikore, duke treguar në këtë mënyrë se leksiku i gjuhës është në ndryshim të vazhdueshëm, bjerr fjalë nga vetja dhe shton të tjera për t’iu përgjigjur më mirë komunikimit midis folësve të gjuhës.

Krahasimi i shifrave tregon një situatë të tillë: FGJSSH 1980, ka 93 fjalë më shumë se Fjalori shpjegues i 1954-ës, por 9 fjalë më pak se “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006. Kështu në Fjalorin e 1980-ës kemi fjalë që nuk janë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, si: *dheks, dhentë, dhelpërush/e, dhematës, dhembjemadh, dhembjeplotë, dhembjeqetësues, dhenrritës, (i, e) dhentë, dhenxjerrës, dheras, dherishte, dherrudh, dhëmbaç, dhëmbcim, dhëmbçën, dhëmbëbardhë, dhëmbëbrisk, (gjenden edhe 32 fjalë të tjera me pjesën e parë dhëmb +), dhendërisht, dhendërrush, dhënie, dhënës, dhiatës, dhishkë, dhjak, dhjakonar, dhjamëzim, dhjamosëm, dhjamosje, dhjamoshe, dhjetëballësh, dhjetëlitërsh, dhjetëvargësh, dhakon, dhomë-muze. Dhrahmi, dhunas, dhunëtar, dhunues, dhunim., dhurues.*

Gjithashtu “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, ka fjalë që nuk gjenden as në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, si: *dhashkë, dhembjeplotë, hdembkë, dhënrritës, dhevështrues, dhëmbecër, dhëmbbardhë, dhëmbcakall, dhëmbëflorinjte, dhëmbëgjatë, dhëmbëmadh, dhëmbëstrall, dhiarës, (i, e) dhimbshëm/e, dhisk, dhishk, (i) dhjamur, dhjetëballësh, dhjetëlitërsh, dhjetëvargësh, dhakon, dhomë-muze. Por edhe te Fjalori i 2006-ës janë pasqyruar fjalë që nuk gjenden te FGJSSH, 1980, si: *dhelem, dhelje, (i, e) dhelur, dhelatoj, dhelatim, (i, e) dhelatuar, dhetar, dhelpëror, dhelpërim, (e) dhembur, dhetar, (i, e) dhëmbcuar, dhëmbëhapur, dhëmbëqitur, dhëmboj, dhëmbim,**

*dhëndërohem, dhëndërim, dhënëcak, dhënëti, (i, e) dhjamëzuar, (i, e) dhjamosur, (i, e) dhjetëfishuar, (i, e) dhunuar, (i, e) dhuruar.*

Në fjalësin e fjalorëve të mëvonshëm shpjegues, pas “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954, vëmë re fenomenin e zgjerimit të kuptimit të një numri të madh fjalësh. Ky fenomen, në aspektin e pasqyrimit si zë më vete, është më i dukshëm te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, që tregon kështu një rritje të fuqisë shprehëse të gjuhës sonë e një zhvillim të leksikut të saj. Ndryshe qëndron problemi në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, pasi aty kemi bashkim të kuptimeve të përafërta, ndaj nuk del shumë në pah ky zhvillim. Kuptimi i rii fjalës, si fakt gjuhësor i formuar, është pasqyruar gjerësisht, brenda strukturës kuptimore të fjalës, sipas rendit të vet, te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980. Fjalët me zhvillim të kuptimeve në fjalësin e kësaj shkronje janë të pakta, se edhe numri i fjalëve, të pasqyruara në këtë shkronjë, është i vogël.



## 2.2.6 MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS F NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Kjo shkronjë hyn te shkronjat që ka një fjalës me peshë specifike mesatare në fjalësin e përgjithshëm të fjalorëve të ndryshëm shpjegues, respektivisht 865 fjalë ose 3.5% te Fjalori i 1954-ës, 1472 fjalë ose 3.6% në Fjalorin e 1980-ës dhe 1870 fjalë ose 3.9% në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006. Pra në fjalorin e fundit shpjegues ka një shtim më të madh fjalësh.

Edhe këtu vihet re pasqyrimi i krahinorizmave, si: *fajtoj, fëjej, fangi, felemoj-felmëz, fëllqash, fëllg-fërflizë, frymë-fërmon, fortomë-fërtomë, floçkë-flokëz-flokshë, flokatë-floke-flokër-flokse, fshehura-fshehurazi-fshehtasetj*. Vërtet pesha specifike e fjalësit të kësaj shkronje është e përafërt me fjalësin në të tre fjalorët shpjegues, por ka ndryshim në numër nga njëri fjalor në tjetrin Kështu “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, 1980, ka 1472 fjalë ose 607 fjalë më shumë, që nuk janë në fjalorin e mëparshëm, si: *fabul, fabulist, fagot, fajangë, fajësoj, fajësohem, fakir, fakifukara, faktorizoj, faktorizim, (i, e) falur, familjarizim, famulleshë, famullor, fap, faqebutë, faqecjerrë, faqeshkë, faqefishkur, faqegjerë, faqehënë, faqembushur, faqemendër, faqemollë, faqendezur, faqendritur, (janë edhe 20 fjalë të tjera me pjesë të parë fjalën faqe+), faraon, ffarëbardhë, farëgjatë, farëdhënë, farëhumbur, farëngrënë, farëpalenë, farësendi, farëshuar, farkëtues/e, (i, e) farkëtuar, farkore, (i, e) farkuar, farmakosem, faror, farosem, fasadë, fasulishte, fashistizohet, fashistizoj, fatmirësi, fatpadalë, fatprurës, fatrrëfyes, fatsjellës, fatshkretë, fatthënë, fatdhënë, faturim, faturoj, faturues, fazan, feçkëdërr, feçkor, faderal, fejton, fekale, felëshues, femëri, femohues, fermentoj, fermentohet, ferrëdet, ferrëgjatë, ferrëlagës, ferrëmi, ferrënuse, ferrëpatë, ferrës, ferrnajë, fërkimor, fërkohem, flegroj, fletanëtarësi, furrëbubëz, furrnaltë, furrohet, etj.*

Ndryshime në makrostrukturë ka edhe midis “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe “Fjalorit të gjuhës shqipe” 2006. Ky i fundit ka edhe 402 fjalë më shumë, si: *fadromë, fagotist, (i, e) fajshëm, (i, e) fakfuntë, faks, faktik, faktikisht, falënderues, (i, e) familjarizuar, fantazohem, fantazim, (i, e) fantazuar, faqedjersitur, faqefurrash, faqemal, faqepjeshkë, faqeportokalle, faqerrip, faqethatë, faqohem, farëtritur, farëveshur, farkaç, farkëtueshmëri, farkofsh, fasulnik, fashitës, fashoj, fatalitet, fathumbur, fatkob, fatkorbë, fatlumnisht, fatprerë, futurist, favorite, favorizues, feldmareshal, femërim, feminizfolklorizëm, feminist, fenomenal, fermentues, ferrëkapës, ferrlë, festiv, festues, feta-feta, fetarisht, fetarizëm, fetarizoj, fetarizim, (i, e) fetarizuar, fetarizohem, fëlliqan, fërkojë, fideist, fiergur, fierinë, figurant, fijëzohet, (i, e) fijëzuar, fikaderë, fikashtëpi, (I, e) fiktë, fiktiv, filaturë, filetoj, filetimit, (i, e) filetuar, filikaçkë, filizon, fillakoj, fillakohem, fillakim, fillimjavë, fillimmuaj, fillimshkull, fillimtar, fillimvit, fillimvjeshtë, fillnisës, finalist, finalizoj, finalizim, financiarisht, finjëz, finjëzim, finjosje, fiqiroj, fiqirohem,*

*fjalëkëmbim, fjalëlashtë, fjalëthyer, fjalosje, (i, e) flakërueshëm, foltar, foltore, fondacion, fonemor, formatoj, formatim, (i, e) formatuar, formësues, fushnjar, fytyrëhënë etj.*

Por në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, 1980, ka fjalë që nuk janë në Fjalorin e 2006-ës, si: *feudo-borgjez, fëstek, fëshfësh, fijedendur, fijehollë, fijeimët, fijerrallë, fijeshpeshtë, fijetrashë, filarmoni, filizëri, filzigan, fillshtrues, fiqfiq, fjalëtërkuzë etj.* Në këtë mënyrë fjalët e përbashkëta janë më pak se ato që nxorëm vetëm si diferencë fjalësh midis dy fjalorëve, në fjalësin e kësaj shkronje. E njëjta situatë është për fjalësin e çdo shkronje të fjalorëve.

## 2.2.7 MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS H NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Shkronja H përfshin 653 fjalë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954. Në dy fjalorët e tjerëshpjegues ka rritje në numër fjalësh, respektivisht 968 fjalë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, ose 315 fjalë më shumë, dhe 1135 fjalë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, ose 482 fjalë më shumë se i pari dhe 167 fjalë më shumë se i dyti.

Në fjalësin e kësaj shkronje ka shumë krahinorizma të panevojshme si dhe variante fonetike dialektore që rrisin fiktivisht numrin e fjalëve pa sjellë asgjë të re, si: *hekatombë, hemistik, hamje, hae, hadhoj, hedh-hudh, hardhiçkë-hardhje-hardhjeshkë, hardhucë-hardhuckë, harris-harroj, hapërndaj-shpërndaj, i hajmë-i hajthëm, haku-haka, hali-halli, hamallëk-hamalli, hamallë-hamull-hamullore, harkëtar-harkëtuer, harris-harroj, hatlla-hatulla, helmatis-helmim, helmatis-helmoj, heqëla-heqje, hisëll-hithër—hithë, hjedh-hedh, hofi-hovi, hollim-hullim, holloj-hulloj, hurma-hurmë, hyu-hyji, hyjnizoj-hyjnoj, hyll-yll etj.*

Në lidhje me fjalët e kësaj shkronje mund të themi se nuk ka gjetur zgjidhje çështja e përdorimit të shkronjës **H** në fillim të disa fjalëve në këtë fjalor, pasi ka fjalë që shënohen në këtë shkronjë dhe pastaj rimerren përsëri në shkronjat përkatëse pa shkronjën **H** në fillim, si: *akrep-hagrep, alijer-halijer, arap-harap, ark-hark, ahur-haur, arrakate-harrakate, ardhi-hardhi, azdisem-hazdisem, idhnim-hidhërim, idhnoj-hidhëroj, ideja-hideja, ylli-hylli, hysht-ysht etj.* Këtu nuk është problemi thjesht te ekzistenca e varianteve dialektore, pasi heqja e shkronjës **H** këtu është shumë e lehtë për t’u bërë dhe pa as më të voglin ndikim në ndonjë nuancë kuptimore.

Siç u tha më lart, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, gjenden edhe 315 fjalë më shumë se në Fjalorin e 1954-ës, si: *haber, (i, e) habitur, hajdutërisht, hajvançe, hakçe, hako, halëbardhë, halëkuq, halëzi, halëzim, halëzon, (i, e) halëzuar, halmuçë, halurinë, hallakatje, (i, e) hallakatur, hallall, hallkeq, hallmo, (i, e) hallmuar, hallvashitës, hamendthi, (i, e) hamendshëm, hamëtor, hamgjitje, hamallisht, hamurik, hanëm, hapdrenushë, hapadollapa, hapor, hapshpejtë, haraçpagues, hara-kiri, harakuqem, harbim, harbohem, hardallos, harbutërisht, hardhiore, hardhishte, harëngë, hareplotë, (i,) hareshëm, hareshëm (nd.), harkore, harkpruar, harkoj, hebraik, hedhurazi, hedhurinë, hejmonist, hejmonizëm, hekurbeton, hekuror, hekur-nikel, helbet, Helen, helenik, helenist, helenistikë, helicopter, helikoptermbajtës, heliocentric, heliocentrizëm, heliograf, heliografik, helmatisem, helmatisje, helmësirë, heroikisht, heroinë, hershmëri, hundëderr, hundëgjatë, hundëgjerë, hundëhequr, hundëkalem, hundëkërrabë, hundëkërrutë, hundëkuq, hundëlesh, hundëmprehtë,*

*hundëngrënë, hundëpatate, hundëpatëllxhan, hundëpërphetë, hundëqiri, hundërrjepur, hundëspec, hundëshqiponjë, hundëtrashë, hundëvarur etj.*

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, gjenden 482 fjalë më shumë se në Fjalorin e vitit 1954, dhe 167 fjalë më shumë se në Fjalorin shpjegues të vitit 1980. Fjalët shtesë që janë te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, në krahasim me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, janë pasqyruar edhe në Fjalorin e vitit 2006, por këtu kemi dhe fjalë që nuk janë në Fjalorin shpjegues të vitit 1980, si: *habertar, hajvanisht, halëzezë, hallavitje, hallkamë, hamendas, hamendoj, hamendësim, hamendësi, hamësi, hamullim, handakosje, hanor, hapagojas, hapakrah, hapaqorras, hapas, hapërdarje, hapore, harabel, hardalli, hardallosje, harkat, helenishte, helenisht, helmatisës, hermëth, hershim, heshturazi, hullizëhumbarak, humbim, humbullim, hundëroj, hundërim etj.* Po ashtu ka fjalë që janë te Fjalori i 1980-ës, por jo te fjalori shpjegues i 2006-ës, si: *halldupëri, hallkeq, hamëndthi, hallvashtës, hapakëmbas, hapdrenush, harkagjendë, harkartë, harkavile, (i, e) harktë, hekur-nikel, hekuror, hekzametër, helenik, helenist, helmlëshues, heshtjerëndë, hidroelektrik etj.*

## 2.2.8 MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS K NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, shkronja **K** hyn tek ato shkronja, fjalësi isë cilës zë një peshë specifike të madhe në makrostrukturën e çdo fjalori. Krahasimet e ndryshme vërtetojnë të njëjtin fenomen, vërejtur edhe te fjalësi i shkronjave të tjera, ndryshime numerike, në njësi të hequra e të shtuara në fjalorë të ndryshëm shpjegues. Nga numërimi që u kemi bërë fjalëve rezultoi se në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, gjenden 2531 fjalë, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, gjenden 3393 fjalë, pra 862 fjalë më shumë, dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, gjenden 3623 fjalë, ose 1092 fjalë më shumë se Fjalori shpjegues i 1954-ës dhe 230 fjalë më shumë se te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980. Duhet t’i shtojmë kësaj dhe faktin se ka fjalë të Fjalori shpjegues i vitit 1954 që nuk janë te të dy fjalorët e tjerë shpjegues, përveç varianteve fonetike-dialektore, ashtu sikurse edhe midis tyre ka fjalë që mungojnë te njëri-tjetri.

Këtu po sjellim shembuj fjalësh që janë vetëm te “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, por jo te dy fjalorët e tjerë, si: *kacabek, kacarrum, kacullë, kad, kagji, kajot, kajthët, kalastrenë, kalbaraq, kalcë, kalecë, kalestër, kalestor, kaletare, kaligrafi, kalive, kalore, kalqyqe, kalvoz, kallamatë, kamalle, kambatis, kambëcur, kamestër, kamjet, kampanulace, kanar, kanarja, kapolis, kopër, kaptej, këc, këhe, këlshejt, këllcacë, këndirrem, këndonjës, kësyeme, kërsac, këstallë, këstalloj, këshyrja, kiemas, këngël, kimerik, kinakin, kleshtë, kjon, klllogjën, kllup, kocale, kocia, kojë, kohot, kokurllëk, kolomdis, koltrinë, kolube, kollsi, confort, kompleksiv, koniferet, kontator, kopit, korozion, koshas, kotor, krej, krilohem, kraqe, krovë, krustancë, kthis, kuestionar, kjoret, kukubritace, kulufiskë, kulumbri, kulvarë, kunë, kuth, kuviset.*

Për shkak të prurjeve të reja në gjuhë, por edhe për arsye të mospërfshirjes të një numri të konsiderueshëm fjalësh në fjalorin e parë shpjegues të gjuhës shqipe, 1954, ashtu si edhe për fjalësin e shkronjave të tjera, edhe në fjalësin e kësaj shkronje ka fjalë të reja që gjenden te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe nuk janë te “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, si: *kaba, kabardhë, kabash, kabashëm, kabëz, kabot, kabolazh, kabull, kadifenjtë, kafshëri, kafsharak, kafshërim, kafshoj, kafshor, (i, e) kafshuar, kail, kaktus, kaladibrance, kaladredhas, kalakyq, kalamallëk, kalandrim, kaldajë, kaldajist, kolektor, kalendarik, kaleidoskop, kalibroj, kalibrim, kalibrohet, kalimtar, kaloshinë, kaltërosh, kaltërsi, (i, e) kaltëruar, kallamishte, kallamsheqer, kallëzambledhës, kallisje, kalliantë, kambanar, kamboxhian, kamer, kampionia, kampist, kamuflim, kamxhikoj, kanalgermues, , kanalhapës, kancelar, kancelari, kanibalizëm, kanonier, kontratë, kantinë, kanunizoj, kanunizohet, kopan, kapelepunues, kapërcehem, kapërcimthi, kopicë, capital, kapoteneri, kapitëm, kapitje, kapitullues, karabinier, karabineri, karantinor, kardiolog, kardiologji, kare, karkërimë, kamerist, karrofcinë, karropunues,*

*katrahurë, katërfish, keqdashës, keqdashje, keqësoj, këllqegjërë, këmbëhuqe, këmbëunazë, këmbyes, këndgjerë, këndngushtë, këndor, kërmillor, kërpacëri, kërthizor, kësulbardhë, kësulkuqe, kilësh, kilian, kilolitër, kismet, kitarist, kithët, klith, klithje, kloun, kllocitje, kodifikues, kohërent, kohëmatës, kokartë, kohor, kokëbardhë, kokëmushkë, kokëqethur, kokëfortë, kokëviç, kolesterinë, kalendarët, kolaudim, kolaudohet, kollofruth, komandim, komodinë, koncentrik, konformizëm, konservoj, konservohet, kontrollues, konteshë, korifer, krahartë, krahinor, krasitës, i krehur, kremator, krepatoj, krijimtari, i krijuar, kritizer, kromozom, kral, kruajtje, krutan, kryeagranom, kryearkëtar, kryebandit, kryegjyqtar, kryekëshilltar, kuant, kuban, kubaturë, kulvare, kurdisem, kurdisje, kureshtje, kurm, kursehem, kushtetim, kushtetoj, kuvaristë, kuzhinier etj.*

Siç kemi theksuar më lart, në dy fjalorët e fundit shpjegues që kemi marrë në shqyrtim, ka fjalë që nuk gjenden në makrostrukturën e njëri-tjetrit. Fjalë që janë te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, por jo te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, janë: *kabardhë, kabllogram, kaçilore, kaçel, kaçkinj, kaçole, kaçorre, kadaifbërës, kadet, kadexhi, kadium, kafehanë, (vjet), kafkor, kafshritës, kafshëri, kafshëror, kaftan, keqadministrim, (e) keqja, kërrmë, këlthitës, kallfisht/e, -ja, këllqegjërë, këmbanik, këmbëbardhë, këmbëdrapër, këmbëhollë, kokëbucelë, kokëcjap, kokëdac, kokëdardhë, kokëdhi, kokëgomar, kokëjashtë, krahabishtëshkulë, krahartë, krahasingtar, krahëthatë, krahazoj, krahëflutur, krahëpunuar, krahnores, kramshinë, kumak, kumb, kumbis, kumbisem, kumet, kundëratomik, kycenicë, kundërkërkesë, kundërbërtham, kundërkritikë, kundërmalarik, kundërmanovër, kundërpropozim, kundërraketë, kyl etj.*

Gjithashtu kemi fjalë që janë te Fjalori i 2006-ës, por jo te Fjalori i 1980-ës, si: *kacambytje, kacamic, kacarrim, (i, E) kacavarur, kacitje, kacaferr, kacik, kacifor/e, -ja, kaculor, (i, e) kadastruar, kafetar, (i, e) kaftë, (i, e) keqësuar, keqinë, keqinformoj, keqinformim, (i, e) keqinformuar, keqat, keqpërdorje, (i, e) keqpërdorur, keqtingëllon, (i, e) keqtrajtuar, kesh (para në dorë), këllitje, këmashtë, këmbare, këmbatisje, këmbeces, këmbëlepur, kohëqëndrim, kohëzgjatje, kokëbrokë, kokëfortësisht, kokëlartë, kokëlesh, krahëllit, krahëllitje, kumas, kundërligjor, (i, e) kundërligjshëm, kundërmësyj.*

## 2.2.9 MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS LL NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Në këtë shkronjë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, ka vetëm 141 fjalë. Edhe këtu ka variante fonetike dialektore, si: *llgaroj-llogaris, llapaja-llapë, llafazan-llapazan, llazurë-llazyrë, lluq-lloq, llustër-lustër*. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, gjenden 217 fjalë, ose 76 fjalë më shumë se në Fjalorin shpjegues të 1954-ës, dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, janë 345 fjalë, ose 204 fjalë më shumë se po tek ai fjalor, dhe 128 fjalë më shumë se në Fjalorin shpjegues të vitit 1980.

Fjalë që janë pasqyruar në Fjalorin e 1980-ës, por jo në Fjalorin e vitit 1954, janë: *llackë, llackos, llackosem, (i, e) llackosur, llaç, llaçavër, llaçkar, llaçkë, llaçpërzierëse, llafator, llafazanëri, llafemadh, llafepakë, llafeshumë, llafosem, llahem, (i) llahtarshëm, (i, e) llahtarisur, llahusi, llakim, llakohet, llakoj, llambadar, llangosem, llangosje, (i, e) llangosur, llapar, llapashit, llapashitem, llapashitje, llapazhar, llapëhollë, llapëgjerë, llapërçit, llapërçitem, llapërkajë, llapëtimë, llaskore, llasticë, llastohem, llastor, (i, e) llastuar, llashkore, llautë, llauz, llërëbardhë, llërëçeliktë, llërëdjegur, llërëjashtë, llërëpërveshur, llërëplotë, llërëzbuluar, llërëzhveshur, llogaridhënës, llogaridhënie, llogaritshëm, (i, e) llogaritur, lloj-lloj, llomotitje, i llojlojshëm, (i, e) llojlojtë, llojor, llojshmëri, llokmë, llokmëmadh, llomishtë, llomotar, llucëroj, llucërohem, llufit, llumishte, (I, e) llumtë, llupashllurbëtirë, llurbës.*

“Fjalori e gjuhës shqipe” 2006, krahas shtesave që ka “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, në krahasim me Fjalorin e 1954-ës, ka edhe 128 fjalë më shumë se fjalori i vitit 1980, duke e çuar diferencën me fjalorin e parë në 204 fjalë më shumë. Këtu do të japim një pjesë të fjalëve që nuk janë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, por janë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, (pasi shtesat që i ka Fjalori i 1980-ës, i ka dhe ai i 2006-ës) si: *llabut, llafosje, (i, e) llafosur, llaftar, llagar, llagaris, llagarisje, (i, e) llagarisur, llagarisem, llgaroj, llagavitje, llahtarisje, llamni, llagar, llanik, llapaç, llapangjesh, llapatan, llapator, llapëtoj, llapushan, llaqemi, llatitë, lloçkat, lloçkatje, llojlojshmëri, llomështi, llomështinë, llomitje, (i, e) llomitur, lluçkan etj.* Por ka dhe fjalë që nuk janë në fjalorin e 2006-ës, por janë në fjalorin e 1980-ës, si: *llaçavër, lladromë, llërëçeliktë, llërëdjegur, llërëjashtë, llërëpërveshur etj.*

## 2.2.10 MAKROSTRUKTURA E LEKSIKUT TË SHKRONJËS O NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, shkronja O përfshin 207 fjalë. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, janë dhënë 282 fjalë, pra dhe 75 fjalë më shumë, si: *objektivist (em.), objektivist (mb),objektivisht, oblikacion, oborrtar (mb.), oborrtari, obrokth, obskurantist, odatar, ofendoj, ofendim, ofendohem, oficere, ofset, ofshaj, ofshamë, ofshëtij, ogi, ogurbardhë, ohu, ojarë, ojnatar, okërishtë, oksigjen, oksigjenim, oksigjenoj, oksigjenohet, (i, e) oksigjenuar, oktet, okulistikë, olivikulturë, om, onomastikë, onkologji, onkologjik, oparak, operativ, operim, opzitar, oqeanor, oratorik, orë-normë, orë-njeri, orësharë, orëshitës, orëshuar, orëvrrarë, (i, e) organizuar, orkestral, osman, osmanishte, oxhakëri, oxhakësi, oxhakëfshirës, oxhakëpastrues, ozon etj.*

Edhe në Fjalorin shpjegues të vitit 2006 ka diferencë në numrin e fjalëve. Në këtë fjalor janë pasqyruar 432 fjalë, ose 225 fjalë më shumë se në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954 dhe 150 fjalë më shumë se në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980. Në ndryshim nga fjalori i fundit kemi fjalë shtesë si: *oberlan, oblikacion, obligoj, obligohem, obligim, observoj, observim, (i, e) oservuar, (i, e) ofenduar, ofertues, ofroj, ofrim, oftikosje, (i, e) oftikosur, ogrraç, ojnammadh, ojnash, okitë, okre, (i, e) oksiduar, oksiton, omanëz, ondi, ondis, ondisje, ondulacion, opinionist, oranik, orendisje, (i, e) orendisur, orëshqimur, orientalistikë, origjinalitet, orkestroj, orkestrim, orkidace, (i, e) ormisur, ornament, orografi, orok, ortakërisht, ortakisht, ortodoksizëm, oval etj.* Por ka dhe fjalë që janë te fjalori i 1980-ës, dhe nuk janë te fjalori shpjegues i 2006-ës, si: *odatar, oriznajë, osakë, otra, ovull.*

Duke ballafaquar raportin e nurit të fjalëve të pasqyruara në këto shkronja, A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O për çdo fjalor shpjegues, me numrin e përgjithshëm të fjalëve në çdo fjalor, vëmë re një raport të tillë dhe shumë të përafërt: Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, në të gjitha këto shkronja së bashku janë pasqyruar 7433 fjalë, ose 29.7% të gjithë fjalësit të fjalorit; “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, në këto shkronja së bashku janë pasqyruar 12720 fjalë, ose 31% të gjithë fjalësit të fjalorit; ndërsa në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, nuri i fjalëve në të gjitha shkronjat e analizuara është 14389 fjalë, ose afërsisht 30% e të gjithë fjalësit të fjalorit.

Në një vështrim të thjeshtë të numrit të fjalëve në secilin fjalor evidentojmë faktin se, pesha specifike e fjalësit të këtyre shkronjave në fjalorët respektivë është përafërsisht e njëjtë, ndaj krahasimet me fjalë të shkronjave të tjera të secilit fjalor nuk do të sillte ndonjë ndryshim të ndjeshëm në përfundimet e nxjerra. Pavarësisht dëshirës së mirë e përpjekjeve të mëdha për të pasqyruar sa më gjerësisht pasurinë e madhe leksikore që ka gjuha shqipe, gjithë fjalorët shpjegues nuk kanë arritur ta bëjnë plotësisht këtë.



Mangësi të shumta vihen re në “Fjalorin e gjuhës shqipe”, 1954. Ky fjalor me gjithë vlerën e pamohueshme që pati si përmbushës i një nevoje të ngutshme për një fjalor shpjegues në gjuhën shqipe, duket se është hartuar pa një përgatitje paraprake për grumbullimin dhe skedimin e të gjitha materialeve gjuhësorë të pasqyruara në vepra të ndryshme shkrimore, pa studiuar thellë të gjitha të folmet tona, pa dokumentuar sa duhet pasurinë leksikore të mbledhur nga goja e popullit. Kjo edhe për një fakt qëështë thënë nga studiuesit, se në vendin tonë mungonte një kartotekë e leksikut të shqipes, por duhet të pranohet se edhe niveli i shkencës gjuhësore shqiptare në përgjithësi e asj leksikografike në veçanti nuk ishte në nivelin e duhur, ndaj do të reflektonin nivelin e tyre edhe në hartimin e të parit fjalor shpjegues të gjuhës shqipe.

Fjalorët shpjegues që pasuan “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, veçanërisht fjalorët shpjegues të viteve 1980 e 2006, e rritën në mënyrë të ndjeshme numrin e njërive leksikore të pasqyruar në ta, përmirësuan trajtimin shkencor gjuhësor, pasi tashmë gjuha shqipe kishte të miratuar dy dokumente kryesore, “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” dhe “Fjalorin drejtshkrimor” të miratuar në Kongresin e drejtshkrimit në nëntor 1972, të cilat ndikuan në hartimin e fjalorëve normativë të gjuhës shqipe. Ndaj si në anën sasiore ashtu dhe cilësore gjithë fjalorët shpjegues të hartuar pas “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954, qëndrojnë më lart, megjithëse edhe këta nuk kanë pasqyruar në shkallë të gjerë pasurinë e madhe leksikore të gjuhës sonë, kjo ndoshta dhe për shkak të natyrës e llojit të fjalorit të hartuar, si fjalorë të tipit të mesëm.

Ka ardhur koha që gjuha shqipe të ketë një fjalor të madh shpjegues, i cili do të ketë funksion pasqyrues e informues më të madh se gjithë fjalorët e derisotëm shpjegues të gjuhës shqipe, krahas funksionit normativ që konsiston në dhënien në mënyrë të plotë e sistemore të normës leksikore të gjuhës së sotme letrare shqipe. Një fjalor i tillë mund të pasqyrojë në mënyrë të plotë leksikun e përgjithshëm të shqipes së sotme, të shtresuar sipas normës letrare e stilistike. Në këtë mënyrë ai do të shërbejë si këshillues për përdorimin normativ të fjalëve e njërive frazeologjike për rethe më të gjera lexuesish. Ky fjalor mund të mishërojë qëndrimet më të fundit të shkencës leksikografike për strukturën kuptimore të fjalëve, për sinonimet, antonimet, homonimet, për shtresën stilistike e për frazeologjinë, për neologjizmat e fjalëformimin, për dialektizmat e terminologjinë etj. Gjithashtu ai duhet të ketë edhe një zgjerim të brendshëm në kuptimet e fjalëve, në thëniet e në ilustrimet, për të përmbushur kështu detyrimin që kanë fjalorët shpjegues të një gjuhe për ta dhënë leksikun e saj sa më të plotë, për të dokumentuar fuqinë shprehëse që ka gjuha jonë.

## KREU III

### PRIRJET E ZHVILLIMIT TË LEKSIKUT TË GJUHËS SHQIPE TË PASQYRUARA NË FJALORËT SHPJEGUES TË SAJ

#### 3.1 ZHVILLIMI I KUPTIMIT TË FJALËVE

Për pasurimin e leksikut të gjuhës me rrugën e zhvillimit të kuptimeve A. Martine është shprehur: Pasurimi i gjuhës me kuptime të reja është në fund të fundit shprehje e ligjit të ekonomisë gjuhësore. Kjo rrugë pasuruese nuk ndërtohet sipas parimit një shenjë një kuptim, por sipas parimit një shenjues (grupeatingull) disa të shënuar (kuptime), e njohur ndryshe në leksikologji si dukuria e polisemisë. Kjo mënyrë e pasurimit të fjalësit të një gjuhe nuk e rëndon kujtesën dhe nuk e vështirëson marrëveshjen gjuhësore, sepse në çdo rast fjala përdoret me një kuptim, i cili zbulohet në kontekst, brenda lidhjeve sintagmatike të saj.

Shfaqja e polisemisë lidhet me procesin e njohjes njerëzore. Zgjerimi i aftësisë shënuese të një fjale, duke u përdorur edhe si emërtim për një realie tjetër, bëhet për faktin se sendet dhe dukuritë, krahas dallimeve, kanë edhe anë të përbashkëta. Dhe sipas ngjashmërisë në formë, funksion etj. bëhet i mundur kalimi i emërtimit edhe për një realie tjetër e kështu me radhë.

Vetë zhvillimi i gjuhës është përsosje e mjeteve të shprehjes e kjo përsosje, në një kuptim, s'është gjë tjetër veç krijim njësisish të reja semantike, leksikore, gramatikore. Çdo kuptim i ri që lind, është njësoj si çdo fjalë e re që formohet, sepse i njëjti shënues (grupeatingull) bëhet shprehës i shumë të shënuarve, pasi fjala jeton në gjuhë për përmbajtjen, e cila përbën vlerën themelore e më të madhe të saj, pa të cilën ajo, siç shprehet akademiku J.Thomai "fjala pa përmbajtjen do të ishte pa vlerë në marrëveshjen gjuhësore".<sup>25</sup>

Në vijim të shtjellimit të fjalëve J.Thomai shprehet: " Kuptimi, meqenëse lidhet më ngushtë me faktorët jashtëgjuhësorë, ndryshon më shpejt e më thellë se forma, sepse këta faktorë ndikojnë më shumë mbi përmbajtjen e shkaktojnë ndryshime në të, kurse mbi formën ky ndryshim është pothuajse i papërfillshëm".<sup>26</sup> Të gjitha kuptimet e një fjale përbëjnë strukturën kuptimore të saj. Çdo kuptim i ri i shtohet kuptimit të parë, e kështu me radhë kuptimet e tjera, duke zgjeruar strukturën kuptimore të fjalës, sepse vetë historia e fjalës është histori e lindjes së kuptimeve të reja. Zgjerimi i strukturës

<sup>25</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.55.

<sup>26</sup> Thomai, J. Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, Tiranë, 1989, f.126.

semantike është pasurim për leksikun dhe rrugë e brendshme e rritjes së forcës kumtuese e shprehëse të gjuhës. Marrëveshja gjuhësore nuk vështirësohet pasi fjalët përdoren në ligjërim të lidhura me fjalë të tjera e krijojnë kështu kontekste, brenda të cilave çdo fjalë hyn vetëm me një nga kuptimet e saj. Për këtë J.Thomai pohon se “brenda saj struktura kuptimore e fjalës mban vlera të mëdha jo vetëm në numrin e kuptimeve, por edhe në llojin e tyre, që nga kuptimi i drejtpërdrejtë, konkret, te kuptimet e prejardhura abstraktë e të figurshëm, deri te nuancat më të holla kuptimore”.<sup>27</sup>

Siç është pohuar nga gjuhëtarët, shqipja është gjuhë polisemike. Por jo të gjitha fjalët e gjuhës shqipe mund të zgjerojnë aftësinë e tyre shënuese. Në rrjedhë të shekujve ka fjalë përmbajtja leksikore e të cilave ka ndryshuar shumë, duke u pasuruar me kuptime të reja të tipave të ndryshëm dhe sot paraqiten me strukturë semantike mjaft të gjerë. Për këtë fenomen J.Thomai është shprehur: “Rikuptimësimi i njësive leksikore është një nga proceset më vepruese që plotëson sistemin leksikor të gjuhës së sotme letrare shqipe, sepse rritet numri i kuptimeve të fjalës”.<sup>28</sup>

Në leksikun e çdo gjuhe, më të dendur rikuptimesimin e kanë njësitë më të hershme, sidomos ato grupe tematike fjalësh që lidhen me pjesët e trupit, me ndarjen e kohës, me ngjyrat, me bimësinë, me blegtorinë e bulmetarinë, me dukuritë atmosferike etj. “Nga elementët e trashëgimisë gjuhësore, -pohon Çabej,-mjaft na dalin si degëzime të reja trajtore e semantike prej fjalësh bazë të lashta”.<sup>29</sup>

“Emërtimi i sendeve dhe dukurive me të njëjtën fjalë sjell zgjerimin e aftësisë shënuese të saj, d.m.th. fitimin e një kuptimi të ri”<sup>30</sup>, duke shtuar numrin e fjalëve polisemike. Që shqipja është gjuhë polisemantike, kjo vërehet te makrostrukturat e të gjithë fjalorëve shpjegues dhe, nga krahasimi midis tyre, duket qartë se edhe për periudha kohore të shkurtra, në varësi të intensitetit të zhvillimeve ekonomike e shoqërore, kemi shtim të fjalësit jo vetëm vertikalisht (numër fjalësh) por edhe horizontalisht (numër kuptimesh). Për këtë do të flasim më poshtë, por këtu do të sjellim si shembull vetëm “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, në të cilin 80% e fjalësit ka më shumë se një kuptim. Ky fjalor ka rreth 41.000 fjalë dhe mbi 180.000 kuptime fjalësh, çka do të thotë se numri i njësive semantike është disa herë më i madh se numri i njësive leksikore. Prandaj lëvizja e brendshme kuptimore në gjuhën shqipe është më e gjerë dhe më prodhimore se ajo e formimit të fjalëve të reja.

---

<sup>27</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.56.

<sup>28</sup> Thomai, J. Tipat themelor të derivacionit në gjuhën shqipe, në “Studime filologjike”, Tiranë, 1981, III, f.87.

<sup>29</sup> Çabej, E. Studime gjuhësore, I, Prishtinë, 1976, f.8-10.

<sup>30</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.117)

Duke marrë si kriter themelor lidhjen me realien e natyrën e saj, në gjuhë (në semantikë) dallohen kuptime të parme e të prejardhura, konkrete e abstrakte, të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm. “Kuptimet e parme të fjalët e thjeshta janë të pamotivueshme gjuhësisht, ndërsa të kuptimet e drejtpërdrejta realia shënohet drejtpërdrejt, pa ndërmjetësinë e ndonjë realie tjetër. Kur realia shënohet në mënyrë të ndërmjetuar, nëpërmjet një realie tjetër, atëherë të fjala emërtuese kemi kuptim të figurshëm”- shprehet J.Thomai.<sup>31</sup>

Kristalizimi i kuptimeve të reja në fjalët ekzistuese përbën një nga rrugët themelore të pasurimit të leksikut të gjuhës sonë. Duke pasur parasysh strukturën e fjalëve polisemantike në fjalor dhe lëvizjet e brendshme të kuptimeve, A.Kostallari shkruan: “Në fjalët polisemike, të cilat kanë pasur që prej kohësh shumë kuptime, zhvillimi i mëtejshëm i kuptimeve të reja në mjaft raste është berë në vijën e secilit prej kuptimeve të mëparshme. Janë krijuar kështu si të thuash, radhë, vargje kuptimore paralele... Ndërtimi i artikullit në tërësi në këto raste merr karakter shumëvijësh e bëhet mjaft i ndërlikuar dhe renditja e kuptimeve i tregon jo plotësisht, por deri në një farë mase, varësinë dhe vazhdimësinë, konsekuencën në formimin dhe lidhjen e kuptimeve”.<sup>32</sup>

Në veçoritë e përgjithshme të gjuhës, si një organizëm i gjallë, që zhvillohet, pasurohet e përsoset, lëvizja kuptimore përbën një nga dukuritë më të rëndësishme. “Pa lëvizje kuptimore, nuk mund të flitet as për prejardhje kuptimore, as për strukturë të kuptimit”,- thotë J. Thomai.<sup>33</sup>

Një ndër proceset kryesore të ndryshimeve semantike është edhe lindja e kuptimeve të figurshme në shumë njësi leksikore. Figurshmëria është veçori e përgjithshme e gjuhës, por për disa klasa fjalësh e grupe tematike, ajo është veçanërisht e gjerë në ligjërimin popullor. “Kuptimi i figurshëm, metaforik i fjalëve në shqipen popullore është një proces shumë më i shpeshtë nga ç’mund të mendohet, metafora dhe shprehja figurative është përgjithësisht një dukuri e shpeshtë edhe ndër njerëzit e thjeshtë, e mbase bash në gojën e tyre”-shprehet E.Çabej.<sup>34</sup> Një burim i madh pasurimi për shqipen letrare, jo vetëm në fjalë, por edhe në njësi semantike, është leksiku dialektor e krahinor. Rikuptimësimi i fjalëve është një riformim semantik dhe sa më i gjerë të jetë ky proces, aq më e pasur bëhet gjuha letrare. Për këtë Th. Feka pranon se “shumë kuptime krahinore pasurojnë strukturën kuptimore të shumë fjalëve të njohura të shqipes letrare.”<sup>35</sup>

<sup>31</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.137.

<sup>32</sup> Kostallari, A. Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, Sf, 1968.

<sup>33</sup> Thomai, Th. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.89.

<sup>34</sup> Çabej, E. Studime gjuhësore, II, Prishtinë, 1976, f.338.

<sup>35</sup> Feka, Th. Rreth fjalorëve krahinorë, leksikologjia shqipe, Tiranë, 2005, f.208.

Në fjalësin e fjalorëve të ndryshëm shpjegues ne kemi parë tipat e ndryshëm kuptimorë (kuptimet e parme e të prejardhura, konkrete dhe abstrakte, të drejtpërdrejta e të figurshme) brenda një fjale, d.m.th. të kundruara brenda dukurisë së polisemisë. Në gjithë fjalorët shpjegues gjejmë shumë fjalë me strukturë kuptimore të gjerë. Këtu po sjellim disa shembuj për të parë se si janë pasqyruar të gjitha kuptimet leksikore të një fjale në fjalorët shpjegues, kuptime që përbëjnë strukturën kuptimore të saj ose dukurinë e polisemisë, duke krahasuar zhvillimin e këtyre kuptimeve nga “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006.

**Bekim (1954)** em. 1.fjalë e mirë, fjalë me të cilën i urojmë tjetrit prokopi e lumturi. 2.rit fetar i të krishterëve, në të cilin bëhet shënja e kryqit duke kërkuar hirin e hyjnise.

**Bekim (1980)** 1.veprim sipas foljeve bekoj, bekohem. I dha bekimin. 2.bised. uratë fjalë a shprehje falenderimi e mirënjohjeje për diçka; kund.mallkim. Bekim i nënës. *Të pastë lënë bekim/ur.*)

**Bekim (2006)** 1.veprim sipas foljeve. 2.uratë, fjalë a shprehje mirënjohjeje; bekim i nënës; *ju pastë lënë bekimin; (ur. kur ka vdekur nëna ose babai).*

**Brez (1954)** 1.rrip i leshtë, i mëndafshhtë ose i pambuktë, që ngjishet në trup duke e sjellë disa herë rreth mesit: rryp i metaltë (i argjendtë) që ngjeshin gratë në mes për stoli. 2. vendi vetë ku ngjishet brezi, mesi, ija: *hyra në ujë gjer në brez.* 3. dru i gjatë i sharruar, që shtihet në mur për ta forcuar; 4. gjeog. secila nga pesë zonat paralele, në të cilat ndahet dheu; 5. brez i zonjës, ylberi; 6. fig.bark, brezni, brezi i ri, *dy breza, lëshoj brezin-kërkoj shkak për t'u zënë, provokoj.*

**Brez~i m.~sh.~a, ~at. (1980)** 1. rrip i gjerë e i gjatë i leshtë, i mëndafshhtë ose i pambuktë etj, që përdoret në disa krahina për ta ngjeshur në mes, duke e mbështjellë disa herë rreth e rrotull; rrip i gjerë prej lëkure, prej meni etj.që ngjishet në mes e shërben për të mbajtur fishekë a armë, për stoli etj. *Brez pambuku, (mëndafshi). Brez i argjendtë. Brez burrash (grash). Brezi i martesës.....*

2. rrip i gjatë e i gjerë, zakonisht i leshtë, me të cilin lidhim fëmijën në djep; ndrize, disqe. *E lidhi (fëmijën) me brez.*

3. shih MES~I 2+3+*Deri në brez. Brezi i duhanit*gjethet e duhanit që mblidhen gjatë një vjeljeje, fletët e një dore. *Ngjesh në brez. Një brez njeriu i thellë.*

4. Pjesa e diçkaje ( e një sipërfaqeje), që ka trajtë të zgjatur e të kufizuar dhe që dallohet nga e tëra; hapësirë në trajtë rripi. *brez pyjor.(kodrinor). Brez kufitar. Brez mbrojtës. brez i bleruar. brez i kuq (i zi, i bardhë). Brez toke. Brez resh. Brez drite...*

5. Dru i gjatë a shtresë betoni, i cili vihet përgjatë murit që ndërtohet me qerpiç, me gurë ose me tulla, për ta lidhur ose forcuar. *Brez i poshtëm (i sipërm). Brez muri. Brez hekuri (betoni). breza kundër tërmetit. Drurë për breza. Mur me breza.*

6. gjeogr. Pjesë e sipërfaqes së tokës ndërmjet dy paralelesh ose dy meridianësh; zonë e tokës që kufizohet nga paralele të caktuara dhe që dallohet prej zonave të tjera nga ndryshime të klimës, të bimësisë etj. *Brez gjeografik. Brez i ftohtë, (i ngrohtë, i nxehtë, mesatar). Brezi arktik. Brezi tropikal. Brezi i borës.*

7. Tërësia e të lindurve të një gjaku kundrejt të parëve të përbashkët; tërësia e njerëzve, që kanë pak a shumë një moshë përkundrejt paraardhësve a pasardhësve të tyre; njerëzit e një moshe a me moshë të afërt, që jetojnë në të njëjtën kohë ose që lidhen nga veprimtaria e përbashkët, që kanë qëllime të përbashkëta etj.; brezni. *Brezi i parë (i dytë, i tretë). Brezi i ri (i vjetër). Brezat e kaluar (e ardhshëm). Breza luftëtarësh. Brezat e gjakut, etnogr. pasardhësit nga ana e babait. Brezat e gjinive, etnogr. pasardhësit nga ana e nënës. Nga brezi në brez. Brez pas brezi që në kohët e lashta, në mënyrë të vijueshme. Gjatë disa brezave.1) (FGJSSH, f.177).*

**Brez ~i. m.sh. (a)t. (2006)** 1. mes. u zhyt deri në brez ; rri me duar në brez. 2. rrip i gjerë e i gjatë prej leshi, prej pambuku etj., që mbështillet rrotullmesit; ndrizë; *brez grash/* gjerdan për fishekë, për armët e mesit, për stoli etj.; *brez shpëtimi* brez gome që fryhet e përdoret në ujë, armët e brezit. 3. sipërfaqe a hapësirë si rrip; *brez toke; brez pyjor, brez kufitar, brezi i qiellit (i shiut)* ylberi./gjeogr. pjesë e sipërfaqes së Tokës midis paralelesh a meridianësh: *brez gjeografik (iftohtë, i ngrohtë); brez tropikal.* 4. Dru i gjatë a shtresë betoni përgjatë murit për ta forcuar: *mur me breza.* 5. të lindurit e një gjaku; *brezi i parë (i dytë)/* njerëzit e një moshe, njerëz të një qëllimi, të një prirjeje etj. *brezi i ri (i vjetër); brezi i luftës, \*brez pas brezi* që në kohët e lashta e vazhdimisht; *nga brezi në brez,* brez pas brezi; *hedh një brez,* ha pak meze (kur pi); lëshoi brezin (i pari) krijoi rrethanë për grindje;/bëri lëshime, hapi rrugë; *i shkeli brezin (dikujt)* i dha shkak për grindje. (f. 109).

**Cergë~a (1954)** 1. mbulesë e leshtë e trashë dhe e ashpër. 2. shatorre e bërë me copa; 3. rrecka, zhele; \_\_\_merimange, pëlhura e merimangës, shtrati i merimangës.

**Cergë~a, (1980)** 1. Qilim ose mbulesë e ashpër që është punuar zakonisht me lesh dhie, *Cergë e dhirtë. shtroj cergen. Hedh një cergë. Mbuloj me cergë.* 2. Pëlhurë merimange. *Cergë merimange. End cergën. Zë cergë. Fshij cergat.* 3. Cipë e hollë; pëlhurë e hollë, tis. *cergë e mëndafshhtë.* 4. Kryes. sh. rrecka të vjetra, rroba të grisura e të bëra zhele, lecka. *Vishej me ca cerga. mori cergat në krahë. Mblodhi cergat. u bë fare cergë. Flak (hedh) si një cergë.* 5. vjet. Shatorre e bërë me cohë a me velenxa të ashpra; tendë. *Cerga e stanit. Ngre (prish) cergën. \*Cergë e re* njeri që sapo ka krijuar familje më vete. **Zuri**

*cergë (brumë)* shih te zë. **Iu bë cergë** i zuri derën tjetrit, ndenji për një kohë të gjatë te tjetri pa dëshirën e tij; iu ngjit; iu qep. **I kanë vënë ( i kanë zënë) sytë cergë**nuk e sheh qartë gjendjen rreth e rrotull, është verbuar.

**Cergë,~a f. sh-a(t) (2006).** 1. qilim ose mbulesë e ashpër leshi: *cergë e dhirtë*,/ tendë me një mbulesë të tillë: *cergat e stanit*. 2. pëlhurë e hollë, tis: *cergë e mëndafshhtë (e pambuktë)*; *cergë basmaje*; kryes. sh. rrecka, lecka, zhele: *mblodhi cergat*. 3.pëlhurë merimange. \***cergë e re** ai që sapo ka krijuar familje më vete; **i u bë cergë** i zuri derën, iu ngjit, iu qep; **zuri cergë (brumë)** vuri një farë pasurie, u mäkëmb; **i ka vënë (i kanë zënë) cergë sytë** i janë zënë sytë, është verbuar, nuk e sheh mirë gjendjen rreth e rrotull.

**Çerdhe~ja, sh.-e, ~et. (1954)** 1.vend që ndreqin zogjtë dhe disa insekte në mënyra të ndryshme e me lëndë gjithfarësh, ku rrine e çelin vezët dhe rritin të vegjëlit e tyre, banesë e ca shtazëve; çerdhe minjsh; vend ku fshihen hajdutët; të arratisurit etj.; banesë: *çerdhja ime, fole, çerdhe; \_\_\_fëmijësh*, institucion edukativ për fëmijët e vegjël, ku këta rrinë e shkojnë ditën, gjersa kthehen nga puna prindërit.

**Çerdh/e,~ja f. sh. ~e, ~et(1980).** 1.vend që bëjnë zogjtë dhe disa kandrra për të çelur vezët, për të rritur të vegjlit e për të ndenjtur të mbrojtur; banesë që e gërmojnë zakonisht në dhe disa kafshë të vogla; fole. *Çerdhe zogjsh. Çerdhe dallëndyshesh (harabelash). Çerdhe grerëzash. Çerdhe mushkonjash* pellg me ujë, ku rriten me shumicë mushkonjat. *Çerdhe me thupra (me baltë, me kashtë). bën (ngre, ndërton) çerdhen. Zë çerdhen.*

2. **fig.** Banesa ku njeriu krijon familjen e vet ose ku rritet, vatra familjare. *Çerdhja familjare. Ngre (krijoj) çerdhe. I prish çerdhen e familjes.*

3.**fig.** Vendi ku rriten dhe edukohen njerëzit për një veprimtari të caktuar; keq. vend, zakonisht i fshehur e i mbrojtur, ku përgatitet për një veprimtari një grup njerëzish. *Çerdhe e gjallë (e zjarrtë). Çerdhe revolucionarësh. Çerdhe lirie. Çerdhe e luftës partizane. Çerdhe hajdutësh (kusharësh, diversantësh). Çerdhe spiunazhi. Çerdhe e reaksionit.*

4. Institucioni që kujdeset për rritjen dhe edukimin e fëmijëve deri në moshën tre vjeç. *Çerdhe ditore. Çerdhe stinore. Çerdhja e kooperativës (e lagjes). Çoj në çerdhe. Edukatorët e çerdhes. Moshë e çerdhes.*

5. **usht.** Llogore e veçantë, nga e cila bën zjarr një grup luftëtarësh ose një armë e lehtë. *Çerdhe zjarri. Çerdhe pushkatarësh. Çerdhe mitralozi. zë çerdhen. zë çerdhen. Shkatërroj çerdhe.*

6. **gjuh.** Grupi i fjalëve që janë formuar nga një rrënjë e përbashkët. *Çerdhe fjalësh. Fjalor me çerdhe.*

7. **përmb.** Të vegjlit e një kafshe shtëpiake që kanë lindur dhe rriten së bashku. Çerdhja e gicave. (f.255).

**Çerdh/e,-ja** f.sh -e(t) (2006). 1. vendi i përgatitur nga zogjtë e disa kandrave, ku çelin vezët e rritin të vegjlit; vrimë në tokë që bëjnë disa kafshë të vogla; fole *çerdhe zogjsh*, *çerdhe grerëzash (milingonash)*; *çerdhe mushkonjash* pellg me shumë mushkonja. 2. përmb. të vegjlit e një kafshe që kanë lindur e rriten së bashku; çerdhja e gicave. 3. *fig.* banesa e vatra familjare; institucioni për rritjen dhe dukimin e fëmijëve deri në moshën tre vjeç; edhe *keq.* vendi ku një grup njerëzish përgatiten për një veprimtari të caktuar: *çerdhja e fëmijëve*; *çerdhe edukimi*; *çerdhe hajdutësh*. 4. *usht.* llogore, nga e cila bën zjarr një grup luftëtarësh ose një armë e lehtë. 5. *gjuh.* grupi i fjalëve me një rrënjë të përbashkët: *çerdhe fjalësh* \**çerdhe mizash* vend i ndotur; papastërti e madhe.

**Fshatarësi, ~a, ek. (1954)** gjithë fshatarët e një vendi; katundësi; katundari; klasa e prodhuesve të vegjël të mallrave në bujqësi, që i kanë mjetet e prodhimin dhe punojnë vetë në prodhim: aleanca e proletariatit me fshatarësinë, \_\_\_\_\_kolkoziane, \_\_\_\_\_e kooperuar, fshatarësi që janë bashkuar në ekonomi kolektive, në kolkoze e kooperativa. **Fshatarësi~af. (1980).1. përmb.** Popullsia që banon në fshat dhe që merret kryesisht me bujqësi dhe me blegtori. *Fshatarësia e fushës (e zonave malore). U mblodh fshatarësia.*

**2.ek.** Në RPSSH: Klasa e punonjësve të bujqësisë, e çliruar nga shtypja e shfrytëzimi, që ka si bazë të ekonomisë pronën kolektive dhe burim kryesor të të ardhurave punën e përbashkët dhe që nën udhëheqjen e klasës punëtore e në aleancë të ngushtë me të merr pjesë në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. *Fshatarësia punonjëse. Fshatarësia kooperativiste. Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë.*

**3. ek.** Klasa e prodhuesve të bujqësisë, e shtypur dhe e shfrytëzuar nga klasa sunduese (nëë rendin skllavop[ronar dhe sidomos në rendin feudal e kapitalist). *Fshatarësia e varfër (e mesme). Fshatarësia e pasur* shtresa e borgjezisë së fshatit në vendet kapitaliste që zotëron toka të gjera, bagëti të shumta e mjete prodimi dhe shfrytëzon punën e të tjerëve. (këtu vihet re ngjyrimi politik në shpjegimin e kuptimit të fjalës). **(f.508-509).**

**Fshatarësi,-a(2006)f.** përmb. tërësia e fshatarëve. fshatarësia e varfër (e mesme, e pasur).

**(i, e) Hidhur m) b. (1954** 1. që vjen i pikët në gojë; *fig.* që të pik në zemër, që të helmos; *lajm i hidhur.*

**(i, e) Hidhur mb. (1980) mb.** 1. Që ka një shije të pikët si të helmit, si të pelinit etj. ; që ka hidhësi; kund. i ëmbël. kafe e hidhur. Trangull i hidhur. Bar (ilaç) i hidhur. i hidhur si helm (si pelin). E kam gojën të hidhur.



**2. fig.** Që është plot vuajtje e mundime, që ka shumë hidhërim, që është shumë i rëndë e i vështirë. *Jetë e hidhur. Fat i hidhur. E kaluara e hidhur. kohë të hidhura.*

**3. fig.** Që të hidhëron, që të bën të vuash shpirtërisht, që të lëndon në zemër e të mundon shumë; që të sjellë hidhërim e brenga, që të shkakton vuajtje e mundime; i papëlqyeshëm, i pakëndshëm. *Fjalë e hidhur. Lajm i hidhur. qortim i hidhur. E vërteta e hidhur. Me pasoja të hidhura. Përvojë e hidhur. Me përshtypjet më të hidhura.*

**4. fig.** Që hidhërohet shpejt, zemërak, hidhërak. *Njeri i hidhur.*

**5. fig.** Që shpreh vuajtje shpirtërore a hidhërim. *Lotë të hidhur. Vështrim i hidhur. Buzëqeshje (psherëtimë e hidhur). Mendime të hidhura. Ndjenjë e hidhur. Heshtje e hidhur.*

**6. fig.** Që të pret, që të than; që mezi durohet a nuk durohet dot; i madh, i keq, i ashpër. *Të ftohtë (acar) i hidhur. Mot i hidhur. Vapë e hidhur.*

**7. si em.** f.~, ~a (e). Diçka që ka shije të pikët si të helmit, të pelinit etj; shija që na jep ajo; hidhësirë. *E hidhura e kastravecit. Nuk i ha fare të hidhurat.*(f.678)

**(i, e) Hidhur mb. (2006)** 1. që ka shije si të helmit; kund. i ëmbël: kafe e hidhur. E kam gojën të hidhur. 2. fig. që është plot vuajtje e mundime; që të hidhëron shpirtërisht; që shpreh vuajtje shpirtërore; i pakëndshëm; kund. i ëmbël: *jetë e hidhur, ngjarje (fjalë) e hidhur; pasoja të hidhura.* 3. fig. hidhnak; zemërak: *njeri i hidhur;*/ që të pret a të than; i padurueshëm; *të ftohtë i hidhur.* (f.385).

**Kthej ft. (1954).** 1. e sjell nga ana tjetër; \_\_\_ *barin* që të thahet mirë. \_\_\_ *borxhi.* \_\_\_ *librin.* ja jap atë që i pata marrë; *ha fjalën,* s'e mbaj; *i kthej fjalë,* i përgjigjem pa respekt; \_\_\_ *besën;* \_\_\_ *krahët;* \_\_\_ *mendjen,* ja ndërroj mendjen; \_\_\_ *rrugë;* ja kthej, ju përgjigj; flint\_\_\_, kthehem; *ai qe i dobët, potani ka kthyer,* është bërë më mirë; *kthehem,* shkoj prapë andej nga erdha, arrij prapë në atë vend nga ku u nisa, sillem, prirem nga e djathta, nga prapa; *iu ktheva,* iu drejtuash, iu vërsula.

**Kthej kal., ktheva, kthyer.(1980)** 1. Sjell diçka nga ana tjetër (që të piqet, të skuqet, të thahet etj.). *Kthej bukën (byrekun). Kthej petullat. Kthej barin Kthej qilimin.*

2. E vë përmbys diçka që është mbarë, e përmbys një enë etj. *Kthej gotën (filxhanin). Kthej pjatat. Kthej përmbys (një enë).*

3. lëroj tokën thellë në mënyrë që shtresa e poshtme të dalë me faqe sipër. *Kthej arën.*

4. Shqep një veshje dhe e qep përsëri, duke vënë për faqe të jashtme atë që ishte e brendshme; nxjerr jashtë faqet e brendshme të një thesi, të një xhepi etj.; sjell mbarë një veshje. *Kthej pallton (xhaketën). Kthej thesin (xhepin). Kthej nga astari. Kthej së mbari.*

5. Përthyej anët a fundin e një pëlhere ose të një veshjeje dhe i qep. *Kthej fundin e fustanit. Kthej anët e përparësës.*
6. Përvesh (mëngët). *Kthej mëngët e këmishës.*
7. E përkul diçka, i jap trajtë të lakuar; e përkul në anën e kundërt a në një anë tjetër. *Kthej hekurin (giozhdën).*
8. Rrotulloj; përdredh. *Kthej timonin. Kthej kyçin. Ia ktheu dorën.*
9. Lëviz trupin tim, një gjymtyrë të trupit, sytë etj. në anën e kundërt a në një anë tjetër; lëviz diçka dhe e vë në drejtim tjetër a në një drejtim të caktuar; i drejtoj dikujt diçka; vë. *Kthej kokën prapa. Kthej trupin. Kthej sytë. Kthej këmbët. I ktheu krahët. I ktheu bakjonetën.*
10. Ndryshoj drejtimin e lëvizjes së diçkaje, i jap asaj drejtim tjetër nga ai që kishte më parë. *Kthej veturën (kamionin). E ktheva nga rruga. Kthej vijën e ujit.*
11. I jap dikujt atë që ia kam marrë a që më ka dhënë. *I kthej librin (gazetën, revistën). Ia ktheu huan (borxhin).*
12. I jap dikujt një përgjigje, i dërgoj një letër etj; bëj një veprim për t'iu përgjigjur një veprimi të mëparshëm të dikujt; i jap diçka dikujt si shkëmbim a si shpërblim për atë që më ka dhënë. *I kthej përgjigje. Ia ktheva letrën. ia ktheva përshëndetjen. I ktheva vizitën. ia ktheu të mirën me të mirë.*
13. Pi me fund; pi; derdh një enë a një gotë të mbushur. *E ktheu tërë shishen. Kthyen nga dy gota birra. Ktheu një gllënjë. Ta kthejmë me fund!*
14. bised. Zëvendësoj diçka me një tjetër; ndryshoj diçka sipas kohës, sipas kushteve të vendit ku jetoj etj.; shndërroj. *Ktheu veshjen. Ktheu zakonet (gjuhën). E ktheu mbiemrin. Ktheu shtetësinë. E ktheu (rrugën) ndërroi rrugë, mori rrugë tjetër.*
15. Shndërroj në një njësi tjetër, e llogarit me një njësi tjetër; e sjell në një gjendje a në diçka tjetër; bëj (edhe fig.). *Kthej në centimetra (në decimetra, në metra). I ktheu në lekë (dollarë). Kthej në gjendje të gaztë. Kthej fjalët në vepra. E kthej në festë.*
16. Ia ndryshoj dikujt sjelljen ose qëndrimin, e bëj që të ndryshojë sjelljen a qëndrimin; *Kthej dikë në udhë të drejtë 9të mbarë). E kthej nga rruga e keqe. E ktheu pas vetes dikë.*
17. Lë dikë në një provim, rrëzoj. *Nuk ktheu shumë.*
18. bised. Përkthej; sjell në një gjuhë më të kuptueshme. *Kthej në gjuhë të huaj. E kthej në gjuhën e sotme (në gjuhën letrare). E ktheu nga poezia në prozë.*

19. jokal. bised. shih kthehem1. *Ktheu në shtëpi. ktheu në atdhe.*
20. jokal. bised. shih Kthehem 3. *Ktheu djathtas. (majtas). Rruga ktheu nga e majta.*
21. jokal. shih Kthehem 4. *Ktheu te nëna.*
22. jokal. (më një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën dhanore), Ia marrë këngës që ka filluar këngëtari i parë me një zë tjetër, ia hedh, ia thyej. *Ia kthen djali (vajza, plaku).*
23. I përgjigjem dikujt menjëherë a flakë për flakë. ia ktheu ashpër. Ia ktheu me të butë.
24. jokal. bised. Rifitoj shëndetin, marr veten pas një sëmundjeje a pas një fatkeqësie. *Ka kthyer krejt. Ktheu shpejt.*
25. jokal. Ndryshoj qëndrim, ndërroj idetë e pikëpamjet, jam i paqëndrueshëm në bindjet e mia. *Kthen nga të fryjë era. Kthen si t'i thonë.* (f. 899-900).

**Kthej kal. ktheva, kthyer (2006)** 1. sjell a rrotulloj diçka nga ana e kundërt, përmbys: e *kthej barkas; kthej bukët (petullat); kthej arënlëroj* tokën a ugarin. 2. qep rishtas një veshje, duke vënë për faqe të jashtme atë që ishte e brendshme, përthyej anët e një veshjeje; përvesh: *kthej pallton (faqen e jastëkut); kthej mëngët* 3. përkul, përdredh: *kthej hekurat;/ ndryshoj drejtimin e lëvizjes së dikujt a të diçkaje: kthej makinën (timonin) djathtas; e ktheva shokun nga rruga; ktheva rrugë* ndërrova rrugën; *kthej kokën (sytë) majtas*. 4. i jap dikujt atë që i kam marrë; i jap një përgjigje; i përgjigjem një veprimi; ia shpërblej dikujt (edhe në disa njësi frazeologjike): *ia ktheva librin; ia ktheu me të egër; nuk i ktheu fjalë* nuk e kundërshtoi; *nuk ktheu dorë* nuk i bie dikujt që e godet; *i ktheu pushkëne* qëllloi ose e kërcënoi duke iu drejtuar me pushkë; *ia ktheu (borxhin) dyfish* ia lau borxhin dhe i dha më shumë. 5. bised. pi me fund; *ktheu dy gota me raki*. 6. edhe fig. bised. zëvendësoj ose këmbej diçka me një tjetër; e sjell (një tekst) në një gjuhë a në një variant tjetër, shndërroj, ndërroj, konvertoj: *i ktheu lekët në dollar; nuk i kthejmë zakonet; e ktheu emrin (fenë); e ktheu në shqipen e sotme:/ edhe jokal. ia ndryshoj dikujt sjelljen, qëndrimin a mendimin: ia ktheva mendjen; ktheu mendje* ndryshoi mendim; *kthen nga fryn era* nuk është i qëndrueshëm. 7. bised. lë dikë në provim: *sot ktheu dhjetë studentë*. 8. jokal. kthehem: *do të kthej nga shtëpia*. 9. jokal. (më trajtë të shkurtër përemërore) ia merr me një zë tjetër këngës që ka filluar dikush: *këndon vjehrra dhe ia kthen nusja*. 10. jokal. bised. ndryshoi për mirë, marr veten pas një sëmundjeje *ka kthyer krejt*. (f. 500).

Një rëndësi të madhe për fjalorët, ashtu si për pasqyrimin e njësisive leksikore, ka edhe pasqyrimi i njësisive kuptimore, të cilat përbëjnë strukturën kuptimore të fjalëve në fjalorët shpjegues. Fjalët, siç e pamë dhe nga krahasimi i strukturave të disa fjalëve në të tre fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, kanë prirje të zgjerojnë strukturën kuptimore të tyre, e

cila duhet të pasqyrohet në këta fjalorë. Në strukturën kuptimore të fjalëve kemi parë të pasqyruar vargun e kuptimeve leksikore të formuar nga pikëpamja gjuhësore, por edhe përdorime të figurshme të fjalëve, kemi parë gjithashtu edhe kuptime jo të lira të shprehura në njësitë frazeologjike me fjalë të tjera.

Të gjithë këto elemente të strukturës kuptimore të fjalëve nuk janë në përmasa të njëjta në tre fjalorët shpjegues që po analizojmë. Dallimi është më i dukshëm kur krahasojmë “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, pasi për numrin e kuptimeve në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, nuk mund të japim një pasqyrë të plotë, se aty kemi grupime të kuptimeve sipas afërisë së tyre, ndaj e shprehur në shifra nuk është pasqyrim real, pasi në përgjithësi kuptimet e pasqyruara në Fjalorin e 1980-ës, janë edhe këtu, me përjashtime të rralla për kuptime fjalësh që ishin të politizuara. P.sh. fjalafshatarësi ka tri kuptime të pasqyruara në strukturën e saj në Fjalorin e 1980-ës, por ka vetëm një kuptim të pasqyruar në Fjalorin e 2006-ës. Kuptimet 2 dhe 3 nuk janë pasqyruar. Është marrë vetëm ndonjë element i kuptimit 3 e i është bashkangjitur kutimit të fjalës. Fjalakthejka 1 kuptim në Fjalorin e 1954-ës, 25 kuptime në Fjalorin e 1980-ës, dhe 10 kuptime në Fjalorin e 2006-ës. Në fjalorin e 2006-ës, megjithëse të shprehur në shifra ka 10 kuptime, pra 15 më pak se fjalori i 1980-ës, në fakt ajo i ka pasqyruar në mënyrë të përmbledhur dhe të shkurtuar kuptimet e fjalës të pasqyruara në fjalorin e 1980-ës.. Është kjo arsyeja që për krahasim do marrim vetëm dy fjalorët 1954 dhe 1980. Kjo shpjegohet edhe nga tipi i fjalorit, i cili u hartua më shumë si një fjalor praktik. Në këtë fjalor kuptimet e emrave të veprimit dhe të mbiemrave prejpesorë, që u përgjigjen kuptimeve foljore të foljes nga e cila vijnë, janë vënë nëpërmjet formulës: **për emrat:** *veprimi sipas foljes përkatëse, dhe për mbiemrat: që është + pjesorja e foljes.*

Ndaj, siç thamë më lart, zgjerim të ndjeshëm të strukturës kuptimore të fjalëve, të pasqyruara në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, kemi kur krahasojmë “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, pasi në këtë të fundit struktura kuptimore e fjalëve është dhënë e plotë dhe e pasqyruar me ndarje me numra sipas njësisë semantike. Për të krijuar një ide më të qartë të shtimit të numrit të njësisë semantike, pjesë e strukturës kuptimore të fjalës, të pasqyruara në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, më poshtë po japim, të pasqyruara në tabela, krahasimin e zhvillimit dhe pasqyrimin të kuptimeve midis “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954 dhe “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” 1980. Krahasimi për strukturën kuptimore të fjalëve që kemi marrë në shqyrtim është i mjaftueshëm për të krijuar idenë e zhvillimit të sistemit të kuptimeve të fjalëve në gjuhën shqipe, që ka çuar kështu në pasurimin e saj. Ne do të pasqyrojmë fjalët që kanë zhvillim më të dukshëm të kuptimeve.

**Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës A**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Abstrakt	1 kuptim	5 kuptime	Acar (emër)	2 kuptime	5 kuptime
Administratë	1 “	5 “	Acar (mbie)	2 “	7 “
Afër	3 “	6 “	Afersi	2 “	5 “
Ah	1 “	13 “	Ai	1 “	8 “
Ajo	1 “	13 “	Ajroj	1 “	5 “
Akoma	1 “	4 “	Aktivitet	1 “	4 “
Akull	3 “	5 “	Aleat	1 “	4 “
Ambient	2 “	5 “	Amerikan	1 “	9 “
Anakronik	2 “	5 “	Analizim	1 “	4 “
Anësor	1 “	9 “	Angari	2 “	4 “
Apo	1 “	7 “	Aq	2 “	10 “
Arbëresh	2 “	7 “	Arkë	4 “	7 “
Armatos	2 “	5 “	Armaturë	1 “	8 “
Arrij	3 “	11 “	As (pjesëz)	1 “	9 “
(i,e) ashpër	4 “	15 “	Ashpërsi	1 “	6 “
Ashtu	2 “	9 “	Ata	3 “	9 “
Atje	1 “	5 “	Ato	2 “	7 “
Athët	2 “	5 “	Avull	2 “	6 “

**Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës B**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Bajonetë	1 kuptim	4 kuptime	Bajrak	2 kuptime	5 kuptime
Balonë	1 “	6 “	Baltë	4 “	9 “
Ballë	3 kuptime	9 “	Banjë	3 “	8 “
(i,e)Bardhë	3 “	20 “	Barku	4 “	11 “
Baba	2 “	7 “	Barrë	2 “	7 “
Bateri	2 “	6 “	Bëj	29 “	39 “
Bibliotekë	2 “	4 “	Bie (rashë)	13 “	44 “
Bie (prura)	1 “	7 “	Bigë	2 “	7 “
Bijë	2 “	7 “	Binjak	3 “	7 “

Bisbiq	1 “	4 “	Bisku	2 “	6 “
Bisht	4 “	13 “	Bllok	4 “	11 “
Boçe	4 “	8 “	Bosh	2 “	6 “
Boshllëk	1 “	7 “	Brenda	3 “	10 “
Brinjë	3 “	7 “	Britmë	1 “	4 “
Buis	1 “	8 “	Buf	2 “	9 “
Bufkë	2 “	7 “	Bujqësor	1 “	7 “
Bukë	5 “	11 “	Bulmetore	2 “	6 “
Burim	4 “	10 “	(i, e) Butë	3 “	17 “

### **Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës C**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Ca	2 Kuptime	7 kuptime	Caku	4 kuptime	11 kuptime
Caktoj	1 “	4 “	Cangël	1 “	4 “
Caran	2 “	6 “	Cektësi	1 “	3 “
Cergë	3 “	5 “	Cilësi	2 “	5 “
Cili	1 “	5 “	Cikël	1 “	4 “
Cungal	1 “	4 “	Cimbidh	1 “	8 “
Cingël	1 “	4 “	Cingërimë	1 “	6 “
Cingëris	1 “	3 “	Cingëron	1 “	3 “
Cipë	2 “	8 “	Copë	5 “	10 “

### **Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës C**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Çafkë	2 kuptime	4 kuptime	Çaj (fol)	1 kuptim	12 kuptime
Çale (mb.)	1 “	4 “	Çaløj	1 “	4 “
Çallmë	1 “	5 “	Çapëloj	1 “	3 “
Çapraz (nd.)	1 “	3 “	Çarçaf	2 “	3 “
Çark	4 “	10 “	Çarmatos	1 “	4 “
Çatall	1 “	9 “	Çehre	1 “	4 “
Çekiç	1 “	4 “	Çel	3 “	23 “

Çelës	3 “	9 “	(i,e)Çelur	2 “	15 “
Çengel	1 “	8 “	Çerdhe	1 “	7 “
Çetë	2 “	8 “	Çfarë? (pp)	1 “	11 “
Çift	2 “	5 “	Çikë	4 “	13 “
Çikrik	3 “	5 “	Çimentoj	1 “	4 “
Çip	1 “	2 “	Çirrem	1 “	8 “
Çliroj	1 “	6 “	Çmim	2 “	5 “
Çmoj	2 “	4 “	Çoj	5 “	15 “
Çok	1 “	7 “	Çokanis	2 “	4 “
Çrregulloj	1 “	4 “	(i,e)Çrregullt	1 “	5 “
Çudi	1 “	5 “	Çull	1 “	4 “

### **Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës DH**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Dheu	5 kuptime	9 kuptime	Dhe (lidhëz)	1 kuptim	11 kuptime
(i, e)Dhënë	1 kuptim	10 “	Dhomë	1 “	7 “
Dhunoj	1 “	5 “	Dhjetë	1 “	3 “
Dhjetoj	2 “	5 “	Dhunë	2 “	3 “
Dhunoj	1 “	5 “	Dhuroj	1 “	3 “

Duke pasur parasysh peshën specifike që ka fjalësi i kësaj shkronje, në raport me gjithë fjalësin e secilit fjalor shpjegues të gjuhës shqipe, sigurisht që edhe fjalët me zhvillime kuptimore do të ishin të pakta. Këtu kemi dhënë fjalët që kanë zhvillim më të madh të kuptimeve në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, në krahasim me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954. Në pjesën dërmuese të gjitha fjalët kanë zhvillime të kuptimeve në raport me fjalorin paraardhës shpjegues të gjuhës sonë.

### **Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës F**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Faj	2 Kuptime	4 Kuptime	Fal	5 Kuptime	11 Kuptime
Familjar	2 “	6 “	Familje	2 “	7 “
Faqe	7 “	11 “	Faqore	2 “	7 “
Farë	7 “	16 “	Farkë	2 “	5 “

Faroj	1 “	5 “	Fazë	1 “	6 “
Feçkë	1 “	4 “	Feks	1 “	6 “
Femëror mb.	1 “	6 “	Fëlliq	1 “	3 “
Fërfëlloj	1 “	5 “	Fërtymë	1 “	3 “
Fiçor	2 “	4 “	Figurë	6 “	12 “
Fije	1 “	9 “	Filiz	1 “	6 “
Filozofi	1 “	5 “	Filozofik	1 “	3 “
Fillestar	1 “	5 “	Firoj	1 “	5 “
Fitil	2 “	5 “	Fitoj	3 “	8 “
Fjalë	6 “	11 “	Flamur	1 “	8 “
Flas	5 “	15 “	Fle	1 “	5 “
Flori	2 “	7 “	Flutur	2 “	8 “
Fluturoj	2 “	10 “	Flluakë	2 “	6 “
Forcoj	1 “	7 “	(i,e) Fortë	4 “	22 “

### **Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës H**

<b>FJALA</b>	<b>FJALORI 1954</b>	<b>FJALORI 1980</b>	<b>FJALA</b>	<b>FJALORI 1954</b>	<b>FJALORI 1980</b>
Ha	4 kuptime	21 kuptime	Hap (fol.)	5 kuptime	20 kuptime
Hapësirë	2 “	4 “	(i,e) Hapur	1 “	23 “
Harboj	1 “	9 “	Harroj	1 “	4 “
(i,e) Harruar	1 “	6 “	Hedh	5 “	29 “
Hekur	2 “	8 “	Hero	2 “	4 “
Heq (fol.)	6 “	31 “	Hesht (fol.)	1 “	5 “
Hidhem	1 “	8 “	(i,e) Hidhur	1 “	7 “
Hije	3 “	13 “	Hipi	2 “	11 “
Histori	3 “	8 “	(i,e) Hollë	2 “	14 “
Hollë (nd.)	1 “	9 “	Holloj	2 “	10 “
Horizont	4 “	7 “	Hov	1 “	5 “
(i,e) Huaj	2 “	9 “	Hudhër	1 “	3 “
Hukat	1 “	3 “	Humb	3 “	18 “
(i,e) Humbur	2 “	12 “	Hundë	2 “	5 “



**Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës K**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Kacagjel	1 kuptim	3 kuptime	Kaish	1 kuptim	3 kuptime
Kala	1 “	5 “	Kalendar	1 “	3 ”
Kalivare	1 “	5 “	Kaloj	8 “	19 “
Kalareja	3 “	7 “	Kalorësi	2 “	4 “
Kaluar (mb.)	2 “	5 “	Kaluar (nd.)	2 “	5 “
Kaluese	1 “	4 “	Kallam	2 “	8 “
Kallauz	1 “	6 “	Kallëp	3 “	7 “
Kam	3 “	24 “	Kap	5 “	16 “
Kapedan	1 “	7 “	Kapelë	1 “	6 “
Kapërcej	4 “	9 “	Kaploj	1 “	4 “
Kaposh	1 “	4 “	Kaq	3 “	6 “
Kasolle	1 “	4 “	Kashtore	3 “	7 “
Katarosh	1 “	6 “	Katran	1 “	8 “
Kep	5 “	9 “	(i, e) Keq	2 “	11 “
Këlysh	1 “	6 “	Keq (nd)	2 “	6 “
Këmbë	5 “	14 “	Kënd	2 “	8 “
Këndoj	4 “	9 “	Këngë	2 “	5 “
Këput	3 “	13 “	Kërthej	1 “	8 “
Kërçep	2 “	5 “	Kërkoj	3 “	13 “
Kështu	1 “	8 “	Këtu	1 “	7 “
Kllapë	3 “	11 “	Kohë	9 “	18 “
Kokë	6 “	10 “	Kokël	1 “	6 “
Kosh	1 “	7 “	Krah	5 “	18 “
Krahas (nd.)	1 “	5 “	Krijoi	1 “	7 “
(i,e)Krimbur	1 “	6 “	(i) Kripur	1 “	5 “
Kthej	11 “	25 “	Kryej	1 “	5 “
Kulaç	3 “	6 “	Kullë	3 “	8 “
Kulloj	3 “	9 “	(i) Kulluar	2 “	6 “
Kufomë	2 “	4 “	Kungulleshkë	1 “	3 “
Kur (nd.)	1 “	3 “	Kurdis	3 “	5 “
Kurorë	3 “	11 “	Kurs	2 “	6 “
Kurriz	3 “	11 “	Kusur	2 “	5 “
Kush	3 “	8 “	Kushedi	1 “	5 “
Kontroll	1 “	5 “	Kombëtar	1 “	4 “

**Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës LL**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Llacaman	2 Kuptime	3 Kuptime	Lladik	1 kuptim	2 Kuptime
Llagëm	1 “	2 “	Llapërçinë	1 “	3 “
Llapë	1 “	6 “	Llasë	1 “	2 “
Llastik	1 “	4 “	(i,e)Llastiktë	1 “	3 “
Llërë	1 “	2 “	Llogari	2 “	5 “
Lloj	2 “	4 “	Llokmë	1 “	2 “
Llokum	1 “	3 “	Llomë	1 “	4 “
Llinxhë	1 “	3 “	Llosh (em)	2 “	5 “
Lloz	1 “	5 “	LLlukë	1 “	4 “
Llullë	2 “	5 “	Llum	1 “	4 “
Llupës	1 “	2 “	Llurbë	1 “	5 “

**Zhvillimi i kuptimeve në fjalësin e shkronjës O**

FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980	FJALA	FJALORI 1954	FJALORI 1980
Objekt	2 kuptime	5 kuptime	Obobo(psth.)	1 Kuptim	3 kuptime
Oborr	2 “	3 “	Ogiç	2 “	4 “
Oh! (psth)	1 “	6 “	Oman	1 “	3 “
Opinion	1 “	2 “	Opium	1 “	2 “
Optimist	1 “	2 “	Orakull	1 “	2 “
Orë	3 “	7 “	Organizoj	1 “	3 “
Orientim	1 “	4 “	Original(mb)	1 “	3 “
Ortak	1 “	3 “	Ortek	1 “	3 “
Oshënar	1 “	3 “	Oxhak	2 “	7 “

Pra, siç shihet fjalësi ka lëvizur në numër, kuptime, nuanca kuptimore me tendencë zhvillimin e tij, duke rritur në këtë mënyrë aftësinë shprehëse të gjuhës e duke pasqyruar kështu kohën në zhvillim. Kjo argumenton konkluzionin shkencor se në gjuhë ajo që ndryshon më shpejt, është fusha leksikore.

## 3.2 NDIKIMI I FJALËFORMIMIT NË SHTIMIN E NUMRIT TË FJALËVE NË MAKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES TË GJSH

### 3.2.1 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Si një kërkesë objektive, pasurimi i gjuhës letrare është një proces i vazhdueshëm, sepse nëpërmjet tij, gjuha letrare shton vazhdimisht fondin e njësive gjuhësore që janë në qarkullim. Në gjuhësinë shqiptare janë pranuar disa rrugë pauruese të gjuhës letrare shqipe:

1. Formimi i fjalëve të reja me brumin e vetë gjuhës shqipe dhe sipas gjedheve prodhimore të sistemit fjalëformues.
2. Zgjerimi i përmbajtjes leksikore të fjalëve me kuptime të reja.
3. Marrja nga dialektet e të folmet e pasurisë leksiko-semantike e frazeologjike që ruhet në ta.
4. Huazimi i fjalëve.

Nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar e deri më sot gjuha jonë letrare mori një zhvillim të madh në të gjitha fushat, veçanërisht leksiku i saj u pasurua me fjalë e shprehje të reja. Në procesin e zhvillimit dhe të pasurimit të pandërprerë të gjuhës sonë letrare janë vënë e po vihen në veprim të gjitha mundësitë potenciale që ka sistemi fjalëformues i gjuhës sonë, gjë që duket qartë në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe 1980 dhe 2006. ‘Struktura fjalëformuese e gjuhës letrare shqipe duke qenë, krahas asaj leksikore, një nga strukturat më të hapura e më dinamike’,<sup>36</sup> thith vazhdimisht krijimet popullore me vlerë, të formuara sipas gjedheve më aktive e më produktive të gjuhës. Këto krijime kanë pasuruar ndjeshëm fondin leksikor të gjuhës letrare shqipe dhe i kanë dhënë e i japin asaj mundësi për të përmbushur nevojat që i dalin në çdo kohë në procesin e zhvillimit të vrullshëm të jetës sonë në të gjitha aspektet e saj.

Kjo pasuri e madhe leksikore e popullit tonë ka gjetur pasqyrimin e vet në vepra leksikografike të llojeve të ndryshme, por pasqyrimin më të madh e ka gjetur në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, të cilët nga njëri botim në tjetrin kanë njohur rritje të numrit të njësive leksikore të pasqyruara, si fjalë të reja të formuara me mjetet e gjuhës shqipe, ashtu dhe ato ekzistuese të panjohura më parë dukë çuar në rritjen e përgjithshme të numrit të fjalëve të futura në makrostrukturën e një fjalori shpjegues, si në ‘Fjalorin e gjuhës shqipe’ 2006, me rreth 48000 fjalë. Këtë rritje e pasurim të leksikut, si dhe pasqyrim të tyre në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues, e pamë gjatë krahasimit të

<sup>36</sup> Kostallari, A. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë,( referat), Tiranë 7 dhjetor 1984, f.27.

fjalësit të tyre të përgjithshëm në tabelën me numrin e fjalëve për çdo shkronjë, ku rezulton se “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, ka rreth 25000 fjalë, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, ka rreth 41000 fjalë dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, që ka rreth 48000 fjalë. Por në mënyrë më të detajuar e vumë re gjatë krahasimit të fjalësit të shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, Ll, O.

Në dy fjalorët e fundit shpjegues, (kemi parasysh fjalorët që po analizojmë, FGJSSH, 1980 dhe FGJSH, 2006) jepet gjendja e leksikut të kohës në të cilën u botuan fjalorët, fjalët që kanë përdorim më të gjerë, fjalë e shprehje të krijuara me mjetet e vët gjuhës sonë, jepen fjalë që kanë zgjeruar strukturën kuptimore nga një periudhë në tjetrën, jepen dhe ndryshimet që janë bërë në shtresat stilistikore të leksikut, si dhe një pasuri e madhe frazeologjike e gjuhës shqipe, dëshmi e origjinalitetit kombëtar të gjuhës sonë.

Ndryshimi i fjalësit nga njëri fjalor shpjegues i gjuhës shqipe në tjetrin nuk është vetëm sasior, por dhe rritje cilësore e tij, duke pasqyruar zhvillimet në të gjitha fushat e jetës shoqërore të popullit tonë, gjë që u shoqërua edhe me zhvillimin e leksikut për t’iu përgjigjur ndryshimeve në të gjitha fushat. Por ky leksik nuk gjeti i gjithë pasqyrim në fjalorët shpjegues të gjuhës sonë, për arsye nga më të ndryshmet, bile edhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, si fjalori me numër më të madh fjalësh deri tani, ky fjalës nuk gjeti i gjithë pasqyrim, por vetëm një pjesë e tij.

Kjo diferencë fjalësh me Fjalorin shpjegues të 1954-ës, në dy fjalorët e tjerë shpjegues, krahas pasurimit të leksikut të gjuhës shqipe të pasqyruar në makrostrukturën e këtyre fjalorëve, ka edhe shkaqe të tjera.

**Së pari.** Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, nuk gjetën pasqyrim shumë fjalë, pasi leksiku i shqipes në gjuhën e shkruar ishte i kufizuar dhe mungonin kërkimet gjuhësore për njohjen sa më të plotë të leksikut popullor. Për këtë arsye hartuesit e këtij fjalori shpjegues, mjaft fjalë që kanë zgjeruar makrostrukturën e fjalorëve të mëvonshëm, nuk i kanë përfshirë, se mund të kenë qenë pak të njohura, pasi nuk janë mbledhur nga goja e popullit dhe nuk kanë qenë të botuara në fjalorët e tipeve të ndryshme, të botuar para tij.

**Së dyti.** Një grup fjalësh, në kohën e botimit të “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954, mund të kenë pasur një përdorim të pangulitur e si të tilla nuk janë gjykuar nga leksikografët si të përshtatshme për të hyrë në leksikun e përgjithshëm të gjuhës shqipe, ndaj se kanë parë të arsyeshme të përfshihen në makrostrukturën e fjalorit shpjegues. Gjithashtu këtë diferencë e rrit edhe fakti se në fjalorët pas atij të 1954-ës, nuk janë futur fjalë pa vlerë komunikative shoqërore, të cilat përdorshin në periudhën e

Rilindjes, si: *skolli* për *shkollë*, *fili* për *fis*, *kuvernë* për *qeveri*, *gjithëmesimet* për *universitetetj*.

Nga analiza e makrostrukturës së fjalorëve shpjegues të viteve 1980 e 2006, vihet re se burimet nga janë vjelë fjalët janë shtuar, pra nuk ka shërbyer si burim vetëm letërsia artistike apo fjalorët paraardhës, siç u përdorën për fjalorin shpjegues të 1954-ës, por edhe gjuha e folur e popullit, nga i ashtuquajtimi fjalor “dialektor” apo “krahinor” që ka marrë një status kombëtar, ose siç e quan J.Thomai “fjalori potencial” për pasurimin e leksikut të gjuhës shqipe.

### **3.2.2 NDIKIMI I NDAJSHTESIMIT NË SHTIMIN E NUMRIT TË FJALËVE NË MAKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES TË GJSH**

Një burim tjetër me ndikim në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues, qenë dhe fjalët e reja të formuara nga fjalët ekzistuese me parashtesa, prapashtesa, përbërje e përngjitje. Veçanërisht është i dukshëm ndikimi i këtij burimi kur krahasojmë “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954. Në fjalorët shpjegues, pas atij të 1954-ës, janë përfshirë fjalë nga letërsia artistike, jo vetëm të asaj letërsie që ka përdorur si burim ky fjalor, por edhe i letërsisë së mëvonshme. Aty gjejnë pasqyrim fjalë të gjuhës zyrtare të kohës, dokumente kryesore të jetës politike-shoqërore e ekonomike të vendit, veçanërisht termat e fushave të ndryshme, ligjet e shtetit e organet e shtypit, të cilat kanë shërbyer si burim nga është vjelë leksiku. Variantet e shumta fonetike dialektore që gjendeshin në makrostrukturën e “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954, nuk janë pasqyruar në asnjë fjalor të mëvonshëm shpjegues të gjuhës shqipe.

“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, ka rreth 16000 fjalë më shumë se “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, ndërsa Fjalori i 2006-ës, ka rreth 23000 fjalë më shumë se Fjalori shpjegues i 1954-ës, dhe rreth 7000 fjalë më shumë se Fjalori shpjegues i 1980-ës. Burimet, siç e theksuam më lart janë të shumta, por ajo që është me ndikim më të dukshëm në shtimin e fjalëve në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues, është dhënia në mënyrë të gjerë e rezultateve të fjalëformimit në gjuhën e sotme shqipe, sidomos format ndajshtesore dhe të përbëra, që krijojnë grupe të mëdha fjalësh, siç shprehet A.Kostallari se “zgjerimi i leksikut nëpërmjet fjalëformimit bëhet kryesisht jo me fjalë të veçuara, por me klasa fjalësh e me vargje leksikore fjalëformuese”<sup>37</sup>.

---

<sup>37</sup> Kostallari, A. Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare, Studime filologjike, nr.2, 1982, f.17.

Kjo prirje e zhvillimit të strukturës leksikore e fjalëformuese të gjuhës letrare shqipe, gjen pasqyrimin konkret në fjalorët shpjgues të 1980-ës dhe 2006-ës. Këta fjalorë dëshmojnë se ka vijuar me ritme të larta pasurimi i leksikut të gjuhës sonë letrare me ndajshitesa, veçanërisht me prapashtesa, jo vetëm se janë më të shumta në numër, por dhe me aftësi të mëdha fjalëformuese, sidomos një pjesë e tyre, për të cilat do të flasim më poshtë. Studimi paraprak i fjalësit të prejardhur e të përbërë, në shkrojat që kemi marrë për analizë, A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LI, O, tregon se shtim më të ndjeshëm kanë pasur këto klasa fjalësh:

- ❖ Emrat e vepruesit dhe mbiemrat foljorë të formuar nga temat foljore me prapashtesën **-ë/s**, si: *tregues (nga tregoj), dhurues (nga dhuroj), zbulues (nga zbuloj), djegës (nga djeg), marrës (nga marr), ashtu dhe me prapashtesën -tar*, nga temat emërore, si: *kufitar (nga kufi), ndërtimtar (nga ndërtim), krijimtar (nga krijim), valltar (nga valle), arkëtar (nga arkë), kërcimtar (nga kërcim), këngëtar (nga këngë), këshilltar (nga këshill), kafetar (nga kafe) etj.*
- ❖ Emrat e veprimit me prapashtesat **-im** dhe **-je**, të cilët vijnë nga foljet si: *gjallërim, dystim, mësim, mënjanim, përpunim, plugim, përshkrim, tregim, lajkatim, njoftim, organizim, qortim, arritje, bërje, ftohje, prashitje, tëharrje, derdhje, marrje, kapje, mbështetje, vaditje, vendosje, zhveshje etj.*
- ❖ Emrat abstraktë me kuptim cilësie të formuar me prapashtesat **-i**, **-(ë)si**, **-(ë)ri** si: *krijimtari, pjekuri, ndershmëri, rrezikshmëri, qëndrueshmëri, paprekshmëri, bardhësi, vazhdimësi, pavdekësi, pasmangësi, zemërgjerësi, shpirtmadhësi, drejtësi, ndershmëri etj.*
- ❖ Mbiemrat e formuar me **-or (-tor, -sor)**, **-shëm**, **-të**, si: *fundor, gojor, gjethor, klasor, rracor, shkëmbor, ranor, rrugor, i mishtë, i tultë, i brumtë, i frikshëm, i tundshëm, i kuptueshëm, i dallueshëm, i përbindshëm etj.*
- ❖ Ndajfoljet e formuara me prapashtesat **-(i)sht**, **-as**, **-azi**, **-thi**, si: *përafërsisht, fatmirësisht, gjallërisht, gjerësisht, pabesisht, burrërisht, fatkeqësisht, fuqimisht, kalimthi, vetëtimthi, barkas, shkarazi etj.*
- ❖ Foljet e formuara me prapashtesat **z(o)**, **-os**, si: *fuqizoj, copëtoj, imtoj, fajësoj, punoj, mbuloj, pengoj, themeloj, ngjyros, vajos, hekuros etj.*

Ndajshitesimi ka pasur ndikim më të dukshëm në shtimin e makrostrukturës në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, në krahasim me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, pasi tipat e fjalëformimit ishin konsoliduar, ndaj fjalët e reja, të pasqyruara në Fjalorin e 2006-ës, më tepër formoheshin për analogji të tipit fjalëformues. Ndaj për tëparë ndikimin e fjalëformimit në zhvillimin e fjalësit në fjalorët shpjgues të gjuhës shqipe është e mjaftueshme të krahasohet fjalori shpjgues i vitit 1980 me fjalorin shpjgues të vitit 1954, por ne në punimin tonë, për të parë zhvillimin e fjalësit nën

ndikimin e ndajshitesimit, kemi bërë krahasimin midis tre fjalorëve shpjegues të gjuhës sonë.

Gjatë shqyrtimit të fjalësit të shkronjave të ndryshme, për të parë vendin që zënë fjalët e prejardhura dhe të përbëra e të përngjitura, vëmë re se në fjalës të shkronjave të ndryshme, shtimi i numrit të fjalëve me anë të ndajshitesave, nuk ka ndonjë ndryshim shumë të madh. Më shumë vend ndajshitesat zënë te fjalësi i shkronjës B, me rreth 63% në FGJSSH 1980, dhe 66% në FGJSH 2006, dhe pastaj vijjnë me radhë fjalët në shkronjat DH, A, K, C, F, H,Ç, O, Ll, (gjithmonë në raport me fjalësin e tyre). Shkronjat DH, F dhe B janë shtuar shumë nëpërmjet përbërjes, në raport me numrin e fjalëve të tyre, por për këtë do të flasim më poshtë.

**TABELA E FJALËVE TË PARME, TË PREJARDHURA DHE TË PËRBËRA NË FJALORËT SHPJEGUES**

Shkr.	Fjalori	Fjalë gjithsej	Fjalë të parme	FJALË TË PREJARDHURA					Fjalë të prejardhura gjithsej	FJALË TË PËRBËRA					Fjalë të përbera gjithsej	TOTALI
				Emra	Mbiemr	Folje	Ndajfol.	Pasthirr.		Emra	Mbiemra	Folje	Ndajfol.	Përemra		
A	1954	884	327	167	123	93	18	1	402	59	47	21	5	2	134	863
	1980	1851	523	389	377	171	27	2	966	138	113	59	9	4	323	1812
	2006	1911	488	419	398	204	31	2	1054	134	120	64	12	5	335	1877
B	1954	1254	480	214	181	97	36	2	530	73	86	67	12	0	238	1248
	1980	2839	869	464	409	293	42	5	1213	257	292	137	36	0	722	2804
	2006	2868	791	488	421	305	48	5	1267	282	302	145	39	0	768	2826
C	1954	282	108	49	26	34	3	1	113	29	19	9	1	0	58	279
	1980	667	210	104	86	84	7	2	283	63	74	24	3	0	164	657
	2006	892	278	135	119	103	9	2	368	85	114	28	6	0	233	879
Ç	1954	480	171	84	58	68	3	0	213	46	32	12	2	0	92	476
	1980	793	266	137	108	94	10	0	349	58	67	21	11	0	157	772
	2006	1066	248	203	172	125	11	0	511	107	129	25	13	0	274	1033
DH	1954	145	48	45	20	13	2	0	80	9	3	1	1	0	14	142
	1980	238	42	55	26	18	8	0	107	32	46	1	4	0	83	232
	2006	247	38	46	31	21	8	0	106	34	52	2	6	0	94	238
F	1954	865	388	154	101	27	4	0	286	92	79	12	5	0	188	862
	1980	1475	467	274	244	89	11	0	618	147	187	35	6	0	375	1460
	2006	1870	482	347	327	172	18	0	864	223	238	41	8	0	510	1856
H	1954	653	254	112	103	43	5	1	264	67	56	8	1	0	132	650
	1980	968	298	215	209	52	8	3	487	73	87	15	3	0	178	963
	2006	1135	315	281	254	65	9	3	612	86	95	17	3	0	201	1128
K	1954	2531	1007	394	357	193	43	0	987	92	44	5	18	0	159	2153
	1980	3393	1268	489	452	312	52	2	1307	261	208	32	56	1	558	3133
	2006	3623	1311	503	487	361	64	2	1417	206	145	29	63	1	444	3172
LL	1954	141	62	48	8	16	1	0	73	3	1	0	0	0	4	139
	1980	217	68	51	33	34	2	1	121	7	16	1	0	0	24	213
	2006	345	75	63	36	35	2	1	137	12	14	3	1	0	30	242
O	1954	207	92	66	15	9	2	3	95	11	7	0	0	0	18	205
	1980	282	96	81	27	19	6	6	139	18	21	0	1	0	40	275
	2006	432	104	106	91	42	7	7	253	37	31	0	1	0	69	426



TABELA ME FJALË TË PËRNGJITURA NE FJALORËT SHPJEGUES

Shkronja	Fjalori	Emra	Mbiemra	Numërorë	Përemra	Ndajfolje	Parafjalë	Lidhëza	Pjesëza	Pasthirrm	Emerzime	Gjithsej fjalë
A	1954	-	3	-	5	9	-	-	-	-	4	884
	1980	-	9	-	8	11	2	2	1	-	5	1851
	2006	-	8	-	8	10	2	1	1	-	4	1911
B	1954	-	1	-	-	2	1	1		1	-	1245
	1980	-	7	-	-	12	4	2	2	2	6	2839
	2006	-	10	-	-	14	5	2	2	2	7	2868
C	1954	-	-	-	3	-	-	-	-	-	-	282
	1980	-	2	-	5	2	-	-	-	-	1	667
	2006	-	3	-	6	2	-	-	-	-	2	892
Ç	1954	-		-	1	1	-	1	1		-	480
	1980	-	6	-	8	3	-	1	1		2	793
	2006	-	8	-	11	6	-	2	2	1	3	1066
DH	1954	-	1	-	-	1	-	-	-	-	1	145
	1980	-	1	-	-	2	-	1	-	-	2	238
	2006	-	2	1	-	2	-	1	-	-	3	247
F	1954	-	1	-	-	2	-	-	-	-	-	865
	1980	1	3	-	-	5	-	-	-	-	3	1472
	2006	1	4	-	-	6	-	-	-	-	3	1870
H	1954	-	1	-	-	2	-	-	-	-	-	653
	1980	-	1	-	-	2	-	-	-	-	2	968
	2006	-	1	-	-	3	-	-	-	-	3	1135
K	1954	-	1	1	3	5	-	-	-	-	3	2531
	1980	-	3	2	9	11	2	2	-	-	5	3393
	2006	-	5	2	10	12	3	2	-	-	5	3623
LL	1954	-	-	-	1	1	-	-	-	-	-	141
	1980	-	1	-	1	2	-	-	-	-	2	217
	2006	-	1	-	1	1	-	-	-	-	2	345
O	1954	-	-	-	-	1	-	-	-	1	-	207
	1980	-	-	-	-	3	-	1	-	1	2	282
	2006	-	-	-	-	3	-	1	-	1	2	432

(Në rubrikën “Gjithsej fjalë” në tabelë, është shuma e fjalësit të çdo shkronje në fjalorët shpjegues të marrë në shqyrtim. Ajo del nga shuma e gjithë ndarjeve në të dyja tabelat)

Pesha specifike e fjalëve tëprejardhura brenda një shkronje në fjalorët shpjegues, nuk varet nga numri i fjalëve të asaj shkronje, por përqindja e tyre në raport me numrin e përgjithshëm të fjalëve të asaj shkronje të pasqyruar në fjalorin shpjegues. Këtu lind pyetja se pse në fjalësin e shkronjave të ndryshme pesha specifike e fjalëve të prajardhura, të përbëra e të përngjitura është e ndryshme. Këtu po sjellim një shembull. Megjithëse për të formuar fjalët e prejardhura në shkronjën K janë përdorur 47 prapashtesa, pra 11 më tepër seç janë përdorur për të formuar fjalët e prejardhura të shkronjës DH (36 prapashtesa), përsëri në shkronjën DH, formimet me prapashtesa zënë vend më të madh në %, rreth 45% në FGJSSH, 1980, ndaj rreth 39% në fjalësin e shkronjës K të po këtij fjalori.

Ndryshimet që ndodhin nëfjalësin e shkronjave të ndryshmenuk janë në përpjestim të drejtë me shtimin ose pakësimin e numrit të ndajshtesave që përdoren në fjalësin e secilës shkronjë për të formuar fjalë të reja. Pra numrit më të madhose më të vogël të fjalëve në një shkronjë, jo domosdoshmërisht do t’i përgjigjet respektivisht numri më i madhose më i vogël i ndajshtesave që marrin pjesë në formimin e fjalëve të reja, duke çuar kështu në pasurimin e leksikut të asaj shkronje e të leksikut të gjuhës në përgjithësi. Kjo do të thotë se në gjuhën shqipe, për formimin e fjalëve të prejardhura nuk është vendimtare numri i ndajshtesave që shërbejnë për formimin e tyre, por specializimi i ndajshtesave, pasi jo të gjitha ndajshtesat përdoren njëlloj për të formuar fjalë të prejardhura, pasi nuk kanë të njëjtën aftësi fjalëformuese.P.sh. në fjalësit e shkronjave B, DH, C, në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, rreth 980 fjalë të prejardhura, ose rreth 56% e të gjitha formimeve me ndajshtesa, janë formuar me tri parashtesa (*pa-*, *mos-*, *jo-*) dhe me nëntë prapashtesat (*-o*, *-im*, *-(ë)s*, *-or*, *-(ë)t(ë)*, *-ar*, *-shëm*, *-e*, *-je*), ndërkohë qëgjithë ndajshtesat e tjera (mbi 190) kanë formuar rreth 761 fjalë.

Këta shembuj tregojnë se specializimi i ndajshtesave në gjuhën shqipe vazhdon të zhvillohet, siç pamë sidomos te dy fjalorët shpjegues “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, ku veçanërisht prapashtesat *-(ë)s*, *-im*, *-je*, *-or*, *-tor*, *-shëm*, *-të*, *-o*, janë më prodhimtaret në leksikun e gjuhës shqipe. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për parashtesat, megjithëse formimet prapashtesore janë më të shumta jo vetëm për faktin se vetëprapashtesat janë më të shumta në numër, por janë dhe më prodhimtare.

Në përfundim të krahasimeve, për të parë aftësinë fjalëformuese të ndajshtesave, mund të themi se prodhimtaria e secilës ndajshtesë varet shumë nga fjalët që përbëjnë fjalësin e secilës shkronjë të fjalorit dhe, në përgjithësi, prodhimtaria e prapashtesave në gjuhën shqipevaret shumë nga temat prodhueseme të cilat ato bashkohen për të dhënë fjalë të

reja. Kështu, meqenëse fjalët e prejardhura në gjuhën shqipe formohen, në pjesën më të madhe, nga tema emërore, foljore e pastaj nga tema mbiemërore, fjalësi i një shkronje që ka më shumë emra, ose folje e mbiemra, ka më shumë mundësi për shtimin e fjalëve të prejardhura sesa fjalësi i shkronjave të tjera.

### 3.2.3 NDIKIMI I PËRBËRJES E PËRNGJITJES NË SHTIMIN E NUMRIT TË FJALËVE NË MAKROSTRUKTURËNE FJALORËVE SHPJEGUES TË GJSH

Një mënyrë tjetër fjalëformimi që ka ndikuar në shtimin e numrit të fjalëve në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe është dhe përbërja. Duke shqyrtuar fjalësin e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe 1954, 1980, dhe 2006, kemi vënë re se janë shtuar disa herëfjalët e përbërë në dy fjalorët e fundit në krahasim me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, dhe sidomos kemi vargje me fjalë të përbëra që kanë si gjymtyrë të parë fjalët: *auto-*, *akt-*, *ballë-*, *bark-*, *bukë-*, *bashkë-* (89 fjalë në Fjalorin e 2006-ës), *dorë-*, *dhëmb-*, *dhjetë-*, *faqe-*, *fjalë-*, *gjysmë-*, *jashtë-*, *këmbë-*, *kundër-*, *keq-*, *kokë-*, *krye-*, *kundër*, *mirë-*, *shumë-*, *trup-*, *vetë- etj.*, si: aktakuzë, aktbesim, aktdalje, aktdënim, aktdorëzim, aktgjykim, autobiografi, autoambulancë, autoblindë, autobot, autobus, autodidact, autodrom, autogol, autokolonë, automat, ballëbardhë, ballëçelik, ballëflori, ballëgështenjë, ballëgjerë, ballëhark, ballëkrenar, ballëlart, ballëngrysur, ballëmadh, ballëhënë, barkbardhë, barkzi, barkbosh, barkbuall, barkcalik, barkdreq, barkgjerë, barkledh, barklepur, barkmadh, barkngopur, bukëpjekës, bukëplotë, bukëshitës, bukëzi, bukësheqer, bashkatdhetar, bashkautor, bashkekzistencë, bashkëjetoj, bashkëfajto, bashkëkombas, bashkëkohës, dorëbardhë, dorëborë, dorëbutë, dorëçelur, dorëdredhur, dorëdhënës, dorëgjatë, dorëflori, dorëhapur, dorëheqje, dhëmbëbrisk, dhëmbëçatall, dhëmbëfildishtë, dhëmbëjashtë, dhëmbëmprehtë, dhjetëballësh, dhjetëditor, dhjetëfish, dhjetëkëndësh, dhjetëlekësh, dhjetërrokësh, faqebardhë, faqebutë, faqehënë, faqelarë, fjalëformues, fjalëgjatë, fjalëkryq, fjalëmatur, fjalëmbël, fjalëpakë, fjalëshpejtë, gjysmanalfabet, gjysmëbosht, gjysmëbujqësor, gjysmëdrejtëz, gjysmëkoloni, gjysmëfferë, gjysmërruzull, jashtëmartesor, jashtëtokësor, keqkuptim, keqpërdorim, keqtingëllim, këmbëgjatë, këmbëhollë, këmbëlehtë, kokëshkëmb, kokëshkretë, kokëzbuluar, kryeagronom, kryeartë, kryebandit, kryefamiljar, kundërmësymje, kundërkimik, kundërpeshë, kundërrymë, mirëdashës, mirëkuptoj, mirënjohje, shumefishoj, shumëgarësh, shumëkombësh, shumëpalësh, trupargjendë, trupdrejtë, vetvetëndosje, vetëveproj, vetëvrasës, vetëzhvillimetj.

Ndikim në zhvillimin e fjalësit kanë edhe vargjet me fjalë të përbëra që kanë si gjymtyrë të dytë një temë prejfoljore më-(ë)s, si: *-dhënës*, *-ndreqës*, *-punuesetj*. P.sh. dorëdhënës, llogaridhënës, mitëdhënës, bukëdhënës, orëndreqës, hekurpunues, bashkëpunues etj. Përngjitja nuk ka pasur ndonjë rol të madh në shtimin e numrit të fjalëve në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues. Në tabelën më lart kemi dhënë numrin e fjalëve të përngjitura në tre fjalorët shpjegues të gjuhës sonë.

Pa kaluar në detaje të mëtejshme, nga krahasimet dhe shembujt e mësipërm, dhe nga vëzhgimi i gjithë fjalëve në FGJSH 1954, FGJSSH 1980 dhe FGJSH 2006, sidomos në dy fjalorët e fundit, mund të nxjerrim përfundimin se ky shtim i madh i fjalësit të fjalorëve shpjegues, me fjalë të prejardhura e të përbëra, pasqyron shtimin e tyre në leksikun e gjuhës sonë letrare, dhe vërteton faktin se në strukturën leksikore e fjalëformuese të shqipes letrare “janë gjallëruar shumë e veprojnë kryesisht ato mënyra e mjete që e thellojnë në përgjithësi në gjuhën tonë (sidomos në të shkruarën) prirjen drejt sintetizmit: formimet me ndajshitesa dhe fjalët e përbëra janë bërë rrugët kryesore për pasurimin e leksikut me vetë mjetet e shqipes”.<sup>38</sup>

Në procesin e zhvillimit dhe të pasurimit të pandërprerë të gjuhës sonë letrare janë vënë dhe po vihen në veprim ato mundësi të mëdha potenciale që ka sistemi fjalëformues i gjuhës sonë, gjë që duket qartë në fjalësin e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe 1980 dhe 2006. “Struktura fjalëformuese e gjuhës letrare shqipe duke qenë, krahas asaj leksikore, një nga “strukturat më të hapura e dinamike” thith vazhdimisht krijimet popullore me vlerë, të formuara sipas gjedheve më aktive e më productive të gjuhës shqipe”.<sup>39</sup>

Shtimi i fjalëve të reja në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe nuk është vepër vetëm e specialistëve të gjuhës sonë, apo e një rrethi të ngushtë njerëzish që njohin e përdorin gjuhën e sotme letrare shqipe, por edhe e atyre që zgjedhin, nga përbërja leksikore e përgjithshme, fjalët dhe shprehjet më të domosdoshme për shoqërinë, pra është vepër edhe e masës së gjerë të njerëzve, shkrimtarëve, arsimitarëve, publicistëve, specialistëve, teknikëve dhe punonjësve të degëve të ndryshme të prodhimit të ekonomisë, politikanëve dhe veprimtarëve shoqërorë, të cilët, të gjithë sëbashku, përpunojnë gjuhën tonë letrare.

Kjo masë e mjeshtërive të fjalës, që përfshin njerëz nga të gjitha shtresat e popullit, është krijuesja e një pasurie të gjithanshme gjuhësore, midis tyre edhe e fjalëve të reja të prejardhura dhe të përbëra, që përdoren sot në letërsinë artistike e shkencore, në veprat politiko-shoqërore e didaktike, në botimet e ndryshme shtetërore etj., dhe si të tilla janë përfshirë në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Këto krijime kanë pasuruar kështu fondin leksikor të gjuhës letrare shqipe dhe i kanë dhënë e i japin asaj mundësi për të përmbushur ato nevoja që i dalin kohë pas kohe në procesin e zhvillimit të vrullshëm të jetës sonë në të gjitha aspektet.

---

<sup>38</sup> Kostallari, A. Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare, “Studime filologjike”, nr.2, 1982, f.23.)

<sup>39</sup> Kostallari, A. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, referat, Tiranë, 1984, f.27.

### 3.3 NDIKIMI I LEKSİKUT DIALEKTOR NË SHTIMIN E FJALËVE NË MAKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES TË GJSH

Fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe kanë përfshirë në fjalësin e tyre një numër të konsiderueshëm njësisish leksikore popullore, me prejardhje dialektore ose krahinore, si ngulitje e tyre në forma e kuptime të veçanta. Prania e leksikut popullor është në përmasa të ndryshme në fjalorë të ndryshëm shpjegues, derisa “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, e ka kufizuar këtë psqyrim në makrostrukturën e tij, por një pjesë e këtij leksiku është futur në fjalësin e fjalorit pa shënimin përkatës. Edhe sot leksiku i shqipes megjithëse është shumë më i pasur, përsëri pasqyrohet në mënyrë të kufizuar. Për pasqyrimin e këtij leksiku dhe shtimin e leksikut të pasqyruar në përgjithësi, A. Kostallari shprehet: “Ky fond ushqehet sot nga dy burime kryesore: **a)** nga formimi i fjalëve të reja mbi bazën e atyre ekzistuese dhe **b)** nga gjuha e folur e popullit, nga leksiku i ashtuquajtur krahinor, dialektor, i cili herë përdoret në të dy dialektet, herë përdoret vetëm në njërin prej tyre...Pikërisht këtu qëndron detyra kryesore e tij informuese- të bëjë të njohur në botën letrare e në masa sa më të gjera atë pasuri të madhe leksikore-frazeologjike të gjuhës së folur të popullit tonë, që deri më sot nuk është pasqyruar nëpër fjalorë e botime, por që është e parapërcaktuar historikisht të bëhet pjesë e pandarë e fondit leksikor të gjuhës sonë letrare kombëtare”.<sup>40</sup>

Midis gjuhës letrare dhe dialekteve vendosen marrëdhënie të caktuara, të cilat ndryshojnë vazhdimisht. “Gjuha jonë letrare e sotme - thekson A.Kostallari - u krijua si një gjuhë me të vërtetë kombëtare, mbidialektore e me vlera shoqërore të gjithanshme”<sup>41</sup> Leksiku dialektor e krahinor është burim pasurimi për gjuhën letrare, sepse siç thotë E.Çabej “...pasuria gjuhësore që rron në dialekte vazhdon të përbëjë një gurrë ende të pasërshme”.<sup>42</sup> Kjo e bën të kuptueshme vendosjen e marrëdhënieve të karakterit marrës e dhënës midis gjuhës letrare dhe dialekteve. Gjuha letrare ka thithur nga leksiku dialektor dhe ka bërë pronë të saj shumë njësi, të cilat kanë fituar vlerë mbidialektore. Kjo shtresë fjalësh që ka hyrë në leksikun e gjuhës letrare, sa vjen dhe rritet. Sipas kohës së hyrjes e përgjithësimin në normë këto fjalë mund t’i klasifikojmë:

- Fjalë që kanë hyrë para kristalizimit të normës së gjuhës letrare.(bishtajë, mashtroj etj)
- Fjalë që janë marrë gjatë fazës së kristalizimit të normës së gjuhës letrare. (almisë, gëmushë, hulli etj.)
- Fjalë të reja që shtohen vazhdimisht në fjalësin e gjuhës letrare. (emnak, përdhej etj).

<sup>40</sup> Kostallari, A. Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” në Studime filologjike, nr.2, Tiranë, 1968, f.56-57.

<sup>41</sup> Kostallari, A. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Tiranë, 1980, f. 9.

<sup>42</sup> Çabej, E. Studime etimologjike në fushëtë shqipes, I, Tiranë, 1980, f.36.

Gjuha letrare shqipe ka nevojë të plotësojë sistemin e vet leksiko-semantik, prandaj i është drejtuar gjithë hapësirës gjuhësore shqipe, jo vetëm dialekteve që përfshihen në truallin e shtetit të sotëm, por edhe nëndialekteve jashtë këtij trualli, si Kosovë, shqiptarët e Maqedonisë e Malit të zi etj. Pra gjuha letrare shqipe vazhdon të thithë vlera, pavarësisht se nga cilat troje vijnë ato. I vetmi kriter vlerësues për këto njësi është vlera që i sjellin fjalorit të gjuhës letrare e sistemit stilistikor të saj.

Leksiku dialektor e krahinor, duke qenë lëndë potenciale pasuruese e gjuhës letrare shqipe, është e natyrshme që shumë fjalë dialektore e krahinore, për shkak të vlerave që kanë, kapërcejnë kufijtë dialektorë e bëhen pronë e gjuhës letrare duke fituar kështu status mbarëkombëtar. Ky kapërcim nuk është thjesht ndërrim mjedisi, por siç argumenton J.Thomai, është një proces që shoqërohet me ndryshime kuptimore, shprehëse emocionale ose lidhje sintagmatike e paradigmatiske. Ky është ndryshim në përmbajtje, pasi “shumë herë ndryshimi themelor gjatë mbartjes së njësisë nga dialekti në gjuhën letrare, e sidomos në terminologji, është ndryshim në përmbajtje, aq sa mund të flitet për një shndërrim semantik. Duke qenë se ky shndërrim semantik bëhet pothuajse përherë në mënyrë të vetëdijshme, të qëllimshme (nga terminologët, shkrimtarët etj.), ai është po ashtu përherë pothuajse i motivueshëm”.<sup>43</sup> Këto fjalë që kalojnë në shtresim gjuhësor mbarëkombëtar e zgjerojnë kuptimin e tyre. Ky zgjerim kuptimi shkakun e ka te zgjerimi i përdorimit të fjalës si rezultat i kapërcimit të pragut dialektor. Pra kalimi i fjalës nga një sistem gjuhësor më i ngushtë në një sistem gjuhësor më të gjerë shoqërohet me lëvizje kuptimore. Një fjalë hyn në leksikun e gjuhës standarde kur:

- Emërton një nocion të ri.
- Sjell një nuancë të re kuptimore.
- Sjell një kuptim të ri.
- Sjell një përdorim stilistikor

“Nga pikëpamja e vlerave konkrete që i sjellin gjuhës letrare shqipe, fjalët me burim popullor mund të ndahen përgjithësisht në dy grupe:

1. Njësi leksikore që shënojnë realie dhe dukuri lokale, të cilat nuk kanë emërtime në gjuhën letrare.
2. Njësi leksikore që shënojnë realiedhe dukuri, të cilat në gjuhën letrare kanë mjete shprehjeje sinonimike”.<sup>44</sup>

---

<sup>43</sup> Thomai, J. Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme, Tiranë, 2001, f.50.

<sup>44</sup> Shehu, H. Rreth vlerave potenciale të leksikut popullor për gjuhën e sotme letrare, në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” III, Tiranë, 1989, f.351.

Gjuha letrare ka nevojë për njësitë leksikore që emërtojnë nocionet e reja, sepse me to ajo plotëson zbrazetitë që ka për njësi emërtuese. Këto fjalë mbulojnë të gjitha fushat ku shtrihet veprimtaria e krijuesve dhe e përdoruesve të tyre. Ato shënojnë nocione që janë karakteristike për jetën e jetesën e bartësve të një të folmeje. Në këtë leksik gjejmë një larmi emërtime duke filluar që nga emërtimet e veshjeve, zakoneve e traditave të vendit, të gatesave e mënyrave të gatimit, të sendeve e paisjeve shtëpiake, veglave bujqësore, mjeshtërive e zejeve popullore, emërtime bimësh barishtore e pemësh frutore, të botës shtazore etj. P.sh.

*Zjarrmi~a* (përmbledhës) të nxehtë i lartë nga ethet:s'i bie zjarrmia; *fjalëtar~i*, - ai që çon lajmin te miqtë e te farefisi për vdekjen e dikujt; *leopardhë~a*, një krah fier, kashtë gruri etj., i lidhur në një shkop të gjatë që ndizej netëve në prag të festës së Shëngjergjit; *vjelacake~ja*, shportë e vogël për të vjelë rrush, pemë etj; *maz/ë~a*, ajkë qumështi, lloj djathi me shumë yndyrë,/ *gjell*. gatesë me këtë lloj djathi. 2. shtrap; perde: maza e qepës vemesë, i kanë zënë sytë mazë; ferrëgjatë,~i -një lloj brejtësi me gjemba të gjatë, iriqi; drithatore,~ja - grua që përgatit drithin për ta çuar në mulli; endëz,~a - bimë e egër barishtore shumëvjeçare, me rrënjë si xhufkë, me kërcell të degëzuar, me gjethe të gjata e të holla, që përdoret për të bërë lakror; *bardhushkë,~a*, bimë barishtore e egër me zhardhokë të bardhë etj.

Po kështu shumë kuptime krahinore pasurojnë strukturën kuptimore të shumë fjalëve të njohura të shqipes letrare ose kuptime me ngjyrimë stilistikore. P.sh.*bjeshkë~a*, -përveç kuptimeve të tjera ka edhe kuptimin “erë që vjen nga bjeshka”; *të falat* - ka edhe kuptimin “dhuratë që sjell nusja”. Në planin kuptimor fjala dialektore që formon sinonimi me një fjalë të gjuhës letrare diferencohet prej saj edhe lidhur me mënyrën e shprehjes së vetë nocionit ose me saktësimin a specifikimin e nocionit. Kështu p.sh. sinonimet *delmere* - *bishtatundës*, *vezulloy* - *xixëlloj*, *grykosem* - *përqafohem* etj., dallohen prej njëri-tjetrit nga fakti se nga ç’këndvështrim e shohin sendin a veprimin, nga mënyra se si e shprehin nocionin dhe me çfarë e lidhin shprehjen e tij. Kështu, ndërsa te *bishtatundës* nocioni lidhet me vetinë e këtij zogu për të tundur gjithnjë bishtin kur ecën, te *delmere* lidhet me qëndrimin e tij pranë deleve.

Në planin stilistikor emocional ajo që dallon disa fjalë dialektore a krahinore nga sinonimet e tyre të gjuhës letrare është ngjyrimi i veçantë shprehës emocional ose stilistik i tyre. P.sh. *bërdokull* në krahasim me *gungë*; *hallakatje* në krahasim me *shpërndarje*; *gaxhakutem* në krahasim me *hutohem*, *habitem* etj. Por ka dhe fjalë ku kuptimi i figurshëm shprehës-emocional zhvillohet dukshëm e motivohet me një formë të brendshme të kapshme. P.sh. *i verdhë*, asnjane - *verdhacuk*, emocionale, ose *dembel*, *anjanës* - *hilenec*, emocionl etj.

Një fushë e aktivizimit të leksikut krahinor në gjuhën letrare është terminologjia. Te shumë fjalë krahinore ose me burim krahinorë të bërë rikuptimësimi terminologjik, duke u ngritur këto fjalë nga rrafshi dialektor në fushë të terminologjisë tekniko-shkencore dhe më tej në rrafshin e gjuhës letrare, pra, bëhen pjesë e saj.

Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe gjejmë dy tipa strukturorë të terminologjizuar me lidhje të drejtpërdrejta me leksikon dialektor:

**a).** Krahinorizma të terminologjizuara si fjalë a kuptime, si: *cali (min.)* “hapësirë e rrumbullakët në minierat e nëndheshme, që shërben për të lidhur dy galeri në vendin e nxjerrjes së mineralit (FGJSSH 1980, f.213); në FGJSH 2006, shënohet me shkurtimin *tek. oxhaku* i minierës, (FGJSG 2006, f.126).; *cupil, min.* tra i shkurtër për të mbajtur tavanin e galerisë, (FGJSSH, f.234; FGJSH 2006, f.141) , *cung, gjeom.* “trung i një trupi gjeometrik”; ffillues gjuh. “që lidh një fjali të varur, e cila sqaron kuptimin e foljes”; *ndishk, mjek* “tuberkoloz” etj.

**b).** Emërtime të pathjeshta me gjymtyrë krahinore të terminologjizuara. Në fushën e botanikës gjejmë shumë të tilla, si: bari i cikës, “bimë si borziloku”; bar pasrregulli “bimë barishtore me lule te kuqe; bar shpirre “kuskutë”; bar tambli “qumështore” etj.

Kjo rrugë është e gjallë e mjaft vepruese, sepse pajtohet me parimin e përgjithshëm të mbështetjes së gjuhës letrare në truallin popullor. Një fjalë dialektore sapo nis të përdoret nga folësit e gjuhës letrare, nuk është më fjalë potenciale për t’u futur në fjalorin shpjegues të gjuhës, por ajo shkon drejt përgjithësimit dhe fiton kështu vlera reale. Në këto fjalë vihet re një kohë relativisht e shkurtër gjatë së cilës ato fitojnë të drejtën të bëhen njësi e zakonshme e gjuhës letrare shqipe. Këto fjalë sapo hyjnë në gjuhën letrare e humbasin ngjyrimin vendor e bëhen pronë e gjuhës letrare dhe jo rrallë ndryshojnë edhe kuptimet e tyre (p.sh *pazarllëk* në përdorimin keqësues në shtyp, është “marrëveshje e ulët dhe e pandershme). Mjaft fjalë të tjera me burim popullor fitojnë rikuptimësim të figurshëm ose terminologjik. Pikërisht ky rikuptimësim është edhe dëshmi e përvetësimit të tyre nga gjuha letrare.

Hyrja e një njësie leksikore me burim dialektor e krahinor dhe përpunimi i saj në gjuhën letrare varen nga faktorë brendagjuhësorë e jashtëgjuhësorë. Faktorët brendagjuhësorë kanë të bëjnë me prirjet e kërkesat e gjuhës, sepse vetë gjuha letrare ka nevojë që të plotësojë sistemin e vet leksikor me mjete të reja gjuhësore. Kështu p.sh. gjuha e sotme letrare parapëlqen folje me prejardhje krahinore me **-oj**, të cilat kanë gjetur pasqyrim edhe në fjalorët shpjegues 1980 e 2006, si: *drunoj, drynoj, shterpoj, vajoj* (kur është dhe *vajos* f.1151, Fjalori 2006) etj. Siç kemi parë edhe te vëzhgimi i grupit paradigmatic folje - emër veprimi -mbiemër prejpjesor (në kapitullin përkatës), klasa e foljeve më-*oj* po tërheq pothuajse të gjitha formimet e reja dhe po bëhet kështu tipi me



prodhimtari më të lartë. Fjalët kur janë futur në gjuhë nga dialektet, janë pranuar duke u përpunuar sipas sistemit fonetik e gramatikor të shqipes letrare, kurse frazeologjitë, kur s'kanë pasur probleme fonetike dialektore kanë hyrë pa asnjëkufizim krahinor.

Shkaqet jashtëgjuhësore kanë të bëjnë me historinë e kulturës, pasi ato fjalë mund të jenë emërtime etnografike, emërtime të bimëve, fjalë që kanë qenë potenciale, por janë bërë pronë e shqipes letrare. Letërsia artistike, letërsia politike e shkencore, media e shkruar e elektronike etj., janë rrugë që rrezatojnë në mënyrë të gjerë risitë e gjuhës së sotme letrare shqipe, që mund të pasqyrojnë jo vetëm atë që tashmë është arritur, por edhe prirjet e sotme e të ardhshme të zhvillimit të gjuhës. Kjo arrihet atëherë kur zbulohet, vilet e përvetësohet në mënyrë të sistemuar pasuria leksikore e popullit. Gjuha e letërsisë artistike ka “mundësitë më të mëdha për të qëndruar fort në truallin e gjuhës popullore e për t'u ushqyer prej saj dhe njëkohësisht për t'u lidhur më ngushtë me traditën e gjuhës letrare, sepse në asnjë fushë gjallëria e forca e gjuhës letrare nuk është aq e fuqishme e jetëgjatë sa në letërsinë artistike”.<sup>45</sup>

---

<sup>45</sup> Kostallari, A. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jone, Studime filologjike, nr.4, Tiranë, 1984, f.50.

### 3.4 GRUPET TEMATIKE ME BURIM POPULLOR TË PASQYRUARA NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS

Njësimit i gjuhës letrare kombëtare është një arritje e madhe kulturore e popullit tonë dhe shkencës sonë gjuhësore, prandaj pastrimi dhe pasurimi i saj ka qenë dhe mbetet detyrë parësore e vetëqenies kombëtare. Gjuha amtare kombëtare është variant i gjuhës së përbashkët, “ajo është forma e një shkalle më të lartë zhvillimi të gjuhës së përbashkët në stadin e sotëm dhe është një tërësi më e thjeshtë, është një sistem i vetëm, me të cilin mund të krahasohen më lehtë dialektet”.<sup>46</sup>

Shqyrtimi i hollësishëm që i kemi bërë fjalësit të shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, Ll, O, në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, tregon se këta fjalorë kanë pasqyruar një lëndë të bollshme të fjalëve me burim popullor, që lidhet me disa fusha leksikore të mjedisit shqiptar, si ajo e botës bimore e shtazore, me kulturën materiale e shpirtërore, me doket e zakonet etj., që e pasurojnë më tej me njësi të tjera leksiko-semantike fjalësin e këtyre fushave, duke zgjeruar kështu jo vetëm leksikun me lëndë shqipe, por edhe informacionin gjuhësor për botën shqiptare. Njësitë leksikore nga të folmet e shqipes, që fitojnë status kombëtar, pasurojnë gjuhën letrare me fjalë e shprehje që jetojnë në ligjërimin popullor, sepse hyrja e tyre në leksikun e gjuhës letrare është një rrugë pasuruese e njohur.

Kjo ka vlerë të veçantë për gjuhën shqipe, pasi rruga e pasurimit të leksikut me fjalë dhe shprehje që rrojnë në ligjërimin popullor, është me rëndësi të dorës së parë, sepse dihet historikisht që gjuha shqipe ka traditë shkrimore të vonshme e për pasojë leksiku i saj është pasqyruar në mënyrë të kufizuar në gjuhën e shkrimit. Për këtë arsye pasuria leksikore e saj duhet kërkuar jo vetëm te botimet, por edhe te gjuha e gjallë e popullit.

Në fjalësin e shkronjave qëshqyrtuam, pamë se zënë vend e bashkëveprojnë si fjalët e burimit popullor që bëhen pronë e gjuhës letrare, ashtu edhe ato që krijohen nga zhvillimi shoqëror i kohës sonë, pasqyrohen kështu lidhjet e ngushta të gjuhës sonë letrare me gjuhën e folur të popullit, të cilat kanë qenë gjithnjë tipar themelor i saj e që ruhet e forcohet në kohën tonë.

Siç dihet, fjalët me burim popullor kanë hyrë në fjalorët shpjegues të gjuhës sonë, kur i kanë sjellë diçka të re fjalorit të gjuhës letrare dhe kanë ndikuar në pastërtinë e saj, kur kanë sjellë ndonjë element plotësues leksikor, stilistikor etj. Për fenomenin e pasurimit të leksikut të përgjithshëm letrar me fjalë dialektore e krahinore H. Shehu shprehet: “Shumë njësi dialektore shpejt fitojnë të drejtën e qytetarisë dhe bëhen pronë e gjuhës letrare. Ato sapo hyjnë në gjuhën letrare e humbasin ngjyrimin vendësor e bëhen pronë e gjuhës

---

<sup>46</sup> Dialektologjia shqiptare, vëll. VI, Tiranë, 1990, f.15.

letrare dhe jo rrallë ndryshojnë dretpërsëdrejti edhe kuptimet e tyre. Mjaft të tjera me burim popullor fitojnë rikuptimësim të figurshëm ose terminologjik. Pikërisht ky rikuptimësim është dëshmi e përvetësimit të tyre nga gjuha letrare”.<sup>47</sup> Analiza semantike e këtyre fjalëve tregon se në gjuhën e sotme letrare kemi të bëjmë me një larmi të madhe grupesh tematike, me gjerësi pasqyrimi të ndryshme në fjalorët shpjegues të saj.

### ❖ Grupi tematik i emrave

Në makrostrukturën e fjalorëve, leksiku i gjuhës letrare shqipe është zgjeruar e pasuruar me **emërtime të botës bimore e shtazore**. Në pjesën më të madhe këto emërtime janë bërë sipas tipareve dalluese të jashtme të bimëve, kafshëve, ose sipas vetive të tyre, p.sh. *Krahkuqe-ja*- emër dhie që ka qime të bardhë, por njërin krah e ka të kuq; *bishtgjel/-e/ja* -- rosë e egër me bisht të gjatë si të gjelit; *bukje/-a*= kashtë kënete me kërcell të mbushur e të butë; *dhishkë/-a*=dele e murrme; *grunabardh/-i* =lloj gruri që bën kokrra të bardha; *bishtkuq/-i* = zog i vogël, këndues, me pendë të murrme në të zezë, me bisht të kuq; *imshtak/-u*= dru i ri, lis i ri, filiz; *lulegoj/ë-a* = gojasllan, gojujku; *lumak/-u*= degë të holla që sjell lumi; *mushtak/-u*= rrush i ëmbël e me shumë lëng, që përdoret sidomos për të bërë pekmes; *pendëkaposh/-i*= bimë barishtore shumëvjeçare me degë të holla që kanë në krye kallinj të vegjël me fara, me majë të hollë e me gjemba të kthyer prapa; *thanec/-i*= rrush thanës; *thekëkuq/-i*= lloj gruri kokërrvogël me hala të kuqërremta; *groshon/-e/-ja*=ngastër e mbjellë me grosh/ vorbë për të zjerë groshët; *brithekre*= lloj kërpudhe në trajtë brirësh të zinj që del në kallinj të thekrës. Te këto fjalë vihet re prirja e gjuhës për emërtime njëfjalëshe si p.sh.: *gjurmë mushke-gjurmëmushk/ë-a*; *lule dimri- luledimër*; *lule shqiponjë- luleshqiponjë*; *lulekadife*; *lulekambanëetj*.

Në leksikon e pasqyruar në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe të shumta janë edhe fjalët që emërtojnë **mjete të ndryshme**, vegla pune, enë e orendi shtëpiake, veshje ose pjesë të tyre, të cilat e kanë pasuruar mjaft, veçanërisht, makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe 1980 dhe 2006, p.sh.:

*Dorak/-u*= doreza e vogël e një vegle, e një mjeti ose e një përdorëseje; *dhëmbec/-i*= krëhër i avlëndit; *beretë/-a*= kapelë e sheshtë e pa strehë; *breshan/-e/-a*= pushkë me strall me tytë të gjatë; *barkësor/-e/-ja*= diçka që bëhet ose që mbushet me leshin e qethur nga barku i dhenve a i dhive; *birës/-e/-ja*= çekan ose daltë me majë që përdoret për të hapur vrima; *eshkëtor/-e/-ja*= qese e vogël për të mbajtur eshkën, gurin e zjarrit dhe urorin; *jakor/-e/-ja*= veshje popullore e leshit me jakë të madhe për të mbajtur veshët; *kryqësor/-e/-ja*= tra a binar që vihet kryq e tërthor me një tjetër, tërthorëse; *pengoj/ë-a*= pengore kafshësh; *kullues/-e*= enë me vrima të vogla për të kulluar; *peshti/-a*=

<sup>47</sup> Shehu, H. Mbi pasqyrimin e leksikut popullor me vlerë letrare potenciale në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, në “Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989, f.616.

xhamadan burrash me mëngë të çara nën sqetull që zakonisht rrinë varur prapa; *mëngore/-ja*= veshje e sipërme grash, e gjatë deri në bel, me mëngë të gjata e të gjera (në veshjet kombëtare), veshje e sipërme foshnjash si bluzë me mëngë; *shalok/-u*= vegël si kompas me hapje të këmbëve dy metra, që përdoret për të matur tokën për nevoja bujqësore; *thundraç/-i*= thikë e lugët për të prerë thundrat e kafshëve para se të mbathen; *petavër/-a*= dërrasë e hollë dhe e ngushtëqë përdoret për të mbuluar çatinë e shtëpisë nën tjegullat; *potkua*= pllakë e hollë a copë prej metali, e kthyer si hark, me të cilën mbathin kafshët e barrës; *qap/-ë/-a*= 1.pengojcë prej druri, në trajtë bige, që i vihet kalit në këmbët e para. 2. mandelli i derës ose i dritares; *qajkë/-a*= kunj druri a hekuri që mbërthen zgjedhën me shtizën e parmendës a të qerres etj.

Fjalë të tilla janë të shumta në fjalor, ndaj nuk e kemi parë të nevojshme e as të arsyeshme të pasqyrojmë më shumë, pasi edhe vetëm këto tregojnë qartë se ky grup fjalësh është i shumtë e i larmishëm dhe me mundësi të mëdha pasqyrimi të jetës së popullit e për pasurimin e leksikut të gjuhës shqipe.

**Emërtimet e vendeve** janë një tjetër mundësi e pasurimit të leksikut të gjuhës shqipe. Ato hasen shpesh në përdorim dhe për këtë arsye kanë zënë vend të konsiderueshëm në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe. Fjalë të tilla janë emra që tregojnë vendin a tokën që mbillet nga njerëzit me bimën, drurin a pemën e shënuar nga tema fjalëformuese, vendin i cili ka një tipar a një karakteristikë që shënohet nga tema fjalëformuese, që përmban sendin e shënuar nga kjo temë etj. si p.sh. :

*Arishte/-a*= arë e vogël, vend me ara; *arrishtë/-a*= pyll me arra; *ahishtë/-a*= pyll me dru ahu; *ajkësinë/-a*= tokë e butë që mban ujë; *brinjore/-ja*= vend brinjë në kodër ose në mal; *dherishtë/-a*= vend tërë dhe; *blinishtë/-a*= pyll bliri; *bokërimë/-a*= vend gurishte, bokë; *botinë/-a*= vend me botë, moçalishte; *burishte/-a*= vend me burime të vogla uji; *dushkajë/-a*= pyll akorije me dushqe; *pellgishte/-ja*= vend me pellgje të vogla; *thellomë/-a*= vend i thellë në det, në liqen a në lumë; *thepajë/-a*= vend me thepa, vend i thepisur; *theqafje/-a*= vend që zbret thikë, greminë; *kripërishtë/-a*= tokë e kripur e jopjellore; *lirishtë/-a*= livadh i vogël në mes të pyllit, çeltinë; *livadh/-i*= fushë a shesh i madh me barë të njomë, pa drurë e shkurre; *llumishtë/-a*= vend i mbushur me lym, lymore; *ujorë/-a*= ligatinë; *rujishtë/-a*= gropë e madhe në bjeshkë e mbushur me borë; *zhavërrimë/-a*= vend me shkurre të parritura ose të thara etj.

Një vend të konsiderueshëm zënë në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe të viteve 1980 dhe 2006, fjalët me burim popullor, por që nuk kanë gjetur vend pasqyrimi në fjalorët para “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” 1980, të cilat **emërtojnë njerëz sipas vetive** të tyre të përhershme apo sipas tipareve të tyre dalluese, sipas një gjendjeje të caktuar të tyre, sipas punës që bëjnë a sipas vendit ku jetojnë. Ky grup emrash e ka shtuar e po e shton në mënyrë të konsiderueshme fjalësin e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe e po zë

një vend gjithmonë e më të qëndrueshëm, gjë që vihet re gjatë krahasimit të leksikut të dy fjalorëve më të mëdhenj shpjegues të gjuhës sonë deri më sot, “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe “Fjalorit të gjuhës shqipe” 2006. Këtu po japim disa nga emrat e pasqyruar në të dy fjalorët shpjegues:

*Bari/-u*= ai që ruan e kullotë bagëtitë, çoban; *barkaç/-i*= njeri me bark të madh; *dhëndërrush/-i*= (mospërfillës) burri që dikush kërkon t’ia japë me detyrim një vajze, dhëndërr i gjetur me mblesëri, ai që kërkon të bëhet dhëndërr me pahir; *dhënës/-i*= ai që i jep a i dorëzon dikujt diçka, dorëzues; *dhogaç/-i*= (mospërfillës) njeri tepër i gjatë e i hollë, stërhell; *ëmbëltor/-i*= ai që merret me gatimin e ëmbëlsirave; *hundës/-i*= ai që flet me hundë; *fagotist/-i*= ai që i bie fagotit; *ikacake/-ja*= grua që e ka lënë burrin; *lëneshë/-a*= vajzë e shkuar në moshë, që ka mbetur pa u martuar; *motërzezë/-a*= motër që ka mbetur pa vëlla, motër e shkretë pa mbështetje e përkrahje, e zeza motër; *shelegar/-i*= bariu që kullot shelegët; *thadërtar/-i*= ai që punon me thadër, ai që thadron; *mollapjeshkë/-a*= vajzë a grua e re, e shëndoshë dhe me faqe të kuqe; *thërritës/-i*= (në etnografi)= thirrës; *vëngarash/-i*= ai që i ka sytë të shtrembër, që sheh shtrembër; *vigtar/-i*= ai që mban vigun; *xhelat/-i*= ai që zbaton dënimet me vdekje ose dënimet trupore; *xhepush/-i*= vjedhës xhepush etj.

Nga emërtimet popullore, grupe të tjera që pasurojnë leksikun, mund të përmendim edhe **emërtimet popullore të sëmundjeve** të njeriut, të kafshëve dhe të bimëve, emërtimet e pjesëve dhe organeve të trupit të njeriut ose të kafshëve, të gjellëve, gatesave e pijeve të ndryshme etj. p.sh. : *mollur/-e/-ja*= sëmundje që prek gjethet e qepëve, të duhanit etj, dhe i than ose i djeg(bastër në krahinorizëm); *gurth/-i*= trup i vogël i ngurtësuar brenda një organi të sëmurë, çmërs, fillesa e gjinjve te vajzat në pubertet; *idhc/-ç/-a*= fshikçza e tëmthit; *dhjamushe/-ja*= copë dhjami e patretur, copë mishi me shumë dhjamë; *flakor/-i*= bukë e hollë e pjekur me një flakë; *gjizëtole/-ja*= tavë me miell misri, me gjizë e me qepë; *trazak/-u*= byrek me trahana, bukë e zënë pa maja; *yshmer/-i*= ëmbëlsirë që bëhet me ajkë qumështi, me vezë dhe me petë të thërmuara; *thanake/-a*= reçel ose shurup thanash etj.

### **Grupi tematik i mbiemrave**

Përveç emrave, edhe mbiemrat me burim popullor nga i gjithë trualli i shqipes, kanë pasuruar fjalorin e gjuhës letrare shqipe. Në mbiemrat me burim popullor, si më të spikaturit mund të dallojmë këto grupe:

- Mbiemra të formuar me parashtesën **pa-**, nga pjesoret e mbiemëruara me të cilat formojnë çifte antonimike, p.sh. *i palidhur*= që nuk është i lidhur; (*i, e*) *pamarrëvesh*= që nuk merr vesh, i padëgjueshëm, kokëfortë; *i pashtruar*= në kuptimin: 1. që nuk është shtruar për të ngrënë e për të pirë (tryeza); 2. që nuk

është shtruar me qilim e me mbulesë etj. 3. që nuk është shtruar me gurë, me asfalt etj. (rruga), me dërrasa (dysHEMEJA) etj. 4. që s'rri lëmuar pasi është krehur, që rri përpjetë (për flokët); (*i, e*) *pazbutur*= që s'është zbutur ende (për kafshët), që s'është përmirësuar me anë të shartimit (për pemët); *i pavararë*= në kuptimet: 1. që s'e ka lodhur e plakur jeta; që s'ka përjetuar vuajtje, 2. që s'është rrahur për t'i marrë gjalpin (qumështi); *i pasherr*= 1. që nuk zihet me të tjerët, i urtë, 2. i padjallëzuar, i patëkeq, jo smirëzi.

Mbiemrat e formuar me këtë parashtesë krijojnë antonime me përgjegjëset e tyre pa parashtesë, por kjo antoniminuk shtrihet në të gjitha kuptimet e tyre, gjë që vihet re po të krahasojmë çiftet antonimike: *i shtruar- i pashtruar*.

*I shtruar*= 1. që është shtruar, dhomë e shtruar, rrugë e shtruar, e priti me tryezë të shtruar. 2. i sheshtë, i rrafshët, vend i shtruar. 3. i ngadalshëm, i qetë, shi i shtruar. 4. që nuk ngutet, njeri i shtruar. Siç shihet kuptimi 3 dhe 4 nuk janë të mbiemri *i pashtruar*, si të tillë ata janë antonime, por jo në të gjitha kuptimet e tyre. (këto kuptime të këtyre mbiemrave janë marrë nga Fjalori i 2006-ës).

- Si pjesëtë makrostrukturës, në fjalorët shpjegues, dallojmë edhe mbiemrat me burimkrahinor të formuar me prapashtesa **nga tema mbiemërore, foljore dhe emërore**. Disa nga këta mbiemra tregojnë cilësi fizike të njeriut e të frymorëve të tjerë, tipare që lidhen me pamjen e jashtme të tyre, karakterizojnë gjithashtu njeriun nga pikëpamja e gjendjes dhe e jetës së tij shpirtërore e mendore, ndërsa disa mbiemra të tjerë cilësojnë sende, dukuri të natyrës sipas anëve të ndryshme, p.sh. : *bishtak/-e*= që ka bisht të gjatë, që vjen si me bisht (fik bishtak, dardhë bishtake); *bishtcung/-u*= bishtajore bishtshkurtër; *elbje*= 1. që është si kokrra e elbit (makarona elbje), 2. që piqet në një kohë me elbin (për një lloj dardhë-dardhë elbje); *dhëmbaç/-e*= që i ka dhëmbët të rrallë e të vegjël, që s'ka dhëmbë të rregullt; *imcak/-e (imtak)*= i paktë nga trupi, i imët, që vjen si i imët; *pallosh/-e*= i shëndoshë e faqekuq; (*i, e*) *pakur*= i mpakur, me trup të pakur; *motës/-e*= që rron deri në një vit ose deri në vitin tjetër (dardhë motëse); *turiderr/-e*= që i ka nofullat të zgjatura e të kthyera pak lart si të derrit (sharje); *thonjèzak/-e*= që ka trajtën e thoit (pata thonjèzake) etj. Një pjesë e mirë e këtyre mbiemrave, duke qene se vënë në dukje veçori të trupit apo karakterit të njeriut, të frymorëve apo sendeve të tjera, kanë ngjyrim emocional të dukshëm.

- Një numër i madh fjalësh janë mbiemrat që janë formuar nga **paranyjëzimi i pjesoreve të foljeve** ose me paranyjëzim dhe prapashtesim njëkohësisht, p.sh. (*i, e*) *ardhur*= që ka ardhur; *i dhënë*=(në kuptimet) 1. i falur, i dhuruar, 2. e fejuar, e martuar, 3. dorëdhënë; *i ikur*= 1. i marrë, i çmendur; 2. që nuk shpëton dot nga vdekja, i vajtur; *i mpakur*= 1. që ka mbetur pa frymë, që i ka rënë të fikët; *i*

*mykur*= që vjen në kundërshtim me të renë, që ka mbetur në vend; *i tenjosur*= 1.që e ka brejtur a ngrënë tënjë, 2. që e bren sëmundja, që nuk shërohet; *i myshkët*= që ka zënë myshk, i mbuluar a i veshur me myshk; *i thiktë* = shumë i pjerrët, që vjen si thikë.

- Edhe **përbërja e përngjitja** kanë ndikuar në shtimin e fjalëve mbiemra që kanë gjetur pasqyrimin në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, por më shumë kanë ndikuar mbiemrat me burim popullor që janë fjalë të përbëra. Me përngjitje janë formuar mbiemra nga bashkimi i parafjalës **pa**-me një emër në rasën kallëzore të pashquar dhe nga paranyjëzimi i kësaj përngjitjeje, si: *ipaemër* = 1. që nuk ka emër, që nuk i dihet emri, (mallkim) që mos iu pëmendtë emri, që mos qoftë (*vend i paemër, e solli kokën i paemri*), 2. që nuk e ka emrin e atij që e ka bërë, i panëshkruar, i padorë, anonim (*letër e paemër*), 3. fig. i pashembullt, i padëgjuar, i jashtëzakonshëm (*tradhëti e paemër*), 4. i panjohur, i padëgjuar; *ipagjumë* = që s'ka fjetur, që duket i lodhur nga pagjumësia; *ipazhurmë* = 1. që s'bën zhurmë, që bëhet pa zhurmë, 2. fjalëpak, i urtë, i heshtur, i qetë etj.
- Nga pikëpamja e karakterit leksiko-gramatikor të përbërësve të këtyre fjalëve, dallojmë mbiemrat e tipit *emër + emër*, *emër + mbiemër*, *emër + pjesore*, *emër + ndajfolje*, *emër + pjesore e paraprirë nga pjesëzat mohuese*. Ndërsa në aspektin kuptimor dallojmë mbiemra të përbërë që tregojnë cilësi fizike e trupore të njeriut dhe frymorëve të tjerë, mbiemra që kanë ngarkesë të dyfishtë kuptimore etj. p.sh. *barkngopur*= që është gjithnjë i ngopur; *barkngushtë*= zemërngushtë, dorështrënguar ( e kundërta barkgjerë); *barkdreq*= ai që rron në kurriz të të tjerëve;*barkdosë*(sharje)= barkmadh; *cullufeverdhë*= me cullufe, (tufë flokësh të dredhura mbi ballë ose në tëmbtha) të verdhë, flokëvevdhë; *dhëmbëdalë*(edhe sharje)= që ka disa dhëmbë të dalë përpara të tjerë; *dhëmbëhapur* = 1.që i ka dhëmbët larg njëri-tjetrit, 2. që qesh vazhdimisht me shkak e pa shkak, dhëmbëjashtë; *dhëmbëprishur* = që i ka dhëmbët të prishur, dhëmbëkrimbur; *halëzi* = që i ka halat e kallirit të zeza; *halëbardhë* = që i ka halat e kallirit të bardha (grurë halëbardhë); *irëmadh* = trim i çartur, sypatrembur; *jetëngrysur* = që është në fund të jetës, që është në prag të vdekjes; *jetëpasosur* = që nuk i ka mbaruar jeta, që ka vdekur i ri; *kërcigjatë* = që i ka kërcinj të gjatë; *këmbëlesh* = 1. që i ka këmbët me lesh, që i ka këmbët me pupla (shpendët), 2. që e ka kërcellin me push (duhan këmbëlesh); *moshëthyer* = që është në moshë të thyer, plak ose plakë; *mustaqefshesë* = me mustaqe të gjata si fshesë; *mustaqepadirsur* = që është i ri dhe s'i ka djersitur ende mustaqja, fig. i papjekur dhe pa përvojë në jetë; *mustaqespice* = me mustaqe të

holla e me majë; *perçebardhë* = 1. me perçen të bardhë, (kalë perçebardhë); *qafësorkadhe* = me qafë të hajthme e të bukur (për vajzat dhe gratë) etj.

### **Grupi tematik i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës**

Përveç kategorive të mësipërme leksiko-gramatikore, leksiku i gjuhës shqipe është pasuruar e zhvilluar edhe me folje, me ndajfolje e me pjesë të tjera të pandryshueshme të ligjëratës. Në fjalorin e vitit 2006, ashtu si edhe në atë të 1980-ës, është pasqyruar ky zhvillim, sidomos me foljet që janë formuar me prapashtesën-**o**, që tashmë hyn te prapashtesat e specializuara për të formuar fjalë të reja, si edhe ndajfolje të formuara me prapashtesat më prodhimtare për këtë kategori leksiko-gramatikore : **-as (azi) dhe -isht**, p.sh. : *ashkëloj* = bëj ashkla, e copëtoj; *avulloj* = e kthej në avull (një lëng); *balsamoj* = 1. lyej me balsam a me lëndë tjetër një të vdekur ose një kafshë a shpend të ngordhur që të mos priset, 2. fig. i zbut dhimbjen dikujt, e ngushëlloj; *dertoj* = bisedoj me dikë për një hall, i qaj hallin, ankohe, qahem; *dhelpëroj* = veproj a sillem me dhelpëri; *erëtoj* = mbush me erë, kundërmoj; *furroj* = 1.pjek në furrë, pjek aq shumë sa e djeg, 2. ndez, nxit; *gurron* = 1. del si gurrë, buron, zë fill a nis të dalë ujë i një përroi a i një lumi, 2. rrjedh shumë, derdhet si rrëke, gurronte shiu, 3. e ka zanafillën, buron; *gjethon* = 1.lëshon gjethe të reja, 2. mbushet me gjethe të reja, gjethet, (gjethoi bjeshka, mali), mbulon me gjethet e gjelbra që lëshon, (fieri gjethoi kodrën); *imshtoj* = bluaj (imshtoj drithin, kafënë); *irrnoj* = e bëj të marrë irnë duke e lënë gjatë pa larë; *moshoj* = e rrit a e madhoj dikë, e vjetroj, e plak (jeta na moshoi) etj.

Nga ndajfoljet sjellim shembujt e mëposhtëm: *dheras (dherazi), tejetej, tejefund, dhëndërrisht, vjedhurisht*, etj. Por siç del nga shqyrtimi i materialit leksikor i shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O, pjesët e pandryshueshme të ligjëratës si edhe foljet janë më të pakta në numër se emrat e mbiemrat, që kanë ndikuar më shumë në rritjen e fjalësit në fjalorët shpjegues të gjuhës sonë. Pra emrat e mbiemrat me burim popullor kanë ndikuar më shumë se pjesët e tjera të ligjëratës në zgjerimin e leksikut normativ të gjuhës shqipe, pra me fjalë që kanë marrë status kombëtar.

“Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, megjithëse ka një numër më të madh fjalësh në krahasim me gjithë fjalorët e mëparshëm shpjegues të gjuhës shqipe, përsëri nuk ka pasqyruar gjithë leksikun e mundshëm, pasi këto vitet e fundit ka pasur zhvillime të reja shumë të shpejta leksiko-semantike në shqipen standarde. Këto zhvillime të shpejta leksikore janë pasojë e drejtpërdrejtë e ndryshimeve gjithashtu të shpejta të zhvillimeve politike, ekonomike, kulturore e institucionale nga viti 1990 e këtej. Vendosija e pluralizmit politik, ekonomisë së tregut, hapja e kufijve, hapja e gjithë shoqërisë shqiptare e lidhja e shumanshme me perëndimin, emigracioni intensiv, zhvillimi i madh i medias së shkruar e elektronike, kontakti me zbulimet e shumta shkencore, ndryshimet e thella shoqërore, fetare, kulturore etj., janë disa nga faktorët që bënë të nevojshëm



përdorimin e shumë fjalëve të reja, të vendit e të huaja, për të emërtuar nocione, koncepte, dukuri, sende dhe procese të reja. Kështu, krahas pasurisë së madhe leksikore të burimit popullor, janë dhe këto fjalë që kanë pasuruar leksikun e gjuhës shqipe. Gjithë kjo lëndë e re pret të mblidhet e pasqyrohet e plotë, pasi dhe Fjalori i fundit shpjegues, ai i vitit 2006, nuk e ka pasqyruar të gjithë këtë pasuri leksikore.

Por edhe në këtë ndërmarrje, del problemi i vështirë i seleksionimit të lëndës së huaj të panevojshme, i fjalëve për të cilat gjuha shqipe ka forcën e saj për t'i zëvendësuar. Në fjalorët shpjegues të gjuhës sonë 1980 dhe 2006, vihet re se shumë nga vargjet sinonimike janë zgjeruar e plotësuar me fjalë e togfjalësha, p.sh. : *dhëmbë-grabujështë* zgjeruar me *dhëmbore* (që lidhet me dhëmbët); *hollësi-imtësi* është zgjeruar me *imti* (imtësi), *hollësi*, 2. fig. mendjemprehtësi, zgjuarësi (plak me imti); *pengë-pjekë-pengojcështë* zgjeruar me *pengorepengojë*= litarë në këmbët e kafshës që e pengon të largohet (pengore kuajsh), 2. hu që futet në pendët e fletës së mullirit për të ndaluar rrotullimin e saj (hoqi pengoren e lëshoi mullirin); *shqetësohem-mërzitëm* me *tanothem* (*shqetësohem*, *ngacmohem*); *thahem-dridhem-ftohem* me *tratarosem*; *gjysh-babagjysh* me *tatëzot* etj.

Në shembujt e shumtë që sollëm ne argumentuam konstatimin e bërë nga studiuesit, se leksiku krahinor e dialektor, leksik me potencial të madh shprehës e pasurues për gjuhën, ka ndikuar shumë në pasurimin e leksikut normativ në gjuhën shqipe, në shtimin e fjalësit, e si rrjedhim në pasurimin e makrostrukturës së fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe. Ky proces është i hapur për të vazhduar, veçse kërkon interes të gjuhëtarëve leksikografë për ta konstatuar e vlerësuar si të mundshëm për t'u bërë pjesë e leksikut me status kombëtar.

### 3.5 KATEGORITË LEKSIKO-GRAMATIKORE ME ZHVILLIM MË TË MADH

Vëzhgimi nga pikëpamja e kategorisë leksiko-gramatikore të cilës i përkasin fjalët jo të parme, në shkronjat që po analizojmë, tregon se numrin më të madh të fjalëve jo të parme shënuese, në raport me numrin e përgjithshëm të fjalëve, e përbëjnë emrat me rreth 26%, pastaj mbiemrat me rreth 24%, foljet me rreth 12%, (ndryshimet në përqindje në dy fjalorët e fundit, 1980 dhe 2006, midis të njëjtës kategorie leksiko-gramatikore janë shumë të vogla. Ndryshim që vihet re, ka vetëm kategoria leksiko-gramatikore e mbiemrit që zë 18% dhe foljes me 9%, në “Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954, kurse përqindja e emrave është përafërsisht e njëjtë në të tre fjalorët.) ndajfoljet etj. Brenda çdo kategorie leksiko-gramatikore më shumë fjalë jo të parme, në krahasim me të parmet, e kanë mbiemrat, pasi këta kanë shtimin më të madh me anë të ndajshitesave dhe kompozimit, shtesa që kanë gjetur pasqyrim në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe.

Nga shqyrtimi i materialit të këtyre shkronjave, A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O, në të tre fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, (1954, 1980, 2006), konstatojmë se shtim të konsiderueshëm të fjalësit në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të viteve 1980 dhe 2006, kanë emrat e veprimit me prapashtesat **-im** dhe **-je**, emra që vijnë nga foljet si dhe mbiemrat të ardhur nga pjesoret e foljeve. Ndaj vargu më prodhimtar i fjalëve në gjuhën shqipe është ai folje-emër veprimi- mbiemër prejpesor.

Veç emrave me këto prapashtesa, të shumtë janë edhe emrat që emërtojnë njerëzit sipas veprimit që kryejnë, llojit të punës që bëjnë, të formuar me prapashtesat **-ar (tar)**, **-or(tor,-sor)**, p.sh. *gazetar, arkëtar, gjahtar, arsimtar, malësor, gaztor, tornitor, udhëtar, dasmor* etj. Vend të rëndësishëm zënë emrat e vepruesit me prapashtesën **-ë(s)**, si: *gjuajtës, mallkues, pajtues, mësues, ujitës, prashitës, vaditës, mbjellës, larës* etj. Të shumtë janë edhe emrat e prejardhur me prapashtesën **-pa**, me kuptim të kundërt me atë të fjalës nga vjen, si: paaftësi, pandershmëri, pakënaqësi, paudhësi, pabarazi etj.

Në kategorinë leksiko-gramatikore të mbiemrave vendin më të madh e zënë mbiemrat cilësorë mohorë me prapashtesën **-pa**, si: *i paaftë, i padrejtë, i paqartë, i pakuptueshëm, i pabesueshëm, i pabindur, i pagdhendur, i padurueshëm* etj. Të shumtë janë edhe mbiemrat me formimet me prapashtesën **-shëm**, si: *i besueshëm, i gëzueshëm, i durueshëm, i dukshëm, i ujitshëm, i ndershëm, i lirshëm* etj. Pas këtyre mbiemrave, vijnë ata që formohen me prapashtesat **-or, (-sor), -ë(s), -ë(t)**, si: *drusor, halor, gjethor, i drunjte, i gazte, gërryes, ushqyes* etj.

Në kategorinë e foljeve në formimet e prejardhura klasën më të pasur e përbëjnë foljet prejmemorore të formuara me prapashtesat **-o (-zo, -to, -so, -ro, -)**, **-os**, si: *dyshoj, duroj, gjurmoj, gjykoj, udhëtohet, gjethëson, palos, vulos, gjallëroj, xixëllon, dritësoj, avulloj,*

*urtësoj* etj. Ndërsa te ndajfoljet, ndër formimet e prejardhura, shumicën e përbëjnë ndajfoljet e mënyrës me prapashtesat **-isht, -as, -azi**, si: *gabimisht, gjallërisht, gjerësisht, gjatazi, gjatas, gjeras, ultas e ultazi, barkas e barkazi* etj.

Nga analiza e fakteve të mësipërme, shohim se ndajshtimi ka luajtur rolin më të madh në shtimin e fjalësit në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, veçanërisht i ndjeshëm, në raport me fjalorin paraardhës, është në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, 1980. Më e drejtë do të ishte të thoshim pasqyrimin, pasi fjalë me ndajshtesa në të folurën e përditshme të popullit, mund të kishte në qarkullim edhe para botimit të “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954, por që nuk janë pasqyruar në këtë fjalor shpjegues.

Ndajshtimi ka ndikuar mjaft në periudhën mbas botimit të fjalorit të parë shpjegues, pasi edhe zhvillimi i gjithanshëm i jetës ekonomike, shoqërore, arsimore e kulturore të popullit tonë që i vrullshëm e me ndikim në lindjen e fjalëve të reja, gjë që pasqyrohet në shtimin e fjalësit në makrostrukturën e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” 1980. Kjo tregon punën me përgjegjësi të hartuesve të fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, sepse siç thotë A.Xhuvani “nuk është detyra e hartuesit a botuesvë të fjalorit, që për çdo fjalë të re që formon kush kundër rregullave të natyrës së gjuhës, ta marri përnjëherësh symbyllazi e ta shtien në fjalor, pa e peshuar, pa e vëzhguar hollë formimin e saj, sepse fjalori me autoritetin e tij e ligjshmëron e sanksionon punën e fjalëve që shtie brenda edhe në rast gabimesh”.<sup>48</sup>

Për të parë efektet që jep ndajshtimi, do të japim më poshtënjë statistikë të fjalëve të formuara nga foljet, për emrat e veprimit më-**im, -je** dhe mbiemrat prejpjesorë. Fjalorët që po analizojmë, pak a shumë janë të ndryshëm, ndaj dhe studimin e vargjeve e kemi vështruar të kushtëzuar nga kriteret e zbatuara për çdo fjalor shpjegues në veçanti, nga lënda leksikore që është mbledhur e trajtuar aty. Dallimet që vërejmë te ky varg, nuk janë vetëm sasiore, por edhe cilësore, pasi ato çojnë në zgjerim të ndjeshëm të fjalësit në makrostrukturën e çdo fjalori shpjegues, në lëvizjet semantike të fjalëve, gjë që ka çuar në shtimin e pasqyrimin të fjalësit të këtij vargu në fjalorët shpjegues të shqipes. Këto fakte vërtetojnë idenë e E.Hysës që thotë se: “në sistemin fjalëformues të shqipesjanë shfaqur prirje që e zhvillojnë më tej këtë sistem dhe krijojnë mundësi të shumta për zgjerimin e inventarit të njësive që përfshihen në të e një nga këto prirje është veprimi i ndërlidhur dhe i ndërvarur i mënyrave dhe i tipeve të ndryshme të fjalëformimit”.<sup>49</sup>

---

<sup>48</sup> Xhuvani, A. Çështje e “Fjalorit të gjuhës shqipe”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972, f.123-124.

<sup>49</sup> Hysa, H. Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, Tiranë, 1988, f.301.

Si pikë nisjeje, përqsasjeje e krahasimi për fjalorët e tjerë shpjegues të gjuhës shqipe shërben “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, megjithëse me mangësi, për arsye të kohës kur u botua. Në këtë fjalor *grupin e foljeve* do ta shohim pa paracaktime fjalëformuese, kurse te dy fjalorët e tjerë vështrohen më gjerësisht. *Si gjymtyrë e dytë e vargut* janë parë *emrat e veprimit më-im* dhe *-je*, të formuar nga tema foljore, emra që kanë zgjeruar fushën e përdorimit, duke zëvendësuar dhe një pjesë të emrave asnjans, ndaj prirja e pasqyrimin të tyre është më e paktë nga njëri fjalor në tjetrin (p.sh. *të ecurit me ecje; të punuarit me punimi; të ngrënit me ngrënie etj.*).

Si gjymtyrë e tretë e vargut është parë *grupi i mbiemrave* të ardhur nga pjesorja e foljeve, të cilët emërtojnë tiparin e rezultatit të veprimit të shprehur nga folja që përbën temën fjalëformuese. Në gjuhën shqipe me prapashtesat *-im* dhe *-je* formohen emra vetëm nga foljet. Por në fjalor ne shohim se jo të gjitha foljet formojnë emra, pasi një pjesë e foljeve nuk kanë emrat korespondues, të pasqyruar në fjalorët shpjegues, sepse ata mund të mos jenë leksikalizuar plotësisht që të bëheshin pjesë e makrostrukturës së këtyre fjalorëve. “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, si i pari fjalor shpjegues i mirëfilltë i gjuhës shqipe hapi etapën e fjalorëve shpjegues kombëtarë normativë”.<sup>50</sup> Siç është thënë dhe më lart, ai pasqyron shtresën aktive të leksikut të shqipes dhe për fondin e fjalëve e për frazeologjinë që përfshin, ai ruan edhe sot vlera të mëdha shkencore, pasi shërben edhe si një pikë referimi për të parë zhvillimin e pasurisë leksikore të gjuhës shqipe, mbështetur në krahasimin që bëjmë me këtë fjalor, fjalorëve të mëvonshëm shpjegues, siç po veprojmë me vargun folje-emër veprimi-mbiemër prejpjesor.

Në fjalor ne gjejmë 871 vargje, afër 12% e gjithë fjalësit të këtyre shkronjave: folje - emër veprimi - mbiemër prejpjesor 48 vargje; folje - emër veprimi (mungon mbiemri) 247 vargje; folje - mbiemër prejpjesor (mungon emri i veprimit) 43 vargje; emër veprimi-mbiemër prejpjesor (mungon folja) 5 vargje, emër veprimi (mungon folja dhe mbiemri) 10 vargje; mbiemër prejpjesor (mungon folja dhe emri) 13 vargje, folje (mungon emri e mbiemri) 505 fjalë.

Në këto shkronja grupi paradigmatic i foljeve përfshin 843 njësi, por duke pasur parasysh se në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, ka shumë variante fonetike dialektore si: *agjëroj - agjënoj, amëlsoj - ëmbëlsoj, andrroj - arnoj, ap - jap, baj - bëj, cikrroj - cirkoj, çkërfitem - skërfitem - çkërfitem, çdredh - zhdredh, dhjetëzot - dhjetot, dugulis - gudulis, gjysmoj - gjymsoj, qëmtoj - gjëmtoj, gulshoj - gulçoj, etj.,* ky numër është më i vogël, gjë që ndodh edhe me gjymtyrët e tjera të vargut.

Grupi i emrave brenda këtij vargu ka 310 njësi, pra 533 njësi më pak sesa foljet, gjë që tregon se vargu nuk ecën në mënyrë simetrike, por vihet re një thyerje. Mangësinë e

<sup>50</sup> Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f.286.

fjalorit në këtë drejtim leksikografët mundohen ta justifikojnë në shënimet mbi përdorimin e fjalorit ku thuhet: “Për të mos rritur shumë vëllimin e fjalorit, janë lënë jashtë disa kategori fjalësh të prejardhura që kuptohen lehtë e s’kanë një përdorim aq të gjerë e të qëndrueshëm. Kështu nuk janë vendosur në makrostrukturën e këtij fjalori:

**PASQYRA E VARGUT folje - emër veprimi - mbiemër prejpjesor NË  
FJALORËTSHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE**

SHKRONJA		A	B	C	Ç	DH	F	H	K	LL	O	Shuma	
<b>FJALORI 1954</b>	f-e-m	6	5	1	6	3	5	6	16	0	0	48	
	f-e	42	31	12	38	2	34	18	62	4	4	247	
	f	23	63	31	67	11	60	40	191	13	6	506	
	f-m	1	3	1	6	2	5	6	18	1	0	43	
	e-m	0	0	1	0	0	0	0	1	0	1	2	5
	e	3	5	0	0	0	1	0	1	0	0	0	10
	m	1	2	2	0	3	1	2	1	0	0	1	13
<b>FJALORI 1980</b>	f-e-m	34	35	25	33	3	33	38	63	5	2	271	
	f-e	61	63	19	44	8	54	22	121	6	6	404	
	f	25	102	40	55	6	57	36	126	11	3	461	
	f-m	4	12	7	5	0	4	2	16	2	0	52	
	e-m	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	3	6
	e	1	6	0	1	1	1	1	4	0	0	0	15
	m	0	5	1	0	1	0	0	0	0	0	1	8
<b>FJALORI 2006</b>	f-e-m	65	74	54	48	14	59	42	89	16	9	470	
	f-e	53	61	39	58	19	67	29	135	27	13	501	
	f	29	15	55	62	7	62	32	110	17	3	392	
	f-m	8	16	11	14	4	7	5	19	2	2	88	
	e-m	3	8	3	5	2	4	3	7	1	1	37	
	e	4	9	2	3	2	3	0	6	1	0	0	30
	m	3	5	7	2	1	2	0	1	0	0	0	21

(f-e-m→folje-emër veprimi-mbiemër prejpjesor; f-e→folje-emër veprimi; f→folje;  
f-m→ folje-mbiemër prejpjesor; e-m→ emër veprimi-mbiemër prejpjesor;  
e→emër veprimi; m→mbiemër prejpjesor)

- shumë emra foljorë të formuar me prapashtesat **-je** a **-im**, si: *dredhje, kapje...*

- mbiemrat foljorë të formuar nga pjesoret, si: *i djegur, i përkëdhelur, i pastruar* etj.<sup>51</sup> Zbatimi i këtij kriteri e ka tkurrur shumë vargun. Aty janë pasqyruar shumë emra foljorë asnjans, gjë që nuk e gjejmë në fjalorët e tjerë shpjegues në këto përmasa.

Grupi i mbiemrave ka 109 njësi, ose 734 më pak sesa folja dhe tregon thyerjen e dytë të simetrisë së vargut. Numri i tyre është relativisht i vogël për shkaqe të ndryshme. Siç cituam më lart në “shënimet për përdorimin e fjalorit”, pranohet se “nuk janë pasqyruar të gjithë mbiemrat foljorë të formuar nga pjesoret e foljeve, por vetëm ata që kanë një kuptim që nuk del drejtpërdrejt nga ai i foljes rrënjë”.<sup>52</sup> Në këtë fjalor gjejmë mangësi si në makrostrukturë ashtu edhe në mikrostrukturë:

- Kemi emra si: *degëzim, cingërimë, cfëngie, korrigjim, paragjykim,* etj. ku nuk jepen foljet nga formohen këta emra.
- Kemi mbiemra si: *i cingërimtë, i cikalosur, (i, e) dhentë, i ngutur, i përzitur* etj. për të cilët nuk jepen foljet nga vijën.
- Në fjalor gjejmë emra veprimi që jepen si emra asnjans, pa u shpjeguar, si: *latoj - latim - të latuarit, të grishurit, të rimëkëmburit* etj.

“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, 1980, me 2300 faqe e rreth 41000 fjalë është një nga arritjet më të rëndësishme të shkencës gjuhësore shqiptare dhe me karakterin e kriteret e tij shkencore mbushi një nevojë të ndierë thellë nga shoqëria jonë. Ai dallohet për materialin e pasur leksikor dhe për një zberthim të mirë e të qartë të kuptimeve të tyre të ndryshme, me frazeologjinë e tyre përkatëse, e cila siç dihet përbën një pasuri të veçantë e karakteristike të gjuhës së popullit tonë.

Nga krahasimi që i kemi bërë “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” 1980, me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, vëmë në dukje këto veçori:

1. Është zgjeruar ndjeshëm fondi leksikor e frazeologjik i gjuhës sonë të pasqyruar në fjalor, nëpërmjet hedhjes në përdorim të fjalëve e shprehjeve pak të njohura ose të panjohura, sidomos të gurrës popullore, të papasqyruara në fjalorin e mëparshëm, por që i kishin të gjitha mundësitë për të qenë pjesë e fondit leksikor e frazeologjik të gjuhës letrare shqipe. Krahas pasqyrimit të fjalës shqipe në gjithë gjerësinë e saj, të lashtë e të rrallë, në fjalor u është hapur shumë vend edhe neologjizmave, siç e tregon edhe vargu i njësisve leksikore që po analizojmë, madje dhe fjalëve të huaja aktive në shqipen e kohës.

<sup>51</sup> Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954, f.V.

<sup>52</sup> “Fjalori i gjuhës shqipe”, Tiranë, 1954, f. V).

2. Një element tjetër që vihet re në Fjalorin shpjegues të 1980-ës, është dhe zgjerimi i mikrostrukturës aty. Strukturat kuptimore të fjalëve, falë plotësimit me elemente të panjohura të kësaj përmbajtjeje sipas modeleve bashkëkohore të strukturimit semantik, zbulojnë përbërësit kuptimorë dhe ndërtojnë strukturat kuptimore në përputhje dhe me tipin e fjalorit, si një fjalor i mesëm gjuhësor. Zgjerimi i fjalorit dhe i strukturave kuptimore është shoqëruar edhe me synimin për të pasqyruar në fjalor sa më shumë vlera të tjera të fjalëve, edhe ato të “mbishtresuara”. Kjo duket po të sjellim shembuj disa fjalë nga të dy fjalorët shpjegues, 1954 dhe 1980, dhe t’i krahasojmë, si:

- *bardhënga* 3 kuptime në fjalorin e 1954-ës në 20 kuptime në atë të 1980-ës, *bie (rashë)* nga 14 në 44 kuptime; *bëj* nga 29 në 39 kuptime; *bie (prura)* nga 1 në 7 kuptime; *bllok* nga 4 në 11 kuptime; *brenda* nga 3 në 10 kuptime; *(i, e) dhënë* nga 1 në 10 kuptime; *kam* nga 3 në 24 kuptime; *kap* nga 5 në 16 kuptime; *kaloj* nga 8 në 19 kuptime, *krah* nga 5 në 18 kuptime etj. (Një pasqyrë krahasuese me zhvillimin e kuptimeve kemi dhënë në kur kemi trajtuar zhvillimin e kuptimeve të fjalëve në fjalorët shpjegues). Në këtë fjalor kuptimi i ri i fjalës, si fakt gjuhësor i formuar, është pasqyruar gjerësisht brenda strukturës kuptimore të fjalës, të renditura sipas vlerës së kuptimit. Zgjerimi i kuptimeve të emrave e mbiemrave në fjalor nuk është bërë vetëm brenda strukturës kuptimore të foljeve, por edhe jashtë tyre.

3. Në dallim nga Fjalori i 1954-ës, në këtë Fjalor është rritur cilësia e shpjegimit të kuptimeve të fjalëve. Ato synojnë të jenë të plota e të përpikta dhe sa më të thjeshta e të qarta. Për emrat prejfoljorë me kuptimet e veprimit, të gjendjes a të rrjedhimit të veprimit, sipas kuptimeve të foljeve përkatëse, me të cilat shprehen, shpjegohen sipas rastit me shprehjet: “*veprim sipas kuptimit + të foljes...*; *gjendja sipas kuptimit + të foljes*; *veprim dhe gjendje sipas kuptimit + të foljes..*; *veprim dhe rrjedhim i tij sipas kuptimit + të foljes*”.<sup>53</sup>

4. Në FGJSSH vihet re dhe një përmirësim i ndjeshëm i sasisë dhe cilësisë së thënieve në shembujt ku shfaqet kuptimi a nuanca kuptimore e njësisë.

Në Fjalor gjejmë 1217 vargje ose 10% e gjithë fjalësit, nga të cilat vargu folje-emër veprimi- mbiemër prejpjesor 271 njësi; folje - emër veprimi (mungon mbiemri) 404 njësi; folje - mbiemër prejpjesor (mungon emri) 52 njësi; emër veprimi (mungon folja dhe mbiemri) 15 njësi; mbiemër prejpjesor (mungon folja dhe emri) 8njësi dhe folje 461 njësi.

---

<sup>53</sup> FGJSSH, Shpjegimi i kuptimit të fjalëve e të njësive frazeologjike, Tiranë 1980, f. XIX.

Grupi i foljeve, me 1188 njësiështë shumë më i plotë, më sistemor e më informues. Grupi i emrave përfshin 696 njësi leksikore(492 njësi më pak se foljet dhe 386 njësi më shumë se FGJSH 1954). Grupi i mbiemrave përfshin 337 njësi leksikore (851 njësi më pak se foljet ose 228 njësi më shumë se FGJSH 1954).

Nga krahasimi i dy fjalorëve del se në FGJSSH 1980, dallohet qartë prirja e zhvillimit të këtyre grupeve paradigmatiche brenda sistemit të gjuhës standarde duke mbushur kështu një simetri të natyrshme e të domosdoshme, një simetri reale. Në këtë mënyrë është pasuruar jo vetëm makrostruktura e fjalorit apo korpusi i fjalëve, por edhe aftësia e shqipfolësve për të shprehur më qartë nuancat kuptimore të fjalëve në ligjërim.

Nga tabela krahasuese për fjalësin e shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O, ne shohim dhe ndonjë mangësi, si: kemi emra veprimi, por jo folje p.sh.*cingërimë, culahitje, kërcëllitje, çhundorëzim, dhjamëzim* etj. Por edhe për të plotësuar simetrinë, në fjalorët shpjegues është mirë që çerdhja e fjalëve të jepet e plotë, jo vetëm se temat janë fjalëformuese e motivojnë nga ana kuptimore këta emra, por edhe sepse këto njësi janë në përdorim nga folësit. Gjithashtu vërejmë se kemi vargun folje - mbiemër, ku mungon emri, p.sh. *i cipricullakur (cipricullakoj), i llahtaritur* etj. Kemi vargun emër - mbiemër, por s'kemi foljen, si: *dellëzim - i dellëzuar, cërirë - i cërirë, cingërim - i cingërimtë* etj.

Përmirësim të ndjeshëm në këtë varg fjalëformues bëri “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006 që ka rreth 48000 fjalë (rreth 7000 fjalë më shumë se “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980), dhe në makrostrukturën e këtij fjalësi edhe frazeologjia e shqipes letrare jepet në mënyrë të ngjeshur, nisur nga kriteret që përdor fjalori dhe nga dëshira për të pasqyruar sa më shumë material leksikor në më pak faqe. (Fjalori ka 1250 faqe nga 2273 faqe që ka Fjalori shpjegues i 1980-ës).

Korpusi i këtij fjalori pasqyron lëvizjet e kohës në leksikun e shqipes, veçanërisht në sferën e përgjithshme e më aktive, duke përfshirë fjalë e kuptime të reja, edhe huazime të domosdoshme, nëpërmjet një përzgjedhjeje të prurjeve leksiko-semantike, kryesisht të periudhës së viteve 90-të e deri kur u botua fjalori. Fjalori, si një pasqyrë e realitetit gjuhësor të shqipes standarde, u është ruajtur elementeve rastësore, të pangulitura mirë, apo edhe elementeve enciklopedikë, si ato që ka Fjalori i 1984-ës, si dhe krahinorizmave dhe historizmave, që në fjalorët e mëparshëm jepeshin në emër të pasurimit kulturor.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, është arritur të pasqyrohet shkalla më e lartë e përgjithësimin e sintezës, e paarritur ndonjëherë në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Një veçanti e këtij fjalori shpjegues është fakti se ai pasqyron për herë të parë mbështetur thjesht në aspektin shkencor (nuk po marrim parasysh Fjalorin vitit 2002, pasi ai ishte më tepër një ribotim) për shkak të ndryshimeve politiko-shoqërore, ekonomike e kulturore, gjithë korpusin e fjalëve apo edhe përmbajtjen dhe përdorimin e tyre, ndryshe



nga Fjalori i 1980-ës, ku kishte dhe këndvështrime politike në interpretimin e një kategorie fjalësh.

Ashtu si në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe ndryshe nga “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, në këtë fjalor nuk përfshihen variantet fonetike dialektore, por ndryshe nga të dy nuk përfshihen krahinorizmat e ngushtë, fjalët me strukturë të lehtë fjalëformuese, forma tipologjike me parashtesa, si: *mos-*, *pa-*, *për-*, *ri-* etj., fjalët e vjetruara e historizmat e rrallë, huazimet tashmë të mënjanuara nga përdorimi apo dhe të rejtat që nuk janë ngulitur në shqipe e kanë koresponduesen e tyre në fjalësin e saj. Me të njëjtin kriter në fjalor veprohet edhe për kuptimet e frazeologjinë. Përfshirja ose jo e një fjale në korpusin e Fjalorit është e motivuar shkencërisht sipas vlerave të saj reale, sipas praktikës gjuhësore dhe sipas kriterëve të fjalorit, larg çdo paragjykimi krahinor e ideologjik.

Fjalori shpjegues i 2006-ës, ka ndryshime të dukshme nga të tjerët, brenda kufijve të mundshëm e shkencërisht të pranueshëm, në paraqitjen e njërive leksikore, në mikrostrukturën e njërive të veçanta dhe të kuptimeve të ndryshme, natyrisht duke ndjekur karakterin kategorial të ndryshimeve dhe duke ruajtur simetrinë e zgjidhjeve brenda makrostrukturës e mikrostrukturës së fjalorit, duke i bashkuar në një zë leksikografik sipas sistemit çerdhor.

Më e dukshme është në këtë fjalor paraqitja në një çerdhe e *vargut folje-emër veprimi- mbiemër prejpjesor*, ato që kanë formë e struktura kuptimore të njëjta. Këto njësi të çerdhes së foljes veprare vihen në fund të strukturës së saj kuptimore, të shprehura nga ana grafike me një pikë të madhe të zezë, për t’u dalluar më qartë nga lexuesi, p.sh.

**Caktoj** (f. 126), *kal.*, *~ova*, *~uar*. 1. jap sasinë, masën, vlerën ose vendin e diçkaje; vendos për kohën e diçkaje, për qëndrimin që duhet mbajtur ose për mënyrën e veprimit, e lë ose e ndaj për një qëllim a për një punë: *caktoj emrin*, *caktoj kufijtë*, *caktoj vendin e takimit*, *caktoj kushtet*, *caktoj truallin e shtëpisë*. 2. e ngarkoj dikë me një detyrë a për një punë; emëroj: e caktoj përgjegjës / pës. caktohem. \* **caktim**, *~i* m. 1. veprimi sipas foljes: *caktimi i datës*. 2. bised. masë, afat etj. që është vendosur që më parë, cak, kufi: *i dha leje pa caktim*. 3. sh. *~ e(t) drejt. vjet.* vendim; ajo që përcaktohej me ligj a me vendim. \* **caktuar (i, e)** mb. 1. që është caktuar: *vlerë e caktuar; në vendin (afatin) e caktuar; në kushte (rrethana) të caktuara*. 2. *gjuh. vjet.* i shquar.

Krahasuar me fjalorët e mëparshëm shpjegues të shqipes, në këtë fjalor janë bërë ndryshime në strukturën kuptimore, nëpërmjet sentezave të reja kuptimore, të shkrirjeve në një kuptim ose të ngjeshjeve të 2-3 kuptimeve në një. P.sh. te foljet vetvetore kuptimi i parë është përmbledhës për të gjitha kuptimet gjegjëse të foljes veprare që ajo i trashëgon, kurse kuptimet 2 e mbrapa janë kuptimet e veçanta të foljes vetvetore, që nuk i ka

veprorja, ose kuptime që kanë përbërës të ndryshëm nga kuptimet e veprores. (Për këto raste kemi dhënë shembuj kur kemi shpjeguar mikrostrukturën në fjalorin shpjegues).

Nga ky varg leksikor (folje - emër veprimi - mbiemër prejppjesor), në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006 gjejmë 1539 vargje (ose 10.7% e gjithë fjalësit për këto shkronja), nga të cilat folje - emër veprimi - mbiemër prejppjesor 470 njësi, folje - emër veprimi (mungon mbiemri) 501 njësi, emër veprimi - mbiemër prejppjesor (mungon folja) 37 njësi, emër veprimi (mungon folja dhe mbiemri prejppjesor) 30 njësi, mbiemër prejppjesor (mungon folja dhe emri i veprimit) 21 njësi dhe folje 392 njësi. Grupi paradigmantik i foljeve përfshin 1451 njësi, 263 njësi më shumë se FGJSSH dhe 608 njësi më shumë se FGJSH 1954. Pra në këtë fjalor janë shtuar 1669 fjalë, ndër to emra veprimi 312 njësi më shumë se Fjalori i 1980-ës dhe 697 njësi më shumë se Fjalori i 1954-ës. Grupi i mbiemrave përfshin 616 njësi leksikore. Krahasuar me FGJSSH, 1980, kemi 279 njësi më shumë mbiemra prejppjesorë, duke rregulluar kështu simetrinë tringjyrëshe, si dhe 507 njësi më shumë se Fjalori i 1954-ës.

Edhe në këtë fjalor, ashtu si dhe në dy të parët, por jo në ato përmasa si ata, duke marrë parasysh edhe shtimin e numrit të fjalëve, vërehen të meta në drejtim të mbushjes së vargut, megjithëse në Fjalorin e 2006-ës, vargjet e plota janë më shumë se edhe Fjalori i 1980-ës. Teorikisht, por edhe praktikisht, ekzistojnë të gjitha mundësitë për mbushjen e vargut. Themi praktikisht, se ka emra veprimi që përdoren gjerësisht nga folësit në ligjërim, por nuk janë pasqyruar në fjalor, si : *cërcërim, cërcëritje*. Ka raste kur në fjalor kemi emra veprimi, por nuk kemi folje apo mbiemër prejppjesor, si *cekqes* etj. Kemi mbiemra, por nuk kemi folje, si: *i cërirë, (i, e) cfengur, (i, e) cungërimtë* etj.

Pra siç shihet, në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, ndryshe nga fjalorët e mëparshëm shpjegues, nuk kemi tri fjalë titull për vargun, por vetëm një fjalë, për foljen, kurse emri dhe mbiemri shpjegohen brenda paragrafit të saj, brenda çerdhes së saj. Shtimi i numrit të fjalëve me brumin e shqipes dhe sipas gjedheve fjalëformuese të saj, është një barrierë e fuqishme ndaj huazimeve të panevojshme. Prof. Gjovalin Shkurtaç në botimin “Si të shkruajmë shqip” në një shtojcë prej 23 faqesh nën titullin “Treguesi i fjalëve të huaja që mund të zëvendësohen plotësisht ose pjesërisht” jep një fjalës prej 1017 njësisish, fjalë të huaja dhe propozimet për zëvendësimin e tyre me fjalë shqipe, rast pas rasti, si p.sh.: *abandonim, ~i, abandonohet, abandonoj, i abandonuar*, çerdhe fjalësh me temë të huazura nga gjuhët neolatine. Në vend të tyre në gjuhën shqipe përdoren fjalët: *braktis, braktiset, braktisje, i braktisur; afinitet, ~i*, fjalë me burim nga frëngjishtja, mund të zëvendësohet plotësisht me *afri, afri shpirtërore, lidhje afrie*.<sup>54</sup>

---

<sup>54</sup> Shkurtaç, Gj. Si të shkruajmë shqip, Bot.Toena, Tiranë, 2008, f.253.

## KREU IV

### RRETH KARAKTERISTIKAVE STILISTIKE TË FJALËVE NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE

#### 4.1 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Në etapën e sotme të zhvillimit të gjuhës shqipe, gjuha letrare ka arritur të mëdha edhe në shtresimin stilistik dhe në përcaktimin e ngjyimeve emocionale vlerësuese të leksikut të saj. Në shkencën gjuhësore shqiptare sot, studimi i varianteve ligjërimore dhe i stileve funksionale të gjuhës standarde shqipe si dhe i mjeteve leksikore që lidhen me to, ka bërë progres, ku siç shprehet A.Kostallari “krahas vëzhgimeve në një plan të përgjithshëm janë bërë edhe studime që i kushtohen posaçërisht stilistikës gjuhësore”.<sup>55</sup>

Dhënia e veçorive stilistike, e shënimeve për sferat e përdorimit dhe për ngjyrimet emocionale-vlerësuese të tyre për fjalësin e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, është një angazhim serioz i leksikografëve shqiptarë.

Përsosja e sistemit stilistikështë e lidhur ngushtësisht dhe me zhvillimin e gjuhës sonë letrare. “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, si i pari fjalor shpjegues i mirëfilltë i gjuhës sonë, nuk dallohet për dhënie të plotë të veçorive stilistike, të shënimeve për sferat e përdorimit të fjalëve dhe për ngjyrimet emocionale-vlerësuese të tyre. Duke filluar me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, e duke vazhduar me fjalorët e tjerë shpjegues, 1984, 2002, 2006, janë bërë përpjekje tërësore për të sistemuar leksikun e gjuhës sonë nga pikëpamja e normës letrare dhe e prirjeve të zhvillimit të tij, duke arritur në rreth 48000 fjalë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006.

“Në shqipen e sotme është përpunuar dhe formësuar një sistem i plotë stilistik, i cili përbëhet nga variantet ligjërimore dhe stilet funksionale, përpunimi i të cilit është pasojë e zhvillimit të përgjithshëm e më të plotë të funksioneve shoqërore të gjuhës letrare shqipe”,<sup>56</sup> sidomos pas viteve 90-të, kur janë bërë përparime të mëdha në jetën politike e shoqërore, në fushën ekonomike e kulturore.

Në gjuhën e sotme shqipe ndërveprojnë mjete të shumta leksikore, që kanë prejardhje, kuptime dhe ngjyime shprehëse e emocionale të ndryshme, duke filluar që nga burimi autokton e deri te huazimet. Gjatë analizës së leksikut të përfshirë në shkronjat A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O, në të tre fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, 1954, 1980 dhe 2006,

---

<sup>55</sup> Kostallari, A. Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme, Buletini i shkencave shoqërore, 1954, 4, f.17-50.

<sup>56</sup> Lloshi, Xh. Tipare të sistemit stilistik në gjuhën e sotme shqipe, “Studime filologjike”, 1985, 1, f.64.

kemi vënë re shënime të ndryshme për karakterizimin stilistik e emocional të fjalëve, për të cilat do të ndërtojmë tabelën përkatëse, si më poshtë.

Vjelja e materialeve për fjalësin e këtyre shkronjave është bërë në mënyrë shteruese. Aty gjejmë përcaktime të fjalëve që përdoren në ligjërimin libror dhe ato në ligjërimin bisedor. Në raport me fjalësin e përgjithshëm të fjalorëve, këto fjalë përbëjnë një grup shumë të kufizuar, kurse pjesa tjetër e leksikut përdoret në të dyja ligjërimet, si në atë libror ashtu edhe në atë bisedor. Gjithashtu, kemi nxjerrë leksikun terminologjik, leksikun e ligjërimin të thjeshtë e atë dialektor-krahinor. Në fjalorët shpjegues, parimeve e kritereve të ndryshme për klasifikimin e leksikut u shtohet edhe parimi semantiko-stilistik, në bazë të të cilit fjalët shihen sipas vlerës së tyre shënuese dhe në lidhje të ngushtë me stilet e ndryshme të gjuhës letrare. Sipas këtij parimi, përcaktimi i etiketës stilistike të fjalëve është orientim kryesor. Kështu në trajtat e ndryshme të ligjërimëve dhe në stilet funksionale mund të dallohen shtresat dhe grupet e veçanta të fjalëve që janë karakteristike për këtë apo atë variant të gjuhës shqipe dhe për stilet e gjuhës së sotme letrare.

Siç e theksuam më lart, në fjalorët shpjegues që po marrim në shqyrtim, në shkronjat B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O, të cilat kanë shënime të posaçme që përdoren për të përcaktuar shtresën ose shtresat leksikore, ku hyn fjala në tërësinë e vet, a një prej kuptimeve të saj, sferën e përdorimit dhe ngjyrimin emocional vlerësues. Ndarja e këtyre shënimeve sipas shkronjave dhe në grupe të veçanta, si dhe sasia e tyre, është dhënë në tabelën e mësipërme. Pjesa më e madhe e shkronjave që po analizojmë, ashtu si gjithë leksiku i fjalorit shpjegues, nuk kanë shënime stilistike. Nga materiali i vjelë për njësitë leksikore, për të tre fjalorët, për shkronjat e analizuara më sipër, ka gjithsej 7433 fjalë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, 12720 fjalë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe 14389 fjalë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006.

Në bazë të pasqyrës së njërive leksikore, për të tre fjalorët, del kjo gjendje e fjalësit të tyre sipas shkronjave. Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, shkronja B ka 1245 njësi leksikore, shkronja C 282 njësi leksikore, shkronja Ç 480 njësi, shkronja DH ka 145 njësi, shkronja F ka 865 njësi, shkronja H ka 653 njësi, shkronja K ka 2531 njësi, shkronja LL ka 141 njësi, shkronja O ka 207 njësi leksikore. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, është kjo gjendje e leksikut për çdo shkronjë: shkronja B ka 2839 njësi leksikore, shkronja C ka 667 njësi leksikore, shkronja Ç ka 793 njësi leksikore, shkronja DH ka 238 njësi leksikore, shkronja K ka 3393 njësi leksikore, shkronja LL ka 217 njësi leksikore, shkronja O ka 282 njësi leksikore. Ndërsa në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, në shkronjat e mësipërme kemi këtë numër njësish leksikore: shkronja B ka 2868 njësi leksikore, shkronja C ka 892 njësi leksikore, shkronja Ç ka 1066 njësi leksikore, shkronja DH ka 247 njësi leksikore, shkronja F ka 1870 njësi leksikore,

shkronja H ka 1135 njësi leksikore, shkronja K ka 3623 njësi leksikore, shkronja LL ka 345 njësi leksikore, shkronja O ka 432 njësi leksikore.

Duke bërë një ballafaqim të fjalësit të këtyre shkronjave, që gjenden në të tre fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, në radhë të parë vihet re ndryshimi i fjalësit në aspektin vertikal, pra në makrostrukturë. Por përveç këtyre të dhënave, në punimin tonë, do të japim informacion edhe për shënimet stilistike. Duke krahasuar të dhënat për njësitë leksikore me të dhënat për shënimet stilistike, do të vëmë në dukje disa raporte e do të nxjerrim prej tyre përfundimet e nevojshme. Të dhënat për çdo fjalor do të jepen në mënyrë kronologjike. Në fillim do të japim informacion për “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, pastaj për “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe në fund për “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006.

Në fjalësin e fjalorëve shpjegues vihet re përdorimi i dy rrugëve në dhënien e shënimeve stilistike. Rruga kryesore është dhënia e shënimeve me struktura të veçanta, kurse në raste të kufizuara përdoret dhe rruga tjetër ku sqarimet jepen në përkufizimin e fjalës. Ne kemi paraqitur me shifra shënimet me shkurtime të veçanta për çdo njësi leksikore. Kjo pjesë e lëndës leksikore përmban ngjyrimet stilistike dhe emocionale-vlerësuese të qarta, të theksuara. Kjo është pjesa e leksikut të shqipes letrare që ka fituar në mënyrë pak a shumë të plotë e sistematike ngjyrimet stilistike dhe emocionale-vlerësuese, e cila dëshmon për një zhvillim të lartë të sistemit stilistik të gjuhës shqipe.

Në “**Fjalorin e gjuhës shqipe**” 1954, për 7433 njësi leksikore të shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O janë vënë gjithsej 752 shënime stilistike, d.m.th. rreth 10% e njësive leksikore kanë shënime stilistike, kurse rreth 90% e njësive leksikore nuk kanë shënime të tilla. Më poshtë këto raporte do t’i shohim për fjalësin e çdo shkronje në veçanti.

**Shkronja A** ka 884 njësi leksikore, nga të cilat 86 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 9.7% e njësive leksikore.

**Shkronja B** ka 1245 njësi leksikore, nga të cilat 112 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 8% e njësive leksikore.

**Shkronja C** ka 282 njësi leksikore, nga të cilat 26 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 9% e njësive leksikore.

**Shkronja Ç** ka 480 njësi leksikore, nga të cilat 23 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 5% e njësive leksikore.

**Shkronja DH** ka 145 njësi leksikore, nga të cilat 11 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 7.6% e njësive leksikore.

**Shkronja F** ka 865 njësi leksikore, nga të cilat 66 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional vlerësues, d.m.th. rreth 7.6% e njësive leksikore.

**Shkronja H** ka 653 njësi leksikore, nga të cilat 82 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 12.6% e njësive leksikore.

**Shkronja K** ka 2531 njësi leksikore, nga të cilat 302 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 12% e njësive leksikore.

**Shkronja LI** ka 141 njësi leksikore, nga të cilat 7 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 5% e njësive leksikore.

**Shkronja O** ka 478 njësi leksikore, nga të cilat 37 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 7.8% e njësive leksikore.

Në “**Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe**” 1980,për 12720 njësi leksikore të shkronjave të mësipërme, janë vënë gjithsej 4729 shënime stilistike, d.m.th. rreth 37 % e njësive leksikore kanë shënime stilistike, kurse 63% nuk kanë shënime të tilla. Sipas shkronjave është kjo ndarje:

**Shkronja A** ka 1851 njësi leksikore, nga të cilat 927 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 50% e njësive leksikore.

**Shkronja B** ka 2839 njësi leksikore, nga të cilat 949 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. 33.4% e njësive leksikore.

**Shkronja C** ka 667 njësi leksikore, nga të cilat 325 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 48.7% e njësive leksikore.

**Shkronja Ç** ka 793 njësi leksikore, nga të cilat 439 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 55% e njësive leksikore.

**Shkronja DH** ka 238 njësi leksikore, nga të cilat 82 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th rreth 34% e njësive leksikore.

**Shkronja F** ka 1472 njësi leksikore, nga të cilat 652 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. 44% e njësive leksikore.

**Shkronja H** ka 968 njësi leksikore, nga të cilat 291 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 30% e njësive leksikore.

**Shkronja K** ka 3393 njësi leksikore, nga të cilat 851 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 25% e njësive leksikore.

**Shkronja LI** ka 217 njësi leksikore, nga të cilat 63 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 29% e njësisive leksikore.

**Shkronja O ka 282** njësi leksikore, nga të cilat 192 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 68% e njësisive leksikore.

Në “**Fjalorin e gjuhës shqipe**” 2006, për 14389 njësi leksikore të shkronjavëe të mësipërme, janë vënë gjithsej 3844 shënime stilistike, d.m.th. 27 % e njësisive leksikore kanë shënime stilistike, kurse 73 % nuk kanë shënime të tilla. Sipas shkronjave është kjo ndarje:

**Shkronja A** ka 1911 njësi leksikore, nga të cilat 675 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 35% e njësisive leksikore.

**Shkronja B** ka 2868 njësi leksikore, nga të cilat 745 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. 26% e njësisive leksikore.

**Shkronja C** ka 892 njësi leksikore, nga të cilat 266 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 30% e njësisive leksikore.

**Shkronja Ç** ka 1066 njësi leksikore, nga të cilat 327 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. rreth 30% e njësisive leksikore.

**Shkronja DH** ka 247 njësi leksikore, nga të cilat 65 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 26% e njësisive leksikore.

**Shkronja F** ka 1870 njësi leksikore, nga të cilat 595 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th. 31.8% e njësisive leksikore.

**Shkronja H** ka 1135 njësi leksikore, nga të cilat 257 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 23% e njësisive leksikore.

**Shkronja K** ka 3623 njësi leksikore, nga të cilat 707 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 19.5% e njësisive leksikore.

**Shkronja LI** ka 345 njësi leksikore, nga të cilat 60 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 17.4% e njësisive leksikore.

**Shkronja O** ka 432 njësi leksikore, nga të cilat 146 njësi kanë shënime për ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues, d.m.th 34% e njësisive leksikore.

Nga krahasimi i të dhënave të mësipërme vëmë re se fjalët (pjesë e fjalësit të çdo shkronje të analizuar), që kanë një fushë të kufizuar përdorimi, ose ngjyrimet emocionale-vlerësuese, kanë raporte të ndryshme sasiore midis tyre, në të tre fjalorët shpjegues. Për të

nxjerrë raportin e përgjithshëm sasior të fjalëve që janë të pajisura me shënime stilistike dhe kanë fituar në mënyrë pak a shumë të plotë sisteme ngjyime stilistike dhe emocionale-vlerësuese të qëndrueshme nga pikëpamja e normës së sotme të gjuhës letrare shqipe, është e nevojshme të bëhet një vjelje shteruese e gjithë fjalëve me shënime stilistike për të gjitha shkronjat.

Raporti i nxjerrë për fjalësin e shkronjave që po shqyrtojmë, është tregues i zhvillimit dhe i përsosjes së sistemit stilistik të gjuhës letrare shqipe. Kjo tregon se në shkallën e sotme të zhvillimit e të përsosjes së mjeteve leksikore, dhe në përgjithësi të gjithë sistemit gjuhësor, gjuha e sotme letrare shqipe është zhvilluar e përsosur edhe cilësisht, duke përmbushur të gjitha funksionet e saj si mjet shprehjeje dhe komunikimi në të gjitha sferat e veprimtarisë politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Thellimi i mëtejshëm i këtij zhvillimi cilësor të shqipes letrare edhe në rrafshin stilistik do të rrisë shkallën e karakterit më të plotë e sistemor dhe qëndrueshmërinë e mjeteve shprehëse të saj.



#### 4.2 FJALËT STILISTIKISHT ASNJANËSE NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Siç e kemi theksuar më lart, makrostruktura e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe përbëhet nga fjalë të përcaktuara nga ana stilistike dhe emocionale-vlerësuese dhe fjalë stilistikisht asnjane ose neutrale. Statistikat e nxjerra, për këtë çështje, në fjalësin e shkronjave të mësipërme, tregojnë se në të tre fjalorët ndryshon raporti midis fjalëve që janë stilistikisht asnjane dhe atyre që janë të përcaktuara nga ana stilistike.

Fjalët neutrale, nga pikëpamja e përdorimit të tyre, janë të përbashkëta për variantet ligjërimore dhe për stilet e ndryshme funksionale të shqipes letrare. Këto fjalë a kuptime fjalësh janë “asnjane” stilistikisht dhe të përbashkëta nga përdorimi për stilet dhe ligjërimet e ndryshme. Këto fjalë në veprat leksikografike normative nuk shoqërohen me shënime të posaçme, që tregojnë shtresat leksikore ku hyn fjala, sferat e përdorimit, ngjyrimin emocional-vlerësues etj. Ky leksik përdoret zakonisht në të gjitha variantet e ligjërimet dhe në stilet e ndryshme të gjuhës letrare.

Leksiku i pacilësuar stilistikisht përbën sfondin kryesor të mjeteve gjuhësore, në të cilin fjalët e tjera fitojnë ngjyrimet stilistike-funksionale dhe emocionale-vlerësuese. Së bashku me fjalët e cilësuar stilistikisht, ky leksik formon tërësinë e mjeteve leksikore që përdoren në ligjërim për nevojat shprehëse e komunikuese. Leksiku i pacilësuar me shënime të veçanta për ngjyrimin stilistik dhe emocional-vlerësues, ka edhe karakteristika dalluese në krahasim me mjetet e tjera gjuhësore me ngjyrimet të tilla.

Nga pikëpamja sasiore, në bazë të përlllogaritjeve për fjalësin që po shqyrtojmë, vendin kryesor e zë shtresa e fjalëve të pacilësuar stilistikisht. Më poshtë po japim statistikën për numrin e fjalëve neutrale etë përcaktuara stilistikisht, për shkronjat që kemi marrë në shqyrtim, në të tre fjalorët.

Në “**Fjalorin e gjuhës shqipe**” 1954, është ky raport midis fjalëve të përcaktuara stilistikisht dhe atyre të papërcaktuara:

**Shkronja A** nga 884 njësi leksikore, 86 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 9.7%, dhe 798 të papërcaktuara.

**Shkronja B** nga 1245 njësi leksikore, 112 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 9%, dhe 1133 të papërcaktuara.

**Shkronja C** nga 282 njësi leksikore, 26 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 9.2%, dhe 256 të papërcaktuara.

**Shkronja Ç** nga 480 njësi leksikore, 23 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 4.8%, dhe 457 të papërcaktuara.

**Shkronja DH** nga 145 njësi leksikore, 11 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 7.6%, dhe 134 të papërcaktuara

**Shkronja F** nga 865 njësi leksikore, 66 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 7.6%, dhe 799 të papërcaktuara.

**Shkronja H** nga 653 njësi leksikore, 82 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 12.5%, dhe 571 të papërcaktuara.

**Shkronja K** nga 2531 njësi leksikore, 302 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 12%, dhe 2229 të papërcaktuara.

**Shkronja LL** nga 141 njësi leksikore, 7 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 5%, dhe 134 të papërcaktuara.

**Shkronja O** nga 207 njësi leksikore, 37 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 18%, dhe 170 të papërcaktuara.

Në “**Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe**” 1980, është ky raport midis fjalëve të përcaktuara stilistikisht dhe atyre të papërcaktuara:

**Shkronja A** nga 1851 njësi leksikore, 927 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 50%, dhe 924 të papërcaktuara.

**Shkronja B**nga 2839 njësi leksikore, 949 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 33%, dhe 1890 të papërcaktuara.

**Shkronja C** nga 667 njësi leksikore, 325 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 49%, dhe 342 të papërcaktuara.

**Shkronja Ç** nga 793 njësi leksikore, 439 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, 55%, dhe 354 të papërcaktuara.

**Shkronja DH** nga 238 njësi leksikore, 82 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 34%, dhe 156 të papërcaktuara

**Shkronja F** nga 1472 njësi leksikore, 652 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, 44%, dhe 820 të papërcaktuara.

**Shkronja H** nga 968 njësi leksikore, 291 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 30%, dhe 677 të papërcaktuara.

**Shkronja K** nga 3393 njësi leksikore, 851 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 25%, dhe 2542 të papërcaktuara.

**Shkronja LL** nga 217 njësi leksikore, 63 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 29%, dhe 154 tëpapërcaktuara.

**Shkronja O** nga 282 njësi leksikore, 192 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 68%, dhe 90 të papërcaktuara.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, është ky raport midis fjalëve të përcaktuara stilistikisht dhe atyre të papërcaktuara:

**Shkronja A** nga 1911 njësi leksikore, 675 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 35%, dhe 1236 të papërcaktuara.

**Shkronja B** nga 2868 njësi leksikore, 745 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 26%, dhe 2123 të papërcaktuara.

**Shkronja C** nga 892 njësi leksikore, 266 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 30%, dhe 626 të papërcaktuara.

**Shkronja Ç** nga 1066 njësi leksikore, 327 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 30.6%, dhe 739 të papërcaktuara.

**Shkronja DH** nga 247 njësi leksikore, 65 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 26%, dhe 182 të papërcaktuara

**Shkronja F** nga 1870 njësi leksikore, 595 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 32%, dhe 1275 të papërcaktuara.

**Shkronja H** nga 1135 njësi leksikore, 257 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 23%, dhe 878 të papërcaktuara.

**Shkronja K** nga 3623 njësi leksikore, 707 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 19.5%, dhe 2916 të papërcaktuara.

**Shkronja LL** nga 345 njësi leksikore, 60 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 17%, dhe 285 të papërcaktuara.

**Shkronja O** nga 432 njësi leksikore, 146 njësi janë të përcaktuara stilistikisht, ose 34%, dhe 286 të papërcaktuara.

Siç pamë në statistikat e mësipërme, sipas shkronjave, për të tre fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, 1954, 1980 dhe 2006, rreth 71% e fjalësit në makrostrukturën e tyre e zënë fjalët e pacilësuara stilistikisht.

Vendin e dytë, pas fjalëve të pacilësuara stilistikisht, e zë shtresa e fjalëve të cilësuara stilistikisht në tërësi, ose në të gjitha kuptimet e tyre. Më poshtë po japim sipas

shkronjave, për të tre fjalorët, të shprehura me shifra, vetëm fjalët që kanë shënimin për gjithë fjalën ose gjithë kuptimet e tyre, dhe jo për ato që kanë shënime vetëm në një ose disa kuptime, por jo në të gjitha kuptimet.

Numri i përgjithshëm i fjalëve të cilësuara stilistikisht në tërësi ose në të gjitha kuptimet e tyre, në shkronjat e mësipërme, që merren si një grup më vete, është: në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, 752 njësi nga 7433 njësi leksikore që është fjalësi i këtyre shkronjave, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, 4729 njësi nga 12720 njësi leksikore që është fjalësi i këtyre shkronjave, në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, 3844 njësi nga 14389 njësi leksikore që është fjalësi i këtyre shkronjave.

Në vend të tretë, pas dy shtresave të mësipërme, vjen shtresa e fjalëve të cilësuara stilistikisht në një kuptim ose në disa prej kuptimeve të fjalëve polisemike. Statistikat për fjalë të tilla nuk i kemi paraqitur në pasqyra, por vetëm ato që kanë shënime stilistike për gjithë fjalën.

Informacionin e mësipërm, me të dhëna statistikore, e kemi paraqitur në tabela, sepse vetëm kështupasqyrojmë qartë fenomenin që po trajtojmë, atë të fjalësit me shënime stilistikore dhe atë të fjalësit neutral. Krahasimi i shifrave dhe raportet përkatëse hedhin dritë edhe për disa veçori të leksikut të pacilësuar stilistikisht, si dhe për dy grupet e leksikut të cilësuar stilistikisht. Nëpërmjet dhënies së veçorive të këtyre grupeve leksikore, ne ndriçojmë në vija të përgjithshme edhe zhvillimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe, që shprehet në rritjen e makrostrukturës së fjalorëve dhe rritjen e fuqisë shprehëse të saj.

Sipas të dhënave të mësipërme del se leksiku i pacilësuar stilistikisht përbën shumicën e mjeteve gjuhësore. Kjo pjesë e mjeteve leksikore që përdoret në variantet e ndryshme ligjërimore të gjuhës letrare dhe në stilet e ndryshme funksionale të saj, nuk përdoret për të dhënë karakteristikat dalluese të tyre. Këto fjalë përdoren në të gjitha ligjërimet e stilet e gjuhës letrare dhe nuk karakterizohen nga pasuria e kuptimeve dhe e ngjyimeve kuptimore të tyre. Pra, polisemantizmi i këtyre njërive leksikore është në një shkallë të ulët dhe treguesi i kuptimeve mesatarisht shkon deri në dy kuptime.

Shtresa e fjalëve të pacilësuar stilistikisht përbën bazën kryesore të domosdoshme mbi të cilën pjesa tjetër e leksikut me ngjyrim stilistik dhe emocional vlerësues merr vlerat karakterizuese për stilet e ndryshme të gjuhës letrare.

Treguesi i shkallës së polisemantizmit të fjalëve të pacilësuar stilistikisht, që është dhënë sipas shkronjave, si mesatare e kuptimeve për çdo fjalë, nuk ka ndryshim të madh, rreth 0.4%, nga fjalësi i njëres shkronjë në tjetrën. Të dhënat për ndryshimin e vogël të shkallës së polisemantizmit të fjalëve në shkronjat që shqyrtoam, për të tre fjalorët, tregojnë se afërsisht po kjo shkallë polisemantizmi, me ndryshime të vogla në përqindje,

është edhe për pjesën tjetër të fjalësit të pacilësuar stilistikisht në të tre fjalorët shpjegues të gjuhës letrare shqipe.

Në krahasim me grupet e tjera leksikore fjalët e pacilësuar stilistikisht e kanë shkallën e polisemantizmit të ulët dhe të afërt me fjalët e cilësuar stilistikisht në tërësi ose në të gjitha kuptimet e tyre. Kurse fjalët e cilësuar stilistikisht në një ose në disa kuptime, e kanë më të lartë shkallën e polisemantizmit se dy grupet e mësipërme. Në këtë mënyrë, fjalët polisemantike në gjuhën letrare shqipe i kanë edhe më të mëdha mundësitë për kuptime të cilësuar stilistikisht. Ato janë një fond i rëndësishëm mjetesh leksikore që fitojnë ngjyrimet të veçanta dhe e thellojnë diferencimin stilistik në gjuhën letrare shqipe. Shtresa e parë e fjalëve që shqyrtoam deri tani, në shumicën e tyre i takon shtresës vendëse të leksikut të shqipes. Gjithashtu ato janë fjalë që njihen e përdoren në ligjërim nga njerëz të shtresave të ndryshme.

Dallimet e stileve të ndryshme pasqyrohen edhe në tërësinë e mjeteve gjuhësore dhe në radhë të parë të mjeteve leksikore. Krahas leksikut të pacilësuar stilistikisht, si element i këtyre stileve janë edhe fjalët e cilësuar stilistikisht, të cilat shpesh përbëjnë shtresa të tëra e grupe që janë tipike për variantet ligjërimore dhe stilet funksionale të gjuhës letrare shqipe. Ligjërimet dhe stilet funksionale të gjuhës letrare kanë jo vetëm tipare të përbashkëta, por edhe tipare dalluese që luajnë rol karakterizues. Në mënyrë të veçantë, për stilet funksionale kanë rëndësi dallimet në përdorimin e mjeteve leksikore dhe terminologjia e fushës përkatëse.

Siç e theksuam dhe më lart, leksiku me ngjyrim stilistik dhe emocional vlerësues i shkronjave të mësipërme, në tre fjalorët shpjegues, është ndarë në dy grupe. Njërin grup e përbëjnë fjalët e cilësuar stilistikisht ose në të gjitha kuptimet e tyre dhe grupin tjetër e përbëjnë fjalët e cilësuar stilistikisht në një kuptim a në disa kuptime të tyre.

Pjesën më të madhe të fjalëve të cilësuar stilistikisht e përbëjnë termat e degëve të ndryshme të shkencës e të teknikës, të cilët zakonisht shënojnë nocione të përpikta tekniko-shkencore dhe si fjalë priren më shumë drejt njëkuptimisë. Treguesit e shkallës së polisemantizmit të fjalëve të këtij grupi, sipas shkronjave të veçanta, kanë ndryshim të vogël midis tyre, kurse fjalët me përmbajtje të gjerë kuptimore, kanë fituar ngjyrimet të reja dhe janë diferencuar e kufizuar në disa kuptime, si nga pikëpamja e përdorimit të tyre në ligjërim, në stilet funksionale, ashtu edhe nga pikëpamja e ngjyrimëve emocionale-vlerësuese dhe e kuptimeve të tjera. Në këtë mënyrë fjalët polisemantike janë edhe një burim i rëndësishëm mjetesh leksikore për diferencimin stilistik në gjuhën letrare shqipe.

Për disa fjalë e kuptime fjalësh në fjalorët shpjegues të gjuhës sonë jepen edhe dy shënime për ngjyrimin stilistko-funksional dhe emocional-vlerësues, p.sh. *çunak*: 1.bsed, 2.tall.; *çupëlinë*, 1.bised 2.tall.; *çifut*: 1.bised., 2. keq; *bandill*: 1bised. 2.tall; *bar*.: 1.tall.,

2.mallk. etj. Kjo do të thotë se ngjyrimet subjektive që shprehin raportet e folësit me objektin e ligjërit janë bërë veçori karakteristike për variantet e ndryshme ligjërmore dhe stilet funksionale të gjuhës letrare shqipe. Prandaj kur ekzistojnë lidhje të tilla, ato kanë gjetur pasqyrim në fjalor.

Sipas pasqyrës së shënimeve nr.1, del se numri i përgjithshëm i shënimeve për karakteristikat stilistiko-funksionale, për sferën e përdorimit të fjalëve dhe për ngjyrimin emocional-vlerësues të fjalëve në shkronjat A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954 është 752 njësi leksikore, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, është 4729 njësi dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006 është 3844 njësi. Këto shënime që e përcaktojnë një fjalë në tërësi, në të gjitha kuptimet e saj, sipas karakteristikave të tyre themelore ndahen në disa grupe. Sistemi i plotë stilistik i gjuhës letrare shqipe në këtë pjesë të fjalorëve pasqyrohet nga këto shënime:

1. Shënime që japin kryesisht terminologjinë tekniko-shkencore në përdorim të gjerë dhe sferat e përdorimit të saj.
2. Shënime për shtresat e fjalëve me funksione stilistiko-ligjërmore në gjuhën letrare si: *bised.*; *libr.*; *art.*; *poet.*; *kr.pop.*
3. Shënime për shtresat e fjalëve me kufizime në rrafshin territorial dhe ligjërmore, si: *krah.* ; *arb.* ; *thjeshtligj.*
4. Shënime që japin karakteristikën stilistike të fjalëve në boshtin kohor, si: *vjet. hist.*
5. Shënime për ngjyrimet emocionale-vlerësuese, si: *iron.*; *keq.*; *mospërf.*; *përb.*; *përçm.përk.*; *shak. sharj.*; *tall.*
6. Një grup më vete përbëjnë disa shënime jogramatikore të fjalëve, si: *euf.* ; *fëm.* ; *mallk.* ; *ur.*

Për të gjitha këto shënime që tregojnë karakteristikat stilistiko-funksionale dhe emocionale-vlerësuese, janë dhënë shifrat konkrete për fjalësin e çdo shkronje për të tre fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe.

#### 4.3 PASQYRIMI I FJALËSIT TERMINOLOGJIK NË MAKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES TË GJSH

Në vëzhgimin që i është bërë fjalësit të fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, është konstatuar se pasqyrojnë shumë fjalë terminologjike. Ky konstatim është bërë në formën e vërejtjes për “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, pasi një pjesë e fjalëve terma në fjalorët e mëvonshëm shpjegues kanë marrë një status tjetër pasi, si rezultat i zhvillimit të shoqërisë, përdoren nga një masë e madhe folësish, duke zgjeruar fjalët kështu fushën e përdorimit e çlirohen nga të qenit thjesht term.

Leksiku terminologjik, ashtu si gjithë leksiku i gjuhës në përgjithësi, është mjaft i gjerë dhe i larmishëm. Sasia dhe cilësia e tij në gjuhën e sotme letrare shqipe pasqyron zhvillimin e vrullshëm të shkencës dhe të teknikës në vendin tonë, futjen e dijeve të ndryshme teknike dhe shkencore në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë shoqërore. Ky leksik, përgjithësisht, bën pjesë në leksikun e gjuhës letrare, ndaj ka karakter normativ. Megjithatë edhe për këtë fjalës, si për gjithë fjalësin e gjuhës letrare shqipe, shtrohet problemi i trajtimit teorik se cila fjalë e terminologjisë tekniko-shkencore do të përfshihet në fjalësin e fjalorëve shpjegues e me karakter normativ të gjuhës shqipe dhe cila fjalë jo. Kjo është dhe një nga arsyet pse në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, , megjithëse me një numër më të madh fjalësh në makrostrukturë, për shkronjat që po analizojmë, por dhe për gjithë fjalësin e fjalorit, ka një numër relativisht më të vogël të fjalëve të cilësuarastistikisht (4.2% të gjithë fjalësit të fjalorit ose 14% e fjalësit të këtyre shkronjave, kundrejt 5.6% të gjithë fjalësit të fjalorit dhe 18% të fjalësit të këtyre shkronjave në Fjalorin e 1980-ës), veçanërisht të atyre me shënime për terminologjinë tekniko-shkencore, pasi një pjesë e tyre ka marrë një status tjetër dhe ka hapësirë përdorimi më të madhe, pasi është kthyer në pjesë të fjalësit të përgjithshëm të gjuhës shqipe. Kjo ka edhe arsye të tjera, pasi parimet kryesore që përcaktojnë përbërjen e fjalësit të një vepre leksikografike me karakter normativ, veprojnë edhe mbi parimet e kriteret e veçanta për futjen ose mosfutjen e një pjese të leksikut të teminologjisë tekniko-shkencore në këtë vepër.

Në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe ka terma të përdorimit të përgjithshëm dhe terma specialë, që përdoren vetëm nga një rreth i ngushtë njerëzish specialistë, por ky dallim lidhet drejtpërdrejt me nivelin e përgjithshëm kulturor të njerëzve, i cili në vendin tonë, nga periudha e botimit të fjalorit të parë shpjegues, 1954, deri te Fjalori i fundit shpjegues, 2006, ka ardhur gjithmonë duke u rritur, sidomos hapja me botën e jashtme në vitet 90-të, rriti shkallën e njohjes së njerëzve, ndaj një pjesë e fjalëve të përdorimit të ngushtë zgjeroi sferën e njohjes duke u kthyer në fjalës të përgjithshëm. Një fenomen të tillë e ka përcaktuar qartë A.Kostallari te “Parimet...” për hartimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe ku thotë: “Ngritja e nivelit kulturor-arsimor të masave të gjera punonjëse dhe sidomos zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor kanë

bërë që terminologjia tekniko-shkencore e speciale në një shkallë mjaft të gjerë t'i kalojë kufijtë e rretheve të mbyllura të specialistëve e të bëhet pronë e masave të gjera të fshatit e të qytetit. Rritja e peshës specifike të terminologjisë në leksikun e përgjithshëm përbën një tipar dallues të rëndësishëm të shqipes letrare të pasçlirimit”.<sup>57</sup>

Në tabelat e mëposhtme kemi dhënë një pasqyrë të plotë të këtij fjalësi për shkronjat A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O, në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe 1954, 1980 dhe 2006, gjë që tregon pasqyrimin e mirë të këtij leksiku në makrostrukturën e tyre, veçanërisht në dy fjalorët e fundit. Siç theksuam më lart, që ky fjalës të bëhet pronë e një mase të madhe njerëzish varet nga niveli i përgjithshëm arsimor e kulturor i popullit. Me këtë nivel lidhen edhe burimet ku dokumentohet përdorimi i përgjithshëm i terminologjisë tekniko-shkencore, duke filluar që nga letërsia publicistike dhe shkencore popullore si dhe përdorimi i tyre në tekstet shkollore në të gjitha ciklet e arsimit.

Gjuhëtarët, para se të përfshijnë një term në fjalësin e fjalorit shpjegues, duhet të zgjidhin problemin se ç'pjesë të terminologjisë tekniko-shkencore do të zgjidhet e do të përfshihet në fjalësin e fjalorit e në ç'kriterë duhet të mbështeten për zgjidhjen drejt të këtij problemi, sepse jo të gjithë termat e shkencës e teknikës mund të përfshihen në fjalësin e fjalorit shpjegues, sado i madh të jetë ai, pasi një pjesë e tyre duhet të përfshihen në fjalorët terminologjikë të fushave të ndryshme të shkencës.

Zhvillimi tekniko-shkencor, duke shkuar paralel me ngritjen e nivelit arsimor e kulturor të popullit, ka bërë që terminologjia tekniko-shkencore e speciale, në një shkallë mjaft të gjerë, t'i kalojë kufijtë e një grupi të caktuar njerëzish specialistë e është bërë pronë e një mase të gjerë të njerëzve. Në këtë mënyrë rritet pesha specifike e terminologjisë në leksikun e përgjithshëm. Ndaj, si kriter i futjes së një termi në fjalorin shpjegues është përdorur roli i tij shoqëror dhe jo rëndësia që ka ai në sistemin e nocioneve të kësaj ose asaj dege të shkencës. Për këtë arsye terminologjitë e fushave të ndryshme të shkencës dhe të teknikës përbëjnë një problem të veçantë në hartimin e makrostrukturës së fjalorëve shpjegues të gjuhës.

Në tërësinë e fjalëve që përfshihen në shkronjat e përmendura më sipër, që sipas përlllogaritjeve janë respektivisht 7433 njësi leksikor në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, 12720 në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe 14389 njësi leksikore në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006. Numri i fjalëve terma që jepen me shënime të veçanta për fushën e përdorimit të tyre, është 740 fjalë në Fjalorin e 1954-ës, ose 10%, 2316 fjalë në Fjalorin e 1980-ës, ose 18.2%, dhe 2023 fjalë në Fjalorin e vitit 2006, ose 14% të leksikut të pasqyruar në këto shkronja në tërësi.

---

<sup>57</sup> Kostallari, A. Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e strukturës së gjuhës letrare, SF, 2, 1982, f.17.



**Tabela 1. Shënimet për fushën e përdorimit të terminologjisë.**

		anat	arkit.	art.	av.	biol.	blet.	bot.	bujq.	det.	drejt.	ek.	etnogr.	fet.	filoz.	fin.	fiz.	fiziol.	folk.	gjah.	gjell.	gjeodez.	gjeogr.	gjeol.	gjeom.	gjuh.	hek.
A	1954	3	2	0	0	0	0	6	0	0	3	2	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	5	1	1	12	0
	1980	7	6	4	2	9	0	49	11	5	34	7	4	15	3	2	10	3	1	0	3	0	4	2	2	11	0
	2006	8	7	7	3	7	0	34	7	3	23	4	2	15	2	8	8	2	1	0	2	2	4	2	2	11	0
B	1954	4	1	0	0	0	0	26	0	0	1	1	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	7	1	2	8	0
	1980	15	2	3	1	7	0	89	5	8	4	3	8	14	2	7	7	0	1	0	2	0	10	2	9	9	0
	2006	16	2	6	2	8	0	76	6	5	0	3	6	13	2	7	8	0	1	0	4	0	13	2	8	12	0
C	1954	3	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	1	0
	1980	3	1	0	0	2	0	18	0	3	7	0	1	1	3	1	1	0	1	0	2	0	4	2	3	4	0
	2006	3	1	0	0	2	0	14	0	2	6	0	1	1	3	1	1	0	0	0	2	0	5	2	2	2	0
Ç	1954	0	0	0	0	0	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0
	1980	6	0	3	0	1	0	14	2	0	6	1	1	0	0	5	3	0	2	1	4	0	2	1	0	5	0
	2006	3	0	3	0	1	0	9	2	0	4	4	2	0	0	6	5	0	2	1	3	0	2	1	0	4	0
DH	1954	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0
	1980	1	0	1	0	0	0	5	1	0	0	1	2	1	0	1	0	0	0	0	1	1	1	0	2	2	0
	2006	1	0	1	0	0	0	7	1	0	0	2	1	2	0	2	0	0	0	0	0	1	1	0	2	2	0
F	1954	2	0	0	0	0	0	19	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	1	1	7	0
	1980	12	1	5	1	5	2	62	5	1	9	7	9	9	7	4	3	3	3	0	1	0	3	4	2	2	2
	2006	13	2	10	1	5	2	45	4	2	10	6	5	10	9	6	4	5	4	0	1	0	4	5	2	2	3
H	1954	1	1	0	0	0	0	23	0	0	3	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	4	1	3	3	0
	1980	1	0	1	1	1	0	20	1	1	3	3	0	5	0	0	2	1	1	0	4	0	2	3	3	3	1
	2006	4	1	1	1	2	0	18	1	1	4	3	0	7	0	0	2	1	2	0	2	0	2	3	3	3	1
K	1954	20	2	0	0	0	0	84	0	0	6	3	0	0	1	0	8	0	0	0	0	0	6	1	12	17	0
	1980	17	4	5	3	4	0	64	8	5	13	9	12	19	3	8	9	3	3	0	8	0	6	8	9	10	0
	2006	16	6	6	3	5	0	47	6	7	14	8	9	21	4	9	8	4	3	0	4	0	7	9	10	10	0
LL	1954	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	0	0	1	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0
	2006	0	0	1	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0
O	1954	0	0	0	0	0	0	9	0	0	0	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	3	0	2	3	0
	1980	2	0	2	0	0	0	7	2	0	1	3	0	3	5	3	2	0	0	0	1	0	2	0	1	8	0
	2006	2	0	3	0	0	0	8	1	0	0	2	0	2	5	3	2	0	0	0	0	0	2	0	1	6	0
Shu	1954	33	6	0	0	0	0	179	0	0	13	7	0	0	6	1	13	0	0	0	0	0	26	6	22	55	0
	1980	64	14	25	8	29	2	330	35	23	77	34	37	67	23	31	37	10	12	1	26	1	34	22	31	56	3
	2006	66	19	38	10	30	2	261	28	20	61	32	26	71	25	42	38	12	13	1	18	3	40	24	30	54	4

**Tabela 2. (vazhdim i tabelës 1). Shënimet për fushën e përdorimit të terminologjisë.**

		hidrol.	hist.	kim.	kinem.	let.	mat.	meteor.	min.	mit.	mjek.	muz.	ndert.	spec.	sport.	shah.	shtypshkr.	teater.	tek.	tekst.	treg.	usht.	veter.	zool.	zyrt.	SHUMA	
A	1954	0	0	12	0	0	0	0	4	0	6	4	0	0	2	0	0	0	0	0	0	4	0	14	0	83	
	1980	0	36	24	1	4	3	1	11	4	22	8	6	14	9	0	1	2	22	3	1	27	2	64	13	472	
	2006	0	17	22	1	5	2	1	9	2	29	7	5	11	9	0	1	3	12	2	1	22	2	27	14	368	
B	1954	0	0	9	0	0	1	0	1	0	4	6	0	0	2	0	0	0	0	0	0	4	1	27	0	108	
	1980	0	32	13	0	2	6	1	2	7	10	11	2	15	8	0	1	2	6	1	1	12	5	95	8	448	
	2006	0	17	11	0	2	4	1	2	4	12	12	4	9	6	0	1	2	3	1	1	13	7	62	12	386	
C	1954	0	0	1	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	13	0	26
	1980	0	7	4	0	1	1	2	3	3	5	5	0	11	5	1	3	0	17	0	0	0	0	1	38	6	170
	2006	0	9	3	0	1	1	2	4	3	4	6	0	9	3	1	4	0	10	0	0	0	1	33	7	149	
Ç	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12	0	23	
	1980	0	7	3	0	1	2	0	1	0	4	7	3	7	5	0	4	0	22	0	1	4	1	23	4	156	
	2006	0	3	3	0	1	2	0	1	0	5	9	2	8	4	0	4	0	12	0	1	3	1	20	6	137	
DH	1954	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6	0	11	
	1980	0	1	0	1	2	4	0	0	2	1	1	0	2	2	0	0	0	1	0	0	0	0	2	0	39	
	2006	0	1	0	1	3	4	0	0	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	37	
F	1954	0	0	2	0	0	2	0	0	0	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	1	19	0	64	
	1980	0	9	6	0	7	1	4	2	5	7	7	2	17	8	1	7	2	13	1	2	17	2	31	14	327	
	2006	0	6	10	0	11	1	5	3	6	8	9	2	10	4	1	8	2	6	1	2	19	2	18	15	309	
H	1954	0	0	6	0	0	0	0	0	0	9	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	3	17	0	82	
	1980	4	10	7	2	3	2	0	0	1	5	0	1	1	6	0	0	0	1	0	0	2	1	13	5	121	
	2006	6	6	8	2	3	2	0	0	1	4	0	1	0	4	0	0	0	0	0	0	2	1	7	6	115	
K	1954	0	0	12	0	0	5	0	2	0	7	10	0	0	3	0	0	0	0	0	0	18	5	77	0	299	
	1980	2	42	12	1	7	1	0	4	4	16	14	4	7	10	0	3	1	7	1	3	33	3	66	3	474	
	2006	2	28	13	2	8	1	0	4	3	16	14	5	6	10	0	3	1	4	1	3	35	4	43	3	425	
LL	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	0	7	
	1980	0	1	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	2	0	0	0	0	1	0	0	0	0	4	0	15	
	2006	0	1	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	3	0	14	
O	1954	0	0	4	0	0	0	0	0	0	4	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	0	0	0	37	
	1980	0	7	7	1	2	1	0	0	2	4	7	0	3	2	1	2	0	1	0	0	8	0	3	1	94	
	2006	0	5	9	1	2	1	0	0	2	3	6	0	2	2	1	2	0	0	0	0	8	0	1	1	83	
Shu	1954	0	0	46	0	0	9	0	8	0	32	33	0	0	7	0	0	0	0	0	0	38	11	189	0	740	
	1980	6	152	76	6	29	21	8	23	29	75	60	18	79	55	3	21	7	91	6	8	103	15	339	54	2316	
	2006	8	93	79	7	36	18	9	23	23	83	64	19	56	42	3	23	8	48	5	8	102	18	216	64	2023	

Kjo pjesë e terminologjisë tekniko-shkencore përbën atë pjesë të fjalëve- terma, që është përfshirë në fjalorët shpjegues që po shqyrtojmë dhe që është pajisur me shënime të veçanta nga pikëpamja e fushës së përdorimit për shenjat që kemi marrë në studim, të cilat janë pjesë e elementeve jashtë nomenklaturës së fjalorëve shpjegues e paraqiten në parathëniet etyre. Shenjat për terminologjinë tekniko-shkencore me përdorim të gjerë dhe për sferat e përdorimit të saj në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe janë këto: *anat.*, *arkit.*, *astr.*, *av.*, *biol.*, *blet.*, *bot.*, *bujq.*, *det.*, *drejt.*, *ek.*, *etnogr.*, *fet.*, *filoz.*, *fin.*, *fiziol.*, *folk.*, *gjah.*, *gjell.*, *gjeod.*, *gjeogr.*, *gjeol.*, *gjeom.*, *gjuh.*, *hek.*, *hidrol.*, *hist.*, *him.*, *kinem.*, *let.*, *mat.*, *meteor.*, *min.*, *mit.*, *mjek.*, *muz.*, *ndërt.*, *spec.*, *sport.*, *shah.*, *shtypshkr.*, *teatër.*, *tek.*, *tekst.*, *treg.*, *usht.*, *veter.*, *zool.*, dhe zyrt për fjalorët shpjegues të viteve 1980 dhe 2006, ndërsa në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, janë vendosur vetëm 25 shenja për fjalësin e cilësuar stilistikisht.

Shënimet për terminologjinë tekniko-shkencore dhe për sferat e përdorimit të fjalëve japin kufizimin për përdorimin e leksikut sipas degëve të ndryshme të shkencës. Ato cilësojnë kryesisht terminologjinë tekniko-shkencore, e cila i ka kaluar kufijtë e rrethëve të ngushta të specialistëve dhe është bërë e njohur nga një masë e gjerë njerëzish. Por, siç dihet, midis fjalëve terma e joterma, në gjuhë nuk ka kufij të prerë. Për këtë A.Kostallari shprehet se “njësitë leksikore kalojnë anasjelltas nga njëra ndarje në tjetrën. Edhe në gjuhën tonë të sotme vihen re qartë dy procese të përkundërta. Më njërin anë terminologjia depërton mjaft gjerë nga të ashtuqujturat “mikrogjuhë” a “nëngjuhë” të shkencës e të teknikës në gjuhën e përgjithshme të masave punonjëse, domethënë terminologjia shterminologjizohet. Nga ana tjetër njësi të leksikut të përgjithshëm popullor terminologjizohen”.<sup>58</sup>

Nga fjalësi i shkronjave që po shqyrtojmë, po japim shembuj me fjalët terma që janë pasqyruar në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe 1980 dhe 2006. Nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, po përmendim:

**Anat.** *bajame, barkushe, brinjë, bishtore, bubrek, cerebral, cipë, faring, fejë, fikth, femëror, fluskë, optikë etj.*

**Arkit.** *ballinë, fasadë etj.*

**Art.** *balet, baritor, barok, baletmaestër, figurë, formalist, formalizëm, futurizëm etj.*

**Bot.** *bogalinë, balç, ballgun, bambuja, banane, baobab, bar, barbut, barmëz, barkuqe, bërthamëz, bigë, blinore, bordullak, boronicë, bozhure, bredh, broker, bush, bushk, buzore, currubabë, cimë, cimbël, cikutë, ciklaminë, cedër, çaj, çallmarie, çetinjë, çallmar, çafier, dhëmbëkal, dhiozmë, farëkuqe, farëveshur, farore, fasule, feraraç, ferrë, farëbardhë, fier, fik, fistik, halëz, halor, hardhi, hashash, hibrid, hidhës, llashtë, okër, etj.*

<sup>58</sup> Kostallari, A. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Tiranë, 1984, f.27-28.

**Biol.***bacil, bastard, bërthamëz, bërthamore, brezni, bakter, cist, farë, fryt etj.*

**Bujq.***bulëzon, bykëzim, bykëzot, brazdëhapës, çarësie, foragjere, frutikulturë, fshesë, humus, olivikulturë etj.*

**Det.***ballamar, bash, bocman, bovë, bregëzohet, bunacë, basen, cekoj, cimë, cokë etj.*

**Drejt.***bashkëfajësi, bashkëpronësi, bashkëtrashëgimtar, bashkëzotërim, civil, bashkëzotëroj, cilësues, cilësi, civil, çatdhesim, çnjohje, faj, fajësi, fajtor, fuqi etj.*

**Etnogr.***babazot, bajrak, be, betar, bujë, brushtulluk, bukëvale, bullë, cipull, fjalëtar, flok, flamurtar, flakadan, fustan, fustanellë, fisetj.*

**Fet.***baba, bajram, baritor, babël, bari, bektashi, bektashian, bektashizëm, bekuar, blatoj, budist, budizëm, celebroy, ferr, fli, flijoj etj.*

**Filoz.***cilësi, cinik, cinizëm, fideizëm, formalist, formë, frenim, fushë etj.*

**Fin.***bankënotë, bilanc, barazuar, bruto, buxhet, buxhetor, cak, çek, çel, çelur, çliruar, fletëdalje, fletëhyrje, fond, forcë, fushë, oblikacion, operacion etj.*

**Gjeom.***barabrinjë, baraslargësi, baraslarguar, bashkëqendror, bazë, brendashkruaj, brendashkruar, brinjë, brinjëshëm, brinjëndryshëm, cilindër, dhjetëkëndësh, hiperbolë, horizontale etj.*

**Gjuh.***bashkëngjitje, bashkërenditje, bashkërenditës, bashkëtingëllor, bisedor, bukurzanor bukurshqiptim, cilësor, cilësues, çerdhe, çuditëse, dhanore, femërore, fërkimore, figurativ, fishkëllore, fjalë, fjalëndryshues, fjalësi, fjalësore, fjalëz, folje, foljor, fonemë, fonetikë, formë, formësim, frazeologjia, frazë, habitore, hundore, homonim etj.*

**Hist.***barbari, bajrak, bajraktar, bajraktarizëm, bashibozuk, bashkësi, bedel, bej, bejler, brigadë, bujkrob, bylyk, bylykbash, cens, censor, cinik, citadelë, çaus, çifçi, çiflig, çifligar, çirak, çlirim, faraon, ferman, feudi, fis, forum, harkëtar, heshtmbajtës, hordhi, haraç, haraçpagues etj.*

**Muz.** *bariton, bas, bashkëtingëllim, bateria, bigonë, buzuk, curlë, cimbal, cezurë, celulë, çakordim, çakordoj, çelës, fagotë, fanfarë, fantazi, flaut, frazë, fushë etj.*

**Zool.***bajukë, bajzë, baldosë, balenë, balash, ballëverdhë, baribojë, baroskë, belbë, belushkë, bengu, berëz, beronjë, bilbileshë, bishtafurkë, bishtlëkundës, bishtlopatë, bizon, bletë, brejtës, breshkë, brufull, bubë, buburrec, bubuzhel, bushtër, buf, bulkth, cakorre, cerre, ciklop, cimbur, ciqë, cirikal, ciqë, cirlë, cironkë, cjap, çafkë, çafkëbardhë, çafkore, çakall, fajkore, fazan, ferracak, ferrës, fikës, fokë, harabel etj.*

Sot vëmë re se terminologjia shkencoredhe teknike ka pësuar ndryshime të mëdha e të dukshme. Shumë terma që janë përdorur në periudhat e mëparshme të zhvillimit e të lëvrimin të shqipes, sot nuk përdoren më dhe kanë dalë nga fondi i terminologjisë aktive

ose kanë zënë vend në shtresën e vjetruar të saj. Zakonisht këta terma emërtojnë sende e mjete të vjetra të prodhimit, të cilat ose nuk përdoren më, ose janë zëvendësuar me emërtime të reja e më të përshtatshme të shqipes. P.sh. fjala *parmendë* që figuron në fjalësin e fjalorit të 1980-ës, nuk përcaktohet si term në fjalorin e vitit 1954, pasi aty thuhet vetëm: *Parmendë-a ef. (emër femëror)= almisë për të lëruar tokën*<sup>59</sup> FGJSSH f.533). dhe mungon në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006. Por për vlerat simbolike që ka marrë, për të shënuar diçka të prapambetur si dhe një simbol të evolucionit të shoqërisë njerëzore, nuk duhej përjashtuar nga makrostruktura e “Fjalorit të gjuhës shqipe” 2006.

Shpeshherë, krahas kuptimit terminologjik, te disa fjalë-terma zhvillohen edhe kuptime të reja, që nuk kanë karakter terminologjik. Ky është tregues i zgjerimit të përdorimit të leksikut terminologjik dhe i afrimit të tij me leksikun e përgjithshëm, neutral. P.sh. fjala *gangrenë*, e cila, përveç kuptimit të parë terminologjik në fushën e mjekësisë “*kalbëzim ose shkatërrim i indeve të një pjese të organizmit, nga që nuk ushqehet me gjak, vendi i kalbëzuar në një pjesë të trupit a në një organ*”<sup>60</sup> ka fituar edhe një kuptim të dytë të figurshëm, joterminologjik: “*diçka që të bren vazhdimisht e të shkatërron dalëngadalë*”<sup>61</sup>

Përveç fenomenit të fitimit të kuptimeve joterminologjike nga fjalët-terma, vihet re dhe fenomeni tjetër, që mjaft fjalë të fondit të leksikut të përgjithshëm e të zakonshëm të gjuhës fitojnë në përmbajtjen e tyre edhe kuptime të veçanta terminologjike nëpërmjet specializimit dhe përdorimit në një degë të veçantë të shkencës, të teknikës e prodhimit, duke zgjeruar kështu përmbajtjen e tyre kuptimore. P.sh. fjala *ushqim* ka në strukturën e saj kuptimore tetë kuptime, nga të cilat njëri ka karakter special terminologjik: “*gjithçka me të cilën punon ose që e përpunon një makinë a një paisje, ose gjithçka që përpunohet prej tyre: energjia e nevojshme që vë në lëvizje diçka: skema e ushqimit të makinës; ushqimi i radios. I jep ushqim. Çon ushqim. Ndërpres ushqimin. etj.*”<sup>62</sup>

Fenomeni i shterminologjizimit, apo afrimit të termave të leksikut terminologjik me leksikun e përgjithshëm e të zakonshëm të gjuhës, fillon nga çasti kur nocioni që shprehet prej tyre, njihet e kuptohet nga një rreth i gjerë njerëzish. Ajo pjesë e leksikut që nuk shpreh nocione të përgjithshme, nuk është përfshirë në fjalësin e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe. Nga kjo del se karakteri i ngushtë i fjalëve-terma është marrë si tipar vendimtar për përjashtimin e leksikut terminologjik nga fjalorët shpjegues e me karakter normativ.

Nga analiza që kemi bërë për vendin e leksikut terminologjik në fjalësin e shkronjave të mësipërme, sidomos në dy fjalorët e fundit, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe

---

<sup>59</sup> FGJSH, 1954, F. 378.

<sup>60</sup> FGJSSH, 1980, f.533.

<sup>61</sup> Po aty, 1980, f.533.

<sup>62</sup> FGJSSH, 1980, f.2097.

“Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, arrijmë në përfundimin se janë pasqyruar gjerë fjalët me burim popullor, forma e gjuhës së shkruar, veçanërisht te Fjalori i 1980-ës, ku fjalësi terminologjik zë rreth 49% të fjalësit të cilësuar stilistikisht dhe rreth 18 % të gjithë fjalësit të këtyre shkronjave. Përafërsisht të njëjtat fjalë-terma, në aspektin numerik, janë pasqyruar edhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, ku fjalësi terminologjik zë rreth 52 % të fjalësit të cilësuar stilistikisht dhe rreth 14% të fjalësit të përgjithshëm të këtyre shkronjave.

Duke anlizuar në detaje fjalësin terminologjik të pasqyruar në dy fjalorët shpjegues, jo të gjitha fjalët që janë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, janë edhe te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, ashtu sikurse te ky i fundit ka fjalë që nuk janë në Fjalorin shpjegues të 1980-ës. (Një gjë e tillë ndodh edhe për fjalësin pa cilësime stilistike). P.sh. disa fjalë terma që ndodhen në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, por jo të “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, janë: *fejzë, fletroci, çaçanik, çaf, çikaverë, halëz, hardhiore, hartin, hunop, hyshtër, hut, hibral, huruvajkë, orëvdekur, orëvrrarë* etj. Fjalë-terma që janë në Fjalorin e 2006-ës, por jo në Fjalorin e 1980-ës janë: *çafërri, çapëz, çobonzëzë, çapërkos, hijedashës, hermthi, halës, hanurika, fluturash të, ferrkë, flatrorë, folez, fplezues, fshikë, oksidues, ojtini, obrakth, ormis, observoj, oktaedër, oksiton* etj.

Këta dy fjalorë shpjegues, si fjalorë me numër më të madh njësisish leksikore, kanë pasqyruar drejt një nga tiparet dalluese të rëndësishme të gjuhës letrare shqipe, që është rritja e peshës specifike të terminologjisë në leksikun e përgjithshëm. Masa e përfshirjes së terminologjisë në një fjalor shpjegues dhe raporti i saj me leksikun joterminologjik, përbën një nga detyrat kryesore të çdo hartuesi fjalori. Synimi ynë këtu është të krijojmë një ide për pasqyrimin e fjalëve të cilësuar stilistikisht dhe, si pjesë të tyre, pasqyrimin e leksikut terminologjik në shkronjat që analizuam. Ky vështirim mendojmë se do të shërbejë për të ndërtuar në mënyrë më të studiuar fjalësin e fjalorit të ardhshëm, duke përfshirë në të në përpjestime më të mëdha leksikun terminologjik.

Leksiku terminologjik, i cili u shqyrtua vetëm në disa drejtime të caktuara, në fakt është edhe më i gjerë, sepse një pjesë e tij është dhënë pa shënime të veçanta për fushën speciale a për fushën e përdorimit, kurse një pjesë është shterminologjizuar dhe në fjalorët shpjegues jepet si fjalë e ligjërit libror (me shënimin përkatës libr.), ose kur kanë fituar një përdorim të përgjithshëm dhe në stile të ndryshme të gjuhës, jepen pa ndonjë shënim të posaçëm stilistik. P.sh. *osmanishtja* është cilësuar te Fjalori i 1980-ës, (*osmanisht/e~ja f. gjuh. Turqishtja e vjetër që përdorej në kohën e Perandorisë Osmane*.<sup>63</sup>, por jo te Fjalori i 2006-ës, (*osmanisht/e -ja, f. turqishtja e vjetër e kohës së Perandorisë Osmane, gjuha osmane*.<sup>64</sup>

<sup>63</sup> FGJSSH, 1980, f.1311.

<sup>64</sup> FGJSH, 2006, f.725.

#### 4.4 SHITESAT E FJALËVE ME FUNKSIONE STILISTIKORE-LIGJËRIMORE NË FSHGJSH

Shtresën e fjalëve me funksione stilistikore-ligjërimore në gjuhën shqipe, në fjalësin e shkronjave që po analizojmë, po e japim si grup më vete. Për këto fjalë, në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, janë përdorur këto shënime: *bised.*, *libr.*, *lart.*, *poet. dhe kr.pop.* Shënimi *bised.* u është vënë atyre fjalëve ose kuptimeve të tyre të veçanta që përdoren zakonisht në ligjërimin bisedor. Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, nga të gjitha grupet e fjalëve me shënime stilistikore, veç shënimeve për terminologjinë, përdoret vetëm shënimi *vjet.* (e vjetruar), edhe kjo në përmasa të pakonsiderueshme (gjithsej 12 fjalë nëfjalësin e shkronjave që po shqyrtojmë), ndaj për shtjellimin e grupeve të mëposhtme të fjalëve me shënime stilistikore, nuk do të marrim në shqyrtim fjalësin e shkronjave në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954.

Fjalët e ligjërimin bisedor që janë në këto shkronja, të shprehura në shifra janë: në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, 657 fjalë, ose 5% e fjalësit të përgjithshëm dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006 janë 544 fjalë, ose afërsisht 4.4% të fjalësit të përgjithshëm të shkronjave që shqyrtoam në këta fjalorë shpjegues. Me këtë shënim në këta fjalorë kemi fjalë të tilla, si: *babllëk, babaxhan, babëlok, baçkollomë, badihava, baft, bahçe, bajagi, barjot, bajmak, barkëdërrasë, barkkeq, barklubi, barkthes, bataqçillëk, batallis, batërdi, batis, baxhia, beden, begani, bekoj, beqarllëk, berbecul, bollëk, brekëçjerrë, brekëzi, budalla, buf, burrëc, ca, cakërr, cakos, capërloj, cazë, cergos, cergurinë, cingëri, cingo, copit, cakërron, çakallos, çakërdis, çalltis, çamarrok, çengel, çepëlit, çilimillëk, çapkënkë, çaprashit, çeço, çehreverdë, çehrevrarë, çekmexhe, çoban, çunak, fodull, fodullëk, foleqesh, for a, frëngjuzë, fringo, fshatçe, fukara, fukarallëk, hajdut, hajvan, hallakat, hallall, haallosem, hallashtis, hallvaxhi, hamall, handakos, haram, harbuçe, haraq, hesap, hiç, honeps, horr, huq, hysmet, kollaj, kopil, koromane, krekos, kullandris, llaçkë, llafazan, llagap, llaktaris, llapëmadh, odë, oxhak etj.*

Shënimi *libr.* u është vënë atyre fjalëve, ose kuptimeve të tyre, që përdoren zakonisht në ligjërimin libror. Në këtë shtresë leksikore përfshihen fjalët e huazuara që në të shumtën kanë sinonime fjalë të përdorimit të përgjithshëm, fjalë që janë formuar në gjuhën e shkruar, të cilat kanë karakter abstrakt ose terminologjik. Shtresa leksikore e ligjërimin libror përbën afërsisht 3.3%, të mjeteve leksikore të shkronjave të mësipërme, ose 426 njësi, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe afërsisht 2.8% të fjalësit të këtyre shkronjave, ose 401 njësi, në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006. Fjalë me shënime të tilla në fjalorët që përmendëm janë: *bakteror, bashkëpërpykëje, bashkëprodhim, bashkërendoj, beniamin, besëkotësibesëpak, besëthyerje, besimplotë, bijësi, bimëtore, bio, birësim, botëndijim, brendior, balancohet, ballkanolog, banalitet, barazimtar, bashkëbanim, bashkëbisedë, bahkëluftoj, bashkëpërgjegjës, bashkëmbart, burues, civil,*

*cilësuar, ciklopi, ciklik, cerebral, centralizoj, centralizim, cekëtinë, çastësi, çekuilibër, çfarësi, çmendurisht, , fantastik, fantazi, fantazoj, fashistizim, fataliste, fatalizëm, favor, favorizim, fenomen, fetishizëm, filantropi, fobi, formalitet, harmonik, harmonikisht, herbarium, hermafroid, hermetik, hershmëri, heterogjen, hidro, hiper, homoseksual, hovdhënës, konsensual, konsideratë, konspiracion, konstrukt, konsultativ, kontakt, kontigjent, kontrast, konvencion, konventë, konvergoj, konvertoj, kooptoj, korpus, kozmos, kredi, ksenofob, ksenoman, kuintesencë, kurrikula, llogaridhënie, llojshmëri, obskurantizëm, okupacion, obligoj, observoj, okupoj, opozitë, optimal, orakull, orator, organikisht, orbitë, orientoj, ovacion etj.*

**Shënimet për funksionet stilistike-ligjërimore, shtresat e fjalëve me kufizime në rrafshin territorial dhe ligjërimit, si dhe karakteristikat stilistike të fjalëve në boshtin kohor.**

		bised.	libr	art.	poet.	kr.pop.	Shuma	krah.	arb.	Thjeshtligj.	Shuma	vjet.	hist.	Shuma
A	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	3
	1980	74	126	8	14	1	223	43	2	21	66	73	36	109
	2006	58	134	7	15	1	215	12	1	7	20	24	17	41
B	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	0	4
	1980	154	61	4	6	0	225	16	7	7	30	74	32	106
	2006	128	44	6	14	0	192	12	3	4	19	34	27	61
C	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	29	16	1	2	1	49	78	1	1	80	12	2	14
	2006	27	13	1	2	1	44	52	1	1	54	7	1	8
Ç	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	91	24	0	0	0	115	35	0	2	37	53	7	60
	2006	71	19	0	0	0	90	24	0	1	25	22	7	29
DH	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	4	5	0	1	2	12	1	0	0	1	9	3	12
	2006	4	4	0	1	2	11	1	0	0	1	2	1	3
F	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	2
	1980	86	61	7	9	3	166	8	1	4	13	32	9	41
	2006	59	68	11	12	5	155	3	2	4	9	14	8	22
H	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	63	13	2	8	0	86	26	0	0	26	15	7	22
	2006	54	14	3	9	0	80	12	0	0	12	8	6	14
K	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	3
	1980	64	82	7	4	2	159	19	0	3	22	48	67	115
	2006	56	72	9	3	2	142	11	0	2	13	22	42	64
LL	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	33	4	0	0	0	37	0	0	0	0	3	1	4
	2006	36	3	0	0	0	39	0	0	0	0	1	0	1
O	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	20	26	0	0	0	46	13	0	0	13	22	0	22
	2006	16	24	0	0	0	40	3	0	0	3	9	0	9
Shu	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12	0	12
	1980	618	418	29	44	9	1118	239	11	38	288	341	164	505
	2006	509	395	37	56	11	1008	130	7	19	156	143	109	252



Fjalët me shënimet stilistike **art.**, **poet.** dhe **kr.pop.** nuk kanë ndonjë peshë specifike të madhe në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, në fjalësin e shkronjave që po shqyrtojmë. Megjithatë ato kanë një forcë të veçantë shprehëse. Kështu fjalët me shënimin **art.** janë fjalë e shprehje me karakter libror që kanë ngjyrim solemn e fuqi shprehëse, ndaj ato quhen dhe fjalë të stilit të lartë. Me këtë shënim në Fjalorin e 1980-ës janë 29 fjalë dhe në Fjalorin e 2006-ës janë 37 fjalë, në fjalësin e shkronjave që po shqyrtojmë. Ndërsa shënimi **poet.** është përdorur për ato fjalë e shprehje poetike që, sipas traditës, kanë lindur dhe janë përdorur në krijimet poetike. Ato nuk kanë kaluar në shtresën e leksikut të përgjithshëm të gjuhës letrare. Me këtë shënim në Fjalorin e 1980-ës janë 45 fjalë dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, janë 57 fjalë. Shënimi **kr.pop.** u është vënë fjalëve a shprehjeve të krijimtarisë gojore popullore, të cilat, edhe pse përfshihen në gjuhën letrare, e ruajnë ngjyrimin e tyre folklorik.

Fjalë me shënimet e mësipërme në fjalorët shpjegues, me ndryshime të papërfillshme midis tyre, duke pasur parasysh peshën e vogël specifike të këtyre fjalëve në raport me fjalësin e përgjithshëm të shkronjave që po analizojmë, por dhe me fjalësin e përgjithshëm të fjalorëve në përgjithësi, janë fjalë të tilla, si:

**Art.** *balet, baritor, barok, baletmaestër, figurë, formaliste, futurizëm, klasicizëm, klasik, komedi, komik, kompozicion, kompozoj etj.*

**Poet.** *ballargjend, ballçelik, ballëgështenjë, ballëndritur, ballëpruar, ballëstolisur, bardhëllosh, belunazë, bjeshkatar, briartë, buklore, buzëkarafil, buzëtrëndafil, faqehënë, faqëndritur, fjalëzjarrtë, flakadani, flatër, flokëlëshuar, fytyrëhënë, hareplot, hënëplot, hyjneshë, kaltëror, kaltërosh, krahëshkruar.*

**Kr.pop.** *cullufedredhëz, fletë-fletë, fara.*

Fjalët e ligjërimit bisedor, libror të stilit të lartë, fjalët poetike dhe fjalët e krijimtarisë gojore popullore, që janë grupuar së bashku si shtresa me funksione të caktuara në gjuhën letrare, përbëjnë afërsisht 9% të njësive leksikore të shkronjave A, B, C, ç, DH, F, H, K, LL, O në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, ose 1118 njësi leksikore dhe rreth 7% në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, ose 1008 njësi leksikore.

#### 4.5 SHITESAT E FJALËVE ME KUFIZIM NË RRAFSHIN TERRITORIAL TË PASQYRUARA NË MAKROSTRUKTURËN E FSHGJSH

Leksiku dialektor e krahinor ka gjetur vendin e tij për t'u pasqyruar në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Pasqyrimi i tij në këta fjalorë është kushtëzuar nga tipi i fjalorit, nga kriteret e përdorura, nga niveli i vjeljes së materialit leksikor, nga botimet e ndryshme leksikografike etj. Në leksikografinë tonë është përcaktuar një qëndrim i drejtë shkencor për lëndën leksiko-semantike e frazeologjike me burim krahinor, duke përfshirë në fondin e fjalorëve shpjegues të shqipes shumë njësi të kësaj natyre. Kriteret përzgjedhëse të fjalësit i ka përcaktuar A.Kostallari në studimin e tij “Parimet themelore për hartimin e fjalorit të gjuhës shqipe”, ku ndër të tjera thotë: “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe duhet t'i shohë të gjitha fjalët e fondit leksikor të shqipes, pavarësisht burimit të tyre, si pasuri e përbashkët kulturore të popullit shqiptar”.<sup>65</sup>

Leksiku dialektor e krahinor, duke qenë lëndë potenciale pasuruese e gjuhës letrare shqipe, është e natyrshme, që shumë fjalë të tij, për shkak të vlerave që kanë, kapërcejnë kufijtë dialektorë dhe bëhen pronë e gjuhës letrare duke fituar një status mbarëkombëtar. Ky leksik në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe është pasqyruar me shënimin **krahin..** Për këtë A.Kostallari shpreh: “Shënimi krahinor do t'u vihet vetëm atyre fjalëve, që vetë zhvillimi i jetës ekonomiko-shoqërore i ka nxjerrë në vendin e normës leksikore”<sup>66</sup> Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe janë përfshirë tre tipa leksikografikë fjalësh dialektore:

- Fjalë dialektore që janë bërë pronë gjuhës letrare dhe që u ndiehet ende karakteri dialektor i burimit si; *akullnajë, amtare, doke, gëmushë, hulli* etj.
- Fjalë dialektore që po përvetësohen ose kanë perspektivë të përvetësohen nga gjuha letrare si: *emnak, tubim, përdhej* etj.
- Fjalë dialektore që nuk janë përvetësuar e mund të mos përvetësohen më tej nga gjuha letrare dhe që përfshihen në fjalor duke u vënë shënim *krahinor*. Pra ky shënim u është vënë atyre krahinorizmave që përdoren në të folmet popullore dhe që zakonisht kanë një sinonim në gjuhën letrare. Ky shënim u vihet edhe varianteve fonetike krahinore që pasqyrohen në fjalor, sepse kanë përdorim të gjerë në gjuhën e shkruar. Gjithashtu e marrin këtë shënim ato fjalë që shënojnë bimë, kafshë, sende shtëpiake, vegla të ndryshme e veshje popullore që ndryshojnë sipas krahinave dhe në përdorimin letrar ose zyrtar mbizotëron një fjalë tjetër.

<sup>65</sup> Kostallari, A. Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, në “Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972, f.17.

<sup>66</sup> Kostallari, A. po aty, f .67.

Në këtë shtresë fjalësh hyjnë edhe fjalët me shënime stilistike **arb.** dhe **thjeshtligj.** Shënimi **arb.** u është vënë fjalëve që vijnë nga arbëreshët e Italisë ose Greqisë në rrugë të ndryshme, sidomos nëpërmjet letërsisë arbëreshe. Kurse shënimi **thjeshtligj.** u është vënë atyre fjalëve ose kuptimeve që i përkasin ligjërit të thjeshtë. Në këtë shtresë leksikore përfshihen sidomos disa huazime turke ose fjalë me prapashtesa turke që kanë ngarkesë të theksuar. Gjithashtu këtu hyjnë edhe ato fjalë që përdoren si sharje ose karakterizim negativ për njerëzit dhe që kanë ngarkesë vlerësuese të rëndë ose sharëse.

Shënime për shtresat e fjalëve me kufizime në rrafshin territorial për fjalësin e shkronjavë që po analizojmë (A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O), përbëjnë afërsisht 2% të numrit të përgjithshëm të fjalëve në “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, ose 288 njësi dhe 1.1% të numrit të përgjithshëm të fjalëve në këto shkronja në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, ose 156 njësi. Për fjalorin e vitit 1954, siç e theksuam edhe më lart, nuk ka shënime të tilla, megjithëse ka shumë fjalë krahinore në makrostrukturën e tij. Përqindja më e ulët e grupit të këtyre fjalëve në Fjalorin shpjegues të vitit 2006, tregon për një seleksionim të këtyre fjalëve, ndoshta për vetë mundësinë e vogël të përdorimit të tyre, ndaj hartuesit e fjalorit, një pjesë të këtyre fjalëve, nuk e kanë parë të arsyeshme që t’i përfshijnë në makrostrukturën e këtij fjalori shpjegues.

Siç duket nga vëzhgimi dy fushat më të pasura me krahinorizma dalin nga bota shtazore dhe bota bimore. Siç e theksuam dhe më lart, në fjalorët shpjegues ka mjaft fjalë krahinore pa shënimin krahinor si: *bëzaj, biban, bjerraditë, bishtni, blegë, bunicë, çart, gem, grish, grunohem* etj. Kurse Fjalori i vitit 2006 ka akoma më pak fjalë të shenjuara krahinorizma. Në këtë fjalor, duke marrë parasysh lëvizjet e ndodhura në leksikun e shqipes, është ulur numri i fjalëve të shenjuara krahinore dhe është shtuar numri i fjalëve që kanë fituar status mbarëkombëtar.

Fjalë të këtij grupimi në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe kemi:

**Krahin.** *bakë, bakthi, ballenxhë, ballçak, ballgun, ballgunisht, barabiti, barash, barkaris, barkullak, batinos, bedunicë, begun, beng, beshtë, bëltacë, bërdalec, bërdokull, bërthakë, bilan, biramel, blec, blecoj, brarë, brumcë, bulgë, buqan, byr, cabok, cahere, cangë, caradunof, cernik, cërulak, cikomë, cilivile, cimbur, cingali, cirua, cubak, cucërrok, cucërosh, culli, cumër, cundër, cungulloj, cyth, (i, e) curruffjasur, çaf, çap, çardak, çarravallet, çekthi, çapoj, çikë, çukë, çorbë, çulzë, furkulidë, fruq, fetig, hajn, hajnisht, harakuq, herdhe, hidhtas, hupës, hubi, kallamidhe, kaptinë, kashnjetë, katinar, kedh, konop, kopresh, koriye, kumi, obrokth, oleve, oreshkë, ormi, ormis.*

**Arb.** *buzësumbull, fushamirë, kangjeleja, kezë* etj.

**Thjeshtligj.***barkledh, barkshuar, barkvozë, barkzhabë, beriha, biçim, bythëgjerrë, bythëturtull, bythëçjerrë, bythëjashtë, copë, copëlan, firifi, firaun, kaplloqe, kokërrotë, llapaqen etj.*

Në veprën “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme” J.Thomai jep një pasqyrë për njësitë leksiko-semantike krahinore në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, ku nga 40800 fjalë të këtij fjalori, 1076 njësi leksiko-semantike janë shënuar si krahinore. “Nisur nga një raport i tillëvërejmë se numri i fjalëve dialektore në një fjalor shpjegues, si ky që përmendëm, i 1980-ës, nuk është i madh. Një numër më i madh fjalësh dialektore mund t’i shërbente më mirë sistemit leksikor e stilistik të gjuhës letrare”.<sup>67</sup>

---

<sup>67</sup> Thomai, J. Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme, Tiranë, 2001, f.204.

#### 4.6 KARAKTERISTIKAT STILISTIKE TË FJALËVE NË BOSHTIN KOHOR, PJESË E MAKROSTRUKTURËS SË FSHGJSH

Në leksikun e gjuhës shqipe dhe në fjalorin që përdor çdo njeri, dallohen dy shtresa fjalësh: një shtresë fjalësh aktive, që njihen mirë e përdoren shpesh në jetën e përditshme nga folësit dhe një shtresë fjalësh që nuk njihen prej të gjithëve ose, megjithëse njihen, s'përdoren, pasi në vend të tyre, përdoren fjalë të tjera, të cilat i kanë zëvendësuar këto fjalë. Kështu p.sh. kemi fjalë të tilla si, *besoj, ditë, kam, kohë, pemë, punoj, gëzim, çliroj, hëna, orëetj.* që përdoren shpesh nga të gjithë folësit e gjuhës dhe përbëjnë shtresën e përdorimit të përbashkët të leksikut. Por ka dhe fjalë si, *bakthi, dac, frezë, krrej, uzdaja, vatan, gjyfqej, jalli,* etj. që nuk përdoren nga të gjithë folësit dhe nuk janë të përdorimit të përgjithshëm.

Por leksikun e gjuhës sonë ne duhet ta vështrojmë dhe nga një pikëpamje tjetër. Shumë fjalë të leksikut tonë shënojnë sende e dukuri me rëndësi dhe, megjithëse kanë kaluar shekuj, ruhen e përdoren edhe sot. Po jo të gjitha fjalët janë shumë të vjetra. Disa fjalë, për shkak se nuk janë më sendet dhe konceptet që shënojnë, janë zëvendësuar nga fjalë të tjera e tani nuk njihen më ose nuk kanë përdorim të dendur. Paralelisht me këto fjalë ka edhe fjalë që lindin së bashku me realitetet e konceptet e tjera dhe marrin përdorim të gjerë sipas vlerës së asaj që shënojnë. Nga ky këndvështrim leksikun e ndajmë në **leksik të sotëm** dhe **leksik të vjetruar**.

**Në leksikun e sotëm** hyjnë fjalë të përdorimit të përditshëm nga shoqëria apo grupe të veçanta shoqërore, që krijohen edhe rishtas, por edhe fjalë shumë të vjetra ( jo të vjetruara). Për leksikun e sotëm nuk ka kufizime, nëse fjalët janë të përgjithshme ose të kufizuara sipas të folmeve a sipas profesioneve, mjafton që ato të jenë të gjalla në ditët tona.

Por në fjalorët shpjgues të gjuhës shqipe gjejnë vend për t'u pasqyruar edhe një shtresë e vjetruare leksikut, ku hyjnë fjalë që për shkaqe historike a gjuhësore sot nuk përdoren më ose mund të përdoren vetëm për qëllime stilistike, fjalët e vjetruara ose arkaizmat dhe historizmat.

Si në çdo fjalor shpjgues, edhe në fjalorët që po analizojmë, për të dhënë karakteristikat stilistike të këtyre fjalëve në boshtin kohor janë përdorur shënimet e veçanta *vjet.* dhe *hist.* Me shkurtimin *vjet.* janë dhënë fjalët e vjetruara ose arkaizmat, të cilat janë fjalë që bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës sonë letrare, por nuk kanë më përdorim të përditshëm. Këto fjalë kanë kaluar nga shtresa aktive në shtresën pasive të leksikut të gjuhës letrare shqipe dhe përdoren në stile të ndryshme për të paraqitur me vërtetësi periudhat e kaluara historike. Kjo është arsyeja që fjalët e vjetruara përdoren më rrallë në gjuhën e sotme letrare. Siç u theksua më lart, këto fjalë marrin në fjalorin shpjgues

shënimin stilistik *vjet.* kur e ruajnë lidhjen me një fjalë të re a me kuptim të një fjale që përdoret aktivisht në ditët tona. Fjalë të tilla ne i gjejmë të përdorura më shumë në letërsinë e Rilindjes Kombëtare, por dhe në mosha të vjetra të popullsisë në disa të folme.

Pjesë e shtresës së vjetruar të leksikut janë edhe fjalët të cilat në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues, pajisen me shënimin stilistik *hist.* Me këtë shënim, përveç termave të mirëfilltë të historisë, janë dhënë edhe historizmat, sifjalë që kanë dalë nga përdorimi i gjallë, sepse sendet dhe dukuritë që shënojnë ato, i takojnë një periudhe të kaluar historike. Këtu do të veçonim dhe një fakt tjetër të vërejtur në fjalorët shpjegues se, përveç shënimit *hist.*, që përdoret për të dhënë dy nocione të dallueshme, ka edhe shënime të tjera të këtij lloji. Të tilla janë shkurtime *bot. e zool.*, që shënojnë jo vetëm termat e mirëfillta të shkencave përkatëse, botanikë e zoologji, por edhe emërtimet popullore të bimëve e të kafshëve në përgjithësi, emërtime që përdoren rrallë, ose nga një shtresë e kufizuar folësish.

Këto nocione e dukuri të së kaluarës historike kanë luajtur rol në jetën shoqërore e kulturore të popullit tonë në periudha të caktuara historike. Fjalët e vjetruara (arkaizmat) dhe historizmat që jepen me shënime të posaçme stilistike, për fjalësin e shkronjave që po analizojmë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954 kemi 12 fjalë ose 0.2% (vetëm shënimin *vjet.*), në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 kemi 505 fjalë, ose 4% të gjithë fjalësit dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006” kemi 158 fjalë, ose 1.1% të fjalësit të këtyre shkronjave. Më poshtë po japim fjalë me këto shënime stilistike nga fjalorët shpjegues që po analizojmë:

**Vjet.***baft, bagëm, bajloz, bakall, bakllama, bakërxi, bakaç, baxhi, bejte, bohas, bostanxi, bozaxhi, brijanac, bujtar, bulgë, bylyk, byrde, cona, cungal, cupë, cakë, çengi, çertexhi, çeshit, çetel, çomang, çarshi, dhaskal, fajde, fajdexhi, ferexhe, fushqet, han, halldupëri, hanxhar, hapsanë, harbi, hasha, hyzmeqar, hysmetçi, kacidhe, kallauz, kallnor, kapedan, kasnec, kallozhek, kondak, kumbaraja, kundraxhi, llauz, opingar, opingë, opingagrisur, ordinancëetj.*

**Hist.***barbari, bajrak, bajraktar, baron, bashibozuk, boshtinë, baxhë, bozhdar, bedel, bej, bejllëk, bersalier, binbash, bizantin, breshanë, bujkrob, bujkrobëri, censor, centuri, citadela, çausht, çefçi, çiflig, çifligar, dhjetar, faraon, ferman, feudi, feudal, harkëtar, hordhi, harkëmbajtës, haraç, haraçpagues, katakomb, keltishte, kelti, kulak, llonxhë, olimpik, oligarki, oxhakëri, orakull etj.*

Siç thamë, fjalët e vjetruara (arkaizmat) dhe historizmat kanë dalë nga shtresa aktive e leksikut të gjuhës shqipe. Kjo s’ka të bëjë me moshën e tyre, prandaj nuk quhen fjalë “të vjetra”. Historizmat mund të jenë shumë të vjetra, por dhe të rinj, të kohëve të afërta historike, si p.sh. *celulë, çetë, kaçator, komisar*, fjalë këto që janë përdorur gjatë Luftës

NÇL. Shumë nga këto fjalë janë fjalë të huaja që kanë dalë nga përdorimi si: *dyfek, istikam, jaran, mbodhisem, sabah, yxhym, zaman*. Fjalët e vjetruara nuk bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës standarde, por përdoren në letërsi me vlera stilistike të veçanta. Këto fjalë përdoren nga shkrimtarët për t'i dhënë ngjyrim historik periudhës që përshkruajnë në veprat e tyre.

Disa fjalë të vjetruara në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, kanë hyrë në shtresën aktive të fjalëve pas viteve 90-të të shekullit të kaluar, si fjalët, *bashki, komunë, prefekt* etj. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe me fjalë të leksikut fetar, të cilat para viteve 90-të, kur, për shkak të sistemit, feja nuk lejohej, këto fjalë nuk përdorehin shpesh nga njerëzit në komunikimin e përditshëm, ato ishin pjesë e shtresës pasive të leksikut si fjalë të vjetruara, kurse sot janë rikthyer në përdorim aktiv.

#### 4.7 SHITESA E FJALËVE ME NGJYRIME EMOCIONALE-VLERËSUESE NË MAKROSTRUKTURËN E FSHGJSH

Gjuha letrare shqipe ka një shtresë fjalësh me ngjyime emocionale-vlerësuese që dallojnë qartë nga shprehësia e tyre. Fjalët me ngjyime të tilla subjektive kanë fituar, krahas kuptimit të tyre emërtues, edhe ngjyime kuptimore karakterizuese vlerësuese. Për të cilësuar ngjyrimin emocional të fjalëve sipas llojit të karakteristikës vlerësuese që folësi synon të shprehë gjatë komunikimit, në të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe (1954, 1980, 1984, 2002 dhe 2006), janë përdorur këto shënime të veçanta si shkurtime, si: *iron.*, *keq.*, *mospërf.*, *përb.*, *përçm.*, *përk.*, *shak.*, *shar.* dhe *tall.* Këto ngjyime emocionale subjektive, pozitive a negative dhe miratuese a jomiratuese qofshin, lindin nga marrëdhënia e folësit me objektin për të cilin flitet ose me një bashkëbisedues a grupbashkëbiseduesish në procesin e ligjërimit. Kështu shkurtime *iron.* u është vënë fjalëve a kuptimeve të tyre që përdoren për të shprehur ironinë e folësit. Fjalë të tilla në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, kemi 33 njësi leksikore dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006 kemi 28 njësi leksikore, si: *begenis*, *bukuri*, *bukurosh*, *çirak*, *fermani*, *kodosh* etj.

Shkurtime *keq.* u është vënë fjalëve që kanë kuptim keqësues dhe përfshin njëkohësisht përbuzjen, sharjen ose qesëndinë. Ndërsa shkurtime *përb.* e *përç.* përdoren për të shprehur përkatësisht vlerësimin përbuzës e përçmues të folësit. Shkurtime e tjera të fjalëve të këtij grupi si *përk.* përdoret për fjalët me kuptimpërkëdhelës, shkurtime *shak.* u është vënë fjalëve që përdoren në ligjërimit për shaka, kurse shkurtime *shar.* u është vënë fjalëve që përdoren për sharje dhe shkurtime *tall.* u është vënë fjalëve që kanë kuptim tallës.

Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, fjalët me shënime të tilla janë 438 ose 3.5%, ndërsa në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006 kemi gjithsej 351 fjalë ose 2.5% të numrit të përgjithshëm të njësisve leksikore me shënime të posaçme për ngjyrimet emocionale-vlerësuese, si:

**Keq.** *barkaç*, *barkledh*, *bibë*, *birbiq*, *bualicë*, *buf*, *bullëndër*, *buzaç*, *byk*, *copamadh*, *cjapos*, *cucërrosh*, *cytanik*, *çetele*, *çiban*, *çifut*, *çakall*, *çanaklëpirës*, *çapaçul*, *çorbë*, *çeço*, *çengi*, *këlysh*, *kasap*, *këmbëlëpirës*, *kloun*, *kokëkungull*, *kuçkë*, *llokmëmadh*, *llapush*, *llurbëtirë* etj.

**Mospërf.** *cuban*, *dhogaç* etj.

**Përb.** *barbari*, *barbare*, *bastard*, *breshkamadh*, *breshkaman*, *frymëprerë* etj.

**Përçm.** *fruçake*, *fretushkë*, *kokëdherr*, *kokëdru*, *kokëlopë*, *kokëmadh*, *llapaqen* etj.

**Përk.** *bejçe*, *buçkan*, *buçko*, *cube*, *çamarrok*, *dhjakonar*, *kolopuç*, *kone* etj.



**Shak.** *ça, farëz etj.* **Tall.** *ballukecjav, bandill etj.*

**Shar.** *bajgë, balash, barkëdreq, besëqen, bushtër, copëlan, dhëmbëçatall, dhëmbëdalë, dhëmbëkrimbur, dhëmbëqen, dhëmbo, hundëpatate, hundëderr, hundëfeçka, kapllloqe, kokërrotë, kopuk etj.*

**Shënime për shtresën e fjalëve me ngjyrimë emocionale -vlerësuese dhe shënime të tjera.**

		iron.	keq.	mosperf.	perb.	perçm.	perk.	shak.	sharj.	tall.	Shuma	euf.	fëm.	mallk.	ur.	Shuma
A	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	5	29	6	2	1	0	2	3	1	49	4	3	1	0	8
	2006	3	14	3	1	1	0	0	2	1	25	3	2	1	0	6
B	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	3	51	18	4	0	4	1	7	3	91	6	2	0	1	9
	2006	2	45	11	5	0	4	2	9	2	80	3	3	0	1	7
C	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	1	7	1	0	0	1	0	1	0	11	0	1	0	0	1
	2006	1	6	1	0	0	1	0	1	0	10	0	1	0	0	1
Ç	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	5	29	7	16	1	1	1	0	2	62	1	2	5	1	9
	2006	4	19	3	11	1	1	1	0	1	41	1	1	2	1	5
DH	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	0	0	2	1	0	0	0	12	1	16	0	0	0	0	0
	2006	0	0	1	2	0	0	0	9	1	13	0	0	0	0	0
F	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	6	28	19	1	3	2	2	12	2	75	9	16	4	1	30
	2006	7	20	17	2	5	4	3	11	3	72	11	10	6	1	28
H	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	0	4	11	2	11	0	0	4	1	33	3	0	0	0	3
	2006	0	7	12	2	9	0	0	2	1	33	3	0	0	0	3
K	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	13	26	31	3	4	4	0	0	0	81	0	0	0	0	0
	2006	11	20	24	2	3	3	0	0	0	63	0	0	0	0	0
LL	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	0	5	0	0	1	0	0	0	1	7	0	0	0	0	0
	2006	0	4	0	0	1	0	0	0	1	6	0	0	0	0	0
O	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	0	9	3	1	0	0	0	0	0	13	1	0	2	1	4
	2006	0	5	2	1	0	0	0	0	0	8	1	0	1	1	3
Shu	1954	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1980	33	188	98	30	21	12	6	39	11	438	24	24	12	4	64
	2006	28	140	74	26	20	13	6	34	10	351	22	17	10	4	53

Në këtë tabelë janë bashkarisht edhe shënimet për çështjen që vjen më pas.

#### 4.8 FJALËT ME SHËNIME TË TJERA JOGRAMATIKORE NË MAKROSTRUKTURËN E FSHGJSH

Përveç grupeve të fjalëve me karakteristika stilistiko-funksionale dhe për ngjyrimin emocional-vlerësues, të përmendura më lart, në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe ka edhe fjalë që kanë shënime të tjera jogramatikore, të cilat po i paraqesim si grup më vete: *euf.*, *fëm.*, *mallk.* dhe *ur.* “Eufemizmat janë fjalët që përdoren për të emërtuar sende dhe objekte, emrat e të cilave për arsye të ndryshme janë shmangur nga përdorimi”, shprehet R. Memushaj.<sup>68</sup> Eufemizmat janë mbartje të emërtimit nga një objekt mbi një tjetër, që ngjajnë me poliseminë, por dallojnë prej saj se te polisemia kemi zgjerim të aftësisë shënuese të fjalës, kurse këto përdoren për të quajtur sende, emrat e të cilëve janë të ndaluar të përdoren nga bashkësia gjuhësore, si p.sh. *banjë*(*euf. nevojto*); (*i, e*) *bekuar*=që ka marrë uratën, që pastë uratën; *euf.* që dëshirojmë të jetë i mirë e i mbarë, por që s’është i tillë, i uruar (ky shi i bekuar i prishi të lashtat. Ku shkoi i bekuari?); *bishtëgjatë*~për dhelprën; *buzëlidhur*, *sojëlidhur*~ për ujkun; *kolla e bukur*, mjek. *euf.* ~kolla e mirë, *fytyrënamët* *euf.* për faqezi etj.

Shkurtimi *fëm.* u është vënë atyre fjalëve që janë karakteristike për gjuhën e fëmijëve, si p.sh. *coparake*, ; shkurtimet *mallk.* dhe *ur.* janë vënë për ato fjalë ose kuptime fjalësh që përdoren përkatësisht si mallkim ose urim. Gjuha shqipe është e pasur me përhëndetje dhe urime. Po t’i shohim ato në planin krahasues mund të pranojmë se: “shqiptarët dhe gjuha shqipe karakterizohen si një nga bashkësitë më të pasura me përhëndetje dhe urime të bukura. Ato janë të mbërthyera në një bosht leksiko-semantik, që tregon cilësitë e larta dhe fisnikërinë e shpirtit shqiptar”.<sup>69</sup> Po këtu prof. Gj. Shkurtaj duke iu referuar Coulmas shprehet: “Urimi - thotë Coulmas,- nuk është tjetër veçse një akt i të folurit që shpreh një qëndrimndaj sjelljes të të tjerëve. Urimi është shprehja e një dëshire me fjalë, që pritët të realizohet në një kohë të ardhme”<sup>70</sup>

Urimi sipas tij, mund të shprehet me shumë lloje formulash rituale që ndryshojnë sipas ndjenjave dhe situatave. “Ato ndahen në dy grupe: *përgëzime* dhe *urime* që dallohen midis tyre në përmbajtjen e kuptimit, por edhe në aspektin kohor; përgëzimet i referohen një ngjarjeje a një ndodhie të realizuar, kurse urimet bëhen mbi bazën e një perspektive dhe që, gjithmonë, përmban edhe një dozë magjie”.<sup>71</sup> **Përgëzime** janë fjalët: *urime të përzemërta!* *Urime të singërta!* Ndërsa **urime** janë fjalët: *Të trashëgoresh!* *Të*

<sup>68</sup> Memushaj, M. Hyrje në gjuhësi, Tiranë, 2004, f.195.

<sup>69</sup> Shkurtaj, Gj. Etnografia e të folurit të shqipes, Tiranë, 2004, f.157.

<sup>70</sup> Shkurtaj, Gj. po aty, f.145.

<sup>71</sup> Shkurtaj, Gj. Po aty, f.147.

*trashëgohet për fare! Me një djalë! Udhë e mbarë! Qoftë i mbarë ky vit! Gëzuar Vitin e Ri! Në dasmë! Të vaftë mbarë!* etj.

Mallkimet janë një lloj tjetër shprehjesh popullore, të cilat kanë qenë dhe janë të pranishme në gjuhën shqipe dhe përdoren gjerësisht nga folësit e saj. Kështu në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, gjejmë këtë shpjegim për fjalën *mallkim*: “1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve mallkoj, mallkohem, 2. Fjalët që themi për dikë a për diçka kur e mallkojmë, nëmë, mallkim i rëndë. I dha mallkim dikujt etj. (FGJSSH, Tiranë, 1980, f.1054). ndërsa për foljen mallkoj në këtë fjalor gjejmë këtë shpjegim: 1. Them për dikë fjalë të rënda, duke besuar se ato i ndjellin fatkeqësi a mjerim, shfaq dëshirën që dikë a diçka ta gjejë një e keqe e madhe, nëm(sipas paragjytimeve e besimeve të kota) kund. bekoj. p.sh. *E mallkoi e ëma (i ati). E mallkoi rëndë. Mos e mallko djalin.*; 2. Iart. Dënoj rëndë e me gjithë shpirt dikë që më ka bërë një të keqe të madhe dhe që dua ta shoh të shkatërruar e të asgjësuar, p.sh. *Mallkova armiqte (pushtuesit e huaj). Mallkuam tradhëtarët.* 3. fet. e quaj diçka jashtë udhës së fesë, e quaj punë të djallit dhe i jap dënimin e perëndisë; e *shkishëroj* (sipas paragjytimeve e rregullave fetare). Kisha mallkonte heretikët. 4. bised. Shfaq hidhërim e pendim të thellë për diçka. *Mallkonte veten. Mallkonte ditën që lindi.* (FGJSSH, Tiranë, 1980, f.1054). Pra, siç e shohim nga shpjegimi që jepet në fjalor, mallkimet janë formula nëpërmjet të cilave shprehet dëshira që dikujt t’i ndodhë një fatkeqësi, një e keqe e madhe. Këto nuk zënë ndonjë vend të konsiderueshëm në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, gjithsej 12 fjalë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe 10 fjalë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, në fjalësin e shkronjave që po analizojmë.

Siç del nga të dhënat e mësipërme, leksiku i cilësuar stilistikisht përbëhet nga gjashtë grupe fjalësh që kanë karakteristika të ndryshme, për të cilat folëm më lart. Nga pikëpamja sasiore vendin e parë e zënë shtresat e fjalëve që japin kryesisht terminologjinë tekniko-shkencore me përdorim të gjerë dhe sferat e përdorimit të tyre me 10% në Fjalorin e 1954-ës, 18.2% në Fjalorin e 1980-ës dhe 14% në Fjalorin e 2006-ës, të gjithë leksikut të shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O. Kjo përqindje e lartë ndodh për faktin se fushat e përdorimit të këtij leksiku janë të shumta në numër dhe jo pasurisë së leksikut për çdo fushë të shkencës e teknikës.

Për nga pesha specifike që zënë në leksikon e shkronjave të mësipërme, pas terminologjisë, vijnë me radhë shtresat e fjalëve me funksione stilistike-ligjërimore në gjuhën e sotme letrare shqipe me 9% (1980) dhe 7.5% në (2006), shtresat e fjalëve me karakteristikën stilistike në boshtin kohor me 0.2% (1954), 4% (1980) dhe 1.8 në (2006), fjalët me ngjyrimë emocionale-vlerësuese me 3.5% (1980) dhe 2.5% (2006), shtresat leksikore me kufizime në rrafshin territorial dhe ligjërimitor me 2.3% (1980) dhe 1.1% (2006), dhe së fundi grupi i fjalëve me disa shënime të tjera jogramatikore 0.5% (1980) dhe 0.4% (2006).

Leksiku i cilësuar stilistikisht ka vlera të posaçme karakterizuese për variantet e ndryshme të gjuhës letrare. Ai përdoret në trajta të caktuara ligjërimore dhe në stile të veçanta funksionale për të dhënë karakteristikat e tyre dalluese. Shtresa e grupe të caktuara leksikore janë tipike për variantet ligjërimore dhe për stilet funksionale të gjuhës sonë letrare. Kështu p.sh. për stilin e veprimtarisë shkencore-teknike shtresat e fjalëveqë përbëjnë terminologjinë e shkencës përkatëse, janë jo vetëm tipike për këto shkenca, por edhe të domosdoshme nga pikëpamja shprehëse e komunikuese.

Karakteristikat stilistike dhe ngjyrimet emocionale vlerësuese të fjalëve në këto shkronja, në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, të krahasuar midis tyre, janë parë në kuadrin e plotë të sistemit stilistik të gjuhës letrare shqipe. Nga krahasimi, sidomos dy fjalorëve të fundit, shohim se kemi një ndryshim të vogël për çdo grup fjalësh në përqindje, pavarësisht nga ndryshimi i numrit të fjalëve të së njëjtës shkronjë në fjalorë të ndryshëm.

Megjithëse në çdo shkronjë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, ka më shumë njësi leksikore se në çdo fjalor tjetër shpjegues të gjuhës shqipe, nuk ka qenë kusht për të pasur më shumë fjalë me shënime stilistike. Ndryshimi për çdo zë në numër është i papërfillshëm dhe jo me vetëm një prirje, d.m.th. një fjalor që ka më shumë fjalë detyrimisht në të gjitha zërat do të ketë shumicën e fjalëve të cilësuar stilistikisht në fjalësin e shkronjave respektive. Por vihet re fakti se një zë mund të ketë më shumë fjalë të cilësuar te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe tjetri mund të ketë më shumë fjalë të cilësuar te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006. P.sh. me shënimin *bot.* kemi 89 fjalë te Fjalori i 1980-ës dhe 76 fjalë te Fjalori i 2006-ës, në shkronjën **B**, por kemi 7 fjalë në Fjalorin e 1980-ës dhe 8 te Fjalori i 2006-ës te shkronja **O**. Me shkurtimin *libr.* kemi 82 fjalë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe 72 fjalë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, në fjalësin e shkronjës **K**, por nëfjalësin e shkronjës **A** kemi 126 shënime në Fjalorin e 1980-ës dhe 134 shënime në Fjalorin e 2006-ës.

Përpyqjen e parë të suksesshme në nistorinë e leksikografisë shqiptare, për një vlerësim stilistik pak a shumë tërësor të leksikut të gjuhës shqipe, nga pikëpamja e normës letrare e ka bërë “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, dhe pastaj, gjithë fjalorët shpjegues të mëvonshëm (1984, 2002, 2006) e gjetën të shtruar këtë rrugë, por kanë bërë saktësime të vogla, sidomos dy fjalorët e fundit shpjegues (2002, 2006), për shkak të kushteve historike e shoqërore pas zhvillimeve demokratike, një pjesë e fjalëve, të konsideruara historizama para tyre, kanë rimarrë kuptimet e tyre si fjalët: *bashki*, *komunë*, *prefekt*, si dhe fjalët e fushës së besimeve fetare.

Megjithëse për këto shtresa të leksikut është treguar vëmendje për pasqyrimin e cilësimit të tyre në fjalorët shpjegues, përsëri ka vend për ta vlerësuar këtë leksik. Ndaj është detyrë e leksikografisë shqiptare, që në veprat e ardhshme leksikografike, sidomos

në fjalorin e madh, t'i kushtojë më shumë vëmendje sqarimeve të ndryshme stilistike dhe saktësisimit të aparatit të shënimeve të posaçme për to. Por zgjidhja e kësaj detyre shkon paralel me zgjidhjen e problemeve të stilistikës gjuhësore, të cilat në fazën e sotme të gjuhës shqipe kanë zhvillime pozitive. Shënimet për karakteristikat stilistike dhe për ngjyrimet emocionale-vlerësuese në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe ndihmojnë jo vetëm për të ndjekur evolucionin funksional të fjalëve si njësi tërësore, por edhe të kuptimeve të tyre të veçanta. Me këto shënime fjalët në fjalor nuk mbeten të shkëputura nga jeta e gjallë e tyre. Ato janë pjesë e pandashme e shpjegimit të saktë të fjalëve dhe e përdorimit të tyre të drejtë në ligjërim.

## KREU V.

### MIKROSTRUKTURA NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE

#### 5.1 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Pas përzgjedhjes së njësive leksikore, renditjes dhe organizimit të tyre, pra, përgatitjes së makrostrukturës, i vjen radha mikrostrukturës. “Mikrostruktura e fjalorit është ndërtimi i çdo njësie leksikografike veças, gjithë ajo që quhet “zë leksikografik” a “paragraf” i fjalës” -shprehet J.Thomai.<sup>72</sup>

Edhe mikrostruktura e fjalorëve shpjegues varet nga tipi apo synimi kryesor i fjalorit. Në një fjalor të madh edhe pasqyrimi i përmbajtjes leksikore të fjalës është më i imët, shpjegimet janë më të gjera për çdo kuptim, ka më shumë shënime plotësuese, më shumë thënie e shembuj. Tre fjalorët shpjegues që kemi marrë në shqyrtim, “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, kanë ndryshim në organizimin e mikrostrukturës, sidomos në mënyrën e organizimit të kuptimeve e shpjegimit të tyre. Në një fjalor shpjegues, pasi gjejmë fjalën si element i makrostrukturës së tij, na intereson mikrostruktura, pra informacioni që ka fjalori për atë fjalë.

Informacionet e mikrostrukturës në fjalorët shpjegues kanë strukturë të qëndrueshme dhe janë të zbatueshme për çdo lloj njësie leksikografike. Kjo do të thotë se, në qoftë se mikrostruktura e një fjalori shpjegues përmban informacionet për kategorinë gramatikore, përkufizimin, shembujt, këto informacione duhet të gjenden në çdo artikull. Një gjë e tillë është zbatuar në të tre fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Në rast se mungon në ndonjë njësi leksikore ndonjë nga këto informacione, kjo mund të vijë për arsye të ndryshme:

**1.** Informacioni zero, i cili lidhet me ato raste kur ky informacion është aq i dukshëm, sa leksikografi nuk e shikon të arsyeshme ta vendosë si pjesë të mikrostrukturës. P.sh. për emrin në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, jepet shënimi *em.* (për emrat e gjinisë mashkullore) dhe *ef.* për emrat e gjinisë femërore, ndërsa në fjalorët e mëvonshëm shpjegues jepet shënimi *m.* për emrat e gjinisë mashkullore dhe *f.* për emrat e gjinisë femërore. Pra në fjalorin e 1954-ës kemi shënimin *e.* për emër, por jo te fjalorët e tjerë ku flitet direkt për gjininë, pasi kuptohet që bëhet fjalë për emrin. Pra në të gjithë fjalorët shpjegues jepet shënimi për gjininë e emrit, pra nënkuptohet emër.

---

<sup>72</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.308.

Por, në fjalorët shpjegues nuk ndodh e njëjta gjë për foljet. Kështu p.sh. në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, për foljen shënohet vetëm nëse është kalimtare, jokalimtare, vetvetore, pësore ose pavetore dhe nuk shënohet shkurtimi *f.*, për folje. Megjithëse nuk shënohet, nënkuptohet se bëhet fjalë për folje, pasi asnjë pjesë tjetër e ligjëratës nuk i ka këto karakteristika. Por në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, shënohet shkurtimi *ift.* (folje transitive) dhe *fint.* (folje intransitive) për të gjitha foljet në fjalorin shpjegues. Ky lloj informacioni që mungon, por që nënkuptohet, si në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, quhet informacion zero në fjalorin shpjegues.

**2.** Përveç informacionit zero, në fjalorët shpjegues kemi raste kur informacioni nuk ekziston. Për shembull antonimi i një foljeje, megjithëse në gjuhë ajo folje ka antonim. Kjo quhet mungesë informacioni.

**3.** Duke pasur parasysh vëllimin e madh të informacioneve të larmishme që shfaqen në fjalorë shpjegues, për arsye të mungesës së vëmendjes, pra për arsye të ndryshme, mund të ndodhë që harrohet ndonjë informacion. Kështu për shembull, në të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, me përjashtim të “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954, ku nuk jepen dy fjalët e urta që do të themi më poshtë. Në artikullin e emrit *gur*, në fjalorët e tjerë shpjegues, jepen dy fjalë të urta: Me një gur s’bëhet mur; Gur, gur bëhet mur. Të dyja këto fjalë të urta nuk shoqërohen nga shpjegimi, i cili nuk gjendet as në artikujt e fjalëve të tjera përbërëse të këtyre fjalëve të urta, siç ndodh për shembull me fjalën e “*do kalë për shalë*” që shpjegohet: *lakmon shumë, ka kërkesa të tepruara; ose*”*më marrsh të keqen (të ligat)*” që shpjegohet: *përdoret si përgjigje kur duam t’i themi dikujt që jam më i mirë se ai ose nuk ka se ç’ më bën.*

Mikrostruktura e fjalorëve shpjegues përmbledh këto informacione: njësia leksikografike, shqiptimi, theksi, kategoria gramatikore, përkufizimi, sinonimia, antonimia, shembujt. Duke i krahasuar të tre fjalorët, do të shohim se si paraqiten këto informacione në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe.

## 5.2 DREJTSHKRIMI I NJËSIVE LEKSIKORE

Kontakti i parë që kemi me fjalorin, është njësia leksikore dhe informacioni i parë që marrim e duhet të marrim është drejtshkrimi i këtyre njësive. Ky informacion është më i plotë te fjalorët shpjegues pas atij të 1954-ës, pasi tashmë gjuha shqipe kishte të konsoliduara rregullat drejtshkrimore të miratuara në Kongresin e drejtshkrimit në vitin 1972, si dhe botimi i Fjalorit drejtshkrimor 1974. Një gjë e tillë nuk ndodh me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, pasi problemet e drejtshkrimit ishin ende në diskutim, ndaj në fjalor gjejmë shumë pika të diskutueshme e ai s’ka mundur t’u shpëtojë lëkundjeve të ndryshme.

Gjuha shqipe është shumë e pasur me trajta të ndryshme të fjalëve, folja zgjedhohet në tri kohë e gjashtë mënyra, emri ka format e njëjësit e të shumësit e lakohet në to, po kështu një pjesë e mbiemrave e përemrave. Ndaj fjalët gjatë ligjërit dalin në trajta të ndryshme, emrat në njëjës e shumës, në pesë rasat e lakimit, folja në veta, mënyra e kohë të ndryshme etj. Kufijtë e kufizuar të fjalorit dhe kërkesa për ta gjetur sa më shpejt fjalën që kërkojmë, e kanë bërë të domosdoshme caktimin e një trajte përfaqësuese për çdo pjesë të ndryshueshme të ligjëratës.

Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, të cilët janë hartuar të gjithë me rend alfabetik, fjalët vihen në trajtën përfaqësuese dhe shoqërohen me shënimet gramatikore për pjesën e ligjëratës dhe për ndonjë kuptim gramatikor themelor. Për trajtat e eptueshme (që lakohen e zgjedhohen), jepen edhe trajtat themelore me vlerë teme. Caktimi i një trajte të tillë përfaqësuese vërtet lehtëson konsultimin e fjalorit nga ana e lexuesit, por nxjerr problemin e njohjes së trajtave të tjera. P.sh. në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, çdo fjalë është e shoqëruar me shënimin e kategorisë gramatikore së cilës i përket e të karakteristikave të tjera të nevojshme: Emrat janë dhënë në rasën emërore të njëjësit, e kur s’përdoren në njëjës, jepen në atë të shumësit. Atyre u shënohet gjinia, trajta e shquar dhe forma a format që kanë në shumës. Trajta e shquar jepet duke shënuar me shkronja të mëdha nyjen e shquar, si: FLAMUR~I; FLETË~A, ose duke e shënuar plotësisht trajtën e shquar kur pëson ndonjë ndryshim trupi i fjalës: Flatër- Flatra; Fletore-Fleotrja, Idealizëm - Idealizmi etj. Shumësi i emrave shënohet me shkronja të vogla të zeza dhe veprohet ashtu si për nyjen; kur s’ndryshon njëjësi, vihet viza\_\_. Kjo (viza) zëvendëson fjalën në trajtën përfaqësuese, siç figuron në krye të artikullit, në formën përfaqësuese të saj. Në rast se viza ndiqet nga mbaresa e rasës, e gjinisë, e numrit etj. Kjo mbaresë i shtohet kësaj trajte. P.sh. Buxhet~i, em, shm\_e, por edhe Garanci~A ef. shf.\_\_\_. (d.m.th. shumësi garanci, pa mbaresë).

Në këtë fjalor shpjegues,(1954), fjalët që marrin përdorime të ndryshme gramatikore, që për këtë shkak ndonjëherë mund të ndryshojnë edhe trajta (p.sh. fjalë që janë emra, por



edhe mbiemra; janë mbiemra, por edhe ndajfolje; janë emra , por edhe ndajfolje) janë vënë herë në të njëjtin paragraf, herë në paragrafe të veçanta, sipas aftësisë më të madhe e më të vogël të kuptimeve. P.sh. *Fortë (i, e)* dhe *Fortë*( me gabim drejtshkrimor, duhet shkruar *fort*) është pasqyruar veç si mbiemër dhe veç si ndajfolje. Po kështu *idealistsi* emër e si mbiemër janë pasqyruar në zë më vete. Nuk ndodh e njëjta gjë me disa fjalë të tjera, si: *blerës* si emër e si mbiemër. Ato janë pasqyruar në të njëjtin zë leksikor. Për foljen trajtat pësore e refleksivenuk janë vënë si fjalë të veçanta, por në të njëjtin paragraf në trajtat veprorë. Një gjë e tillë ndodh zakonisht edhe me trajtat mesore.

Në fjalorët shpjegues që vijnë pas “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954, janë konsoliduar si rregullat drejtshkrimore, ashtu edhe informacioni e mënyra e dhënies së tij për çdo artikull. Siç u theksua edhe më lart, fjalët vihen në trajtën e tyre përfaqësuese dhe shoqërohen me shënime gramatikore për pjesën e ligjëratës dhe për ndonjë kuptim gramatikor themelor. Për trajtat e eptueshme jepen edhe trajtat themelore me vlerë teme. Kështu: **emrat** vihen në trajtën e numrit njëjës të pashquar, në rasën emërore, pastaj vihet trajta e shquar, pas kësaj vihen shënimet gramatikore dhe trajtat e shumësit: p.sh. *Buçim/ë, ~a, f. sh~a, ~at; goj/ë, ~a, f. sh.~ë, ~ët*. Kështu trajtohen edhe **përemrat**, p.sh. përemri pronor *im-e* (gjin. dhan. rrjedh.: *tim, sime*; kall. *tim, time*) sh. *Mi (e) Mia (e)*; përemri vetor *Ai* (atij, tr. e shkurtër I; Atë pas paraf. të tr. e shkurtër, *e* ; *Atij*, pas parafjalës *tij*.) (edhe si përemër vetor edhe si dëftor).

**Mbiemrat** vihen në trajtën e numrit njëjës të gjinisë mashkullore, pastaj vihet trajta plotësuese e gjinisë femërore (për mbiemrat e nyjshëm nyja vihet në kllapa), p.sh. *Bukur (i, e) mb.* ; *Përshtatsh/ëm (i), - me. (e) mb.* ... pastaj vjen shpjegimi; *burrëror, - e mb....; besnik, (e)...* Trajtat përfaqësuese të mbiemrave jepen nëpërmjet shembujve: mirë (i, e) mb. Ka lënë kujtime të mira. *Burrëror, -e, mb. Ka mbajtur qëndrim burrëror.*

**Foljet** vihen në mënyrën dëftore në kohën e tashme, në numrin njëjës dhe, pas shënimeve gramatikore, vihen, si trajta plotësuese, e kryera e thjeshtë e pjesorja: p.sh. *Buzëqesh jokal.* , ~a, ~ur; përshëndet (s0 kal. ~a, ~ur; zot/ohem vetv. ~ova (u), ~uar. Për klasën e foljeve të dhënat gramatikore janë më të shumta në raport me klasën e emrave, sepse vetë sistemi foljor i shqipes është më kompleks e karakterizohet nga një numër më i madh formash e dukurish, sesa sistemi emëror. Kështu, për foljen, përveç kohës së tashme në vetën e parë njëjës, që jepet si formë përfaqësuese, duke u parqitur si fjalë titull, jepen si forma plotësuese të saj e kryera e thjeshtë dhe pjesorja, kalimtare ose jo, jepet shënimimi “pavetore” ose “vetëm veta e tretë”.

Kështu një folje leksemë që në fjalor përfaqëson vetëm një fjalë, në thelb mund të fshehë dy ose tri të tjera (trajtën veprorë, pësore, mbiemrin përkatës). “Natyrisht infinitivi, paskajorja, siç veprohet për gjuhë të tjera si frëngjishtja, anglishtja, italishtja etj. do të jepte në mënyrë më të saktë formën përfaqësuese të foljes, jashtë lidhjeve me

një vetë të caktuar, por duke u paraqitur vetëm si formë foljore, e cila del thjesht si emërtim i një veprimi të caktuar”<sup>73</sup> Por shqipja e ka zëvendësuar infinitivin me kohën e tashme, kohë në të cilën jepet forma përfaqësuese e foljes në fjalorët shpjgues të saj.

Në fjalorët shpjgues të gjuhës shqipe pasqyrohen si fjalë titullmë vete format vetvetore të foljes. Dalja e tyre si fjalë titull më vete paraqet vështirësi, të cilat duhet të përliqjen semantikisht. Prof. E.Hysa thekson se “kur kalojmë nga një formë fjale në një formë tjetër të po asaj fjale, nuk kemi në të njëjtën kohë edhe kalim në një kuptim të ri ose rikuptimësim të formës së fjalës”.<sup>74</sup> J.Thomai, sheh te vetvetorja e foljeve, “jovetëm një shtresim kuptimesh gramatikore, por edhe zhvillime të reja semantike, që nuk gjenden në strukturën semantike gjegjëse të foljes në veprorë. Ndaj vetvetorja e foljeve është parë si njësi e veçantë leksiko-semantike”.<sup>75</sup> Kjo tregon vështirësitë dhe kujdesin që duhet të tregojë hartuesi i fjalorit, kur e ndan formën vetvetore si fjalë-titull më vete. Kjo kërkon një analizë të hollësishme semantike të formës veprorë në formën pësore-vetvetore.

Në fjalorët shpjgues, fjalët e paeptueshme vihen në trajtën e tyre të vetme: p.sh. *mirë*. ndajf.; *bukur*. ndajf.; *dhe*, *edhe*, *ndërsa*. lidhëza...; *oh*, *uf*.pashirra etj. Në trajtën përfaqësuese të fjalës, te pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, vihet një vizë midis pjesës sëpandryshueshme të fjalës dhe pjesës së ndryshueshme, ku me pjesën e pandryshueshme lidhen elementet plotësuese të trajtave të tjera.

Përveç shënimeve gramatikore, sipas rastit, jepen edhe shënime të tjera për vlerat shprehëse, emocionale e stilistike të fjalëve, për fushën e përdorimit, për ligjërimin a stilin, për burimin etj. : *anat.* -term në anatomi; *arb.* -fjalë a shprehje e arbëreshëve të Italisë e Greqisë; *folk.* term në folkloristikë; *fig.* i figurshëm; **krahin.**- fjalë a shprehje krahinore; **euf.**- eufemizëm; **përçm.**- fjalë a shprehje përçmuese; **vjet.**- fjalë a shprehje e vjetruar. Për këto shënime stilistike kemi analizuar në mënyrë shteruese leksikun e shkronjave A, B, C, Ç, DH, F, H, K, LL, O në fjalorët shpjgues të gjuhës shqipe 1954, 1980 dhe 2006., informacion që e kemi pasqyruar në kapitullin përkatës. Në të gjithë fjalorët shpjgues, ky informacion, për shkurtimet që përdoren aty, është dhënë në fillim të fjalorit. Ne kemi paraqitur përmasat e shënimeve të tilla në fjalorët shpjgues.

Siç u theksua më lart, megjithëse përdoren edhe trajtat plotësuese, fjalorët shpjgues të gjuhës shqipe nuk i japin të gjitha trajtat e njësisve leksikografike ose rregullat e formimit të tyre. Këtu bën përjashtim “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, ku në 45 faqe (1470-1515) jep këto informacione:

---

<sup>73</sup> Hysa, E. Gramatika në fjalorët shpjgues, në “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.107.

<sup>74</sup> Hysa, E. po aty f.106.

<sup>75</sup> Thomai, J. Rreth semantikës leksikore të foljeve veprorë, pësore e vetvetore në gjuhën shqipe, në “Gjuha jonë”, nr. 2, 1988, f.13.

- Pasqyra gramatikore për lakimin e emrave të të tri lakimeve, në të dy numrat, në trajtën e shquar e të pashquar, duke dhënë shpjegime edhe për emra të tjerë të ngjashëm me ta.
- Lakimin e emrave asnjans.
- Pasqyrën e lakimit të mbiemrave të nyjshëm në të dyja gjinitë e numrat, kur shoqërojnë emra në trajtën e shquar e të pashquar.
- Lakimin e mbiemrit para emrit, me shpjegimet përkatëse për rastet e veçanta.
- Lakimin e përemrave vetorë, vetvetorë, dëftorë, pyetës, lidhor (i cili), përemrat e pakufishëm dhe pronorë. Për përemrat pronorë informacioni jepet për të tri vetat, dy numrat e gjinitë si dhe lakimi i përemrave pronorë të emëruar e përemrat pronorë me emra farefisnie.
- Në një vëllim prej 15 faqesh jepet zgjedhimi i foljeve ndihmëse (kam e jam), foljeve veprorë të rregullta të tri zgjedhimeve e për tipa të ndryshëm, duke dhënë edhe format pjesore për çdo folje; jepet zgjedhimi i foljeve të parregullta si dhe i foljeve pësore e vetvetore. Për çdo ndryshim të rasteve jepen shënimet përkatëse pas çdo tabele lakimi ose zgjedhimi.

Për informacionin gramatikor në fjalorët shpjegues ka mendime të ndryshme. Disa gjuhëtarë mendojnë se ky informacion nuk duhet të jepet në fjalor, pasi ai dublon në këtë mënyrë gramatikën, duke e argumentuar me faktin se këtë informacion konsultuesi i fjalorit e merr nga gramatika në shkollë, duke e lënë kështu problemin në dorë të subjektivizmit, pasi lexuesit nuk kanë bërë të gjithë të njëjtat studime dhe aftësitë e tyre nuk janë të njëjta. Madje ka raste që edhe ata që kanë kryer studimet në gjuhësi mund të hezitojnë për trajtat e ndryshme të një fjale të re, ose për shkak të harresës, për trajtat e një fjale që ekziston prej kohësh.

Por ka edhe një grup gjuhëtarësh që kanë hedhur e mbrojnë idenë se fjalori duhet të japë informacion gramatikor për lexuesin, pasi ata janë të formimeve të ndryshme shkencore gjuhësore. Mendimi i gjuhëtarëve të grupit të dytështë më i arsyeshëm, pasi për vetë kompleksitetin e lakimit e të zgjedhimit, fjalorët shpjegues duhet të japin informacion gramatikor që lidhet me trajtat plotësuese të pjesëve të ndryshme të ligjëratës, pa pretenduar të dublojë gramatikën. Më i drejtështë qëndrimi që mbahet me “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, i cili në fund të makrostrukturës së tij jep tabela me rregullat e lakimit e zgjedhimit. Kjo edhe për faktin tjetër se jo çdo lexuesi të fjalorit i bie në dorë teksti i gramatikës së gjuhës shqipe, por i bie në dorë fjalori shpjegues dhe si i tillë njihet me të gjitha format gramatikore që merr fjala, pavarësisht kulturës gjuhësore që ka konsultuesi i fjalorit shpjegues.

### 5.3 NORMA E SHQIPTIMIT NË NJËSITË LEKSIKORE DHE THEKSI

Drejtshkrimi i Gjuhës shqipe është ngritur mbi parimin fonetik, me përjashtime të rralla. Në gjendjen e sotme të gjuhës letrare normat e shqiptimit letrar përgjithësisht janë kristalizuar, megjithëse në hallka të veçanta të tij vihen re ende lëkundje. Normat e gjuhës letrare janë formuar dalëngadalë së bashku me formimin e gjuhës letrare të përbashkët. Këto norma edhe në rrafshin praktik përfaqësojnë rezultatin e një procesitë gjatë të zhvillimit të vetë gjuhës. Normat që lidhen me anën tingëllore të gjuhës letrare, kanë fituar karakter gjithëkombëtar dhe nuk përputhen plotësisht me bazën dialektore të asnjërit dialekt. Struktura fonetike e gjuhës letrare mbështetet në radhë të parë në elementet e përbashkët të dy dialekteve.

Duke qenë se fjalët në gjuhën shqipe shqiptohen ashtu siç shkruhen dhe shkruhen ashtu siç dëgjohen, në fjalorët shpjegues të saj shqiptimi i fjalëve jepet vetëm për disa raste. Kështu në fjalorët shpjegues shqiptimi jepet vetëm për inicialet e emërtimeve të ndryshme, por që kanë hyrë në përdorimin e përditshëm, për shembull: *SMT (lexo sëmëtë), ~ja, f. sh~të.* ; *NB (lexo: nëbë), ~ja, f. sh.~të.* Shkurtime të tilla nuk janë në fjalorët shpjegues të viteve 1954 dhe 2006. Në hyrje të “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, 1980, janë dhënë rastet kur është pasqyruar ky informacion në fjalor.

Përveç shqiptimit, në fjalor jepet në mënyrë sistematike edhe pozicioni i theksit. Nuk vihet theksi në fjalët titull kur janë njërrrokëshe ose kur ai bie mbi zanoren ë (për arsue teknike).<sup>76</sup> Për veçantinë e gjuhës shqipe, informacioni për pozicionin e theksit është i domosdoshëm, pasi ndryshimi i tij, në shumë fjalë ndryshon edhe kuptimin e tyre. Një informacion i tillë jepet për njësitë leksikore në të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës sonë, duke filluar që nga “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954 e deri te i fundit fjalor shpjegues i gjuhës shqipe, ai i vitit 2006.

---

<sup>76</sup> Fjalori i gjuhës shqipe, (Paraqitje teknike e grafike), Tiranë, 2006, f.23

#### 5.4. PASQYRIMI I VEÇORIVE GRAMATIKORE TË FJALËVE NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Informacion tjetër i rëndësishëm që jepet në fjalorët shpjegues , për çdo zë leksikografik, (ose njësi leksikore) është edhe kategoria gramatikore e fjalës. Për realizimin e këtij informacioni përdoret terminologjia e gramatikës tradicionale të gjuhës (*emër, mbiemër, folje, ndajfolje* etj). Siç e kemi thënë edhe më lart, informacioni për përkatësinë në një pjesë të ligjëratës jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose lihet të nënkuptohet, ose informacioni zero.

Kështu p.sh. për *emrin* nuk përdoret asnjë lloj simboli që të tregojë në mënyrë të drejtpërdrejtë se është emër në fjalorët shpjegues duke filluar nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, e deri te Fjalori i 2006-ës. Ai nënkuptohet duke shënuar vetëm gjininë, mashkullore, femërore ose asnjënjësë. Por ndryshe ndodh në “Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954, ku përcaktohet kategoria gramatikore e emrit për çdo fjalë emër dhe kjo shoqërohet me përcaktimin femëror, mashkullor apo asnjënjës.

Me informacionin gramatikor për **mbiemrat e përemrat**, nuk ndodh e njëjta gjë, pasi gjini kanë edhe këto pjesë të ligjëratës, pasi ky informacion jepet me njësinë leksikografike dhe jo me kategorinë gramatikore. P.sh. *emër:llogor/e~ja, f. sh~e(t); ngjyr/ë, ~a, f. sh. ~a(t)*. *Mbiemër: olimpik, ~e, mb.; ngadaltë (i, e) mb.* Por në disa raste jepet informacioni edhe për emrin. (Këtu bëhet fjalë për fjalorët shpjegues që nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980 e deri te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, pasi, siç theksuam më lart, në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954 informacioni për emrin jepet në çdo zë leksikografik emër).

Në fjalorët që përmendëm, ky informacion jepet për fjalët që përdoren si mbiemra të panyjshëm, por edhe si emra ose ndajfolje. P.sh. *llafemadh, ~e, mb. (shkruhet në fund të artikullit : edhe përd. em.)*. *Gjuhëmpirë, mb. (edhe përd.ndajf.Mbeti gjuhëmpirë)*. (FGJSSH, 1980). Kurse në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, ky informacion jepet menjëherë pas informacionit mbiemër (mb.) P.sh. *llërëbardhë, mb., edhe si em. f.; lloçan, ~e, mb., edhe si em. llaftar, ~e, mb., edhe si em.* “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, ka ndjekur një traditë të fjalorëve shpjegues të gjuhëve të tjera, si ajo franceze, ku informacioni për pjesët e ligjëratës jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në fjalorët e tjerë shpjegues të gjuhës shqipe, ndoshta për ekonomi vendi, nuk jepet, por mendojmë se kjo duhet bërë edhe për arsyen e thjeshtë se kategoria gramatikore, së bashku me njësinë leksikografike dhe shpjegimin, përbëjnë boshtin e domosdoshëm të artikullit të fjalorit shpjegues të gjuhës. Mungesa e njërës prej këtyre elementeve do të bënte që fjalori të mos kryente funksionin që ka.

Shënime e të dhëna gramatikore më të hollësishme mund të shoqërojnë një fjalë edhe në ato raste, kur në një sintagmë të caktuar, ajo mund të funksionojë ose të marrë tiparet gramatikore të një pjese tjetër të ligjëratës, pa arritur të shndërrohet tërësisht në një fjalë të re. Nga kjo pikëpamje janë të zakonshme në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe shënimet e tipit: *përdorim emëror ose si emër, përdorim mbiemëror, ndajfoljor, paraafjalor etj.*, që tregojnë se një fjalë e veçantë, p.sh. *frymor, ~e (si mbiemër)* del në kuptimet: 1. që merr frymë me mushkëri (për njerëzit e për kafshët); *i gjallë (për një qenie)*. 2. që nxjerr tinguj muzikorë duke i fryrë me gojë (për veglat muzikore), që përbëhet nga këto vegla; *vegël, orkestër frymore etj.*; ndërsa si emër: *frymor, ~i, ~ët* del në kuptimin: “qenie e gjallë (për njerëzit, kafshët): p.sh. *frymorët e jofrymorët*.” Në fjalorët shpjegues të zakonshme janë edhe shënimet e tipit: *vetëm shumës ose vetëm njëjës, vetëm femëror ose vetëm mashkullor.*

Problemet gramatikore në fjalorët shpjegues mund të jenë të natyrave nga më të ndryshmet. Kështu p.sh. në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, janë lënë jashtë disa kategori fjalësh të prejardhura që s’kishin një përdorim aq të gjerë e të qendrueshëm, si:

1. Emrat foljorë të formuar nga pjesorja pa parashtesë, si p.sh. të caktuarit, të ardhurit, të afruarit.
2. Shumë emrafoljorë të formuar me prapashtesat: -ja, -im si larje, dredhje, kapje, mënjanim, punim, shkrim. Emra dhe mbiemra të tillë në këtë fjalor shpjegues janë vënë kur kanë një kuptim që nuk del drejtpërdrejt nga ai i foljes rrënjë. , emrat edhe kur kanë një përdorim të shpeshtë dhe të gjerë.
3. Mbiemrat foljorë të formuar nga pjesoret, si: i djegur, i përkëdhelur, i pastruar.

Një e metë e tillë është korigjuar në fjalorët shpjegues që vijnë më pas, duke filluar nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, e deri te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006. Megjithatë edhe në këta fjalorë shpjegues duhet parë vendi që zënë mbiemrat prejpjesorë. Teorikisht është e mundur që çdo pjesore të bëhet mbiemër nëpërmjet paranyjzimit të saj. Në këtë rast duhet parë nëse duhet paraqitur në fjalorin shpjegues të gjuhës si mbiemër çdo pjesore e paranyjzuar apo vetëm rastet me një denduri të madhe përdorimi dhe kur përmbajtja kuptimore e tyre sjell elemente të reja në raport me foljen (pjesoren). Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe është praktikuar zgjidhja e dytë, pasi duket më e drejtë edhe nga pikëpamja leksiko-gramatikore e semantike.

## 5.5 STRUKTURA KUPTIMORE DHE SHPJEGIMET E KUPTIMIT TË FJALËVE

Përmbajtja kuptimore e fjalëve të gjuhës shqipe, e cila përbën strukturën kuptimore, pasi përfshin të gjitha kuptimet e saj, është formuar, pasuruar e zhvilluar gjatë shekujve dhe në kohën tonë po zhvillohet e pasurohet në shumë drejtime. Ajo, së bashku me numrin e fjalëve, është pjesë përbërëse e pandarë e thesarit të pasur leksikor të gjuhës sonë. Pasuria leksikore, kuptimet e shumta të fjalëve dhe zbulimi i jetës reale të tyre në gjuhë, përcaktojnë dhe karakterin e fjalorit shpjegues. Zbulimi dhe shpjegimi i kuptimit ose kuptimeve të fjalëve dhe nuancave të tyre kuptimore, në çdo fjalor shpjegues, është bërë në bazë të parimit se si e kupton e si e përdor një fjalë të caktuar shoqëria e kohës. Ndoshta kjo është një nga arsyet që makrostruktura e fjalorëve të ndryshëm shpjegues të gjuhës shqipe, që nga “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954 e deri te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, kanë ndryshuar në numër, por edhe në numër të kuptimeve të fjalëve, të cilat janë fituar gjatë përdorimit në kontekste të ndryshme. “Strukturë kuptimore kanë edhe fjalorët dygjuhësh, por ajo ndryshon nga ajo e fjalorëve shpjegues, pasi ajo nuk ndërlidhet me shpjegimin e kuptimeve, por me fjalët gjegjëse në gjuhë të huaj për çdo kuptim nëse një fjalë gjegjëse e gjuhës së huaj nuk është e mjaftueshme për të gjitha kuptimet e fjalës”<sup>77</sup>

Zbulimi sa më i plotë i kuptimeve, shpjegimi dhe ilustrimi i tyre, tregojnë se pasuria dhe forca e leksikut të gjuhës sonë nuk qëndron vetëm në sasinë e fjalëve të ndryshme, por edhe në kuptimet e nuancat e shumta të tyre. Në fjalorët normativpërkufizimi i fjalës ka karakter filologjik dhe jo enciklopedik. Por kjo s’do të thotë se ai nuk duhet të jetë shkencor. Përkufizimi duhet të zbulojë kuptimet dhe nuancat e fjalëve në bazë të realizimeve më të fundit të shkencës në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, gjë e cila vihet re në shpjegimet që u janë bërë njësive leksikore nga fjalori i parë shpjegues (1954) deri te i fundit (2006), ku përkufizimet janë më të plota.

Ndarja e kuptimeve të fjalëve si dhe ndërtimi i strukturës kuptimore të fjalëve në fjalorët shpjegues, janë njësuar sipas kategorive a sipas klasave të fjalëve (emra, mbiemra, emra veprimi, emra cilësorë, emra bimësh, emra kafshësh, terma, fjalë krahinore...). Kjo lloj zgjidhjeje e njësuar është parim themelor në hartimin e fjalorëve shpjegues. Kuptimet e fjalëve polisemantike, që përbëjnë strukturën kuptimore të saj, në fjalor shënohen zakonisht me numra të veçantë. Fjalët kanë strukturë kuptimore kur kanë dy a më shumë kuptime. Çdo kuptim në fjalorët shpjegues shpjegohet veçan, por duke mbajtur parasysh kuptimet e tjera të fjalës, madje edhe kuptimet e fjalëve të të njëjtit tip.

---

<sup>77</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.310.

Gjatë hartimit të fjalorëve, kërkesa për shpjegimin e kuptimeve të fjalëve, është kërkesa kryesore, pasi qëllimi i shpjegimit të kuptimit është që ta lidhë atë me realien që shënon fjala në atë kuptim, ta identifikojë dhe ta dallojë nga radhët e tjera të ngjashme me të. Duke u nisur nga argumentet e mësipërme, në ballafaqimin e përkufizimeve të njësisive të njëjta leksikore në fjalorë të ndryshëm shpjegues vëmë re ndryshime, bile edhe të meta në fjalorin e parë shpjegues, 1954, p.sh.:

*Balenë (1954)* - emër i përgjithshëm i llojeve të një familje sisorësh detarë nga rendi i cetacevet, që banojnë në detet e veriut e që janë shtazët më të mëdha në botë që kanë trajtën e peshkut dhe arrijnë në gjatësi 15 m.

*Balenë (1980)* Kafshë gjitare shumë e madhe, me trup si të peshkut, me gojë shumë të gjerë e me fletëza të birta në vend të dhëmbëve, që jetojnë në oqeane e dete dhe gjuhet për mishin dhe për dhjamin e saj.. në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, ky kuptim është dhënë më i përmbledhur pa dalë jashtë teme.

*Cikël (1954)* - një seri poemash që trajtojnë argumente rreth një subjekti të përbashkët. (Cikli i kreshnikëve).

*Cikël (1980)*, 1. varg i plotë dukurish ose shndërrimesh, që kryhen brenda një kohe të caktuar dhe që përsëriten rregullisht sipas po asaj radhe; periudha e kohës në të cilën një varg dukurish ose shndërrimesh kryehet i plotë sipas një radhe të caktuar (cikël i plotë, cikël bimor, cikli i stinëve).

2. Varg dukurish, të dhënash, materialesh etj., që lidhen ndërmjet tyre nga përmbajtja dhe që formojnë një tërësi më vete. (Cikël leksionesh).

3. Varg veprash artistike të një gjinie, të cilat kanë po atë temë, po atë subjekt ose po ata heronj kryesorë të përbashkët. (Cikël lirik, Cikli i Mujit dhe i Halilit, Cikël vjershash).

4. Ndarja e viteve të mësimimit në shkollë sipas rrethit të njohurive që jepen. (Cikli i ulët, Cikli i lartë).

*Shi~u.m\_* “reshje që bie në trajtë pikash uji”.

*Bor/ë~a.f.* “reshje që bie në trajtë flokësh të ngrira”.

*Bresh/ër~ri.m.* “reshje që bie në trajtë kokrrash të akullta”.

Këto shpjegime duken që në pamje të parë që janë të thjeshtëzuara, për të dhënë vetëm një element të përbashkët dhe një element dallues të kuptimeve të fjalëve përkatëse. Ballafaqimi i shpjegimeve të mësipërme të kuptimit të fjalëve tregon se, për të dhënë shpjegime të drejta, është e nevojshme të kihet parasysh të dhënat më të fundit të



shkencës, por ato tregojnë edhe zgjerimin e kuptimeve të fjalëve, gjë që ka çuar në rritjen e aftësisë shprehëse të gjuhës.

Qëllimi i shpjegimit është që të na lidhë me realien që shënon fjala në atë kuptim, ta identifikojë dhe ta dallojë nga realiet e tjera të ngjashme me të. Çështja e kuptimeve leksikore është më e ndërlikuar, pasi ka një tipologji të shpjegimit dhe disa procedura për ta sendërtuar atë. Por cila është tipologjia e shpjegimit që përdoret në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe? Për këtë J.Thomai jep katër tipe shpjegimesh:

1. Shpjegimi me perifrazim.
2. Shpjegimi me përshkrim.
3. Shpjegimi me përkufizim.
4. Shpjegimi me sinonimi.”<sup>78</sup>

**1. Shpjegimi me perifrazim,** përdoret kur kuptimin leksikor e japim me disa fjalë të tjera të njohura, veçojmë disa nga përbërësit semantikë për ta rrokur atë më mirë; p.sh: *duroj* kal. dhe jokl. “i përballoj dhe i kaloj vështirësitë, dhembjet, shqetësimet, vuajtjet, fatkeqësitë, etj., i qetë e me gjak të ftohtë, pa u ankuar e pa u ligështuar, i bëj ballë a i qëndroj një ndikimi, një veprimi ose një ngacmimi të jashtëm, jam në gjendje të mposht një dëshirë, një kërkesë të organizmit, që më mundon e më tundon. Ky tip shpjegimi përdoret rregullisht për fjalët e leksikut të përgjithshëm e për leksikun abstrakt. Perifrazimi duhet të jetë i qartë, i plotë dhe sa më ekonimik, i ngjeshur. Ai kërkon të jetë më i njohur përballë kuptimit që shpjegohet dhe në të njëjtën kohë të pasqyrojë strukturën e këtij kuptimi, përbërësit e tij, në rendin e lidhjet e tyre.

**2. Shpjegimi me përshkrim,** është kur në të pasqyrohen treguesit kryesorë të realies së cilës i referohet fjala, përshkruhet realia sipas këtyre treguesve; p.sh. *lulebor/ë-a* f. “bimë barishtore shumëvjeçare zbukuruese, me gjethe të gjera, me majë e të dhëmbëzuara anash dhe me lule të grumbulluara si top, që ndërrojnë ngjyrat gjatë kohës së lulëzimit”. Përshkrimi përdoret rregullisht për leksikun konkret. Edhe Përshkrimi duhet të jetë i qartë, i plotë, i ngjeshur, duke pasqyruar ata tregues të realies që na e sjellin më shpejt e më lehtë ndërmend atë, edhe pse mund të mos jenë thelbësore për natyrën fizike të sendit.

**3. Shpjegimi me përkufizim,** përmban të shprehura gjuhësisht tiparet themelore të konceptit për realien e dhënë, pra, kryesisht ata tregues të realies që janë thelbësore për natyrën e saj. P.sh. *em/ër-ri* m.sh. *-ra, -rat*: “**1.** fjalëose grup fjalësh, me të cilat quhet një njeri ose një kafshë, një send, një dukuri, një vend etj., për ta veçuar ose për ta dalluar atë nga të tjerët. **2.** gjuh. pjesë e ligjëratës që shërben për të shënuar një qenie a një send dhe që ka gjini, numër e rasë”.

---

<sup>78</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.312.

**4. Shpjegimi me sinonimi,** është kur kuptimi i një fjale më pak të njohur, me një sinonim më të përgjithshëm. Ky tip shpjegimi përdoret rregullisht për fjalë ose për kuptime të kufizuara në përdorim, siç janë fjalët e kuptimet krahinore, të vjetruara, të ligjërimet të thjeshtë, huazimet leksikore që mund të zëvendësohen me një fjalë shqipe etj. P.sh. *kumbullor/e-ja* f.sh. -e, -et, domate; *eksperienc/ë-a* f. sh. -a, -at, përvojë.

Në një varg sinonimesh përdoret sinonimi dominant, pra më i njohuri, më i përgjithshmi. P.sh. për *gjiton*, *komshi* mund të shërbejë si shpjegim “fqinj”, por jo anasjelltas. Në këtë rast sinonimi kryesor merret si i njohur ose që mund të shpjegohet në mënyrë të plotë me perifrazim. Shpjegimi me sinonim përdoret vetëm kur kuptimet e fjalëve përkatëse janë plotësisht të njëjta, spse me këtë tip shpjegimi nuk duhet të humbasë asnjë vlerë e kuptimit që shpjegohet, asnjë përbërës i kuptimit, asnjë ngjyrim ligjërimor e stilistik. Prandaj, shpesh ndihet nevoja që, përveçsinonimit, si shpjegim të jepen edhe shënime të tjera plotësuese për këto vlera si, e vjetruar, krahinore, bisedore, tallëse etj.

Lind pyetja se si ndërtohet shpjegimi i kuptimit të fjalëve? Prej elementeve të ndryshme të kuptimit zgjidhen ato elemente që do të formulohen në shpjegim me fjalë të tjera. Si element i parë i shpjegimit është vënë ajo fjalë apo togfjalësh që i referohet grupit më të afërt ku bën pjesë realia (sendi, tipari, veprimi etj) e shënuar nga fjala e dhënë. P.sh. *mineral~i m. sh. ~e(t)* “lëndë joorganike ose bashkim kimik natyror...”; *mollë~a, sh.~ë(t)*. “pëmëfrutore, që bën lule të bardha dhe kokrra të rrumbullakëta, të tulta e të shijshme, kokrra e kësaj peme...”.

*Trëndafil~i m. sh. ~a(t) (1954)*. Shkurre me gjëmbe nga familja e rozacevet; me lule të mëdha e të mesme dhe me ngjyrë të kuqe, të bardhë. etj.

*Trëndafil ~i m. sh.~a, `at. (1980)*. shkurre zbukuruese me gjemba të gjatë, me lule të mëdha fletë-fletë të bukura, me erë të këndshme e me ngjyra të ndryshme; lulja e kësaj shkurreje. trëndafil i kuq (i bardhë).

*Trëndafil/i m. sh. ~a, ~a(t) (2006)* bot. Shkurre zbukuruese me kërcell të gjatë me gjemba, me lule të mëdha fletë-fletë, të mesme e me ngjyra të ndryshme, lulja e kësaj shkurreje.

Pas fjalës së parë renditen përbërësit e tjerë të kuptimit, sipas peshës që kanë, që siç shihet nga shembujt e mësipërm kanë ndryshime nga njëri fjalor në tjetrin. Në shpjegim është mbajtur parasysh edhe kuptimi kategorial i fjalës, i cili jep mundësinë për të ndërtuar ndonjëherë edhe edhe një shpjegim tip (ose një pjesë të tij). Kështu p.sh. shpjegimi i kuptimeve të mbiemrave pronësorë mund të fillojë me sintagmat: “*që ka.....*”; “*që është....*”; “*që bën...*” etj. :

*Thellë (i, e) mb. (1954).* 1. që shtrihet mjaft nga lart poshtë, që ka fundin larg nga syprina.

*Thellë (i, e) mb (1980 dhe 2006).* 1. Që ka largsi të madhe nga lart poshtë duke u nisur nga sipërfaqja e tokës a e ujit; që ka thellësi; që ndodhet a që bëhet në thellësi.

2. Qështë larg nga kufiri; nga skaji a fillimi i një vendi ose larg nga kryeqyteti etj.

*Simetrik, ~e, mb.(1954).* Që ka simetri. Figurë simetrike.

*Simetrik, ~e, mb.(1980).* Që ka simetri; që është ndërtuar a që është vendosur sipas rregullave të simetrisë. Figurë simetrike. Trupa simetrikë. Në mënyrë simetrike.

*Simetrik, ~e, mb. (2006).* Që ka simetri; figura simetrike trup simetrik, në mënyrë simetrike.

Kurse shpjegimi i mbiemarve me kuptimin e tiparit sipas lëndës mund të fillojë me sintagmën: “që është prej....”; “që bëhet nga....”; “që përbëhet nga....”.

*Artë (i, e) mb. (1980).* 1. i bërë prej ari ose i larë me ar. 2. që ka ngjyrën e arit.

*Artë (i, e) mb.(2006).* 1. i bërë prej ari ose i larë me ar, i qëndisur me fije ari. 2. Që ka ngjyrën e shkëlqimit të arit. Flokë të artë.

Fjalorët e ndryshëm shpjegues, pavarësisht ndërtimit të përafërt të shpjegimit, kanë edhe dallimet e tyre. Kështu në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, në çdo fjalë jepet shpjegimi i kuptimit ose i kuptimeve që ka sipas fjalëve të para. Kuptimet janë renditur sipas shkallës së përdorimit, duke u shënuar më parë ato më të përdorurat dhe sipas lidhjes që kanë ndërmjet tyre. Kuptimet e ndryshme zakonisht ndahen me shifra arabe, kuptimet më të afërta vetëm me pikëpresje, kuptimet sinonime me presje. Për të sqaruar më mirë kuptimin e fjalëve dhe për të ilustruar përdorimet e tyre, shpjegimi është shoqëruar shpesh me shembuj nga frazeologjia. Shembujt jepen pas shpjegimit të kuptimit me të cilin lidhen, duke u ndarë prej tij me dy pika dhe janë fjali ose fraza të shkurtëra.

“Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, në krahasim me dy fjalorët e mësipërm shpjegues ka bërë ndryshime në strukturën kuptimore të njësive leksikore, realizuar kjo nëpërmjet sintezave kuptimore a të shkrirjeve të kuptimeve të përafërta në një kuptim, ose ka ngjeshur shpjegimet. Ndërtimi i kuptimeve më të përgjithshme nëpërmjet abstragimit të një shkalle më të lartë të dy a më shumë kuptimeve në një, është mbështetur në afrinë e këtyre kuptimeve sipas përbërësve themelorë dhe në mundësinë për abstragim.

Në këtë fjalor për foljet vetvetore, për emrat e veprimet dhe mbiemrat prejjesorë, nuk ndërtohen struktura kuptimore të plota, kur nuk kanë kuptime të tjera nga ato të foljeve

përkatëse. Shnërimi semantik nga një kuptim foljor në një kuptim emëror ose mbiemëror, mendohet se bëhet lehtë nga përdoruesi i këtij fjalori shpjegues.

P.sh. **Mbush**: 1. shtie diçka në një enë, në një arkë etj. aq sa nxë, zë një vrimë, një gropë etj. me diçka, kund. zbraz. Mbush gotën (shishen) me verë. 2. edhe fig. fryj, enjt, ngop. Klima ia mbushi faqet, na mbushi me llafe. 3. bujq. mbath bimën me dhe. 4. fig. i ngjall dikujt një ndjenjë, bëj që ta pushtojë të tërin, e nxit. 5. plotësoj një moshë a një kohë: mbush pesëdhjetë vjet. 6. fig. bised. kryej, përmbush, plotësoj: mbush premtimet. 7. jokal. iku me vrap, ia mbathi, ia mbushi në shtëpi. \*mbushem vetvet. \*mbushje~a f. sh.~e(t). 1. veprim sipas foljeve. 2. lëndë me të cilën mbushet diçka: armë me mbushje \*mbushur (i, e) mb. 1. qëështë mbushur, dhëmballë e mbushur. 2. i shëndetshëm, i ngjallur, i plotë, i fryrë, : me faqe të mbushura.

Te foljet vetvetore kuptimi i parë është përmbledhës për të gjitha kuptimet gjegjëse të foljes veprorë, të cilat folja vetvetore i trashëgon; kuptimet 2 e tutje janë kuptimet e veçanta të foljes vetvetore, që nuk i ka veprorja, ose kuptime që kanë përbërës të ndryshëm nga ato të veprorës.

**Çoj, kal. çova, çuar** 1. edhe fig. ngre, kund. ul, e çoj peshë. 2. i prish gjumin; e ngre, zgjoj, e çoj nga shtrati. 3. gjah. nxjer nga strofulla a nga një vend i fshehtë; i çuan rosat. 4. fig. e bëj që të marrë pjesë në një veprimtari shoqërore; frymëzoj për diçka; i jap zemër; ngre; e çuan popullin. 5. bëj punimin e parë, çoj, lëroj, kthej: çoi tokën (arën, ugarin). 6. fig. i ngjalli a i shkaktoi diçka. zgjoj, më çon mallin, të çon etjen.

**Çohem vetv.** 1. vetv. e çoj, çohem në këmbë; çohem nga gjumi. 2. nis të eci, mëkëmbem, fig. bëhem për punë; iu çuan fëmijët. 3. V.III, fryhet, del më lart se të tjerët përreth. Çohet buka (brumi).

**Çuarje~a f.** veprim sipas foljeve.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, bashkohen në një kuptim (zakonisht) ato kuptime të prejardhura që në fjalorët e mëparshëm shpjegues të gjuhës shqipe, janë veçuar sipas figurave gjuhësore të tejdukshme (metaforë e metonimi). në paraqitjen grafike ato jepen të ndara me pikëpresje a me një vizë të pjerrët sipas shkallës së afërisë. Ka raste kur kemi një formulim të përbashkët: p.sh. fjala *grykë* në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, ka tetë kuptime, kurse në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, jo vetëm bashkohen disa kuptime të fjalorit të mëparshëm, si kuptimi 1 me 3, kuptimi 2 me 8, kuptimi 5 me 6, por edhe ka shumë kuptime të reja duke e çuar në 10 kuptime, si: 8. pjesa e sipërme e gjellës, e qumështit etj; gryka e qumështit, ajka, *i dha grykën e gjellës*, i dha pjesën e sipërme më të mirë të gjellës.

Në shumë raste edhe ndarjet sipas përbërësve kuptimorë frymorë - jofrymorë, i kaluar - i tashëm, vend - kohë, sipas tipareve etj., kur kuptimet janë shumë të afërta ato bashkohen në një kuptim: p.sh. kuptimet 1dhe 2 dhe 5me6 te mbiemri (*i, e*) afërt, kuptimet 2dhe 3 tek *akull-i*, ose kuptimet 3dhe 4 tek *angari* etj.

**Afërt (*i, e*) (1980, f.8)**1. që ndodhet në largësi të vogël nga diçka tjetër, që është pranë, afër diçkaje; fqinjë; kund. i largët. *Fshatra të afërta. Shtëpi (rrugë) të afërta..*

2. Që do të vijë pas pak, a që ka qenë para pak kohe: kund. i largët. *Detyrat e afërta.*

3.shih Afërm (*i*)-*e* (*e*)1. *Njerëzit e afërt.*

4. Që ka marrëdhënie të ngrohta e të çiltërta më dikë, i dashur e i përzemërt; që bën pjesë në rrethin e ngushtë të dikujt, që ka fituar besimin e dikujt.*Shok (mik) i afërt.*

5. Që ka përmbajtje ose tipare të ngjashme me një tjetër. *Qëllime të afërta. Fjalë me kuptime të afërta. Degë (shkenca) të afërta.*

6. gjuh. Që ka prjardhje të përbashkët me një tjetër. *Gjuhë të afërta.*

7.Që afrohet nga madhësia ose nga vlera me një tjetër.*Shuma të afërta. Dy numra të afërt.*

**Afërt (*i, e*) (2006, f.28).** 1. që ndodhet afër dikujt a diçkaje; që ndodhet afër një kohe të caktuar; kund. i largët; *fshatra të afërta, e ardhmja e afërt; në të kaluarën e afërt.*

2. i afërm, i lidhur ngushtë e i dashur me dikë: *njeri i afërt; tregohet i afërt.*

3. që ka lidhje të ngushta prejardhjeje a ngjashmëri të madhe me një tjetër: *kuptime të afërta, shkenca të afërta, gjuhë të afërta (gjuhë).*

Pra siç pamë nga shembulli i mësipërm, te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, kemi bashkime të kuptimeve të përafërta dhe në këtë mënyrë struktura kuptimore nga 7 njësi kuptimore që ka në fjalorin e 1980-ës, këtu ka 3 njësi kuptimore, por nuk ka rrudhje të fuqisë shprehësetë saj, pasi edhe kjo strukturë kuptimore i jep të gjitha kuptimet leksikore të kësaj fjale. Në këtë fjalor shembujt e bashkimit të kuptimeve janë të shumta. Ne këtu sollëm këtë shembull për të konkretizuar idenë e këtyre bashkimeve.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, kemi ndryshime të shpjegimit të njësive leksikore edhe në aspektin vëllimor, krahas shkrimit. Kjo është një arsye tjetër që ky fjalor, megjithëse ka rreth 7000 fjalë më shumë se “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, ka numër faqesh më pak, gjithsej 1515 faqe, nga 2273 qëka ky i fundit (1980).

Sinteza e kuptimeve në njësi të shumta leksikore, në krahasim me fjalorët e tjerë shpjegues, nuk ka çuar gjithnjë e domosdo në zgjerimin e vëllimit të shpjegimit, në

zgjatjen e tij. Përkundrazi, sa më shumë janë bashkuar kuptimet, aq më të përgjithshëm kanë qenë përbërësit (elementët) e kuptimit, kështu që më i vogël ka qenë numri i tyre, ndaj përmbledhja e tyre në formulimin e shpjegimit leksikor është më e shkurtër. Por mund të thuhet se zgjerimi i vëllimit të kuptimit leksikor është një përpjestim të zhdrejtë me vëllimin e shpjegimit të tij. Kjo në fjalor nuk ka përjashtuar rastet kur shpjegimi ka qenë më i gjatë se formulimi për çdo kuptim, por gjithësesi formulimi nuk përfshin fjalë për fjalë shpjegimet e dy-tri kuptimeve që bashkohen (me përjashtim të rasteve kur këto kuptime kthehen në nuanca të një kuptimi e detyrimisht jepen me pikëpresje). Këto bashkime kuptimesh nuk janë bashkime mekanike të tyre, por sinteza a “shkrirje” për të dhënë një lëndë të re semantike.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, vihet re një rivlerësim, ose rikuptimësim i shumë fjalëve që në fjalorët e mëparshëm (kryesisht 1980 dhe 1984) kishin vlerësim klasor a politik, mbi bazën e vlerësimeve që u bënë atyre grupe të caktuara social-politike nëkohë të ndryshme. Ky vlerësim klasor nuk duhet ngatërruar me ngjyrimet emocionale a stilistike të fjalëve që kanë karakter mbarëshoqëror. Më poshtë po sjellim shembuj fjalësh nga fjalorët shpjegues, 1954, 1980 dhe 2006, për të vënë re këtë ndryshim në formulimin e kuptimeve të tyre.

**Bankier (1954).** Pronar ose drejtor i një banke.

**Bankier (1980).** Pronar i një banke ose aksioner i madh financiar në vendet kapitaliste, i cili drejton veprimtarinë e bankës për të nxjerrë fitime.

**Bankier (2006).** pronar banke ose aksioner i madh financiar.

**Fe~ja ef. sh~,~të. (1954).**1. Ide dhe pikëpamje të bazuara në mistikë, në besimin se ekzistojnë forca dhe qenie që bëjnë mbrekullira: Feja është opium për popullin (Marksi). 2.Nishani i martesës.

**Fe`ja, f. sh~,~të (1980).** Besim i verbër se gjithçka në botë përcaktohet e drejtohet gjoja nga forca të mbinatyrshe, hyjnore, si pasqyrim fantastik e i shtrembër i realitetit dhe si një nga format e ndërjegjes shoqërore; tërësi dogmash që japin një botëkuptim fund e krye idealist e reaksionar, i cili përdoret nga klasat shfrytëzuese për të mashtruar e për të nënshtuar masat punonjëse; besimi te zoti. *Feja katolike (ortodokse, myslimane). Feja është opium për popullin.*

**Fe,~ja f. sh~,~të. (2006).** Besimi te Zoti a te një perëndi; feja e krishterë (myslimane, budiste).

“Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, duke ruajtur karakterin shkencor të shpjegimeve, ka synuar që ato të jenë sa më të qarta për t’u kuptuar, sa më të shkurtra e ekonomike, sa më të lehta në kuptim, me fjalë të zgjedhura mirë e ndërtime sintaksore normative.

Përveç anës shkencore, për t’u pasqyruar në fjalorët shpjegues, njohuritë për shpjegimin e kuptimit të fjalëve kanë edhe vlera praktike, pasi lind nevoja e njohjes së tyre, për ta përdorur fjalën drejt në ligjërim. Duke zotëruar mirë strukturën semantike të leksikut, ne zhvillojmë të folurit tonë duke e bërë atë të pasur e të larmishëm, organizojmë më mirë mendimet në variantet e ndryshme të shprehjes.

Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, shpjegimi shfaqet në shumë raste si një rimarrje në mënyrë analitike e njësisë leksikografike. P.sh. **Besnikëri, ~a f.** Të qenët besnik ndaj dikujt a diçkaje. Besnikëri ndaj atdheut. Ndershmëri~a, f. Cilësi e njeriut të ndershëm, të qenët i ndershëm. *Punon me ndershmëri. Ftohtësi~a f.* 1. Të qenët i ftohtë i një sendi, ndjenja e të ftohtit në trup; kund. ngrohtësi. *Ftohtësia e dimrit. E mban ftohtësinë.*

Në fjalor ka raste kur shpjegimi merr formën e një rimarrjeje të njësisë leksiko-grafike që nuk është më analitike se vetë njësia. Kjo përdoret vetëm në rastet kur kemi kalime nga një nivel gjuhësor në tjetrin. Për shembull: njësia leksikografike i përket shtresimit krahinor, kurse shpjegimi i përket gjuhës letrare kombëtare. P.sh. :

**Dang/ë~a f.sh~a(t).** edhe fig. krahin. damkë, njollë: *fytyrë me danga; dangë turpi.*

**Kori, ~a f. krahin.** Turp. Muçit/em vetv. ~a (u)~ur. krahin. 1. enjtem, fryhem, mbufatem, (edhe fig.) *Iu muçit zemra.*

**Brengosur (i, e):** i mërziur, i helmuar, i sëkëlldisur, me shpirt të plasur. *E kam shpirtin të brengosur.*

Nëkëto raste shpjegimi reduktohet në një fjalë sinonime. Sinonimia këtu shfaqet edhe ndërmjet njësisë leksikografike dhe *shpjgimit në formë perifraze.*, por jo gjithmonë nga një fjalë tjetër pa cënuar kuptimin ose shtresimin e fjalisë. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, përdoren të njëjtat skema shpjegimi për të njëjtën pjesë të ligjëratës. Në vëzhgimin tonë për këto skema del se në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” njësia leksikografike dhe shpjegimi kanë të njëjtin funksion. Normalisht, në një fjali, njësia leksikografike mund të zëvendësohet nga shpjegimi. (*njeri i përgojuar ose njeri që e kanë përgojuar*). Ka raste kur ky shpjegim bëhet me vështirësi, pasi shpjegimi përbëhet nga dy ose më shumë shpjegime të bashkëngjitur, që kanë të njëjtën përmbajtje, por në forma të ndryshme:

**Detar~e mb.** Që lidhet me detin, që i përket detit; që ndikohet nga deti; që vjen nga deti.

**Nxehtë (i, e) mb.** 1. Që ka temperaturë të lartë, që ka nxehtësi. *Ujë i nxehtë. Hekur i nxehtë.* 2. Që sapo ka dalë nga furra, që sapo është zier ose pjekur. *Bukë e nxehtë. Gjellë e nxehtë.* (vazhdon shpjegimi i kuptimeve të tjera, gjithsej 7 kuptime).

Te fjala **port** kemi të dhënë shembullin *port detar*. Në fjalor jepen edhe kuptimet e mbiemrit *detar~e* mb. 1. që lidhet me detin, i detit; që rritet a që gjendet në det, që ndikohet a që vjen nga deti: *bimësi detare, rrymë detare, klimë detare.* 2. që lidhet me detarinë ose me mjetet e lundrimit nëpër det, i detarisë, që merret me detari: *transport detar; njësi ushtarake detare.*

Kështu që në shembullin e dhënë në fjalor, *port detar*, mbiemri *detar* mund të zëvendësohet nga shpjegimi i parë (i kuptimit 1), por jo me shpjegimet e tjera. Ky zëvendësim është i pamundur edhe në rastet kur njësia leksikografike dhe shpjegimi nuk kanë të njëjtën gjini (mirëkuptim, ~i m. marrëveshje; *mirëkuptim i plotë, marrëveshje e plotë*). Siç shihet, mbiemri duhet të ndryshojë gjininë për t'u përshtatur me gjininë e përkufizuesit. Ky problem mund të zgjidhet duke përdorur si element kryesor të shpjegimit një fjalë që ka të njëjtën gjini me njësinë leksikografike.

Ashtu si dhe në fjalorët e tjerë shpjegues, shpjegimi i mbiemrave, në këtë fjalor (1980), bëhet duke nisur me një fjali lidhore, ndaj nuk e pranon ndajfoljen pa bërë ndryshim të strukturës së fjalisë. P.sh. :

**Përgojuar (i, e) mb.** që e kanë përgojuar. *Intelektual shumë i përgojuar* bëhet *Intelektual shumë që e kanë përgojuar* (një ndërtim i tillë është i papranueshëm për sintaksën e gjuhës shqipe), por mund të bëhet duke ndryshuar strukturën e fjalisë : *Intelektual që e kanë përgojuar shumë.*

Në fjalor kemi edhe **shpjegim morfosemantik**. Ky shpjegim përdoret kryesisht për fjalët e prejardhura e të përbëra dhe i paraqet elementet e njësisë leksikografike në një kombinim të ndryshëm, duke sjellë ose jo informacion të ri. P.sh. :

**Hekurbeton~i, ndër.** Beton i forcuar me shufra hekuri në ndërtime të ndryshme; shpjegimi morfo-semantik është ithjeshtë dhe jep sinonimi formale. Vetëm se ky shpjegim nuk është shumë i qartë. Fjalorë të gjuhëve të tjera, këtë shpjegim e kanë zëvendësuar me shpjegimin logjik ose duke mos e dhënë fare shpjegimin, si fjalori i frëngjishtes. Në shpjegimin logjik njësia leksikografike dhe përmbledhësi i perkasin së njëjtës pjese të ligjëratës. (*karrige - ndenjese*: emra; *emocionoj - çliroj*: folje). P.sh. :

**Ekran~i, m. sh. ~e(t)** (1980). Pëlhurë zakonisht e bardhë, e shtrirë a e varur në mur, mbi të cilën shfaqen filma.

**Ekran~i, m.sh.~e(t)** (2006). spec. Pëlhurë e bardhë (në kinema) ose pllakë prej lënde të posaçme (në televizor, kompjuter etj.) ku riprodhohen me anë të dritës filma, sinjale etj.



## 5.6 VEÇORITË E PARAQITJES SË THËNIEVE ILUSTRUESE NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Parimet e përgjithshme për hartimin e fjalorëve shpjegues i gjejmë në punimin e A.Kostallarit “Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” ku shprehet se: “Sintagmatika në një fjalor nënkupton drejtpërdrejt thëniet në të cilat nuk mund të konsiderohen nivel i pavarur i gjuhës, ato janë njësi ndërtimore të ligjërit, lëndë ilustruese për fjalorin, e brenda kësaj hullie ato janë nocione gjuhësore, dhe veçmas nocion leksikologjik e leksikografik”.<sup>79</sup> Thëniet janë togje të shkurtra fjalësh, që vihen pas shpjegimit të një kuptimi, për ta plotësuar atë me elemente e nuanca më të imëta të atij kuptimi, të cilat nuk mund të jepen të gjitha në shpjegim. Por thëniet kanë dhe vlera të tjera plotësuese në nuancat shprehëse, emocionuese e stilistike, në llojet e lidhjeve sintaksore të fjalës që shpjegohet, në fushën leksikore dhe në të gjithë leksematikën a sintagmatikën e saj.

Thëniet tregojnë që kjo fjalë në këtë kuptim është reale në gjuhë dhe ka këtë fushë e këto veçori përdorimi të gjerë të fjalës në leksikografi dhe barasvlerësimi në fjalorët dygjuhësh. Fjalorët kanë nevojë për ndërlidhjet kontekstuale, për bashkëlidhjet e zakonshme të fjalëve. Thëniet nënkuptojnë që fjala është përdorur në një kontekst të caktuar, edhe pse në një fjalor ky kontekst është minimal. Jashtë kontekstit, jashtë përkatësisë sendore-nocionore konkrete, fjala sjell informacion të papërcaktuar dhe ka vetëm kuptim potencial. Ajo e merr plotësisht kuptimin e saj real, si të thuash semantizohet në një kontekst a situatë të caktuar, ku asnjansohen disa përbërës të saj kuptimorë e aktualizohen disa të tjerë. Në këtë aspekt kuptimi është rezultat i bashkëlidhjes së fjalës me mjedisin rrethues.

Thëniet kanë të bëjnë me fjalorin e tipit aktiv. Kuptimi leksiko-semantik shihet, para së gjithash, si sistem i përdorimit të tij (i konteksteve gjuhësore). Mundësitë semantike të fjalës, siç u theksua më lart, shfaqen jo duke treguar përmbajtjen nocionore, por, para së gjithash, duke paraqitur mundësisht të plotë distribucionin tipik (shuma e të gjitha konteksteve ku del një njësi e caktuar e gjuhës), normativ të fjalës së dhënë. P.sh.: *besa* jepet, mbahet, shkelet, thyhet, kthehet; kurse *detyra* kryehet, mbarohet, përfundohet, lihet; *jam me ethe* dallon kuptimisht nga *jam ndër ethe/ në ethe* -këto me kuptim të figurshëm; *në tryezën e bukës* *hahet*, kurse *në tryezën e bisedimeve* *nuk hahet*; *ka bisedime zyrtare*, por jo *biseda zyrtare* etj.

---

<sup>79</sup> Referuar H.Shehu, Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes, në “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.162.

Ky distribucion gjen shprehjen e vet më të qartë në fjalorin aktiv, ku përmbajtja kuptimore e fjalës shfaqet në një varg të gjerë përdorimesh, sipas tipave të konteksteve që pasqyrojnë jetën e fjalës në gjuhë. Këto kontekste bëjnë që të rrokët e plotë semantika e fjalës dhe të përdoret drejt ajo. (krahaso, p.sh. *kreh flokët/ kreh leshin/kreh kalin/kreh tekstin etj.*).

Në një vështrim gjuhësor e veçmas leksikologjik e leksikografik më specifik përmendim se thëniet kanë vlera të ndryshme, si:

1. Vlerë denotative (shënuese) p.sh. elektrodë pozitive është “anodë”, elektrodë pozitive është “katodë”.
2. Vlerë konotative (ngjyruese). P.sh. kuptimet e kushtëzuara sintaksore, që lindin veçse në një kontekst të caktuar si te tipi: *është dhelpër ai etj.*
3. Thëniet diferencojnë kuptimet e fjalëve shumëkuptimëshe. P.sh. : *rini entuziaste* është “rini që punon me entuziazëm”/ *këngë entuziaste* është “këngë që shpreh entuziazëm”.
4. Thëniet saktësojnë kuptimet e kryehershme. P.sh. *nxit zjarrin* “i fryj që të ndizet”; *kallëzuan grunjëzat* “nxorën kallëzat”.
5. Saktësojnë ngjyrimet kuptimore të sinonimeve. P.sh. krahasojmë ndajfoljet *shumë tepër*.

**Shumë ndajf.** 1. në një sasi të madhe, në një shkallë të lartë, fort, mjaft; kund. *pak a shumë* në një farë mase; *punon shumë; i dhemb shumë; e dua më shumë se ti; aq më shumë* sidomos, veçanërisht, aq më tepër, madje. 2. gjatë një kohe të madhe, mjaft kohë, më tepër se ç’duhet; tepër; mjaft; kund. *pak; fjeti shumë, zjeu shumë, ndenji shumë*. \*pj. përdoret për të formuar shkallën sipërore ose një shkallë të lartë të cilësisë, të një veprimi a të një gjendjeje; mjaft; *shumë i shpejtë (i fortë); shumë pjellor; shumë mirë (keq); shumë afër (larg); mbahet shumë rëndë; janë shumë miq janë miq të ngushtë*.

**Tepër ndajf.** 1. më shumë nga ç’duhet; shumë; *foli tepër; / (në shkallën krahasore) në një shkallë më të lartë e më me forcë: ishte më tepër një qortim sesa një këshillë*. 2. si *kallëz*. mjafton: *teper dhe kaq*. \*pj. tregon një shkallë më të lartë të cilësisë, të veprimit a të gjendjes: *teper kërkues (i suksesshëm)*.

6. Thëniet plotësojnë informacionin që jepet në shpjegimin e glosës. P.sh. : *zvarranik, ~u m. sh. ~ë(t)* (2006, f.1238) 1. zool. kafshë kërbishtore (si hardhuca, gjarpri etj.), me trup të zgjatur e pa këmbë, që lëviz duke u zvarritur, rrëshqanor; sh. klasa e këtyre kafshëve: *vezë zvarranikësh*. Pra në këtë shembull plotësohet informacioni duke thënë se zvarranikët pjellin vezë, informacion që nuk jepet në shpjegimin e glosës.

7. Motivojnë regjistrat shkencorë të njësive leksikore a të kuptimeve të tyre. Një gjë e tillë duket po të krahasojmë dy thënie (si shumë të tjera): *pika e vlimit* dhe *vëmë pikë në fund të fjalisë*.
8. Ilustrojnë njësitë e çerdhes fjalëformuese. Për të argumentuar këtë cilësi të thënieve po sjellim këta shembuj për t'i krahasuar: *mish pa kocka s'ka* dhe *ind kockor*. *Mbuloj supet me shall* dhe *mbulesa e tryezës / me fytyrë të mbuluar*.
9. Tek emrat prejfoljorë, thëniet shërbejnë për të dalluar veprimin, gjendjen, rezultatin, p.sh. : gjetje te *gjetja e qymyrgurit* është veprim; ndërsa te *gjetje të reja arkeologjike* (d.m.th.sendet që zbulohen nga gërmimet), shënon rezultat; te *gjelbërimi i rrugëve* shënohet veprim; therje te *bagëti për therje* është veprim; te *kam therje në shpatullështë* rezultat.
10. Motivojnë vlerat stilistike të fjalëve a kuptimeve të tyre, p.sh. : *njom pambukun* dhe *e njomi me pështymë*; *e hëngri bukën* dhe *e hëngri të shkretën vajzë*.
11. Tregojnë nivelin stilistik të përdorimit, pasi fjalorët e kanë për detyrë të japin informacion stilistik). Gjithashtu ato veçojnë homonimet .P.sh.: erë (I) e butë është juga; erë (II) e mirë është ajo që ndihet me hundë.

Shembujt në një fjalor shpjegues shërbejnë për të plotësuar shpjegimin e kuptimit me nuanca të holla semantike, emocionuese, shprehëse, stilistike të përdorimit etj., por më shumë se thëniet, ato japin edhe bukurinë e shprehjeve me këtë fjalë, jetën e saj të gjallë në ligjërimi të ndryshme.

Studjuesi H.Shehu, që është marrë drejtpërdrejt me sintagmatikën në një fjalor shpjegues, sqaron konceptin teorik të lidhjeve leksiko-sintagmatike të fjalës me fjalë të tjera të gjuhës. Ai shprehet se “gramatikisht, mundësia për të krijuar bashkëlidhje kushtëzohet nga valenca e pjesëve të ligjëratës. Përkatësia në këtë a atë pjesë të ligjëratës kushtëzon mundësinë, gjerësinë dhe strukturën e bashkëlidhjeve të fjalëve: p.sh., siç dihet, folja bashkëlidhet thujse pa kufizim me ndajfoljet; emri me emër e mbiemër etj.<sup>80</sup> Valenca kushtëzohet edhe nga veçoritë kuptimore që ka një pjesë ligjërata. Emri e folja, për shembull, kanë frymorësi. Sipas kësaj rregullsie ndërtohen skema bashkëlidhjesh metaforike:

- Në vend të një emri frymor të një grupi tematik, zë vend një emër frymor i një grupi tjetër tematik; *skithet qeni - skithet njeriu*.
- Në vend të një emri jofrymor të një grupi tematik, zë vend një emër jofrymor i një grupi tjetër tematik: *pagur i plumbtë - qiell i plumbtë*.

---

<sup>80</sup> Shehu, H. Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes, në “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë” Tiranë, 2005, f.165).

- Në vend të një emri frymor të një grupi tematik, zë vend një emër jofrymor: e hëngri qeni - e hëngri meraku.
- Në vend të një emri jofrymor të një grupi tematik, zë vend një emër frymor: degë e thatë - burrë i thatë.

Në leksikografinë shqipe thëniet kanë krijuar traditë brenda kornizës së zgjedhur teorike dhe praktike, kohës, mundësive etj. Këtë traditë e gjejmë në gjithë fjalorët shpjgues të gjuhës shqipe, me fjalë e shprehje të rralla popullore. Thëniet si mjete ilustruese në fjalorët shpjgues veç vlerave denotative, konotative kanë edhe vlera të mëdha etnolinguistike. Nëpërmjet tyre fjalorët na lidhin me një etnografi të caktuar. Është kjo një vlerë tjetër e madhe, sepse pasurojnë kulturën kombëtare. Përdorimin e thënieve të ndryshme mund ta shohim edhe sipas klasave leksiko-gramatikore të fjalëve, si: thënie me shembuj për emra, për mbiemra, për folje, për ndajfolje, për numërorë e për pasthirrma.

## 5.7 VEÇORITË E PËRDORIMIT TË SHEMBUJVE NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJSH

Njësitë leksikografike dhe kuptimet e tyre, në përgjithësi, ilustrohen me shembuj. Shembulli bën pjesë në programin e mikrostrukturës dhe plotëson dy kushte:

- Është një fjali që përmban njësinë leksikografike.
- dallohet nga informacionet e tjera në sajë të tipografisë (mënyrës se si shkruhet).

Shembujt shërbejnë për të plotësuar shpjegimin e kuptimit me nuanca të holla semantike, emocionuese, shprehëse, stilistike, të përdorimit etj., por më shumë se thënie ato japin edhe bukurinë e shprehjeve në këtë fjalë, jetën e saj të gjallë në ligjërimet e ndryshme. Shembujt që përdoren për ilustrim në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe janë nxjerrë nga të gjitha gjinitë e gjuhës së shkruar e të folur, nga letërsia artistike, shkencore, mësimore, publicistika, nga folklori, nga të folurat popullore etj. Shembujt që jepen në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe jepen pa nënshkrime. Këtu bën përjashtim vetëm “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, ku në ndonjë rast ka edhe nënshkrime. P.sh. *Fe~ja: Feja opium i popullit*. Marks. (FGJSH, 1954, f.115). Përmasat dhe tipat e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe e bëjnë të pamundur dhënien e shembujve të nënshkruar (citateve) dhe atyre të panënshkruar së bashku. Pasqyrimi i shembujve të nënshkruar mund të bëhet ose duke rritur volumin e fjalorit, ose duke zëvendësuar një pjesë të shembujve të panënshkruar me citate.

Kjo pjesë e programit të mikrostrukturës nuk zbatohet në mënyrë shteruese për të gjitha njësitë leksikografike. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me informacion zero, pra të nënkuptueshëm, as me mungesë informacioni, por ndoshta në harresë a moszbatim të programit të shembujve. Kjo mungesë dëmton cilësinë e fjalorit, pasi fjalorët shpjegues nuk janë vetëm inventar i një pjese të leksikut të gjuhës shqipe, por aty lexuesi duhet të gjejë, përveç listës së fjalëve, edhe mënyrat e përdorimit të tyre. kështu p.sh në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 fjalë të tilla si: *dafinore, dafnjohem, dajrexhi, dak* etj. si dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, fjalë të tilla, si: *gjamatore, gjanesë, gjarpërzi, gjazë, gjegjës*, (f.346-348), nuk janë shoqëruar me shembujku të jepej përdorimi i tyre, por kanë vetëm shpjegimin.

Ashtu sikurse ka artikuj pa shembuj ka edhe artikuj që kanë shembuj të ndryshëm në numër, me 2,3,4 e në ndonjë rast edhe më shumë shembuj. Këtu nuk bëhet fjalë për njësi leksikore që kanë numër kuptimesh të ndryshme, por për shembujt e përdorur në një nga kuptimet e fjalës, pra me ndryshimin e shembujve nga njëri kuptim në tjetrin brenda një fjale. Është mirë që fjalorët shpjegues të vendosin një ekuilibër në trajtimin e këtij informacioni. Nuk duhet të ketë artikuj pa shembuj dhe fjalët për çdo kuptim të tyre të kenë numër të barabartë shembujsh.

Ilustrimet në fjalorët shpjegues janë gjuhësore dhe janë thënie (togje fjalësh) e shembuj (fjali). Thëniet janë togje të shkurtra fjalësh, që vihen pas shpjegimit të një kuptimi, për ta plotësuar atë me elemente a nuanca më të imta të atij kuptimi, të cilat nuk mund të jepën të gjitha në shpjegim. por ato kanë edhe vlera të tjera plotësuese në nuancat shprehëse, emocionale e stilistike, në llojet e lidhjeve sintaksore të fjalës që shpjegohet. Thëniet tregojnë që kjo fjalë me këtë kuptim është reale në gjuhë dhe ka këtë fushë dhe këto veçori përdorimi. P.sh. *dru~ja f. sh.~të*. 1. trung ose degë druri, pjesë nga druri, që përdoret për t'u djegur, për ndërtim etj.; *hu, dajak, kopaçe*, (edhe fig.)dru i thatë (i njomë), dru të prera ( të çara, të thata, të shkurtra); dru dushku (shkoze, ahu), një krah me dru, *hëngri dru*, e rrahu keq dikush; *e shtroi ne dru-* e rrahu shumë.

Me këtë funksion vihen në fjalorët shpjegues edhe proverbat e fjalët e urta, të cilat janë fjalë të zgjedhura e të ndërtuara mirë, në përputhje me natyrën e shqipes, por edhe nga përmbajtja e nga “estetika” e shprehjes, nëpërmjet të cilave lexuesi fiton vlera të reja për fjalën dhe ndien bukurinë dhe forcën e gjuhës.

Me vlerë shënuese e ilustruesnjëherazi në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe kemi edhe frazeologji gjuhësore. Njësitë frazeologjike dhe fjalët e urta, fjalorët shpjegues i kanë grupuar në fund të artikullit të prira nga një yll (\*). Fjalët e urta janë dhënë edhe jashtë rubrikës kushtuar frazeologjisë, por pa shpjegime. Shpjegimi i fjalës së urtë ose i njësisë frazeologjike jepet vetëm te njëra prej fjalëve përbërëse të saj, kurse te fjalët e tjera fjalori na adreson tek artikulli ku ndodhet shpjegimi. Kjo për faktin se njësia frazeologjike jepet vetëm një herë te gjymtyra ku shpjegohet. Në fjalorët shpjegues nuk ka njësi frazeologjike të kufizuara krahinore, apo variante fonetike e morfologjike, pasi fjalori shpjegues nuk ka për detyrë të japë frazeologjinë si sistem.

Por gjatë shqyrtimit të materialit në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe ne kemi ndeshur edhe një mungesë simetrie në trajtimin e frazeologjisë. Ka shumë fjalë të urta si p.sh. : *gur~i, sh. ~ë(t)....me një gur s'bëhet mur; gur, gur bëhet mur (kalaja)* (2006,f.337), që nuk janë shoqëruar as me shpjegime, as me adreim në një artikull tjetër..

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, fjalët e urta përfshihen te kuptimet e fjalëve me të cilat lidhen, jo në zërin leksikografik të frazeologjisë, pasi fjalët ku vihen këto njësi, në vetë strukturat e fjalëve të urtë po ato kuptime dhe figurshmëria i takon gjithë strukturës së tyre.

Ndërsa në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, shprehjet frazeologjike janë shpërndarë brenda paragrafit duke u vënë pas kuptimeve me të cilat lidhen. Por ka raste kur ato vijnë në fund, zakonisht pas një vize vertikale (/) dhe kjo ndodh kur kuptimi i përgjithshëm i tyre s'lidhet drejtpërdrejt me kuptimet e fjalës që shpjegohet.

Për shtresimin e informacionit lidhur me fushat e përdorimit të fjalëve të ndryshme, si dhe në nivelet gjuhësore të cilat u përkasin këto fjalë, në të gjithë fjalorët shpjegues këto informacione mund t'i ndajmë në dy plane: plani diakronik dhe plani sinkronik.

Në planin sinkronik ndahen më tej : 1. Në hapësirë. 2. Në shoqëri. 3. Në profesion. Për të gjitha këto informacione, apo edhe ato që do të japim më poshtë, për shënimet që u vendosen fjalëve, të para në planin diakronik dhe sinkronik, kemi dhënë shembuj të shumtë kur kemi pasqyruar në mënyrë shteruese fjalësin në shkronjat A, B, C, Ç, DH, H, F, K, LL, O, si pjesë e makrostrukturës, për të trefjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, 1954, 1980 dhe 2006. Ndaj këtu nuk do të japim shembuj gjatë trajtimit të këtij informacioni, si pjesë të mikrostrukturës.

Në planin diakronik fjalëve që përdoren sot, u kundërvihen fjalë që mbajnë shënimin *i vjetër* dhe *histori*. Shënimi *i vjetër* u është vënë fjalëve që nuk përdoren në mënyrë spontane, sepse janë vjetruar, kurse shënimi *histori* u vihet fjalëve që emërtojnë realitete që i përkasin historisë.

Në planin sinkronik, pranë fjalëve me kuptime hapësinore vihen shënimet *krahin*. (=krahinorizëm), fjalë që nuk i kanë kapërcyer kufijtë e një të folmeje, ndërsa shënimet arb. (=arbëresh) vihet vetëm atëherë kur fjala përdoret vetëm në të folmet e arbëreshëve dhe kur ky burim dihet me siguri (droqe, f. vet.sh. arb. makarona shtëpie të prera në copa të shkurtea e të trasha. Në këtë mënyrë të gjitha zonat që flasin shqip janë të përfaqësuara në fjalor.

Folësit në shoqëri japin vlerësime sociolinguistike për njësitë leksikore. Ky dallim bëhet në raport me gjuhën letrare që nuk mban asnjë lloj treguesi social a gjuhësor. Kështu për këto fjalë në fjalorët shpjegues përdoren disa shënime: *bised*. (=ligjërim bisedor), *kr. pop* (=krijimtari gojore popullore), *lart* (=stil i lartë), *libr*. (=ligjërim libror), *zyrt*. (=njësi leksikore a fjalë zyrtare).

Fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe nuk mbajnë të njëjtin qëndrim ndaj termave të ndryshëm të një terminologjie. Ka terma që e kanë humbur statusin e termit dhe janë kthyer në fjalë të përdorimit të përgjithshëm, sepse njihen nga publiku i gjerë në sajë të mjeteve të shumta të informacionit, si media e shkruar e elektronike. Këto fjalë, kur kalojnë në fondin e fjalëve të përgjithshme, nuk janë në fjalor me shënim të veçantë. Kjo është një nga arsyet që në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, kemi më pak terma se në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1980.

Termet që vazhdojnë të jenë të tillë ndahen sipas fushave të përdorimit. Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, (të pasqyruara dhe të elementët jashtë nomenklaturës) përdoret ky numër termash: në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, 25 terma, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, 70 terma dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe”

2006, 70 terma. Këtu nuk është fjala për numrin e fjalëve që kanë terma, por për llojin e termave që shënojnë fjalët në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Përcaktimi i fushës është i lehtë kur termi shfaqet vetëm brenda një terminologjie shkencore ose teknike. Në rastet kur termi del në më shumë se një fushë, atëherë është përdorur shënimi *spec.* (=special) (*dinamo f. tek.; dyzanor mb. gjuhë; dozim m. spec.*).

Të gjitha këto informacione që trajtuam lidhen me përmbajtjen e njësive leksikografike, kurse me paraqitjen e tyre në fjalorët shpjegues merret tipografia, e cila ndihmon në organizimin sa më të mirë të artikujve të fjalorit, në dallimin e informacioneve të ndryshme që jepen, në kursimin e vendit duke bërë të mundur që të mos përsëriten disa informacione që bëhen të qarta nëpërmjet tipografisë, në konsultimin dhe gjetjen e shpejtë të njësive leksikografike a të një informacioni brenda mikrostrukturës dhe së fundi në atë që specialistët e quajnë “komoditeti optik i lexuesit”<sup>81</sup>. Në konkluzion të atyre që thamë, duhet të pohojmë se fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe përdorin katët tipe të ndryshme karakteresh për llojet kryesore të informacioneve:

- për njësinë leksikografike.
- për shpjegimin dhe sinonimet.
- për kategorinë gramatikore, shembujt dhe shtresimin.
- për njësinë frazeologjike dhe antonimet.

Për të konkretizuar këto tipa karakteresh po japim një shembull:

*Dallg/ë,~a, f. sh.~ë,~ët.* (1980, f.289). Valë e madhe në det, në liqen etj., që lëviz me vrull. Dallgë të fuqishme. Dallgët e detit. 2. fig. Diçka që të kujton valët e detit ose që lëviz si ato. *Dallgët e grurit.* 3. krahin. Shi me erë të fortë: shtrëngatë, furtunë. *Mbrëmë bëri dallgë e madhe. I theu dallga pemët. Merr dallgë,* shih te Marr. *Është me dallgë,* dikush është i zymtë e tërë inat, i ka hipur inati. *E paskan kapur dallgët,* dikush qenka zemëruar shumë, qenka tërë inat; po shfryn e turfullon nga inati.

Nga zbatimi i kritereve përzgjedhëse të njësive leksikografike fjalorët marrin dhe fizionominë e tyre, si p.sh. dy fjalorët e fundit që po analizojmë (1980 dhe 2006) janë fjalorë të tipit të mesëm (respektivisht me 41000 dhe 48000 fjalë) që kanë pasqyruar leksikon aktiv dhe një pjesë të leksikut pasiv të gjuhës shqipe. Në këta fjalorë, si dhe te të tjerët, njësitë leksikore janë të renditura sipas alfabetit. Në të dy këta fjalorë (1980 dhe 2006), por edhe në fjalorët shpjegues të 1954-ës dhe 2002-it, mungon informacioni i zgjeruar gramatikor, siç e ka “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, i cili jep informacion gramatikor (lakimet dhe zgjedhimet) në fund të makrostrukturës. Ndaj do të ishte mirë që

<sup>81</sup> Rey, A. Dictionnaire alphabetique et analogique de la langue française, Le Robert, 1985, f.28.



të gjithë fjalorët shpjegues të kishin informacion të zgjeruar gramatikor, në pamundësi brenda mikrostrukturës të vendosëj në fillim ose në fund të makrostrukturës, si te Fjalori i vitit 1984. Ajo që kemi pohuar edhe më sipër, ekuilibri në përdorimin e shembujve, është i domosdoshëm me qëllim që asnjë njësi leksikore apo semantike të mos mbetet pa u konkretizuar në shembuj.

Në aspektin e mënyrës së pasqyrimin të njësive leksikore e semantike, nga të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, dallon “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, i cili i përdor artikujt të shoqëruar me çerdhe fjalësh, të cilat krijojnë një rrjet të dendur marrëdhëniesh kuptimore midis njësive leksikografike. Por “Fjalori i gjuhës së sotmë shqipe” 1980, dallon në trajtimin sistematik të shpjegimit të njësive leksikografike, ndaj është më i përdorshëm nga lexuesi në aspektin e gjetjes së një kuptimi të fjalës. Po kështu, gjithë fjalorët shpjegues, sinonimet e antonimet i kanë të shpërndara gjatë artikullit dhe kjo i lidh ato më mirë me kuptimet e fjalëve, ndërsa njësitë frazeologjike janë grupuar në fund të mikrostrukturës.

## 5.8 FJALËT QË DUHET TË PASQYROHEN NË MAKROSTRUKTURËN E FJALORËVE SHPJEGUES TË GJSH

Fjalorët shpjegues të çdo gjuhe në përgjithësi e të gjuhës shqipe në veçanti, janë pasqyrë e pasurisë leksikore të kohës në të cilën gjejmë dritën e botimit, por asnjëherë nuk mund të pretendohet se ata e pasqyrojnë në mënyrë shteruese visarin leksikor, ndaj nuk mund të konsiderohen si të përfunduar.

Fjalorët shpjegues në mënyrë të vetvetishme ndjekin në çdo hap zhvillimin ekonomiko-shoqëror, duke zgjeruar pa reshtur fjalësin e tyre me synimin për t'iu përgjigjur zhvillimit shoqëror e gjuhësor të një kombi. Në këtë aspekt ata janë veprat e para shkencore që i ndiejnë dhe pasqyrojnë lëvizjet e pandërprera në leksik. Duke e parë në këtë këndvështrim, për “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, Q. Murati shpreh: “Për kohën tonë mund të thuhet se “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” ka këmishë “të ngushtë” : shumë fjalë të bukura që ka gjuha popullore, sidomos dialekti i gegërishtes, nuk figurojnë aty; shumë fjalë të reja (neologjizma) që kanë krijuar shkrimtarët dhe publicistika jonë, nuk përfshihen te ky fjalor; e po kështu edhe shumë terma të rinj të teknologjisë moderne (teknologjia kompjuterike, juridike, administrative, ekonomike) janë mungues në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980”.<sup>82</sup> Një gjë e tillë vihet re nga kushdo që i lind nevoja për të gjetur shpjegimin e shumë fjalëve të panjohura, që ndeshen shpesh në ligjërimin e përditshëm, por ndien mungesën e tyre gjatë kërkimit në fjalor.

Fjalori shpjegues që, në aspektin numerik, ka pasqyruar një numër më të madh fjalësh, në raport me të gjithë fjalorët e tjerë shpjegues të gjuhës shqipe, që ka pasqyruar në një farë mase dhe leksikon e ri të periudhës së ndryshimeve demokratike, është “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, me rreth 48000 fjalë. Edhe pas botimi i këtij fjalori, shihet se fjalorit shpjegues të gjuhës shqipe i mungojnë shumë fjalë të cilat duhet të ishin pjesë e makrostrukturës të këtyre fjalorëve.

Megjithatë fjalorët shpjegues nuk duhen gjykuar për mungesën e leksikut në ta, por për atë pasuri të lëndës leksikore semantike që kanë pasqyruar dhe mënyra se si e kanë dhënë këtë lëndë. Kjo e metë e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe justifikohet edhe nga fakti vëllimor, pasi një fjalor shpjegues i tipit të mesëm nuk mund të pasqyrojë të gjitha fjalët e gjuhës shqipe, të cilat janë të denja për të zënë vend në një fjalor të tipit të madh. Pasuria leksikore e gjuhës shqipe është mjaft e madhe, qoftë me fjalë të gjuhës popullore, qoftë të fjalësit letrar e libror, të cilat shtrojnë para leksikografëve nevojën urgjente që të zënë vendin e tyre në një fjalor të madh shpjegues të gjuhës shqipe.

---

<sup>82</sup> Murati, Q. Fjalori i gjuhës shqipe, fondi leksikor dhe probleme standardologjike, në “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.56.

Siç e cilësuam më lart, megjithëse “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, ka një numër më të madh fjalësh se çdo fjalor tjetër shpjegues i gjuhës shqipe, përsëri vihen re mungesa të ndieshme, veçanërisht në fjalësin onomastik. Në një vështrim jo të detajuar, vërejmë se këtij fjalori, ashtu si dhe fjalorëve të tjerë shpjegues, veç “Fjalorit të shqipes së sotme” 1984, i mungojnë këto kategori fjalësh”.

- Emrat që shënojnë banorin në trevat shqiptare të Kosovës, Maqedonisë e Malit të zi, si: *gucjan* “banor i Gucisë”; *llapjan* “banor i Llapit”; *drenicas*, *drenicak* “banor i Drenicës”; *gostivaras* “banor i Gostivarit”; *gjilanas* “banor i Gjilanit”; *krajan* “banor i Krajës”; *tetovar* “banor i Tetovës”; *tivaras* “banor i Tivarit”; *ulqinak* “banor i Ulqinit”; *hotjan* “banor i Hotit”, *preshevas* “banor i Preshevës”; *strugan* “banor i Strugës”<sup>83</sup>
- Disa emra të banorit të vendeve ose krahinave brenda kufijve të Shqipërisë, si: *Bajzjan* “banor i Bajzës”; *thethjan* “banor i Thethit”; *shëngjinas* “banor i Shëngjinit”; *shëngjergjas* “banor i Shëngjergjit”; *nartjot* “banor i Nartës”; *lapardhjat* “banor i Lapardhasë, Berat”; *milotas* “banor i Milotit”; *poshnjar* “banor i Poshnjes, Berat”, *kuçovar* “banor i Kuçovës”, megjithëse në fjalorin e 2006-ës është fjala *kuçovas*, kur në fakt në komunikim përdoret fjala *kuçovar* për banorin e Kuçovës.
- Disa ndajfolje të formuara nga emri i banorit të qytetit a krahinës + prapashtesën **-çe**. Në fjalorët shpjegues gjejnë pasqyrim disa fjalë si: *fshatçe*, *malokçe*, *malësorçe etj.*, *por nuk gjenden fjalë të tilla si tirançe, vlonjaçe, gjirokastricë, shkodrançe, devolliçe, matjançe, dibrançe etj.* Këto fjalë emërtojnë mënyra të kënduari a të veshuri të banorëve të këtyre vendeve.
- Emërtimet e lojrave popullore e të pjesëve të tyre, si: *bab:a*, emërtimi i një shkopi që vihet si piketë në lojën cingël; *ferrapariz*- lojë e djemve dhe vajzave në mjediset baritore; *syshilza e kika*- variante të kukumsheftas, ose disa fjalë që lidhen me veshjen e nuses e përgatitjen e pajës, si: *veshtare* - “gruaja që vesh nusen”, etj.
- Disa shprehje, urime, mallkime, të cilat duhet të futen si lëndë ilustruese a si thënie brenda një zëri leksikografik, si: *të lumtë krahu, julumshin krahët* - përshëndetje që kalimtari i jep atijqë është duke punuar, bashkë me përshëndetjet kthyesë përkatëse: *i lumtur qofsh*, etj. Gjithashtu është mirë të kenë vendin e tyre në fjalorët shpjegues të shqipes edhe urime të tjera popullore të cilat tregojnë vlera të larta shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, si p.sh. : *mos e prehtë syri ikeq*- që thuhet për fëmijët e vegjël ose për bagëtitë etj. nga kalimtarët, si dhe përshëndetja kthyesë: *të lumshin sytë!*

<sup>83</sup> Shkurtaç, Gj. Elemente etnokulturore në fjalor të shqipes, në “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.129).

Përveç këtyre kategorive të leksikut të gjuhës sonë, fjalorëve shpjegues u mungojnë edhe fjalë të leksikut të përgjithshëm, që përdoren dendur në ligjërim, por të pa pasqyruara në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues. Për këto fjalë kemi folur në kapitullin përkatës kur kemi krahasuar fjalësin e shkronjave që kemi marrë në shqyrtim, ku kemi sjellë shumë shembuj të fjalëve që janë në një fjalor, por jo në tjetrin.

“Gjuha shqipe në fazën e sotme e ka të nevojshme hartimin e një fjalori thesar”<sup>84</sup>, sepse ata shihen sot si “një pasuri me të vërtetë kombëtare, prandaj hartimi i fjalorëve të tillë duhet të jetë në përparësitë tona gjuhësore”.<sup>85</sup> Këtë e pranon edhe Jani Thomai kur thotë se: “detyrë e gjuhësisë në fazën e sotme është hartimi i fjalorit të madh, disa vëllimësh, të gjuhës shqipe, i cili përbën një kërkesë të kahershme dhe një detyrë të një rëndësie të veçantë. Puna për të nisi në fund të viteve 70-të të shekullit të kaluar, por u ndërpre për shkak të ndërmarrjes së veprave të tjera leksikografike”.<sup>86</sup>

Fjalorët e mëdhenj janë shprehësit më të plotë të pasurisë, të larmisë, të forcës e të bukurisë së gjuhës, të mundësive që ajo jep për të gjitha fushat e veprimtarisë së gjallë gjuhësore. Hartimi i fjalorit të madh nuk është më një ëndërr, “po një vepër e domosdoshme dhe e mundshme për t’u realizuar. Hartimin e një fjalori të tillë e bëjnë të mundshëm shumë faktorë, si: mbledhja e gjerë e lëndës leksiko-frazeologjike e semantike e shqipes së shkruar e të folur, studimi i saj në shumë aspekte e përpunimi leksikografik i pjesës thelbësore në fjalorë të tipeve të ndryshëm, përfitimi i përvojës në hartimin e fjalorëve shpjegues, përdorimi i teknikave e i metodave bashkëkohore në leksikografi etj.”<sup>87</sup>

Sot gjuhësia shqiptare ka në përdorim pesë fjalorë shpjegues të gjuhës shqipe, shumë fjalorë dalektorë e krahinorë, fjalorë terminologjike, artikuj e monografi dialektore të shoqëruara me nga një fjalorth etj. Këto pasuri leksikore si dhe ndjekja hap pas hapi e leksikut të publicistikës e të letërsisë artistike kanë mundësuar që gjuhësia shqiptare të ndërmarë një hap të tillë, duke hartuar një fjalor të madh që të përfshijë gjithë leksikun e gjuhës, si fjalët e gjuhës standarde ashtu edhe ato të dialekteve, në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore.

---

<sup>84</sup> Rrokaj, Sh. Hartimi i fjalorëve dhe gramatikave thesarë, një mundësi më shumë për pasurimin e gjuhës standarde shqipe, në Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003, f.274.

<sup>85</sup> Islamaj, Sh. Për një leksikografi bashkëkohore, në “Leksikografia shqipe-trashëgimi e perspektivë”, Tiranë, 2005, f.31.

<sup>86</sup> Thomai, J. Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë, Tiranë, 2005, f.22.

<sup>87</sup> Thomai, J. Leksikografia shqipe drejt objektivash madhorë: Fjalori i madh i gjuhës shqipe, në “Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë”, Ohër, 2007, f.47-48.

Duke folur për domosdoshmërinë e hartimit të një fjalori të madh, Shezai Rrokaj i mëshon faktit se "vetë larmia demografike e politike ku gjenden shqiptarët bën të domosdoshme ruajtjen dhe pasurimin e standardit nëpërmjet përfshirjes gjithmonë e më të madhe të njësive dhe të strukturave të mbarë gjuhës sonë dhe të përdorimit të varianteve, të cilat i japin hijeshi mozaikut gjuhësor dhe tregojnë pasurinë dhe vitalitetin e saj".<sup>88</sup> Ilirologu arbëresh, Aleksandër Stipçeviç, vlerëson me krenari pasurinë e madhe leksikore të gjuhës sonë dhe sipas tij "shqipja duhet të kishte një fjalor jo me një e dy vëllime, por me njëzet e tetë vëllime, si shumica e gjuhëve të tjera".<sup>89</sup>

Për të konkretizuar idenë e fjalëve të cilat duhet të zënë vend në fjalorin e madh të gjuhës shqipe, po sjellim disa shembuj të marrë nga disa fjalorë krahinore: *okllaç, olloveckë, ordis, ogriz, orop, ortali, orizçe, paemërsi, (i, e) pacing, pacorak, pacavel, pafajni, pajasi, pajadisje, (i, e) pagand, (i, e) pagrosh, (i, e) pagjëshosh, paiada, piaman, pajetar, pajëthërrç, pajithët, pajkë, pajmak, pajsha, pakërçik, (i, e) pakiem, pakokësi, (i, e) pkopili, pakpërparshëm, pakrrëz, (i, e) pakrruar, (i, e) pakuar, pakujt, pakujtim, pakujtimësi, pakurkushoq, pakvlerësh, palabardhas, palakordhë, palagaç, palaqys, palardhës, palarec, pallabyk, pallaguz, pallangjak, pallojkë, pandlan, pajenc, papalok, papalan, papçuk, paran, parenicë, paresh, parnatë, projtim, provanik, (i, e) prufulitur, prumë, prushërues, prregull, psirmit, (i, e) pucanitur, pucat, pucatem, puçrriz, puçrrim, pufilloj, pufllues, puftim, pulamshefas etj.*

Fjalët dialektore e krahinore janë të shumta, por ne sollëm fjalë vetëm nga fjalësi i një shkronje sa për të treguar se leksiku i gjuhës shqipe është shumë i pasur, ndaj ai duhet të zërë vend në një fjalor të madh qoftë edhe për t'iu regjistruar si një pasuri leksikore me qëllim që atë të mos e mbulojë pluhuri i harresës.

---

<sup>88</sup> Rrokaj, Sh. Hartimi i fjalorëve dhe gramatikave thesarë, një mundësi më shumë për pasurimin e gjuhës standarde shqipe, në Konferenca shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë, 2003, f.274.

<sup>89</sup> Murati, Q. Fjalor i gjuhës shqipe, fondi leksikor dhe probleme standardologjike, në "Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005, f.57.

## KREU VI.

### ONOMASTIKA NJË SHKENCË E RE GJUHËSORE

#### 6.1 FLLIMET E STUDIMEVE ONOMASTIKE PËR GJUHËN SHQIPE

Lashtësinë e një populli e dokumentojnë jo vetëm gërmimet arkeologjike, shkrimet e vjetra të lëna nga historianë të lashtësisë, por edhe toponimet, ku mund të gjenden elementë të ruajtur që i kanë rezistuar shekujve e që e gjejnë shpjegimin në gjuhën e sotme. Është në natyrën e popujve që vendeve, fushave, kodrave, maleve, lumenjve, grykave, rrugëve, vendbanimeve, t'u vënë emra në gjuhën e tyre me synimin që të orientohen gjatë komunikimit midis tyre. Edhe pse në shqotat e historisë popujt janë pushtuar, janë ndikuar nga gjuha e pushtuesit, përsëri, si një libër i pashkruar, por i lexuar dhe në ditët tona, mbetet fusha e toponimeve. Edhe pse shumë prej tyre kanë ardhur jo të ruajtura në gjuhën e emërimit të parë, por si përkthime në gjuhën e pushtuesit, sërish ato, me shpjegimet që u kanë dhënë gjuhëtarët, mbartin me vete të vërteta që duhen vlerësuar.

Mbledhja, evidentimi e pasqyrimi i toponimeve kryesore vendase e të huaja në fjalorë të ndryshëm, kanë vlerë për vërtetimin e autoktonisë së shqiptarëve, por dhe për rifreskimin e kujtesës qytetare për një numër të madh toponimesh, që ato të njihen nga brezat që vijnë, që jo vetëm t'i përdorin, por edhe të dinë vendndodhjet dhe domethënien e tyre. Ndaj jo më kot toponimet janë cilësuar “përmendore të kujtesës njerëzore”<sup>90</sup>. Ato kanë vlerë të rëndësishme për zhvillimin e kulturës së një populli në rrjedhën e ngjarjeve historike të tij. Ndaj toponimet nuk duhen lënë në mëshirën e fatit, por u duhet kushtuar kujdes i veçantë mbledhjes, ruajtjes dhe zbërthimit etimologjik të tyre.

Toponimet në të folurin e përditshëm dhe në hapësirën që i rrethon njerëzit janë shenja të krijuara dhe që përdoren prej tyre. Ato, pa marrë parasysh se cilës gjuhe i takojnë, paraqesin emërtime konkrete në fushën e onomastikës. Pjesë përbërëse e onomastikës janë dhe emrat e njerëzve, apo emrat vetjakë (antroponimet) dhe emrat familjarë përkatës të tyre (patronimet). Emri është një element me rëndësi të posaçme në jetën e çdo njeriu. Ai paraqitet në forma dhe kuptime të ndërlukuara, me domethënie shumë më të gjerë seç ka kuptimin dhe rëndësinë për individin që e mban emrin përkatës, madje ai është një element që në njëfarë mase, tregon edhe zhvillimin shoqëror e kulturor të një populli, të një ambienti gjeografik. Prandaj mund të themi se emrat, deri diku, luajnë rolin e dokumentit historik në bazë të të cilave mund të konstatohen ecuritë shoqërore në periudha të caktuara.

---

<sup>90</sup> Halimi, M. Mbi disa toponime të tipit perifrastik, OK, Prishtinë, 1979, f.243.

Emri është faktor që ndryshon sipas rrethanave shoqërore e kulturore të një vendi. Ai tregon shkallën e zhvillimit të vetëdijes sociale dhe kombëtare, të gjendjes politike, të bestytive të ndryshme që shoqërojnë zhvillimin e shoqërisë. Të gjitha këto ndikime kanë lënë mbresa të forta gjatë periudhave të ndryshme, madje disa janë prezente edhe sot në botën e qytetëruar.

Në periudha të ndryshme historike, sfera antroponimike e pushtuesve u bë edhe e shqiptarëve, si rezultat i përqafimit prej tyre të religjionit të pushtuesit. Prej kësaj rrjedh edhe shtresëzimi i emrave të njerëzve, apo edhe toponimeve, të kushtëzuara nga ndikimet e huaja që sunduan me shekuj këtu. Kjo është arsyeja që në kohën e sundimit romak, bizantin, e më vonë sllav e turk, emrat iliro-shqiptarë u pakësuan dukshëm.

Në studimet albanologjike, të dhënat e onomastikës dhe hulumtimet e shqyrtimet rreth emrave të viseve (toponimet) dhe emrave të njerëzve (antroponimet) bashkë me emrat familjarë (patronimet) kanë përbërë një fushë të gjerë studimi për gjuhëtarët. Në punimin tonë nuk do të merremi me gjithë studimet onomastike, por me pasqyrimin e elementeve onomastike në kohë të ndryshme, që nga studimi i elementeve të para. Studimet onomastike janë një dëshmi e qartë e kokëfortë e pranisë së shqipes e të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. Në një numër të madh studimesh onomastike, toponimia shqiptare vijon të jetë një mbështetje për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e veta, si dhe për lidhjen e ngushtë të onomastikës me historinë e gjuhës shqipe, megjithëse ajo si shkencë është nga disiplinat më të reja të gjuhësisë. Kjo duhet kërkuar një toponim (emër vendi), antroponim (emër njeriu) bashkë me emrat familjarë (patronimet).

Ky material i larmishëm para saj ka qenë objekt studimi i shkencave të ndryshme si etnografisë, historisë, gjeografisë apo sociologjisë, dhe vetëm para më shumë se një shekulli onomastika është bërë temë studimi më vete në gjuhësinë evropiane në përgjithësi dhe atë shqiptare në veçanti, vetëm atëhere kur u kuptua se ky material, para së gjithash, është një material gjuhësor ndaj duhej bërë objekt studimi i një shkence të re gjuhësore. kjo edhe për faktin se emrat e përveçëm, megjithëse dallojnë nga leksiku i përgjithshëm, janë fjalë që duhen studiuar nga gjuhësia dhe jo nga shkencat e mësipërme.

Onomastika, megjithëse një shkencë e re gjuhësore dhe ende pa zgjidhur mirë çështje të ndryshme teorike, nuk i ka penguar studiuesit që të merren me trajtimin e lëndës onomastike në aspekte të ndryshme, ku në plan të parë del aspekti historik. Kjo ka ndodhur për disa arsye, ndër të cilat më kryesorja ka qenë se onomastika deri para një shekulli ka qenë konsideruar si shkencë ndihmëse e historisë dhe e shkencave të tjera. Këtu ndihmon edhe fakti se “materiali onomastik të jep mundësi të depërtosh më thellë në të kaluarën sesa materiali që ofron gjuha e përgjithshme”.<sup>91</sup>

---

91 Dauzat, A. La toponymie mie française, Paris, 1946, f.10.

Megjithëse si shkencë albanologjike onomastika e ka filluar jetën e vetë relativisht vonë ose siç shprehet Rexhep Qosja “E vonuar në përpjestime botërore, ajo mund të quhet aq më e vonuar te shqiptarët”.<sup>92</sup> Të dhënat e onomastikës janë shfrytëzuar për të hedhur dritë mbi probleme me rëndësi jetike për historinë e shqipes e shqiptarëve. Ato kanë shërbyer si dokument i pakundërshtueshëm për origjinën ilire të shqipes e shqiptarëve, dhe kanë fituar vlera për gjuhën tonë, një gjuhë e lashtë, por me një dokumentim shkrimor mjaft të vonshëm.

Materialin onomastik nga studiuesit shqiptarë të parët e kanë futur në përdorim rilindasit, qoftë që të dëshmojnë origjinën pellazgjike të shqiptarëve, qoftë për qëllime poetike<sup>93</sup>. Por fillimet e studimeve të vërteta shkencore për historinë e albanologjisë dhe të onomastikës shqiptare duhen kërkuar në veprën e Johan Tunmanit, Leipzig, 1774. Me ndihmën e toponomastikës, Tunman u përpoq të ndriçojë problemin e gjenezës së popullit shqiptar dhe të shqipes dhe, lidhur ngushtë me të, edhe të autoktonisë dhe të vendbanimit të hershëm të shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor, problem me të cilin u morën më vonë shumë gjuhëtarë dhe historianë me emër si: J.G.Hahn, G.Mayer, G.Veigand, K.Jireçek etj.

Momentet kryesore nëpër të cilat ka kaluar mbledhja dhe studimi i materialit onomastik, pas J.Tunmanit, do të përmendnim, jo me ndonjë kronologji shteruese, por më shumë pikante janë:

- J.G.Hahn me listën e emrave dhe të mbiemrave shqiptarë të botuar në vitin 1854.
- Thimi Mitko, i cili i bëri problemet gjuhësore si çështje të rëndësishme të veprimtarisë së tij atdhetare. Në veprën “Alvaniki Melissa” (Bleta shqiptare), botuar më 1878 në Aleksandri, u kushton një kapitull më vete “emrave vetjakë të kështera dhe mohamedanë”. Në fjalësin e këtij “fjalorthi” onomastik përfshirë në këtë vepër në pjesën e dytë me titull “Të përshëndoshura”, Fjalori i “Bletës shqiptare dhe shënime të tjera gjuhësore” kemi këtë përbërje:

❖ **Emra të krishterë** 65, pa përfshirë variantet e ndryshme të tyre:

- Aldham= Dhame-ja, Dhamo-ja, Çame-ja.
- Aleksandër= Lleshi-i, Lekë-a, Sandër-i, Sandër-a (f).
- Athanas=Nasi, Nase-ja, Naço-ua, Nasho-ua, Thanë-a
- Anton= Ndonë-a, Toqe-ja, Noi, Noc-i, Noka, Ndokë, Doni.

---

92. R.Qosja, Fjala e hapjes së Simpoziumit “Onomastika e Kosovës” Prishtinë, 1979.

93. R.Qosja, Fjala e hapjes në OK, Prishtinë, 1979.



- Dhimitër= Dhimo-ja, Dhimash-i, Mitr-i, Mitro-a, Mitrush-i.
- Ekaterinë= Rinë-a, Kato, Katelino, Lino-a, Katrinë.
- Filip= Filo, Lipe, Thëlip-i, (ose Thilip-i),
- Gjergj= Gjergo-ja, Gjikkë-a, Gjokë-a, Jorgo, Gaqo-ua, Gegë-ja, Xhoxhi-a.
- Hristo= Risto, Lito, Kiço, Rici, Lici, Ciko, Cikë-a, Ristë.
- Joan= Jano-ja, Jan-i, Nano-ja, Gjon-i, Gjin-i, Janko, Naqo, Vani.
- Kostandina= Ndino, Ndile, Nine, Koto, Kotinë-a.
- Llazar= Llazër, Lazër-i, Laçe-ja, Llazo-ua.
- Maria= Maro, Marino-a, Mëri-a, Mrikë, Marushe, Mine, Minkë.
- Petro= Pet-i, Peco, Petrush, Peçi, Pjero, Pjetro, Pjetri.
- Sofia= Sofo, Fije, Sofkë.
- Vasil= Vaso-ja, Cile-ja, Vac-i, Vaskë-a, Silkë-a.
- Zahari= Zari, Zaro-ua, Zahar-i.

❖ **Emra mohamedanë** 24, pa përfshirë variantet e ndryshme të tyre:

- Abidin= Bido
- Adem= Demo, Demkë.
- Hysejn= Hyso, Cene-ja.
- Islam= Lame, Lamçe.
- Mehmet= Meço, Meto.
- Nuredin= Nure, Nuri (më i theksuari)
- Rustem= Rustë, Rusto.
- Salih= Salkë, Saliko.
- Xhafer= Xhafo.
- Zeqir= Zeqo.

Janë dhe një numër emrash pa variante të tyre (gjithsej 43) si: Bilo, Bodo, Çurri, Diellë, Dude, Dudi, Dhoqinë, Galo, Ganxhë, Habo, Hajdho, Hënë, Kadifkë, Koçë, Kondesë, Kondë, Korrë, Llambri, Lele, Lilo, Lono, Lule, Lulë, Malo, Nerënxë, Nicë, Noni, Paruqe, Peristerë, Qafo, Rendë, Ruçë, Simo, Sojë, Sone, Shegë, Tënkë, Tinë, Vitore, Xhinxhife, Zarë, Zogo, Zoro.

- ❖ **Mbiemra familjesh** 239 si: Aleko, Alizoti, Alia, Balo, Balla, Beka, Beshiri, Brisku, Bubuli, Buja, Capo, Cara, Ceka, Çako, Çalo, Çuko, Çuli, Dakli, Dako, Dedeja, Dema, Dumi, Durro, Gallan, Gode, Guri, Gusho, Gjikondaj, Hodo, Jare, Kalanderi, Karbunara, Kaso, Koka, Kuçi, Koroveshi, Kryezoti, Kuço, Lapa, Laro, Londo, Lulaj, Mako, Mara, Mato, Mema, Nushi, Papo, Paruca, Piperi, Pula, Pupo, Qafo, Qendro, Qypi, Ramizi, Rërësi, Sallabanda, Sara, Stamo, Shaplllo, Shetro, Shkurti, Shtylla, Telo, Toska, Themeli, Veveçka, Xavara, Yrija, Zaro, Zguri, Ziko, Zoto, Zhuro etj.

**Emra dhe llagape të arbëreshëve të Greqisë** 33 si: Belec-i, Beno-ua, Bricë-a, Bëricë, Bulë-a, Çakall-i, Çallë-a, Çam-i, Çelo-ua, Çullë-a, Dervish-i, Karaçol-i, Kocir-i, Kokëzë-a, Kollombos-zi, Koros-zi, Kricë ose Këricë-a, Lanës-i, Lasko-ua, (Iazaros), Leco-ua, Makul-i, Nikë-a, Paqë-a, Pepë-a, Sallapata, Suflë-a, Cuflë-a, Vito-ua, Xhakristo-ua, Xhavellë-a, Zurë-i. **94**

Të njëjtën gjë bën edhe Spiro Dine në veprën “Valët e detit”, botuar në Sofje, më <sup>93</sup>1908.F. Nopsca në veprën “Gjeografi dhe gjeologji e Shqipërisë së veriut” jep 2800 toponime të transkriptuara e të shpjeguara saktë dhe përbën kështu një burim të rëndësishëm për studimet toponomastike.

Në faqet e “Hyllit të dritës” në vitet 1939-1943 u botua fjalori toponomastik i Nikollë Gazullit, në 4000 onomat e të cilit gjejmë jo vetëm toponime, por edhe patronime e etnonime si edhe përpjekje të autorit për të bërë interpretime etimologjike. Ky fjalor mbetet një burim i rëndësishëm për të bërë jo vetëm studime të mirëfillta onomastike, por edhe leksikologjike, etimologjike, dialektologjike e leksikologjike.

Prof. Eqrem Çabej, në punimet e tij shkencore, materialin onomastik e vë në funksion të mbështetjes së tezës të prejardhjes ilire të shqiptarëve. Kështu në punimet “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve”, BUSHT,2, 1958 dhe “Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve ne Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve” BUSHT, 1, 1961, E.Çabej duket se sjell një kontribut të mjaftueshëm për ta konsideruar të zgjidhur çështjen e pranisë e të vijimësisë iliro-shqiptare në trojet e sotme. Ky argumentim vjen edhe si një kundërpërgjigje për V.Georgievin, për një shkrim të botuar në “Linguistika Balkanika”, II, Sofia, 1960, i cili hedh hipotezën e prejardhjes dako-mize të shqipes me komponente ilire.

Një vëmendje të veçantë i kanë kushtuar onomastikës studiuesit kosovarë, të nisur edhe nga rrethana, që në Kosovë më shumë se në anë të tjera të territoreve shqiptare lanë gjurmë popuj e gjuhë të ndryshme, dhe në kuadër të përpjekjeve për barazi onomastike atje. Kjo nisur edhe nga veçoritë tepër specifike që kanë pasur trojet shqiptare, ashtu si gjithë Gadishulli i Ballkanit.

Studiuesit e fushave të ndryshme kanë arritur në një konkluzion se vështirë të gjenden në hapësirën e globit shtresime kaq të shumta e të thella kulturore brenda një tërësie gjeografike, sikur e gjejmë në Ballkan. Është e kuptueshme pse ka shumë kohë që studimi i onomastikës, përkatësisht i toponimisë, paraqet një prej problemeve të shpeshta dhe shumë interesante në rrethet shkencore, jo vetëm linguistike. Ndaj toponimia është bërë fushë e kërkimeve të shkollave dhe drejtimeve më bashkëkohore, ajo është sinonim i

---

<sup>94</sup>Mitko, Th. Vepra, (Bleta shqiptare, pjesa e dytë), Tiranë, 1981, f. 461-476.

kërkimeve historike, gjuhësore, kulturore, deri dhe mjet i caktimit të hapësirave gjeografike të banuara nga popujt në këtë rajon në shekujt më të errët të historisë.

Studiuesit, përmes kërkimeve onomastike, kanë hulumtuar zanafillën e etnive dhe gjurmët e tjera kulturore të popujve të zhdukur gjatë “përmbytjeve” të ndryshme historike, para së gjithash të atyre popujve që u kanë munguar dokumentet e shkruara, si popullit tonë. Pikërisht përmes onomastikës, gjuhësia shqiptare ka zbuluar në detaje më të veçanta nga ç’dihej më parë, praninë e paraardhësve të popullit shqiptar në trojet etnike, nënshtrësën paraindoevropiane të ilirishtes dhe mbishtresat e ndikimeve të huaja në kulturën shqiptare; shtrirjen gjeografike të Ilirisë në hapësirën e Evropës Juglindore dhe Evropës Qendrore; vendin e formimit të etnisë së Arbrit në trojet e sotme ku jetojnë shqiptarët; prerjet kulturore, fetare e historike të brendshme e të jashtme të hapësirës etnike shqiptare etj.

Një shtysë të fuqishme studimeve në fushën e onomastikës u dha veçanërisht Simpoziumi “Onomastika e Kosovës”, i mbajtur më 25-27 shkurt 1977 në Prishtinë, organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Në këtë Simpozium materiali onomastik, toponimik e antroponimik, u trajtuan jo vetëm në këndvështrimin gjuhësor nga gjuhëtarët, por edhe nga historianë, gjeografë, etnografë, folkloristë, arkeologë e historianë të letërsisë. Aty u bë objekt i një shqyrtimi të imët veçanërisht onomastika mesjetare dhe e sotme, në sinkroni e diakroni, dhe u prekën edhe çështje të toponimisë antike.

Materiallet e këtij Simpoziumi u publikuan në një botim të posaçëm në vitin 1979. Në këtë botim nga autorët Emine Fetahu, Daut Bislimi e Skënder Gashi u dha një bibliografi e tipit recensional të punimeve onomastike të Kosovës, në bazë të konsultimit me shtypin dhe periodikun për periudhën 1945-1976, të cilat shërbyen dhe shërbejnë si një material i vlefshëm për të gjithë ata që do të punonin në këtë fushë.

Rezultatet që shënoi ky simpozium mund të përmbliidhen në sjelljen e dëshmive të reja për praninë e etnosit iliro-shqiptar në trojet e sotme që nga koha antike, por sidomos nga Mesjeta, me lëndë onomastike të vjelë ndër shkrime kishtare serbe të shek. XIII-XIV të shkruara nga serbofonë dhe në dëfterë turq.

Nga kumtesat del se shqiptarët ishin gjatë mesjetës në këto troje, faktuar dhe nga dëshmitë antroponimike e toponimike, megjithëse jo të shumta. Pjesa e antroponimisë sllave që kanë shqiptarët e atyre viseve, vështrohet si pasojë e mungesës së kishës kombëtare dhe e përqaftimit të ritit ortodoks dhe administrata serbe që i regjistronte në shkrim.

Në kumtesat që u mbajtën për trajtimin e toponimisë së sotme u theksua se ajo nuk ishte regjistruar besnikërisht në librat kadastralë si dhe në burime të tjera, se gjurmët

leksikore të turqishtes në emërtimet e vendbanimeve janë emërtime të administratës së kohës. Mikrotoponimia e Kosovës dhe e viseve të tjera të banuara me shqiptarë u vështruan edhe në pikëpamje thjesht gjuhësore, pra së brendshmi, dhe u konstatua se ajo është e pasur me tipe formimi ku mbizotëron toponimi togfjalësh, ndërsa toponimet kompozita janë të pakta dhe në pjesën më të madhe janë sajuar nëpërmjet bashkimit për shkak të frekuencës së përdorimit pranë e pranë.

Nga kumtesat që trajtuan çështje të antroponimisë së ditëve të sotme, dhe në diakrini më pak, u arrit në përfundimin se në kushtet e lëvizjeve të shpeshta, shqiptarët kanë ruajtur për patronime emërtimet e katundeve a të anëve prej nga kanë ardhur dhe se kohët e fundit po vërehet një tendencë e theksuar e vënies së emrave personalë më të qartë, më të kapshëm, më të kuptueshëm e të zbërthyeshëm nga brumi leksikor i shqipes.

Ky simpozium ishte një arritje e madhe për shkencën onomastike shqiptare, sidomos duke pasur parasysh kuadrin social-politik të mbajtjes së tij dhe gjerësinë e shtrimit të problemeve. Ai vuri detyrë për gjurmimin e lëndës onomastike ndër burime të ndryshme dhe vënien e saj në shërbim të identifikimit të saktë e lokalizimit të kështjellave që ndërtoi e rindërtoi perandori Justinian në Dardani gjatë shekullit të pestë si dhe i vendbanimeve më të vogla mesjetare për të sqaruar fizionominë etnike të popullatës së atyre trevave në të kaluarën. Kjo mbetet një detyrë para gjithë onomastikës shqiptare, në të gjitha viset ku banojnë shqiptarët.

Në onomastikën tonë janë të pakta studimet monografike në këtë fushë. Këtu do të përmendim një studim të Rexhep Doçit “Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës”, Prishtinë 1990, studiuesit shqiptar nga Maqedonia Qemal Murati “Dëshmi onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni”, Tiranë, 1993, “Fjalori onomastik i Epirit”, Tiranë, 1995 i Fatos M. Rrapajt, ku përmbledhen toponimet dhe patronimet e Çamërisë dhe të trevave të tjera të Shqipërisë Jugore. Po ashtu mund të veçojmë librin e Jusuf Shpuzës “Vëzhgime për emrat familjarë të shqiptarëve” 1998.

Vëzhgime gjuhësore për toponiminë e një treve të caktuar kanë botuar Ali Dhrima “Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit”, SF 3, 1974, dhe David Luka “Të dhëna të onomastikës të trevës së Krujës për historinë e formimit të popullit shqiptar”, SF 3, 1982. Kontribute me vlerë përbëjnë artikujt problemorë të prof. Seit Mancakut si p.sh. “Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë”, trajtesat e prof. Rexhep Ismajlit si “Disa çështje të onomastikës shqiptare të mesjetës” dhe “Mbi disa toponime në Serbi të Jugut dhe në Maqedoninë e Veriut” botuar në Gjurmime albanologjike, 1-2, 1970, “Prapashtesa ilire dhe shqipe-përkime e paralelizma” i prof. M. Domit, botuar në “Kuvendin e Parë të Studimeve Ilire, II, Tiranë, 1974, artikujt e shumtë të Kol Lukës, ku po veçojmë “Raste ndërhyrjesh administrative në toponiminë e Defterit të Shkodrës të vitit 1485” SF, 2, 1975. Po ashtu shqyrtime interesante dhe me rezultate të

admirueshme për onomastikën shqipe të trevave të Malit të Zi ka sjellë prof. Ruzhdi Ushaku, sidomos në librin e tij “Ulqini në gjurmët e shekujve”, Ulqin, 1991, dhe studimin “Një rishqyrtim i prejardhjes së hidronimit Buna” në “Filologji” nr.4, 1997.

Në studimet për toponiminë shqiptare, për të ndriçuar problemin e gjenezës së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe, janë nxjerrë të dhëna onomastike nga burime të ndryshme, duke filluar që nga autorët antikë si Skilaksi, Straboni, Plini, Ptolemeu, Stefani i Bizantit etj. Gjithashtu janë shfrytëzuar të dhëna nga vepra dokumentare, harta gjeografike, raporte, relacione etj. Me studimin e këtyre materialeve janë marrë jo vetëm gjuhëtarë, por edhe historianë, gjeografë, etnografë, arkeologë etj. Ajo që i ka bashkuar gjithë këta studiues ka qenë synimi që me anë të analizës së tyre të hedhin sadopak dritë mbi problemin e përcaktimit hapësinor të trevës ku kanë banuar shqiptarët dhe është folur shqipja. Pavarësisht se jo të gjitha mendimet e hedhura e përfundimet e nxjerra kanë qenë të drejta, vlera e materialit onomastik, sidomos e atij toponimik, mbetet e padiskutueshme veçanërisht si mbështetje për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre dhe vazhdimësinë iliro-shqiptare.

Vështrimet e derisotme toponimike i ka sunduar aspekti historik. Kjo është bërë me synimin që të identifikohet në mes të saj ajo pjesë e toponimisë ilire që ka vijuar nëpër gojën e shqiptarëve, banorë të lashtë të këtyre trojeve, edhe sipas ligjeve fonetike të shqipes deri në ditët tona e për t’u sjellë si argument i vijimësisë iliro-shqiptare. Një ndihmesë e madhe e këtyre studimeve ka qenë edhe fakti që me argumentet e fonetikës historike të shqipes u rivlerësuan disa etimologji të mëparshme, dhe u provua që ato nga format e hershme deri në të sotmen janë zhvilluar duke kaluar në mënyrë të pashkëputur në gojën e shqipfolësve.

Këto studime, nëpërmjet këtij materiali, kanë provuar në mënyrë përfundimtare vazhdimësinë iliro-shqiptare dhe se trojet e sotme ku banojnë shqiptarët nuk janë rezultat i pushtimit nga shqiptarët, por trojet e tyre etnike. Ky mendim u formulua së pari nga historian gjerman J.Thunman dhe i mbështetur mbi argument historike, ndër të cilat ai i mungesës së të dhënave dhe i gjurmëve të ndonjë migracioni të popullit shqiptar, i përforcuar nga J.G.V.Hahn me argumente gjuhësore dhe me një kuadër hapësinor më të gjerë, duke përfshirë edhe Dardaninë në trevën e lashtë të të parëve tanë, si rezultat të toponimeve antike, disa prej të cilave janë ruajtur si apelative në gjuhën e sotme shqipe (Delmatia-delme, Dardania-dardhë) dhe i mbështetur më pas nga një numër i madh shkencëtarësh, midis të cilëve përmendim H.Pedersen, F.Ribezzo, M. La Piana etj.

Sa herë që trajtohet materiali onomastik, shqyrtimi historik i tij është i pranishëm, gjë që provohet dhe nga dy aktivitetet e mëdha shkencore si Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, organizuar në Tiranë në vitin 1968, ku u lexuan 8 kumtesa, që kishin për objekt onomastikën, në të cilat këndvështrimi i materialit ishte ai historik, diakronik,; si

dhe Kuvendi i Parë i Studimeve Ilire, mbajtur në Tiranë më 15-20 shtator 1972, ku nga 14 kumtesat, gjysma e tyre u kushtohet studimeve onomastike me lëndë onomastike iliro-shqiptare. Edhe në referatin e prof. E.Çabej: “Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe”, shqyrtimi i lëndës onomastike dhe veçanërisht asaj toponimike, zë një vend të konsiderueshëm”<sup>94</sup>

Në studimet etimologjike dhe në shkrimet e tij për historinë e shqipes prof. E.Çabej merr në shqyrtim një lëndë të pasur onomastike me 195 onoma të llojeve të ndryshme, të cilat i bën objekt të një shqyrtimi të hollësishëm. Ato janë ndarë:

- **Në emra visesh e krahinash**, gjithsej 51, si: Bushat, Drisht, Dukagjin, Durrës, Frakull, Gomsiqe, Gjonm (Gjorm), Kelmend, Kuç, Karavasta, Laç, Lesh, Mallakastër, Mirditë, Nish, Orosh, Patos, Petrelë, Progër, Pult, Sul, Shar, Shijak, Shkodër, Shkup, Tomor, Theth, Vajkal, Valbonë, Vilë, Vlorë etj.
- **Emra lumenjsh**, gjithsej 5, si: Drin, Ishëm, Mat, Shkumbin, Vjosë.
- **Etonime**, gjithsej 10, si: arbën (arbër), çam, gegë, grek, lab, latin, rëmër, shqa, toskë, turk.
- **Emra personash e familjesh**, gjithsej 25, si: Barleci, Bua, Dorsa, Bdek, Dhoqinë, Garentinë, Gjike, Gjini, Gjokë, Gjon, Kastriot, Lekë, Llesh, Matrënga, Mëhill, Mëri, Mërti, Muriqi, Muzaki, Pal, Pjetër Vlash etj.
- **Emra të tjerë visesh e personash** të trajtuar tek apelativët përkatës, gjithsej 104, si: Agrit (qafa), Amantia, Anamali, Arrtunde, Balldreni, Barboçi, Batra, Bishqem, Bizë, Begë, Bora, Brisku, Bunë, Bulgër, Bunga, Burgajet, Burth, Burmi, Çikë, Dardania, Dejë etj.

Prof. Çabej me këto onoma, megjithëse jo të shumta në numër, ka punuar për të sqaruar etimologjinë e tyre, për ta plotësuar tablonë e raporteve trashëgim-huazim, ashtu si dhe në leksikun e përgjithshëm, në mënyrë që elementi vendës i trashëguar të zërë vendin që i takon objektivisht, atë që ka konstatuar G.Majeri se ai duhet të arrijë rreth 40 përqind të lëndës leksikore të gjuhës.

Studimet e bëra në këtë fushë kanë arritur në një konkluzion se edhe në onomastikë raportet trashëgim-huazim janë të përafërta si edhe te leksiku i përgjithshëm. P.sh. ndikimi turk në toponimi është shumë i vogël (Elbasan, Has, Tepelenë etj), por ai është i konsiderueshëm në antroponimi, po ashtu si edhe në leksikun e përgjithshëm. Shtresa e antroponimisë u prek më shumë nga ky ndikim, sepse qe e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me pasojat që solli feja e re islame. Emrat islamë në fillim dubluan emrat e vjetër paganë ose kristianë dhe më vonë u bënë të vetmit emra për popullsinë që u islamizua.

---

94. E.Çabej, Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe, Studime historike, nr.3, 1972.

Në qoftë se për leksikun onomastik do të flasim me gjuhën e shifrave duhet të hedhim poshtë pohimin, që ashtu si dhe për leksikun e përgjithshëm, se në pjesën më të madhe ai është i huaj. Edhe vetë ndarja fjalës i huaj apo vendës ka nevojë për rikonceptim, duke e vështruar më gjerë, duke parë edhe fjalë të formuara me lëndë vendi që vetëm rrënjën kanë shfrytëzuar si të huaj.

Me gjithë dëshirën e madhe që kanë pasur disa studiues të huaj për ta dalluar e ndarë lëndën e huazuar të shqipes edhe në onomastikë, e veçmas në toponimi, gjendja në realitet nuk paraqitet aspak ashtu si janë munduar ta përgjithësojnë ata, por duhen nxjerrë konkluzione të drejta mbi materialin faktik që ata kanë paraqitur. P.sh. A.M.Selishçevi në veprën e tij “Popullsia sllave në Shqipëri”, duke gjykuar vetëm nga të dhënat e hartave të ndryshme, arrin në një përfundim të nxituar kur thotë që shumica e emrave të vendeve në Shqipëri janë sllave, sepse nga studimi i tij dalin vetëm rreth 1000 toponime sllave dhe këto kryesisht emra vendbanimesh e krahinash, pra makrotoponime, kur dihet se vetëm fshatra në Shqipëri janë mbi 3000. Pra toponimet e sjella nga Selishçevi nuk përbëjnë shumicën, po të kemi parasysh se aty ka nevojë edhe për ndonjë saktësim. Kështu bëhet më e qartë se si qëndron puna realisht, ndaj është i domosdoshëm objektiviteti në studime.

Historia e këtij vendi e përlligj edhe gjendjen në onomastikë, gjendje që nuk ka sesi të mos e pasqyrojë këtë histori. Prandaj, duke mbajtur kudroherë mirë parasysh faktorët shoqërorë, historikë e gjuhësorë, përfundimeve të derisotme u duhen kushtuar studime të posaçme, për t’i mbështetur kur ato janë të drejta, dhe për t’i ndrequr e saktësuar kur është e nevojshme. Megjithatë ne këtu po japim vetëm një vështrim të përgjithshëm mbi studimet onomastike të kryera deri sot te ne, pra nuk kemi si qëllim të ndalemi posaçërisht mbi këto probleme. Një ndihmë të çmuar do të jepte mbledhja më e plotë dhe botimi i materialeve onomastike në të gjitha trevat shqiptare.

## 6.2 STABILIZIMI I TERMAVE NË ONOMASTIKË

Studimi i terminologjisë shkencore të një fushe të caktuar ka dy aspekte. Nga njëra anë jep mundësi të klasifikohen termat, të seleksionohen, të jepen rekomandime për përdorimin e një termi apo të një tjetri, të sistemohet, të unifikohet terminologjia, me një fjalë të ndikohet në mënyrë të ndërgjegjshme mbi zhvillimin e saj. Nga ana tjetër njohja dhe studimi i terminologjisë jep mundësi të shihet lindja dhe zhvillimi i vetë degës së shkencës, sepse ky zhvillim pasqyrohet qartë në terminologji, me arritjet e dështimet, luhatjet e gabimet, raportet e zhvillimit të barabartë ose të pabarabartë të degëve të ndryshme të një fushe.

Në terminologjinë që përdoret në literaturën tonë shkencore për onomastikën, e veçanërisht për toponimikën, ne mund të gjurmojmë zhvillimin e kësaj dege të shkencës, sepse në familjen e madhe të shkencave ajo është nga më të rejat dhe zhvillimi i terminologjisë së saj ndiqet relativisht lehtë këta dhjetëvjeçarët e fundit.

Autorët e punimeve të para për toponimikën përdornin si terma në pjesën më të madhe togfjalësha përshkrues. Kështu, në këto punime nuk i gjejmë termat *toponimikë*, *hidronimikë*, *formant toponimik*, *toponimizim* etj., ndonëse pikërisht për këto nocione bëhej fjalë. Dhe kjo është e kuptueshme, sepse termi, si rregull, lind pas lindjes së nocionit. Termi *toponimikë* shfaqet në literaturë në vitet njëzet të shekullit të kaluar dhe vijon të konkurojë edhe sot e kësaj dite me termin tjetër *toponomastikë*. Ka edhe autorë që termin *toponomastikë* e përdorin në vend të *onomastikës*, gjë që krijon dysori të panevojshëm në terminologji.

Në punimet e gjysmës së dytë të shek.20 dalin termat *hidronim* dhe *oronim*. Me zhvillimin e studimeve të grupeve të ndryshme të emërtimeve gjeografike lindi dhe nevoja për të emërtuar degët përkatëse të toponimikës. Dolën dhe u futën shpejt në përdorim termat *antroponimika*, *mikrotoponimika*, *hidronimika* etj. Secila nga këto degë të onomastikës mori më vonë një zhvillim të madh, e bashkë me këtë zhvillim eci edhe përpunimi i terminologjisë së çdo dege, madje filluan të mbahen konferenca shkencore kushtuar një dege të veçantë të onomastikës, gjë që tregon interesin gjithmonë e në rritje të gjuhëtarëve për këtë degë të re të shkencës gjuhësore, degë që ka ardhur gjithmonë duke u konsoliduar si e tillë edhe në aspektin terminologjik, por dhe me hapësira të mëdha zhvillimi e përmirësimi të tij.

Terminologjinë shkencore të çdo fushe mund ta përcaktojmë sipas tipareve të ndryshme: sa e zhvilluar është; sa i formuar është sistemi i termave të saj në pikëpamje të pasqyrimin të nocioneve të shkencës dhe strukturës gjuhësore të vetë termave; nëse ka dublete sinonimike; nëse i reflekton shkollat dhe rrymat e ndryshme, d.m.th. nëse ka



kuptim individual, autorial, termi në dallim nga ai i përgjithshmi; nëse është ndërtuar mbi bazën e një gjuhe apo të disave dhe cila nga këto gjuhë qëndron në themel të saj: ndonjëra nga gjuhët klasike (latinishtja apo greqishtja) apo ndonjë gjuhë kombëtare e gjallë; nëse ajo është ngurtësuar apo ndodhet në periudhë kërkimesh, lindjeje termash të rinj, saktësim kuptimesh dhe, më në fund, sa e kënaq ajo studiuesin.

Sot po bëhet një punë e madhe për evidentimin dhe unifikimin e terminologjisë onomastike. Tani për tani mund të bëhen vetëm disa konkluzione paraprake për gjendjen e terminologjisë onomastike, mbi bazën e materialeve të grumbulluara e të krahasuara me të dhëna të fushave të tjera.

Interesi për onomastikën në fillimet e gjysmës së dytë të shekullit të kaluar (sidomos në vitet 60-të) u shpreh në mënyrë të posaçme me daljen në shtyp të një numri të madh punimesh, ku do të evidentonim për ndihmesën e rëndësishme në onomastikën shqiptare dy mjeshtrat e mëdhenj të gjuhës shqipe prof. Eqrem Çabej që u priu studimeve tona në Tiranë, duke bërë rishqyrtimin kritik të asaj çka ishte thënë nga studiuesit e huaj, por edhe zbatoi për herë të parë metoda pune për të mbërritur në etimologjitë e sakta, sa më të pranueshme, të toponimeve shqiptare; dhe prof. Idriz Ajeti në Prishtinë, i cili gjithashtu, vuri gurë themeli në ngrehinën e studimeve kushtuar onomastikës shqiptare.

Gjithashtu me trajtesa të rëndësishme onomastikës i janë kushtuar kumtesa, referime e artikuj edhe nga studiues të tjerë të mirënjohur si Mahir Domi, Androkli Kostallari, Kolë Luka, Palok Daka. Veçanërisht do të sillnim në vëmendje Simpoziumin Shkencor të mbajtur në shkurt të vitit 1977 nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, ku u shqyrtuan në 45 kumtesat e referimet shkencore probleme me rëndësi të toponimisë së lashtë, onomastikës mesjetare e të onomastikës së sotme, lënda e vlefshme e të cilit është botuar në vëllimin “Onomastika e Kosovës”<sup>95</sup>

Larmia e problemeve dhe hedhja në qarkullim shkencor e materialeve të reja kanë kërkuar dhe kërkojnë krijim termash. Kohët e fundit pothuajse nuk ka asnjë punim, ku autori të mos ketë futur një term të ri ose të mos ketë shfrytëzuar për nevojat e onomastikës një term linguistik ekzistues. Termet që lindin nuk janë gjithmonë të goditur e të suksesshëm, por megjithatë janë një dëshmi e sigurtë e zhvillimit të mendimit shkencor në fushën e onomastikës, e ndeshjes së tij me fakte të reja.

Sot mund të konsiderohen të stabilizuara këto fakte të terminologjisë: termi onomastikë për të gjithë shkencën e emrave të përveçëm (ka ende diskutime vetëm për përcaktimin e këtij termi për ta konsideruar onomastikën shkencë më vete, apo degë të gjuhësisë). Në përbërje të onomastikës hyjnë: *toponimika* (dega e emërtimeve të objekteve gjeografike), *antroponimika* (dega e emrave vetiakë), *etnonimika* (dega e

<sup>95</sup> Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979.

emërtimeve të fiseve dhe popujve), *teonimika* (dega e emrave të perëndive), *astronimika* (dega e emrave të objekteve astronomike), *zoonimika* (dega e emrave të kafshëve), *fitonimika* (dega e emrave të bimëve), *krematonimika* (dega e emrave të përveçëm të disa objekteve si vaporë, aeroplanë, trena, gazeta, libra, filma, institucione, festa et.).

Në renditjen që u bë më sipër është marrë parasysh jo vetëm ana vëllimore, por edhe fakti se sa e studiuar është secila degë deri më sot. Disa nga këta terma kanë nevojë të përcaktohen e të saktësohen më tej. Termi teonimikë ka shkaktuar reagime të shumta midis onomastëve, megjithatë sot ai jo vetëm që ka hyrë në përdorim, por ka shërbyer edhe si temë për formime të reja si p.sh. *teonimi*(Zeus), *emra teoforikë* (Teofil, Teodor), *teoantroponime* (Apollon, Mërkur)etj. Midis termave që shënojnë ndarjet e onomastikës, termi *krematonimi* është më i riu dhe ende s'ka gjetur një përcaktim të saktë.

Toponimika është deri më sot dega më e studiuar e onomastikës. Zhvillimi dhe detajimi i saj vijon paprërë. Sot p.sh. është futur termi *oikonimika* për atë degë të toponimikës që studion emërtimet e vendbanimeve në përgjithësi dhe për ndarje të brendshme të saj janë propozuar termat *komonimikë* (studimi i emërtimeve të vendbanimeve të tipit fshat) *polisonimikë* (studimi i vendbanimeve të tipit qytet, nga greqishtja, polis- qytet. Në këtë term është ruajtur s-ja fundore e rrënjorit për të shmangur homoniminë me rrënjorin tjetër shumë prodhimtar, po nga greqishtja me kuptimin “shumë”), *urbonimikë* (studimi i i emërtimeve të objekteve të qytetit, si p.sh. të rrugëve, shesheve, rrugicave, urave etj. nga latinishtja urbs-qytet), *uronime* (emra fshatrash). Krahas termit *oronimikë* për studimin e emërtimeve të elementëve të relievit, është futur edhe termi *horonimikë* për emërtimet e zonave, territoreve, rajoneve që kanë kufij të përcaktuar ( nga greqishtja opas-shenjë ndarëse, cak, kufi). Këtu duhen futur edhe emërtimet e rajoneve të gjeografisë fizike dhe ekonomike, emërtimet e njësive të ndarjes administrative territoriale të vendit dhe vetë emërtimet e vendeve. Termi *dromonimikë* është propozuar për atë degë të onomastikës që studion emërtimet e rrugëve.

Janë bërë të dukshme qartë e të rregullta disa tipe të formimit të termave. Kështu p.sh. dega e shkencës formësohet me prapashtesën **-ka**: *toponimika, antroponimika, onomastika, hidronimika, urbonimika, etj.*, ndërsa tërësia e emrave të përveçëm, që studiohet nga kjo degë, merr mbaresën **-a**: antroponimi-a, hidronimi-a, urbonimi-a, madje edhe onomi-a (term i propozuar nga onomatologët çekë për tërësinë e të gjithë emrave të përveçëm). Ndërsa për një emërtim që përdoret vetëm një herë, përdoret termi pa fleksion: *toponim, urbonim, hidronim, etj.* Procese të ndryshme marrin shpesh sufiksën – **zim**: *toponimizim, hidronimizim, onomizim, ;* emërtimet e fjalorëve marin leksemën **-kon**: *onomastikon, antroponimikon, toponimikon, etj.*

Duhet vënë në dukje se sot po pasurohet mjaft edhe kategoria e termave të përbërë, me dy tema, ku e para emërton atë nga ka dalë emri i përveçëm, ndërsa e dyta tregon se

ç'është ai tani, p.sh. *topoantroponim* (d.m.th. emër vetiak që ka dalë nga një toponim), *antropotoponim* (toponim i dalë nga një emër vetiak), *hidrooikonim*, *etnotoponim*, *zootoponim*, *fitotoponim*, *zooantroponim*, *astroantroponim* etj. Terma si këta janë të nevojshëm për të ashtuquajturat formime të dyta. Në literaturën studimore onomastike, veç termave specialë, gjejnë përdorim edhe shumë terma gjuhësorë të përgjithshëm si: *aglutinim*, *pseudoetimologjizim*, *topoleksemë*, *kalk* etj.

Në onomastikë, në punime speciale e sidomos në ato monografike, përdoren edhe terma të shkencave të tjera si p.sh.: *stratigrafia e emrave*, *shtresë toponimike*, *formula e emrit*, *emër hibrid*, *emra okazionalë*, *term-indikator* etj. Këta terma, të marrë hua nga gjuhësia e përgjithshme dhe jashtë gjuhësisë, që përdoren në onomastikë, marrin veçori që shprehen me shtimin e përcaktorit toponimik, antroponimik etj. si p.sh. *sufiks toponimik*, *hartë toponimike*, *etimologji toponimike* etj.

Natyra e dyfishtë e emrit të përveçëm që përcaktohet nga faktorë gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, është e ndërlikuar dhe e veçantë. Për këtë shkak edhe terminologjia linguistike në onomastikë merr një ngjyrim të veçantë.

Nga sa u paraqit më lart, duket që terminologjia onomastike sot është bërë një sistem i zhvilluar. Megjithatë, ende shumë nocione shprehen në mënyrë përshkruese, si p.sh. emërtimet e kontinenteve, emërtimet e objekteve natyrore, emërtimet e objekteve të krijuara nga njeru, emërtimet e fushave, të hidroobjekteve, emërtimet e burimeve, emërtimet e fiseve (etnonime), termi për atë që jep emrin, bën emërtimin etj.

Sot terminologjia onomastike ka shumë terma që janë bërë pronë e qëndrueshme e saj kudo ku ajo prodhohet si p.sh. *topoizoglose*, *kontekst toponimik*, *topoleksemë*, etj. dhe që huazohen prej specialistëve në shumicën e rasteve pa përkthim.

Terminologjia onomastike që përdoret sot, në themel të saj është linguistike, gjë që përcaktohet nga qenia fjalë. Në sferën e nomenklaturës janë ligjëruar termat me origjinë greke (vetëm në ndonjë rast latine si *urbonim*) dhe në këtë aspekt terminologjia është internacionale. Në literaturën shkencore synohet gjithmonë që termi të jetë i njëkuptimshëm dhe të shmangen dyshimet terminologjike. Sot ajo ndodhet në një fazë detajimi, që pasqyron edhe gjendjen në të cilën është sot mendimi shkencor për degën përkatëse të shkencës. Marrim si shembull *hidronimikën* e cila ka arritur në një detajim mjaft të hollësishëm. Brenda saj ka sot degëzime më të holla si: *potamonime* - emra lumenjsh, *limnonime* - emërtime liqenesh, *pelagonime* - emërtime detrash.

Pas hidronimisë mund të rendisim mikrotoponimikën, ku, për shkak të larmive të objekteve që emërtohen, mund të gjejmë shumë terma që lidhen me teorinë e emrit të përveçëm, sepse shumë mikrotoponime qëndrojnë në kufirin midis emrit të përveçëm dhe atij të përgjithshëm, duke qenë ende toponime- togfjalësha dhe madje toponime- fjali.

Ndërsa oikonimika, emërtimet e qendrave të banuara, ka ende një terminologji pak të zhvilluar.

Antroponimika kohët e fundit ka përjetuar një zhvillim të vrullshëm të terminologjisë. Kanë lindur terma e togfjalësha terminologjike të tillë si: *emër zyrtar, emër jozyrtar, emra kanonikë, emra paganë, emra kristianë e paleokristianë, emra ebraikë e islamikë, pseudonim, kriptonim, fitonim, deantroponimizim, etj.* Për termat *etnonim e patronim* në literaturën gjuhësore të E. Çabejt janë përdorur variantet e marra nga sllovenishtja: *etnika, patronimika*, me sa duket nën ndikimin e literaturës së lexuar në këtë gjuhë.

Për të dhënë një përcaktim sa më të saktë të sistemit onomastik, na duhet të marrim në shqyrtim edhe çështjen e kundërvënies së tiparit koherent dhe atij inherent, sidomos kur kemi të bëjmë me koinoniminë antroponimike. Tipari inherent e fiton vlerën e vet determinuese kur të merren në shqyrtim emrat kolektivë ose emrat e bashkësive, të quajtur *koinonime*, si një rend i veçantë i nënklasës së antroponimeve nga ajo shtresë e leksikut e cila që nga lashtësia është quajtur në mënyrë përshkruese emra të përveçëm dhe që këtu, për koncizitet dhe koherencë terminologjike, po quhen eidonime, pra fjalë me funksion eidonimik, individualizues.

Nga pikëpamja e logjikës elementare koinonimet, duke pasur edhe numër njëjës edhe numër shumës, nuk mund të quhen emra të përveçëm, sepse funksioni eidonimik i tyre arrin deri në identifikimin e një shumësie natyrale krahas identifikimit të njëjësive natyrale, që i takojnë shkallës më të ulët të klasifikimit, mbi atë madhësi taksonomike ku futet edhe njëjësia e identifikuar.

Është e qartë, që në koinonimi është krejt i pamundur ai lloj supletivizmi, kur numri njëjës i leksemës genonimike shprehet me një formë, ndërsa shumësi me një formë tjetër. Format e njëjësit dhe të shumësit janë patjetër të lidhura me të njëjtën temë, dhe formave të shumësit u atribuohet po ai tipar individual, i papërsëritshëm, i pandashëm si edhe formave të njëjësit. Por nuk duhet mohuar edhe fakti që tipari inherent nganjëherë shndërrohet në koherent, pra pushon së qeni i mjaftueshëm për ndarjen e koinonimeve nga genonimet. Këtu edhe duhet parë karakteri kalimtar apo i ndërmjetëm i rendit të koinonimeve, si limitrofe në kufirin e shtresave genonimike dhe eidonimike të leksikut.

Nga pikëpamja leksikore nuk ka paralelizëm të plotë midis emërtimeve banor i Tiranës dhe tiranas, sepse në rastin e parë leksema banor me funksion klasifikues dhe me tipar koherent kualifikohet si *genonim tipik*, ndërsa leksema (gjinorja) i Tiranës (që nga pikëpamja logjiko-semantike është e barasvlerëshme me mbiemrin tiranas) del si *eidonim-toponim tipik* (astionim), në të njëjtën kohë, kur në rastin e dytë kemi përpara një koinonim me funksionin e vet individualizues dhe me tiparin inherent të supozuar (nga pikëpamja leksikore nuk ka dallim: i lindur dhe banues në Tiranë; i lindur, por që s'banon

në Tiranë, që nuk ka lindur, por banon në Tiranë. E rëndësishme këtu është lidhja e ngushtë me leksemën eidonim Tirana).

Kështu, pikëpamja logjiko-semantike mbi leksikun ka çuar dhe çon në mosmarrjen parasysh të specifikës leksikore, d.m.th. të veçorive të sistemit leksikor të gjuhës të kuptuar si sistem dinamik e jo statik. Nga kjo pikëpamje, që i imponon leksikologjisë një trajtim natyralistik të objektit të saj, konsiderohet e mundshme ndarja metafizike e gjithë leksikut në dy klasa leksikore: në emra të përveçëm dhe në apelativë (të përgjithshëm), duke lënë mënjanë çështjen e klasave kalimtare, të ndërmjetme dhe duke i kuptuar në mënyrë natyralistike dhe jo linguistike funksionet e klasifikimit dhe të individualizimit.

Por, duke pasur të bëjmë me studimin e materialit gjuhësor të gjuhëve natyrale, do ta quanim plotësisht të përligjur dhe gjuhësisht të mbështetur pikëpamjen leksikore, leksikologjike, sipas së cilës funksionet e klasifikimit dhe individualizimit që ekzistojnë në gjuhë, çojnë në shtresimin në leksik të leksemave genonimike dhe eidonimike. Këto dy shtresa nuk duhen parë si dy klasa të kundërta, të ndara prerazi, por duhen njohur e pranuar lidhjet e tyre të shumta si në diakroni, ashtu edhe në sinkroni. Leksiku pra mund të trajtohet si nga ana e shtresës genonimike, ashtu edhe nga ana e shtresës eidonimike. Në rastin e parë vëmendja përqëndrohet në leksikun genonimik ose klasifikues, në të dytin në leksikun eidonimik ose individualizues.

Kur individualizimi nuk arrin deri në cakun e vet të poshtëm, që është identifikimi i objekteve natyrale ose subjekteve (në rastin e antroponimeve), kufijtë e shtresave leksikore të genonimeve dhe eidonimeve bëhen të kapërcyeshëm. Atëherë çështja e përkatësisë së leksemave zgjidhet në të mirë të njëres ose tjetres shtresë mbi bazën e lidhjeve fjalëformuese të gjuhës nga vjen termi. Në këtë rast kategorinë e ndërmjetme, kalimtare, të koinonimeve antroponimike duhet ta përfshijmë në eidonimi e jo në genonimi.

Për përcaktimin e vendit të koinonimeve në përbërjen leksikore të gjuhës mund të përdoret edhe një kriter tjetër që mund të quhet kriteri i perifrazës ose i transformimit perifrastik. Kur duam të zbulojmë në mënyrë përshkruese dhe sa më qartë përmbajtjen kuptimore të një lekseme, siç bëhet në fjalorët shpjegues dhe enciklopedikë, do të na duhet që për zbërthimin e përmbajtjes së një genonimi t'u referohemi vetëm genonimeve p.sh. strateg- udhëheqës trupash, komandant ushtrie. E kundërta do të ndodhë kur do të na duhet të zbërthejmë përmbajtjebn e një eidonimi.

Këtu do t'u referohemi jo vetëm genonimeve, por edhe eidonimeve, p.sh.Miltjadhi-strateg athinas, nën komandën e të cilit grekët korrën fitoren mbi persët në Maratonë në vitin 490 p.k. Është e qartë, që një zbërthim i tillë i përmbajtjes së eidonimit-antroponim Miltjadh, thjesht si Miltjadh-strateg, do të jetë mjaft i pasaktë dhe i paplotë,dhe kur flitet

për kriterin e perifrazës nuk kihet kjo parasysh. Është e qartë po ashtu që të kihet parasysh një minimum informacioni i shprehur, sepse maksimumi i tij duhet të përmbajë të gjitha të dhënat që janë në dispozicion Për Miltjadhin, të birin e Kimonit, të vëllanë e Stesagorit, arkondit athinas në vitet 524 p.k., të martuar me Hegesipilën, të bijën e mbretit trakas Olorit që i dëboi pellazgët nga ishulli Lemnos dhe që e ndihmoi mbretin pers Dari në fushatën kundër Skithëve etj.

Brenda eidonimikës, *koinonimika* përbën një degëzim të antroponimikës. Deri më sot me antroponime janë kuptuar vetëm *idionimet* (emrat vetiakë të njerëzve), *ankistonimet* (mbiemrat) dhe *genetonimet* (emrat e fiseve, nëse këto mund të ndaheshin nga ankistonimet). Etnonimikën praktikisht e kanë futur në onomastikë pa ndonjë bazë teorike të veçantë, por si të lidhur ngushtë me toponimikën, pavarësisht nga binumeralizmi i objekteve diskrete apo kolektive që identifikojnë etnonimet.

Ndërmjet filonimeve dhe etnonimeve ka mbetur një material “ i askujt”, që ka marrë emrin oikistonime. Këto janë të lidhura me toponimet jo më pak se etnonimet duke qenë patjetër edhe derivate të tyre. Kështu kufiri midis oikistonimeve (sidomos katoikonimeve) dhe etnonimeve mbetet krejt i hapur. Sot po ndodh edhe një dukuri tjetër: shndërrimi i etnonimeve në *politonime*. Është vështirë të thuash ç’do të thotë amerikan : banor i kontinentit amerikan (katoikonim), përfaqësues i ndonjë etnosi amerikan (etnonim), apo qytetar i SHBA (politonim). E padiskutueshme mbetet vetëm lidhja e këtij koinonimi me toponimin Amerika.

Oikistonimet zënë vend midis filonimeve dhe etnonimeve brenda koinonimeve. Me studimin e kësaj kategorie duhet të merret koinonimika antroponimike, ose antroponimika si fushë e eidonimikës. Veç kësaj koinonimike, mund të flitej edhe për një tjetër që do të studionte emërtimet e grupeve apo bashkësive të botës shtazore.

Si përfundim duhet thënë se terminologjia onomastike ka mundësi dhe perspektiva të mëdha zhvillimi. Sistemi ekzistues i nocioneve dhe termat përkatës na lejojnë të supozojmë daljen e termave të rinj me një strukturë të parashikuar. Ndikimi ynë mbi këtë terminologji duhet të ecë në linjën e një strukture të njëjtë, p.sh. të mënjanimet të dubleteve terminologjike dhe të përdorimit për krijimin e termave të rinj të fjalëve e termave që kuptohen sa më mirë nga studiuesit, por dhe lehtësisht të kuptueshme nga lexuesit e gjuhës amtare.

### 6.3 STANDARDIZIMI I ELEMENTEVE ONOMASTIKE

Një çështje që duhet trajtuar më vete, e cila në mënyrë sporadike ka dalë në rend të ditës në momente të caktuara historike, është edhe çështja e standartizimit të elementeve onomastike të huaja në gjuhën standarde shqipe, një pjesë e tyre e pasqyruar edhe në ndonjë fjalor shpjegues të gjuhës shqipe, si “Fjalori i shqipes së sotme” 1984.

Mjetet e ndryshme të informacionit, sidomos media e shkruar përhapin më shumë gjuhën standarde. Kontakti me informacionin e gjuhëve të huaja sjell vërshimin e shumë fjalëve, midis tyre dhe fjalë onomastike, të cilat të ardhura në formën e gjuhës së shkruar vijnë në trajtë origjinale, pa u adaptuar apo asimiluar nga folësi shqiptar. Por gjuha kombëtare, gjithnjë e më shumë, bëhet mjete kryesor i komunikimit në shoqërinë tonë dhe grupe të mëdha shoqërore i afrohen gjithnjë e më shumë, duke u larguar nga qarku i ngushte lokal. Në këtë mënyrë leksiku diferencohet, unifikohen variantet, kështu në gjuhë pranohen shumë fjalë të huaja bashkë me nomenklaturën terminologjike të burokracisë, si leksiku i trafikut, doganave e përgjithësisht zyrave të shtetit, të cilat bëhen pjesë e gjuhës kombëtare. Të gjitha këto e ngrenë në një shkallë të re kulturën gjuhësore të folësve të saj. Ndaj me këtë kulturë gjuhësore të ngritur mund të shtrohet çështja e trajtimit të emrave dhe emërtimeve të huaja në standardin e gjuhës sonë.

Kategoria e emrave dhe emërtimeve që kanë nevojë të trajtohen kur vijnë e bëhen pjesë e një teksti shqip janë: toponimet, antroponimet dhe patronimet, ku nëpërmjet këtij teksti ato bëhen të detyrueshme për t’u pranuar si lëndë e huaj, pranim që nuk varet nga qëndrimi që do të mbajmë ne si folës të standardit të gjuhës shqipe siç mund të ndodhë me leksikun e huaj apelativ, i cili mund të mos pranohet, pasi ka koresponduesen e tij në shqip. Ndaj çështja këtu për këtë kategori fjalësh, nuk është t’i pranojmë ose jo, por në ç’mënyrë do t’i pranojmë në standardin tonë: në trajta të njësuara apo alternative, sipas variantit të realizuar në një areal të dhënë onomastik, qoftë ky dialektor apo në një mjedis tjetër nacional.

Po të rindërtohej mendimi i studiuesit Dubois për gjuhën standarde, përpjekja për standardizim të toponimeve mund të përkufizohej “si një formë e gjuhës standarde ku në një vend të caktuar përtej varianteve lokale ose shoqërore, toponimia imponohet në shkallën që të përdoret në mënyrë të zakonshme si mjete më i mirë i komunikimit. Gjuha standarde anon drejt shuarjes së shmangieve duke imponuar një formë të vetme ndër të gjitha format dialektore, gjuhësore dhe historike të tyre.

Studiuesit e ndryshëm, në fushën e standardit, kanë parasysh së paku dy elemente të rëndësishme: legjitimitimin historik dhe realizimin gojor e atë të shkruar. Në këtë aspekt, emrat dhe emërtimet toponimike paraqesin një problematikë komplekse. Të ashtëquajturat oikonime, emrat e qyteteve dhe të fshatrave dhe toponimet brenda arealit

shqiptar e shqipfolës, dhe lidhur ngushtë me këtë pasqyrimi i tyre në dokumentet e shkruara, hartë apo fjalor, nxjerrin problemin nëse do të ndryshojnë ato, do të ndërrohen apo standardizohen sipas rregullave të gjuhës, proces që po kërkohet për t'u bërë në Kosovë dhe që ka ngjallur debat atje.

Përprojekjet e pasluftës në Kosovë për të standardizuar toponiminë, për të rikthyer gjendjen e mëparshme apo për të legjitimuar trajtën tradicionale të saj, janë symine të bartësve të tyre për të çliruar hartën e Kosovës nga mitet serbe, një mjet bazë me të cilin populli serb dhe institucionet e tij shtetërore, kulturore e shpirtërore e kanë sulmuar Kosovën.

Toponimet serbe të ndërtuara mbi mitet reflektojnë përprojekjet shfarosëse, të cilat edhe më tej gjenerojnë rreziqe të vazhdueshme për banorët e këtij rajoni dhe më gjerë, ndaj është e kuptueshme pse eliminimi i tyre është mënjanim i rreziqeve të vazhdueshme, ndërsa ndërrimi i tyre ose kthimi në gjendjen fillestare paraqet eliminimin e shkaqeve që sjellin konflikte të përhershme, qofshin këto shkencore apo edhe politike.

Për të mënjeluar sistemin toponimik të ngritur mbi mitin e përvojës kolektive serbe, në Kosovën e pasluftës së 1999-ës, e cila sollti ndryshime të thella në historinë e saj, në aspektin e zhvillimeve të brendshme, realitet që sot shihet dhe në fushë të toponimisë, e cila ka qenë pengu më i madh i qytetërimit shqiptar pqë disa shekuj me radhë, ndaj është ngritur një Këshill shkencor për standardizimin e emërve të Kosovës.

Në toponiminë tonë njihet një ndërrim masiv gjatë dyndjeve sllave (në fillim të sh.VI). Në këtë kohë u zëvendësuan të gjitha ato emërtime që vazhdonin të ruanin kuptimin e tyre paratoponimik, duke u përkthyer ose adoptuar në gjuhën e ardhësit.

Por ndërmarrje të pjesshme janë bërë dhe në administratën shtetërore shqiptare. Një projekt i tillë për ndërrimin e oikonimeve brenda territorit të Shqipërisë u bë nga Qeveria e Monarkisë në vitin 1937, në të cilin bëhej fjalë për rreth 50% të emrave të vendbanimeve të Shqipërisë, duke përfshirë emra qytetesh, fshatrash, lumenjsh e deri te lagje qytetesh. Megjithatë ky ligj nuk gjeti zbatim dhe shumica e vendbanimeve i ruajtën emrat e mëparshëm. Ky është rasti kur ndërrimi i emrtimeve ndodh në kuadrin e një gjuhe, të një populli dhe pasqyron në njëfarë mënyre luftën sociale. Meqenëse toponimi kryen jo vetëm funksionin e drejtpërdrejtë të adresave, por edhe një funksion ideologjik, në momente të ashpërsimit të konfliktit social kjo ngjyresë shfaqet më qartë. Objekt ndërrimi bëhen sidomos emrat e vendbanimeve, të rrugëve, shesheve, shkollave, ndërsa emërtimet e objekteve fiziko-gjeografike mbeten përgjithësisht të paprekura.

Ky projekt kaq radikal ndërrimesh meriton të shqyrtohet dhe mund të nxirren përfundime që mund t'i vlejnjë ndërhyrjes në këtë fushë kaq delikate. Përgjithësisht onomastët janë kundër ndërrimit të emrave, sepse veç vlerës si përmendore të kujtesës njerëzore, e cila mund të zbehet me ndërrimin e tyre, çdo ndërrim emri sjell vështirësi



edhe në ndërlidhje. Kur shtrohet problemi i ndërrimit të emërtimeve, në fakt pikënisje është bërë një homonimi që i kapërcen caqet e një marrëveshjeje shoqërore, p.sh disa emra fshatrash të njëjtë në të njëjtin rreth ose kur emërtimet kanë pasur ngjyresë të papëlqyeshme, psh. raste të tilla si: Qelbësirë - lagjja “Guri i bardhë” Ura Vajgurore; Qenas- Afrim; Sakat -Blerim etj. Por një projekt kaq masiv emërtimeve të qendrave të banuara, që shkon deri në 50%, është jo vetëm i paarsyeshëm, por edhe i parealizueshëm, pasi ai mund të shkaktojë pështjellim në administratën shtetërore. Në rastin tonë nuk ishin të domosdoshme disa ndërrime si: Golem, Novoselë, Selenicë, Bistricë, Kuç etj.

Një projekt tjetër ishte ai i regjimit komunist. Por ky u krye me procedurë formale të pranueshme si të inicuar nga vetë banorët. por edhe këto mbetën të dyshimta për motivet e ndërrimit, sepse janë vënë në shenjë oikonimet me prejardhje turke e sllave, duke sterilizuar një pjesë të toponimisë dhe duke bjerrë kështu vlerat e tyre kulturore historike.

Problemi i ndërrimit të emërvendeve në Kosovë është më i argumentuar, më i motivuar, sepse një pjesë të toponimisë atje e përbën ajo paradigmë kontekstuale dhe e rimotivuar ndër shekuj, ku në emërtimin e disa vendbanimeve kisha serbe ka luajtur një rol të theksuar, ndërsa shqiptarët, me të drejtën që u jep historia e tyre, kërkojnë të ndërtojnë toponiminë mbi paradigma të tjera, si: faktorët natyrorë (pozita gjeografike), përbërja gjeologjike e vendbanimit, prania e rrjedhave ujore etj., nga prejardhja patronimike, historia bashkëkohore etj., pasi shembuj të shumtë dëshmojnë për rimotivimin dhe rimeërtimin e vendbanimeve shqiptare gjatë fillimit të shekullit të XX nga administrata serbe në kontekst të koncepteve të tyre mitike, politike, historike, kulturore, gjuhësore etj. Studiuesi Begzad Baliu sjell disa shembuj për të argumentuar shtresimin e fondit serb mbi toponiminë e leksikut iliro - shqiptar duke u shprehur: “Fondi i moçëm i trashëgimisë iliro-shqiptare, si: Llap, Gallap, Ulpianë, Therandë, Dardanë, Sharr, Vendenis, Bardosanë, Lumbardh, Naisus, Siparant, Margus, Bardarium, Scup etj., është ndeshur me mitin e rikonstruktuar të fondit sllav të toponimisë së Mesjetës: Lazarevo, Milosevo, Obilica, Kosovo Polje, Uroevac, duke u shtresuar ky fond mbi toponiminë e leksikut iliro-shqiptar”.<sup>96</sup>

Në aspektin e standartizimit, një problem më vete paraqesin emërtimet e shteteve, të kryeqyteteve dhe qyteteve të huaja. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndryshim apo ndërrim emrash, pasi ata janë të njohur prej kohësh dhe kanë krijuar traditën e përdorimit në shqipe, traditë që meriton të ruhet, pasi është dëshmi e vyer e lidhjeve dhe marrëdhënieve të shqipes dhe shqipfolësve me historinë dhe kulturat e vendeve fqinje dhe të gjuhëve tona. Kështu në dokumentet tona shkrimore këta emra nuk duhen shkruar si në gjuhën nga vijnë, por të transkriptuar si p.sh. New-York --Nju Jork; jo Mynhein - por

---

<sup>96</sup> Baliu, B. Jo ndryshim i emërvendeve të Kosovës, por standardizim i tyre, Gjuha jonë, nr. 1-2, Tiranë, 2000, f.71-80.

Mynih, jo Kolonia- por Këln, jo Lipcia -por Lajpcig, jo Dancing - por Gdansk etj. Edhe emërtimet e qyteteve tona në harta, apo fjalorë, si në shtojcën e “Fjalorit të shqipes së sotme” 1984, duhen shkruar në një rën nga trajtat, në të shquarën ose të pashquarën, sepse një gjendje e tillë sjell probleme për standardizimin e onomastikës gjeografike.

Në kohë të ndryshme, bazat e një sistemi onomastik me burim nga motivet e historisë i ka ndjekur si toponimia ashtu edhe antroponimia, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX në Shqipëri dhe në fundin e tij e fillimin e shekullit XXI në Kosovë, për shkak se toponimet dhe antroponimet e tilla zgjojnë ndjenjat e përkatësisë kombëtare, ndaj janë vendosur emra abstraktë, të motivuar nga nomenklatura gjuhësore dhe semantike e shqipes, por në Kosovë në këtë kohë janë vënë re prirjet e formimit paralel të toponimeve e antroponimeve me motive nga zhvillimet në Kosovë, duke u bërë pjesë e krenarisë dhe identitetit tonë kulturor, shoqëror dhe është niveli më i lartë i vetëdijes sonë historike. Te antroponimet problem përbën çështja e përdorimit të emrit personal në trajtë të pashquar në bashkëvajtje me patronimin, të tipit Jetë Krasniqi apo Besë Shala, përballë Lule Dibra, Engjëllushe Tepelena, ku dy të fundit e përjashtojnë përdorimin e tyre në trajtë të shquar, ndërsa dy të parat edhe mund të përdoren në këtë trajtë p.sh. Jeta Krasniqi, Besa Shala duke mos krijuar ndonjë problem.

Patronimia, si sistem i mbyllur, nuk paraqet probleme për ndryshim, ndërrim apo standardizim, ajo te ne është stabilizuar para vitit 1948, kur është miratuar edhe ligji për trajtën e tyre. Parimi udhëheqës në këtë fushë duhet të mbetet paprekshmëria e patronimit, sepse ai ka të bëjë me identifikimin e saktë të personit. Ajo që është e rëndësishme në këtë proces, mendojmë se është ruajtja e vijueshmërisë së toponimeve në kohë, për të hetuar modifikimet e ndryshme të shkaktuara nga proceset fonetike ose zëvendësimet e dhunshme dhe për të pasur të njëjtën formë, në përputhje me rregullat e shqipes standarde, për të kryer si duhet rolin komunikues midis shqiptarëve e më gjerë.

## KREU VII

### PASQYRIMI I FJALËSIT ONOMASTIK NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE

#### 7.1 ETNONIMET SI KATEGORI E NDËRMJETME MIDIS EMRIT TË PËRVEÇËM DHE APELATIVIT.

Në studimet albanologjike të dhënat e onomastikës dhe hulumtimet e shqyrtimet e emrave të vendeve (toponimet), emrave të njerëzve (antroponimet) dhe emrat familjarë (patronimet), kanë përbërë një interes të vazhdueshëm për studiuesit e gjuhës. Sinjë prej fushave më komplekse të gjuhësisë, onomastika, në shekullin e fundit është bërë objekt studimi më vete në gjuhësinë evropiane në përgjithësi dhe atë shqiptare në veçanti. Studiuesit e huaj dhe ata shqiptarë, përmes kërkimeve onomastike, kanë hulumtuar gjithë ndryshimet e këtij fjalësi gjatë lëvizjes së popujve në histori, kulturat, zanafillën e etnisë etj. Mjafton të përmendim se shumë nga shpjegimet serioze rreth historisë së gjuhës shqipe e, madje, edhe për historinë e popullit shqiptar si vijues i ilirëve, të kulturës e të traditave shqiptare si tashëguese e vijuese të pandërmjetshme të kulturës, gjuhës e historisë ilire, nga lashtësia deri në ditët tona, janë projektuar e mbështetur sa me gërmimet arkeologjike, aq edhe me të dhënat e onomastikës iliro-shqiptare.

Gjuhësia shqiptare, përmes onomastikës, ka zbuluar në detaje praninë e paraardhësve të popullit tonë në trojet etnike, nënshtrësën paraindoevropiane të ilirishtes dhe mbishtresat e ndikimeve të huaja në kulturën tonë, vendin e formimit të etnisë së arbrit në trojet e sotme ku jetojnë shqiptarët, prerjet kulturore, fetare e historike në hapësirat etnike shqiptare. Onomastika, si degë e gjuhësisë, përbën një ndër shtresat gjuhësore me vlerë të paçmuar për historinë dhe gjuhën e një etnie. Për këtë arsye studimi i emrave të përveçëm të njerëzve dhe i emërtimeve të vendeve merr një rëndësi të veçantë.

Qëllimi i studimeve onomastike ka një natyrë të dyfishtë: nga njëra anë synon të vendosë lidhjen e emrave dhe të emërtimeve të përveçme me bashkësinë që i përdor dhe nga ana tjetër synon të vendosë lidhjen e këtyre emërtimeve me leksikun e përgjithshëm të gjuhës. Në rastin e parë studimi jep të dhëna për prejardhjen e popullsisë së një etnie, për historinë e saj, për mënyrën e punës dhe të jetesës, për zakonet, veçoritë e relievit të saj etj.

Studimi i lidhjeve të emrave të përveçëm vetjakë e familjarë dhe të emërtimeve të përveçme me leksikun e përgjithshëm ka si detyrë të përcaktojë shkallën e pasqyrit të thesarit leksikor të një etnie në onomastikën e saj, por dhe mënyrën dhe nivelin e pasqyrit të leksikut onomastik në fjalorët shpjegues apo të llojeve të tjerë në një gjuhë.

Krahasimi i pasurisë leksikore në kohë të ndryshme, pasqyruar në fjalorë të llojeve të ndryshme, veçanërisht në ata shpjegues të gjuhës shqipe, nxjerr si domosdoshmëri pajisjen me koncepte të qarta gjuhësore, sa dhe si janë marrë në konsideratë kriteret e ndryshme, të cilët kanë evoluar së bashku me zhvillimin e pasurimin e njohurive teorike për gjuhën në përgjithësi, leksikologjinë, e brenda saj, leksikografinë në veçanti.

Në këtë aspekt kemi parë të nevojshme sjelljen në vëmendje të koncepteve teorike për dallimin e emrave të përveçëm nga apelativët, apo funksionet apelative të prejardhura të emrave të përveçëm, gjë që, e parë nga këndvështrime të ndryshme, ka sjellë edhe ndryshimin, pasurimin apo bjerrjen e fjalësit të gjuhës, të pasqyruar në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, që nisin me të parin fjalor shpjegues të saj, “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954.

Brenda emrave të përveçëm, kategoria e emrave vetjakë përbën një pjesë të mirë të tyre në gjuhë, megjithëse teorikisht ata hyjnë si një e tërë në grupin e emrave të përveçëm. Në librin “Fonetika dhe gramatika e gjuhës shqipe”, botim i UT, përcaktimi teorik i emrave të përveçëm është bërë në mënyrë të tillë: “fjalë që emërtojnë njerëz, kafshë dhe sende të veçanta, individuale, të dalluara nga njerëzit, kafshët dhe sendet e së njëjtës klasë”.<sup>97</sup> Me gjithë këtë përcaktim, me gjerësi përfshirjeje e i prerë, ende nuk pretendohet se ka një mendim të njëzuar për thelbin e kësaj kategorie emrash. Kjo është arsyeja që sa herë shkruhet për emrat e përveçëm, jepet një karakterizim perifrastik i përcaktimeve që janë dhënë për këtë kategori emrash në kohë të ndryshme.

Në një shikim të historisë së trajtimit të këtyre emrave që nga kohët e lashta e deri më sot, nuk kanë munguar përpjekjet për të rrokur thelbin e emrit të përveçëm, bile, në ndonjë rast, ka pasur edhe pohime krejt të ndryshme e madje të kundërta. Por ne nuk do të ndalemi te evidentimi i këtyre përcaktimeve në mënyrë kronologjike. Në gjithë këto përpjekje detyra më e vështirë ka qenë të përcaktohej specifika e kuptimit të emrit të përveçëm. Kjo ka ndodhur se deri vonë ky problem shihej jo aq gjuhësor sesa logjik, ndaj me të u morën logjicienë e filozofë.

Logjicienët i kushtuan më shumë vëmendje atij që mund ta quajmë kuptim fjalori të emrit dhe shumë pak u morën me kuptimin e tij kontekstual, në situatën konkrete në të cilin ai shqiptohet a shkruhet. Ndërsa kur çështjen e përcaktimit të thelbit të emrit të përveçëm dhe të dallimit të tij nga emri i përgjithshëm e trajtuan gjuhëtarët, nxorën në pah karakterin më abstrakt të emrit të përgjithshëm në krahasim me karakterin më konkret të emrit të përveçëm.

Prof. Çlirim Bidollari, që është marrë me studimin e kësaj kategorie emrash, në SF. nr.1, 2000, shprehet se: “antroponimet dhe toponimet dallojnë rrënjësisht prej emrave të

<sup>97</sup> Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotmeshqipe, II, Tiranë, 1976, f.56.

përgjithshëm, pasi këta të fundit, si pjesë e leksikut të përgjithshëm, kanë funksion përgjithësues, klasifikues, duke u përdorur për një numër të madh frymorësh ose jo frymorësh të së njëjtës klasë. Kurse emrat e përveçëm dhe emërtimet e përveçme kanë si funksion themelor thjesht shënimin, individualizimin e frymorëve dhe të objekteve, vënien e një etikete çdonjërit prej tyre, me qëllim që individi apo objekti i emërtuar të identifikohet e të dallohet me lehtësi prej individëve apo objekteve të tjera të asaj klase.<sup>98</sup>

Por karakteri konkret i emrit të përveçëm nuk duhet vënë në lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën unike të objektit. Një natyrë e tillë i jep të drejtë objektit të ketë emrin e vet. Por i njëjti emër mund të shërbejë për të shënuar disa objekte. E rëndësishme është që të gjithë ata të mendohen si individualë.

Emrat e përgjithshëm nënkuptojnë emërtimin e koncepteve për klasa frymorësh e objektesh, ndaj përmbajtja e tyre mund të ndryshojë me ndryshimin e koncepteve që ata shënojnë. Ndërsa emrat e përveçëm, meqë nuk shënojnë koncepte, nuk kanë as përmbajtje, kështu që ndryshojnë më pak e më ngadalë, pasi nuk kanë arsye të brendshme gjuhësore për ndryshim e tyre. Kjo shpjegohet me faktin se këta emra nuk kanë lidhje të ngushtë me frymorët dhe objektet që emërtojnë, pasi shërbejnë thjesht si etiketa për dallimin e një individi apo të një grupi, nga individët apo grupet e tjera. Por kjo nuk do të thotë se ata janë përjetësisht të pandryshueshëm. Ata mund të ndryshojnë për shkaqe nga më të ndryshmet si, për shkak të modës, shkaqe politike, ideologjike etj.

Mirëpo, edhe kur ndikimi i faktorëve të mësipërm është shumë i fortë, një numër i madh antroponimesh, sidomos ato që lidhen me anë të qenësishme të një bashkësie gjuhësore, me mënyrën e jetesës së saj dhe me kulturën materiale e shpirtërore, ruhen të paprekura. Kjo është arsyeja që antroponimet përbëjnë një nga shtresat gjuhësore me interes të veçantë për të provuar përkatësinë etnike të një grupi i caktuar etnik. Këto emërtime me kalimin e kohës mund të pësojnë ndryshime fonetike. Duke u transmetuar nga njëri brez në tjetrin emrat e përveçëm të njerëzve dhe emrat e vendeve pësojnë ndryshime nën veprimin e rregullave fonetike të gjuhës së cilës i përkasin.

Veç këtyre ndryshimeve spontane dhe të pavetëdijshme të formës, ka dhe ndryshime që ndodhin si rezultat i përpjekjeve të vetëdijshme të bashkësisë së cilës i përkasin këto emërtime. Kjo ndodh edhe për faktin se emrat vetjakë, emrat e familjeve dhe toponimet janë vendosur arbitrarisht, jo nga thelbi i objektit. Duke mos pasur lidhje të ngushtë me objektet që emërtojnë, ata i nënshtrohen ndërhyrjes së njeriut i cili, në mënyrë të vetëdijshme, mund t'i ndryshojë dhe t'i zëvendësojë me emërtime të tjera. Kësaj ndërhyrjeje i nënshtrohen emrat e përveçëm vetjakë, por, ndonëse më pak, edhe patronimet dhe toponimet.

---

<sup>98</sup> Bidollari, Ç. SF, nr.1, Tiranë, 2000.

Sot në teorinë e përgjithshme të emrit të përveçëm, gjithnjë e më shumë po futen në punë përkufizime të ndikuara nga degët e reja të shkencës gjuhësore të tilla si stilistika gjuhësore dhe gjuhësia e tekstit. Megjithatë edhe këtu duhen bërë dallime në tri drejtime:

- **Së pari**, duhet dalluar midis emrit të përveçëm në funksionin e tij referencial dhe emrit të përveçëm si autonom, d.m.th. si lemë në fjalor. (Emri Bora i vihet një personi femër).
- **Së dyti**, mund të thuhet që lema e përveçme merr shpesh funksione apelative të prejardhura. (Ka shumë Bora në qytet).
- **Së treti**, emri i përveçëm dallohet nga i përgjithshmi, sepse ky i fundit u referohet entiteteve jashtëgjuhësore nëpërmjet kuptimit të tij leksikor klasifikues, ndërsa emri i përveçëm i referohet në mënyrë të përkohshme një entiteti të caktuar, ndonëse ky entitet mund t'i përkasë një lloji të veçantë.

Ndaj në konkluzion të përcaktimeve teorike janë përcaktuar dhe kriteret për dallimin e emrave të përveçëm nga apelativët si:

- Emrat e përveçëm nuk kanë kuptim leksikor.
- Emrat e përveçëm kanë më shumë kuptim se apelativët.
- Emrat e përveçëm janë arbitrare.
- Emrat e përveçëm janë individualë.<sup>99</sup>

Siç del edhe nga konkretizimi i idesë së individualitetit të emrit të përveçëm, ky kriter mbështetet vetëm në një kategori të caktuar të emrave të përveçëm, e pikërisht të emrave vetjakë. Gjuhëtari A.Gardiner arbitraritetin e quan kriter dallues kryesor, kur kalon në shqyrtimin e emrave të familjeve, të mbiemrave, por mbiemrat nuk i quan arbitrare deri sa kalojnë automatikisht nga i ati tek i biri. Ndaj ai propozon që emrat e familjeve apo mbiemrat të ndahen në një klasë më vete dhe të quhen emra apelativo-të përveçëm.

Duket qartë se një kriter i tillë, që nuk arrin të mbulojë të gjithë klasën e emrave të përveçëm, por vetëm një kategori të caktuar të tyre, nuk mund të formulohet si kriter i përgjithshëm dallues. Edhe më i vështirë e i ndërlikuar bëhet problemi kur vijnë në vështrim krahas antroponimeve edhe toponimet. Kuriloviç në artikullin: “Pozicioni i emrit të përveçëm në gjuhë” shkruan: “emra të tillë të përveçëm si Servantes, Napoleon Mont Blank, ndryshe nga emra të tillë si ujk, dru ose qytet, përfaqësojnë klasa që përbëhen nga një objekt”.<sup>100</sup>

Dihet që antroponimet (emrat vetjakë e mbiemrat) i takojnë një sistemi që bazohet në parimin e hierarkisë, kurse toponimet bëjnë pjesë në një sistem që bazohet në parimin e

---

<sup>99</sup> Sorensen, H. The meaning of proper Names With a Definien names in Modern English, Copenhagen, 1963, f. 89.

<sup>100</sup> Kuriloviç, I. La position linguistique du nom propre, Onomastika, II, Wroclaw, 1956, f.1-14).

koordinimit. P.sh. emri i përveçëm Naim që është i lidhur ngushtë me një individ konkret, parimisht nuk mund t'i vihet një individ tjetër, sepse emri i përveçëm emërton në vend që të shënojë si apelativët (emrat e përgjithshëm). Megjithatë nuk është parimisht e pamundur që një emër t'i vihet edhe një individ tjetër, përndryshe do të kishim aq emra sa kemi edhe njerëz.

Në qoftë se onoma (emir i përveçëm) është fjalë, d.m.th. njësi themelore e gjuhës, ajo duhet të ketë edhe të gjitha tiparet e fjalës: të ketë një theks kryesor, të ketë kuptim, përkatësi leksiko-gramatikore dhe të jetë e padepërtueshme, pra e formësuar si një fjalë.

Për nga përkatësia leksiko-gramatikore onoma futet në kategorinë e emrit. Emri si kategori shenjuese karakterizohet nga kategoria leksiko-semantike e sendësisë. Prandaj kuptimi kategorial i sendësisë është i pranishëm edhe tek onoma, edhe tek antroponimi. Kjo sendësi, si të gjithë emrat, tek onomat realizohet në formën e gjinisë, të numrit, të rasës etj.

Antroponimia ka edhe kuptimin e vet të posaçëm leksiko-semantik, që e dallon nga grupet e tjera onomastike. Ky kuptim përcaktohet nga karakteri i objektit me të cilin ka të bëjë onoma-antroponim. Meqenëse onomastika është një nënsistem (sociolinguistik) i leksikut edhe funksionimi i onomas (antroponimit) nuk kufizohet vetëm në shenjimin e një personi siç ndodh vetëm me apelativët që vetëm e shenjojnë një person si: vëlla, student etj. Pra, me gjithë përpjekjet e gjuhëtarëve për të përcaktuar kufirin midis emrit të përveçëm dhe atij të përgjithshëm, ende nuk është arritur në një rezultat të pranueshëm nga të gjithë.

## 7.2 VENDI I ETNONIMEVE NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPES

Në gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, duke filluar që nga “Fjalori i gjuhës shqipe”, 1954 e deri te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, nuk gjejmë si njësi më vetë të shpjeguar fjalën etnonim. Shpjegimi për të është bërë në njësinë leksikore :

**Etni**, bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në një truall të caktuar, e cila ka një gjuhë dhe kulturë materiale e shpirtërore të njëjtë.

**etnik** (mbiemër): “që lidhet me një popull a me një komb të caktuar dhe me kulturën materiale e shpirtërore të tij. Bashkësi etnike, emër etnik, përbërje etnike e popullsisë.<sup>101</sup>

Termi etnonim që po përdorim në këtë punim, duhet të merret në kuptimin që i jep atij Dionis Trakasi: “Etnonimi është një emër që tregon nacionalitetin (etnosin) si p.sh. Frigas, Galateas...”. Ky do të ishte edhe emërtimi i motivuar më saktë për këto lloje etnonimesh po të mbajmë parasysh se, në Greqinë e lashtë , qytetërimi “polis” nuk njihje përmasë më të madhe. (ashtu sikurse gjuhësia shqiptare etnonimin arbër, shqiptar).

Me kalimin e kohës dhe me përsosjen e organizimit të shoqërisë, ky kuptim kaq strikt për objektin që emëronte, filloi të zgjerohej dhe të nënkuptonte çdo emërtim që shenjonte një njeri sipas vendit, qoftë ky vendi i lindjes, i banimit apo edhe i një prone. Një përkufizim më të përafërt, që shpreh përdorimin e sotëm në emërtimin e banorëve sipas përkatësisë së vendit të lindjes apo banimit, ndryshe nga fjalorët tanë shpjegues që, për këtë fjalë, shpjegimi ka një nivel më të lartë përgjithësimi, ka dhënë në fjalorin e tij Rikard Simeoni ku fjalën etnike shpjegon: “emër për emrin e banorëve të një vendbanimi, zone, vendi ose shteti; p.sh. zagrebas-është etnik nga Zagrebi...”.

Pavarësisht se mungon në fjalorët shpjegues, në studimet shqiptare në fushë të onomastikës, etnonimi ulet edhe në shkallë krahinore e deri në nivel vendbanimesh, qytetesh apo fshatrash, gjë që pasqyrohet edhe në fjalorë enciklopedikë. Për kuptimin e ngushtë që u jep atyre Dionis Trakasi sot në literaturën e specializuar të greqishtes përdoret më shumë termi patridhonimika (emra atdheu).

Në literaturën që ka përdorur Prof. Eqrem Çabej edhe trajta “etnika” sipas gjedhës “topika”, “patronimika” etj. është përdorur gjithmonë me një përmbajtje më të gjerë e më të çlirët të një emërtimi të formuar nga një emër vendi, që mund të jetë një emër krahine, qyteti, fshati etj. Duke tërhequr mbi vete edhe një karakterizim të tillë si: emra etnikë, mbiemra etnikë e më shpesh si identifikues a karakterizues toponimikë e duke u formuar nëpërmjet mbiemërzimit të emrave të vendeve (shqiptar<Shqipëri, Italian<Itali etj.).

---

<sup>101</sup> FGJSH, 2006, f.252



Kjo dukuri, që ne këtu po e quajmë, për nevoja terminologjike të këtij studimi, por edhe për një saktësi më të madhe: etnonimizim të toponimit, ndodh me të gjitha kategoritë e etnonimeve, dhe jo vetëm në gjuhën tonë. Pasi kanë qenë njëherë onoma, emërtime si toponime, ato shndërrohen në etnonime, jo më për të shenjuar një vend, por një person që përgjithësisht ka lidhje me atë vend.

Shqiptarët asnjëherë nuk e kanë ndërprerë bartjen e emrave vetjakë, në trajtë etnonimi dhe toponimit të mjedisit të tyre kudo që kanë shtegtuar brenda trojeve shqiptare, ose edhe kur shtegtonin jashtë këtyre trojeve. Në gjuhën shqipe ky process etnonimizimi kryehet në dy mënyra: me mjete morfologjike, duke i shndërruar ata në mbiemra etnikë (Tiranë-tiranas, Berat-beratas, Mallakastër-mallakastriot, Osmënzezë-osmënzezaz.), gjë që u jep atyre të drejtë të bëhen pjesë, qoftë dhe periferike (anësore), e leksikut të shqipes dhe si të tillë të gjejnë pasqyrim në fjalësat e fjalorëve shpjegues e dygjuhësh të saj, duke u përcaktuar përmasa e këtij pasqyrimi nga shumë faktorë, midis të cilëve peshën më të madhe e mbajnë kriteret profesionale leksikografike.

Por duke qenë fjalorët vepra që regjistrojnë një gjendje të caktuar të leksikut të gjuhës dhe duke pasur si mënyrë leximi “konsultimin” lejojnë edhe shmangie nga kriteret profesionale, sepse leksikografia, teknika tradicionale e hartimit të fjalorëve, punon mbi bazën e unitetit të trajtimit leksikografik, shpesh mjaft larg njësisë leksikore të përcaktuar nga leksikologjia si shkencë më e re dhe më e rreptë.

Por fjalori nuk mund t’i shpëtojë arbitraritetit për shumë arsye, dhe nga ky arbitraritet ka rezultuar edhe ajo gjendje aspak uniforme brenda prodhimit leksikografik të shqipes, që mund të përshkruhet si gjendje e bardhë, zero, nga pikëpamja e pasqyrimin të këtij leksiku. Këtë problematikë mund ta konstatosh fare lehtë duke shfletuar fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe që, megjithëse të paktë e jo të larmishëm si tipa, e të hartuar në një shtrirje kohore jo më shumë se një gjysmë shekulli, nuk kanë mundur ta stabilizojnë gjendjen që do të duhej të ishte.

Nga pesë fjalorët shpjegues të shqipes (“Fjalori i gjuhës shqipe” 1954; “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980; “Fjalori i shqipes së sotme” 1984; “Fjalori i shqipes së sotme” 2002, dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006), vetëm ai i vitit 1984 meriton të veçohet si përpjekje e parë, por edhe ajo e ndërprerë, për të dhënë një gjendje të re në këtë fushë. Ky fjalor, megjithëse nuk sjell ndonjë ndryshim të dukshëm në fjalësin e përgjithshëm (apelativ), ka meritën që në trajtë shtojce, sipas modeleve të fjalorëve të huaj, i jep lexuesit edhe një informacion enciklopedik që ka të bëjë me gjeografinë, historinë, etnografinë e popullit që e flet shqipen dhe që realizon në këtë mënyrë detyrën e fjalorit për t’i dhënë përdoruesit të tij edhe mjeshtërinë e shprehjes dhe të ngrejë nivelin kulturor të tij. Madje grupi hartues e ka parë të udhës ta paralajmërojë lexuesin se në të kanë zënë

vend (ndryshe nga dy fjalorët shpjegues para tij 1954, 1980) edhe një numër jo i vogël emrash e emërtimesh që janë ndarë në tri rubrika:

1. Emra gjeografikë, emërtimet e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe mbiemrat që lidhen me to.
2. Shkurtime e shkurtesa.
3. Shkurtesat e targave të automjeteve.

Kur pohuam më sipër se gjendja paraqitet shumë e larmishme dhe jo uniforme, patëm parasysh tri burime leksikografike mjaft të ndryshme njëra nga tjetra, fjalorë që kanë pasqyruar fjalësin onomastik, si “Fjalori i gjuhës shqipe” 1984, “Fjalori i arbëreshëve të italisë”, 1963, i P.Kolombos, dhe “Fjalori shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip”, Hamburg, 1991, i A.Hetzer, në pjesën e parë të tij, nga buron edhe lënda e fjalësit, pra gjuha shqipe, me brumin e së cilës është formuar ky fond emërtimesh.

I nisur nga ideja që në fjalor, sidomos dygjuhësh, duhet të dalin veçantitë e një gjuhe që ballafaqohet me një tjetër gjuhë, autori gjermano-albanolog ka “provokuar” edhe një dilemë tjetër duke dhënë në fjalor dhjetë ekuivalenca emrash vetjakë shqip-gjermanisht si (Andon-Anton, Gjergj-Georg, Gjon-Hans-Johannes, Mehmet-Mohamed, Memo-Mehmet, Pal-Paul, Rrapo-Raphael, Skënder-Alexandër- Skander, Shtjefën-Stephan, Pjetër-Petër). Natyrisht me këto dhjetë çifte emrash vetjakë shqip-gjermanisht (në fakt nëntë çifte, sepse një çift Memo-Mehmet është brenda shqipes) nuk është zgjidhur çështja e një nevojë që kanë fjalorët shpjegues të shqipes për të pasqyruar edhe një informacion të tillë, por ndërkaq, është dhënë ngacmimi për leksikografët, se ka ardhur koha, që edhe kjo kategori emrash të gjejë vend në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe në trajtën e njohur të shtojcave, për të plotësuar një nevojë që e ndien veçanërisht përdoruesi i huaj i fjalorit shpjegues të shqipes, sidomos për faktin se veç fjalorit nuk kanë në dorë ndonjë doracak tjetër.

Informacioni që japin këta emra për identitetin fetar të shqiptarëve, nëse s’do të arrinte të plotësonte një kërkesë të të interesuarëve për gjuhën tonë, të paktën do të ngacmonte kureshtjen e një kërkuesi informacioni që mund të shndërrohet në shtysë për të shfletuar edhe më tepër, për të njohur historinë e kulturën e popullit tonë. Në kontekstin e integritit, ne kemi nevojë për t’u identifikuar sa më saktësisht në të gjitha vlerat tona, kur edhe të tjerët nuk janë të paineresuar për ta njohur.

Qysh në takimin e parë që ka pasur shqipja me një gjuhë tjetër, si latinishtja, në fjalorin e Frang Bardhit: *Dictionarium latino-epiroticum*, është ndier nevoja nga autori i tij, me një vëllim modest të veprës, që të përfshihet në të edhe një lëndë e tillë si emërtime gjeografike (Africa-Afrika, e treta pjesë e sekulit (Botës); Albania-Arbëni; Babilonia-

Bagdat; Byzantium-Stamboll; Constantinopolitanus-Instambolas.<sup>102</sup> Duke qenë i pari në serinë e fjalorëve të shqipes, që e ballafaqojnë këtë gjuhë me gjuhë të tilla si latinishtja, gjuhë e kultivuar kulture, me status dukshëm më të lartë, ky fjalor nuk na jep mundësi të bëjmë vlerësime shkencore objektive edhe për një arsye tjetër, sepse ky fjalor ndahet gati me tre shekuj nga fjalori pasues, “Fjalori i gjuhës shqipe” i Kristoforidhit, Athinë, 1904. Neve na intereson këtu më shumë si pikëmisje jo vetëm në hartimin e fjalorëve dygjuhësh, por edhe si zanafillë e pasqyrimin të asaj kategorie emërtime, që janë bërë objekt i studimit tonë, edhe në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, pasi po të marrim në shqyrtim ndonjë fjalor të veçantë nga natyra e tij, si p.sh. “Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja”, Prishtinë 1986, me autor M.Ndrecën, ku ka një numër të madh emrash vetjakë me prejardhje nga gjuhë të tjera (hebraishte, greqishte e lashtë, latinishte, persishte, arabishte, turqishte etj), të cilët i ka trajtuar njësoj si fjalët e shprehjet e huaja në shqipe, shoqëruar madje me një përpyetje për t’i zëvendësuar me emra të formuar me brumin e shqipes, po ashtu si fjalët e shprehjet nga gjuhë të tjera, dhe “Fjalor i orientalizmeve të shqipes” Tiranë 2005, me autor T.Dizdarin, ku krahas fjalëve orientale (perse, arabe, turke), merren në vështrim edhe shumë emra vetjakë të kësaj prejardhjeje, mund të bindemi se lënda e pasqyruar në fjalorë me natyra të ndryshme bëhet e paklasifikueshme sipas kritereve teorike-shkencore të leksikologjisë.

Po kështu “Fjalori i arbëreshëve të Italisë”, veç dy shtresave të pranuar edhe në fjalorë të tjerë: emrat e njerëzve dhe emra gjeografikë e toponime, jep edhe një listë me emra fshatrash të themeluar nga emigrantë shqiptarë në Italinë e Jugut, brenda të cilit jepet një informacion i detajuar (emri italisht krahas atij shqip, provinca, dioqeza, gjuha që përdorin banorët dhe numri i tyre). Për të dy fjalorët e mësipërm (të Hetzerit dhe Kolombos) do të flasim në një kapitull më vete.

Një faktor që luan një rol mjaft të rëndësishëm për përmbushjen e funksionit akulturues të fjalorëve është edhe destinacioni i fjalorit, që kushtëzohet nga disa faktorë që kanë të bëjnë me mungesën e një informacioni të përgjithshëm për gjuhën e kulturën e popullit që e flet. Meqenëse fjalori perceptohet si një objekt kulture e libër tavoline i pamungueshëm, hartuesi i tij mund të kapërcejë dilema e të kalojë në informacione krejt specifike, që i gjykon të domosdoshme për veprën që është duke hartuar.

Gjendja e përshkruar më lart nuk të lejon të flasësh për një traditë të ngulitur në këtë fushë, prandaj edhe detyra e këtij punimi do të kufizohet në disa këshillime për të “themeluar” një traditë, duke marrë përsipër që qerthulli i çështjeve për t’u zgjidhur të formohet si rezultat i monitorimit të gjendjes së prodhimit leksikografik të derisotëm me

---

<sup>102</sup> Bardhi, F. Fjalor latinisht-shqip, Roma, 1635.

një bankë të dhënash të varjueshme sipas atyre veçantive të fjalorëve që u përmendën më sipër.

Grupi hartues i “Falori i shqipes së sotme”, 1984, është shprehur që në parathënie se në vepër lexuesi do të gjejë edhe emërtime të njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe mbiemra që lidhen me ta, banorët e shteteve kryesore të botës, të krahinave, qyteteve e disa fshatrave të Shqipërisë, ose të banuara nga shqiptarët. Me kufizuesit kryesorë dhe disa të përdorur në këtë pohim, buron edhe problemi i vëllimit të lëndës që do të gjejë pasqyrim në fjalor, që mbetet i tillë, pra problem, kur hartuesit në procesin e hartimit të fjalorit i duhet të kapërcejë dilema, sepse është lehtë ta pohosh në parathënie disa fshatra ose shtete kryesore, por në procesin hartues kjo dilemë nga pamja: të gjithë apo disa fshatra, të gjithë shtetet e botës apo shtetet kryesore të botës merr një pamje tjetër e pikërisht : cilët fshatra do të përfshihen e cilët jo, cilët shtete të botës do të përfshihen e cilët jo. I vënë para një dileme të tillë hartuesi i fjalorit të gjuhës shqipe, pa një model brenda shqipes (sepse nga tradita botërore ai mund të zgjidhë vetëm dilemën teorike, por jo atë praktike që ka të bëjë me lëndën e shqipes) do të tërhiqet më shumë nga dëshira për të paraqitur të plotë lëndën sesa nga kriteri, sidomos kur ai është i papërcaktuar.

Për rastin e gjuhës sonë është fjala për një repertor prej rreth 2000 emërtime banorësh, sepse prej rreth 700 emra të vendbanimeve të tipit fshat nuk formohen emërtime banori me trajtë të mbiemërzuar. Shtrohet problemi se këto 2000 njësi duhet të integrohen në fjalësin e fjalorit, duke u konceptuar qoftë edhe fjalor periferik me një zgjidhje të pranueshme, apo nuk duhen pasqyruar plotësisht. Mbledhja, evidentimi e pasqyrimi i leksikut onomastik, vendas e të huaj, në fjalorët e ndryshëm, por veçanërisht në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, kanë vlerë për njohjen dhe rifreskimin e kujtesës qytetare për këtë fjalës.

Në tekstin “Onomastikë dhe etnolinguistikë” prof. Gj.Shkurtaj në onomastikë dallon dy grupe të mëdha emrash:

- Emrat e njerëzve apo emrat vetjakë (antroponimet) dhe emrat familjarë përkatës të tyre (patroniet)
- Emrat e vendeve, toponimet, me llojet e ndryshme të tyre si: oikonimet (emrat e vendeve të banuara si qytete, fshatra etj.), etnonimet (emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nënndarjet e ndryshme administrative e shoqërore të ndryshme), hidronimet (emrat e liqeneve, deteve, lumenjve, përrenjve etj.), oronimet (emrat e maleve, fushave, kodrave etj).<sup>103</sup> Në një analizë që u kemi bërë toponimeve në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe vërejmë se rrethi i makrotoponimeve, sidomos

---

<sup>103</sup> Shkurtaj, Gj. Onomastikë dhe etnolinguistikë, Tiranë, 2001, f.13-14.

me studimet e shumta e me shtimin e numrit të fjalorëve me fjalës të evoluar, ka kaluar shumë përtej kufijve kombëtarë, duke e pasuruar këtë fjalës me emrat e kontinenteve, të shteteve, kryeqyteteve e qyteteve kryesore të tyre.

Makrotoponimet dhe emrat etnikë që shënojnë banorin e krahinave, qyteteve e fshatrave të Shqipërsë, apo banorët e shteteve e qyteteve të ndryshme të botës, përdorimet mbiemërore të tyre, emërtimi i gjuhëve dhe përdorimet ndajfoljore, janë ato që kanë gjetur vend pasqyrimi në fjalorët shpjegues të shqipes si dhe në disa fjalorë dygjuhësh. Ajo që të bie në sy është diferenca e madhe e fjalësit onomastik pasqyruar nga “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, me fjalësin e pasqyruar në fjalorët e mëvonshëm shpjegues, si dhe mënyrat e ndryshme të pasqyrimin të tyre, kjo për arsyen e thjeshtë, se në fjalorët shpjegues zgjidhjet janë konvencionale, nuk ka kritere rigorozë për toponimet, pasi ato janë karakteristike për fjalorët onomastikë.

Por nevoja për informacion është ndikim i drejtpërdrejtë për pasqyrimin e tyre, sepse dihet që në një fjalor shpjegues normativ, krahas normativitetit, ka edhe informim, gjë që fjalorët shpjegues të shqipes e kanë pasqyruar në mënyra të ndryshme dhe kanë dhënë informacion të ndryshëm, me tendencë zgjerimi nga njëri fjalor në fjalorin pasardhës shpjegues, në raport kjo edhe me shtimin e fjalësit të përgjithshëm të tyre. Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe kanë gjetur pasqyrim në fjalësin e përgjithshëm të tyre këto njësi onomastike: emri etnik i banorit, mbiemri, gjuha ose të folmet dhe përdorimi si ndajfolje. Këtu bën përjashtim vetëm “Fjalori i shqipes së sotme”, 1984, i cili ka gjetur formën e shtojcës, e në këtë mënyrë hapësira e fjalësit onomastik është disa herë më e madhe se në fjalorët e tjerë shpjegues të botuar para dhe pas tij. (rreth 25 herë më shumë se i 1954-ës, rreth 6 herë më shumë se i 1980-ës, dhe rreth 5 herë më shumë se ai i 2006-ës).

### **7.2.1 FJALËSI ONOMASTIK NË “FJALORIN E GJUHËS SHQIPE” 1954**

“Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, me një fjalës të përgjithshëm rreth 25000 fjalë, në hapësirat e tij ka gjetur vend për 131 njësi onomastike, nga të cilat vetëm 14 njësi janë fjalë që kanë përkatësi shqiptare si: arbëror/e, arbërisht, bregdetas, bregdetar, labërisht, labërishtja, shqip, shqiptar/e, shqiptarçe, toskërisht, toskërishtja, gegërisht, gegërishtja dhe 117 fjalë u përkasin përdorimeve për gjuhë të vendeve të tjera si: afrikan, amerikan, anglez, anglisht, arabisht, aziatik, frëng, frëngjisht, japonez, japonisht, spanjoll, spanjisht, spanjishte, turke, turqisht etj. Nga numri i përgjithshëm i fjalësit onomastik 6 njësi janë hidronime si: arktiku, arqipelag (grumbuj ishujsh), gadishull, oqean, bregdet, det, ndërsa 125 njësi janë: emra etnikë 2, përdorime si mbiemra 76, ndajfolje 29 dhe emërtime gjuhësh apo të folmesh 24 njësi.

FJALËSI ONOMASTIK NË “FJALORIN E GJUHËS SHQIPE” 1954.

Nr.	Shkronja	Numri i fjalëve	FJALËSI ONOMASTIK				
			Emra etnonimikë	Mbiemra	Ndajfolje	Gjuhë dhe të folme	Gjithsej
1	A	884	-	13	2	-	15
2	B	1245	2	5	1	-	8
3	C	282	-	-	-	-	-
4	Ç	480	-	3	2	1	6
5	D	1088	-	2	-	-	2
6	DH	145	-	-	-	-	-
7	E	321	-	5	-	-	5
8	Ë	18	-	-	-	-	-
9	F	865	-	2	1	1	4
10	G	719	-	2	1	1	4
11	GJ	384	-	1	1	1	3
12	H	653	-	2	2	1	5
13	I	290	-	6	1	2	9
14	J	151	-	2	1	1	4
15	K	2531	-	5	-	-	5
16	L	1045	-	5	2	3	10
17	LL	141	-	-	-	-	-
18	M	1692	-	4	-	-	4
19	N	963	-	1	1	-	2
20	NJ	128	-	-	-	-	-
21	O	207	-	3	-	-	3
22	P	2993	-	2	2	2	6
23	Q	478	-	-	-	-	-
24	R	541	-	3	2	3	8
25	RR	468	-	-	-	-	-
26	S	1206	-	6	4	5	15
27	SH	1502	-	1	2	1	4
28	T	1198	-	2	3	2	7
29	TH	244	-	-	-	-	-
30	U	277	-	-	-	-	-
31	V	1015	-	1	1	-	2
32	X	46	-	-	-	-	-
33	XH	100	-	-	-	-	-
34	Y	19	-	-	-	-	-
35	Z	559	-	-	-	-	-
36	ZH	157	-	-	-	-	-

Pra, siç shihet, emrat etnikë nuk kanë gjetur pothuajse fare pasqyrim në “Fjalorin” e 1954-ës, ashtu sikurse edhe toponimet. Kjo mendojmë se ndodh për faktin se fjalori është më tepër i tipit filologjik, pra është më tepër fjalor kuptimesh e jo konceptesh, ndaj nuk janë të shumta informacionet enciklopedike si dhe në gjithë fjalorët e tjerë shpjegues të shqipes, përjashtuar atë të 1984-ës, i cili është pajisur dhe me një shtojcë ku kanë gjetur gjerësisht pasqyrim toponimet dhe emrat etnikë.

### **7.2.2 FJALËSI ONOMASTIK NË “FJALORIN E GJUHËS SË SOTME SHQIPE” 1980.**

Në përpunimin, më tepër statistikor, që po u bëjmë fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, ne mund të bëjmë një vlerësim pozitiv në aspektin e pasqyrimin të fjalësis onomastik për gjithë fjalorët shpjegues që vijnë pas “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954. I pari që jep shembullin e rritjes së numrit të fjalëve të fjalësis onomastik, është “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, megjithëse, në krahasim me fjalorin e mëparshëm, do të kishte më shumë, pasi ka një rritje që pasqyrohet vertikalisht në fjalësin e tij, duke arritur deri në rreth 41000 fjalë.

Në fjalësin e këtij fjalori gjenden 515 njësi onomastike, që përfaqësojnë 1.25% të gjithë fjalësit të tij. Pra, në krahasim me “Fjalorin” e 1954-ës, kemi një shtim prej 384 njësi, por edhe në raport me fjalësin e përgjithshëm është rritur pasha specifike e fjalësit onomastik. Fjalët onomastike në këtë fjalor kanë këtë ndarje: emra etnikë 205 fjalë, mbiemra 211 fjalë, ndajfolje 48 fjalë dhe gjuhë e të folme 51 fjalë. Nga gjithë fjalësi onomastik 22 njësi kanë përcaktimin fjalë historike. Numrin më të madh të njësive onomastike e zënë përdorimet mbiemërore me rreth 41%, si: abisinias, amerikan, anglosakson, arabik, hebraik, britanik, latin, sovjetik etj. Rritje këtu ka emri etnik me 205 njësi, kur në të parin pothuajse nuk ekzistonte (vetëm 2). Kjo është një risi tjetër e këtij fjalori shpjegues. Siç shihet, me zgjerimin e fjalësit onomastik, krahas atij të përgjithshëm, në këtë fjalor lexuesi gjen përgjigje edhe për elemente enciklopedike, krahas atyre gjuhësore.

FJALËSI ONOMASTIK NË “FJALORIN E GJUHËS SË SOTME SHQIPE” 1980.

Nr.	Shkronja	Numri i fjalëve	FJALËSI ONOMASTIK				Gjithsej
			Emra etnonimikë	Mbiemra	Ndajfolje	Gjuhë dhe të folme	
1	A	1851	27	24	5	6	62
2	B	2839	10	10	1	-	21
3	C	667	-	-	-	-	-
4	Ç	793	4	5	2	1	12
5	D	1969	5	5	2	1	13
6	Dh	238	-	-	-	-	-
7	E	534	9	7	2	2	20
8	Ë	52	-	-	-	-	-
9	F	1472	7	6	2	3	18
10	G	1442	7	7	2	3	19
11	Gj	756	4	4	1	1	10
12	H	968	6	7	2	3	18
13	I	421	8	9	1	5	23
14	J	278	3	5	1	1	10
15	K	3393	18	19	1	2	40
16	L	1637	12	16	4	3	35
17	Ll	217	-	-	-	-	-
18	M	2482	17	16	4	2	39
19	N	1478	4	5	1	1	13
20	Nj	332	-	-	-	-	-
21	O	282	4	4	-	1	9
22	P	4793	19	16	2	2	39
23	Q	712	2	2	-	-	4
24	R	865	3	3	2	2	10
25	Rr	752	-	-	-	-	-
26	S	1640	14	16	6	6	42
27	Sh	2632	3	4	3	2	12
28	T	1563	9	9	3	3	24
29	Th	372	-	-	-	-	-
30	U	417	4	4	-	-	8
31	V	1575	4	6	1	1	12
32	X	57	-	-	-	-	-
33	Xh	153	-	-	-	-	-
34	Y	59	-	-	-	-	-
35	Z	764	2	2	-	-	4
36	Zh	421	-	-	-	-	-



### 7.2.3 FJALËSI ONOMASTIK NË “FJALORIN E GJUHËS SHQIPE” 2006.

Me kalimin e kohës, me rritjen e mundësive të njohjes së hapësirave të lejuara e pa pengesa ideologjike të pasqyrimin, “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, si ruajtës në shkallën më të lartë të vlerave kryesore të fjalorëve të mëparshëm shpjegues të gjuhës shqipe, i ka krijuar hapësira më të mëdha fjalësit onomastik brenda fjalësit të tij të përgjithshëm jo vetëm në numër (618 njësi onomastike), por dhe si përqindje e këtij fjalësi duke përfaqësuar 1.3% të fjalësit të përgjithshëm me rreth 48000 fjalë. Në këtë mënyrë fjalori merr vlera më të mëdha praktike, krahas elementëve të tjerë që ia përcaktojnë këto vlera

Fjalët onomastike të përfshira në fjalësin e këtij fjalori kanë këtë ndarje:

- Emra etnikë 243 njësi onomastike ose 38 më shumë se i 1980-ës si *algjerian, anglez, angolas, armen, ganez, dibran, himarjot, irlandez, japonez, beratas, mirditor, oparak, peshtanak, shqiptar, ugandas etj.*
- Mbiemra 248 njësi onomastike ose 37 më shumë se i 1980-ës si: *amerikan, australian, ballkanik, britanik, myzeqar, mokrar, helenistik etj.*
- Gjuhë e të folme 62 njësi ose 14 më shumë se i 1980-ës si: *anglishte, frëngjishte, gegërishte, elbasanishte, holandishte, indishte, portugalishte, rusishte, toskërishte, shkodranishte etj.*
- Ndajfolje 65 njësi onomastike ose 17 më shumë se i 1980-ës si: *arabisht, arbërisht, arumanisht, gorarçe, myzeqarçe, shqip, toskërisht, turqisht etj.*

Edhe këtu numrin më të madh të fjalësit onomastik e zënë mbiemrat dhe pas tyre emrat etnikë, ndajfoljet dhe fjalët që emërtojnë gjuhë e të folme. Pra siç shihet, në fjalësin e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe nuk përfshihen emrat e vendeve, por vetëm emri i banorit që lidhet me të si dhe gjuha që flasin banorët e atij vendi. Kjo motivohet me faktin se toponimi, emri i vendit, nuk është emër i përgjithshëm, por i përveçëm. Detyrën për pasqyrimin e emrave të përveçëm do ta kryente më mirë një fjalor onomastik.

FJALËSI ONOMASTIK NË “FJALORIN E GJUHËS SHQIPE” 2006

Nr.	Shkronja	Numri i fjalëve	FJALËSI ONOMASTIK				
			Emra etnonimikë	Mbiemra	Ndajfolje	Gjuhë dhe të folme	Gjithsej
1	A	1751	24	25	5	5	59
2	B	1911	17	17	1	1	36
3	C	2868	1	1	-	-	2
4	Ç	892	2	2	2	2	8
5	D	1066	10	10	1	1	22
6	DH	2226	-	-	-	-	-
7	E	757	11	15	3	2	31
8	Ë	78	-	-	-	-	-
9	F	1870	4	4	2	2	12
10	G	1496	4	4	3	3	14
11	GJ	792	3	3	2	2	10
12	H	1135	7	7	4	4	22
13	I	657	10	11	6	6	33
14	J	367	3	6	1	1	11
15	K	3623	22	22	3	3	30
16	L	1930	16	13	4	6	39
17	LL	345	-	-	-	-	-
18	M	2723	23	25	4	2	54
19	N	1652	5	6	1	1	13
20	NJ	446	-	-	-	-	-
21	O	432	8	4	1	1	14
22	P	5112	17	17	4	4	42
23	Q	982	-	-	-	-	-
24	R	918	5	3	2	2	12
25	RR	1017	-	-	-	-	-
26	S	1945	17	18	8	8	51
27	SH	3267	6	6	4	2	18
28	T	1942	14	14	2	2	32
29	TH	461	-	-	-	-	-
30	U	488	5	5	1	1	12
31	V	1836	6	7	2	2	17
32	X	71	-	-	-	-	-
33	XH	179	-	-	-	-	-
34	Y	67	-	-	-	-	-
35	Z	1194	4	4	-	-	8
36	ZH	668	-	-	-	-	-

#### 7.2.4 FJALËSI ONOMASTIK NË “FJALORIN E SHQIPES SË SOTME” 1984

Ndryshe qëndron puna me “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984. Ky fjalor gjen zgjidhjen e shtojcës me titull: “Emrat gjeografikë, emërtimet e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe mbiemrat që lidhen me to”.

Në shtojcën e këtij fjalori gjenden gjithsej 3325 fjalë onomastike, nga të cilat 1036 janë emërtime nga vende të ndryshme të botës dhe 2289 janë të territorit të Shqipërisë e të territoreve të banuara nga shqiptarët brenda e jashtë kufijve shtetrorë. Për herë të parë në një fjalor shpjegues të shqipes ndryshon raporti i emrave toponimikë shqiptarë me të huaj në favor të emrave tanë.

❖ Emrat toponimikë të vendeve të tjera kanë këtë shpërndarje, sipas nënndarjeve të tyre:

- Oikonimet 346 njësi leksikore si: Aleksandri, Algjer, Amsterdam, Argos, Athinë, Bejrut, Berlin, Birmingham, Boston, Dublin, Dyseldorf, Kashmir, Oksford, Paris etj.
- Etnonime 564 njësi leksikore si: Afganistan, Algjeri, Argjentinë, Bangladesh, Bregu i Fildishtë, Danimarkë, Egjipt, Finlandë, Ganë, Honduras, Islandë, Turqi, Zambia etj.
- Hidronime 69 njësi leksikore si: Atlantik, Amazona, Balaton, Danub, Deti i Zi, Ebro, Egje, Kaspik (deti), Mesdhe, Oqeani Indian, Paqësor, Vollga etj.
- Oronime 57 njësi leksikore si: Alpet e Evropës, Andet, Apeninet, Himalajet, Dardanelet, Everest, Pirenej, Kilimanxharo etj.

❖ Toponimet shqiptare me 2289 njësi leksikore kanë këtë shpërndarje në Fjalor:

- Oikonime 812 njësi leksikore si: Agim, Aranitas, Baldushk, Berat, Dajt, Delvinë, Dhërmi, Elbasan, Fier, Finiq, Glinë, Golem, Gjirokastër, Iballë, Kaçinar, Këlcyre, Korçë, Lezhë, Libohovë, Librazhd, Vlorë, Sarandë etj.
- Etnonime (së bashku me emrat atnonimikë), 1324 njësi leksikore si: shqiptar, gegë, toskë, arbër, bajramcurras, beratas, dropullit, devolli, myzeqar, mallakastriot, piluriot etj.
- Hidronime 42 njësi leksikore si: Adriatik, Bunë, Drin, Drin i Bardhë, Drin i Zi, Drino, Erzen, Fan i madh, Fan i vogël, Jon, Liqeni i Shkodrës, Osum, Shkumbin Vjosë etj.
- Oronime 111 njësi leksikore si: Alpet e Shqipërisë, Bjeshkët e Kushnenit, Çajup, Fusha e Korçës, Fusha e Myzeqesë, Gryka e Këlcyrës, Gramoz, Jezercë, Korab, Qafa e Kërrabës, Munellë, Rrafshi i Dukagjinit, Trebeshinë etj.

Siç shihet, në “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, në pjesën shtojcë të tij, kemi të pasqyruara toponimet në të gjitha nënndarjet e tyre, oikonime, etnonime, hidronime dhe oronime. Ne vëmë re se rrethi i makrotoponimeve në këtë fjalor ka kaluar përtej kufijve

**FJALORI I SHQIPES SË SOTME, 1984**

Shkronja	FJALËSI ONOMASTIK SHQIPTAR				FJALËSI ONOMASTIK I HUAJ			
	Oikonime	Emra dhe Mbiemra etnikë	Hidronime	Oronime	Oikonime	Emra dhe mbiemra etnikë	Hidronime	Oronime
A	1	5	1	1	10	37	4	7
B	7	26			11	49	4	2
C	20	36			17	27	6	2
Ç	25	37	4	5	13	22	1	2
D	26	46	1		7	10		
DH	25	43		5	2	17	1	1
E	32	56	5	1	6	2	8	2
Ë	15	36	1	1	6	9	3	
F	17	28	2	1	8	20	2	1
G	22	45		5	5	7	7	
GJ	31	50		8	2	14		1
H	21	33	2	1	5	14	1	1
I	17	34			5	35		1
J	11	18	1	2	9	25	5	
K	30	41		2	13	12	2	4
L	25	45	1	1	15	21	2	2
LL	33	56	1	2	5	7		
M	30	56	4	1	5	14	2	
N	26	41	8	2	11	4		5
NJ	19	31		25	11	16		3
O	29	52		2	20	9	3	
P	18	30		5	16	28	3	
Q	18	30	1	1	14	18	5	1
R	29	40	1	1	9	16	1	2
RR	33	54			11	15	1	1
S	22	33		20	1	5		
SH	28	29		2	11	13		
T	17	29	1		19	29	1	2
TH	20	34		2	12	24	1	
U	33	61	1	5	4	3		4
V	19	33		2	14	16	2	4
X	21	35		2	8	11		4
XH	16	30	5	6	7	15		
Y	26	45	1		9	12	2	4
Z	28	44	1		4	11		
ZH	4							
<b>Shuma</b>	<b>794</b>	<b>1342</b>	<b>42</b>	<b>111</b>	<b>325</b>	<b>588</b>	<b>67</b>	<b>56</b>

kombëtarë, pasi aty gjejmë emrat e kontinenteve, të shteteve të botës, si dhe kryeqytetet e tyre, gjë që nuk e kemi gjetur në këto përmasa në fjalorët e mëparshëm shpjegues të gjuhës shqipe. Por pjesën më të madhe të fjalorit onomastik e zënë emrat toponimikë shqiptarë, megjithëse edhe këtu nuk i kemi të pasqyruara të gjitha njësitë e domosdoshme, sidomos oikonimet shqiptare të cilat janë dhënë në më pak se 1/3 e tyre. Ky nivel pasqyrimi i jep fjalorit vlera të mëdha informuese për lexuesin, duke hapur kështu një rrugë që duhet vazhduar, ndoshta gjatë hartimit të “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”.

“Fjalori i shqipes së sotme” 1984, në aspektin e mënyrës së pasqyrimin të fjalësit onomastik, ka të përbashkët me fjalorët shpjegues që analizuam më sipër, përdorimet ndajfoljore e emërtimet e gjuhëve, të cilat janë përfshirë në fjalësin e përgjithshëm të secilit fjalor, ndërsa emrat etnikë e përdorimet mbiemërore janë dhënë së bashku me toponimet e tjera në pjesën shtojcë të tij. Edhe këtu ka ndonjë përjashtim të vogël nga rregulli i përgjithshëm, pasi kemi disa përdorime të emrave etnonimikë të pjesës shqiptare që përdoren edhe në fjalësin e përgjithshëm, edhe në shtojcën e tij si: shqiptar (em.), shqiptar (mb.), bregdetar (mb.), bregdetas (em. mb.) etj.

Mënyrat e ndryshme të pasqyrimin të fjalësit onomastik tregojnë se zgjidhjet e fjalorëve janë zgjidhje konvencionale. Neve na duket më e përshtatshme zgjidhja e “Fjalorit të shqips së sotme” 1984, sepse informacionin për emrin e vendit, banorin dhe mbiemrin që lidhet me ta e ka pasqyruar nën një glosë dhe e ndihmon mjaft lexuesin për të gjetur në një kohë më të shpejtë fjalën që kërkon. Megjithatë edhe kjo zgjidhje nuk e mbulon plotësisht fjalësin onomastik të një gjuhe, çka nxjerr nevojën e hartimit të një fjalori të veçantë për njësitë emërtuese të kësaj fushe, fjalor që të përfshijë toponimet e të gjitha llojeve, emrin etnik, mbiemrin, gjuhën dhe përdorimin ndajfoljor jo vetëm për emërtimet shqiptare, por edhe ato të huaja.

## KREU VIII

### ANTROPONIMET DHE PATRONIMET ME FREKUENCË MË TË LARTË PËRDORIMI NË FJALËSIN ONOMASTIK SHQIP

#### 8.1 ANTROPONIMET ME FREKUENCË MË TË LARTË PËRDORIMI

Në këtë punim do të jepet një informacion për antroponimet, apo emrat vetjakë të njerëzve, patronimet, apo emrat familjarë përkatës të tyre, që kanë frekuencë relativisht më të lartë përdorimi në Shqipëri, material i vjelë nga vepra të ndryshme me material onomastik në gjuhën shqipe. Në këtë material leksikor, antroponimet janë ndarë në dy grupe të mëdha:

1. emra vetjakë me burim vendës
2. emra vetjakë me burim të huaj.

Fjalët e grupit të parë janë ndarë në emra shqiptarë ku dallohen, emra historikë, emra me origjinë nga bota bimore e fauna, emra nga fjalësi apelativ si dhe emra me lëndë shqiptare, të cilët, veç lëndës shqiptare, kanë edhe ndikim të jashtëm të kohës, ambientit apo kontaktit me kultura të tjera. Fjalët e grupit të dytë, emrat me burim të huaj, janë ndarë në emra vetjakë myslymanë, gjermanikë e anglo-saksonë dhe emra me origjinë greke.

Në punim janë sjellë njëqind patronimet me denduri më të lartë përdorimi, të cilat janë ndarë në disa tipa sipas prejardhjes së tyre në: emra familjesh të prejardhura nga emra të parë (nga emra personi); emra familjesh të ardhur nga toponimet dhe emra familjesh të ardhur nga emërtime profesionale, funksionesh a ofiqesh. Në fund evidentohet rëndësia e studimeve me kritere të rrepta shkencore të këtij fjalësi, veçanërisht të antroponimisë shqipe, pasi kështu do të shmangen interpretimet jo të drejta për problemet që lidhen me emrat e shqiptarëve, të huazuara nga pushtuesit, nomenklatura fetare apo dhe huazimet e reja për arsye nga më të ndryshmet.

#### 8.1.1 EMRAT VETJAKË TË ARDHUR NGA LEKSIKU I PËRGJITHSHËM.

Pjesë përbërëse e onomastikës së çdo gjuhe janë dhe emrat e njerëzve, apo emrat vetjakë (antroponimet) dhe emrat familjarë përkatës të tyre (patronimet).

Duke e përdorur si një shtojcë, për fjalësin onomastik, ne do të japim në këtë punim një informacion për antroponimet e patronimet me frekuencë më të lartë përdorimi në Shqipëri, material i vjelë nga fjalorë të ndryshëm të gjuhës shqipe, si "Fjalor me emra njerëzish", Tiranë, 1982, A.Kostallari, M.Domi, P.Daka, S.Mancaku; Vëzhgim për emrat

familjarë të shqiptarëve, Shkodër, 1998, J. Shpuza; Emrat vetjakë ilirë, Tiranë, 1998, Q.Lleshi; Antropologjia e shqiptarëve, Tiranë, 1977, grup autorësh etj.

Emri është një element me rëndësi të posaçme në jetën e çdo njeriu, ai është pjesë përbërëse e njeriut, madje ky në shoqëri paraqitet, veçohet dhe identifikohet vetëm me emrin e tij. Emri paraqitet në forma dhe kuptime të ndërlikuara, me domethënie shumë më të gjerë seç ka kuptimin dhe rëndësinë për individin që mban emrin përkatës, madje emri është një element që, në një fare mase, tregon edhe zhvillimin shoqëror e kulturor të një populli, të një ambienti gjeografik. Prandaj mund të themi se emrat, deri diku, luajnë rolin e dokumentit historik, në bazë të të cilëve mund të konstatohen ecuritë shoqërore në periudha të caktuara, ndaj thuhet se “*mosha e emrave të vendeve dhe të njerëzve është aq e vjetër sa edhe vetë gjuha*”<sup>104</sup> sepse edhe emri është një faktor që ndryshon sipas rrethanave shoqërore e kulturore të një vendi. Ai tregon shkallën e zhvillimit të vetëdijes sociale dhe kombëtare, të gjendjes politike, të bestytive të ndryshme që shoqërojnë zhvillimin e shoqërisë. Të gjitha këto ndikime kanë lënë mbresa të forta gjatë periudhave të ndryshme, por disa nga këto janë prezente në çdo kohë, madje edhe sot në botën e qytetëruar.

Në periudha të ndryshme historike sfera antroponimike e pushtuesve u bë edhe e shqiptarëve si rezultat i përqafimit prej tyre të religjionit të pushtuesit. Prej këtej rrjedh edhe shtresëzimi i emrave të njerëzve, kushtëzuar nga ndikimet e huaja që sunduan me shekujdhe lanë ndikimin e tyre këtu. Kjo është arsyeja që në kohën e sundimit romak, bizantin, e më vonë sllav e turk, antroponimet ilire-shqiptare u pakësuan dukshëm.

Periudha më e mirë e ripërtëritjes së antroponimeve shqiptare që ajo e viteve të pasluftës së Dytë Botërore, ku bashkë me një jetë ndryshe pa pushtues, me konceptet e reja për jetën, filloi një luftë e hapur kundër emrave të huaj dhe zëvendësimi i tyre me të rinj. Kështu filloi një përtëritje e vullshme në përmasa të gjera në çdo fushë të gjuhës, në pajtim me kushtet shoqërore e kulturore. Masat e gjera të popullit të prirura nga ndjenja kombëtare e panë të nevojshme të vjelin leksikun autokton për emërtime.

Megjithëse në periudhën pas viteve 50-të të shekullit të kaluar ndodhi një evolucion i leksikut në përgjithësi, pra edhe i antroponimeve, pakesimi i emrave të huaj të njerëzve nuk shkoi me ritme aq të shpejta si në leksikun e përgjithshëm. Shkalla e rritjes së fondit tonë leksikor në antroponime nuk është e njëjtë jo vetëm në treva të ndryshme, por dhe në shtresa të ndryshme të popullsisë, në varësi të nivelit intelektual të grupeve të ndryshme shoqërore.

Me zhvillimin e inteligjencës e shkollimin masiv, vërshimi i leksikut të përgjithshëm të shqipes në emrat e njerëzve mori një përhapje të gjerë. Në këtë mënyrë ndikimeve të huaja iu ngushtuan hapësirat e përdorimit, por jo se u eliminuan fare.

---

<sup>104</sup> Daka, P. Emrat e njerëzve në gjuhën tonë, GjJ, 1, 1981, f.105.

Një vështrim i përgjithshëm mbi zhvillimin e emrave të përveçëm, tregon se tradita dhe e reja ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Tradita është zhvilluar gjatë shekujve, është pasuruar me elemente të reja, i ka përvetësuar plotësisht, e më pas i ka shndërruar në traditë. Kur bëhet fjalë për antroponiminë, zemra e kësaj tradite është fondi i emrave të shqipes. Ndryshimet ekonomike-shoqërore e kulturore që ndodhën në vendin tonë gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, përmbysën edhe mjaft norma, zakone e koncepte të së kaluarës duke i zëvendësuar me të reja, të cilat gjetën pasqyrim edhe në antroponime, emrat e njerëzve, si një kërkesë e zhvillimit të ri shoqëror.

Ashtu sikurse fenomene të ndryshme të jetës shoqërore janë tregues të zhvillimit të saj, edhe emrat e njerëzve kanë qenë dhe janë tregues të zhvillimit të shoqërisë, të kulturës dhe të mendimit njerëzor nga një epokë në epokën tjetër historike. Emri i njeriut, fillimisht është një akt dëshire e prindërve, së bashku me përkatësinë në një kulturë, në një fe ose në një vizion për botën.

Emërtimi vetë e ka gjithnjë një aspekt magjik, madje përtej ritualeve të lashta të pagëzimit. Për këtë na bind vetë historia e emrit shqip, në të cilën gjen të pasqyruar historinë e shqiptarit vetë. Fetë ndër shqiptarët, nga ana e tyre, e kanë sistematizuar emërtimin prej shekujsh, në kuptimin që pagëzimi ndër besimtarët e feve të ndryshme funksionon më tepër si akt përkatësie të kësaj ose asaj feje, pasi edhe dëshira e vetë prindërve përputhet me dëshirën e përbashkët të atij komuniteti për t'u riprodhuar dhe përkushtimin e përbashkët ndaj hyjnisë.

Për këtë arsye, që nga Rilindja Kombëtare e këtij, konfirmimi i shqiptarisë si fe kombëtare (feja e shqiptarit/ është shqiptaria- thoshte Pashko Vasa), përkoi me gjallërimin dhe përhapjen e një sistemi të ri emrash shqip, të cilët do t'ia ndërronin pamjen antroponimisë shqiptare në shtetin shqiptar. Ajo që ndodhi me emrat e përveçëm të shqiptarëve gjatë shekullit të 20-të, mund të merret si shembull i një ringjalljeje relativisht të suksesshme, edhe pse vënia e emrit fëmijës është akt social më tepër se institucional. Këtu është fjala për dukurinë e ringjalljes dhe të përhapjes, deri diku edhe institucionalisht, të emrave ilirë të gjetur nga historianët, filologët dhe arkeologët në tekste të lashta ose mbishkrime varresh, emra që do të konfirmonin formulën rilindase se “feja e shqiptarit është shqiptaria”.

Tradicionalisht edhe shqiptarët u kanë vënë fëmijëve emra që kanë të bëjnë me besimin dhe botëkuptimin fetar, që te të krishterët lidhej dhe lidhet edhe sot, me aktin e pagëzimit, por gjithnjë janë përdorur emra të ashtuquajtur “apelativë” (të përgjithshëm) që janë edhe fjalë të leksikut të përgjithshëm të gjuhës, si: Drita, Shega, Lule, Rrapi, Bajame, Flamur, Bora, Sheqere, Rudina, Voglushe, Manushaqe, Trëndafille, Zambak, Vjollca etj.

Edhe emrat e njerëzve i nënshtrohen ligjit të zhvillimit, ata lindin, ndryshohen, zhvillohen dhe zhduken në këtë apo atë etapë të caktuar të zhvillimit të gjuhës dhe



shoqërisë. Ndaj njohja dhe studimi i antroponimisë, i prejardhjes dhe historisë së saj, janë të lidhura ngushtë me historinë e gjuhës dhe të kulturës materiale e shpirtërore të popullit.

Çdo epokë apo kthesë, siç qe ndër ne Rilindja Kombëtare apo dhe periudha e gjysmës së dytë të shek.XX, pas Çlirimit, në historinë e një populli shoqërohet gjithnjë me një varg ndryshimesh dhe fenomenesh të reja si në lëmin e zhvillimit ekonomik, politik e shoqëror, ashtu edhe atë kulturor. Këto ndryshime kanë ndikuar, në masë e në kohë të ndryshme, edhe në sferën e emrave të njerëzve. Është kjo arsyeja që në antroponiminë shqiptarë, ndër epoka historike kanë ekzistuar emra laikë e fetarë, me prejardhje të huaj (greke, romake, bizantino-sllave, arabo-perso-turke) krahas emrave të fondit vendës, që tregon se emrat janë të lidhur ngushtë me ngjarjet e mëdha historike e kulturore nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë në rrjedhë të historisë.

Nga studiues e gjuhëtarë të ndryshëm është shprehur e pranuar mendimi se emrat e njerëzve, si emra të përveçëm, janë sajuar kryesisht nga fjalë, fraza e shprehje të zakonshme të gjuhës, d.m.th. ata burojnë nga njësi të sferave të ndryshme të leksikut të gjuhës së vendit përkatës, ose nga njësi të sferave të ndryshme të leksikut të gjuhëve të vendeve të tjera, të huazuara kryesisht si antroponime. Një fenomen i tillë vihet dhe re te emrat tanë vetjakë, emrat ilirë. Emrat ilirë të njohur në kohën tonë, vijnë nga burime të ndryshme të shkruara në gjuhët greke e latine, nga vepra autorësh klasikë greko-romakë, nga mbishkrimet e zbuluara nëpërmjet gërmimeve arkeologjike etj.

Në punën tonë kërkimore ne kemi vjelë një numër të madh emrash vetjakë, gjithsej 1015, të përdorur nga populli ynë për emërtimin e pasardhësve të tij. Këtu janë zgjedhur emra që kanë një frekuencë më të lartë përdorimi. Në gjithë këtë pasuri antroponimike evidentohen qartë gjurmët e periudhave të ndryshme historike e deri te bashkëkohësia. Për gjithë këtë pasuri antroponimike, pa dhënë shpjegime të hollësishme për prejardhjen e tyre, do të mundohemi të bëjmë një ndarje nga pikëpamja etnografike, megjithëse edhe kjo nuk është e dhënë një herë e përgjithmonë, sepse gjithmonë ekziston mundësia që një ndarjeje të tillë t'i shtohet edhe diçka e re në bazë të të dhënave të reja nga një regjion, fis apo popull tjetër. Megjithatë ne do të bëjmë një renditje në vija të përgjithshme.

Nga materiali i vjelë, modest në numër në raport me gjithë këtë fjalës, por përfaqësues në shumëllojshmëri, para së gjithash, sipas studimeve të bëra deri më sot, emrat vetjakë, mund të ndahen në dy kategori ose grupe të mëdha :

1- Emra vetjakë me burim vendës (432 emra nga materiali i vjelë).

2- Emravevetjakë me burim të huaj, kryesisht emra me burim fetar (myslymane, ortodoks, katolikë ) (583 emra nga materiali i vjelë).

Për arsye historike, tashmë të ditura, sasia më e madhe e emrave vetjakë të shqiptarëve (nga materiali i vjelë 583) i përket grupit të dytë, d.m.th. kanë mbizotëruar emrat me

prejardhje të huaj: greke, romakë, orientalë (arabo-turke), hebraikë, italianë, francez, gjermanë, spanjollë, rusë e tani së fundi anglo-amerikanë .

Gjithë kjo mori emrash kanë pasur denduri e shtrirje të pabarabartë nëpër krahinat shqiptare, po edhe u përkasin periudhave a epokave të ndryshme historike dhe pasqyrojnë fatet dhe hapat e bashkësisë shoqërore shqiptare në shekuj. Tani, këtë fjalës onomastik, do ta ndajmë sipas grupimeve të mësipërme.

### **8.1.2 EMRAT E PËRVEÇËM ME BURIM VENDËS**

Kjo kategori emrash është e kompozuar me shumë elementë të sferave të ndryshme. Por kryesorja është se emrat me burim vendës kanë një domethënie, kanë një kuptim qoftë nga aspekti gjuhësor, qoftë nga ai historik, gjeografik apo shoqëror në kuptimin më të gjerë. Kjo për arsye se këta emra jo vetëm se kanë, zakonisht, një kuptim në gjuhën amtare, ose në shoqëri përgjithësisht, por edhe për arsye se ata janë të vendit, të ambientit ose të rrethit tonë gjeografik, etnik e shoqëror, gjë që nuk ndodh me emrat e përveçëm me burim të huaj.

Në vendin tonë emrat me burim vendës fillojnë që nga Rilindja, por gjetën përdorim të gjerë sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, periudhë kur filloi emancipimi kulturor me një intensitet më të madh se në të kaluarën, periudhë kur filloi dhe ndryshimi i strukturës sociale të familjes shqiptare si rezultat i arsimimit të saj.

Te emrat me burim vendës do të japim më poshtë një listë të tyre, por dhe këtu do të bëjmë më parë një ndarje në këto nëngrupe :

1. Emra vetjakë të shtresës ilire, të cilët përbëjnë fondin më të lashtë antroponimik vendës, megjithëse shumica e tyre nuk mund të shpjegohen me mjetet gjuhësore të shqipes së sotme. (68 emra nga materiali i vjelë).
2. Emra vetjakë të burimit shqip, që shpjegohen me anë të njësive të ndryshme të leksikut të sotëm të shqipes, me emra të përgjithshëm ose kategori të tjera leksiko-gramatikore, togje a grupe fjalësh të sferave të ndryshme të leksikut konkret e abstrakt. (190 emra nga materiali i vjelë).
3. Emra vetjakë të burimit shqip, por që janë cunuar prej kohësh dhe që nuk u dihet prototipi ose emrat e sajuar artificialisht me kombinime inicialesh a shpikje të rastit etj. (174 emra nga materiali i vjelë).

Kjo kategori emrash është e kompozuar me shumë elementë të sferave të ndryshme.

## ❖ EMRA SHQIPTARË

Admir, Admirim, Adriatik, Adrian, Adhurim, Afrim, Agim, Agron, Alban, Almir, Altin, Arbër, Ardian, Argjend, Arian, Arianit, Artan, Atdhe, Bamir, Bardhyl, Bashkim, Bajame, Bekim, Bersant, Besa, Besfort, Betim, Bilbil, Binak, Bjeshka, Bledi, Blerim, Boiken, Bora, Besnike, Bukuroshe, Brikena, Bujar, Bukurie, Burbuqe, Burim, Çeljeta, Çlirim, Çun, Dafinë, Dallëndyshe, Dardan, Dash, Dashamir, Dashnor, Detar, Dëfrim, Donika, Ditmir, Drin, Dukagjin, Durim, Dhurata, Edlira, Edo, Elira, Elona, Emirjeta, Emona, Engjëll, Enkel, Enkelejd, Entela, Era, Erblin, Ergys, Erjon, Erkand, ermal, erlis, Ermira, Fatbardh, Fatime, Fatjon, Fatmira, Fatmir, Fatos, Festim, Fidane, Fisnik, Fjolla, Flamur, Flatra, Flutura, Gazmend, Gazmir, Gent, (Genc), Gëzim, Gojart, Gonxhe, Gramoz, Granit, Guri, Guxim, Gjelosh, Gjellak, Hekuran, Ildir, Ilir, Iljon, Jamarbër, Jehona, Jeta, Jetgjat, Jetmir, Jon, Kaltrina, Kastriot, Karafile, Kelmend, Kliti, Korab, Krenar, Kreshnik, Kujtim, Kushtrim, Lavdërim, Lareshë, Lavdie, Lavdosh, Ledina, Lindita, Liridon, Liri, Lirim, Luan, Luftim, Lule, Lulëzim, Luljeta, Lumturi, Majlinda, Manushaqe, Marash, Marenglen, Merita, Mimoza, Mira, Miranda, Mirbana, Mirdash, Naltin, Nderim, Ndriçim, Nertil, Nerënxa, Nirva, Nora, Njomza, Olsi, Ora, Ornela, Ortenisa, Pajtim, Paqesor, Parlind, Patriot, Pëllumb, Përparim, Petrit, Plasent, Pranvera, Redon, Rezart, Rinush, Rudina, Rrapi, Sazan, Selvi, Sibora, Sidorela, Skerdilait, Skifter, Sokol, Shqiponja, Shegë, Shkëlqim, Shkëndijë, Shpat, Shpend, Shpëtim, Shpresa, Shqiponja, Taulant, Teuta, Tomor, Trim, Trendelinë, Trëndafile, Thëllëza, Ukë, Urim, Vala, Valbona, Valdet, Valdrin, Vegim, Vera, Vesa, Vigan, Visar, Vjollca, Voc, Vlora, Zambak, Zamir, Zigur, Zjarm. etj.

**Emrat vetjakë të shtresës ilire.** Ashtu si gjithë popujt e tjerë të lashtë, edhe të parët tanë, ilirët, kanë pasur fondin e tyre të emrave vetjakë të burimit vendës. Por përmbysjet dhe shndërrimet e mëdha të së kaluarës, mungesa e burimeve shkrimore ilire, bëri që të humbisnin shumica e emrave vetjakë të atyre kohëve, ashtu siç humbën në errësirën e shekujve shumë elemente dhe vlera të kulturës materiale e shpirtërore të stërgjyshërve tanë.

Futja e emrave ilirë mund të ishte edhe si pjesë e një prirjeje të përgjithshme të Rilindjes Kombëtare për t'u freskuar shqiptarëve kujtesën historike, të topitur prej shekujsh si rezultat i rrethanave të disfavorshme. Kështu ndër shtresat e mesme qytetare dhe më tej, nisën të përdoreshin emra që u përkisnin burrave e grave të shquara të kombit në të shkuarën, duke filluar që me Lekën e Madh, e pastaj me radhë Pirron, Gjergj Kastriotin, Donikën, Gjinin, Vojsavën, Komnenin, Gjonin, Aranitin, Mamicën etj.

Nëse janë përdorur, ndër shqiptarë, emra ilirë në mënyrë të vijueshme që nga lashtësia, kjo është një çështje që duhet t'i japë përgjigje shkencë e gjuhësisë apo historisë, megjithëse ka të dhëna se disa prej emrave të përdorur në malësorët e veriut

mund të kenë prejardhje pagane parahistorike, por ka dhe mendime se vetë struktura tripjesëshe e emrit të malësorit, e tipit Ndue Ndrec Gjoka, Gjergj Elez Alia, i përgjigjet një sistemi parlatin e më të lashtë se kontaktet iliro-romake, si edhe emra si Dedë (në Veri dhe Jug) ose Bato (në Jug) mbahen si të trashëguar prej ilirishtes. Megjithatë adoptimi në kohët moderne i emrave ilirë si: Taulant, Agron, Teuta, Genci, Enkelejda, Bardhyl nuk kanë të bëjnë me ruajtjen, apo për të treguar lashtësinë e shqiptarëve, por më tepër ata gjetën një mënyrë për të shprehur nëpërmjet tyre vendosmërinë për të treguar se i përkasin kombit shqiptar modern.

Për ta kuptuar më mirë këtë dukuri, shohim se shqiptarët e sotëm e kanë gjithnjë e më të vështirë të identifikohen me emra fisesh ilire të dy-tre mijë vjetëve më parë, si Taulant, Ardian, Enkelejd etj. dhe aq më pak me emra të nxjerrë nga mbishkrimet, si p.sh. Lydra, që sjellin në kulturë vetëm vlera arkeologjike. Ndërsa ndryshe qëndron puna me emra personazhesh historikë të mirëfillta, si: Donika , Gjergj, Aranit, Skënder, Pirro, Lekë, të cilët kanë treguesit historikë përkatës. Prandaj emrat ilirë u ngjajnë më tepër simboleve, të cilët mbushen me kuptim individual nga bartësit e tyre. Emra të tillë (ilirë e historikë) nga materiali i vjelë kemi, si: Agron, Dardan, Ilir, Gent, Teuta, Kastriot(nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu), Pirro etj. Duhet të përmendim se në antroponiminë historike ka dhe emra të huaj, të personave të huaj historikë, të cilët në kohën e caktuar kanë qenë të njohur në skenën ndërkombëtare.

**Emrat e grupit të dytë.** Që nga Rilindja e Shpallja e Pavarësisë, dhe veçanërisht pas çlirimit të vendit, numri i fjalëve apo njësive të gjalla të leksikut të sferave të ndryshme të shqipes, që ka kaluar e po kalon në lëmin e emrave të njëjërëzve, ka ardhur gjithnjë duke u rritur. Kjo prirje e pasurimit dhe përhapjes në shkallë të gjerë të emrave vetjakë të burimit shqip që janë vënë në gjysmën e dytë të shekullit XX, por për fat të keq nuk kanë të njëjtën prirje këtë fillim shekulli, shqiptarët në radhë të parë, me dëshirën e vetë njerëzve për të pasur edhe emrat e tyre në pajtim me frymën e kohës, me zhvillimin e shoqërisë dhe të kulturës sonë, por edhe me njëfarë tradite të krijuar.

Është e qartë se emrat vetjakë me burim shqip që janë sot në qarkullim, janë të periudhave të ndryshme dhe të burimeve të ndryshme. Disa emra janë më të vjetër e disa janë më të rinj, disa të burimit popullor të nxjerrë kryesisht nga leksiku i sferës së florës, faunës e më pak nga leksiku abstrakt, si: Lule, Ujk, Zogë, Shegë, Dashi, Shpend, Miri, Mira etj., ndërsa të tjerë emra janë të burimit kulturor, si: Çlirim, Lufta, Blerta, Bora, Lirak, Ermal, Dritan, Mirjeta, Rezar, Gazmir, Lindita, Saimir etj.

Nga analiza e materialit të vjelë në fjalorë me emra njerëzish (Fjalor me emra njerëzish, Tiranë, 1982, A.Kostallari, M.Domi, P.Daka, S.Mancaku; Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve, Shkodër, 1998, J. Shpuza; Emrat vetjakë ilirë, Tiranë, 1998, Q.Lleshi; Antropologjia e shqiptarëve, Tiranë, 1977, grup autorësh etj), del se emrat vetjakë të burimit shqip vijnë nga këto sfera apo njësi leksiko-gramatikore, si: nga flora,

nga fauna, nga emrat konkretë e abstraktë të thjeshtë, nga emra të prejardhur e të përbërë, nga emra gjeografikë (toponimikë), etnonimikë, terminologjikë, nga emërzimi i mbiemrave, i foljeve dhe ndajfoljeve etj., si më aktivët në formimin dhe pasurimin e mëtejshëm të antroponimisë shqipe. Më poshtë po paraqesim të ndarë në grupe emrat vetjakë të burimit shqip (të grupit të dytë, në ndarjen që i bëmë materialit të vjelë)

**1.Emrat gjeografikë** janë numerikisht më shumë. Përveç domethënies gjeografike, kuptimore dhe estetike, në shumë raste kanë dhe kuptim etnografik, sidomos ata që nuk janë të përcaktuar si emrat: Mal, Bjeshkë, Fushë, etj., nëpërmjet të cilëve është shprehur dëshira e prindërve, siç ka qenë e është zakon te shqiptarët, që fëmija i tyre të jetë i shëndoshë, i fortë, igjerë si malet, bjeshkët, fushat plot me lule. Mirëpo këtë domethënie mund ta kenë dhe emrat konkretë nga kjo sferë siç janë Adriatik, Drin, Shkëlzen, Korab, Tomor, Sazan, Gramoz, Çajup, Kelmend, Shkëlzen, Kastrat, Valbonë, Vjos etj. Emrat vetjakë nga sfera gjeografike kanë domethënie të shumta. Para së gjithash ata kanë anën e tyre estetike, shpeshherë edhe patriotike (Vlorë, Dukagjin), por mund të tregojnë dhe vendin ku ka lindur fëmija. Emra të tillë ne sot dëgjojmë në media dhe i gjejmë të përdorur më shumë, sidomos në Kosovë, për vetë rrethanat historike e të nxitur nga ndjenja patriotike.

**2.**Në emrat e shumtë me burim shqiptar shohim se **bota bimore** ka dhënë mundësi të mëdha për pasurimin e antroponimisë shqiptare me emra lulesh, bimësh, drurësh, shkurresh etj. si: Lule, Luljeta, Lulash, Vjollca, Manushaqe, Trëndafille, Burbuqe, Gonxhe, Mimoza, Shegë, Selvi, Bajame, Fidan, Borzilok, karafille, Mollë, Nerënxë, Trendelinë, Zambak etj. Emrat nga kjo sferë gati kanë një funksion të vetëm, anën estetike, pra bukurinë e emrit.

**3. Emrat nga fauna** janë me përdorim të gjerë. Ata vijnë nga emra kafshësh, shpendësh, insektesh etj. Edhe këta emra kanë para së gjithash funksion estetik, si Flutur, Thëllëzë, Dallëndyshe, Drenushë, Gjeraqinë, Bilbil, Pëllumb, Zogë, Shqiponja, Shpend, Kanarinë, Petrit, Laureshë, Ujk, Ujkan, Skifter, Sokol, Dash, Luan, etj. Antroponimet nga bota shtazore janë të vjetra dhe trashëgohen edhe sot, megjithëse jo me frekuencë shumë të lartë si më parë.

**4.**Emra vetjakë **nga emra konkretë** të sferave të ndryshme, si emra sendesh, mjeshtërish, apo dhe etnonimikë etj. p.sh.: Bora, Çelik, Çun, Dritë, Granit, Flamur, Guri, Sheqere, Hënë, Dhurata, Stoli, Shkëndi, Rudina, Zonjë, Kalem, Matjan, Lumjane, etj.

**5.**Emra vetjakë **nga emra abstraktë të parmë**, si: Dëshira, Jeta, Merita, Shpresa, Vullnet, Virtyte, Vlera, etj.

**6.**Emra **nga sfera e terminologjisë** dhe emërtimeve të ndryshme, si dhe nga emra kalendarikë si: Ideal, Asamble, Kongres, Shkenca, Vigilent, Vigjilencë, Nëntor, Pranverë, Prendë, Vera etj. Emrat terminologjikë nga fusha e shkencës, teknikës,

politikës, mendojmë se për vetë karakterin e tyre specifik të ngushtë profesional e terminologjik, nuk janë të përshtatshëm për t'u përdorur si emra vetjakë. Kjo vërejtje vlen edhe për disa emra të tjerë, ndonëse mjaft të rrallë, që janë zgjedhur e pranuar pa kriter dhe pa u thelluar për rëndësinë që ka për njeriun emri që mban, si: Modë, Prodhim, Sqarim, Vogëlushe, Vashë etj., pasi emra të tillë për moshën e rritur do të bëheshin qesharakë. Pranë gjendjeve civile në Republikën e Shqipërisë është dërguar një listë me 64 emra që nuk lejohen t'u vihen fëmijëve.

**7. Emra vetjakë nga emra të prejardhur, të përbërë e të përngjitur**, si: Afrim, Adhurim, Agim/e, Bashkim, Bukuri, Çlirim, Dashuri, Dëfrim/e, Durim, Festim/e, Fitim/e, Fitore, Gëzim/e, Kujtim/e, Lavdi/e, Lavdërim/e, Luftim/e, Lulëzim/e, Nderim/e, Pajtim/e, Shkëlqim/e, Përparim/e, Shpëtim/e, Dashamir, Fatbardh/a, Fatlum/e, Fatmir/e, Kushtrim/e, etj.

**8. Emra vetjakë nga mbiemra e folje të substantivuar**, si: Artë, Blerta, Bardha, Besnik/e, Bukurosh/e, Fisnik/e, Gazmor/e, Guximtar, Krenar/e, Kreshnik/e, Luftëtar/e, Miri, Mira, Paqësor, Edlira, Emira, Ilir, idlir, Linda, Veron, Veton, etj.

#### ❖ EMRA ME LËNDË SHQIPE

Një grup të veçantë të emrave shqiptarë përbëjnë dhe ata me lëndë shqiptare, por që në përbërjen e tyre kanë dhe ndikim të jashtëm, të kohës, ambientit apo kontaktit me kultura të tjera. Emra të tillë kemi :

Afërdita, Ajkuna, Aiba, Alda, Alisa, Alma, Altea, Amali, Ambla, Ambra, Ana, Anastasi, Andromeda, Anila, Anisa, Antigona, Anjeza, Ardita, Arenea, Argita, Ariana, Arta, Artemisa, Aspasi, Atalanta, Aurora, Barbara, Bardha, Beatrice, Belina, Blerta, Briseida, Berta, Bianka, Blerina, Bruna, Çelesta, Dafina, Daniela, Dasara, Dashuri, Dëbora, Desdemonë, Diana, Dituri, Dodona, Doloreza, Donika, Dorina, Dorotea, Doruntina, Dhespina, Eda, edita, Eftali, Eglë, Ela, Elektra, Elfrida, Elida, Elisabeta, Elsa, Elvira, Ema, Eranda, Esmeralda, Evgjeni, Fabiola, Fanstina, Fedra, Filloreta, Filomena, Fioralba, Flavia, Flora, Florenca, Françeska, Frosina, Gerta, Gertruda, Gladiola, Greta, Gjenovefa, Gjeraqina, Gjystine, Hava, Haxhire, Helena, Helga, Hermiona, Herta, Hilda, Holta, Hygerta, Hyrie, Ida, Ina, Ines, Ingrid, Ira, Irena, Irini, Iris, Irma, Isida, Iskra, Isolia, Iva, Izabela, Izaura, Jalldyz, Jerina, Jolanda, Jona, Kaliopi, Kamela, Karolina, Katerina, Katjusha, Klara, Klea, Kleopatra, Klodeta, Klotilda, Kornelia, Kostanca, Kozeta, Krisanthi, Kristina, Lajla, Larisa, Laura, Laureta, Lauresha, Lidra, Liliana, Linda, Lirika, Lola, Lorena, Loreta, Ludmilla, Luiza, Magdalena, Manjola, Mara, Margarita, Margita, Margjela, Mariana, Mariela, Marjeta, Marlena, Marta, Matilda, Merjeme, Melani, Melisa, Melita, Melpomeni, Menada, Meri, Migena, Mimi, Mimika, Milena, Minerva, Mirela, Miriam, Mirza, Monika, Mrika, Mynever, Myzejen, Najada, Natali, Natasha, Naunka,

Nausika, Naxhie, Naze, Nertila, Nevila, Nexhmie, Rajmonda, Rakela, Rea, Rebeka, Renata, Rexhina, Rovenia, Roza, Rozafa, Sabina, Samauta, Semiranda, Serena, Sevim, Silvana, Silvia, Sofie, Sonila, Sonja, Stefani, Stela, Suzana, Shota, Shuhrete, Tamara, Tanusha, Tereza, Tinka, Tringë, Trendelina, Ursula, Vaçe, Valentina, Vanesa, Vasilika, Venera, Viola, Violeta, Vitore, Xhilda, xhozefina, Zyhra, Zhaneta, Zhulieta

Përsa u përket llojeve të emrave mund të vazhdojë rreshtimi i tyre gati pa kufi. Por edhe me kaq mund të kemi një pasqyrë të qartë mbi antroponiminë tonë dhe mbi begatinë e gjuhës sonë edhe në këtë fushë, si edhe mbi mundësitë e mëdha që ka ajo për të krijuar një fond të ri shumë të pasur të emrave vetjakë, shumë të përshtatshëm dhe të arsyeshëm nga ana kuptimore dhe shumë të bukur nga pikëpamja estetike. Ajo që ne na intereson më shumë në këtë rast është ana etnografike e antroponimisë sonë.

Në bazën e shumicës së emrave vetjakë të burimit shqip qëndron motivi i dëshirës, ku me anë të emrit të zgjedhur shprehet dëshira e prindit që fëmija dhe jeta e saj të jetë e gëzuar, e lumtur, e lirë, e begatë, e ndritur, e shëndetshme, e pastër, e gjatë etj. Në këtë motiv gërshetohet edhe figura e krahasimit. I porsalinduri, sipas emrit që zgjidhet për të, simbolikisht krahasohet me të bukurën, me të fortën, me të bardhën, me të mirën, me krenaren etj. Kështu p.sh. disa emra si Lule, Trëndafil, Mimoza, Vjollca, Flutur, Pranverë etj. kanë për motiv bazë figurën e së bukurës; të tjerë emra si Bora, Pëllumb, Drita etj. krahasohen me diçka të bardhë; emrat Guri, Çelik, Granit, Luan, Shqiponjë etj. krahasohen me diçka të fortë.

Mjaft emra të tjerë simbolizojnë veti e karakteristika të ndryshme të popullit tonë, si: forca, trimëria, bujaria, besnikëria, guximi, urtësia etj. që shprehen me anë të emrave vetjakë si: Besë, Besnik, Kreshnik, Luftëtar, Fatos, Guxim, Liri, Fitore, etj. Brezi i sotëm i prindërve, veç arsyes të dhënë në pikën e dytë më sipër, sidomos në qendrat e mëdha urbane, nuk u vendos më fëmijëve emra shqip të spikatur apo të shpjegueshëm nga shqipja, por në emër të globalizmit, u vendos emra të huaj. Meqë në vënien e emrit ka një element magjik, atëherë mund të themi se ky brez prindërisht u uron fëmijëve një të ardhme më të mirë nga e vetja.

Në pamje të parë, vënia e emrit është një deklaratë kulturore dhe për shumë prindër akti i emërtimit i referohet botës së afruar nga televizioni, si një botë që i përmban të gatshme objektet e dëshirave dhe i paraqet ato në mënyrë të tillë që këto mund të ekzistojnë vetëm si objekt dëshirash. Kur matet t'i vendosë fëmijës emër, prindi gjithnjë detyrohet të ndjekë konvencione të ndryshme, si fetare ose të karakterit kombëtar, që gjithnjë i referohen autoritetit pagëzues, që e kufizojnë lirinë e vendosjes së emrit. Por këtë liri e kufizojnë edhe rastet e vendosjes së emrave të gjyshërve ose një emër tjetër, në bazë rregullash të shumëllojshme, që mund të kenë lidhje me strukturat e afisë familjare, fafëfisnore, me kalendarin ose radhën e lindjes.

Nuk mund të mohohet se estetika luan një rol të dorës së parë në zgjedhjen private të emrit, së paku për shqiptarin e sotëm, i cili nuk e përjeton më forcën evokuese (të atdhetarisë) që ndoshta i bashkelidhej dikur. Kur flasim për estetikë të emrit, duhet të lëmë jashtë arsyet jashtëgjuhësore që na bëjnë ta quajmë të bukur një emër si Klinton, se kemi njohur Presidentin e Amerikës, kontributin që dha ai për Kosovën. Po t'i lëmë jashtë këto konsiderata, si të thuash kulturore, mbetet vetëm aspekti i shenjës gjuhësore, që në rrafshin estetik shprehet vetëm nga bukurtingëllimi. Me fjalë të tjera emër estetik është ai që tingëllon bukur. Këtu duhet pasur parasysh edhe grupi i emrave që përfaqësohet me fjalë që përdoren normalisht në gjuhë, si: Bashkim, Dëshira, Shkëlqim, Pranvera, Petrit etj. Këta emra jo vetëm estetikisht, por edhe kuptimisht i përgjigjen kriterit estetik, meqë, kur përdoren si fjalë të gjuhës, shënojnë sende ose koncepte që vijnë me tingëllim pozitiv, janë fjalë vetvetiu të bukura, pasi këtu estetika shpesh vjen e bashkohet me etikën, meqë virtyti jo vetëm që na shfaqet si i mirë, por edhe si i bukur. Ndaj prindërit fëmijët i quajnë me emra lulesh, kafshësh që na pëlqejnë, malesh që shprehin krenari e bukuri etj.

Fjalët, si njësi leksiko-gramatikore të gjuhës, kanë kuptime të ndryshme. Ato shprehin sipas përdorimit, nocione të caktuara për sende, fenomene, procese a cilësi të ndryshme të tyre etj. Të gjitha ato njësi leksiko-gramatikore të gjuhës (qofshin këto fjalë të thjeshta, të prejardhura, të përbëra a togje fjalësh) kur kthehen në emra të përveçëm, si rregull e humbasin kuptimin leksikor, nuk shprehin më nocione, por shërbejnë duke ruajtur funksionin nominativ, si fjalë për të emërtuar njerëzit. Ky ndryshim në përmbajtje nuk do të thotë se semantika e fjalës së përgjithshme, d.m.th. kuptimi leksikor i një fjale që zgjidhet për t'u përdorur si emër vetjak, nuk luan më asnjë rol; përkundrazi semantika e fjalës lot një rol aktiv në përdorimin e saj edhe si emër vetjak.

Nga kuptimi leksikor që ka fjala, varet, në fund të fundit, edhe qëndrimi ynë për të pranuar ose jo, këtë ose atë fjalë të zgjedhur si emër vetjak për të emërtuar fëmijën. Kjo do të thotë se jo çdo njësi leksiko-gramatikore e gjuhës mund të zgjidhet e të përdoret si emër vetjak. Ndoshta këtu duhet parë shkaku pse fondi i emrave vetjakë është shumë më i kufizuar se fondi leksikor i gjuhës sonë. Pra, në zgjedhjen e një emri a të një fjale të përgjithshme për ta përdorur si emër vetjak, veç faktorëve të tjerë, duhet patur parasysh, edhe ana kuptimore e fjalës.



### 8.1.3 EMRA VETJAKË ME BURIM TË HUAJ

Antroponimet janë pjese e rëndësishme e trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore të çdo populli. Kudo ato kanë pasur e kanë lidhje të ngushtë me vendin përkatës. Në rrjedhë të kohëve, në emrat e përveçëm, ashtu si në shumë popuj edhe në popullin tonë kanë çuar peshë ndikimet e feve të ndryshme, pasi kufijtë e shtrirjes së tyre janë më të gjerë se të vendeve përkatës.

Trysnia e emrave të përveçëm të huaj ka filluar që me kolonizimin grek të shek.VII-VI p.e.re e deri në fundin e pushtimit turk. Por kjo ka vazhduar edhe më vonë, bile edhe në ditët e sotme, por tani jo nën ndikimin e feve, por të letërsisë e filmave artistikë të huaj dhe sidomos kjo ndodh nën ndikimin e faktorëve me karakter politik, ekonomik, kulturor që lindën e po zhvillohen nga marrëdhëniet e shqiptarëve me popuj të tjerë për shkak të hapjes së vendit tonë këto 20 vitet e fundit.

Përsa thamë më sipër emrat me burim të huaj po i ndajmë:

1. Emra të krishterë me origjinë greke si qendra e ortodoksisë 126 emra.
2. Emra vetjakë myslymanë 322 emra.
3. Emra vetjakë gjermanikë e anglosaksonë 135 emra.

#### ❖ EMRA ME ORIGJINË GREKE

Aleksandër, Aleko, Anastas, Andrea, Anton (Andon), Apollon, Apostol, Argjir, Aristidh, Aristotel, Ateo, Demosten, Diogjen, Dionis, Dhimitër, Edip, Eftim, Emanuel, Enea, Epaminoda, Eros, Filip, Foto, Gaço, (Jorgaq), Gavril, Grigor, Gjergj, Gjin, Gjon, Harallamb, Harilla, Harito, Hektor, Hermes, Ilia, Irakli, Ivan, Jani, Jeronim, Jorgji, Jorgo, Jovan, Kiço, Kleanth, Kleo, Koçi, Kosta, Kostandin, Kozma, Kristaq, Kristo, Kristofor, Ksenofon, Leonardo, Lefter, Leonidha, Ligor, Loni, Llambro, Llazar, Lluka, Lluka, Mantho, Marko, Minella, Mentor, Mico, Mihal, Mitrush, miti, Miltjadh, Misto, Mitro, Nikollë, Ndreko, Nathanail, Naum, Nasho, Niqifor, Odise, Orest, Pali, Panajot, Pandeli, Pavllo, Perikli, Petraq, Petro, Platon, Polikron, Priam, Prokop, Ptoleme, Qirjako, Sanri, Serafin, Simon, Sofokli, Sofron, Sokrat, Sotir, Spartak, Spiro, Spiridon, Stavri, Stefan, Stilian, Strati, Telemak, Teodor, Timoleo, Trajan, Trifon, Thanas, themistokli, Theodhori, Theofan, Theofil, Thimi, Thoma, Uran, Vangjel, Vasil, Virgjil, Zahar, Zoi, Zoto.

#### ❖ EMRAT MYSLYMANE

Abas, Abdulla, Abedin, Adem, Adil, Adnan, Ago, Ahmed, Ajas, Ajet, Ali, Allaman, Aqif, Arif, Asaf, Asim, Asllan, Asqeri, Azem, Aziz, Baftjar, Bahri, Bajazit, Bajram, Baki, Bedri, Behar, Bejkush, Bejtulla, Bektash, Belul, Beqir, Beshir, Bexhet, Bilal,

Bislim, Burhan, Caush, Çelik, Çelo, Çerçiz, Destan, Demir, Dilaver, Dyrnish, Ejup, Ekerem (Eqerem), Elham, Elmas, Enver, Fadil, Fahri, Faik, Faruk, Faslli, Fehim, Fejzi, Fehrat, Ferid, Ferik, Feriz, fetah, Fevzi, Fikri, Fiqiri, Fuat, Gafur, Galip, Gani, Gudar, Gjyzel, Gjysho, Gjyle, Habil, Hafie, Hajdar, Hajri, Hajredin, Hajrulla, Haki, Halil, Halim, Hamdi, Hamid, Hamza, Hashim, Hysamedin, Hysen, Hysni, Ibrahim, Idajet, Idris, Iljas, Irfan, Isa, Islam, Ismail, Ismet, Isuf, Izet, Jahja, Jakup, Jashar, Jaup, Javer, Jonuz, Jusuf, Kadri, Kahreman, Kajmak, Kalem, Kamber, Kapllan, Karafil, Kasëm, Kudret, Kurt, Latif, Laver, Levend, Lutfi, Llane, Maksut, Maliq, Masar, Maxhun, Mazllum, Mefail, Mehdi, Mehmet, Meleq, Memo, Memush, Menduh, Mensur, Mersin, Merxhan, Mesut, Met, Metin, Metush, Mevlan, Mexhid, Milaim, Milazim, Mirxhan, Muharrem, Muhamet, Muhedin, Muho, Muin, Mujo, Muntaz, Murat, Musa, Muslim, Mustafa, Myfit, Myftar, Mynir, Myqerem, Myrteza, Mystehak, Myzafer, Nafiz, Nail, Naim, Namik, Nasip, Nasuf, Nazif, Nazim, Nebil, Nedim, Neshat, Neki, Neriman, Nesim, Nesip, Nevruz, Nexhat, Nexhdet, Nexhip, Nexhmedin, Nezir, Nijazi, Nuredin, Nusret, Osman, Omer, Petref, Qamil, Qani, Qatip, Qazim, Qemal, Qenan, Qerim, Raif, Rakip, Ramadan, Ramazan, Ramiz, Rasim, Rauf, Razi, Refat, Refik, Reis, Remzi, Reshat, Reshit, Result, Rexhep, Riza, Rizvan, Rushan, Rushit, Rustem, Ruzhdi, Rrahman, Sabaudin, Sabit, Sabri, Sadri, Sadik, Safa, Safet, Sami, Sefedin, Sefer, Seit, Sejfulla, Selam, Selaudin, Selim, Selman, Servet, Sinan, Sitki, Skënder, Sulejman, Sulo, Sybi, Syrja, Shaban, Shahin, Shaqir, Shefik, Shefki, Shefqet, Shemsi, Sherif, Shemsi, Shuaip, Shukri, Shyqyri, Tabil, Tahir, Tahsim, Taib, Tajar, Tefik, Teki, Telat, Tosun, Turhan, Vaedin, Vahid, Vasfi, Veiz, Vedin, Veli, Vesel, Vedad, Vehad, Vehbi, Xhafer, Xhav, Xhelal, Xhemal, Xhemil, Xhevahir, Xhevat, Xhevdet, Xhezair, Xhezmi, Ylvi, Ymer, Yzedin, Yzeir, Zaim, Zenel, Zenun, Zeqir, Zihni, Zija, Zyber, Zyhdi, Zylyf.

#### ❖ EMRAT GJERMANIKË E ANGLOSAKSONË

Albert, Alfons, Alfred, Angjelin, Ariel, Armand, Arion, Arqile, Arsen, Artur, Astrit, Aurel, Beniamin, Benedikt, Bernard, Bjorn, Bruno, Çezar, Damian, Daniel, Domenik, Donald, Donat, Edgar, Edison, Edmond, Eduard, Edvin, Elton, Elvis, Emil, Emiliano, Enio, Fabian, Ferdinand, Fidel, Florenc, Frederik, Gabriel, Gasper, Gilbert, Gjovalin, Hamlet, Henri, Henrik, Herald, Igor, Isidor, Isak, Jakov, Jordan, Jozef, Julian, Kel, Kevin, Klajd, Klarens, Klark, Klement, Klevis, kolec, Laert, Lazer, Lekë, Leon, Leonard, Loredan, Lorenc, Ludovik, Luigj, Luka, Llesh, Maksim, Manuel, Marin, Mario, Mark, Marsel, Martin, Mateo, Matish, Mërkur, Mëhill (Hilë), Mikel, Mishel, Moisi, Napolon, Nard, Ndoc, Ndoc, Ndre, Ndue, Nelson, Neptun, Nestor, Nikolin, Nikë, Noel, Oliver, osvold, Pal, Paskal, Patrik, Pjerin, Pjetër, Rafael, Raul, Rikard, Robert, Roland, Romeo, Ronald, Rubena, Rubin, Rudolf, Rrok, Samuel, Salvator, Serxhio, Severin, Silvestër, Tish

(Matish), Tonin, Tristan, Uesli, Uiliam, Valter, Viktor, vilson, Vlash, Xhilibert, Zef (Jozef), Zhak.

Duke përfunduar shqyrtimin e emrave vetjakë me burim të huaj, kryesisht të sferës fetare, na duket e arsyeshme të themi atë që është specifike për antroponiminë tonë nga e cila mund të nxjerrim disa konstatime :

**1.**Emrat vetjakë me karakter fetar janë të imponuar nga sunduesit në mënyrë të dhunshme nëpërmjet fesë, apo të imponuar dhe nga pushtuesit e huaj .

**2.** Në bazë të emrave vetjakë të periudhave kur populli ynë ka qenë i sunduar, si emrat në mesjetë apo koha e sundimit turk, nuk mund të konstatohet gjithmonë përkatësia kombëtare për shqiptarët, sepse ata në përmasa të mëdha kanë pasur emra sllavë, turq, grekë etj. Një shqetësim i tillë po vihet re edhe në ditët e sotme, ku më tepër për arsye ekonomike, jo vetëm po ndryshohen emrat e qytetarëve shqiptarë, veçanërisht të atyre që punojnë në Greqi, por dhe fëmijëve të tyre nuk po u vendosin emra shqiptarë, e shpesh u ndryshojnë edhe kombësinë. Në rast se vazhdon një praktikë e tillë vjen një moment që ndryshon së tepërmi raporti i emrave shqiptarë në favor të emrave të huaj.

## 8.2 PATRONIMET

Siç pamë në kapitullin e mëparshëm, objekt i këtij studimi është bërë një kategori fjalësh, që bëjnë pjesë në grupin e emrave dhe të emërtimeve të vendeve (toponimet), të emrave të njerëzve (antroponimet) dhe do të vazhdojë me mbiemrat (patronimet, 100 të tilla në studimin tonë), që të gjithë së bashku përbëjnë atë që quhet onomastikë. Në fushë të onomastikës rezultatet nuk kanë qenë të njëjta në të trija degët e saj.

Makrotoponimia, e cila përfshin emrat e qyteteve, krahinave, deteve, lumenjve, maleve etj. është marrë si argument për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre, kur lënda gjuhësore nga ilirishtja mungon. Krahasuar me toponiminë historike, dy degët e tjera të onomastikës, antroponimia e veçanërisht patronimia, nuk janë bërë objekt i ndonjë studimi të gjerë e të plotë. Ndoshta edhe nga fakti se rëndësia e tyre është më e vogël në krahasim me toponimet, sidomos patronimia e cila është më e re, ndonëse shfrytëzon si lëndë toponiminë dhe antroponiminë, duke qenë vetë emra të shkallës së dytë. Deri më sot një studim më të plotë për patronimet ka bërë prof. Çlirim Bidollari në veprën “Hulumtime onomastike, patronimia shqiptare” në të cilën përshkruan procesin historik të lindjes dhe stabilizimit të patronimisë shqiptare, tiparet e përgjithshme të prejardhjes së tyre dhe në fund jep veçoritë e fjalëformimit në patroniminë shqiptare.

Patronimet kanë vlerë jo vetëm gjuhësore, por edhe kulturore për mbartësit e tyre, që duan të dinë origjinën e emrit të familjes së tyre. Patronimet, ose emrat e familjeve, përbëjnë një nga pjesët më të qëndrueshme të thesarit onomastik, pasi, meqë nuk lidhen me individë të veçantë, që rrojnë jo më shumë se tre breza, po me grupe individësh të shumë brezave, të cilët i bashkon pikërisht prejardhja nga një i parë i përbashkët, ato ruhen më gjatë në gjuhë, duke ndryshuar për arsye shumë të forta. Si të tilla ato marrin një vlerë të veçantë, pasi, duke u mbështetur në to, mund të nxjerrim të dhëna të rëndësishme për historinë, për besimin dhe mënyrën e jetësës së një bashkësie.

Shqyrtimi i kësaj lënde onomastike, 100 patronimet me frekuencë më të lartë përdorimi, do të bëhet në dy plane:

1. Në planin sinkronik, me qëllim që të zbulohen veçoritë strukturore të këtyre njësive. sipas këtij plani patronimet do të vështrohen nga pikëpamja e strukturës, e gjedhës fjalëformuese, e veçorive gramatikore dhe fonetike.

2. Në planin diakronik për të parë vijimësinë e emërtimeve dhe të gjedheve derivuese të tyre. Trajtimi diakronik i lëndës është më i vështirë, pasi jo gjithnjëforma në të cilën shfaqen këto emërtime lejon të zbulohet prejardhja e tyre.

Gjithmonë këtu bëhet fjalë për 100 patronimet me frekuencë më të lartë përdorimi që kemi marrë në shqyrtim, por duke shtuar edhe ndonjë të ngjashëm në aspektin strukturor, fjalëformues a fonetik. Siç do të shohim më poshtë, në aspektin strukturor patronimet

janë njëfjalëshe.(Hoxha, Prifti, Dibra, Aliaj, Luarasi etj.) dhe dyfjalëshe (Gjonedaj, Lazemetaj, Gjemarkaj, Përdodaj etj.). Sikurse është vënë në dukje nga studiues shqiptarë dhe të huaj, në popullin tonë ka qenë i përhapur gjerësisht individualizimi “vetëm me anë të një emri vetjak i babait ose i gjyshit<sup>105</sup> Pra, në të kaluarën në shqiptarë ka qenë zakon, vazhduar deri vonë, përdorimi sidomos i emrit vetjak dhe emrit të babait.

Ndryshe ndodh në ditët tona, kur në zyrat e gjendjes civile ndër të dhënat anagrafike të porsalindurve përfshihen emri vetjak, emri i babait dhe emri i familjes. Si rrjedhim tradita që po mbizotëron është ajo e emrit vetjak dhe emrit të familjes, traditë që zë fill me krijimin e shtetit kombëtar dhe të administratës shqiptare, ndonëse në disa dokumenta shënohet edhe emri i babait. Por në dokumentet e fundit, si kartat e identitetit, pasaportat biometrike, ndryshe nga pasportat e mëparshme, nuk shkruhet emri i babait, por vetëm emri vetjak dhe i familjes.

Në aspektin gjuhësor, kur është fjala për patronimet e formuara nga trajtat e shkurtuara të emrave vetjakë, emërtime titujsh, ofiqesh, gradash e deri te nofkat e llagapet, që në pjesën më të madhe janë apelativa, është me interes të studiohet lënda me të cilën formohen këto mbiemra. Periudha e fillimit të pajisjes së shqiptarëve me mbiemra, patronime, ka përkuar me kohën e sundimit osman në Shqipëri, ndaj kjo ka lënë gjurmë të thella në këtë fushë duke futur përmes turqishtes në gjuhën shqipe emra vetjakë me ngarkesë emocionale vlerësuese negative të lartë, duke përfshirë emërtimet e titujve, gradave e ofiqeve, por edhe nofkat e llagapet, gjë që duket në renditjen që u kemi bërë më poshtë 100 patronimeve me frekuencë më të lartë përdorimi ndër shqiptarë.

Në gjuhën shqipe përdoren paralelisht dy fjalë për emërtimin e emrave të familjes; përdoret fjala *mbiemër*, por që në gjuhën tonë ekziston edhe si pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që shpreh cilësi të një sendi a diçkaje tjetër, por edhe termi *patronim*, por që në asnjë fjalor shpjegues të gjuhës shqipe nuk është vendosur në fjalësin e tyre, bile edhe te fjalat mbiemërnë kuptimin: 2. *emri i familjes që vihet pas emrit të njeriut (llagap). Emri e mbiemri. Mbiemri i burrit (i gruas). Sipas mbiemrit të autorit. Mbante dy mbiemra.*<sup>106</sup> FGJSSH, 1980, jep fjalën llagap si sinonim, jo fjalën patronim. Kurse fjala antroponim është futur në fjalësin e fjalorëve shpjegues.<sup>107</sup>Ndoshta kjo mund të ndodhë për faktin se patronimi është i barasvlershëm me emrin e familjes, në kundërvënien me emrin e parë ose vetjak, personal të njeriut.

Por termi emër familjeje nuk ka zënë vend të qëndrueshëm në gjuhë. Në të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, as në njësitë *leksikore emër/emri, familje/familja* nuk

---

<sup>105</sup> Kuçuli, H. Sprovë për studimin e emrave të familjeve në rrethin e Vlorës, në “Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të A.Xhuvanit” Tiranë, 1986, f.454.

<sup>106</sup> FGJSSH, 1980, f.1085.

<sup>107</sup> FGJSSH, 1980, f.41.

e gjejmë togfjalëshin *emër familjeje*. Vetëm në kuptimin e dytë të fjalës *familje*: 2. “*Tërësia e Njerëzve që rrjedhin nga një paraardhës i përbashkët ( njerëzit që kanë pasur ose vijnë të kenë brez pas brezi lidhje gjaku e lidhje afërie ndërmjet tyre) farefis*”, hasim togfjalëshin “*emër i familjes*” si ilustrim i këtij kuptimi, por i përdorur në një radhë me: “*Stema e familjes, familje mbretërore*”, ndaj është i domosdoshëm, deri diku, të përdoret si term për këtë karakterizim të emrit. Gjenetikisht termi *patronim* ka të bëjë me emrin e babait, duke shënuar kështu një tipar qenësor të këtij emri si i trashëgueshëm në linjën e birësisë nga babai. Por në të vërtetë ai nuk është gjithmonë një emër babai i shndërruar në emër familjeje, por vetëm një prej kategorive të emrave të familjeve, krahas emrave të origjinës, të profesionit e të nofkave.

Në literaturën shkencore të kësaj fushe të gjuhësisë, në këtë kuptim përdoret termi *patronim*, pra si një emër i dytë që i jepet njeriut dhe që mund të jetë emri i të atit ose i një parardhësi tjetër të tij. Ai është i përbashkët për të gjithë anëtarët e të njëjtës familjeje në linjë mashkullore (gjaku) që rrjedhin nga njëri-tjetri. I përdorur në kuptimin e vet më të gjerë, ai është shenjë e individualitetit të tij, është formë e detyrueshme e shenjimit të personit, madje shenja më karakteristike e identitetit të tij.

Dy tipat kryesorë të patronimeve edhe në pikëpamje numerike janë: emri i dytë vetjak dhe vendi i origjinës. Për këtë studiuesi austriak Seiner Franz shprehet: “Identifikimi i shqiptarëve bëhet nëpërmjet një emri tjetër vetjak që mund të jetë i babait ose i gjyshit, ndërsa jashtë vendlindjes edhe emri i fshatit për të treguar prejardhjen”.<sup>108</sup> Sigurisht që një konstatim i tillë nuk është i plotë, sepse nuk janë vetëm këta tipa patronimesh, bile emri i vendlindjes nuk përdoret vetëm jashtë vendlindjes, por edhe në vendlindje për njerëz shumë të njohur.

Me pushtimin osman sistemi antroponimik shqiptar pëson një ndryshim të madh, pasi pushtuesi së bashku me fenë e re solli me vete edhe antroponiminë islame, e cila nisi t’u paravihej emrave të arbërve që deri në atë kohë kishin qenë vetëm të krishterë. Kështu me fillimin e islamizimit përbri emrit kalendarik të pagëzimit shfaqen emrat e parë myslimanë, në fillim si emra të parë vetjakë e pastaj në brezin e dytë edhe si patronime, “madje emri Abdullah (që në gjuhën arabe ka kuptimin: adhures i zotit) filloi të përdorej njëkohësisht edhe si patronim për të sapoislamizuarit, duke u shtuar pas emrave të parë në trajtën: i biri i Allahut, në vend të patronimeve të krishtera për ta shpejtuar procesin e islamizimit dhe për t’i fiksuar rezultatet e këtij procesi në dokumente”<sup>109</sup>

Me kalimin e shekujve formula denominuese onomastike e shqiptarëve pasurohet edhe me kategori të tjera patronimesh, si: titujt e ofiqet (bej, subash, Çausht etj.), me emrat e

<sup>108</sup> Bidollari, Ç. Hulumtime Onomastike, Tiranë, 2010, f.31.

<sup>109</sup> Tërnavë, M. “Onomastika e Kosovës”, Prishtinë, 1979, f.591).

esnafëve, të zejeve, zanateve a profesioneve si: Berberi, Takijexhiu, Kazazi, Terziu, Jorganxhiu, Teneqexhiu, të cilët u kthyen në patronime kur u desemantizuan. Në periudha të ndryshme ka pasur lëvizje brendapërbrenda sistemit, derisa mbyllet me regjistrimin e parë të popullsisë në shtetin shqiptar, në vitin 1923. Por deri në miratimin e ligjit për emrat vetjakë më 1 shtator 1948, mjaft emra familjesh, sidomos ato të prejardhura nga nofkat, u ndërruan qoftë edhe në rrugë gjyqësore.

Në krahasim me emrin, mbiemri ka një domethënie më të gjerë në jetën praktike, sepse, ndërsa i pari përcakton e identifikon në shoqëri një njeri, një individ, i dyti e kryen këtë funksion për një grup njerëzish, për një ose më shumë familje.

Patronimet mbartin mbi vete veçori krahinore të cilat janë të vogla dhe formojnë kështu pjesë të nuancave të ndryshme në mozaikun e tërësishëm të kulturës së një populli, ndërsa antroponimet janë pjesë e kulturës së përbashkët të një populli, ato kanë gjëra të përbashkëta në rang kombëtar, *“por shpesh mbiemrat kanë ngjyrë specifike më shumë se emrat, sepse ata shpeshherë tregojnë viset e ndryshme prej nga kane ardhur familjet ose njerëzit përkatës.”*<sup>110</sup>

Ne në punimin tonë do të sjellim 100 njëqind) patronimet me dendësi më të lartë përdorimi (bëhet fjalë për frekuencë relative) të hulumtuar në burime të ndryshme gjuhësore, siç i kemi përmendur më lart. Renditjen më poshtë po e bëjmë sipas dendurisë së përdorimit, jo sipas rendit alfabetik :

Hoxha	Ruci	Lako	Laze
Shehu	Sula	Mehmeti	Marku
Prifti	Zeneli	Niko	Nano
Çela	Balla	Osmani	Shyti
Leka	Bushati	Pano	Skënderi
Dervishi	Gjoni	Bardhi	Berberi
Kaja	Ibrahimi	Cani	Dede
Rama	Papa	Deda	Elezi
Dibra	Spahiu	Demiri	Gjergji
Abazi	Alikaj	Hasa	Jaupi
Sinani	Arapi	Kuka	Koka
Gjika	Caushi	Mema	Kondi
Kola	Halili	Myftiu	Luarasi
Murati	Konomi	Peci	Mata
Kurti	Aliaj	Shtylla	Meçe
Milo	Basha	Toska	Nikolla
Muço	Mezini	Treska	Rexha

110 Titra, M. Migrimet e shqiptarëve, të brendshme dhe të jashtme, Tiranë, 1999, f.83

Andoni	Zoto	Ymeri	Saraçi
Hasani	Thanasi	Zajmi	Jorganxhi
Haxhi	Xhafa	Bezhani	Çorbaxhi
Koçi	Agolli	Dedja	Subashi
Frashëri	Gjata	Duro	Nikolla
Ruci	Haxhiu	Kamberi	Ndoi
Zeneli	Jaho	Kote	Xhani
Balla	Kodra	Laci	Malaj

Për paraqitjen sa më të qartë e në mënyrë më të logjikshme ne mund të bëjmë një klasifikim të këtyre patronimeve. Në përbërjen e tyre dallojmë disa tipa mbiemrash sipas prejardhjes:

1. Patronime ose emra familjesh të prejardhura nga emra të parë (emra personi).
2. Emra familjesh nga toponimet.
3. Emra familjesh të ardhura nga emërtime profesionale, funksionale a ofiqesh, nofkash, llagapesh.

1. Emrat familjarë të prejardhur nga emra të parë ose personi janë më të përhapurit. Këta emra janë të bazuar në gjini gjaku në shkallë të ndryshme duke filluar nga banori e deri te fisi. Ky tip jo vetëm është më i shumtë në numër, por është dhe tipi që ka lindur më herët si emër i dytë saktësues. Edhe rruga krejt e natyrshme që ka përshkuar ky tippatronimesh e bën atë të jetë sot në këto përpjestime me tipat e tjerë dhe më të natyrshëm për nga arsyeja logjike e lindjes së tij. Kështu në 100 patronimet me denduri më të lartë, pjesën më të madhe e bëjnë pikërisht emrat familjarë të këtij grupi, 58 patronime, si: Abazi, Sinani, Gjika, Kola, Murati, Kurti, Muco, Milo, Andoni, Hasani, Zeneli, Ibrahim, Halili, Thanasi, Nano, Mehmeti, Niko, Osmani, Demiri, Ymeri, Kamberi, Laze, Marku, Skënderi, Elezi, Gjergji, Gjoka, Jaupi, Nikolla, Malaj, Marku, Alikaj, Cani, etj. Vendi që zë ky tip patronimesh është i rëndësishëm, siç u dëshmuua dhe nga të dhënat statistikore, sepse ka të bëjë si me shtrirjen e tyre, ashtu edhe me dendurinë e përdorimit.

Një kriter klasifikimi i patronimeve të ardhur nga emrat vetjakë është dhe shërbimi i tyre si patronime të thjeshta, të drejtpërdrejta, pa u formësuar me ndonjë ndajshesë, duke u paraqitur në trajtën e tyre përfaqësuese të rasës emërore njëjës. Këtu kemi parasysh përdorimin zyrtar të patronimit, pasi në ligjërimin e përditshëm joformal, sidomos në mjedis të ngushta me shkallë njohjeje, sidomos në fshatra, trajtat e emërores njëjës përdoren më shumë në gjinore shumës, duke kuptuar me këto trajta shumësi, jo familje të veçanta, por fise të tëra, p.sh. Agimi i Sinanajve, mbi bazën e të cilave janë krijuar edhe emra fshatrash, si p.sh. Sinanaj (Tepelenë).



Nga shqyrtimi i patronimeve të mësipërme vetëm dy nga 58 patronimet janë formësuar më **-aj** (Malaj, Alikaj), që tashmë është provuar si ndajshesë e specializuar për formim patronimesh. Kështu e karakterizojnë këtë ndajshesë (prapashtesë) edhe A.Xhuvani - E.Çabej në studimin e tyre për prapashtesat e gjuhës shqipëduke ia përcaktuar funksionet në: **1.**-formim patronimikash, d.m.th. emra fisesh e çetash, p.sh. Gjinaj (Gjin), Gjellaj (Gjel), Kolaj (Kolë), Nikaj (Nikë), dhe **2.**- formim emrash visesh a krahinash, të Jugut a të Veriut, të dalë nga patronimikat, p.sh. Bardhaj (Fier), Çorraj (Sarandë), Lekaj (Kavajë, Tepelenë), Zogaj (B.Curri), Memaliaj (Tepelenë) etj.<sup>111</sup> Edhe në këtë kontigjent të kufizuar të këtij tipi patronimesh bie në sy mbizotërimi i gjedhes më të përgjithshme të formësimit të antroponimit gjatë procesit të patronizimit. (Trajta e emërores Dervish njëjës më **-i**, Dervishi, Mehmet - Mehmeti), gjithsej 25 patronime, një përpjestim që u përgjigjet jo vetëm patronimeve tona në tërësi, por edhe leksikut apelativ. Pjesa që mbetet ndahet midis fundoreve *-u*, *-i*, *-a*, dhe *-o*.

Grupi i patronimeve më **-u** dhe **-a** ndiehen si trajta njëjësi të shquara dhe në këtë pikëpamje shkojnë së bashkume ato më **-i**, me rregullën e shquarjes së emrave, ndonëse rregulla gramatikore e shquarësisë i nënshtrohet një rregulle tjetër shquarjeje, jo si apelativit, p.sh. *gjak - gjaku; gjikë - gjika*, por sipas rregullit gramatikor duhej *gjiku*, pasi këta emra mashkullorë marrin mbaresën trajtëformuese **- u** të lakimit të dytë, jo **- a**, që është mbaresa e gjinisë femërore, pra e lakimit të tretë. Pra kjo është një shquarësi “dialektore”. Edhe te tipi i patronimeve që dalin më **- a**, kemi të bëjmë me një dukuri dialektore që ka vepruar mbi këta emra. Dy grupet e tjera të patronimeve më **- o** dhe më **- a**, që ndjehen si trajta të pashquara, Çabej i merr si “trajta vokativi”.<sup>112</sup>

Përveç këtyre mbiemraveqë kanë një frekuencë të lartë përdorimi, në këtë tip patronimesh futen edhe emra vetjakë të vjetër, biblikë, të përvetësuar me kohë nga shqipja, si: Adam e Adami, por edhe Adhami - Avrami (Berat), të cilët si emra vetjakë vështirë se prindërit ua vendosin fëmijëve të tyre, pasi nuk u duken estetikisht të bukur. Po kështu një grup tjetër përbëjnë edhe patronimet që kanë në përbërje veç emrave vetjakë edhe tema të tjera, si ato që shënojnë tituj: aga - Agolli, etj. që formohen nga shkurtimi i emrit me një fundore - olli, si Baholli nga një shkurtim Baho; Azizolli, Avdolli, Alikolli etj.

Në këtë grup hyn dhe kategoria e patronimeve tripjesëshe si Gjin Bue Shpata, Ndrec Ndue Gjoka etj. Për mekanizmin e formimit të këtij tipi patronimesh, mendojmë se këtu kemi të bëjmë me prirjen drejt një identifikimi sa më të saktë të subjektit duke futur në punë sa më shumë elemente, që shenjojnë jo vetëm paraardhësin e drejtpërdrejtë

---

<sup>111</sup> .Xhuvani A. - Çabej, E. Prapashtesat e gjuhës shqipe, në “Studime gjuhësore”, Vol. III, Prishtinë, 1976, f.196-197.

<sup>112</sup> Çabej, E. Diskutim për kumtesën e H.Boissin-it, në Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1965, f.353.

(babanë), por edhe emra të përfaqësuesve të brezave të mëparshëm (gjyshër e stërgjyshër).

Në konkluzion të këtij grupi patronimesh me përhapje të gjerë, mund të konstatojmë me lehtësi dhe mund ta paraqesim si karakteristikë të tyre faktin se pjesa më e madhe e patronimeve preantroponimike janë variante të shkurtuara emrash vetjakë me strukturë dyrrrokëshe, gjë që mbështetet nga të dhënat e mësipërme.

**2. Në grupin e dytë**, siç e thamë më sipër, hynin emra familjarë të prejardhur nga toponimet. Të tillë emra familjarë ka kudo. Kjo vërehet më shumë në zonat urbane të krijuara me një popullsi heterogjene për nga përkatësia krahinore, ndodhur kjo në periudha të ndryshme, por kjo mundësi nuk përjashtohet as në ditët e sotme gjersa është një mundësi krijimi.

Nga aspekti etnografik këta janë me interes të posaçëm, sepse me anë të tyre mund të studiohet prejardhja e elementëve të ndryshëm nga një krahinë në krahinën ose vendin tjetër. Këta emra para së gjithash tregojnë se familja përkatëse ka prejardhjen nga vendi, emrin e të cilit ai mban. P.sh. Bushati, Frashëri, Luarasi, Kraja, Dibra, Alikaj etj.

Familjet e tilla sjellin me vete jo vetëm emrin e vendlindjes ose krahinës nga vijnë, por edhe të gjitha elementët e tjerë etnografikë, si veshjen, zakonet, mënyrën e jetesës etj. Këto për një kohë relativisht të shkurtër zhduken dhe përshtaten me ambientin e ri, por mbiemri ruhet dhe është dëshmi e prejardhjes së asaj familjeje ose fisi .

Ashtu sikurse patronimet e grupit të parë, edhe patronimet e këtij grupi, si toponime me funksion patronimesh janë shfaqur herët, por jo në trajtën që kanë sot (emërore e shquar), por dalin në trajtën e gjinore a emërores me parafjalën *nga* ose rrjedhores me parafjalën *prej*, si: Moisiu i Dibrës dhe jo Agron Dibra. Por qysh me regjistrin venecian të Kadastrës së Shkodrës, që përkon në kohë me regjistrimin që bënte kisha katolike në vende të ndryshme të Evropës Perëndimore, hasen edhe trajtat e sotme pa parafjalë si: Jon Gruda, Pjetër Kastrati etj. Pak më vonë zënë të shquhen edhe patronime nga etnonimet si; Andrea Mollasaku, (Mollosët, emër fisi ilir) etj.

Në literaturën onomastike, ky tip identifikimi përcaktohet si një formë përshkruese, ose si një përshkrim vendor me anë të një fraze parafjalore vendore dhe nuk pranohet si formulë mbizotëruese deri sa merr trajtën e një elementi a gjymtyre pa parafjalë. Ky tip identifikimi është në një farë kuptimi konvencional, sepse makrotoponimet, duke filluar nga etnonimet e duke zbritur deri te urbonimet e ruronimet nuk mund të krijojnë funksionin e identifikuesit të saktë, të përpiktë, përkatësisht saktësuesit, se identifikimin e parë e bën vetë emri vetjak. Ata e marrin këtë funksion vetëm kur personi që shënojnë, është i njohur në një bashkësi të caktuar njerëzish (p.sh. selam Musaj njihet dhe si Selam Salaria). Aq më pak mund ta bëjë një idenifikim të tillë një patronim i ardhur nga një etnonim si, Arbëri (Berat), Turku (Elbnasan), Myzeqari, Gega, Toska (Berat) etj.

Ky grup patronimesh duke shprehur një marëdhënie të njeriut me vendin, i cili mund të jetë vendlindja a vendbanimi, ose dhe prone, pavarësisht nga forma e tyre, (Dibra - Dibrani, Korça-Korçari), pra si etnika ose toponime të tipave të ndyshëm, nga pikëpamja sintaksore ata funksionojnë si emra. Këto forma kanë gjegjëset e tyre në togfjalësha, pra në lidhje me emra të përgjithshëm, ku ata funksionojnë si përcaktorë (p.sh. shkrintar, durrsak; Arben Durrsaku etj.). Por në këtë funksion këta identifikues dalin edhe në rastet kur kane trajtë toponimi (Dibra dhe Dibrani nga ana e funksionit sintaksor nuk kanë asnjë dallim).

Ky tip identifikuesi, pra patronimi prejtoponimik kërkon kushte të caktuara funksionimi. Siç vë re me të drejtë J.Shpuza: "...një familje shkodrane, kur jeton në Shkodër nuk ka arsye të mbajë patronimin "Shkodra", sepse ky emërtim dallues u takon të gjitha familjeve shkodrane dhe nuk mund të shërbejë si element për veçimin e saj nga familjet e tjera të Shkodrës".<sup>113</sup> Megjithatë, po sipas J.Shpuzës, sot në qytetin e Shkodrës jetojnë katër familje që mbajnë patronimin "Shkodra". Këto familje u takojnë dy trungjeve familjare që përkohësisht kanë jetuar në vendbanime të tjera dhe janë kthyer në Shkodër, duke sjellë me vete patronimin "Shkodra" që mbajnë aktualisht.

Duke u mbështetur në arsyetimet që u bënë më sipër, mund të themi se ky tip patronimesh (nëpërmjet toponimit a etnonimit ) për të funksionuar plotësisht në këtë rol ka nevojë për disa kushte:

- a. Si rregull familja që mban këtë tip patronimi duhet të jetë shpërngulur nga vendlindja ose nga vendbanimi i mëparshëm dhe të jetë vendosur në një vendbanim tjetër (qytet a fshat) dhe të banojë aty sot. Në këto kushte do të kishte kuptim që një banor i Beratit të mbante këtë mbiemër.
- b. Patronimi prejtoponimik do të funksiononte nëse familja a personi që mban atë sot do të kishte shtegtuar ose së paku do të kishte banuar për një kohë diku tjetër dhe do të ishte kthyer përsëri në vendin e origjinës ( rasti i familjes që përmendëm më sipër).
- c. Ky lloj patronimi mund të funksionojë edhe në rastet kur personi që do ta përdorë atë për identifikim është i njohur a kërkon të bëhet i tillë ( Selam Salaria, Musai). Në këtë rast ai mund të vijë së jashtmi, t'i ngjitet një personi nga të tjerët, zakonisht jo banorë të të njëjtit vendbanim, ose së brendshmi kur personi vetë e zgjedh atë si identifikues. Në shumë raste ky mbetet një patronim jo formal, për faktin se e mban vetëm personi që bëhet i njohur, dhe jo anëtarë të tjerë të familjes së tij, madje ai vetë njihet ashtu publikisht, por në dokumente zyrtare ka patronimin e mëparshëm, atë që ka familja.

Ndër 100 patronimet me frekuencë më të lartë përdorimi, këta lloje patronimesh përbëjnë rreth 10% të tyre, pra s'kanë ndonjë peshë specifike të madhe, si: Dibra, Kraja,

---

<sup>113</sup> Shpuza, J. Vep., cit., f.73.

Frashëri, Bushati, Kodra, Shtylla, Bezhani, Luarasi dhe po të përfshijmë këtu edhe patronimet Arapi e Toska, për aq sa ata mund të përcaktojnë përkatësi në një bashkësi të caktuar. Krahasuar me tipin e parë të patronimeve prejtoponimike, që e përcaktojnë më qartë identitetin e personit, të gjithë tipet e tjerë e bëjnë me për afërsi.

Në grupin e dytë të patronimeve përfshihen patronimet që vijnë nga patronizimi i makro e mikrotoponimeve duke filluar me dy ndarjet e mëdha etnike: Gegë - Gega, Toskë- Toska, emërtimet e krahinave të brendshme brenda kufijve shtetërorë, ndonëse më pak dhe në të dyja trajtat, të makrotoponimit dhe të emërtimit të banorit: Dibra - Dibrani, Dukagjini, Tomorica, Zagoria, Mirdita, Kastrati, Shkreli etj., emrat e qyteteve të vjetra e të mëdhenj qoftë në trajtë toponimi, qoftë etnonimi: Shkodra - Shkodrani, Korça - Korçari, Kruja - Krutani, Durrësi, Lezha etj., si dhe identifikimi nëpërmjet emrit të fshatit të lindjes a banimit, si: Arbana, Armeni, Ballgjini, Cerova, Cukali, Dishnica, Dragoti, Drenova, Dajçi, Ermenji, Gurabardhi, Gurakuqi, Kanina, Kamenica, Lubonja, Malëshova, Malindi, Nivica, Panariti, Peza, Selita, Selenica, Trebicka, Ziçishti etj.

Kategoria më e vogël e patronimeve të këtij grupi është ajo nga emrat e lagjeve të qyteteve ose edhe e lagjeve e mëhallave të fshatrave: Alushani (lagje e fshatit Gjerbës Skrapar), Uznova (Lagje e qytetit të Beratit) etj.

**3. Në grupin e tretë** hynin emra familjesh të ardhura nga emërtime profesionale, funksionale a ofiqesh. Këta emra familjarë janë tregues i mirë i kushteve shoqërore, ekonomike dhe paraqesin interes sidomos për studime etnografike të shtresave të ndryshme të popullsisë dhe të mjeshtërive, sidomos të zejtarisë, nga kuadri i së cilës sot janë zhdukur shumë zanate të cilat e ruajnë kujtimin në emrat familjarë të atyre që dikur janë marrë me këto mjeshtëri, si : Saraçi, Jorgaxhi, Berberi.

Nga sfera e emërtimit sipas titujve ose ofiqeve emrat e familjeve shqiptare janë turqisht, që është e kuptueshme nëse i kemi parasysh kushtet e kohës në të cilën janë krijuar këta. Kështu Spahiu, Subashi, Çausi janë të prejardhur nga koha e marrëdhënieve feudale, ndërsa patronimet Hoxha, Shehu, Dervishi, Papa, Myftiu, Haxhiu, janë emra nga sfera e hierarkisë fetare dhe janë shumë të përhapur kudo në Shqipëri, por dhe në troje shqiptare jashtë territorit të Shqipërisë .

Nga të gjitha ndarjet e onomastikës, ajo që ka pësuar më shumë ndikim turk, është antroponimia e veçanërisht patronimia, sepse procesi i formimit të saj filloi e mbaroi brenda sundimit osman. “Me patronimet shqiptare ka ndodhur pak a shumë ajo që ndodhi me toponiminë e trojeve tona pas dyndjes masive sllave, që ia ndryshoi fytyrën rrënjësisht kësaj pjese të Ballkanit dhe mbuloi një faqe të historisë”<sup>114</sup>

---

<sup>114</sup> Ismajli, R. Disa çështje të onomastikës mesjetare, në “Onomastika e Kosovës”, Prishtinë, 1979, f.48.

Tipi i patronimeve me burim nga emra profesionale (zanatesh e zejesh), titujsh, gradash e ofiqesh, afrohen për nga burimi i tyre prej apelativëve që fillimisht kanë shërbyer si karakterizues shtesë, që u atriboheshin njerëzve që i ushtronin vërtet këto profesione, zanate a funksione që i mbanin njerëz konkretë. Pra duke u nisur nga funksioni i tyre identifikues si karakterizime shtesë, me kalimin e kohës, kur ky zanat a profesion trashëgohej nga njëri brez në tjetrin, u gjet i përshtatshëm për të bërë një identifikim më të saktë të personave që e ushtronin këtë zanat.

Në kushte të tilla apelativët epitetikë që karakterizonin e identifikonin njerëz të veçantë që i ushtronin me të vërtetë këto profesione, e sidomos zeje, pas një kohe të gjatë përdorimi në këtë funksion, u shndërruan në emra të përveçëm, në identifikues patronimikë, kur filluan të shenjonin familjen e ushtruesit të zejës, edhe në ato raste kur zeja, kishte pushuar së ushtruarit në atë familje. Në fillim emërtimet e profesioneve, të zanateve, zejeve, përdoren thjesht si apelativë pas emrit të zanatçiu apo zejtarit, pra si epitete, pa e humbur kuptimin ende, për t'u shndërruar më vonë në patronime të mirëfillta, duke u desemantizuar apelativi që shënon zejtet, profesionet apo zanatin, si: Jorganxhi, Çorbaxhi, Berberi etj.

Vështruar ngushtësisht nga pikëpamja gjuhësore, kjo kategori patronimesh në shqipe paraqet një pamje të larmishme, por të mbizotëruar nga lënda e huaj, e kryesisht orientale, për shkaqe që i përmendëm më lart. Këtë tip mbiemrash nga emri i vepruesit në patronim, shqipja e ka kryer nëpërmjet prapashtesës turke **-xhi (-çi)**, që lidhet jo vetëm me tema turke, por edhe ato jo turke.

Në këtë tip patronimesh, megjithëse jo të shumtë në numër, por me një intensitet të lartë përdorimi, hyjnë ata që e kanë prejardhjen nga hierarkia fetare, që në renditjen e 100 patronimeve të mësipërme, zënë tri vendet e para: Hoxha (1), Shehu (2), Prifti (3) dhe pastaj patronimet e tjera Dervishi, Papa, Konomi (Ekonomi, Ikonomi), Myftiu. Në qindëshen e parë bëjnë pjesë edhe kategori të tjera emërtime si: Spahiu, Çausi, Mezini, Haxhiu, Berberi etj. Patronimet e këtij tipi, në pjesën më të madhe, i takojnë jetës qytetare, sepse në qytete u zhvilluan zanatet e zejjet, administrata shtetërore, ajo ushtarake, klerikale etj. Megjithatë disa zanate, që ishin të domosdoshme, u ushtruan edhe në fshat, zanate që kanë mbijetuar në patronimi, si: Kovaçi, Nallbani, Mullisi, por edhe detyra që lidhen me jetën e fshatit, të tilla si: Bariu, Lopari (lopçari) etj.

Në patroniminë tonë, krahas trajtave të formësuara si emra vepruesi dhe që në pjesën më të madhe sot janë shmangur nga formimet me prapashtesat turke - xhi, (- ç) dhe - li, mund të identifikojmë edhe mënyra të tërthorta të shenjimit të profesioneve, të zanateve e zejeve nëpërmjet:

- a. Materialit a lëndës së parë me të cilën punohet: Bakri, Boja, Bushi, Dërrasa, Dushku, Kashta, Pambuku, Qarri, Teneqja (për teneqexhiun).

- b. Mjetit, veglës a instrumentit me të cilin punon ushtruesi i një profesioni, zanati a zeje, si: Brisku, Çekani, Çekiçi, Çiftja, Sharra etj.
- c. Objektit të prodhuar, të riparuar a të ndrequr, por edhe tregtuar, si: Piperi, Biçaku, Çerepi, Gjymi, Këmbora, Kanaçja, Krypa, Masati, Pogaçja, Qyrku, Sahati, Salepi, Shajaku, Shosha etj.

Në këtë grup emërtimeve mbeten për t'u sqaruar motivi dhe historia e shndërrimit të tyre në patronime, gjë mjaft e vështirë, por këtu po i trajtojmë si denominues të tërthortë, në kufi me nofkat e llagapet.

Në procesin e huazimit nga turqishtja, gjuha shqipe, së bashku me emrat e foljet, që janë në numër të ndryshëm, ka marrë prej saj edhe disa prapashtesa, ndër të cilat këtu na interesojnë këto prapashtesa: **-xhi** (edhe varianti **-çi**), **-llar (-ler)**, **-li (-lli)**. “Për sa i takon prapashtesës së parë (- xhi) dhe variantit të saj fonetik (- ç) pas temave më bashkëtingëllore të shurdhëta, zë funksionin e emrit të vepruesit.<sup>115</sup> Ky funksion i kësaj prapashtese, me gjithë përpjekjet për ta shmangur, sidomos në gjuhën e shkrimit, duke e zëvendësuar më- **tar**, ajo ka mbetur e ngurtësuar në kategorinë e patronimeve që po shqyrtojmë këtu (Jorganxhi, Çorbaxhi etj.). edhe dukuria tjetër e formimeve me këtë prapashtesë, që ka dy variante shquarjeje me - u (Bojaxhiu, Jorganxhiu, Kallajxhiu, Barkaxhiu) dhe Barkaxhia, Topçia, Thikaxhia etj. Për këtë kategori patronimesh mund të themi se janë mjaft të larmishme dhe interesante sidomos në aspektin e motivimit semantik dhe dendurisë së përdorimit. Mbizotërimi i patronimeve nga fjalë të turqishtes ka lidhje të drejtpërdrejtë me kohën kur janë fiksuar patronimet pas emrave të parë të shqiptarët, si shtetas të perandorisë osmane.

**4.Grupi i katërt.** Një grup të veçantë në patronimet që po shqyrtojmë, përbëjnë patronimet me burim nga nofkat e llagapet. Për këtë tip patronimesh T. Osmani shprehet: “Në përgjithësi janë të qartë nga kuptimi, ndonëse kushtet në të cilat u janë ngjitur këto llagape nuk i dimë”.<sup>116</sup> Kur ka marrë në shqyrtim lëndën onomastike të “Regjistrin kadastral të Shkodrës” T.Osmani e ka veçuar këtë grup patronimesh, por i ka ndarë në dy tipa:

1. Antroponime që vijnë nga fjalë që shënojnë veçori fizike ose morale të njeriut.
2. Antroponime të prejardhura prej ofiqesh (nofkash) midis të cilave dallon: antroponime që vijnë nga emri i një kafshe, antroponime të prejardhura nga emra që shënojnë një të metë fizike, të përdorur me kuptim të figurshëm.

Duke marrë në shqyrtim këtë kategori patronimesh, studiesi J.Shpuza bën këtë klasifikim:

<sup>115</sup> Xhuvani A.- Çabej, E. Prapashtesat e gjuhës shqipe, në “Studime gjuhësore”, vëll.III, f.295.

<sup>116</sup> Osmani, T. Vep. cit. f.14.

1. Patronime nga fjalë që emërtojnë të meta fizike, si Sakati, Topalli Shurdhi, Qorri, Doraci etj.
2. Emra shpotitësnë funksion patronimesh, ku përfshin nofka të tilla si Pilafi, Tutkalli etj.
3. Patronime që emërtojnë të meta psikike, si Trashë, Trashani, Makabashi etj.
4. Patronime që emërtojnë të meta të karakterit të njeriut, si Havalja, Rrodhja etj.
5. Patronime nga nofka që përftohen prej emërtime si të kafshëve, si Derri, Dosa, Kali, Kokoshi, Magari etj.
6. Një grup më vete trajton emërtimet e pjesëve të trupit të njeriut në rol patronimesh, si Këmba, Koka, Qafa, Syri, Veshi, , të cilat gjithashtu janë nofka.
7. Grupin e fundit e përbëjnë patronimet që vijnë nga mbiemrat, të cilët i quan një burim i begatë për patronime, duke bërë edhe këtu një ndarje të brendshme: - patronime që burojnë nga fjalë që emërtojnë ngjyra: Bardhi, Kuqi, Ziu; - patronime që burojnë nga fjalë që emërtojnë madhësi: Madhi, Vogli, Gjata, Shkurta; - patronime nga fjalë që emërtojnë cilësi fizike dhe morale: Bujari, Bukura, Çeli, Kaleshi, Krenari, Kuka dhe një varg i gjatë emrash familjarë që vijnë nga fjalët që emërtojnë cilësi: Bumçi, Keqi, Larti, Llopësi, Xhymerti, etj.<sup>117</sup>

Nofkat e llogarit janë krijime që vijnë së jashtmi, të ngjitura nga të tjerët. Nofka a llogarit në thelb është individuale, sepse të gjithë në zanafillë kanë të bëjnë me veçoritë fizike a morale të njeriut. Trashëgimi i nofkave të brezave pasardhës kalon po atë proces si emërtimet e origjinës e të profesionit, por këtu nuk ka më motivim, sepse vetë veçoritë fizike e morale mund të mos jenë të trashëgueshme.

Një veçori tjetër që shquan këtë kategori patronimesh nga të tjerat dhe pikërisht nga fakti që ajo i imponohet mbartësit nga jashtë, nga të tjerët, që në fillim është i papëlqyeshëm e në qoftë se vijon të mbahet, kjo ndodh se emërtimi shkuptimëzohet e humbet domethënien, prandaj edhe mbajtësit e brezave pasardhës nuk e ndiejnë si të tillë.

Kalimi i mbiemrave të nyjshëm a të panyjshëm në patronime është rruga më e drejtpërdrejtë, sepse semantikisht mbetemi në të njëjtën fushë, në atë të cilësisimit, të karakterizimit, që më së miri kryehet me këtë kategori leksiko-gramatikore. Por në këtë funksion dalin edhe emra që shprehjen e cilësisë e kanë në semantikën e tyre: Avdalli, Bandilli, Behari, Çollaku, Doraci, Kaçaku, Magjistari, Plaku, Shkurta, Trimi, Vokshi, Vokri etj. Në aspektin semantik këto lloj patronimesh janë krijuar nga fjalë që:

- tregojnë veçoritë fizike të njeriut dhe identifikimi i tyre mund të bëhet nëpërmjet antonimisë: - i madh/i - i vogël/i, pra një karakteristikë fizike që e veçon njeriun

---

<sup>117</sup>Shpuza, J. vep., cit., f.50-54.

për nga masa e shprehjes së saj, si: Madhi, Madhaj, Vogli, Voci, Vokri, Vokshi etj.

- nga antonimi tjetër i gjatë - i shkurtër formohen patronime Gjata, Shkurti, Shkurtaj.
- nga antonimi i trashë - i hollë formohen patronimet Trasha, Trashi, Holli, Olli etj.

Mbështetur në veçoritë fizike të njeriut, të pjesëve të trupit të tij, të nofkave me burim nga zoonimet, ngjyrat, apelativët që shënojnë veçori morale etj. patronimet janë të shumtë. Ne këtu nuk kemi si qëllim të paraqesim në mënyrë të detajuar të gjitha këto lloje patronimesh, por disa karakteristika të patronimeve mbështetur në 100 patronimet me frekuencë më të lartë përdorimi.

Nga analiza e mësipërme arrijmë në përfundimin se një karakteristikë e përgjithshme e antroponimisë sonë bashkëkohore është larmia e saj e madhe, ku ka gjurmë ndikimi i kohëve të kaluara dhe vrulli i zhvillimit të gjithanshëm bashkëkohor. Shqipja i përmban në sistemin e vet patronimik, të formuar historikisht dhe tashmë të mbyllur, të gjitha tipet e patronimeve për krijimin e të cilave ka rrahur rrugë të ndryshme, që i ka diktuar ndër të tjera edhe natyra e saj si gjuhë sintetiko-analitike. Kjo dhe për faktin e depërtimit të arsmiit e kulturës së përgjithshme në shtresat e gjera të popullit.

Rritja e mjeteve të informimit dhe depërtimi i tyre në gjithë familjet shqiptare ka sjellë dhe depërtimin e antroponimisë së re te populli ynë. Fëmijëve po u vihen emra shqiptarë, por vitet e fundit vihet re dukuria e shtimit të emrave vetjakë të huaj të ardhur nga antroponimia artistike apo emrat e personazheve, sidomos të telenovelave që kanë pushtuar ekranet e televizorëve, por dhe nga veprat letrare të përkthyer në gjuhën tonë. Ndaj mendojmë se është i domosdoshëm hartimi i fjalorëve me emra thjesht me burim shqip e t'u rekomandohen qytetarëve nëpër zyrat e gjendjes civile për t'i përdorur për fëmijët e tyre.

Studimi i antroponimisë dhe i patronimisë shqipe me kritere të rrepta shkencore duhet të bëhet një ndërmarrje e rëndësishme, e cila fillon me evidentimin e këtij leksiku nga botimet e derisotme të burimeve dhe dokumentacionit historik. Kontribut modest mund të sjellë çdokush që ka formimin e duhur gjuhësor, por të parët që duhet të japin mendimet e tyre për përkatësinë gjuhësore të këtij fondi emrash vetjakë dhe rrugën e formimit të tyre në trajtat që i kemi në dokumentacionin historik dhe në gjendjen e sotme, duhet të jenë gjuhëtarët. Studimet shkencore për emrat vetjakë do të shmangin dhe interpretimet jo të drejta, ndonjëherë dhe të qëllimshme nga studiues të huaj.



## KREU IX.

### VENDI I FJALËSIT ONOMASTIK NË DISA FJALORË DYGJUHËSH

#### 9.1 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Deri në botimin e “Fjalorit të gjuhës shqipe” 1954, si i pari fjalor shpjegues i gjuhës shqipe, historia e leksikografisë sonë, me ndonjë përjashtim të rrallë, si Gazulli, në thelb ka qenë dygjuhëshe. Nga vitet 90-të e këtej ka pasur një fluks të madh botimesh të fjalorëve dygjuhësh. Studiuesi A.Dhrimo në larminë e madhe të botimeve sheh rrezikun e cilësisë së ulët, pasi me botimin e fjalorëve merren edhe njerëz jo profesionistë të gjuhës shqipe ndaj shprehet se, “nuk është e udhës që Instituti i Gjuhësisë ta quajë dygjuhësinë punë jo të vetën dhe t’ua lërë hartimin e fjalorëve dygjuhësh të tjerëve, të cilët mund të kenë lidhje me turqishten, greqishten anglishten, frëngjishten, gjermanishten etj., por nuk kanë formim filologjik. Përvoja tregon se është e domosdoshme që hartuesit të jenë, në radhë të parë, njohës të thellë të gjuhës amtare, madje mund të mbajnë qëndrim kritik edhe për të dhëna të pamjaftueshme të fjalorëve njëgjuhësh. Formim i tillë kërkohet edhe për gjuhën e huaj. Vetëm ndër ne hasen fjalorë nga gjeografë, kimistë, mekanikë, fizikantë etj.”<sup>118</sup>

Pasi folëm për shtimin e fjalëve në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, për mikrostrukturën e fjalëve në këta fjalorë, si dhe për pasqyrimin e fjalësit onomastik aty, tani do të ndalemi për të bërë një vëzhgim të shkurtër mbi zhvillimin e fjalësit onomastik në disa fjalorë dygjuhësh, si dhe për të dhënë një informacion të tillë rreth organizimit të makro e mikrostrukturës së tyre., për të realizuar në mënyrë të plotë qëllimin që i kishim vënë vetes në temën që përcaktuam për ta zhvilluar.

Në hyrjen e temës ne kemi dhënë në mënyrë kronologjike, krahas fjalorëve shpjegues, dialektorë, terminologjikë edhe kronologjinë e botimeve të disa prej fjalorëve dygjuhësh, ku vëmë re se periudha më intensive e botimit të tyre është ajo pas vitit 1990. Kjo shpjegohet me faktin se, përveç kërkesës për fjalorë të mesëm apo të mëdhenj, ndryshimet globale shoqërore e politike në të cilat u përfshinë edhe trojet tona, si vendosja e pluralizmit politik e ekonomik, hapja e shoqërisë shqiptare e lidhja e shumëanshme me Perëndimin, emigracioni intensiv dhe rritja e interesit për gjuhët e huaja, krijimi i realitetit të ri në Kosovën e pasluftës, bënë që nevojat për fjalorë dygjuhësh të ndjehet më shumë. Në rrethanat e krijuara, për t’i përmbushur këto kërkesa, por edhe për të mbajtur hapin me realitetin e ri, në trevat tona panë dritën e botimit shumë fjalorë shqip - gjuhë e huaj, apo dhe gjuhë e huaj - shqip, të vëllimeve të ndryshme.

---

<sup>118</sup> A.Dhrimo, A. “Leksikografia shqipe- trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.224-225.

Fjalorët dygjuhësh kanë pasuruar shumë edhe gjuhën shqipe në përgjithësi. Midis fjalorëve dygjuhësh e shpjegues të gjuhës shqipe ekzistojnë shumë fjalë që janë te njëri fjalor, por nuk janë te tjetri. Ka shumë fjalë që janë pasuri e gjuhës shqipe, por nuk gjenden në fjalorët shpjegues dhe gjenden në fjalorë dygjuhësh. P.sh. fjala donkishot, e cila si emër i përgjithshëm jepet në fjalorët tanë, por fjala nastradin, e cila është shumë e përdorur e për të cilën kemi edhe fjalën nastradinllëk, nuk jepet në fjalorët shpjegues, madje as në fjalorin e vitit 2006., e as në fjalorë dygjuhësh.

Kemi konstatuar se ka autorë që kanë përgatitur fjalor gjuhë e huaj - shqip dhe shqip - gjuhë e huaj, një prej të cilëve do ta analizojmë më poshtë, fjalorin shqip - gjermanisht dhe gjermanisht - shqip të A.Hetzerit. Konstatimi i parë që bëjmë në këta fjalorë është se pasuria leksikore shqipe e variantit gjuha e huaj - shqip është shumë më e madhe se ajo e variantit shqip-gjuhë e huaj. Në rastin e dytëhartuesit e fjalorit kanë marrë dhe janë mbështetur thjesht te fjalori shpjegues i shqipes.

## **9.2 FJALËSI ONOMASTIK NË FJALORIN DYGJHËSH TË A. HETZERIT**

Në gjendjen e sotme të gjuhës standarde janë vendosur norma të përpunuara e të qëndrueshme në të gjitha nënsistemet e saj, në fonetikë, në gramatikë, në leksik, në fjalëformim e në stilistikë. Funkcionet shoqërore të saj janë zgjeruar shumë duke u shtrirë në të gjitha fushat e jetës e veprimtarisë. Ajo ka fituar tipare të dallueshme veçanërisht në fushën e leksikut, të frazeologjisë e formimit të fjalëve.

Në studimet e shumta leksikografike është evidentuar fakti se studimi dhe njohja e leksikut është një nga detyrat kryesore të leksikografëve, pasi pasuria dhe larmia e leksikut është një tregues i drejtpërdrejtë i pasurisë dhe i zhvillimit të gjuhës. Duke e parë në aspektin e peshës specifike që ka leksiku në gjuhë, del edhe rëndësia e madhe që kanë fjalorët ku pasqyrohet ky leksik në zhvillimin e tij.

Në punimin tonë ne do të analizojmë vetëm pasqyrimin e fjalësit onomastik në fjalorët që do të marrim në shqyrtim. Nga llojet dhe tipat e ndryshëm të fjalorëve, për të vëzhguar pasqyrimin e këtij fjalësi, do të ndalemi në “Fjalorin gjermanisht-shqip e shqip-gjermanisht”, të A.Hetzerit, 1991, “Fjalorin gjermanisht-shqip”, 2002, të prof.dr. Ali Dhrimos, si dhe fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe “Fjalori i shqipes së sotme”, 1984. Në këta fjalorë do të veçojmë Fjalorin e Hetzerit dhe “Fjalori i shqipes së sotme”, 1984, jo vetëm për peshën specifike që zë fjalësi onomastik në raport me fjalësin e përgjithshëm, por dhe për mënyrën e pasqyrimin të këtij fjalësi, do të shprehim mendimin se cila duhet të jetë hapësira që duhet të zërë ky lloj fjalësi në fjalorët shpjegues e dygjuhësh, ku veçanërisht këta të fundit, njëzet vjetët e fundit kanë njohur një bum botimesh në vendin tonë.

Ne nuk marrim përsipër të gjykojmë cilësinë e këtyre fjalorëve, as vëzhgimin e gjithë fjalësit të tyre, por do të ndalemi vetëm te fjalësi onomastik i disa fjalorëve që ne menduam se do të sjellin materialin e mjaftueshëm për të argumentuar idenë tonë në lidhje me mënyrën e pasqyrit të këtij fjalësi. Në një analizë që u kemi bërë, në fjalorët që po shqyrtojmë, toponimeve, të cilat jo më kot janë cilësuar “përmendore të kujtesës njerëzore”<sup>119</sup>, vërejmë se rrethi i makrotoponimeve ka kaluar <sup>120</sup>shumë përtej kufijve kombëtarë, duke e pasuruar fjalësin e këtyre fjalorëve me emrat e kontinenteve, të shteteve, kryeqyteteve e qyteteve kryesore. Makrotoponimet dhe emrat etnikë që shënojnë banorin e krahinave, qyteteve e fshatrave të Shqipërisë, apo banorët e shteteve e qyteteve të ndryshme të botës, përdorimet mbiemërore, emërtimi i gjuhëve dhe përdorimet ndajfoljore të tyre, kanë gjetur vend pasqyrimi në fjalësin e tyre dhe e kanë pasuruar këtë fjalës. Nga fjalorët e përmendur më sipër po veçoj “Fjalori gjermanisht-shqip e shqip-gjermanisht” të Hetzerit, fjalor me rreth 12000 fjalë, për faktin se brenda fjalësit të fjalorit, në të dyja pjesët e tij, janë përfshirë edhe toponimet, gjë që nuk është në natyrën e fjalorëve të tillë, pasi ato fjalë janë emra të përveçëm dhe si të tilla duhet të përfshihen në fjalorët onomastikë.

Ky fjalor dygjuhësh është i ngjashëm me “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, por vetëm me shtojcën e këtij fjalori. Ndryshimi qëndron në faktin se në Fjalorin e tij Hetzeri, këtë pasuri leksikore, e përfshin të gjithën në fjalësin e fjalorit, ndryshe nga Fjalori i 1984-ës, që përfshin në fjalës vetëm emërtimet e gjuhëve e të folmeve si dhe përdorimet ndajfoljore të tyre, ndërsa toponimet, emrat etnikë, emrin e banorit që vjen direkt pas emrit të vendit dhe ka kuptimin “banor vendës i atij shteti, qyteti a fshati” <sup>121</sup> dhe mbiemrin që vjen pas emrit të banorit dhe ka kuptimin “që lidhet me atë vend a me banorët e tij, që është karakteristik për atë vend e për banorët e tij ose është krijuar prej tyre”,<sup>122</sup> i ka të vendosura në shtojcë. Më poshtë do të paraqesim në tabelë numrin e fjalësit onomastik të pjesës shqip-gjermanisht e gjermanisht-shqip të Fjalorit të Hetzerit, të krahasuar me fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe, “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, si dhe krahasimin midis dy pjesëve të këtij fjalori, gjermanisht-shqip e shqip-gjermanisht, pasi ka një ndryshim të madh të fjalësit onomastik midis tyre, gjë që tregon se nuk është përdorur i njëjti kriter e material leksikor, si dhe faktin se autori është nisur nga qëllime të ndryshme praktike gjatë hartimit të fjalorit dygjuhësh.

---

<sup>119</sup> Halimi, M. Mbi disa toponime të tipit perifrastik, OK, Prishtinë, 1979, f.243.

<sup>120</sup> Halimi, M. Mbi disa toponime të tipit perifrastik, OK, Prishtinë, 1979, f.243.

<sup>121</sup> Dhrimo, A. Probleme teorike dhe praktike për hartimin e fjalorëve dygjuhësh, “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.

<sup>122</sup> Dhrimo, A. Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit, Konferenca e Dytë Albanologjike, III, Tiranë, 1962.

**FJALORI SHQIP-GJERMANISHT E GJERMANISHT-SHQIP I HETZERIT, 1991**

	FJALORI SHQIP-GJERMANISHT				FJALORI GJERMANISHT-SHQIP			
	Toponime të huaja	Toponime shqiptare	Emra etnikë të huaj	Emra etnikë shqiptarë	Toponime të huaja	Toponime shqiptare	Emra etnikë të huaj	Emra etnikë shqiptarë
A	35	4	19	21	40	2	22	3
B	53	7	16	29	45	2	13	1
C	6		1	5	24		2	
Ç	6		5	5				
D	13	2	5	29	15	3	3	3
DH				2				
E	13		4	2	12	1	3	1
Ë								
F	11	3	4	11	9	1	2	1
G	15	1	5	16	19	4	4	2
GJ	5	3	2	9				
H	13		6	9	11		1	
I	12	1	8	3	14		10	
J	9		5		7	1	3	
K	51	3	12	39	42	4	8	2
L	23		3	27	23		4	2
LL				2				
M	38		8	30	46	2	7	1
N	14		4	5	22		5	
NJ	3							
O	9		1	1	15		1	
P	29	4	11	29	29	5	10	4
Q	3		2	4	2			
R	10	1	4	6	9	1	2	
RR	1	1		1				
S	37	2	16	19	43	6	15	2
SH	10	3	1	19				
T	27	3	7	10	33	3	8	2
TH								
U	5		3	3	6	1	3	1
V	22	1	5	21	10	1	3	1
X				1				
XH	3		1	1				
Y								
Z	5		1	8	3	1	1	
ZH								
W					12		1	
<b>Shuma</b>	<b>481</b>	<b>39</b>	<b>159</b>	<b>367</b>	<b>491</b>	<b>38</b>	<b>131</b>	<b>26</b>

Gjithashtu ne do të bëjmë një krahasim jo vetëm në vlera numerike, por dhe do të shohim se ç'toponime e emra etnikë të banorit kanë zënë vend në këtë fjalor, sa janë toponime të huaja e sa janë toponime shqiptare, sa emra etnikë janë të huaj e sa janë shqiptarë, në cilën pjesë të fjalorit pasqyrohen më shumë toponime e emra etnikë, cili është raporti i toponimeve e emrave etnikë shqiptarë me ata të huaj brenda çdo pjese të fjalorit e midis dy pjesëve të tij, si dhe me fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe të vitit 1984. Siç shihet nga tabela, te pjesa shqip-gjermanisht, fjalësi onomastik zë vend më të madh në raport me fjalësin e përgjithshëm, afërsisht 9.5%, sesa në pjesën gjermanisht-shqip, ku ky fjalës zë afërsisht 5% të fjalësit të përgjithshëm. Kjo tregon se autori i fjalorit ka dashur të japë më shumë informacion të këtij lloji për lexuesin gjerman, sesa atë shqiptar. Në pjesën shqip-gjermanisht përfshihen në fjalësin e përgjithshëm të fjalorit 1046 njësi onomastike, nga të cilat 640 janë toponime e emra etnikë të huaj dhe 406 janë toponime emra etnikë shqiptarë. Nga gjithë fjalësi onomastik i huaj, 481 njësi onomastike janë toponime dhe 159 janë emra etnikë të huaj

### 9.3 KRAHASIMI I FJALËSIT ONOMASTIK TË FJALORIT TË HETZERIT ME “FJALORIN E SHQIPES SË SOTME” 1984

Për fjalësin onomastik në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1984, kemi folur dhe kur kemi krahasuar fjalësin onomastik në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Rimarrja e informacionit të tabelës me fjalësin onomastik të këtij fjalori bëhet për efekt krahasimi, tashmë të një fjalori dygjuhësh me fjalorin shpjegues të shqipes. Merret për krahasim fjalësi i këtij fjalori, pasi siç e kemi shpjeguar dhe më sipër, parë nga numri i njësive leksikore onomastike dhe mënyra e paraqitjes së tyre në nomenklaturë dhe jashtë saj, është e veçantë në të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Por edhe për një fakt tjetër, për sasinë dhe cilësinë e lëndës që ofrojnë, veçanërisht “Fjalori shqip - gjermanisht dhe gjermanisht - shqip” i Hetzerit nga fjalorët dygjuhësh, është i përafërt me fjalorin shpjegues të vitit 1984. Në këtë mënyrë, nga krahasimi me tipa të ndryshëm fjalorësh, mund të nxjerrim konkluzione më të sakta për pasqyrimin e këtij fjalësi në fjalorin shpjegues “Fjalori i gjuhës shqipe” 1984, dhe të shprehim mendimin se cili duhet të jetë vendi i fjalësit onomastik në fjalorët shpjegues, pse janë të domosdoshëm dhe si duhet të pasqyrohen, brenda apo jashtë nomenklaturës së fjalorëve shpjegues.

Në fjalor janë dhënë toponime të tilla si: *Abisini, Afganistan, Afrikë, Alpet Dinarike, Alpet e Evropës, Andet, Amerikë, etj.* Këtu nuk po analizojmë nënndarjet e toponimeve, por pasqyrimin e tyre si toponime në përgjithësi. Emrat etnikë janë më të paktë në numër se toponimet, afërsisht tri herë më pak, dhe jo gjithmonë u përgjigjen oikonimeve që janë në fjalësin e fjalorit. Në fjalor, siç e thamë më sipër janë vendosur 159 emra etnikë, si: *afgan, afrikan, anglo-amerikan (-), grek, gjerman, holandez, kanadez, Korean, sllovak (-), sudanez (-), vitnamez (-) etj.* (Fjalët që kanë vijë në kllapa përbri, nuk kanë oikonimin përgjegjës në fjalësin e fjalorit, por është pasqyruar vetëm emri etnik).

Pjesa me toponime dhe emra etnikë shqiptarë është më e paktë në numër, gjithsej 406. Ajo zë rreth 40% të gjithë fjalësit onomastik të “Fjalorit shqip- gjermanisht”. Toponimet shqiptare zënë shumë pak vend, rreth 4% të tij, ose 10% të pjesës shqipe, gjithsej 39 fjalë. Nga emrat toponimikë shqiptarë në fjalor kemi këto fjalë: *Berat, Belsh, Bjeshkët e Nëmuna, Durrës, Fier, Ferizaj, Gegëri, etj.* Ndoshta autori nuk e ka quajtur të domosdoshme të pasqyronte më shumë toponime shqiptare në fjalor, pasi ai mund të jetë nisur nga fakti se, gjatë pasqyrimin të emrave etnikë, mbas çdo fjale jepet edhe shprehja “banor i atij vendi”, p.sh. elbasanas (aus Elbasan), korçar (aus Korçë), Lezhjan (aus Lezha) etj. Në qoftë se do të marrim në konsideratë këtë fakt, atëherë mund të themi se informacioni toponimik me lëndë shqiptare në Fjalorin e Hetzerit është edhe rreth 300 njësi më shumë. Këtu, nga numri i përgjithshëm i emrave etnikë shqiptarë, kemi zbritur ato oikonime të cilat, krahas bashkëshoqërimit me emrin etnik, janë pasqyruar edhe si zë më vete në fjalësin e fjalorit.

**FJALORI I SHQIPES SË SOTME, 1984**

Shkronja	FJALËSI ONOMASTIK SHQIPTAR				FJALËSI ONOMASTIK I HUAJ			
	Oikonime	Emra dhe Mbiemra etnikë	Hidronime	Oronime	Oikonime	Emra dhe mbiemra etnikë	Hidronime	Oronime
A	1	5	1	1	10	37	4	7
B	7	26			11	49	4	2
C	20	36			17	27	6	2
Ç	25	37	4	5	13	22	1	2
D	26	46	1		7	10		
DH	25	43		5	2	17	1	1
E	32	56	5	1	6	2	8	2
Ë	15	36	1	1	6	9	3	
F	17	28	2	1	8	20	2	1
G	22	45		5	5	7	7	
GJ	31	50		8	2	14		1
H	21	33	2	1	5	14	1	1
I	17	34			5	35		1
J	11	18	1	2	9	25	5	
K	30	41		2	13	12	2	4
L	25	45	1	1	15	21	2	2
LL	33	56	1	2	5	7		
M	30	56	4	1	5	14	2	
N	26	41	8	2	11	4		5
NJ	19	31		25	11	16		3
O	29	52		2	20	9	3	
P	18	30		5	16	28	3	
Q	18	30	1	1	14	18	5	1
R	29	40	1	1	9	16	1	2
RR	33	54			11	15	1	1
S	22	33		20	1	5		
SH	28	29		2	11	13		
T	17	29	1		19	29	1	2
TH	20	34		2	12	24	1	
U	33	61	1	5	4	3		4
V	19	33		2	14	16	2	4
X	21	35		2	8	11		4
XH	16	30	5	6	7	15		
Y	26	45	1		9	12	2	4
Z	28	44	1		4	11		
ZH	4							
<b>Shuma</b>	<b>794</b>	<b>1342</b>	<b>42</b>	<b>111</b>	<b>325</b>	<b>588</b>	<b>67</b>	<b>56</b>

Emrat etnikë, siç e thamë më lart, zënë pjesën më të madhe të fjalësit onomastik me burim shqiptar, gjithsej 367 fjalë onomastike. Në fjalor janë dhënë emra etnikë si: *beratas, belshak, voskopojar, berishas (aus Berisha), bicjan (aus Bicaj), damësjet (aus Damës), fierzak (aus Fierzë), frashërlli (aus Frashër) etj.* Emrat etnikë me shpjegimet në kllapa nuk e kanë oikonimin përgjegjës në fjalësin e fjalorit.

Një raport krejt tjetër është në pjesën gjermanisht shqip të fjalorit. Edhe si numër njësitë onomastike janë më të pakta, gjithsej 686 njësi. Në fjalësin onomastik të kësaj pjesë 622 njësi, ose rreth 90%, janë toponime dhe emra etnikë të huaj dhe vetëm 64 njësi, ose rreth 10%, janë toponime e emra etnikë shqiptarë. Pra, siç shihet, në pjesën gjermanisht-shqip, informacioni enciklopedik shqiptar nuk ka raporte të barabarta me informacionin për vende të tjera të njohura. Kjo ndoshta shpjegohet nga fakti se autori i fjalorit më tepër i drejtohet një lexuesi që ka informacion të bollshëm për vendin e tij nga burime të tjera.

Nga 622 njësitë onomastike joshqiptare, 491 njësi, ose 79%, të tyre e zënë toponimet dhe vetëm 131 njësi, ose 21%, e zënë emrat etnikë të banorit. Nga toponimet joshqiptare që janë pasqyruar aty po japim disa prej tyre: *Afrikë, Algjeri, Amerikë, Andet, Ankara, Bazel, Bagdad, Kinë, Kili, Finlandë, Francë Ganë, Havai, Itali, Xhamajkë, Lombardi, Libi, etj.*, ndërsa emra etnikë të huaj të pasqyruar në Fjalor janë gjithsej 131 njësi si: *abisinias, afgan, egjiptian, algerian, grek etj.* Në njësitë onomastike shqiptare janë dhënë 38 toponime dhe 26 emra etnikë të banorit si: *Berat- beratas, Gjakovë-gjakovar, Durrës-durrsak, etj.*

Duke e krahasuar Fjalorin e Hetzerit me “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, shohim se kemi ndryshime midis dy fjalorëve, ndryshime që konsistojnë jo vetëm në numër njësish onomastike, por edhe në konceptim a mënyrë pasqyrimi e në njësi toponimike të përbashkëta dhe të ndryshme. Siç e kemi thënë dhe më lart, Fjalori i Hetzerit, në të dyja pjesët e tij, gjithë njësitë onomastike i ka dhënë në fjalës, ndryshe nga “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, që ka dhënë në fjalës vetëm emërtimin e gjuhëve e përdorimet ndajfoljore të tyre si: *anglishte (gjuha)- anglisht (ndajfolje), frëngjishte-frëngjisht.* Ky Fjalor, i 1984-ës, ka gjetur zgjidhjen me shtojcë me titull: “Emrat gjeografikë, emërtimet e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe mbiemrat që lidhen me to”.<sup>123</sup>

Edhe në aspektin sasior, brenda numrit të njësive toponimike që ata pasqyrojnë, kanë raporte të ndryshme në numrin e fjalëve të përbashkëta e atyre të ndryshme. Fjalori i Hetzerit ka 1046 njësi toponimike, pra rreth tri herë më pak se Fjalori i 1984-ës, i cili ka 3325 njësi toponimike, nga të cilat 1036 janë emërtime nga vende të ndryshme të botës dhe 2289 janë emërtime të territorit të Shqipërisë e trojeve të banuara nga shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë londineze.

---

<sup>123</sup> Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë, 1984, f.1421.



Pra, siç shihet, në këtë fjalor, ndryshe nga ai i Hetzerit, ndryshon raporti i njësive onomastike shqiptare me ato të huaja në favor të atyre shqiptare. Përveç kësaj, vihet re edhe një dallim tjetër. Nga 1046 njësi onomastike të Fjalorit të Hetzerit, 798 njësi janë të përbashkëta, ndërsa 248 njësitë e tjera të pjesës shqip-gjermanisht janë të ndryshme nga ato të fjalorit shpjegues të gjuhës shqipe të vitit 1984, pra janë vetëm në Fjalorin e Hetzerit. Meqë “Fjalori gjermanisht-shqip e shqip-gjermanisht” i Hetzerit është botuar në vitin 1991, shtatë vjet më vonë se “Fjalori i shqipes së sotme”, mendojmë se mund të jetë shfrytëzuar materiali i këtij të fundit për pasqyrimin e fjalësit onomastik të pjesës shqiptare.

#### **9.4 FJALËSI ONOMASTIK NË FJALORIN GJERMANISHT-SHQIP TË A.DHRIMOS**

Një kontribut të vyer në pasqyrimin e fjalësit onomastik në fjalorët dygjuhësh ka sjellë prof.dr. Ali Dhrimo me “Fjalori gjermanisht-shqip”, me rreth 45.000 fjalë, botuar në vitin 2002. Për të çmuar vlerën që ka një fjalor dygjuhësh duhet të merret për bazë pika nëse e plotëson qëllimin për të cilin është hartuar. dhe a shënohet ndonjë përparim në raport me fjalorët e tjerë. Koha në të cilën u botua ky fjalor dygjuhësh, sigurisht që i krijoi avantazhe autorit, pasi ishte i çliruar nga çdo kufizim në aspektin e dhënies së kuptimit leksikor të një kategorie fjalësh, por edhe se ekzistonte një praktikë deri diku e konsoliduar. E kemi veçuar këtë fjalor dygjuhësh edhe për faktin senë të jepet një material i pasur onomastik dhe ndryshon nga fjalorët e tjerë dygjuhësh pasi një pjesë e këtij fjalësi jepet në shtojcë, si në asnjë fjalor dygjuhësh të botuar deri atëherë.

Një fjalor dygjuhësh ka si qëllim kryesor të ndihmojë për njohjen e gjuhëve letrare respektive. Këtë ka synuar dhe hartuesi i fjalorit, si një njohës i mirë i gjuhës sonë, dhe mund të konstatojmë se ja ka arritur qëllimit, sidomos me përfshirjen e leksikut aktual, duke treguar një kujdes të posaçëm me fjalët e futura së fundi në gjuhën shqipe, që përkon me ndryshimet e mëdha politike e shoqërore, hapja me botën, arsye për të depërtuar një leksik më i madh, por edhe zhvillimi i shkencës, teknikës e kulturës së popullit tonë. Në ndërtimin e makrostrukturës së fjalorit, një fjalor i tipit të mesëm, A.Dhrimo ka pasur parasysh pasqyrimin e fjalëve më të përdorshme në ligjërim, duke dhënë në mënyrë më të plotë dhe strukturën kuptimore si dhe jep disa shembuj për përdorimin e saj. Autori plotëson mikrostrukturën e fjalës edhe me veçoritë gramatikore të fjalës në gjuhën gjermane, ashtu siç edhe pasqyrohet fjala në gjuhën shqipe në fjalorët shpjegues.

Ne, në këtë informacion të shkurtër, nuk kemi pasur si qëllim të analizojmë pasqyrimin e gjithë fjalësit në fjalorin gjermanisht - shqip të A.Dhrimos, në makrostrukturë apo dhe veçoritë e mikrostrukturës në këtë fjalor, por veçoritë e pasqyrimin të fjalësit onomastik aty, duke e krahasuar me dy fjalorët e tjerë, Fjalorin e Hetzerit dhe “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, të përbashkëtat dhe dallimet me ta, pasi të tre fjalorët kanë të përbashkëta dhe dallime në pasqyrimin e këtij fjalësi, të cilat duhen marrë në konsideratë nga specialistët e fushës për të dhënë një zgjidhje përfundimtare për pasqyrimin e një pjese të fjalësit onomastik në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe dhe mënyrën e dhënies së tyre.

Këtu nuk kemi bërë një vjelje shteruese të materialit, si te dy fjalorët e tjerë, por kemi ballafaquar mënyrën e pasqyrimin të këtij fjalësi në fjalor, i cili ka të përbashkëtat dhe dallimet e tij, siç u shprehëm më sipër, me mënyrën e pasqyrimin në dy fjalorët që analizuam. Ashtu si Fjalori i 1984-ës, ky fjalor ka shtojcë, ndryshe nga fjalori i Hetzerit, por këtë e ka vetëm për toponimet, ndërsa emrat etnikë, gjuha dhe përdorimet ndajfoljore jepen në fjalës, ashtu siç vepron Hetzeri me Fjalorin e tij. Kjo ndodh se vetë kriteret e fjalorëve shpjegues ndonjëherë e copëzojnë çerdhen e leksikut onomastik, sepse nuk mund të pasqyrojnë brenda fjalësit emrat e përveçëm. Kjo bën që të ndjehet i nevojshëm hartimi i fjalorëve onomastikë.

Krahasimi i mënyrave të ndryshme të pasqyrimin të fjalësit onomastik në fjalorët që analizuam, si dhe ndryshimi në numër i fjalëve të dhëna në fjalor, tregon se nuk kemi ende një traditë të ngulitur në këtë fushë dhe se zgjidhjet e fjalorëve janë zgjidhje konvencionale. Meqë “toponimia e një vendi ka interes për shumë degë të shkencës, si për gjuhësinë, etnografinë, studimin e legjendave, problemet mjaft të gjera të prehistorisë e të historisë së vendbanimeve”<sup>5</sup>) ato nuk duhen lënë në mëshirën e fatit, por i duhet kushtuar kujdes i veçantë mbledhjes e ruajtjes së tyre në vepra leksikografike si fjalorët.

Për mendimin tonë më e përshtatshme, nga zgjidhjet e derisotme, duket zgjidhja që ka dhënë “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, sepse informacioni për emrin e vendit, banorin dhe mbiemrin që lidhet me vendin dhe banorin, e ka pasqyruar nën një glosë (*Berat-i~ m; Beratas~i, m.sh~, ~it; Beratas~e, mb.*) dhe është mjaft praktik për t’u përdorur nga lexuesi kur kërkon të gjejë një informacion që i duhet për këtë fjalës. Megjithatë edhe kjo zgjidhje nuk e mbulon plotësisht fjalësin onomastik të një gjuhe, çka nxjerr nevojën e hartimit të një fjalori të veçantë për njësitë emërtuese të kësaj fushe, botimin e një fjalori onomastik që të përfshijë toponimet e të gjitha llojeve, emrin etnik, mbiemrin që lidhet me atë emër, gjuhën dhe përdorimin ndajfoljor të saj, jo vetëm për emërtimet shqiptare, por edhe të huaja.

## KREU X

### 10.1 INFORMACIONET JASHTË NOMENKLATURËS

Me termin nomenklaturë e fjalorit shpjegues gjuhëtarët kanë parasysh tërësinë e informacioneve në makrostrukturë dhe mikrostrukturë. Por, përveç këtij informacioni, fjalorët shpjegues kanë dhe një informacion shtesë që nuk lidhet në mënyrë organike me informacionet bazë, por është i domosdoshëm për konsultuesin e fjalorit, për ta kuptuar më mirë atë informacion. Informacionet në formë liste që jepen jashtë nomenklaturës, janë të shumta. Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe i gjejmë para nomenklaturës në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe 2002 dhe 2006, ndërsa në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, i gjejmë në fillim dhe në fund të nomenklaturës.

Ne jemi përpjekur të bëjmë një grupim të këtyre informacioneve në fjalorët shpjegues, arsyet pse pasqyrohet ky informacion në fjalor, domosdoshmërinë ose jo të pasqyrimin e tij dhe lidhjen e këtyre informacioneve me makrostrukturën dhe mikrostrukturën.

Informacionet e dhëna jashtë nomenklaturës mund të ndahen në disa grupe, pavarësisht se fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe kanë ndonjë ndryshim midis tyre, nga i pari te i fundit, me tendencë përmirësimi në fjalorin pasardhës, duke shfrytëzuar informacionet e fjalorit shpjegues paraardhës:

1. Shpjegime për ndërtimin e fjalorit (hyrja dhe bibliografia e veprave të shfrytëzuara për ndërtimin e fjalorit).
2. Shpjegime për përdorimin e fjalorit (shpjegime për ndërtimin e fjalorit, shenjat konvencionale dhe shkurtime).
3. Informacion me karakter gramatikor (zgjedhimi i foljeve, lakimi i emrave, mbiemrave dhe përemrave).
4. Informacion me karakter leksikor enciklopedik (lista e emrave të vendeve: shteteve, kryeqyteteve, qyteteve, krahinave, fshatrave maleve, fushave, deteve etj.).

Siç shihet, informacionet në një fjalor shpjegues janë të shumta dhe të ndryshme. Këto informacione, nga fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, i ka që të gjitha vetëm “Fjalori i shqipes së sotme” 1984.

Pas përfundimit të fjalorit, interesi kryesor i leksikografëve është që ky fjalor të përdoret sa më mirë dhe me sa më shumë lehtësi nga lexuesit. Ky interesim shprehet nëpërmjet shpjegimeve për ndërtimin dhe përdorimin e fjalorëve. Nëpërmjet shpjegimeve për ndërtimin e tyre, leksikografët vënë në dukje edhe punën e bërë prej tyre, etapat nëpër

të cilat ka kaluar fjalori, problemet që kanë dalë dhe zgjidhjet që janë zbatuar në makro e mikrostrukturën e fjalorit shpjegues dhe nëpërmjet punës cilësore, në mënyrë indirekte, shprehin edhe arritjet e shkencës së leksikografisë dhe të shkencave gjuhësore, të cilat janë të dukshme kur krahasojmë me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe duke filluar nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, e deri të “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006.

Në praktikën leksikografike botërore, fjalorët shpjegues janë të paisur edhe me bibliografi, ndërsa në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe nuk ekziston një praktikë e tillë. Ndoshta do të ishte pozitive pajisja me bibliografi e fjalorëve shpjegues, pasi edhe ata, si gjithë veprat e tjera studimore-shkencore, ndërtohen duke shfrytëzuar një bibliografi të caktuar, pasi ajo përbën dhe një nga treguesit e punës së leksikografëve për përgatitjen e fjalorit dhe, si e tillë, ajo duhet të pasqyrohet në fjalor.

Një vend të veçantë në fjalor zënë informacionet me karakter gramatikor, parashtesat dhe prapashtesat, zgjedhimet e foljeve, lakimet e emrave, mbiemrave e përemrave. Në të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe nuk ka informacion gramatikor jashtë nomenklaturës për fjalëformimin (parashtesat, prapashtesat, përngjitjen dhe përbërjen). Ky informacion jepet brenda zërave leksikografikë jo të drejtpërdrejtë, por të nënkuptueshëm, duke vendosur fjalët njëra pas tjetrës pas fjalës rrënjë, sipas radhës së formimit. Më e qartë është kjo te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, pasi aty, disa njësi leksikore si, foljet vetvetore e pësore, emrat e veprimit dhe mbiemrat prejppjesorë te çerdhja e foljes veprorë, ndajfoljet me prapashtesën *-as, -azi*, ndajfoljet me prapashtesën *-isht* dhe mbiemrat përkatës me një etj., vihen me temë të plotë brenda çerdhes, kurse kur nuk ka ndryshime të rrafshit fjalëformues, si tek emërzimet e mbiemrave, mbiemërzimet e emrave, formimet femërore nga emrat mashkullorë etj. vihen vetëm mbaresat për trajtat plotësuese. Kurse variantet fjalëformuese me dallime fonetike nistore a të ndjeshme dhe me përdorim të gjerë, nuk bashkohen në një zë leksikografik (*p.sh.brijohem* f.110, *brinjohem* f.111 e *mbrijohem, mbrinjohem* f.608, “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006).

Në grupin e informacioneve me karakter gramatikor futet dhe zgjedhimi i foljeve, lakimi i emrave, mbiemrave, përemrave. Nga fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe vetëm “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, e ka informacionin jashtë nomenklaturës, duke dhënë të plotë në 40 faqe (1475-1515), gjithë sistemin e lakimit të emrave, mbiemrave, përemrave si dhe zgjedhimin e foljeve ndihmëse, veprorë të rregullta të tri zgjedhimeve, foljeve të parregullta dhe foljeve pësore e vetvetore. Kurse në fjalorët e tjerë shpjegues brenda nomenklaturës (mikrostrukturës) për çdo fjalë jepen vetëm ato shënime gramatikore që janë të domosdoshme për të kuptuar përmbajtjen e përdorimit e saj sipas normës gramatikore të gjuhës sonë letrare kombëtare.

Veç shënimeve të zakonshme, siç janë shënimet për pjesën e ligjëratës së cilës i përket fjala, për gjininë, numrin, diatezën etj. janë përdorur edhe disa shënime të tjera që tregojnë llojin e kuptimit si, *përmb.* për kuptimet përmbledhëse; *fig.* për kuptimet e figurshme; *përd.em.* për përdorimet emërore etj. Për mjetet fjalëformuese është përdorur shënimi *fjalëform.* Për emrat, veç trajtës së pashquar të njëjësit, vihen si trajta plotësuese: trajta e shquar dhe trajtat e numrit shumës. Për mbiemrat, veç trajtës përfaqësuese, vihet dhe trajta e gjinisë femërore. Te mbiemrat që përdoren vetëm në një gjini, veç shënimit për pjesën e ligjëratës, janë vënë sipas rastit edhe shënimet *vet. m* (vetëm në gjininë mashkullore) ose *vet. f.* (vetëm në gjininë femërore), p.sh. *barrse -mb. vet. f.* Për foljet, veç trajtës përfaqësuese, vihen edhe trajtat e së kryerës së thjeshtë dhe të pjesores. Trajtat plotësuese jepen te foljet veprorë dhe vetëm tek ato folje vetvetore që nuk bashkëlidhen me folje veprorë përgjegjëse, p.sh. *:la/j kal., ~va, ~rë*, (te folja vetvetore-pësore *lahem*, nuk vihen trajtat përfaqësuese).

Disa shënime gramatikore të shkurtuara jepen si pjesë e shpjegimit dhe jo si shënime të veçanta: te foljet pësore që shpjegohen në lidhje me foljet veprorë përkatëse (p.sh. *shqipërohet pës. e shqipëroj*) dhe te përdorimet emërore, mbiemërore, ndajfoljore etj. të pjesëve të tjera të ligjëratës...: p.sh. *shegan, ~e mb.* 1. që e ka qimen të kuqe në të murrme a në kafe (për qetë, kuajt etj.) *ka (kalë, mëz) shegan.* 2. që skuq në fytyrë nga shëndeti, që i kuqojnë faqet. 3. *përd. em.* sipas kuptimeve të mbiemrit.

Edhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, jepen po ato trajta plotësuese, pas trajtës përfaqësuese të eptueshme, si në fjalorët e mëparshëm shpjegues të shqipes. Përrjashtim bën vetëm forma e dhënies së shumësit të shquar të emrave, që jepët në kllapa (t), (të), (it), (ët), e cila bashkohet rregullisht me mbaresën e shumësit të pashquar.

Në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, informacionet jepen edhe jashtë nomenklaturës, edhe brenda mikrostrukturës. Këtu brenda mikrostrukturës jepet aq informacion sa në fjalorët e tjerë shpjegues të gjuhës shqipe. Në këtë fjalor shpjegues, si në asnjë fjalor tjetër shpjegues të shqipes, kemi dhe informacion me karakter leksikor enciklopedik, në një vëllim prej 44 faqesh (1425-1469), ku përfshihen emrat gjeografikë, emrat e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe mbiemrat që lidhen me to, shkurtimet e shkurtesat shqipe dhe të huaja që janë përdorur më dendur në shtypin tonë dhe botimet e tjera (4 faqe), si dhe shkurtesat e targave të automjeteve (1 faqe) me anë të të cilave leksikografët pasurojnë fjalorin me informacion me karakter enciklopedik.

Sipas një rregulli leksikografik, emrat e përveçëm përjashtohen nga makrostruktura e fjalorëve shpjegues. Atëherë ata pasqyrohen jashtë saj, si në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984. Këtu lind një problem, pasi emrat e përveçëm janë aq të shumtë sa që nuk mund të pasqyrohen dot në një fjalor gjuhësor shpjegues, ndaj duhet të përcaktojmë se cili prej

tyre duhet bërë pjesë e këtij fjalori, qoftë dhe jashtë nomenklaturës, duhet të vendoset njëfarë kriteri, apo do t'i lihet kjo spontanitetit.

Duke u nisur nga “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, brenda një zëri (emri të përveçëm) nuk është ndjekur i njëjti rregull. janë dhënë emrat e kryeqyteteve dhe qyteteve të disa shteteve të Botës, por nuk është dhënë emri i përgjithshëm i banorit, ndërsa për emrat e qyteteve dhe fshatrave të Shqipërisë është dhënë edhe emri i banorit dhe përdorimi mbiemëror i tyre.

Një çështje tjetër që duhet shtruar është se a duhet të jenë pjesë e makrostrukturës emrat e përgjithshëm të ardhur nga emrat e banorit, pasi ka dy praktika në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Te të gjithë fjalorët e tjerë shpjegues, veç atij të 1984-ës, emrat e përgjithshëm të njerëzve të ardhur nga emrat e vendeve, i kanë në makrostrukturë. Për këtë ka mendime të ndryshme. P.sh. D.Xhaxhaj është i mendimit se këta emra duhet të vihen brenda nomenklaturës, pasi siç shprehet ai “nuk na duket e arsyeshme që këta emra të pasqyrohen jashtë nomenklaturës. Në qoftë se këta emra nuk i plotësojnë kushtet e vëna nga leksikografët, të shprehura në kriteret përzgjedhëse të njësive leksikografike, atëherë ata nuk duhet të pasqyrohen as brenda, as jashtë nomenklaturës”<sup>124</sup>

Autori i pohimit të mësipërm, mund të ketë të drejtë kur thotë se grupimet e këtyre fjalëve jashtë nomenklaturës mund të jenë të pjesshme, por nuk mund të biem dakord që ky informacion të mos jepet fare në fjalorët gjuhësorë, sidomos për emrat gjeografikë e emrat e përgjithshëm që dalin prej tyre, ashtu siç është vepruar në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, duke i grupuar ata: emër vendi, banori e përdorimi mbiemëror. Këtu mund të ngrihet çështja e futjes së emrit të përgjithshëm në makrostrukturë, por për mendimin tonë është vepruar më drejt në këtë fjalor shpjegues, pasi informacionin enciklopedik e kemi të grupuar e jo të copëtuar, dhe kjo krijon lehtësi për gjetjen e këtij informacioni nga konsultuesi i fjalorit.

Nëpërmjet informacioneve që përmban, fjalori shpjegues ndihmon në mësimin e gjuhës, në përmirësimin e aftësive shprehëse të folësve, pasi ai ka informacione gjuhësore të domosdoshme për çdo kategori lexuesish.

**Vështrimi diakronik.** Për një periudhë rreth gjysmë shekullore, për gjuhën tonë, janë botuar pesë fjalorë shpjegues, “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, (dhe ribotimi i tij në vitin 2002), dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006. Për katër fjalorët shpjegues (pa Fjalorin e vitit 2002), do

---

<sup>124</sup> Xhaxhaj, D. Studime filologjike, nr.1-4, Tiranë, 1995, f.80.

të vëmë në dukje prirjet në pasqyrimin e informacioneve jashtë nomenklaturës. Shtimi sasior i informacioneve vihet re në rimarrjen e të njëjtëve grupe informacionesh nga një botim paraardhës në tjetrin pasardhës, duke u pasuruar pasardhësi me informacione të reja jashtë nomenklaturës. Më poshtë po japim në tabelë krahasuese të dhënat për informacinin jashtë nomenklaturës që gjendet në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, (krahasimi është bërë në numër faqesh që zë ky informacion në fjalorët shpjegues).

**TABELA ME SHËNIME JASHTË NOMENKLATURE NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE**

<b>Informacioni jashtë nomenklaturës</b>	<b>FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE</b>			
	<b>1954</b>	<b>1980</b>	<b>1984</b>	<b>2006</b>
Parathënie	1.5 faqe	7 faqe	6 faqe	2 faqe
Shpjegime për përdorimin e fjalorit.	2.5 faqe	7 faqe	4 faqe	17 faqe
Shenjat	1 paragraf	1 paragraf	1 faqe	1 faqe
Shkurtime	1 faqe	3 faqe	2 faqe	2 faqe
Treguesi alfabetik	—	1 faqe	1 faqe	—
Fjalësi onomastik	—	—	35 faqe	—
Shkurtime e shkurtesa	—	—	5 faqe	—
Pasqyra gramatikore	—	—	41 faqe	—

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, informacionet jashtë nomenklaturës përbëhen: nga parathënia 2 faqe (1.5 të shkruara); shënime mbi përdorimin e fjalorit 3 faqe (2.5 të shkruara), brenda të cialve ndodhet një paragraf (f.5) për shenjat e përdorura; shkurtime 1 faqe. Pra ky fjalor shpjegues ka gjithsej 6 faqe me shënime jashtë nomenklaturës.

Në fjalorët e mëvonshëm shpjegues ndryshimet nuk janë vetëm sasiore, por edhe cilësore, në mënyrën e shpjegimit më me hollësi të kritereve të ndryshme që ndiqen për hartimin e fjalorit dhe informacioneve të domosdoshme gjuhësore të pasqyruara në çdo zë leksikografik. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, kemi informacione të dhëna në 19 faqe, të përbërë nga:

- Parathënia (ku ka edhe shënime të politizuara) 7 faqe;

- Shpjegime për ndërtimin e fjalorit 11 faqe, ku përfshihen: **1.** informacion për ndërtimin e fjalorit 2.5 faqe. **2.** informacion për ndërtimin e artikullit për çdo fjalë 1 faqe. **3.** informacion për shënimet gramatikore 1 faqe. **4.** shpjegimi i kuptimeve të fjalëve e të mjësive frazeologjike 1.5 faqe. **5.** shkurtimet dhe shenjat 4 faqe;
- treguesi alfabetik 1 faqe.

Në krahasim me fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe 1980, numri i faqeve për informacion të njëjtë, në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, është më i vogël, gjithsej 14 faqe, pra 5 faqe më pak se fjalori i 1980-ës, por 8 faqe më shumë se fjalori shpjegues i 1954-ës. Në këtë fjalor parathënia ka 6 faqe, shpjegimet për përdorimin e fjalorit 4 faqe, shkurtimet dhe shenjat 3 faqe (shenjat 1 faqe dhe shkurtesat 2 faqe) dhe treguesi alfabetik 1 faqe. Ndryshimi qëndron në faktin tjetër se në “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984, janë pasqyruar edhe grupe të reja informacionesh, që nuk i gjejmë në dy fjalorët e mëparshëm shpjegues të gjuhës shqipe, si dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006. Në këtë informacion shtesë futen emrat gjeografikë, emërtimet e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe mbiemrat që lidhen me to (gjithsej 35 faqe), shkurtimet dhe shkurtesat (gjithsej 5 faqe) dhe pasqyra gramatikore 41 faqe. Pra “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, ka edhe 81 faqe më shumë me informacion jashtë nomenklaturës, i domosdoshëm ky për sqarimin e informacioneve të plota gramatikore për pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, por dhe për një informacion modest enciklopedik, edhe ky i domosdoshëm për kulturën e përgjithshme të lexuesit, informacion që lexuesi e gjen në rrugë shumë të shpejtë në fjalorin shpjegues.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006, informacioni jashtë nomenklaturës përfshin një vëllim prej 22 faqesh, pra më shumë se çdo fjalor paraardhës shpjegues të gjuhës shqipe, për informacion të të njëjtës natyre. Numri i faqeve për këtë informacion rritet, për arsye se në këtë fjalor jepen shpjegime më të detajuara, pasi aty jo vetëm janë shtuar njësi leksikore të reja (fjalori ka rreth 48000 fjalë), por aty është ndryshuar edhe mënyra e paraqitjes së këtyre njësive leksikore në krahasim me të gjithë fjalorët e mëparshëm shpjegues. Një gjë e tillë është bërë për të krijuar hapësirë për sa më shumë fjalë e kuptime. Për këtë gjë, përveç sintezave me një përgjithësim sa më të lartë të strukturave kuptimore e kuptimeve në vetvete, janë përdorur edhe zgjidhje leksikografike, siç është:

- ndërtimi i çerdheve për fjalë me lidhje të drejtpërdrejtë prejardhjeje (foljet vetvetore, emrat foljorë e mbiemrat prejpjesorë të foljeve veprare, emërzimet në të dyja gjinitë të mbiemrat, ndajfoljet për gjuhët tek emrat e gjuhëve ose ndajfoljet me prapashtesën *-shëm*, të mbiemrat me këtë prapashtesë etj.)
- përdorimi i formave shpjeguese për fjalë të së njëjtës kategori semantike (për foljet vetvetore, për emrat e veprimit, për formime me ndajshtesa të specializuara etj),



- disa zgjidhje grafike me shkurtesa termash lehtësisht të kuptueshëm dhe tipi i shkronjave nga madhësia.

Të gjitha këto veçori janë shpjeguar qartë në hyrje të fjalorit dhe zënë një vëllim prej 22 faqesh (parathënia 2 faqe dhe hyrja e fjalorit 20 faqe) duke lehtësuar kështu përdorimin e fjalorit nga çdo lexues, pasi janë zgjidhje që kuptohen shpejt nga ana praktike. Në hyrjen e fjalorit, me vëllim 20 faqe, përfshihen këto rubrika:

- parime të përgjithshme , 2.5 faqe.
- bazat e fjalorit dhe burimet e lëndës, 1.5 faqe.
- fjalësi i fjalorit, 1 faqe.
- shënime për përdorimin e fjalorit 13.5 faqe.
- shkurtime, 1.5 faqe.

Nga krahasimi i bërë ndërmjet gjithë botimeve të fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, vëmë re një prirje për shtimin e informacionit jashtë nomenklaturës, ndryshime që vijnë edhe si rezultat i pasurimit të mikrostrukturës me informacione të reja dhe për arsyet që shpjeguan më sipër.

Informacionet jashtë nomenklaturës janë të shumta dhe të karaktereve të ndryshme. Për këto grupë informacionesh ne dhamë mendimin tonë për arsyet e pasqyrit të tyre në fjalorin shpjegues, për lidhjen ndërmjet këtyre informacioneve dhe atyre që ndodhen brenda artikujve të fjalorit si dhe për domosdoshmërinë ose jo të pasqyrit të tyre në fjalorin shpjegues të gjuhës.

Por siç vumë re edhe nga krahasimi i fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, nga të gjitha grupet e informacioneve që gjejnë vend pasqyrimi të të gjithë fjalorët, të domosdoshme për fjalorin shpjegues të gjuhës janë shpjegimet për ndërtimin dhe përdorimin e fjalorit dhe një pjesë e informacioneve gramatikore, ajo pjesë që lidhet me trajtat e ndryshme që marrin pjesët e ndryshueshme të ligjëratës. Fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe duhet të japin një pasqyrë të zgjedhimit të foljeve, të lakimit të emrave, mbiemrave e përemrave, siç është vepruar me “Fjalorin e shqipes së sotme” 1984.

Për fjalësin onomastik, zgjidhjet e fjalorëve të ndryshëm shpjegues janë zgjidhje konvencionale. Zgjidhja më e përshtatshme, siç e kemi thënë në kapitullin përkatës, na duket përsëri ajo e “Fjalorit të shqipes së sotme” 1984, me shtojcë (informacion jashtë nomenklaturës), sepse veç fjalësit të përgjithshëm që gjendet në makrostrukturë, në shtojcë informacioni për emrin e vendit, banorin dhe mbiemrin që lidhet me vendin e banorin, e ka pasqyruar nën një glosë dhe e ndihmon mjaft lexuesin për të marrë shpejt informacionin me karakter enciklopedik, pa përjashtuar edhe atë gjuhësor. Kjo është e

domosdoshme pasi vetë kriteret e fjalorëve shpjegues e copëzojnë çerdhen e leksikut toponomastik, sepse nuk mund të pasqyrojnë brenda makrostrukturës emrat e përveçëm.

Por në fjalorët shpjegues ndiehet nevoja për këtë lloj informacioni, qoftë për pasqyrimin e tyre si emërtime, por edhe për shqiptimin e emrave gjeografikë të huaj si p.sh. Nw Jork- Nju Jork etj.

Sot, jo vetëm se ekziston në praktikën leksikografike, është e nevojshme përfundimi i fjalorëve me pasqyra të gjera gramatikore, sidomos për fjalët e eptueshme, çka tregon lidhjen e ngushtë të tyre si edhe për nevojën për t'i paraqitur së bashku dy elementet kryesore të një gjuhe, fjalën dhe format e saj gramatikore, sepse asnjëra s'mund të ekzistojë pa tjetrën. Fjala, siç dihet, e bën jetën e saj në ligjërime vetëm nëpërmjet formave të veta, të cilat e vendosin atë në raporte të ndryshme e të larmishme me fjalë të tjera.

## **PËRFUNDIME**

1. Gjuha është tipar i rëndësishëm i kombit, vlerë dhe identitet i tij. Prandaj ruajtja, zhvillimi dhe pasurimi i vazhdueshëm i saj ka qenë dhe mbetet një detyrë e përhershme. Gjithë përpjekjet shekullore për të mbrojtur vetëqenien, lirinë dhe dinjitetin kombëtar, kanë synuar të mbajnë gjallë dashurinë për atdheun dhe gjuhën amtare. Ideali patriotik bashkoi rilindësit në luftën dhe përpjekjet për pavarësinë kombëtare e për ruajtjen e vlerave të gjuhës sonë, “sepse - siç thotë Idriz Ajeti - gjuha letrare s’është vetëm thesar i kulturës sonë, por edhe mjet i fortë për mbrojtjen e etnisë sonë”<sup>125</sup>, apo siç thotë prof. E.Çabej “gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar”.<sup>126</sup>

Në kushtet e sotme kjo bëhet më urgjente, kur shqipja standarde, si faza më e lartë e zhvillimit të gjuhës, po përjeton zhvillim të shumanshëm të hovshëm si dhe përballje me sfidat e reja të hapjes me botën, sepse, gjuha e njësuar si një madhësi kulturore që u formua në një etapë të caktuar të zhvillimit politik e shoqëror të kombit shqiptar, po u shërben kërkesave në rritje të bashkësisë së shqiptarëve, duke u bërë shprehëse e njësisë kombëtare, trguese e identitetit, gjallërisë së kombit tonë, baza mbi të cilën ngrihet dhe përcillet kultura dhe përvoja e tij. Vetë kushtet e komunikimit ndërgjuhësor dhe të shkëmbimeve ndërkulturore e kanë vënë shqipen përballë gjuhësh të pasura e të lëvuara prej shekujsh.

Zhvillimet e vullshme që prekin jetën materiale e shpirtërore të popullit tonë, kanë sjellë dyndjen e një numri të madh nocionesh të të gjitha fushave, të cilat i janë drejtuar gjuhës për emërtime, që kanë zënë vendin në fjalorë të tipave të ndryshëm në leksikografinë tonë. “Leksikografia, - thotë J.Thoma - është fusha më e hershme dhe më e pasur e gjuhësisë shqipe. Ajo fillon që me “Fjalorin latinisht-shqip” të Frang Bardhit (1635) e deri më sot na ka sjellë mbi 500 fjalorë të shqipes a me shqipen, njëgjuhësh, dygjuhësh ose shumëgjuhësh të cilët në pjesën shqipe regjistruan shumë fjalë e shprehje me vlerë, që i shpëtuan kështu humbjes”.<sup>127</sup> Por kjo pasuri e madhe leksikore ndjen nevojën të pasqyrohet në një fjalor të madh të gjuhës shqipe apo një fjalor “thesarus”, që do të pasqyroste sa më gjerë pasurinë leksikore e frazeologjike të gjuhës shqipe psi siç thotë J.Thomai, “në Institutin e Gjuhësisë e Letërsisë të Akademisë së Shkencave të

---

<sup>125</sup> Shih më gjerë B.Kryeziu, Standardi i shqipes dhe disa probleme rreth tij” në “Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë”, Ohër, 2007, f.93.

<sup>126</sup>Çabej, E. Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre, në Studime gjuhësore, VI, Prishtinë, 1977, f.329).

<sup>127</sup> Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.12.

Shqipërisë , Kartoteka me më shumë se 4 milionë skeda, dëshmon mbi 150.000 fjalë” 2). (J.Thomai, Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.21).<sup>128</sup>

2. Në punimin tonë shkencor, për mbrojtjen e gradës “doktor”, kemi bërë objekt trajtimi pasqyrimin e fjalësit apelativ e onomastik në makro e mikrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, duke filluar me të parin fjalor shpjegues të saj “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, e deri te “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006. si dhe në disa fjalorë dygjuhësh.

Në këta fjalorë kemi parë zhvillimin e pasurimin e makrostrukturës së tyre nga njëri fjalor shpjegues në tjetrin, duke evidentuar shtimin dhe bjerrjen e fjalëve, që shprehet me ekzistencën apo mungesën e fjalëve në fjalorë të ndryshëm shpjegues, ku fenomen dominant është shtimi i fjalëve në fjalorin pasardhës shpjegues. Gjithashtu objekt i punës sonë studimore është bërë pasqyrimi i strukturës kuptimore të fjalëve si pjesë e makrostrukturës së fjalorëve shpjegues, e cila ka ardhur gjithmonë në zhvillim duke rritur në këtë mënyrë fuqinë shprehëse të gjuhës sonë, pasi aty ka edhe mdarje kuptimore tepër të imta. Dhënia e mikrostrukturës së fjalëve është një tjetër çështje që është trajtuar në punim, duke përshkruar në mënyrë të detajuar fjalësin e dhjetë shkronjavë të fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe: “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006.

Fenomeni i zgjerimit të strukturës kuptimore është më evident në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, si fjalori me diferencë më të madhe në njësi leksikore e zgjerim të kuptimeve të fjalëve, në raport me fjalorin paraardhës shpjegues të gjuhës shqipe, por edhe për faktin se aty janë dhënë në mënyrë më të gjerë e më të sistemuar se në çdo fjalor tjetër shpjegues të gjuhës kuptimet e fjalëve. Vërtet “Fjalori shpjegues i gjuhës shqipe” 2006, ka një numër më të madh fjalësh, rreth 48000, por në këtë fjalor nuk mund të krijohet qartë ideja e numrit të kuptimeve, pasi aty janë ndërtuar struktura kuptimore e kuptime të një shkalle të lartë përgjithësi, nëpërmjet sintezave të reja kuptimore a të shkrirjeve në një kuptim ose janë ngjeshur shpjegimet duke u bashkuar ato. Në këtë fjalor, duke pasur parasysh, në vija të përgjithshme, përmasat fjalë-kuptim për fjalorët e këtij tipi, ky përpjestim nuk është arritur mekanikisht njësoj për çdo fjalë. Ndërtimi i kuptimeve më të përgjithshme, nëpërmjet abstragimit të një shkalle më të lartë të dy a më shumë kuptimeve në një, mbështetet në afrinë e këtyr kuptimeve sipas përbërësve themelorë dhe në mundësinë për abstragim, d.m.th. për të ndërtuar në mënyrë të natyrshme një kuptim më të përgjithshëm, që përmban në vetvete përbërësit themelorë të dy a më shumë kuptimeve.

---

<sup>128</sup> Thomai, Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f.21.

3. Dhënia e veçorive stilistike, e shënimeve për sferat e përdorimit të fjalëve dhe për ngjyrimet emocionale vlerësuese të tyre në tre fjalorët shpjegues që kemi marrë në shqyrtim, në mënyrë shteruese për fjalësin e shkronjave A, B, C, Ç, Dh, F, H, K, Ll, O, ka qenë një nga çështjet që kemi trajtuar në këtë punim shkencor. Shënimet stilistike shërbejnë për të karakterizuar atë pjesë të leksikut të gjuhës së sotme letrare, e cila për shkaqe të ndryshme ka përdorim të kufizuar në ligjërim. Përvijimi dhe përsosja e sistemit stilistik janë të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin e përgjithshëm të gjuhës së sotme letrare shqipe. Sigurisht që më i dukshëm është ky fenomen në dy fjalorët e fundit, nga ata që kemi marrë në shqyrtim, 1980 dhe 2006, pasi për fjalorin e vitit 1954 nuk mund të pretendojmë një përcaktim të saktë, duke pasur parasysh kohën kur u botua, nivelin e shkencës së leksikografisë dhe variantet e shumta dialektore si pjesë e makrostrukturës së tij. Tashmë dihet se ekziston një gjuhë e vetme letrare shqipe dhe “epoka, në të cilën jeton dhe vepron sot populli shqiptar, është epoka e gjuhës letrare shqipe të njësuar e të përbashkët për të gjithë pjesëtarët e kombit”.<sup>129</sup>

Ajo që kemi vënë re është fakti se përpjekja e parë për dhënien e plotë të veçorive stilistike, të shënimeve për sferat e përdorimit të fjalëve dhe për ngjyrimet emocionale-vlerësuese të tyre, si dhe për një vlerësim tërësor e sistemor të leksikut të shqipes së sotme nga pikëpamja e normës letrare dhe e prirjeve të zhvillimit të tij të mëtejshëm, është bërë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980. Në të gjithë fjalorët shpjegues, leksiku i pacilësuar përbën sfondin kryesor të mjeteve gjuhësore. Së bashku me fjalët e cilësuar stilistikisht ky leksik formon tërësinë e mjeteve leksikore që përdoren në ligjërim për nevojat shprehëse e komunikuese.

Leksiku i pacilësuar me shënime të veçanta për ngjyrimin stilistik dhe emocional-vlerësues ka edhe karakteristika dalluese në krahasim me mjetet e tjera gjuhësore me ngjyrim të tilla. Pra gjithë mjetet leksikore të gjuhës në fjalorët shpjegues, në bazë të pranisë ose mungesës së shënimeve për ngjyrimet stilistike, emocionale-vlerësuese dhe për sferat e përdorimit të fjalëve, ndahen në tri shtresa kryesore: shtresa e fjalëve të pacilësuar stilistikisht, që është më e shumta në numër; shtresa e fjalëve të cilësuar stilistikisht në tërësi ose në të gjitha kuptimet e tyre që zë vendin e dytë për nga numri i njëjësive leksikore në tërësi, dhe shtresa e fjalëve të cilësuar stilistikisht në një kuptim ose në disa kuptime të tyre, që është më e pakta në numër.

Sistemi i plotë stilistik i gjuhës së sotme letrare shqipe, në këtë pjesë të fjalorit, pasqyrohet nga shënimet që japin terminologjinë tekniko-shkencore me përdorim të gjerë dhe sferat e përdorimit të saj, si arkitekt. (arkitekturë), art. (arte), gjuh. (gjuhë)muz. (muzikë etj.; nga shënimet për shtresat e fjalëve me funksione stilistikore-ligjërimore në gjuhën

---

<sup>129</sup> Kostallari, A. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, në “Studime filologjike”, 4, 1984, f.25.

letrare, si bised. (bisedë), libr. (libër), kr. pop. (krijimtari popullor) etj.; nga shënimet për shtresat e fjalëve me kufizime në rrafshin territorial dhe ligjërimor krahin. (krahinorizëm), arb. (arbëresh) thjeshtligj. (ligjërimi i thjeshtë); nga shënimet që japin karakteristikën stilistike të fjalëve në boshtin kohor, si vjet. (fjalë e vjetër), hist. (historizëm); nga shënimet për ngjyrimet emocionale-vlerësuese dhe nga një grup ku përfshihen disa shënime të tjera jogramatikore të fjalëve, si: euf. (eufemizëm), fëm. (fëmijore), mallk. (mallkim), ur. (urim).

Karakteristikat stilistike dhe ngjyrimet emocionale - vlerësuese të fjalëve të shkronjave që kemi shqyrtuar në fjalorët shpjegues, janë parë në kuadrin e plotë të sistemit stilistik të shqipes së sotme. Është detyrë e leksikografëve që të forcojnë vëmendjen për sqarimet e mëtejshme stilistike dhe për saktësimin e aparatit të shënimeve të posaçme për to. Zgjidhja e kësaj detyre shkon paralel me trajtimin më gjerë e më thellë të problemeve të stilistikës gjuhësore, të cilat i kërkon zhvillimi i sotëm i gjuhës letrare shqipe.

Shënimet për karakteristikat stilistike dhe për ngjyrimet emocionale - vlerësuese në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe ndihmojnë për të ndjekur jo vetëm evolucionin funksional të fjalëve si njësi tërësore, por edhe të kuptimeve të tyre të veçanta. Me këto shënime fjalët nuk mbeten të shkëputura nga jeta e gjallë e tyre. Ato janë pjesë e pandashme e shpjegimit të saktë të fjalëve dhe e përdorimit të tyre të drejtë në ligjërim.

4. Hartimi i një fjalori shpjegues të gjuhës shqipe ka qenë një dëshirë e atdhetarëve dhe veprimtarëve të kulturës shqiptare, që u bë realitet me “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954. Ky fjalor, si i pari fjalor shpjegues i mirëfilltë i gjuhës shqipe, me gjithë vlerën e pamohueshme që ka, si përmbushës i një nevoje të ngutshme, tregon qartë se është një fjalor i mbështetur te tradita leksikografike, duke bërë një kodifikim kritik të lëndës leksikore e frazeologjike që kishte dalë në fjalorët e mëparshëm, por duke sjellë edhe lëndë të re leksikore e frazeologjike, i hartuar pa bërë përgatitjet paraprake për grumbullimin e gjithë materialit gjuhësor të shtypur, pa studiuar thellë të gjitha të folmet tona, pa dokumentuar sa duhet pasurinë leksikore të popullit tonë, pasi mungonte dhe Kartoteka e leksikut të gjuhës shqipe.

“Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, është i tipit të vogël, sepse pasqyron shtresën aktive të leksikut të shqipes dhe një pjesë të kufizuar të shtresës pasive, që është krejt e domosdoshme për të kuptuar gjuhën e sotme shqipe. Vetë tipi i fjalorit, kushtet në të cilat u hartua e qëllimet për të cilat u hartua, i sollën disa kufizime vëllimit të tij. Me gjithë të metat që ka, “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, ka bërë një shërbim të madh, pasi ai hapi udhën e fjalorëve të tjerë shpjegues kombëtarë e normativë të shqipes, udhën e një tradite të re në leksikografinë shqiptare.

5. Për hartuesin e çdo fjalori ka rëndësi se çfarë kriteresh do të ndjekë ai për renditjen e fjalëve në fjalor, për formën përfaqësuese të saj, për elementet që do të përmbajë artikulli për çdo fjalë, pra ndërtimi jo vetëm i makrostrukturës dhe i mikrostrukturës, por edhe i elementeve gramatikore, sintaksore etj. Çdo fjalë në fjalor si njësi e pandarë leksiko-semantike e fonetiko-gramatikore formon një artikull të veçantë me kuptimet e përdorimet e saj. Pjesa e parë e çdo artikulli përfshin fjalën në trajtën përfaqësuese e trajtat e saj plotësuese, shpjegimet e kuptimeve të fjalës dhe thëniet për çdo kuptim. Pjesa e dytë e artikullit përfshin frazeologjinë gjuhësore e të ashtuquajturën frazeologji letrare, bashkëlidhjet e qëndrueshme gramatikore. Pjesa e ndryshueshme e trajtës përfaqësuese të fjalës ndahet nga pjesa e pandryshueshme me një vizë të pjerrët dhe i shtohet drejtpërdrejt kësaj pjese, e cila në trajtat e tjera përfaqësohet nga një vijë e lakuar (~, tilda); p.sh. *balerin/ë, ~a f. sh. ~a, ~at..*

Ajo që vëmë re menjëherë, sapo hapim një fjalor, janë disa të dhëna gramatikore të thjeshta, por të nevojshme për çdo përdorues fjalori. Veç shënimeve të zakonshme, siç janë shënimet për pjesën e ligjëratës së cilës i përket fjala, për gjininë, numrin, diatezën etj. janë përdorur edhe disa shënime të tjera që tregojnë llojin e kuptimit (si përmb. për kuptimet përmbledhëse, fig. për kuptimet e figurshme, përd. em. për përdorimet emërore etj.) Për mbiemrat, veç trajtës përfaqësuese, vihet edhe trajta e gjinisë femërore. Për foljet, veç trajtës përfaqësuese (veta e parë, numri njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore), vihen edhe trajtat e së kryerës së thjeshtë dhe pjesores. Trajatat përfaqësuese jepen te foljet veprare dhe vetëm tek ato folje vetvetore që nuk bashkëlidhen me folje veprare përgjegjëse.

6. Detyrë themelore e fjalorëve shpjegues është shpjegimi i kuptimit të fjalëve ose i kuptimeve të fjalës, kur ajo është polisemantike. Ky është qëllimi kryesor i artikullit për çdo fjalë., ndërsa gjithë elementet e tjerë që përmban artikulli i nënshtrohen këtij qëllimi. Me të drejtë J.Thomai thekson se përpara leksikografit qëndrojnë, ndër të tjera dy detyra të vështira: ndërtimi i sistemit të kuptimit të fjalëve që duhet të ngërthejë një fjalor dhe përkufizimi i kuptimeve leksikore. Ndërtimi i sistemit të kuptimeve nuk mund të bëhet duke i marrë fjalët të veçuara, por duke i parë në lidhje të shumëllojta, fjalëformuese, antonimike, sintaksore, në lidhje paradigmatiche e sintagmatike. Në përgjithësi, por sidomos nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, shpjegimet janë cilësore e shkencore jo vetëm në kuptimin gjuhësor, të plota, duke pasqyruar të katër llojet e shpjegimeve: shpjegimin me perifrazim, me përshkrim, me përkufizim, dhe me sinonimi. Në fjalorët shpjegues të gjuhës sonë nuk mungojnë edhe shpjegimet e përziera. Proceset semantike të zgjerimit apo ngushtimit që ndodhin në kuptimin e fjalëve kanë çuar në ndryshimin e fjalësit të fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, i cili reflektohet në daljen nga qarkullimi të disa kuptimeve ose të vetë fjalëve si dhe me shtimin e fjalëve të reja që lindin duke pasuruar kështu leksikun e shqipes.

7. Një fushë me interes për lëndën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe është edhe marrëdhënia e lëndës së tyre me leksikun e frazeologjinë dialektore e krahinore, e cila ka fituar status mbarëkombëtar normativ dhe ka zënë vend në këta fjalorë. Por ende ka shumë njësi leksikore e frazeologjike që trajtohen si pasuri pasive.

Gjuha shqipe e njësuar ka nevojë të plotësojë sistemin e vet leksiko-semantik e leksiko-stilistik me njësi të reja, prandaj ajo i është drejtuar ngaherë gjithë hapësirës gjuhësore shqipe, jo vetëm dialekteve që përfshihen në truallin e shtetit të sotëm, por edhe nëndialekteve jashtë këtij trualli, te arbëreshët e Greqisë e Italisë, te shqiptarët e Maqedonisë, Malit të Zi dhe në shtetin e Kosovës e kudo ku flitet gjuha shqipe. Ajo vazhdon të thithë vlera, pavarësisht se nga cilat troje vijnë ato. I vetmi kriter vlerësues për këto njësi është t'i sjellin diçka të re fjalorit të gjuhës letrare në rrafshin shënues, konotativ dhe stilistikor të saj.

Shumë fjalë dialektore e krahinore për shkak të vlerave që kanë, kapërcejnë kufijtë dialektorë dhe bëhen pronë e gjuhës letrare duke fituar të drejtën e qytetarisë dhe status mbarëkombëtar. Ky kapërcim nuk është thjesht ndërrim mjedisi, por siç argumenton J.Thomai, është një proces që shoqërohet me ndryshime ndërtimore e kuptimore, shprehëse dhe emocionuese ose lidhesh sintagmatike e pragmatike. Ky është një ndryshim në përmbajtje të cilin e sqaron qartë J.Thomai “shumë herë ndryshimi themelor gjatë mbartjes së njësisë nga dialekti në gjuhën letrare e sidomos në terminologji, është ndryshim në përmbajtje, aq sa mund të flitet për një shndërrim semantik. Duke qenë se ky shndërrim bëhet pothuaj përherë në mënyrë të vetëdijshme, të qëllimshme(nga terminologët, shkrimtarët etj. , ai është po ashtu pothuajse përherë i motivueshëm”.

Në punim kemi sjellë shembuj të shumtë që tregojnë fjalë dialektore e krahinore që janë bërë pjesë e leksikut të përgjithshëm të gjuhës shqipe dhe kanë vendin e tyre në fjalorët shpjegues të saj. Këto fjalë që kalojnë në shtresën gjuhësore mbarëkombëtare e zgjerojnë kuptimin e tyre. Ky zgjerim kuptimi shkakun e ka te zgjerimi i përdorimit të fjalës si rezultat i kapërcimit të pragut dialektor. Pra, kalimi i fjalës nga një sistem gjuhësor më i ngushtë, në një tjetër më të gjerë, shoqërohet me lëvizje kuptimore.

8. Leksiku është parë edhe sipas morfologjisë së fjalëformimit, ku kemi dalluar emërtime të thjeshta dhe të pathjeshta. Këtu kemi parë mënyrat kryesore të fjalëformimit dhe tipat e mjetet e këtij procesi. Në përfundim të shqyrtimit të materialit leksikor kemi konstatuar se prejardhja dhe kompozimi kanë qenë rrugët me intensitet më të lartë prodhimi që kanë çuar në pasurimin e leksikut të shqipes, i realizuar ky nëpërmjet fjalëformimit me klasa fjalësh e vargje leksikore fjalëformuese, zgjerim që është realizuar me vetë mjetet e shqipes.



Vështruar nga pikëpamja leksiko-gramatikore numrin më të madh të fjalëve jo të parme, në gjithë fjalësin e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, e përbëjnë emrat, pastaj mbiemrat e foljet. Megjithatë, brenda çdo kategorie leksiko-gramatikore më shumë fjalë jo të parme, në krahasim me të parmet, e kanë mbiemrat. Kjo shpjegohet me shtimin e ndjeshëm të mbiemrave të prejardhur e të përbërë, të formuar me ndajshtesa e kompozim, të cilët janë pasqyruar në fjalor në mënyrë më sistemore. Gjuha jonë letrare i ka tashmë të gjitha mënyrat, tipat e mjetet fjalëformuese për të krijuar fjalë të reja të nevojshme e për t'u prerë kështu rrugën mjet huazimeve nga gjuhët e tjera, fenomen shqetësues ky, veçanërisht 20 vjetët e fundit.

**9.** Nga shqyrtimi i tre fjalorëve me distancë kohore përafërsisht nga 25 vjet larg nga njëri-tjetri kemi vënë re se pesha specifike e terminologjisë tekniko-shkencore në periudha të ndryshme të zhvillimit të gjuhës letrare është e ndryshme. Kjo ka ndodhur për faktin e lidhjes së drejtpërdrejtë me zhvillimin e përgjithshëm të dijeve, , të shkencës, teknikës, por edhe të procesit të terminologjizimit e shterminologjizimit të një pjese të leksikut të gjuhës shqipe. Pjesa e leksikut terminologjik mund të zërë peshë më të madhe në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues sesa na del nga analiza, sepse një pjesë e tij është dhënë pa shënime të veçanta për fushën speciale a për fushën e përdorimit, kurse pjesa e shterminologjizuar jepet si fjalë e ligjërimit libror.

Leksiku terminologjik i shkronjave që analizuam, na jep mundësinë të shprehemi se në pjesën më të madhe ky leksik është leksik i shqipes dhe formimet në të janë krijuar me mjetet dhe sipas gjedheve fjalëformuese të gjuhës sonë. Niveli i ndryshëm i pasqyrimin të termave në fjalorët e ndryshëm shpjegues, ka ndodhur edhe për faktin se si tipar vendimtar për përjashtimin e leksikut terminologjik nga fjalorët shpjegues e me karakter normativ të gjuhës shqipe, është marrë karakteri i ngushtë i fjalëve terma.

**10.** Një pikë tjetër me interes për t'u parë e për t'u paraqitur më mirë e më gjerë në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe përben edhe fjalësi onomastik. Zgjidhjet që kanë ofruar fjalorët e ndryshëm shpjegues kanë qenë zgjidhje konvencionale për fjalësin onomastik. Në materialin e analizuar, zgjidhja më e përshtatshme na duket ajo që ka dhënë "Fjalori i shqipes së sotme" 1984, me shtojcë, sepse, veç fjalësit të përgjithshëm, në shtojcë informacioni për emrin e vendit, banorin dhe mbiemri që lidhet me vendin e banorin, është pasqyruar nën një glosë dhe e ndihmon mjaft lexuesin për të marrë shpejt informacion me karakter enciklopedik, pa përjashtuar edhe atë gjuhësor. Megjithatë, edhe kjo zgjidhje nuk e mbulon plotësisht fjalësin onomastik të një gjuhe, çka nxjerr nevojën e hartimit të një fjalori të veçantë për njësitë emërtuese të kësaj fushe, i cili të përfshijë toponimet e të gjitha llojeve, emrin etnik, mbiemrin, gjuhën e përdorimin ndajfoljor jo vetëm për emërtimet shqiptare, por edhe të huaja. Kjo është e domosdoshme, pasi vetë kriteret e fjalorëve shpjegues të gjuhës e copëzojnë çerdhen e leksikut toponomastik, sepse nuk mund të pasqyrojnë në makrostrukturë emrat e përveçëm.

**11.** Emrat e përveçëm gjeografikë është mirë të jenë në fjalorët shpjegues si zë më vete, në një shtojcë të tyre, si te “Fjalori i shqipes së sotme” 1984, nën titullin “Emrat gjeografikë”, sepse edhe për këtë lloj informacioni ndjehet nevoja brenda një fjalori, qoftë për pasqyrimin e tyre si emërtime, por veçanërisht për shqiptimin e emrave gjeografikë të huaj, si p.sh. New Jork -Nju Jork etj.

**12.** studimi i antroponimisë dhe patronimisë shqipe me kritere të rrepta shkencore duhet të bëhet një ndërmarrje e rëndësishme e cila fillon me evidentimin e tyre nga botimet e derisotme të burimeve dhe dokumentacionit historik. Të parët që duhet të japin mendimet e tyre për përkatësinë gjuhësore të këtij fondi emrash vetjakë dhe patronimesh, rrugën e formimit të tyre në trajtat që i kemi në dokumentacionin historik dhe në gjendjen e sotme, duhet të jenë gjuhëtarët, pasi kanë formimin e duhur shkencor gjuhësor për të interpretuar drejt ndryshimin e këtij fjalësi. studimet shkencore për emrat vetjakë dhe patronimet do të shmangin dhe interpretimet jo të drejta shkencore për probleme që lidhen me emrat e shqiptarëve, të huazuar nga pushtuesit, nomenklatura fetare, apo dhe huazimet e reja për arsye nga më të ndryshmet si dhe ndikimin e këtyre huazimeve në patroniminë tonë, veçanërisht ndikimi turk, pasi periudha e fillimit të pajisjes së shqiptarëve me mbiemra, patronime, ka përkuar me kohën e sundimit osman në Shqipëri, ndaj kjo ka lënë gjurmë të thella në këtë fushë duke futur përmes turqishtes në gjuhën shqipe emra vetjakë me ngarkesë emocionale vlerësuese negative të lartë, duke përfshirë emërtimet e titujve, gradave e ofiqeve, por edhe nofkat e llogarit.

**13.** Nga të dhënat faktike që u sollën në këtë punim, lidhur me emrat vetjakë të burimit shqip, njësitë leksiko-gramatikore dhe rrugët e mjetet e pasurimit të fondit kombëtar të emrave vetjakë, del se:

- a.** Si burim për emrat vetjakë të ardhur nga leksiku i shqipeskanë shërbyer e shërbejnë kryesisht fjalë nga sfera e faunës, e florës, e botës sendore, e toponomastikës, e emrave abstraktë të parë, të prejardhur, të përbërë ose të përngjitur, si edhe fjalëve të kategorive të tjera leksiko-gramatikore (mbiemra, folje, togje fjalësh etj.). Numrin më të madh të emrave vetjakë të burimit shqip e përbëjnë emrat abstraktë, veçanërisht emrat e formuar me prapashtesën -im, kurse emrat e sferave të tjera si numër janë më të kufizuar. Kjo gjendje dikton nevojën e një shfrytëzimi më të madh të këtyre sferave.
- b.** Procesi i pasurimit të fondit të emrave vetjakë të burimit shqip, siç doli nga punimi, ka kaluar e kalon nëpërmjet katër rrugëve: me kalim të drejtpërdrejtë të leksikut të përgjithshëm në emra vetjakë, si Agim, Bora, Flamur, Besa (nga emrat e përgjithshëm, agim, borë, flamur, besë) etj.; me ndërrim gjinie (kryesisht nga mashkullorja në femërore) p.sh. Diella nga diell, Gëzime nga gëzim etj.; me formim të ri të prejardhur me anë të prapashtesave, si Dritan (nga dritë), Mirosh

(mirë) etj.; me anë të përngjitjes ose të kompozimit të dy fjalëve në emra vetjakë, si Arjetë (ar + jetë), Ermirë (erë + e mirë) etj.

Shfrytëzimi dhe kombinimi me kriter i këtyre rrugëve, veçanërisht i rrugës së tretë dhe të katërt, hapin mundësi të mëdha për pasurimin e mëtejshëm të fondit kombëtar të emrave vetjakë.

c.Njënumër emrash vetjakë janë marrë nga fusha e terminologjive të ndryshme, të shkencës, teknikës, politikës etj. Dihet se fjalët si njësi leksiko- gramatikore të gjuhës kanë kuptime të ndryshme, ato shprehin, sipas përdorimit, nocione të caktuara për sende, fenomen, proces a cilësi të ndryshme të tyre etj. Të gjitha ato njësi leksiko-gramatikore të gjuhës që kthehen në emra të përveçëm, si rregull e humbasin kuptimin leksikor. Ky ndryshim në përmbajtje nuk do të thotë se semantika e fjalës së përgjithshme, d.m.th. kuptimi leksikor i një fjale që zgjidhet për t'u përdorur si emër vetjak nuk luan më asnjë rol, përkundrazi, semantika e fjalës lot rol në përdorimin e saj edhe si emër vetjak. Nga kuptimi i saj varet dhe qëndrimi ynë për ta pranuar ose jo si emër vetjak. Pra veç faktorëve të tjerë, për zgjedhjen e një fjale si emër vetjak, duhet pasur parasysh edhe ana kuptimore e fjalës.

**14.** Kristalizimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe ka krijuar të gjitha mundësitë për njohjen e pasurisë leksikore të kësaj gjuhe, kushtet për hartimin e një fjalori thesar që të përfshijë gjithë pasurinë leksikore të saj. Në rrethanat e reja historike, të krijuara pas viteve 90-të, edhe gjuha shqipe po përjeton një zhvillim tërësor e bashkues në të gjitha trevat e saj. Në përdorimin e përditshëm, përfshirë atë mediatik, fjalët e reja të nevojshme, janë një realitet i pamohueshëm; ato janë pasuri e vërtetë leksikore e shqipes dhe dëshmojnë gjallëri të shkallës së lartë të shqipes dhe në veçanti pasurinë dhe gjallërinë e jashtëzakonshme të mjeteve fjalëformuese të saj, të cilat mundësojnë krijimin me shumë lehtësi të fjalëve të reja të nevojshme.

Gjuha shqipe u përgjigjet menjëherë nevojave të praktikës, ajo krijon fjalë të reja, merr fjalë nga dialektet, zëvendëson fjalët e huaja ose i asimilon ato sipas modeleve të saj, dhe në pak kohë plotëson ose krijon çerdhe të reja fjalësh. Prandaj fjalët e reja të nevojshme e të ndërtruara në përputhje me natyrën e ligjet e shqipes, duhen përfshirë me guxim në fondin e fjalësit të shqipes standarde, se ato shumë shpejt bëhen krejt të natyrshme në ligjërim. Por jo çdo fjale të dëgjuar apo të shkruar do t'i hapen dyert menjëherë në fjalësin e gjuhës standarde. Kjo kërkon zbatimin e disa kriterëve, ndër të cilët më të rëndësishëm janë: vlera semantike e stilistikore dhe lidhja e fjalës me sistemin fjalësor, tipi fjalëformues i saj në përputhje me natyrën e shqipes, denduria e përdorimit etj. Prandaj shfrytëzimi i të gjitha vlerave kombëtare të gjuhës shqipe, pavarësisht nga e folmja e krahina, nxjerr në para detyrën e ngutshme të ndriçimit të këtyre vlerave.

**15.** Studimet në fushën e gjuhës letrare shqipe kanë vërtetuar tashmë se variantet letrare shqipe të së kaluarës kanë ndërvepruar gjithnjë e më shumë me njëri-tjetrin e kanë ushtruar pandërprerë ndikime të ndërsjella. Ky proces në kushtet e reja të krijuara pas viteve 40-të të shek. XX u shpejtua e u thellua, mori tipare të reja dhe solli kurorëzimin e përpjekjeve për një gjuhë të njësuar e të përbashkët letrare. Duke i vështruar në tërësinë e tyre rezultatet e leksikografisë, mund të themi me bindje se ajo është në një rrugë që po njuh ngjitje. Ajo tani është në gjendje të shtrojë dhe të zgjidhë detyra më të vështira për të pasqyruar mirë zhvillimin e leksikut si sistem. Ka ardhur koha që të ndërmerren studime të plota dhe jo sporadike për marrëdhëniet e leksikut dialektor me fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, duke mënjanuar përfundimisht një mjegull që përhapet shpesh për raportin dhe sasinë e leksikut të njërit apo tjetrit dialekt me leksikun e shqipes normative. Një shtytje e fuqishme do të jetë botimi i fjalorit të madh të gjuhës shqipe, që do të jetë fjalori i parë shpjegues i këtyre prmasave dhe që do të nxjerrë në dritë pasurinë e madhe leksikore që ka gjuha shqipe e do të hapë rrugë për fjalorin “Thesaurus”.

## ABSTRAKT

### **Leksiku apelativ e onomastik në makro e mikrostrukturën e fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe dhe në disa fjalorë dygjuhësh**

Puna për të ngulitur fjalën e shkruar shqipe ka filluar shumë herët, të paktën me veprën e Buzukut, kurse puna për një paraqitje sistemore, qoftë edhe të pjesshme, të leksikut të shqipes, ka nisur me veprën e F.Bardhit, për të vazhduar më vonë me të tjera. Por shek. XIX, pas zbulimit të madh të F.Bopit, që përcaktoi vendin e shqipes në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe me rëndësinë që fitoi kodifikimi e lëvrimi i shqipes në programin kulturor të Rilindjes Kombëtare, u zgjua në mënyrë të veçantë interesi i albanologjisë së huaj e asaj shqiptare për gjuhën shqipe, për strukturën gramatikore e pasurinë leksikore të saj. Kështu shek.XX nisi me Fjalorin e Kristoforidhit, vepër që shënoi një etapë të re në historinë e leksikografisë shqiptare, për të ardhur te fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe 1954, 1980, 1984, 2002, 2006 si dhe fjalorë të tjerë njëgjuhësh e dygjuhësh, duke realizuar kështu një ëndërr për t'i dhënë shqipes një nga shtyllat që e kishte, por i mungonte si vepër leksikografike e realizuar me përmasat që kërkonte paraqitja sistemore e saj.

Vlera e këtij punimi disertacioni qëndron në aspektin praktik të ballafaqimit të fjalësit në makrostrukturën e fjalorëve shpjegues të saj, për të evidentuar zhvillimin e fjalësit dhe pasqyrimin e tij në këta fjalorë, nga Fjalori i 1954-ës deri te ai i 2006-ës, si dhe në monitorimin e fjalësit onomastik në fjalorët ekzistues shpjegues e në disa fjalorë dygjuhësh, konstatimi i problemeve dhe dalja me zgjidhje sa më të pranueshme. Për realizimin e kësaj teme kemi grumbulluar lëndë analizuese nga të gjithë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, nga disa fjalorë dygjuhësh si dhe nga fjalorë me emra njerëzish.(Për antroponimet dhe patronimet).

Çështjen e pasqyrimin të fjalësit onomastik në këta fjalorë, për të cilin nuk ka pasur qëndrim të njëjtë në fjalorë të ndryshëm shpjegues, si për peshën specifike që ka zënë, ashtu dhe konceptimit që i është bërë atij fjalësi ku diku janë përfshirë në makrostrukturë, e diku pjesërisht në shtojcë. Por pavarësisht kësaj, punimi ka një bosht: dhënien e mendimit për zgjidhje të qëndrueshme si për përfshirjen e visarit leksikor të gjuhës shqipe në fjalorët shpjegues, ashtu dhe për atë që zakonisht quhet aparat plotësues i fjalorit.

Nga ballafaqimi i fjalësit të të gjithë fjalorëve shpjegues të shqipes vëmë re se është bërë një përditësim i tyre, sidomos te fjalori i 2006, por dhe kjo jo e plotë, pasi nuk gjejmë vendin e duhur korpusi leksikor i shqipes standarde që përjetoj një periudhë pasurimi pas ndryshimeve politike dhe ekonomike të vendit në vitet 90-të të shek. XX e këtej. Për fjalësin onomastik ne kemi dhënë mendimin se zgjidhja më e përshtatshme na duket ajo e

“Fjalorit të shqipes së sotme” 1984, me shtojcë, sepse, veç fjalësit të përgjithshëm, në shtojcë informacioni për emrin e vendit, banorin dhe mbiemrin që lidhet me vendin e banorin është pasqyruar nën një glosë dhe e ndihmon mjaft lexuesin për të marrë shpejt informacion me karakter enciklopedik, pa përjashtuar dhe atë gjuhësor.

Sot gjuha shqipe ballafaqohet në një situatë të re zhvillimesh shoqërore e kulturore dhe leksikografisë shqipe i dalin detyra të reja për t’iu përgjigjur këtyre zhvillimeve. Me gjithë pasurinë e veprave leksikografike, ka ende zbrazëti që duhen plotësuar, ashtu si duhet ngritur më tej niveli i përpunimit leksikografik të fjalës, por veçanërisht duhet synuar për të përfshirë më gjerë visarin leksikor të shqipes, për të zgjeruar hapësirën e shtresave të ndryshme leksikore, të fjalëve të kulturës, të leksikut dialektor të të gjitha trevave e të leksikut të ligjërimit popullor, të neologjizmave leksikore e semantike, si dhe të sistemit të vlerave të mbishtresuara, me objektivin për të hartuar Fjalorin e Madh të gjuhës shqipe, vepër leksikografike që do të strehojë në “ndërtesën” e saj pasurinë më të madhe të thesarit leksikor që ka kjo gjuhë, dhe që do të jetë i pari fjalor shpjegues i këtyre përmasave.

Fjalë kyçe: Fjalorë shpjegues dhe dygjuhësh, fjalës apelativ, fjalës onomastik, makrostrukturë dhe mikrostrukturë, bankë të dhënash, mënyrë pasqyrimi, informacion jashtë nomenklaturës.

## ABSTRACT

### **Appealing and onomastic lexicon in macro and micro structure of the explanative vocabulary of the Albanian language and in some two lingual vocabularies**

The work for the imprint of the written Albanian language has started very early , at least with the work of Buzuku, while the work for even a partly systematic presentation of the Albanian language lexicon, has started with the deed of F. Bardhi, to be continued later with other works, Thus, the XX century started with the Vocabulary of Kristoforidhi, a deed that marked a new era in the history of the Albanian lexicography to come to the explanative vocabularies of the Albanian language of the years 1954, 1980, 1984, 2002, 2006 and other one and two lingual vocabularies.

The value of this dissertation , stands in the practical aspect of facing of words in macro structure of its explanatory vocabularies, in order to make evident the development of the word and its representation in these vocabularies, from the vocabulary of the year 1954 until to the one of 2006 , as well as the monitoring of the onomastic word in the existing explanation vocabularies and in some two lingual vocabularies, ascertainment of the problems and proposing acceptable solutions.

From the conformation of the word in the whole Albanian explanation vocabularies , we notice that there's done an updating of these vocabularies, especially in the vocabulary of the year 2006 , but although this is not fully finished, because the lexicon corpus of the standard Albanian which experienced an enrichment period after the political and economic changes in the country during the years '90 of the XX cent, doesn't find its right place .

Considering the specific weight the onomastic vocabulary has and the conception done to this vocabulary, we have the opinion that the most suitable solution is the one given in "Today Albanian language" vocabulary of the year 1984 , with its annexes, because despite the general vocabulary , in the annexes there's been presented the information connected to the place's name, the inhabitant and the surname linked to the place and to the inhabitant, and this helps a lot the reader to take the encyclopedic information in a shorter time and without excluding the linguistic one.

Today , the Albanian language is faced with a new situation of the social and cultural developments and the Albanian lexicon has new duties with the aim to respond to these developments , in order to get a wider involvement of the Albanian lexicon depository,with the objective in the Big Vocabulary of the Albanian language , an lexicographical deed that will shelter in its' building'' the biggest asset of the lexicon treasure that this language has.

Key words: Explanatory vocabulary, two lingual vocabulary, appellative vocabulary, onomastic vocabulary, macro structure, micro structure, database, representative manner, information out of the nomenclature .

## FJALORËT E SHFRYTËZUAR

1. Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954.
2. Fjalor i gjuhës së sotme shqipe. Tiranë, 1980.
3. Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984.
4. Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 2002.
5. Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.
6. Fjalor i arbëreshëve të Italisë, E.Giordano, Bari, 1963.
7. Fjalor latinisht-shqip, F.Bardhi, Tiranë, 2006.
8. Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe, G.Meyer, përkth. A.Omari, Tiranë, 2007.
9. Fjalor sininimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2004.
10. Fjalor me emra njerëzish, Grup autorësh, Tiranë, 1982.
11. Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, M.Ndreca, Prishtinë, 1986.
12. Fjalor toponomastik i Epirit, .F.M.Rrapaj.
13. Fjalorth i Ri, (ribotim), N.Gazulli, Tiranë, 2005.
14. Fjalor i emrave vetjakë ilirë, Q.Lleshi, Tiranë, 1998.
15. Fjalorth etnobotanik i shqipes, Sh.Sejdiu, Prishtinë, 1984.
16. Disa emra personalë të myslimanëve dhe myslimaneve, A.Saliu, Tetovë, 2000
17. Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë, Q.Murati, Tetovë, 1998.
18. Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë, Q.Murati, Shkup, 2008.
19. Emërtime për kafshë e shpendë në labëri, V.Memisha, Gjirokastrë, 2001.
20. Fjalor Albanisch-deutsches und deutsch-albanisches Taschenwörterbuch, A.Hetzer, Hamburg, 1991.
21. Fjalor gjermanisht-shqip, A.Dhrimo, Tiranë, 2002.
22. Fjalor italisht-shqip, F.Leka, Z.Simoni, Tiranë, 2002.
23. Fjalor frëngjisht-shqip, V.Kokona, Tiranë, 1989.
24. Fjalor anglisht-shqip, I.Stefanllari, Tiranë, 2001.
25. Fjalor i orientalizmave të shqipes, T.Dizdari, Tiranë, 2005.
26. Vëzhgime për emrat familjarë të shqiptarëve, J.Shpuza, 1998.
27. Fjalë e shprehje të gjuhës shqipe, A.Xhuvani, botuar në SF, 1972-1984.
28. Fjalor emrash, V.Zoto, Tiranë, 2005.
29. Studime etimologjike në fushë të shqipes, E.Çabej, vëll. I-VII.
30. Frazologjizma të gjuhës shqipe, M.Gjevori, Prishtinë, 1968.
31. Fjalori i “Bletës shqiptare” dhe shënime të tjera gjuhësore, Th.Mitko, Vepra, Tiranë, 1981.



## BIBLIOGRAFI

- ❖ Bidollari, Ç. Zhvillimi historik i patronimeve të shqiptarëve, SF, 3-4, Tiranë, 2003.
- ❖ Bidollari, Ç. Patronimet me burim nga emrat e parë (personalë) SF, 3-4, Tiranë, 2004.
- ❖ Bidollari, Ç. Patronimet me burim nga toponimet, SF, 1-2, Tiranë, 2005.
- ❖ Bidollari, Ç. Patronime të shqipes me burim nga emrat që shënojnë prejardhjen: semantika e morfologjia, SF, 3-4, Tiranë, 2005.
- ❖ Bidollari, Ç. Tradita dhe risi në fondin e emrave personalë të shqiptarëve, SF, 1-2, Tiranë, 2001.
- ❖ Bidollari, Ç. Hulumtime onomastike, patronimia shqiptare, botime Kumi, Tiranë, 2010
- ❖ Baliu, B. Jo ndryshim i emërvendeve të Kosovës, por standardizim i tyre, Gjuha jonë, nr. 1-2, Tiranë, 2000.
- ❖ Buxheli, L. Emrat e veprimit me prapashtesat -im dhe -je në gjuhën shqipe SF, 4, Tiranë, 1981.
- ❖ Bejtja, M. Çështjet e fjalëve të huaja dhe e neologjizmave në gjuhën shqipe, “Leksikologjia shqipe- trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Bellusci, A. Ricerche e studi tra gli arbërori dell’Ellade, Cosenza, 1994.
- ❖ Bozhori, K. Dokumente të periudhës bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. VII-XV, Tiranë, 1978.
- ❖ Ceka, H. Përputhje onomastike ilire-epirote, SF, 1, 1965.
- ❖ Clayer, N. Aux origines du nationalisme albanais, Paris, 2007.
- ❖ Çabej, E. Studime gjuhësore, vëll. I, Prishtinë, 1976.
- ❖ Çabej, E. Studime gjuhësore, vëll. II, Prishtinë, 1976.
- ❖ Çabej, E. Për pastërtinë e gjuhës, Gjuha jonë, 2, 1981.
- ❖ Çabej, E. Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes, SF, 1, 1975.
- ❖ Çabej, E. Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve, BSHSH, 1958.
- ❖ Çabej, E. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike e shqipes, Tiranë, 1957.
- ❖ Çabej, E. Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes, SF, 4, 1975.
- ❖ Çabej, E. Studime etimologjike në fushëtë shqipes, I, Tiranë, 1980.
- ❖ E.Çabej, Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe, Studime historike, nr.3, 1972.
- ❖ E.Çabej, Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe, Studime historike, nr.3, 1972.
- ❖ Çeliku, M. Disa detyra të leksikografisë së sotme shqipe, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Çeliku, M. Çështje të shqipes standarde, Tiranë, 2000.

- ❖ Dialektologjia shqiptare, vëll.VI, Tiranë, 1990.
- ❖ Daka, P. Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe, SF, 3, 1968.
- ❖ Daka, P. Vëzhgime mbi emrat vetjakë të ardhur nga leksiku i përgjithshëm i shqipes, SF, 3, 1970.
- ❖ Daka, P. Emrat e njerëzve në gjuhën tonë, GjJ, 1, 1981.
- ❖ Demiraj, Sh. Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Shkenca, Tiranë, 1999.
- ❖ Dine, S. Mbledhës të folklorit të hershëm shqiptar.III, Valët e Detit, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1962.
- ❖ Draga, N. Shqiptarët në Mal të Zi, Ulqin, 1994.
- ❖ Domi, M. Burime dhe materiale të shqipes së shek. XV, Studime, Prishtinë, 2001.
- ❖ Duro, A. Pasqyrimi i termave me strukturë togfjalëshi në fjalorët terminologjikë të shqipes, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Duro, A. Termi dhe fjala në gjuhën shqipe, Tiranë, 2009.
- ❖ Duro, A. Terminologjia si sistem, Tiranë, 2001.
- ❖ Doci, R. Antroponimia paraislame e Llapushës në dritën e mikrotoponimisë, OK, Prishtinë, 1979.
- ❖ Doci, R. Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës, Prishtinë, 1990.
- ❖ Dautat, A. Les noms de famille de France, Paris, 1949.
- ❖ Dautat, A. La toponymie mie française, Paris, 1946.
- ❖ Debove, J.R Etude linguistique et semiotique des dictionnaires français contemporains, La Haye, 1971.
- ❖ Desnickaja, A. Gjuha shqipe dhe dialektet e saj, Prishtinë, 1972.
- ❖ Dhrimo, A. Probleme teorike dhe praktike për hartimin e fjalorëve dygjuhësh, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Dhrimo, A. Formimi i mbiemrave në gjuhën shqipe, SF, 3, 1972.
- ❖ Dhrimo, A. Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit, SF, 3, 1974.
- ❖ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotmeshqipe, II, Tiranë, 1976.
- ❖ Feka, Th. Rreth fjalorëve krahinorë të gjuhës shqipe, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Feka, Th. Vëzhgime mbi leksikun terminologjikë “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, SF, 2, 1986.
- ❖ Gashi, S. Nga leksiku i pasivizuar i shqipes në mikrotoponimi, Onomastica Jugoslavica 5, Zagreb, 1975.
- ❖ Germiaj, Sh. Fjalorët anglisht-shqip dhe shqip-anglisht, arritje dhe sfida, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Gjinari, J. Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, Gjuha jonë, 2, 1982.
- ❖ Gjinari, J. Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet, SF, 1, 1965.

- ❖ Gjevori, M. Frazologjizma të gjuhës shqipe, Prishtinë, 1972.
- ❖ Gjocaj, Z. Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe, Prishtinë, 2001.
- ❖ Hysa, E. Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, SF, 3, 1973.
- ❖ Hysa, E. Formimet me prapashtesa në shqipen e sotme letrare, SF, 1, 1970.
- ❖ Hysa, E. Gramatika në fjalorët e shqipes, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Hysa, E. Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005.
- ❖ Hoxha, Sh. Gjurmime toponimike, Tiranë, 1998.
- ❖ Ismajli, R. Disa çështje të onomastikës mesjetare, OK, Prishtinë, 1979.
- ❖ Ismajli, R. Gjuha standarde dhe histori identitetesh, Prishtinë, 2008.
- ❖ Ismajli, R. Tekste të vjetra, Pejë, 2000.
- ❖ Islamaj, Sh. Për një leksikografi bashkëkohore, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Islamaj, Sh. Sinonimia frazeologjikenë gjuhën shqipe, SF, 4, 1986.
- ❖ Jacques, E. The Albanians. An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present, London, 1995.
- ❖ Jubani, Z. Vepra të zgjedhura, (mbledhur nën kujdesin e Jup Kastriotit) Tiranë, 1966.
- ❖ Kostallari, A. Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, “Studime mbi leksikun.....”, II, 1972.
- ❖ Kostallari, A. Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme, “Studime mbi leksikun.....”, II, 1972.
- ❖ Kostallari, A. Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes, “Studime mbi leksikun.....”, I, 1972.
- ❖ Kostallari, A. Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare të kohës sonë, “Studime mbi leksikun.....”, I, 1972.
- ❖ Kostallari, A. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Tiranë, 1984.
- ❖ Kostallari, A. Kompozita ekzcentrike të shqipes si tema fjalëformuese, “Studime mbi leksikun.....”, I, 1972.
- ❖ Kostallari, A. Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, “Studime mbi leksikun.....”, I, 1972.
- ❖ Kostallari, A. Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shek. XVII-XVIII, “Studime mbi leksikun.....”, III, 1989.
- ❖ Kuriloviç, I. La position linguistique du nom propre, Onomastika, II, Wroclaw, 1956.
- ❖ Kuçuli, H. Sprovë për studimin e emrave të familjeve në rrethin e Vlorës, Studime për nder të A.Xhuvanit, Tiranë, 1986.
- ❖ Kryeziu, B. Standardi i shqipes dhe disa probleme rreth tij” në “Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë”, Ohër, 2007.

- ❖ Leka, F. “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954)- i pari fjalor shpjegues i gjuhës sonë, Gjuha jonë, 1, 1984.
- ❖ Leka, F. Vendi i termave në gjuhën letrare, “Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë”, 2, 1974.
- ❖ Lafe, E. Toponime latine-romane në truallin e shqipes, Kuvendi I i studimeve ilire 1972, botuar 1974.
- ❖ Lafe, E., Çepani, A., Rreth pasqyrimin të fushave terminologjike në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Lafe, E. Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional, Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003.
- ❖ Luka, K. Formantët stër-, stra- në onomastikë, SF, 3, 1978.
- ❖ Luka, K. Elemente toponomastike mbi feudalizmin paraturk në Shqipëri, S.H, 1, Tiranë, 1975.
- ❖ Luka, K. Raste ndërhyrjesh administrative në toponiminë e Defterit të Shkodrës të vitit 1485, SF, 2, Tiranë, 1975.
- ❖ Luka, D. Shënime mbi toponomastikën e krahinës së krujës, SF, 4, Tiranë, 1975.
- ❖ Lyons, J. Structural semantics, I, Cambridge, 1977.
- ❖ Lloshi, Xh. Mbi rregullsitë në ndryshimet e emrave të njerëzve, SF, 2, 1969.
- ❖ Lloshi, Xh. Stilistika dhe pragmatika, Tiranë, 1999.
- ❖ Lloshi, Xh. Tipare të sistemit stilistik në gjuhën e sotme shqipe, “Studime filologjike”, 1, 1985.
- ❖ Murati, Q. “Fjalori i gjuhës shqipe”, fonde leksikore dhe probleme standardologjike, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Murati, Q. Dëshmi onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni, Tiranë, 1993.
- ❖ Mansaku, S. Përmasa historiko-etimologjike në leksikografinë shqipe, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Mansaku, S. Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë, SF, 3, 1982.
- ❖ Memisha, V. Rreth vargut fjalëformues folje-emër veprimi-mbiemër prejpjesor në fjalorët shpjegues të shqipes, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Memisha, V. Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999.
- ❖ Memisha, V. Rreth emrave të formuar me parashtesën -mos në gjuhën shqipe, Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2004 (22.02).
- ❖ Memisha, V. Rreth një fjalori shkurtesash në gjuhën shqipe, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, Ohër, 2007.

- ❖ Memisha, V. Termat togfjalësha në fjalorët shpjegues të shqipes, Konferenca “Terminologjia e shqipes-dukuri dhe probleme”, Tiranë, 2009.
- ❖ Memushaj, R. Hyrje në gjuhësi, Tiranë, 2004.
- ❖ Memushaj, R. Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike, Toena, Tiranë, 2006.
- ❖ Martine, A. Elemente të gjuhësisë së përgjithshme, Tiranë, 2003.
- ❖ Murati, Q. Fjalor i gjuhës shqipe, fondi leksikor dhe probleme standardologjike, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Murati, Q. Për shqipen standarde, Prishtinë, 2009.
- ❖ Milkani, V. Vëzhgime mbi emërtimet e njerëzve sipas profesionit, Studime mbi leksikon.....”, I, 1972.
- ❖ Mile, I. Zejtaria fshatare shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare, Tiranë, 2001.
- ❖ Mulaku, R. Hulumtime dialektologjike dhe onomastike, Prishtinë, 2005.
- ❖ Myderrizi, O. Emri i vjetër kombëtar i shqiptarëve, S.H, 1965.
- ❖ Myderrizi, O. Toponomastika jonë dhe disa çështje të historisë së popullit tonë, Konferenca II e Studimeve albanologjike, Tiranë, 1969.
- ❖ Ndocaj, F. Mbi fondin e fjalëve dhe kuptimet e tyre në Fjalorin e gjuhës shqipe, Studime mbi leksikon.....”, II, 1972.
- ❖ Omari, A. Disa sllavizma të pavëna re në të folmet veriore të shqipes, SF, 1-4, Tiranë, 1994.
- ❖ Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979.
- ❖ Osmani, T. Vep. cit.
- ❖ Pasho, H. Marrëdhëniet e leksikut të përgjithshëm me leksikon terminologjik, Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003.
- ❖ Pasho, H. Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në vitet ’80 të shek.XX, Tiranë, 2005.
- ❖ Petta, P. Despoti d’Epiro e principi di Macedonia, Lecce, 2000.
- ❖ Pilika, Dh. Pellazgët, origjina jonë e mohuar, Tiranë, 2005.
- ❖ Pulaha, S. Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, Tiranë, 1984.
- ❖ Qosj, R. Fjala e hapjes, OK, Prishtinë, 1979.
- ❖ Rey, A. Dictionnaire alphabetique et analogique de la langue française, Le Robert, 1985.
- ❖ Rrokaj, Sh. Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme, Tiranë, 2007.
- ❖ Rrokaj, Sh. Çështje të gjuhësisë shqipe, Tiranë, 2007.
- ❖ Rrokaj, Sh. Hartimi i fjalorëve dhe gramatikave thesare, një mundësi më shumë për pasurimin e gjuhës standarde shqipe, Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003.
- ❖ Sejdiu, Sh. Rreth disa motivimeve denominuese në antroponimi, 2002.
- ❖ Samara, M. Parafjalët në gjuhën shqipe, Tiranë, 1999.

- ❖ Samara, M. Rreth normës leksikore dhe kodifikimit të saj në fjalorët shpjegues të shqipes, Konferencë shkencore, 2004.
- ❖ Sorensen, H. The meaning of proper Names With a Definien names in Modern English, Copenhagen, 1963.
- ❖ Sotiri, N. E folmja dhe toponimia e Himarës, Tiranë.
- ❖ Spiro, A. Mbi drejtshkrimin shqip të disa emrave me prejardhje greke, Albanohellenica, nr.1, 1999.
- ❖ Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972.
- ❖ Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, Tiranë, 1972.
- ❖ Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, III, Tiranë, 1989.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Onomastika dhe etnolinguistika, ShBLU, Tiranë, 2001.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Sociolinguistika, SHBLU, Tiranë, 1999.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Elemente etnokulturore në fjalorë të shqipes, Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Disa veçori strukturore e semantike të toponimeve të formuara me mjetet e shqipes, SF, 3, 1987.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Shqyrtime sociolinguistike për emrat e farefisnisë dhe për emrat vetjakë të shqipes, SF, 3-4, 1999.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Zbunimi si shkak i lindjes së trajtave të dyta të emrave vetjakë SF, 1-2, 1999.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2004.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Kultura e gjuhës, Tiranë, 2006.
- ❖ Shkurtaj, Gj. Si të shkruajmë shqip, Bot.Toena, Tiranë, 2008.
- ❖ Shehu, H. Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes, “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë” Tiranë, 2004.
- ❖ Shehu, H. Rreth ndajshtesave në gjuhën e sotme shqipe, SF, 2, 1989.
- ❖ Shehu, H. Rreth vlerave potenciale të leksikut popullor për gjuhën e sotme letrare shqipe, Studime mbi leksikun.....”, III, 1989.
- ❖ Shpuza, V. Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve, Shkodër, 1998.
- ❖ Titra, M. Migrimet e shqiptarëve, të brendshme dhe të jashtme, Tiranë, 1999.
- ❖ Toçi, V. Të dhëna mbi onomastikën ilire në Dyrrah dhe në qendra të tjera të vendit tonë, Konferenca II e studimeve albanologjike, Tiranë, 1969.
- ❖ Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë 2006.
- ❖ Thomai, J. Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe. Tiranë 2001.
- ❖ Thomai, J. Çështje të leksikut potencial në gjuhën shqipe, gjuha jonë, 2, 1986.
- ❖ Thomai, J. Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, Tiranë 1989.
- ❖ Thomai, J. Mbi mënyrën e pasqyrimin të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe, Studime mbi leksikun.....”, II, 1972.

- ❖ Thomai, J. "Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë", (artikull në Konferencën shkencore) Tiranë, 2004.
- ❖ Thomai, J. Leksikografia shqipe drejt objektivash madhorë: Fjalori i madh i gjuhës shqipe, "Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë", Ohër, 2007.
- ❖ Thomai, J. Rreth semantikës së foljeve veprorë, pësore e vetvetore në gjuhën shqipe, "Gjuha jonë", 3, 1984.
- ❖ Thomai, J. Shqipja standarde dhe leksikografia shqipe, Konferenca shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë, 2003.
- ❖ Thomai, J. Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe, Tiranë, 2004.
- ❖ Thomai, J. Tipat themelor të derivacionit në gjuhën shqipe, në "Studime filologjike", III, Tiranë, 1981
- ❖ Xhuvani, A. Çështja e "Fjalorit të gjuhës shqipe", Studime mbi leksikun...", II, 1972.
- ❖ Xhuvani, A. Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë 1956.
- ❖ Xhuvani, A.-Çabej, E. Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë 1962.
- ❖ Xhuvani, A. Prapashtesat -më, -imë, -im, Studime mbi leksikun.....", I, 1972.
- ❖ Xhuvani, A. Studime të gjuhësisë, 1956.
- ❖ Xhuvani, A. Vepra, I, Tiranë, 1980.
- ❖ Xhuvani, A. Vepra, II, Tiranë, 1990.